

MANUAL

PËR PUNONJËSIN E SHËRBIMIT TË PROVËS



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

MANUAL

PËR PUNONJËSIN

E

SHËRBIMIT TË PROVËS



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

janar 2014

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Botimi i parë: 2009
Ribotim: 2010
Ribotim: 2014 (me ndryshime të Shtojcat)

AUTORËT: Kevin Haines
Rasim Gjoka
Migena Leskoviku
Ioana van Nieuwkerk
Sorina Poledna
John Graham Deering
Eliona Kulluri
Marinela Sota
Lukas Pieplow

Përkthimi: Jorida Nano

Redaktimi shkencor dhe letrar: Ioana van Nieuwkerk
Migena Leskoviku
Alba Jorganxhi

Design & Layout: INTERGRAFIKA

ISBN:

Përmbajtja

Parathënie.....	7
Rreth autorëve të Manualit.....	14
1. Çfarë është shërbimi i provës?.....	19
<i>Kevin Haines</i>	
2. Ndërmjetësimi midis viktimës - autorit të veprës penale, Drejtësia Restauruese.....	45
<i>Rasim Gjoka</i>	
3. Konteksti ndërkombëtar i shërbimit të provës.....	64
<i>Migena Leskoviku</i>	
4. Legjislacioni shqiptar për shërbimin e provës	
4.1 Legjislacioni bazë për shërbimin e provës.....	82
<i>Migena Leskoviku</i>	
4.2 Aktet nënligjore për shërbimin e provës në Shqipëri	97
<i>Ioana van Nieuwkerk</i>	
5. Njohuri kriminologjike për punonjësin e shërbimit të provës	
5.1 Teoritë sociologjike dhe teoritë psikologjike.....	114
<i>Migena Leskoviku dhe Marinela Sota</i>	
5.2 Studimi i karrierës kriminale.....	127
<i>Migena Leskoviku</i>	
6. Metodat e punës me të dënuarit	
6.1 Vlerat, parimet dhe aftësitë profesionale në shërbimin e provës.....	132
<i>Sorina Poledna</i>	
6.2 Çfarë funksionon: teoria e sjelljes njohëse dhe modeli i ndërprerjes.....	152
<i>John Deering</i>	
6.3 Puna në nivel individual. Këshillimi dhe intervistimi.....	161
<i>Sorina Poledna dhe Eliona Kulluri</i>	
6.4 Puna në grup.....	186
<i>John Deering</i>	

6.5	Zhvillimi i komunitetit. Roli i vullnetarëve. Protokollet e bashkëpunimit.....	195
	<i>Marinela Sota</i>	
7.	Puna me të dënuarit	
7.1	Puna në gjykatë.....	201
	<i>John Deering</i>	
7.2	Mbikqyrja e të dënuarve në komunitet.....	209
	<i>Migena Leskoviku</i>	
7.3	Puna në burgje.....	217
	<i>Marinela Sota</i>	
7.4	Risistemimi i të dënuarve.....	234
	<i>John Deering</i>	
8.	Disa grupe të veçanta	
8.1	Të miturit.....	242
	<i>Migena Leskoviku</i>	
8.2	Personat me sëmundje mendore, autorë të veprave penale.....	250
	<i>Ioana van Nieuwkerk</i>	
9.	Vlerësimi i aktivitetit të shërbimit të provës.....	267
	<i>Migena Leskoviku dhe Lukas Pieplow</i>	
	Referencat.....	278
Shtojca 1	Ligji Nr.10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.....	283
Shtojca 2	Vendim nr. 302, Datë 25.3.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.....	291
Shtojca 3	Vendim nr. 377, Datë 6.6.2012 “Për kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe të drejtat e detyrimit e tij”.....	314
Shtojca 4	Urdhër, nr. 05, Datë 10/01/2013 “për, përcaktimin e metodologjisë dhe rregullave të ushtrimit të kontrolleve për mënyrën e realizimit të mbikqyrjes elektronike, periodicitetit dhe përmbajtjes së	

	informacionit të përcjellë ministrisë së drejtësisë, si dhe rregullave për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë gjykatave.....	319
Shtojca 5	Udhëzim, nr. 06, Datë 10/01/ 2013 “për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret e dhënies së autorizimit për subjektet e vendosura nën mbikqyrje Elektronike për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar.....	326
Shtojca 6	Intervistë.....	331
Shtojca 7	Raport i vlerësimit për personin nën hetim / të pandehurin.....	339
Shtojca 8	Raport i vlerësimit për të dënuarin.	342
Shtojca 9	Programi Individual i Trajtimit	346
Shtojca 10	Raport përfundimtar	349
Shtojca 11	Marrëveshje bashkëpunimi	351

Parathënie

Sistemi i drejtësisë penale në Shqipëri është i bazuar kryesisht te aplikimi i dënimit me burgim, me një numër të pakët alternativash të tjera dënimi. Modeli i dënimeve ka tendencë drejt burgimit, me masa të gjata të këtij dënimit, dhe ku mbipopullimi është një problem serioz. Duke ndjekur rekomandimet që theksohen në një sërë instrumentesh ndërkombëtarë, autoritetet shqiptare kanë treguar angazhimin e tyre drejt krijimit të mundësive për një zbatim në rritje të alternativave të dënimit me burgim, me qëllim që të reduktohet mbipopullimi në burgje, kostot dhe efektet negative të burgimit të panevojshëm.

Ekziston një nevojë e njohur për të zhvilluar një shërbim kombëtar të provës për të mbikëqyrur të dënuarit në komunitet. Gjithashtu, ekziston edhe një nevojë për të shkuar drejt dënimeve të individualizuara, të cilat kërkojnë më shumë informacion mbi të dënuarit që mund të paraqiten në gjykatë për të kërkuar zbatimin e sanksioneve komunitare në vend të burgimit. Në 27 nëntor 2008 u miratua baza ligjore që mundësoi krijimin e shërbimit të provës në Shqipëri. Krijimi i shërbimit të provës, i cili mund të përgatisë raporte dhe të ofrojë mbikëqyrje të planifikuara në komunitet, është një hap përpara në reformën e sistemit të drejtësisë penale. Ka shumë gjasa që funksionimi i këtij shërbimi të ri, të inkurajojë gjyqtarët për të dhënë më shumë dënime alternative.

Në momentin e përgatitjes së këtij Manuali, shërbimi kombëtar i provës ende nuk kishte filluar funksionimin e tij, por ishte në krijim e sipër, si një strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo strukturë e re do të krijohet në nivel qendror (në nivel inistrie) dhe në nivel lokal. Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni të ri në sistemin e drejtësisë penale është një proces i gjatë dhe kërkon, si një nga faktorët kryesorë, personel të trajnuar në mënyrë të mjaftueshme dhe mbështetje përmes programeve arsimore.

Manuali për shërbimin e provës është hartuar me iniciativën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, me qëllim që të ndihmojë në trajnimin e punonjësve të shërbimit të provës që do të punësohen nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë drejtim, aktualisht në Shqipëri nuk ka asnjë material tjetër trajnimi të vlefshëm në gjuhën shqipe. Manuali u përgatit me kontributin e ekspertëve të huaj dhe vendas dhe mund të konsiderohet si materiali bazë kur të fillojnë kurset e trajnimit për kandidatët që do përzgjidhen për pozicione të ndryshme në shërbimin e provës. Në të njëjtën kohë, ky manual mund të konsiderohet edhe si një përfitim i rëndësishëm për gjyqtarët, prokurorët, avokatët, stafin akademik, punonjësit socialë, psikologët dhe profesionistët e tjerë,

pasi ai jep një përshkrim të mjaftueshëm të filozofisë profesionale dhe aktivitetëve të një institucioni të ri që punon me të dënuarit në sistemin e drejtësisë penale.

Kursi i trajnimit synon të mundësojë bazën e përshtatshme metodologjike dhe teorike, e nevojshme për punonjësit e shërbimit të provës për të hartuar raportet para dhënies së dënimit dhe për të mbikëqyrur siç duhet të dënuarit në komunitet. Manuali specifikon njohuritë dhe aftësitë që janë me rëndësi bazë për punonjësit e rinj të shërbimit të provës në Shqipëri, të cilat duhet të përmbushen për të arritur standardet minimale të punës për personelin e nivelit bazë. Ai garanton konceptet bazë, mjetet dhe aftësitë e nevojshme për punën e punonjësit të shërbimit të provës. Në hartimin e manualit janë marrë në konsideratë shembuj të praktikës më të mirë nga vende të tjera dhe nga Shqipëria.

Manuali i shërbimit të provës është i ndarë në 9 krerë. Kreu i parë paraqet konceptin shërbimit të provës dhe momentet më të rëndësishme të zhvillimit të tij. Ai përshkruan dhe krahason dy sisteme evropiane – sistemin britanik dhe danez, duke marrë në konsideratë përjasjen e tyre sistematike. Sistemet e shërbimit të provës në këto vende analizohen në ndërveprim me nën-sistemet e drejtësisë për të mitur, të asistencës për ish të dënuarit, etj. Parimi i përjasjes sistematike i paraprin parimeve të cilat përmenden nga autori në fund të këtij kreu.

Kreu i dytë u referohet praktikave të ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale (VOM) dhe drejtësisë restauruese. Kreu përshkruan se si aplikimi i drejtësisë restauruese, si një alternativë e sistemit të drejtësisë penale ndëshkimore tradicionale, mund të ketë pasoja pozitive ndaj riintegritimit të të dënuarve dhe plotësimit të nevojave të viktimës dhe komunitetit. Praktikën restauruese gjenden në të drejtën zakonore shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjinit ku instituteve të pajtimit dhe ndërmjetësimit u jepet një rol i rëndësishëm në garantimin e paqes dhe mirëkuptimit mes palëve duke shmangur mosmarrëveshjet dhe konfliktet. Bazuar mbi këtë fakt, kreu prezanton një projekt-pilot të suksesshëm në lidhje me ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale dhe drejtësinë restauruese, të zbatuar nga një OJF shqiptare me asistencën e Shërbimit Norvegjez të Ndërmjetësimit.

Kreu i tretë prezanton standardet ndërkombëtare të aplikueshme në zbatimin e masave dhe sanksioneve komunitare, të fokusuara veçanërisht te Rregullat e OKB-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës. Pas prezantimit të kontekstit ndërkombëtar të aktivitetëve të shërbimit të provës, kreu i katërt përshkruan kuadrin ligjor shqiptar të adoptuar për krijimin dhe funksionimin e shërbimit të provës si një institucion i pavarur nga institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë penale. Këtu prezantohen dispozitat e Kodit Penal mbi alternativat e dënimit me burgim dhe dispozitat e ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Për më tepër, në këtë manual përfshihet një nën-kre mbi Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e

shërbimit të provës, si dhe mbi procedurat e mbikëqyrjes në ekzekutimin e dënimeve alternative. Gjithashtu, këtu duhet të përmendet se rregullat e bashkëpunimit midis shërbimit të provës dhe OJF-ve, si dhe me partnerët e tjerë të mundshëm socialë, ende nuk ishin miratuar apo hartuar në kohën e publikimit të manualit. Kjo është arsyeja se përse këto rregulla nuk janë përfshirë në manual, por ndoshta ato përfshihen në një botim të dytë të këtij manuali.

Kreu i pestë bën një hyrje në kriminologji dhe shqyrton shkaqet e shumta të krimit, kryesisht nga këndvështrimi i sociologjisë, si dhe të raporteve mes strukturave sociale, varfërisë, përfshirjes sociale dhe të ndikimit të tyre në sjelljen kriminale. Kreu i gjashtë prezanton modelet e punës me të dënuarit, duke filluar nga vlerat, parimet dhe kompetencat profesionale në punën e shërbimit të provës. Ai vazhdon me teorinë e sjelljes njohëse si një nga modelet që japin rezultate në punën me të dënuarit. Kreu na njeh gjithashtu edhe me metodat dhe teknikat që përdor shërbimi i provës në punën e tij në nivel individual (intervistimi, këshillimi, zgjidhja e problemeve) si dhe në nivel grupi dhe komuniteti.

Kreu i shtatë fokusohet tek praktika e shërbimit të provës, mbi punën e përditshme të punonjësit të shërbimit të provës në gjykatë, në komunitet dhe në burgje. Ky shërbim harton raportet para dhënies së dënimit në gjykatë, për mbikëqyrjen e të dënuarve në komunitet, vlerësimin e rrezikut për recidivizëm si dhe programet para lirimit nga burgu. Kreu i tetë u dedikohet kategorive të veçanta të të dënuarve si: të miturve, autorë të veprave penale me sëmundje mendore. Kreu i fundit parashtron një sërë modelesh dhe parimesh të përdorura në vlerësimin e efikasitetit të veprimtarisë së shërbimit të provës.

Nga sa më sipër, themi se manuali është një hyrje në teorinë dhe praktikën e shërbimit të provës që mund të përdoret në trajnimin e punonjësve të shërbimit të provës në Shqipëri. Janë disa autorë që kanë kontribuar në hartimin e këtij manuali, shumica e të cilëve akademikë, duke sjellë një shumëllojshmëri stilesh dhe metodash në punën e shërbimit të provës. Megjithatë, mbi të gjitha, manuali përfaqëson një prezantim koherent, sfidues dhe stimulues ndaj temës së ndërlikuar të shërbimit të provës.

Prill 2009

Ioana van Nieuwkerk
Këshilltare e Lartë Ligjore
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Foreword

The Albanian criminal justice system is mainly prison-based, with very few community sentences. The sentencing pattern is towards imprisonment, with lengthy sentences, overcrowding being a serious problem. Following the recommendations outlined in the international instruments, the Albanian authorities have shown commitment towards facilitating an increased use of the alternatives to imprisonment in order to reduce the overcrowding in prisons, the costs and negative effects of unnecessary imprisonment.

There is a recognized need to develop a National Probation Service to supervise offenders in the community. There is also a need to moving towards individualised sentencing, which requires more information on offenders available to the courts in order to apply community sentences instead of custody. On 27 November 2008, the legal framework for the creation of a Probation Service in Albania was adopted. The establishment of a Probation Service which can conduct pre-sentence reports and offer planned supervision in the community is a step forward in the reform of the criminal justice system. It is very likely that the functioning of this new service will encourage judges to impose more alternative sentences.

At the time of writing this Handbook, the National Probation Service is not yet in place, but about to be established under the authority of the Ministry of Justice. A new probation structure will be set up in central (ministry level) and local level. The organization and functioning of this new criminal justice agency is a long process and requires, as one of the main factors, sufficiently trained staff and support through educational programmes.

The Probation Handbook has been designed at the initiative of the OSCE Presence in Albania in order to assist in training the probation officers who will be employed by the Ministry of Justice. No other training materials in Albanian are available in this field. The handbook has been prepared with contribution of international and local experts and could be the basic material when delivering training courses for the candidates to a probation officer position. At the same time, the handbook could be also of significant benefit to judges, prosecutors, defence lawyers, academics, social workers, psychologists and other professionals as it provides for a comprehensive description of the professional philosophy and activities of a new criminal justice agency working with offenders.

The training course aims to facilitate relevant methodical and theoretical background necessary for probation officers to write pre-trial reports and supervise efficiently

the offenders in the community. The handbook specifies the knowledge and skills that are essential for the newly hired probation officers in Albania to meet minimum performance standards for entry-level personnel. It provides for the basic concepts, tools and skills necessary for the probation officer job. In designing the handbook, examples of best practice from other countries and from Albania have been taken into consideration.

The Probation Handbook is divided into nine chapters. The First Chapter presents the concept of probation and its most significant moments of development. It describes and compares two European probation systems, the British and the Danish, taking into consideration their systemic approach. The probation services in these countries are analyzed in interconnection with the sub-systems of juvenile justice, assistance for ex-prisoners etc. The principle of systemic approach anticipates the succession of principles that are stated by the author at the end of the chapter.

The Second Chapter refers to victim-offender mediation (VOM) and Restorative Justice practices. The chapter describes how the emergence of restorative justice as an alternative to the traditional retributive criminal justice system can have positive implications upon the reintegration of offenders and meeting the needs of victim and community. Restorative practices are found in the Albanian customary law, the Kanun of Leke Dukagjini, where the institutions of reconciliation and mediation are given an important role in ensuring peace and understanding between parties, avoiding disputes and conflicts. Based on that, the chapter presents a successful pilot project on VOM and Restorative Justice developed by an Albanian NGO with the assistance of the Norwegian Mediation Service.

The Third Chapter introduces the international standards applicable to the implementation of community measures and sanctions with a particular focus on the United Nations Rules and Council of Europe Recommendations. After the presentation of the international context of probation activities, Chapter Four describes the Albanian legal framework adopted for the creation and functioning of probation services as an independent agency in the criminal justice system. The Criminal Code provisions on alternatives to imprisonment and the dispositions of the Law on the execution of criminal decisions are presented. Moreover, a sub-chapter on the Regulations on the organisation and functioning of the probation service and the standards and procedures of supervising the execution of alternative sentences is included in the handbook. It should also be stated here that the Rules of co-operation between the probation services and NGOs and other potential social partners have not been adopted or even drafted at the time of publishing the handbook. That is why such rules are not provided for in the Manual, but it is intended to insert them in an updated edition of the handbook.

Chapter Five is an introduction to criminology and investigates the many causes of crime mainly from the point of view of sociology, and the relationships between social structure, poverty, social inclusion and their impacts upon criminal behaviour. The Sixth Chapter presents methods of working with offenders, starting with the values, principles and professional competences in the probation work. It continues with the cognitive-behavioural approach as one of the models that achieve results in the work with offenders. The chapter introduces also the methods and techniques used in probation work at individual level (interviewing, counselling, problem solving) and at group and community level.

Chapter Seven focuses on probation practice, on the daily work of a probation officer in court, in the community and in prison. It introduces the pre-sentence reports for the judges, the supervision of offenders in the community, the assessment of the risk of re-offending, the prison pre-release programs. The Eight Chapter is dedicated to some special categories of offenders, respectively juveniles and mentally ill offenders. The last chapter provides a set of models and principles used in the evaluation of efficiency and efficacy of probation activities.

The Handbook is therefore an introduction to probation theory and practice to be used in the training of probation officers in Albania. There are several authors who contributed to the design of the handbook, most of them academics, bringing a diversity of styles and approaches to probation work. However, overall the handbook presents a comprehensive, challenging and stimulating introduction to the diverse and complex subject of probation.

April 2009

Ioana van Nieuwkerk
Senior Legal Officer
OSCE Presence in Albania

Rreth autorëve të Manualit

Ky manual është përgatitur nga disa ekspertë shqiptarë dhe të huaj, akademikë dhe punonjës të praktikës, specialistë në fushën e drejtësisë penale dhe të shërbimit të provës. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dëshiron t'u shprehë mirënjohjen dhe t'i falënderojë të gjithë autorët për interesin dhe entuziazmin e tyre që treguan duke punuar së bashku, duke kontribuar për zhvillimin e shërbimit të provës në Shqipëri.

Kevin Haines është lektor në Kriminologji dhe Drejtor i Qendrës për Drejtësinë Penale dhe Kriminologjinë në Universitetin e Uellsit, Swansea - Mbretëria e Bashkuar. Ai ka kryer një Master në Filozofi dhe një Doktoraturë në Kriminologji në Universitetin e Kembrixhit, para sesa të punonte si bashkëpunëtor shkencor në një projekt kërkimor mbi vlerësimin dhe njohjen me gjykatat për të mitur në Angli dhe Uells. Kevin Haines është anëtar i bordit të Rrjetit Ndërkombëtar për Kërkime në fushën e drejtësisë për të mitur, dhe ndërmjet viteve 1998 dhe 2003 ka punuar me Ministrinë e Drejtësisë në Rumani për krijimin e shërbimit të provës dhe zbatimin e sanksioneve komunitare. Ai ka mjaft publikime mbi çështje që lidhen me drejtësinë për të mitur.

Rasim Gjoka është një nga themeluesit dhe Drejtor Ekzekutiv i “Fondacionit Shqiptar për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve”, si dhe Kryetar i Forumit për Ndërmjetësim të Evropës Juglindore. Që prej vitit 1981, ai është aktivizuar si lektor i lëndës së Sociologjisë së Besimit dhe Edukimit në Universitetin e Tiranës. Rasim Gjoka ka bërë mjaft trajnime në menaxhim konfliktesh, ndërmjetësim, dhe drejtësinë restauruese, si dhe ka zbatuar për herë të parë në Shqipëri, një projekt të suksesshëm mbi ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale dhe praktikat e drejtësisë restauruese. Ai është autor dhe bashkautor i disa studimeve sociologjike dhe manualeve në fushën e menaxhimit të konfliktëve, ndërmjetësimit, edukimit për paqen, drejtësisë restauruese.

Migena Leskoviku është lektore e të Drejtës Penale dhe Kriminologjisë në Universitetin e Tiranës që prej vitit 1998. Në periudhën 2000-2003, ajo ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si Shefe e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun, dhe ka qenë e angazhuar në aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të Reformës në Burgje dhe të Sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, ku ndër më kryesorët janë aktivitetet me Këshillin e Evropës dhe pjesëmarrja e saj si Kryesuese e Grupit për Çështjet Ligjore, në

kuadër të Projektit të parë të binjakëzimit për reformën në sistemin penitenciar, programi CARDS për Shqipërinë. Gjithashtu, ajo ka eksperiencë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, pasi ka punuar si Drejtore e Shërbimeve Juridike në dy ministri. Në vitin 2008, ajo është angazhuar si Konsulente Kombëtare në një Projekt Kërkimor të UNICEF-it, për vlerësimin e situatës së sistemit të drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri. Migena Leskoviku ka publikuar mjaft artikuj si dhe është bashkautore e librit “Kushtet e paraburgimit dhe të burgjeve në Shqipëri”.

Ioana van Nieuwkerk është Këshilltare e Lartë Ligjore pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, e cila bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë në Shqipëri në krijimin dhe funksionimin e shërbimit të provës në Shqipëri. Ajo ka mjaft eksperiencë në praktikën e shërbimit të provës, në menaxhimin dhe zhvillimin institucional, duke qenë Drejtoresha e parë e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në Rumani, e emëruar në këtë pozicion në vitin 1998. Ioana van Nieuwkerk ka asistuar autoritetet shqiptare në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Shërbimin e Provës dhe alternativat e dënimit me burgim, në trajnimin e trajnerëve të ardhshëm të Shërbimit të Provës, në hartimin e një strategjie rekrutimi dhe një programi për brezin e parë të punonjësve të shërbimit të provës në Shqipëri. Ajo është iniciatore dhe kryeson Grupin Këshillimor të Shërbimit të Provës në Tiranë.

Sorina Poledna është Profesore e Asociuar në Universitetin Babes-Bolyai, në Cluj –Napoca, Rumani, ku ajo ka filluar për herë të parë programin e trajnimit profesional për punonjësit e Shërbimit të Provës. Ajo jep mësim në lëndët e Sociologjisë së Devijancës, Metodën e punës sociale, Asistenca Sociale për viktimat dhe autorët e veprave penale, teoria dhe metodologjia e Shërbimit të Provës. Sorina Poledna ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në krijimin dhe zbatimin në Rumani, të politikave arsimore dhe trajnuese kombëtare për punonjësit e Shërbimit të Provës, si dhe ka qenë koordinatorë në një nga projektet e para pilote për Shërbimin e Provës në Transilvani të Rumanisë. Ajo ka publikuar disa libra mbi metodën e punës me të dënuarit, ndërmjetësimin dhe abuzimin me drogën.

John Graham Deering është titullar i lëndës Drejtësia Penale dhe Komunitare, në Universitetin e Newport Wales, Mbretëria e Bashkuar. Ai është i përfshirë drejtpërdrejt në trajnimin profesional të punonjësve të Shërbimit të Provës dhe është drejtues i kursit për drejtësinë për të mitur, si dhe drejtues i programit për drejtësinë në komunitet, *BA* (në nivelin e parë të studimeve) për punonjësit e Shërbimit të Provës. Gjithashtu, John Deering është edhe një punonjës i praktikës me përvojë të gjatë, dhe në harkun kohor të viteve 1984-1991, ai ka punuar si

punonjës i shërbimit të provës dhe Drejtues i Lartë (1991-2003) në Zyrën e Shërbimit të Provës në Uellsin Jugor. Ai është anëtar i Shoqatës Britanike të Kriminologjisë dhe ka publikuar një sërë artikujsh në lidhje me punën me të dënuarit, si dhe ka bërë kërkime mbi ndikimin e ndryshimeve në sistemin e drejtësisë penale në punën e punonjësve të Shërbimit të Provës në Angli dhe Uells.

Eliona Kulluri është lektore e lëndëve metodat e kërkimit në punë sociale, politika sociale, shëndetin mendor, teknikat e intervistimit dhe këshillimit, dhe praktikat e punës sociale me grupet dhe komunitetin, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Që prej vitit 2004, ajo ka marrë pjesë si trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Eliona Kulluri është Drejtuese e Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë në Shqipëri, si dhe gjatë viteve 1998-2007 ka qenë koordinatorë e një projekti për krijimin e një qendre strehimi për vajzat dhe gratë e abuzuara në Tiranë,. Ajo ka bërë disa studime të cilat janë publikuar, ku si ndër më kryesoret janë ato mbi dhunën në familje në Shqipëri, organizuar me iniciativën e UNICEF-it, në lidhje me çështjet e trajtuara në qendrën e ngritur për vajzat dhe gratë e abuzuara, si dhe mbi abuzimin me fëmijët në Shqipëri.

Marinela Sota është pedagoge në Departamentin e Punës Sociale, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës ku ajo ka zhvilluar një modul mbi punën me të dënuarit, si diçka e re për programin e trajnimit në Shqipëri. Ajo ka eksperiencë pune në lidhje me problemet e burgjeve, pasi për disa vite ka qenë inspektore burgjesh dhe më pas Drejtore e Burgut të Grave në Tiranë, në periudhën 2005-2008. Marinela Sota është anëtare e Komitetit Drejtues të Shoqatës Evropiane të Edukimit në Burgje dhe anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Burgjeve. Ajo ka publikuar disa artikuj mbi kriminalitetin e të miturve, reformën në burgje dhe një guidë për edukatorët dhe punonjësit socialë të burgjeve.

Lukas Pieplow është avokat, i specializuar në çështjet penale në Rechtsanwalte Esche & Partner - Cologne, Gjermani. Në periudhën e viteve 1983-1989, ai ka punuar si asistent/lektor në Departamentin e të Drejtës Penale për të Miturit, në Kriminologji dhe Sistemin Korrektues, Universiteti i Hamburgut dhe Cologne në Gjermani. Ai është bashkëthemelues i një projekti të suksesshëm mbi ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale, i quajtur “Die Waage” në Cologne. Lukas Pieplow ka mjaft publikime mbi çështje që lidhen me dënimin, kriminologjinë dhe ndërmjetësimin. Ai është anëtar i Bordit Ekzekutiv të Shoqatës Gjermane për Gjykatat e të Miturve, dhe ka kontribuar në reformën e drejtësisë penale për të miturit në Gjermani në periudhën 2001-2002.

About the authors

This handbook has been written by a range of international and Albanian academics and practitioners in the field of criminal justice and probation. The OSCE Presence in Albania would like to thank all the authors for their interest and enthusiasm in working together and contributing to the development of Probation in Albania:

Kevin Haines is Reader in Criminology and Director of Centre for Criminal Justice and Criminology at the University of Wales Swansea, UK. He completed an M.Phil and PhD in Criminology at the University of Cambridge before working as a Research Associate on a Home Office funded research project evaluating the introduction of the Youth Court in England & Wales. Kevin Haines is a board member of the International Network for Research on Juvenile Justice and between 1998 and 2003 he worked with the Romanian Ministry of Justice to establish a national Probation Service and community sentences. He has published widely on topics related to youth justice.

Rasim Gjoka is one of the founders and executive director of the Albanian Foundation for “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes” and Chair of the Southeast Europe Mediation Forum. Since 1981 he has worked as a lecturer in Sociology of Religion and Education at the University of Tirana. Rasim Gjoka has had extensive training in conflict management, mediation, and restorative justice and developed for the first time in Albania a successful project on victim-offender mediation and restorative justice practices. He is author and co-author of several sociological studies and manuals in the area of conflict management, mediation, education for peace, restorative justice.

Migena Leskoviku is Lecturer in Criminal Law and Criminology at the University of Tirana since 1998. Between 2000 and 2003 she worked for the General Directorate of Prison Service as Head of International and Public Relations Department, and has been engaged in several international and local activities in the framework of the prison and criminal justice reform in Albania, where some of the most important are the activities organized by the Council of Europe as well as her participation as Head of Legal Affairs Group in the framework of first Twinning Project on Prison Reform, under CARDS Program for Albania. Also, she has experience in drafting legislation as she used to work in Albanian ministries as Director of Legal Service Departments. In 2008 she acted as National Consultant for a regional UNICEF Research Project assessing the situation of Juvenile Justice System in Albania. Migena Leskoviku published several articles and is the co-author of the book “Pre-detention and prison condition in Albania” .

Ioana van Nieuwkerk is Senior Legal Officer at the OSCE Presence in Albania working closely with the Albanian Ministry of Justice in developing a national Probation Service. She has extensive experience in the probation practice, management and institutional development, being the first Director General of Probation Service in Romania appointed in 1998. Ioana van Nieuwkerk has assisted the Albanian authorities in drafting the primary and secondary legislation on probation services and alternatives to imprisonment, in training the future probation trainers, in drafting a recruitment and training strategy and a curriculum for the first generation of probation officers in Albania. She is the initiator and Chair of the Probation Advisory Group in Tirana.

Sorina Poledna is Associate Professor at Babes-Bolyai University in Cluj –Napoca, Romania where she has initiated the professional training programme for probation officers. She teaches Sociology of deviance, Methods of social work, Social assistance of offenders and victims of crimes, Theory and methodology in probation. Sorina Poledna has been contributed significantly to the design and implementation in Romania of the National Education and Training Policy for the probation officers and has coordinated one of the first probation pilot projects in Transilvania, Romania. She has published several books on methods of work with offenders, mediation, and drug abuse.

John Graham Deering is Senior Lecturer in Criminal and Community Justice at the University of Newport Wales, UK. He is directly involved in the professional training of probation officers being the subject leader for the Joint Honours degree in Youth Justice and programme leader for the BA Community Justice (Probation). John Deering is also an experienced practitioner, between 1984 and 1991 he worked as a probation officer and then as a Senior Practitioner & Manager (1991-2003) in the South Wales Probation Area. He is member of the British Society for Criminology, has published several articles on working with offenders and has researched the impact of the changing nature of the criminal justice system in England and Wales upon the work of probation practitioners.

Eliona Kulluri is Lecturer at the University of Tirana, the Faculty of Social Sciences. She teaches research methods in social work, social policy, mental health, techniques of interviewing and counseling and social work practices with groups and communities. She has trained judges and prosecutors on gender and human rights issues at the Albanian School of Magistrates since 2004. Eliona Kulluri is the Chair of the National Association for Social Workers in Albania and coordinated a Shelter project for abused women and girls in Tirana between 1998- 2007. She has published several studies, the most important ones on Domestic Violence in Albania at UNICEF's initiative, on cases treated in the Shelter for abused women and girls and on child abuse in Albania.

Marinela Sota is Lecturer in Social Work at the University of Tirana, the Faculty of Social Sciences where she has developed a module on working with offenders as a novelty for the Albanian training curricula. She has extensive knowledge in prison related issues and experience in working with detainees being a prison inspector for several years and then director for the Women Prison in Tirana between 2005 and 2008. Marinela Sota is a member of the Steering Committee of the European Prison Education Association and of the International Corrections and Prison Association and has published articles on youth criminality, prison reform and a Guide for educators and social workers in prisons.

Lukas Pieplow is Defence Lawyer specialized in criminal cases at Rechtsanwaelte Esche&Partner - Cologne, Germany. Between 1983 and 1989 he worked as Assistant Lecturer at the Department of Juvenile Criminal Law, Criminology and Correctional System at the Universities of Hamburg and Cologne. He is the co-Founder of a successful victim-offender-reconciliation-project called “Die Waage” in Cologne. Lukas Pieplow has published widely on topics related to sentencing, criminology, and mediation. He is member of the executive Board of German Association for Juvenile Courts and contributed in 2001-2002 to the Reform of Juvenile Penal Law in Germany.

Çfarë është shërbimi i provës?

1

Kevin Haines

Shërbimi i provës ekziston në shumë vende të ndryshme në mbarë botën, në çfarëdo regjimi politik apo kulturë. Edhe vetë fjala *shërbim i provës* po përdoret si term ndërkombëtar duke kapërcyer çdo gjuhë dhe ndryshime ligjore. Megjithatë nuk ka një përkufizim të thjeshtë dhe koherent të fjalës “shërbim i provës”. Shërbimi i provës karakterizohet më mirë nga larmia që përmban sesa nga ndjekja e një modeli fiks.

Në Evropë shërbimi i provës njihet një varietet të gjerë formash organizative, p.sh., në Holandë shërbimi i provës sigurohet nga një organizatë kombëtare joqeveritare. Në shumë nga vendet e Evropës Perëndimore ky shërbim është pjesë e strukturave të qeverisjes qendrore (edhe pse zakonisht ndahet në njësi gjeografike). Në Austri dhe Finlandë shërbimi i provës kryhet nga organizata private kombëtare, ndërsa në Gjermani kjo strukturë reflekton strukturat federale dhe shtetërore të qeverisë.

Personeli i organizatave të shërbimit të provës është gjithashtu një fushë e larmishme. Disa nga këto shërbime përdorin gjerësisht punën vullnetare, megjithatë shumica e shërbimeve të provës punësojnë personel të specializuar që u janë nënshtruar trajnimeve profesionale. Edukimi i punonjësve të shërbimit të provës dhe kualifikimet e tyre të veçanta ndryshojnë nga vendi në vend. Në disa vende ekzistojnë sisteme kombëtare trajnimi të centralizuara të shërbimit të provës ndërsa në vende të tjera punonjësit e shërbimit të provës kualifikohen në kurse universitare. Strukturat arsimore variojnë edhe në bazë të orientimit të përgatitjes së shërbimit të provës: çështje të specializuara të drejtësisë penale apo probleme më të përgjithshme të punëve sociale. Ndryshime ka edhe në varësi të faktit se si i përdor shërbimi i provës aftësi të ndryshme profesionale. Disa shërbime prove punësojnë psikologë

ose profesionistë të trajnuar të fushave të tjera (p.sh., të specializuar për të punuar me njerëz që kanë probleme me drogën ose alkoolin). Në disa shtete, shërbimi i provës bashkëpunon me agjenci të tjera që ofrojnë shërbime të tilla të specializuara.

Shërbimi i provës ndryshon nga një vend në një tjetër edhe në lidhje me aktivitetin që kryen. Në disa vende shërbimet e provës janë të kompletuara, d.m.th., që mbulojnë të gjitha fushat e “punëve të shërbimit të provës”. Në vende të tjera ky shërbim ka funksion më të kufizuar, p.sh., mund të merret me përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve në gjykata. Edhe grupet kryesore të synuara të shërbimit të provës variojnë. Në Angli dhe Uells, Irlandë dhe Norvegji shërbimi i provës ka në fokus autorët e veprave penale të cilët paraqesin shkallë të lartë rrezikshmërie, në Holandë fokusi vendoset mbi ata autorë të veprave penale të cilët janë ose mund të motivohen për të ndryshuar, ndërsa në Skoci dhe Spanjë fokusi përqendrohet mbi autorët e rinj në moshë. Edhe niveli i punës me të rinjtë ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Edhe pse zakonisht sistemet e shërbimit të provës merren me autorët e mitur të veprave penale, në shumicën e vendeve sistemi i drejtësisë për të mitur ndryshon shumë nga ai për të rritur dhe ekzistojnë organizma të veçantë, përgjegjësia kryesore e të cilave është të punojnë me të dënuarit e mitur (Mehlby & Walgrave 1998).

Këto ndryshime në fushën e shërbimit të provës komplikohen edhe më tej për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që pëson ky shërbim. Ristrukturimi organizativ është një tipar konstant i shërbimit të provës, megjithatë ky shërbim ka kaluar edhe në një proces zhvillimi (ndonjëherë edhe me ndryshime radikale) në lidhje me orientimin profesional. Kohët e fundit shërbimi i provës është vënë në qendër të vëmendjes të politikës dhe si rrjedhojë ndikohet më tepër nga ndryshimet e politikave dhe ideologjive politike.

Këto tipare të fushës së shërbimit të provës e shtojnë vështirësinë e të gjeturit të një përkufizimi të thjeshtë dhe të kuptueshëm të “shërbimit të provës”. Përpyekjet e deritanishme për të përkufizuar shërbimin e provës kanë dështuar. Për shembull, Kombet e Bashkuara deklarojnë se vënia në provë është një ndëshkim, një metodë për të trajtuar të dënuar të veçantë dhe që konsiston në pezullimin me kusht të dënimit penal dhe i dënuari vihet nën mbikëqyrje dhe merr udhëzim ose trajtim individual (UNICRI 1998). Shërbimi i provës është përkufizuar pak më gjerësisht si:

“Një mënyrë ndëshkimi me bazë sociale-pedagogjike që karakterizohet nga një kombinim i mbikëqyrjes dhe ndihmës. Aplikohet falas për ata të dënuar të përzgjedhur në bazë të personalitetit të tyre kriminal, llojit të krimit dhe pranimet nga ana e tyre, në raport me një sistem, qëllimi i të cilit është t'i japë të dënuarit mundësinë për të ndryshuar përjashten ndaj jetës në shoqëri dhe të bëhet pjesë e mjedisit social të zgjedhjeve pa rrezik se mund të shkelë përsëri ndonjë normë penale shoqërore.” (Cartledge 1995)

Nga këto përkufizime lindin më shumë pyetje sesa sigurohet një përshkrim apo përkufizim i kënaqshëm. A është ndëshkim vënia në provë? A pajtohet ndëshkimi me mbikëqyrjen dhe asistencën? Po për sa i përket rëndësisë gjithmonë e në rritje të kontrollit shoqëror për politikat dhe praktikat e shërbimit të provës? A ekziston personaliteti kriminal? Nëse po apo jo, çfarë nënkupton kjo në lidhje me punën e shërbimit të provës? Ky përkufizim nuk e përmend faktin se vënia në provë është një lloj “lirie e mbikëqyrrur”, me fjalë të tjera “vënia në provë” është një aktivitet që kryhet në komunitet dhe pa qenë nevoja që personat e mbikëqyrrur të kufizohen fizikisht. Po kështu, ky përkufizim nuk përfshin të gjithë gamën e aktiviteteve të shërbimit të provës, si p.sh., strategjitë e skemave alternative, alternativa të paraburgimit (arrest parandalues), etj.

Në përpjekjet e fundit për të gjetur një perspektive evropiane gjithëpërfshirëse mbi shërbimin e provës (duke përfshirë edhe përshkrimet e sistemeve të shërbimit të provës në 19 vende të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore) *Conference Permanente Europeenne de la Probation* (Konferenca e Përherëshme Evropiane e Shërbimit të Provës- CEP) deklaroi:

“Në këtë volum, koncepti i “shërbimit të provës” përdoret njësoj si ajo që në sociologji quhet “koncept sensibilizues”: një koncept i gjerë apo i hapur i cili merr kuptim në kontekstin ku përdoret. Këtu shërbimi i provës nënkupton të gjitha aktivitetet në fushën e drejtësisë penale (raportet për vlerësimin e rrethanave shoqërore, puna e ndërhyrjes së hershme, aktivitetet në fushën e sanksioneve dhe masave komunitare, aktivitetet në institucione të vuajtjes së dënimit (institucione penitenciare), mbikëqyrje, vënia në provë si sanksion penal, aktivitete të parandalimit të krimit, etj.).” (Van Kalmthout & Derks 2000)

Ky nuk është në të vërtetë një përkufizim i shërbimit të provës (por më tepër një përkufizim i “konceptit” të shërbimit të provës), por me fjalë të tjera do të thotë që “shërbimi i provës është ajo çfarë bëhet gjatë vënies në provë”. Në fakt, kjo është mënyra kryesore se si përkufizohet shërbimi i provës, d.m.th., nëpërmjet përshkrimit të aktiviteteve që kryhen dhe mënyrës sesi ato kryhen. Ky proces anashkalon në mënyrë të pashmangshme gjetjen e një përkufizimi të pastër të shërbimit të provës, por nuk mjafton për të treguar kuptimin e këtij koncepti. Kësisoj, qëllimi i këtij kapitulli është të shtjellojë konceptin e shërbimit të provës dhe të përpiqet të zhvillojë një kuptim më të gjerë të tij.

Ky kre fillon me një përpjekje për të treguar kontekstin e gjerë ku mund të kërkojmë për gjetjen e një kuptimi për atë se çfarë është shërbimi i provës. Duke parë shkurtimisht se çfarë nuk është shërbimi i provës, mund të vendosim disa limite mbi të kuptuarin tonë të asaj se çfarë mund të jetë shërbimi i provës dhe të eksplorojmë territorin brenda këtyre kufijve.

Çfarë është vënia në provë?

Çdo përpjekje për të treguar se çfarë është vënia në provë duhet të vërë theksin në kontekstin social të krimit dhe në rolin e shërbimit të provës. Kjo përjasje të çon në mënyrë të paevitueshme drejt një analize sociale, politike dhe ekonomike të krimit dhe shkaqeve të tij. Një analizë e tillë e detajuar shtrihet përtej qëllimit të këtij kapitulli, megjithatë, mund të nxjerrim disa konkluzione të përgjithshme. Pikë së pari, duhet të pranojmë se në mbarë botën, këto dy shekujt e fundit, zhvillimi i kapitalizmit dhe ekonomisë së tregut është shoqëruar nga një rritje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e krimit. Ndryshimet social-ekonomike në lidhje me zhvillimin e ekonomive moderne të tregut (që mund të përmbledhen si: produktiviteti ekonomik në rritje, hyrja dhe zgjerimi i ekonomive të tregut të lirë, rritja e prosperitetit në përgjithësi dhe si rrjedhojë, rritja e konsumit, thellimi i pabarazisë sociale dhe i përjashtimeve sociale, rritja e urbanizimit dhe çrregullimit social) janë faktorë që çojnë në rritjen e krimit. Për më tepër, mund të themi se sa më shumë të zhvillohen këto procese aq më tepër do të rritet numri i krimeve. Për shembull, në Angli dhe Uells gjatë periudhës 1963 – 1983 pati një rritje prej 232% të numrit të krimeve të regjistruara nga policia.

Ndërsa duhet të pranojmë që shkaqet e krimeve janë komplekse dhe subjekt i debateve të shumta, mund të dalim në një përfundim të rëndësishëm: zhvillimi dhe ekzistenca e vënies në provë nuk ka ndikim të dukshëm në numrin e krimeve/nivelin e kriminalitetit. Vënia në provë nuk është faktor që ndikon në rritjen e krimit por as nuk ka ndikim madhor në uljen e tij. Ndryshimet sociale, politike dhe ekonomike që ndikojnë në shkallën/nivelin e krimeve janë përtej arritjes së praktikës së vënies në provë. Pra, vënia në provë nuk është një mekanizëm që kontrollon krimin. Këto aktivitete shkojnë përtej aftësive të vënies në provë dhe shtrihen diku gjatë në strukturën sociale të shoqërisë.

Nocioni që shërbimi i provës nuk është një organ për kontrollin e krimit na bën të kuptojmë që ai është një organizëm dedikuar drejtësisë penale. Me fjalë të tjera, shërbimi i provës është pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe si i tillë, është një nga institutet e shumta që merren me autorë të caktuar të veprave penale.

Çdo institucion brenda sistemit të drejtësisë penale ka rolin e vet: Policia është përgjegjëse për arrestimin e autorëve të veprave penale, prokurorët janë përgjegjës për ndjekjen dhe procedimin penal të tyre, gjykatat për dënimin e autorëve dhe burgjet për të mbajtur të dënuarit e dërguar nga gjykatat. Megjithatë, roli i shërbimit të provës brenda sistemit të drejtësisë penale ndryshon nga roli i institucioneve të tjera të drejtësisë penale, sepse ky Shërbim luan rol në të gjitha stadet e procesit të drejtësisë penale.

Roli i shërbimit të provës në sistemin e drejtësisë penale		
Roli	Organi përfshirë	Aktiviteti i shërbimit të provës
Skemat alternative	Policia	Bashkëpunimi me policinë për të shmangur veçanërisht autorët/shkelësit e rinj dhe më potencialë nga ndjekja penale/procedimi penal
Shërbimet në Paraburgim	Policia	Dhënia e shërbimeve ndihmëse (p.sh akomodim, punë në familje dhe mbikëqyrje) për të shmangur arrestimin nga policia
Skemat alternative	Prokuroria	Dhënia e informacionit dhe/ose shërbimeve ndihmëse për të shmangur veçanërisht shkelësit e rinj dhe më potencialë nga ndjekja penale/procedimi penal
Shërbimet në Paraburgim	Gjykatat	Dhënia e informacionit dhe/ose shërbimeve ndihmëse për të shmangur shkelësit nga arresti në burg (paraburgimi)
Raportet para dhënies së dënimit	Gjykatat	Përpilimi i raporteve për të ndihmuar gjykatat gjatë procesit të dhënies së dënimit dhe për të nxitur dënimet në komunitet, kur është e përshtatshme
Mbikëqyrja e të dënuarve	Gjykatat	Zhvillimi, organizimi dhe mbikëqyrja e të dënuarve me “punë në komunitet”.
Kujdesi gjatë kryerjes së dënimit	Burgjet	Bashkëpunim me burgjet, të dënuarit dhe familjet e tyre për të siguruar një rikthim pozitiv në komunitet dhe për të reduktuar recidivizmin.
Kujdesi pas dënimit	Burgjet	

Pra, shërbimi i provës ka një rol të veçantë në sistemin e drejtësisë penale; ai kryen një sërë funksionesh të specializuara, të domosdoshme për funksionimin e sistemeve moderne të drejtësisë penale. Megjithatë, një tipar kryesor i rolit të këtij shërbimi është që kryen shumicën e aktiviteteve në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me pjesë të tjera të sistemit të drejtësisë penale. Për më tepër, nëpërmjet këtij bashkëpunimi, shërbimi i provës po përpiqet të sjellë ndryshim në mënyrën sesi institucionet e drejtësisë penale marrin vendime në lidhje me shkelës/autorë të veprave penale.

Ku e gjen të drejtën ky shërbim për të sjellë këto ndryshime? Pa dyshim, që është përgjegjësi e policisë, prokurorisë dhe përfundimisht e gjykatave që të vendosin ndëshkimin e autorëve të veprave penale. Atëherë, mbi ç'baza e mbështet shërbimi i provës rolin legjitim të tij brenda sistemit të drejtësisë penale? Kjo është një pyetje komplekse dhe përgjigja gjendet në identitetin e shërbimit të provës.

Shërbimi i provës mund të përkufizohet në bazë të aktiviteteve që kryen, por edhe në bazë të mënyrës si i kryen këto funksione, d.m.th., në bazë të vlerave të këtij shërbimi. Edhe pse nuk është artikuluar, argumenti mbi vlerat e shërbimit të provës është që nëse vlerat e shërbimit janë të rëndësishme atëherë vetë shërbimi mund të konsiderohet një organizatë me vlerë. Cilado qofshin meritat e këtij argumenti, është treguar se këto vlera kanë një cilësi ndërkombëtare dhe janë identifikuar si:

- Respekt për individët, vlerën bazë të njerëzimit, integritetin dhe jetën private
- Drejtësi, sinqeritet dhe përgjegjësi
- Respekt për dinjitetin njerëzor dhe drejtësinë
- Parimi i ndërhyrjes minimale – d.m.th., që të mos përdoret më shumë forcë nga sa është e nevojshme
- Parimi i normalizimit – që kushtet për të dënuarit duhet t'i korrespondojnë atyre jashtë sistemit të drejtësisë penale
- Parimi i ndërhyrjes në kohë – për të siguruar një reagim të efektshëm ndaj veprës penale dhe për të trajtuar një çështje me efikasitet, punonjësi i shërbimit të provës duhet të ketë akses te të dënuarit në çdo fazë të procesit të drejtësisë penale.
- Parimi i ndërhyrjes së vazhdueshme
- Gatishmëria për të bashkëpunuar me organizata të tjera (CEP 2000).

Por vetëm vlerat nuk mjaftojnë, sepse ato nuk na tregojnë shumë rreth asaj se çfarë bën shërbimi i provës dhe përse e bën ky shërbim. Përgjigja ndaj pyetjes “çfarë është shërbimi i provës?” duhet të përfshijë diçka rreth rolit të shërbimit të provës, vetëm të këtij shërbimi, në sistemin e drejtësisë penale. Kjo çështje është në qendër të debateve bashkëkohore kriminologjike dhe i referohet lidhjes midis drejtësisë ndëshkuese dhe asaj shpërndarëse.

Drejtësia ndëshkuese ka të bëjë me mënyrën sesi shkelësit ndëshkohen dhe me shpërndarjen e masës së duhur të ndëshkimit sipas dëmit të shkaktuar nga i dënuari. Kështu, një shoqëri është e padrejtë nëse ndëshkon lehtë një të dënuar të rrezikshëm dhe nëse ndëshkon më rëndë një të dënuar më pak të rrezikshëm, apo nëse ndëshkon autorë veprash penale me rrezikshmëri të njëjtë në mënyra të ndryshme.

Nga ana tjetër, drejtësia shpërndarëse ka të bëjë me shpërndarjen më të gjerë të shpërblimeve në shoqëri. Me fjalë të tjera, mënyra sesi punët, paraja, të mirat

materiale, shtëpitë, mallrat e konsumit, etj., shpërndahen në shoqëri. Pra, një shoqëri e drejtë është ajo shoqëri ku këto “shpërblime” ndahen në mënyrë të barabartë, dhe është e padrejtë nëse vetëm një pakicë i zotëron këto shpërblime ndërsa shumë të tjerë kanë pak ose aspak.

Pyetja kryesore që lind është: Si mundet një sistem ndëshkimesh (ose sistem i drejtësisë penale apo një shoqëri) të arrijë drejtësinë ndëshkuese në një kontekst pabarazish shpërndarëse?

Nuk ka një zgjidhje të thjeshtë për këtë pyetje komplekse. Nuk ka as një zgjidhje e cila mund të karakterizojë vënien në provë në një kontekst të përgjithshëm ose ndërkombëtar. Mënyra sesi vënia në provë i jep kuptim rolit që ka në sistemin e drejtësisë penale në lidhje me këtë pyetje mbi drejtësinë, jo vetëm që mbështet legjitimitetin e shërbimit të provës por i jep edhe përgjigje pyetjes se “çfarë është vënia në provë?”.

Zhvillimi i shërbimit të provës në Angli dhe Uells

Anglia dhe Uellsi kanë një eksperience mbi 100 vjeçare të shërbimit të provës. Në këtë pjesë do të eksplorojmë zhvillimin e shërbimit të provës në Angli dhe Uells (Skocia dhe Irlanda Veriore, pjesët e tjera të Mbretërisë së Bashkuar, kanë sisteme të tjera) gjatë kësaj periudhe dhe të nxjerrim disa nga temat kryesore në historinë e tij.

Historia dhe zhvillimi i shërbimit të provës

Origjina e shërbimit të provës gjendet te Kisha dhe në lëvizjet fetare të saj. Në vitin 1876 Shoqata anti-alkoolike e Kishës së Anglisë (Church of England Temperance Society) caktoi Misionarin e parë të gjykatës së shkallës së ulët¹ (pararendësi i Punonjësit të Shërbimit të Provës sot). Gjashtë vjet më vonë kishte 146 Misionarë në gjykatat e shkallës së ulët. Puna e misionarëve të gjykatës së shkallës së ulët kishte të bënte kryesisht me “këshillimin e shkelësve që të linin pijen, shpërndarjen e trakteve fetare dhe marrjen e zotimeve për të hequr dorë (nga pija)” (McWilliams 1983).

Këta misionarë e zgjeruan shumë shpejt rolin e tyre dhe u përpoqën të ndihmonin gjykatësit duke u përfshirë si përfaqësues në konfliktet martesore, duke ndërmjetësuar në grindjet midis fqinjëve, duke ndihmuar prindërit që s’i kontrollonin dot fëmijët e tyre dhe në vlerësimin e kandidatëve për “kutinë e të varfërve” (një lloj bamirësie).

Megjithatë, në atë kohë ashpërsia e ndëshkimit filloi të përbënte shqetësim; sidomos ndëshkimi ndaj shumë autorëve të veprave penale jetët e të cilëve karakterizoheshin

1. Në versionin anglisht *Police Court Missionary*. *Police Court – sot Magistrates’ Court* është shkalla më e ulët e gjykatave në Angli, Uells dhe në shumë vende të tjera të sistemit *Common Law* [shënim i redaktorit]

nga vështirësitë dhe varfëria e skajshme. Sistemi i drejtësisë penale lindi nën presionin në rritje të publikut dhe si rrjedhojë, gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët filluan t'i linin shkelësit, në rrugë joformale, nën mbikëqyrjen e Misionarëve të Gjykatës së shkallës së ulët (në mënyrë vullnetare, sipas dispozitave të Ligjit të Juridiksionit të vitit 1879.). Ky ishte një fillim i ngadaltë, jo gjithëpërfshirës, por që shënon fillimet e “shërbimit të provës” që megjithëse fillimisht erdhi nga gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët, shumë shpejt u përvetësua nga numri në rritje i Misionarëve të Gjykatës së shkallës së ulët.

Sipas McWilliams, mëshira është çelësi për të kuptuar rolin e këtyre Misionarëve në gjykatë: “Mëshira ndodhej midis shkelësit, misionarit dhe gjyqtarit, dhe kjo i jepte kuptim marrëdhënies së tyre” (McWilliams 1983). Kështu, Misionarët e Gjykatës së shkallës së ulët filluan një proces hetimi para dhënies së dënimit dhe në rastet e duhura kërkonin falje ose mëshirë. Nuk kemi shumë informacion se cili u zgjodh nga misionarët e gjykatës së shkallës së ulët për një kërkesë faljeje apo përse (dhe mbi ç'baza) u bënë këto zgjedhje – që pa dyshim ishin pak ideosinkretike – por, kur dilnin me sukses, i jepte misionarëve një mundësi për të drejtuar reformimin e shkelësve duke krijuar kështu termin “këshillo, ndihmo dhe trego miqësi” si parimi kryesor i shërbimit të provës.

Në fillim të viteve 1900 dolën një sërë aktesh (ligjesh) të cilat, në kombinim me njëra-tjetrën, themeluan Shërbimin e Provës pothuajse në të njëjtën formë që ai ekziston dhe në ditët e sotme. Në vitin 1907 u miratua Akti mbi Shërbimin e Provës të Autorëve të Veprave Penale, i cili u dha gjykatave të rrethit autoritetin për të punësuar dhe emëruar Punonjës të Shërbimit të Provës dhe autoriteteve lokale pushtetin për të financuar këtë shërbim. Gjithsesi, Urdhrat e Shërbimit të Provës nuk ishin dënime, por urdhra të dhëna në vend të një dënimi – duke ndjekur parimin e mëshirës të aplikuar në fillimet e Shërbimit të Provës.

CJA 1925 e bëri të detyrueshme për të gjitha gjykatat e shkallës së ulët që të caktonin Punonjës të Shërbimit të Provës me pagesë dhe të krijonin njësi më të zgjeruara administrative ose të quajtura ndryshe “Shërbime të Provës”. CJA 1925 bëri të detyrueshme edhe krijimin e Komiteteve të Shërbimit të Provës. Këto komitete përfshinin edhe gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët të cilët kishin për detyrë të caktonin dhe paguanin Punonjësit e Shërbimit të Provës. Në çdo gjykatë të shkallës së ulët u krijuan Komitete të Çëshjteve (gjyqësore) për mbikëqyrjen e punës së Punonjësve të Shërbimit të Provës nga gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët.

Në vitin 1936, me krijimin e Sektorit të Shërbimit të Provës, Inspektoratit dhe Bordit Trajnues të Shërbimit të Provës u formua edhe baza e përgjegjësisë të Ministrisë së Brendshme. Kjo strukturë bazë ka qëndruar e njëjta, me disa modifikime të vogla, deri vonë dhe formoi kontekstin organizativ mbi të cilin u zhvillua Shërbimi i Provës në Angli dhe Uells.

Filozofia ndryshuese e shërbimit të provës

Ne mund të kuptojmë natyrën ndryshuese të praktikës së shërbimit të provës ose filozofinë e saj duke iu referuar katër periudhave të ndryshme:

Ideali misionar
Ideali rehabilitues
Rënia e idealit rehabilitues
Shfaqja e menaxherializmit

Siç përmendet më sipër, origjina e Misionarëve të Gjykatës së Shkallës së Ulët gjendet te kisha dhe “vënia në provë” e autorëve të veprave penale ishte një zgjerim i rolit të kishës dhe të idealit të saj misionar, d.m.th., ideja e të shpëtuarit të shpirtit të autorit të veprës penale nëpërmjet hirit hyjnor. Ekzistonte besimi se nëse kishe Perëndinë dhe kishën në jetën tënde, atëherë *de facto*, nuk do të kryeje vepra penale, do të ishe një person i mirë që nuk pinte apo rrihte fëmijët, etj. Theksi, siç përmendet dhe më lart, ishte në marrjen e zotimeve.

Ky ideal misionar nuk mund t’i mbijetonte kritikave dhe pushtetit në rritje të idealit rehabilitues me bazë shkencore i cili u zhvillua rreth shkencave sociale që po lulëzonin në fillim të viteve 1900. Ideali misionar bazohej në reformimin moral të shkelësve nëpërmjet fesë i cili jo vetëm që nuk përputhej me filozofinë e re të shkencave sociale por ishte edhe tepër selektiv, aq sa “vënia në provë” i ofrohej vetëm atyre shkelësve që mendohej se mund të reformoheshin.

Paradigma shkencore që mbështeti vizionin diagnostik të idealit rehabilitues ishte shumë më tërheqëse dhe e zbatueshme. Vizioni diagnostik bazohej në shkencë, kështu që besohej se: i) kryerja e veprave penale ishte simptomë e një lloji sëmundjeje, ii) duke aplikuar teknikat shkencore mund të identifikojmë shkakun (sëmundjen) e simptomës (kryerjes së veprës penale), dhe iii) nëpërmjet zhvillimit të trajtimeve shkencore mund të “shërojmë” nga veprimtaria kriminale - të gjithë njerëzit (të paktën potencialisht). Paradigma e trajtimit dhe ideali diagnostik arritën kulmin gjatë periudhës së pas luftës (në vitet 1950 dhe 60).

“Në bazë të këtij modeli, sjellja kriminale shihet si shfaqje e një sëmundjeje psikologjike ose psiko-sociale, dhe si e tillë mund të diagnostikohet dhe të marrë trajtim profesional; dhe themelore për të gjithë procesin ishte diagnoza e saktë bazuar në një vlerësim objektiv, faktiv të shkelësit, rrethanave të tij dhe reagimit të mundshëm të tij ndaj repertorit/programit të trajtimit. Mjeti i zgjedhur për diagnostikimin dhe trajtimin e shkelësve të ligjit nga Punonjësit e Shërbimit të Provës eventualisht u shndërruan në ato teori dhe metoda që u avancuan nga shkollat e ndryshme të rasteve sociale.” (McWilliams; 1985)

Fuqia dhe ndikimi i këtij lloji mendimi nuk duhet nënvlerësuar. Në atë kohë ekzistonte besimi i përhapur gjerësisht se kriminaliteti dhe sjellja kriminale mund të kuroheshin. Megjithatë, ky besim nuk kishte baza dhe rezultati ishte katastrofik për shërbimin e provës (ndonëse një katastrofë që zgjati me vite të tëra, jo vetëm disa muaj apo javë).

Ideali rehabilitues u rrëzua nga evidencat e shumta, që ne as nuk mund të dallojmë shkaqet e kryerjes së veprave penale dhe as nuk mund të gjejmë metoda për të trajtuar autorët e këtyre veprave. Nga fundi i viteve 70 kjo ide u hodh plotësisht poshtë. “Asgjë nuk funksionon” u bë slogani që karakterizonte punën me autorët e veprave penale dhe gjatë një periudhe prej 30 vitesh kaluam nga besimi maksimal në aftësitë tona për të trajtuar autorët e veprave penale në një dëshpërim maksimal nëse mund të arrinim ndonjë gjë pozitive në këtë aspekt. Fundi i viteve ‘70 dhe pothuajse gjithë periudha e viteve ‘80 ishte një kohë e tmerrshme për shërbimin e provës. Nga mungesa e një ndjenje të vërtetë misioni, e cila u shpërbë plotësisht nga doktrina “asgjë nuk funksionon”, Shërbimi i Provës nuk ishte më i qartë për rolin që duhej ose nuk duhej të luante.

Në fillim të viteve ‘80 qeveria filloi të shqetësohej për shërbimin e provës. Ky shërbim nuk po jepte ndonjë kontribut në uljen e numrit të veprave penale nëpërmjet punës së tyre me autorët e veprave penale, dhe dukej se shërbimi i provës nuk po jepte ndonjë kontribut të rëndësishëm në funksionimin “efektiv” të sistemit të drejtësisë penale (në terma të politikave publike, shërbimi i provës nuk po funksiononte në mënyrë efektive për të reduktuar numrin e të dënuarve).

Kështu që nga fillimi i viteve ‘80, qeveria filloi të shtojë kontrollin e aktiviteteve të shërbimit të provës dhe të sigurojë që puna e tij të përmbushte objektivat e politikës së Ministrisë së Brendshme. “Megjithatë, qeveria vazhdon të besojë se shërbimi lokal duhet të kryhet brenda një kornize të përcaktuar objektivash dhe përgjegjësie. Kështu që objektivi i shumë prej propozimeve të dhëna në këtë dokument është të përforcojnë strukturën lokale brenda një kornize me përgjegjshmëri më të lartë kundrejt qendrës. Nga ana tjetër, është nevoja që shërbimi i provës të tregohet përgjegjës ndaj shqetësimeve të politikave qendrore. Qeveria përballon 80% të kostos së shërbimit dhe kështu ka të drejtën të presë që shërbimi i provës do t’i përgjigjet pikëpamjeve të saj në lidhje me mënyrën sesi duhen shpenzuar këto para” (Ministria e Brendshme 1991).

Kështu që, një pjesë e mirë e praktikës së shërbimit të provës në vitet ‘90 u zhvillua në një kontekst të politikës përshkruese të Ministrisë së Brendshme dhe në mënyrë specifike nëpërmjet zhvillimit të Standardeve Kombëtare – një dokument i Ministrisë së Brendshme që përmban në hollësi procedurat operative për praktikën e shërbimit të provës. Prandaj, temat kryesore të kësaj praktike në vitet ‘90 ishin: mbrojtja

e publikut, shërbimet të përdoren atje ku do kenë më shumë ndikim përfitues në funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, shtimi i kontrollit ndaj të dënuarve me punë në komunitet dhe reduktimi i recidivizmit.

Në vitin 2001 shërbimi i provës në Angli dhe Uells u ristrukturua në mënyrë radikale duke u kthyer në një shërbim kombëtar, i financuar tërësisht dhe nën përgjegjësinë e qeverisë vendore. Ky hap ishte faza përfundimtare në një proces ku qeveria ka bërë përpjekje të shumta për të kontrolluar qëllimin e shërbimit të provës dhe natyrën e aktiviteteve të këtij shërbimi.

Fëmijët dhe drejtësia

Shërbimi i provës në Angli dhe Uells ka punuar shumicën e kohës si me autorë të veprave penale, të rritur në moshë ashtu dhe me të mitur – pavarësisht se dispozitat dhe sistemet ligjore parashikonin mënyra të ndryshme trajtimi të të miturve që reflektonin trajtimin e veçantë që i bëhej të miturve. Megjithatë, në vitet ‘70 zgjerimi i shërbimeve sociale çoi në një rritje të përfshirjes së punonjësve socialë në gjykatën e të miturve dhe në punën me shkelësit/të dënuarit e mitur. Gradualisht, në departamentet e shërbimeve sociale filluan të punonin specialistë të drejtësisë për të mitur, të cilët më vonë zëvendësuan punën e shërbimit të provës në këtë fushë. Siç përmendet më sipër dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare, shumë vende kanë sisteme të veçanta për trajtimin e të dënuarve të mitur. Në praktikë kjo do të thotë se, kur një i mitur arrestohet për një vepër penale, ai/ajo mbahet dhe merret në pyetje nga policia sipas ligjeve të caktuara që rregullojnë punën e policisë dhe ofrojnë një shkallë mbrojtje për fëmijën. Prezumimi se, pas arrestit fillon menjëherë procedimi penal nuk zbatohet rigorozisht për të miturit, madje ka disa masa të cilat mund të aplikohen si alternativë e këtij procedimi. Nëse të miturit ndiqen penalisht, parimet e ndëshkimit të tyre ndryshojnë nga ato për të rriturit dhe gjykata merr parasysh çfarë do të ishte në interesin më të mirë për fëmijën. Sistemet e drejtësisë për të miturit në mbarë botën ndryshojnë si në formë edhe në përmbajtje, pak a shumë njësoj siç kemi treguar për sistemet e shërbimit të provës për të rriturit. Megjithatë, mbrojtja e fëmijëve dhe parandalimi i veprave penale janë objektiva të përbashkëta që karakterizojnë sistemet e ndryshme të drejtësisë për të rritur. Në këtë pjesë paraqitet një histori e shkurtër e zhvillimit të drejtësisë për të mitur në Angli dhe Uells.

Fillimet e hershme

Që nga themelimi i saj në Angli dhe Uells në vitin 1908, gjykata e të miturve kishte si juridiksionin penal dhe atë civil mbi fëmijët. Diferencimi midis çështjeve penale dhe civile brenda gjykatës së të miturve ka ndryshuar me kalimin e kohës; ndonjëherë

më i dallueshëm dhe ndonjëherë më pak i dallueshëm. Shkelësi/i dënuari i mitur dhe i mituri “në nevojë” nuk janë trajtuar gjithmonë si entitete të ndara dhe nuk ka pasur gjithmonë dallim midis masave të marra për ata që kanë kryer krime dhe për ata që kanë nevojë për ndihmë ose mbrojtje. Megjithatë, në praktikë gjykata e të miturve ka trajtuar kryesisht të rinj të cilët kanë kryer vepra penale ndërsa numri i rasteve civile ka mbetur relativisht i vogël. Por gjithsesi, gjykata e të miturve duhet të kishte parasysh nevojat e të rinjve kur jepte vendimin/dënimin.

“Çdo gjykatë që trajton çështjen e një fëmije ose të riu, qoftë si autor i veprës ose ndryshe, duhet të mbajë parasysh mirëqenien e fëmijës ose të të riut...” (Akti/Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë i vitit 1933 i ndryshuar me Aktin/Ligjin për Fëmijët dhe të Rinjtë të 1969).

Vitet ‘60 ishin një dekadë turbulente për sa i përket politikave të drejtësisë për të mitur. Megjithatë, nga fundi i dekadës, në bazë të besimit se kishte shumë ngjashmëri midis fëmijëve që kryejnë vepra penale dhe atyre në nevojë, qeveria formuloi një politikë për gjykatat e të miturve të mbështetur nga një filozofi e orientuar drejt mirëqenies sociale. Kjo politikë u pasqyrua nga Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë 1969 (CYPA² 1969). Në praktikë CYPA u zbatua vetëm pjesërisht (për shkak të një ndryshimi në qeveri në vitin 1970), u prezantuan ndëshkime të reja të bazuara në mirëqenien sociale (Urdhra Kujdesi dhe Mbikëqyrjeje – si për të miturit që kanë kryer vepra penale edhe për ata në nevojë), por ndëshkimet e vjetra me burgim nuk u shfuqizuan.

Trajtimi i ndërmjetëm

Prezantimi i ndëshkimeve të bazuara në mirëqenien sociale në gjykatat e të miturve u shoqërua nga një lëvizje e punonjësve socialë në sistemin e drejtësisë për të miturit, të punësuar nga departamentet e shërbimeve sociale në qeverisjen vendore, përgjegjësia e të cilëve ishte të zbatonin këto masa të reja. Mjeti kryesor i këtij zhvillimi ishte ajo që quhej Trajtim i Ndërmjetëm (TN). Në terma ligjorë, një kërkesë për TN ishte një kusht që gjykatat mund të vendosnin për të dhënë një Urdhër Mbikëqyrjeje, por qëllimi ishte që TN duhej të jetë një shërbim i bazuar mbi nevojat dhe i përdorshëm për një numër të madh të rinjsh – jo vetëm për ata që kanë kryer vepra penale dhe po gjykoen.

Koncepti i TN-së u prezantua në CYPA 1969 dhe nënkuptonte punën me fëmijët “në rrezik” që shërbente si “ndërmjetësim” midis punës në familje (puna me fëmijën në ambientin familjar dhe fokusimi te familja si njësi ndërhyrjeje) dhe dërgimit të fëmijës në një institucion. TN do të thoshte punë e drejtpërdrejt me të rinjtë, por natyra e kësaj pune nuk u përcaktua apo nuk u kuptua asnjëherë qartë; kuptimi i saj ishte puna e drejtpërdrejtë me fëmijët e cila ishte e shumëllojshme. Në fillim të viteve ‘70, qeveria u dha fonde departamenteve të shërbimeve sociale për të zhvilluar TN-n

2. CYPA (Children and Young Persons Act) – Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë [shënim i redaktorit]

dhe në praktikë pothuajse gjithçka që bënin punonjësit socialë, drejtpërdrejtë me të rinjtë, mund të quhej dhe në fakt quhej TN.

Jo vetëm që natyra e aktivitetit të TN-së ishte e shumëllojshme dhe jo e qartë, por edhe grupi i synuar nuk ishte i përcaktuar mirë dhe si rrjedhojë i ndryshëm. Meqë burgimi nuk ishte shfuqizuar, shumë prej këtyre klientëve të synuar të TN-së burgoseshin, duke e kufizuar këtë popullsi në një grupmoshë të re dhe grupin e atyre që në përgjithësi nuk ishin dënuar me burgim. Në praktikë, në një mënyrë disi kaotike dhe konfuze, vitet '70 dëshmuuan si degëzimin e dënimit (ku dënimi ndahet sipas disa pikave arbitrare dhe ku disa prej autorëve marrin ndëshkim të rëndë ndërsa të tjerë ndihmë) ashtu edhe praktika jo të qarta ndëshkimi ku si ata që kanë kryer vepra penale edhe të rinjtë në nevojë marrin të njëjtin lloj dënimi.

Punonjësit social besonin se ndërhyrja zyrtare ishte e mirë dhe vendosën të punonin me sa më shumë fëmijë, shpesh duke rekomanduar ndëshkime intervencioniste për fëmijët që kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri të ulët ose që po përjetonin vështirësi të vogla në familje, zhvillimi apo adoleshencë. Kushtet formale të TN-së ndaj Urdhrave të Mbikëqyrjes ishin thjesht një mekanizëm për të “futur fëmijët në grupe TN”. Aksesi ndaj TN-së nuk u kufizua për ata me vendim gjyqi, përkundrazi u vu në dispozicion për një gamë të gjerë fëmijësh. TN-ja ishte e lidhur fort me filozofinë e shkencave sociale dhe me modalitetin e trajtimit të bazuar në mirëqenien sociale. Nëse trajtimi ishte i dobishëm, dhe punonjësit social në vitet '70 mendonin se po, atëherë duhej të ishte i përdorshëm për çdo të ri në nevojë. Zelli për trajtime dhe i të rinjve për të mbushur programet e trajtimit ishte një karakteristikë kryesore e kohës. Por gjithashtu, ishte e zakonshme që punonjësit social mund edhe të rekomandonin dënim me burgim për të miturit që dilnin para gjykatës së të miturve; ndonjëherë sepse mendonin se trajtimi kishte dështuar, sepse kishin pasur vështirësi të integronin të rinjtë në grupe trajtimi dhe ndonjëherë sepse mendonin se ishte më mirë për të riun të merrte një dozë të shkurtër por të prerë disiplinë.

Në vitet '70, gjykata e të miturve u kthye në dy sisteme paralele – një sistem për dënim me burgim dhe tjetri bazuar në mirëqenien sociale – dhe u zgjeruan llojet e ndëshkimeve. Si rrjedhojë, gjatë kësaj kohe një numër i madh fëmijësh u futën në sistem dhe shumë të rinj që kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri tepër të ulët, u ndëshkuan me burgim ose me punë në komunitet. Një analizë e zhvillimeve të viteve '70 tregoi se në vend që të krijoheshin një sistem i ri i bazuar në mirëqenien e fëmijëve që do të zëvendësonte sistemin e bazuar në ndëshkim, sistemi i ri thjesht iu shtua atij të vjetër duke krijuar kështu një sistem të ri dhe më të madh që kërkonte sa më shumë të rinj për të plotësuar ndëshkimet e mundshme (Thorpe et al 1980). Ky argument ishte një kritikë e sjelljes së sistemit – sistemi dhe punonjësit individualë brenda tij (policët, punonjësit social dhe gjyqtarët), merrnin vendime të gabuara për fëmijët

e gabuar në kohën e gabuar/jo të duhur. Filozofia e punës sociale e viteve 80 mori shumë kritika të tjera në atë kohë:

- Shkencat sociale nuk arrijnë të identifikojnë me sukses shkaqet e kriminalitetit.
- Shkencat sociale nuk arrijnë të zhvillojnë dhe sigurojnë programe efektive trajtimi.
- Punonjësit social po i përdornin shkencat sociale për të justifikuar programet intensive të trajtimit të cilat jo vetëm që nuk funksiononin, por ishin tepër ndërhyrëse dhe nuk justifikoheshin nga niveli i kriminalitetit apo serioziteti i problemeve sociale.
- Programet tepër ndërhyrëse ndonjëherë u shkaktonin më shumë dëm se përfitim individëve.
- Programet tepër ndërhyrëse shkaktonin më shumë dëm se përfitim në lidhje me sistemin, sepse pasi një i ri i provonte këto trajtime dhe dështonte, dënimi penal ishte rrjedhoja e pashmangshme (edhe pse vetë modeli i trajtimit ishte i gabuar).

Dy linja të ndryshme u shfaqën gjatë fillimit të viteve ‘80: “lëvizja rikthim në drejtësi” dhe “menaxhimi i sistemeve dhe filozofia kundër-burgimit”.

Lëvizja rikthim në drejtësi

Argumenti ligjor për përjasjen e bazuar në drejtësi të procedimit dhe dënimit të një autori veprash penale bazohet në besimin se *drejtësia* është një gjë e mirë. Të argumentosh kundër drejtësisë është njësoj sikur mbron padrejtësinë – që është qartësisht e padëshirueshme: nuk është e mundur të kemi shumë drejtësi. Kjo lëvizje në Angli dhe Uells besonte në vlerën e drejtësisë, por mbështetja që i jepnin drejtësisë ishte pjesërisht një qëndrim reaksionar kundër mirëqenies sociale. Kjo përjasje e bazuar në drejtësi solli dënime fikse, ndryshe nga natyra e papërcaktuar e shumë opsioneve të bazuara në mirëqenien sociale; kufizoi diskrecionin dhe shtoi nivelin e sigurisë në marrjen e vendimeve; kufizoi ndërhyrjen e ndëshkimit në nivelin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale dhe përjashtoi ndëshkimet e bazuara në nevojat për mirëqenie sociale të të rinjve, dhe së fundi, drejtësia ofroi mbrojtje ligjore dhe siguri për fëmijët duke zvogëluar ushtrimin arbitrar të pushtetit nga ana e stafit të drejtësisë penale.

Këto argumente ishin shumë të fuqishme në fillim të viteve ‘80 dhe patën ndikim të gjerë në zhvillimin e legjislacionit të ri për trajtimin e autorëve të mitur të veprave penale. Duke reflektuar pjesërisht politikat e viteve ‘80, Ligji i Drejtësisë Penale 1982 konsolidoi burgimin në qendër të sistemit të drejtësisë për të mitur, duke kërkuar që dënimi të jetë në të mirë të të rinjve. Ky ligj përfshinte edhe një sërë paragrafesh të ndryshëm të bazuar në drejtësi, si për shembull:

Të gjithë të rinjtë që dilnin para një gjykate për të mitur kishin të drejtën e përfaqësimit ligjor falas.

Gjykatat duhet të parashtronin arsyet për vendimet që merrnin.

Në mënyrën më domethënëse, Ligji prezantoi tre kritere nga të cilat të paktën një duhej plotësuar para se gjykata të merrte një vendim për dënim me burgim:

- I pandehuri nuk është i gatshëm apo në gjendje të kryejë një dënim të ndryshëm nga burgimi, ose
- Dënimi me burgim është i nevojshëm për mbrojtjen e publikut, ose
- Vepra penale është aq e rëndë, saqë një dënim jo me burgim nuk mund të justifikohet.

Për më tepër, para se të jepet një dënim me burgim, ligji kërkon që të përgatitet një raport për vlerësimin e rrethanave shoqërore që të vlerësonte, *inter alia*, nëse një sanksion komunitar ishte i përshtatshëm apo jo. Edhe pse u treguan të ngadalshëm për të përfutur nga këto kërkesa ligjore, këto kritere formuan bazën ku u mbështetën punonjësit social për të sfiduar dënimin me burgim të të miturve.

Menaxhimi i sistemeve dhe filozofia kundër burgimit

Një sërë konkluzionesh të nxjerra nga studimet formuan besimet që përforconin zhvillimin e praktikës së punës së punonjësve social me të miturit që kryenin vepra penale:

- *Realiteti i parëndësishëm* – shumica e veprave penale të kryera nga të miturit nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë dhe madje janë të parëndësishme.
- *Zhvillimi i arsytimit të krimit* – që shumica e të rinjve kryejnë vepra penale në një kohë të caktuar gjatë adoleshencës dhe se pjesa më e madhe nuk do të kryejnë më vepra penale për shkak se në mënyrë natyrore do të rriten/maturohen (e thënë ndryshe – kriminaliteti i të miturve nuk është produkt i patologjisë sociale apo personale dhe si rrjedhojë, nuk duhet të trajtohen).
- *Teoria e etiketimit* – përfshirja zyrtare me sistemin e drejtësisë penale mund të ketë pasoja negative të të rinjtë, aq sa të etiketohen si kriminelë dhe si rrjedhojë, të sillen si të tillë.
- *Efekti i koston në rritje* – nëse të rinjtë sillen para drejtësisë penale që në moshë fare të re dhe për vepra penale me rrezikshmëri të ulët, atëherë do të shpejtojnë dënimin me burgim në të ardhmen nëse do të kryejnë vepra të tjera penale.
- *Argumenti i shkollave të krimit* – burgimi është një eksperience brutale dhe e dëmshme që i ekspozon të rinjtë ndaj shkelësve më të mëdhenj në moshë

dhe më profesional të cilët shërbejnë vetëm si modele negative.

- *Parimi i zgjerimit të rrjetit* – përqaşjet e bazuara në ndihmën sociale sjellin më shumë të rinj para sistemit të drejtësisë penale.
- *Teza radikale e mos-ndërhyrjes* – më e mira që mund të bëjnë punonjësit e drejtësisë për të mitur është që të shmangin dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet nga sistemi i drejtësisë penale dhe sistemi i tij i sanksioneve; për të rinjtë është më mirë të mos bëjnë asgjë sesa të përfshihen në sistemin e drejtësisë penale.

Këto ide ishin shumë të rëndësishme për krijimin e besimeve profesionale të specialistëve të drejtësisë penale për të mitur, që punonin në departamentet e shërbimeve sociale, kështu që u zhvillua një tipar dominues i fuqishëm kundër burgosjes, si dhe një qëndrim pro-diversitetit/skemave alternative. Por këto besime nuk do të kishin qenë aq të fuqishme në praktikë nëse nuk do të ishin shoqëruar nga teknikat e menaxhimit të sistemeve. Thorpe et al (1980) kishte qenë kritik i vendimmarrjes në sistemin e drejtësisë penale, gjë që bëri të kuptohej se nëse vendimet e marra për gjykimin e një të riu mund të ndryshoheshin, atëherë jo vetëm që do të ndryshohej edhe rezultati për këta individë por edhe vetë sjellja e sistemit. Ky proces i planifikimit të çështjeve të vendimmarrjes në sistemin e drejtësisë penale për të mitur dhe ndryshimi i vendimeve në mënyrë të tillë që të reflektojnë besimet e punonjësve të drejtësisë penale për të mitur, u njoh si menaxhimi i sistemeve. Punonjësit e drejtësisë penale për të mitur në vitet ‘80 përdorën gjerësisht teknika agresive të menaxhimit të sistemeve për të rritur numrin e vendimeve të marra për të larguar të rinjtë nga sistemi i drejtësisë penale dhe për të zvogëluar numrin e dënimeve me burgim të dhëna nga gjykatat. Këto teknika ishin shumë efektive në praktikë. Gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh, dënimi me burgim i të miturve ra me rreth 70%. Në të njëjtën kohë, norma e diversifikimit të të rinjve (norma me të cilën të rinjtë trajtoheshin në mënyrë joformale pa u proceduar penalisht) u dyfishua në afërsisht 80%. Për më tepër, këto ndryshime ndodhën pa rritje të dukshme të kriminalitetit të të miturve.

Drejtësia për të rinjtë dhe shërbimi i provës në Danimarkë

Në Danimarkë historikisht nuk ka pasur ndryshim në sistemin e drejtësisë penale për të miturit dhe të rriturit. Në vitin 1789 u miratua një akt që i lejoi gjykatat të konsideronin moshën e autorit dhe rrethanat e veprës penale kur jepnin dënimin, edhe pse në të njëjtën kohë, mosha për marrjen në përgjegjësi penale u ul nga 15 në 10 vjeç. Deri në vitet 1900, Kodi Penal danez bazohej në parimin e ndëshkimit dhe u vendos një përcaktim për rrezikshmërinë e veprës penale të kryer dhe dënimit përkatës për të. Edhe pse këto ndëshkime përfshinin burgimin dhe dënimin me vdekje, ishte një urdhër që ndëshkimet duhej të parandalonin krimin. Në 1890 sistemi i ndëshkimit u

rishikua dhe parandalimi i përgjithshëm u zëvendësua nga parandalimi i veçantë si qëllimi kryesor i ndëshkimeve. Kjo çoi në shfuqizimin e dënimit me vdekje në vitin 1930 dhe në pranimin zyrtar të rëndësisë së karakterit të autorit të veprës penale dhe rrethanave/kushteve shoqërore të tij për të vendosur dënimin më të përshtatshëm për të, dhe në vend të ndëshkimit, këto dënime kishin për qëllim të trajtonin dhe të ri-edukonin shkelësit në interesin e përgjithshëm të shoqërisë.

Për sa u përket autorëve të rinj në moshë, këto ndryshime çuan në krijimin e burgjeve për të rinj. Këto burgje përdorshin për djemtë e moshës 15 deri në 21 vjeç dhe regjimi i burgut përbëhej nga aktivitete edukuese dhe trajnuese. Megjithatë, në vitet '70 këto burgje u mbyllën. Sipas studimeve rezultoi që mbi 80% e të rinjve të liruar ri-dënoheshin. Studimet gjithashtu tregonin se shumë prej të rinjve që ishin dënuar me burgim vuanin nga një sërë problemesh sociale apo që lidheshin me sjelljen e tyre. 60% e tyre, për një periudhë kohe, kishin qenë në shtëpi fëmijësh. Rreth një e treta vinin nga familje të ndara. Shumica ishin vetëm me arsimin bazë. Rreth një e treta kishin vështirësi në të mësuar dhe më shumë se gjysma e tyre kishin qenë pa punë. Si rrjedhojë, qeveria daneze vendosi që këto burgje nuk ishin as vendi i duhur për të rinjtë dhe as të përshtatshëm për nevojat e tyre. Në fillim të viteve '70 në Danimarkë u krijuan shtëpitë komunitare për të trajtuar dhe rehabilituar autorët e rinj në moshë të veprave penale dhe fëmijët problematikë. Këto shtëpi nuk ishin burgje, por komunitete residenciale të përdorura me qëllim për të përmirësuar situatën sociale dhe edukative të fëmijëve. Megjithatë, rezultatet nuk ishin shumë të mira. Në fakt, të dhënat ishin njësoj si ato të burgjeve për të rinjtë – të rinjtë kryenin edhe më shumë vepra penale se më parë, pasi qëndronin në këto shtëpi (Mehlbye & Sommer 1989).

Mosha e përgjegjësisë penale në Danimarkë është 15 vjeç. Në kohën e sotme shërbimet për fëmijët e moshës 15 deri në 18 vjeç të cilët kanë shkelur ligjin, sigurohen nga tri organizata: shërbimet sociale, shërbimet psikiatrike dhe burgjet. Në praktikë, shërbimi i provës në Danimarkë rrallë punon me shkelësit e kësaj grupmoshe. Shumica e shërbimeve për të miturit sigurohet nga shërbimet sociale ndërsa shërbimi i provës punon kryesisht me të rriturit.

Sistemi i mirëqenies sociale

Fëmijët që dënohen për kryerjen e një vepre penale u kalohen shërbimeve sociale si pjesë e dënimit të tyre (nëse vepra penale nuk është aq e rëndë sa të nevojitet burgimi, ose aq e lehtë sa të marrin thjesht një gjobë). Përpara se një i ri të çohet në gjykatë, çështja i kalon autoriteteve të mirëqenies sociale, të cilëve u kërkohet të hartojnë një plan me masa sociale që kanë si qëllim të parandalojnë kryerjen e mëtejshme të veprave penale. Plani hartohet në marrëveshje me të riun dhe prindërit e tij/saj, duke marrë parasysh situatën e tyre sociale. Nëse plani pranohet nga gjykata, i riu merr

një dënim me pezullim bazuar në kushtet e planit. Këto plane shpesh përfshijnë: riintegrimin në sistemin arsimor, ndihmë për t'u punësuar, trajtim apo këshillim familjar dhe, nëse është e nevojshme, ndihmesë ndaj të riut për të filluar një jetë të pavarur.

Shërbimet psikiatrike

Të rinjtë që mendohet se vuajnë nga çrregullime mendore i kalohen shërbimeve psikiatrike në klinika ose spitale. Kur është e nevojshme, këto shërbime sigurohen nëpërmjet këtyre spitaleve.

Burgjet

Në Danimarkë, burgimi rrallë përdoret për të rinjtë nën 18 vjeç. Nëse një i ri ka kryer një veprë penale të rëndë dhe burgimi është gjykuar si i nevojshëm, atëherë ai dërgohet në një institucion të sigurt që nuk është burg por një institucion ku ka mundësi edukimi. Danimarka ka një Shërbim të unifikuar të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës (*shih në vijim*) dhe, nëse një i ri dënohet me qëndrim në një nga këto institucione të sigurta, Shërbimi i Provës dhe Burgjeve bashkëpunojnë me autoritetet e mirëqenies sociale për të gjetur një alternativë të dënimit me burgim për të riun.

Shërbimi i provës në Danimarkë

Që në mes të shekullit të 19, një sërë shoqërisht që siguronin ndihmë për të burgosurit kanë punuar për të ndihmuar të burgosurit e liruar nga burgjet dhe, që nga viti 1905 ato filluan të punonin me të dënuarit e vënë në provë. Në vitin 1951 këto shoqëri u shkrinë në Shoqërinë Kombëtare të Mirëqenies Sociale në Danimarkë. Në vitin 1973 përgjegjësia e shërbimit të provës iu transferua Ministrisë së Drejtësisë dhe u krijua Departamenti i Shërbimit të Provës dhe Burgjeve. Gjithsesi, ky ishte një ndryshim administrativ dhe organizimi dhe struktura e zyrave të shërbimit të provës dhe vetë shërbimeve mbetën me bazë komunitare duke ruajtur strukturën e tyre të menaxhimit.

Danimarka ka një sistem të thjeshtë të sanksioneve penale: burgimi, burgimi i lehtë (për dënime të shkurtra për vepra penale me rrezikshmëri të ulët) dhe gjobat. Vënia në provë, duke përfshirë edhe shërbimin në komunitet, funksionon gjerësisht brenda një sistemi dënimesh me burgim të pezulluara. Kështu, roli i Shërbimit të Provës dhe Burgjeve në Danimarkë është zbatimi i dënimeve të vendosura nga gjykatat. Ky rol duhet kryer me kontrollin dhe sigurinë e duhur por dhe me qëllimin për të mbështetur dhe motivuar të dënuarit që të jetojnë duke respektuar ligjin dhe duke i ndihmuar në zhvillimin e tyre personal dhe social (Vinding 2000).

Shërbimi i provës në Danimarkë ka 7 detyra kryesore:

- Përgatitja e raporteve para gjykimit
- Mbikëqyrja e të dënuarve me dënime alternative
- Mbikëqyrja e të dënuarve të liruar përkohësisht nga burgu
- Mbikëqyrja e të dënuarve të liruar me kusht
- Të punojnë me të dënuarit që kryejnë dënimin me burgim
- Të punojnë në bashkëpunim me shërbimet lokale sociale dhe të mirëqenies sociale për të nxitur përfshirjen sociale të autorëve të veprave penale
- Lidhja me agjenci të tjera për të rritur mundësitë e përfshirjes në shoqëri

Gjatë punës që kryen, shërbimi i provës në Danimarkë duhet të tregojë vazhdimisht se po zbaton këto gjashtë parime:

Normalizimi – ku është e mundur, kushtet e të burgosurve ose të atyre të vendosur në provë, duhet t'i korrespondojnë kushteve të komunitetit të gjerë.

Hapja – të sigurojnë që të burgosurit dhe të dënuarit me dënime alternative, ruajnë kontaktet me familjet dhe komunitetin.

Ushtrimi i përgjegjësisë – t'i japin të dënuarve mundësinë për të zhvilluar një ndjenjë përgjegjshmërie për të përmirësuar mundësitë e të jetuarit duke respektuar ligjin.

Siguria – zbatimi i sanksioneve për mbrojtjen e të gjithë anëtarëve të komunitetit.

Ndërhyrja minimale – nuk mund të përdoret më shumë forcë ose kufizim nga sa është e nevojshme për të ndërmarrë dhe përfunduar me sukses detyra të caktuara.

Përdorimi optimal i burimeve – detyrimi për të përdorur burimet në mënyrë efektive dhe me fleksibilitet për të përmbushur nevojat e perceptuara.

Përveç këtyre parimeve, shërbimi i provës në Danimarkë vepron mbështetur në katër parime bazë:

Ndërhyrja e hershme: siguron që punonjësit e shërbimit të provës punojnë me klientët që nga fillimi i procesit gjyqësor penal.

Afërsia: të shkurtojnë distancën gjeografike midis punonjësit dhe klientit, si dhe klientit dhe komunitetit, sa më shumë të jetë e mundur.

Vazhdimësia: mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm midis punonjësit të shërbimit të

provës dhe klientit gjatë gjithë procesit gjyqësor penal.

Koordinimi: nevoja për të siguruar bashkëpunim efektiv midis shërbimit të provës, burgut dhe agjencive me bazë komunitare.

Parimet kryesore për një praktikë pozitive të drejtësisë për të mitur

Çdo përpjeke për të bërë një krahasim ndërkombëtar të praktikave të drejtësisë për të rinjtë do të tregojë ndryshimet ndërmjet sistemeve të vendeve të ndryshme (Mehlbye & Walgrave 1998). Megjithatë, në botën moderne shtetet nuk operojnë vetëm brenda kufijve të shtetit, por po përdoret gjithmonë e më shumë një kontekst ndërkombëtar që strukturon sjelljen e të gjithë shteteve. Gjatë 100 viteve të fundit janë zhvilluar tekste ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e veçantë të fëmijëve, duke përfshirë edhe të rinjtë që kryejnë vepra penale. Deklarata e Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve (1924) pohon se fëmijëve iu duhet kushtuar kujdes i veçantë. Kjo ndjenjë është pasuar nga një sërë konventash ndërkombëtare (shihni për shembull, Haines 2000). Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985), pohojnë se, si një parim kryesor, qëllimi i një sistemi drejtësie për të mitur duhet të jetë promovimi i mirëqenies së të miturve dhe se ndjekjet penale/procedimi penal (të çdo lloji) duhet të kryhen në interesin më të lartë për të miturin. Rregullat e Pekinit nuk bazohen në ligjin kombëtar, por Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989), bazohet ligjërisht në vendet nënshkruese dhe përfshin në nenin 3 deklaratën e rëndësishme:

“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra qoftë nga institucionet publike, ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative, apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”

Në këtë shembull, përkufizimi i një fëmije është: çdo i ri nën 18 vjeç (Konventa nuk lejon konsiderime të tjera të fëmijëve që mund të etiketohen si p.sh., autorë të veprave penale – të gjithë fëmijët duhen trajtuar sipas të njëjtit parim). Përkufizimi i termit “mbizotëruese” (siç përmendet në Nenin 3 të Konventës në versionin anglisht të saj, ka kuptimin “thelbësore” ose “konsiderata më e rëndësishme” (siç tregohet në Nenin 21). Këto konventa ndërkombëtare përcaktojnë parimin se çdo veprim i ndërmarrë si rrjedhojë e një vepre penale të kryer nga një i mitur duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.

Gjetja e një përkufizimi universal të termit “në interesin më të lartë” nuk është punë e thjeshtë dhe të vendosësh nëse një veprim i caktuar është në interes të fëmijës, është kompleks. Megjithatë, vetë konventa siguron disa udhëzime të mtejshme në

lidhje me këtë çështje. Për shembull, fëmijët kanë të drejtën e një edukimi pozitiv, të shprehin pikëpamjen e tyre dhe të dëgjohen, të mos ndahen nga prindërit e tyre (përveçse kur është në të mirë të fëmijës) ose të mund të takojnë prindërit e tyre në rast se janë ndarë me forcë, të kenë kohë të lirë dhe të kryejnë aktivitete argëtuese, të mbrohen nga keqtrajtimi, forma të rrezikshme të punësimit (duke përfshirë edhe ato që ndërhyjnë me shkollën ose kohën e lirë) si dhe nga forma të tjera shfrytëzimi. Këto dispozita janë krijuar për të njohur në mënyrë të veçantë statusin e fëmijërisë dhe sidomos nocionin që fëmijëria është një periudhë tranzicioni përpara kalimit në moshë madhore dhe natyra e këtij tranzicioni duhet kuptuar dhe pranuar (shih Coles 1995).

Kur mendojmë për punën me të rinjtë që kryejnë vepra penale, duhet të fillojmë të mendojmë për rininë dhe të lidhim ndërhyrjet me të rinjtë në vështirësi në gamën e gjerë të dispozitave apo aktiviteteve që ekzistojnë për të gjithë të rinjtë. Me fjalë të tjera, konventat ndërkombëtare përcaktojnë parimin se ndërhyrjet te të rinjtë, duke përfshirë edhe ata që kanë kryer një vepër penale, duhet të bazohen në kushtin e “normalizimit”. Kështu, normalizimi është një parim thelbësor mbi të cilin duhet të bazohen të gjitha ndërhyrjet ndaj shkelësve të rinj, dhe kjo do të thotë një përmbyseje e tendencës së ndërhyrjeve të drejtësisë penale që janë zhvilluar kohët e fundit në drejtësinë dhe vënien në provë për të rinjtë.

Kohët e fundit, në Angli dhe Uells vrulli i zhvillimeve në lidhje me ndërhyrjen te autorët e veprave penale është parë kryesisht në krijimin e programeve edhe më të specializuara dhe të fokusuara te ky grup. Ky zhvillim/kjo tendencë tregohet më tepër në Shërbimin e Provës, i cili nën shtysën e Ministrisë së Brendshme u përqendrua në “praktikën e bazuar mbi provat” (Hope & Chapman 1998), programet njohëse (McGuire 2000), dhe certifikimin e stafit për të kryer aktivitete të tilla, por zhvillime të ngjashme janë gjithashtu karakteristike e drejtësisë për të rinjtë. Në këtë mënyrë, stafi trajnohet dhe krijohen programe për ndërhyrjen që i largojnë autorët e veprave penale nga komuniteti dhe i tërheqin në aktivitete të mbyllura, intensive, “të orientuara ndaj autorëve të veprave penale” dhe të fokusuara te vepra penale. Edhe kur “komuniteti” merr pjesë në këto aktivitete si p.sh., në Panelet për Shkelësit e Rinj, nuk dërgohet shkelësi/autori i veprës apo i riu në komunitet, por përfaqësues të komunitetit hyjnë në programet e mbyllura.

Të dhënat nga rasti në Massachussets (Coates et al 1980), kanë treguar vlera, në kuptimin e uljes së rasteve të përsëritjes së veprave penale, të programeve “të lidhura me komunitetin”, por parimi i normalizimit na shtyn të shkojmë edhe më tej. Një program plotësisht veprues ndërhyrjesh do të shmangte sigurimin e aktiviteteve të specializuara për autorët e veprave penale. Në të kundërt, ndërhyrja do të bazohej në (ri)futjen e të rinjve tërësisht në shërbimet sociale dhe edukative që ekzistojnë për të rinjtë në përgjithësi. Kjo metodë nuk është më pak e specializuar apo sfiduese, por kërkon një ndryshim të fokusit të ndërhyrjes – mosndërhyrje në jetën e të rinjve dhe

ndërhyrje në mekanizmat që i lidhin të rinjtë me shërbimet sociale dhe edukative.

Kjo metodë është krijuar në bazë të përjashtimit që kanë përjetuar shumë të rinj të cilët kanë shkelur ligjin. Për shembull, monitorimi lokal në Swansea (Haines, Jones & Isles 1999) ka treguar se rreth 70% deri në 80% e të gjithë të rinjve të vendosur nën Urdhrat për Mbikëqyrje nuk u përfshinë në aktivitete ditore domethënëse. Për ata që ishin dënuar me burgim shifrat arrinin mbi 90%. Një anketim me të rinj që kishin shkelur ligjin për herë të parë tregoi se mbi 20% e të rinjve ose mungonin ose përjashtoheshin nga shkolla. Më shumë se gjysma e këtyre të rinjve ose familjet e tyre merrnin ndihmë nga Departamenti i Shërbimeve Sociale. Ishte e qartë që kostot e përjashtimit vazhdonin edhe gjatë jetës pas shkollës, ku një pjesë e mirë e të rinjve të shkëputur nga arsimi, trajnimi dhe puna, u përfshinë në përdorim droge dhe alkooli, dhe në sjellje kriminale me rrezikshmëri më të lartë.

Për rrjedhojë, strategjia e normalizuar e ndërhyrjeve bazohet në promocionin e përfshirjes sociale. Konceptet themelore të pasqyruara në konventat ndërkombëtare të cilat i japin formë praktikave pozitive në drejtësinë për të rinjtë janë:

- Ndërhyrjet duhet të jenë në interesin më të lartë të fëmijës.
- Duhet shmanjur programet e fokusuara te vepra penale ose autorët e tyre.
- Puna me të rinjtë (duke përfshirë edhe ata që kanë kryer vepra penale) duhet të bazohet në njohuritë e grumbulluara dhe në eksperiencën e fituar gjatë praktikës.
- Praktika duhet të udhëhiqet nga parimi i normalizimit dhe nxitjes së përfshirjes sociale.

Një praktikë e normalizuar dhe përfshirëse karakterizohet nga: drejtësia (jo vetëm në kuptimin ligjor formal, por sipas parimeve të së drejtës natyrore, pjesëmarrja (e të rinjve në tërësinë e plotë të shërbimeve sociale dhe edukative të krijuara për ta), dhe përfshirja (vënia në praktikë e të drejtës së të rinjve për të bërë zgjedhjet e tyre dhe për të marrë vendimet, si dhe për t'u përfshirë plotësisht në të gjitha çështjet që kanë lidhje me ta).

Duhet pranuar që politikat e drejtësisë për të mitur ende hartohen nga qeveritë e shteteve në nivel kombëtar, ashtu si dhe ligjet për të miturit që kryejnë vepra penale si dhe ligjet për krijimin e agjencive të drejtësisë për të mitur dhe rolet e tyre – pavarësisht se shkalla e “centralizimit” ndryshon. Në disa vende, politikat kombëtare të drejtësisë për të mitur janë më të orientuara drejt ndëshkimit, ndërsa në vende të tjera të rinjtë që kryejnë vepra penale, fillimisht trajtohen si fëmijë. Megjithatë, në drejtësinë për të mitur, mbeten shumë të rëndësishme konventat dhe parimet ndërkombëtare, pavarësisht politikave kombëtare.

Shërbimi i provës dhe misioni i tij

Shërbimi i provës për të rriturit u referohet shumë më pak standardeve ndërkombëtare dhe më tepër politikave kombëtare. Në këtë kontekst, është më se normale në botën moderne të gjendet misioni kombëtar i cili shpjegon rolin e shërbimeve të provës. Ky mision na ndihmon të kuptojmë se çfarë është Shërbimi i Provës.

Në Evropë, Austria njihet si vendi i vetëm që shprehimisht ka si mision heqjen dorë nga ndëshkimi duke favorizuar dhënien e ndihmës ndaj autorëve të veprave penale. Zakonisht ka një ndërthurje ose balancë ndërmjet ndëshkimit dhe kontrollit nga njëra anë dhe ndihmës ose asistencës nga ana tjetër. Për shembull, në Irlandë qëllimi i shërbimit të provës është të “krijojë sigurinë publike dhe të promovojë të mirën e përbashkët duke rritur njohjen e avancuar dhe përdorimin e sanksioneve dhe masave me bazë komunitare, duke ulur kështu nivelin e recidivizmit” (CEP 2000). Në mënyrë edhe më të qartë, në Francë misioni i shërbimit të provës është që “t’iu japë autorëve të veprave penale më shumë mbështetje të vazhdueshme dhe efektive, shërbime kujdesi dhe rehabilitimi” (CEP 2000).

Misioni i Shërbimit të Provës në shumë vende u jep prioritet të lartë sanksioneve dhe masave në komunitet. Misioni në Finlandë, ka si detyrë kryesore zbatimin e sanksioneve komunitare dhe aktiviteteve të tjera në komunitet, njësoj si shërbimi i provës dhe i Burgjeve në Danimarkë. Të njëjtat qëllime ekzistojnë edhe në Belgjikë, Itali, Maltë dhe Skoci. Këto synime nuk reflektojnë realisht rolin profesional apo vlerat e shërbimit të provës, por janë më tepër synime administrative ose menaxherialiste që tregojnë qëllimin dhe funksionin e tij.

Korporatizmi dhe menaxherializmi në rritje i kohëve moderne reflektohet në objektivat e shërbimeve të provës të shumë vendeve. Në Suedi, shërbimi i burgjeve dhe shërbimi i provës kanë një qëllim të përbashkët, të reduktojnë kriminalitetin dhe të mbrojnë qytetarët nga krimi, dhe roli kryesor i shërbimit të provës në Suedi është zbatimi i vendimeve gjyqësore. Në Angli, Uells dhe Norvegji qëllimi rrjedh nga qëllimi i përgjithshëm i departamentit përkatës në qeveri. Në Norvegji, shërbimi i provës është pjesë e shërbimeve korrigjuese, qëllimi i së cilave i jep prioritet sigurisë së komunitetit. Misioni i shërbimit të provës në Angli dhe Uells është pjesë e politikës penale të qeverisë: “dhënia e drejtësisë nëpërmjet një hetimi, procedimi, gjykimi dhe dënimi efektiv dhe eficient, si dhe duke ofruar mbështetje për viktimat; si dhe ekzekutimi efektiv i dënimeve me qëllimin për të ulur rastet e përsëritjes së veprave penale dhe për të mbrojtur publikun. Këto tema janë të zakonshme për misionet e shërbimit të provës të shumë vendeve dhe tregojnë tendencën e qeverive për të mos identifikuar punën e shërbimit të provës me vlerat dhe konceptet tradicionale të punës sociale dhe për të përputhur misionin e shërbimit të provës me aktivitetet, rolet dhe qëllimet e agjencive të tjera të drejtësisë penale. Kështu që theksi vihet mbi: mbrojtjen publike, vlerësimin e riskut dhe zbatimin efektiv të dënimeve.

Çfarë është shërbimi i provës?

Tani duhet t'i kthehemi pyetjes fillestare të këtij kapitulli: çfarë është shërbimi i provës? Diskutimi i mësipërm tregon që nuk është e lehtë të gjesht një përgjigje për këtë pyetje – të paktën jo në mënyrë të thjeshtë, koherente dhe të qëndrueshme. Ndoshta për t'iu afruar më shumë kuptimit të shërbimit të provës, mund të përdorim tre përkufizime: së pari, çfarë ka qenë shërbimi i provës, së dyti, çfarë është bërë dhe së fundi, çfarë duhet të jetë. Megjithatë, duhet pranuar se këto përkufizime bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Por duke pranuar përgjithësimin e këtyre deklaratave duhet të fillojmë nga diku.

Në vijim ofrohet përkufizimi i asaj çfarë ka qenë shërbimi i provës:

Shërbimi i Provës ka qenë një organizatë që punonte me dhe për autorët e veprave penale, që ndërhynte në procesin e drejtësisë penale për të ndikuar vendimmarrjen me qëllim që sistemi të trajtonte shkelësit duke marrë parasysh faktorët socialë dhe individualë që kishin ndikuar në sjelljen kriminale dhe, kur ishte e përshtatshme, ndëshkimi të lehtësohej me anë të ndihmës apo asistencës.

Shërbimi i provës nuk ka qenë gjithmonë i suksesshëm në punën e vet, por nuk duhet të harrojmë që puna e shërbimit të provës është ndërlikuar nga dy faktorë kryesorë: 1 – gjithmonë është përpjekur të ndikojë dhe ndryshojë vendimmarrjen e organizmave të tjera (të cilave iu mbetej përgjegjësia përfundimtare për veprimet e tyre) dhe 2 – punonte me individë në rrethana sociale komplekse dhe të ndryshueshme të cilat nuk mund të parashikohen apo kontrollohen lehtë. Megjithatë, punonjësit e shërbimit të provës gjatë punës së tyre përdornin njohuri dhe aftësi të veçanta: njohuri sesi funksionon sistemi i drejtësisë penale, njohje të sjelljes individuale dhe sesi kjo sjellje ndikohet dhe ndryshohet nga rrethanat sociale, aftësi për t'u përfshirë me organizata dhe agjenci për të sjellë ndryshim, aftësi për të mbledhur informacion (kryesisht social), aftësi në vlerësim dhe planifikim, aftësi akademike/për të shkruar dhe ndër-personale dhe aftësi për të kuptuar (dhe simpati për) gjendjen e personit.

Shumë prej këtyre karakteristikave janë të njëjtat edhe në shërbimin modern të provës ose të paktën kanë vlerë. Megjithatë, pavarësia që ka pasur shërbimi i provës, aftësia për të caktuar rolin e vet profesional dhe fokusi në punën me autorët e veprave penale, në interes të tyre, kanë pësuar ndryshime të mëdha gjatë viteve të fundit. Shërbimi i provës në kohët moderne mund të përkufizohet si vijon:

Shërbimi i provës është bërë pjesë e sistemit penal. Është pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Shërbimi i provës është një nga agjencitë e drejtësisë penale roli i të cilës në sistemin e drejtësisë penale përcaktohet nga qeveria, dhe puna e mënyra në të cilën zhvillohet ndikohet edhe më tepër nga politikat qeveritare (të cilës i referohemi si politika). Roli i tij përcaktohet më mirë në lidhje me përfitimin potencial që i sjell komunitetit, veçanërisht në lidhje me aftësinë për të mbrojtur publikun nëpërmjet

aktiviteteve që ndëshkojnë dhe kontrollojnë autorët e veprave penale.

Edhe pse disa ende mund të diskutojnë nëse këto ndryshime kanë qenë pozitive, ndikimi i tyre i madh në punën e shërbimit të provës nuk mund të vihet në dyshim. Një sistem më i koordinuar dhe planifikuar i drejtësisë penale është një arritje e mirë. Një theks më i madh mbi mbrojtjen e publikut dhe për reduktimin e recidivizmit është një objektiv i lartë. Megjithatë, mënyra sesi këto objektiva janë artikuluar, duke i ndarë “shkelësit/autorët e veprave penale” nga komuniteti, përbën shqetësim. Gjithashtu shqetësim përbën edhe mënyra sesi politika e shërbimit të provës ka kaluar në varësinë e politikës dhe lëkundjeve të procesit politik. Kjo tendencë dallohet në shumë vende dhe është arritur në dëm të shërbimit të provës dhe drejtësisë.

Së fundi, mund të thuhet disa fjalë në lidhje me atë çfarë duhet të jetë shërbimi i provës. Një deklaratë e tillë do të thotë të kalosh në një territor debatues, por nëse duam të shpëtojmë shërbimin e provës nga mbi-kontrolli politik duhet të artikulojmë disa orientime për të ardhmen. Një e ardhme pozitive do të thotë që shërbimi i provës:

- Është një organizatë me një strategji të përcaktuar mirë për të ndërhyrë në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale (arresti, garancia/paraburgimi, gjykata, dënimi, mbikëqyrja e të dënuarve).
- Ka një qëllim të qartë dhe pozitiv lidhur me punën me të dënuarit.
- Kafokuskomunitetin, strategjitë dhe praktikatenormalizimitdheriintegrimitsocial.

Ndërmjetësimi midis viktimës – autorit të veprës penale Drejtësia Restauruese

2

Rasim Gjoka

Drejtësia Restauruese po përdoret gjerësisht në ditët tona si në teori edhe në praktikë, duke u bërë kështu një lëvizje globale. Janë dhënë shumë përkufizime për drejtësinë restauruese. Megjithatë, pavarësisht këtyre përkufizimeve të shumta të formuluara nga autorë të ndryshëm, studiues dhe profesionistë, të gjitha kanë disa elementë kryesorë të përbashkët, të dhënë më poshtë:

Drejtësia Restauruese vlerësohet si:

- Teori dhe praktikë e drejtësisë.
- Një proces pjesëmarrjeje dhe bashkëpunimi midis viktimës-autorit të veprës penale-komunitetit dhe aktorëve të tjerë.
- Një proces që ka për qëllim të rregullojë dëmin e shkaktuar nga një sjellje kriminale.
- Një proces që mund të zbatohet dhe kontribuojë edhe përtej sjelljes kriminale të individëve, ose siç shprehet Lode Wagrave (Wagrave, L., 2006) ... zbatohet përtej fushës së çështjeve penale, si p.sh., në disiplinën në shkollë, në konfliktet mes fqinjëve apo në vendosjen e paqes.
- Më tepër se një korpus teknikash - një filozofi e përdorshme në nivele të ndryshme.

Çfarë është Drejtësia Restauruese? Si përkufizohet?

Në kompleksitetin e përkufizimeve, kemi përzgjedhur disa prej tyre, dhe veçanërisht ato që ne besojmë se janë më tipiket dhe më përfaqësueset.

Përkufizime:

- **Drejtësia Restauruese (DR)** është një proces që mundëson viktimën dhe shkelësin, me vullnetin e tyre të lirë, të përfshihen në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga vepra penale, me ndihmën e një pale të tretë të paanshme (ndërmjetësuesi) (Rec. No. R 99(19) i Këshillit të Evropës, 1999).

Sipas Kombeve të Bashkuara (2002)

- Një “**proces restaurues**” është çdo proces ku viktimat, shkelësi dhe/ose një individ tjetër apo anëtar i komunitetit i ndikuar nga krimi, marrin pjesë së bashku aktivisht në zgjidhjen e konflikteve të shkaktuara nga shkelja, shpesh me ndihmën e një pale të tretë të drejtë dhe të paanshme. Shembuj të procesit restaurues janë: rrethet e ndërmjetësimit, konsultimit dhe dënimit.

Përkufizimet e mësipërme, dhe shumë të tjera, të drejtësisë restauruese janë krijuar në bazë të studimeve dhe eksperimenteve të shumta paraprake në këtë fushë. Në vitin 1977 Prof. Nils Christie (Christie, N., 1977), e përkufizoi DR-në si një pikënisje për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga krimet ndaj komunitetit dhe shoqërisë. Viktimat dhe shkelësit kanë mundësinë të diskutojnë rreth veprës penale dhe dëmshpërblimit të duhur. Ata janë “të zotët e konfliktit” - shprehet ai, - dhe ky konflikt nuk mund t’i “vidhet” atyre nga profesionistët, siç janë juristët apo punonjësit socialë.

Një nga profesionistët dhe teoricienët e hershëm të drejtësisë restauruese është Howard Zehr. Në librin e tij “Libri i vogël i DR” Zehr argumenton se krimi shkakton dëme te viktimat, autorët dhe komuniteti, dhe ai thekson se “Drejtësia Restauruese është një kompas dhe jo një hartë” (Howard, Z., 2002, fq.10).

Zehr deklaroi se lëvizja e drejtësisë restauruese filloi si një përpjekje për të rimenduar nevojat që shkakton krimi si dhe rolet e nënkuptuara në krim. Procesi i drejtësisë restauruese përmbush nevojat e viktimës, autorit të veprës penale dhe komunitetit, gjë që s’mund të arrihet nëpërmjet sistemit të drejtësisë penale.

Roli dhe nevojat e viktimës

Në një proces të zakonshëm penal, viktimat ndihen të përjashtuara, të neglizhuara dhe të lëna mënjanë nga sistemi i drejtësisë penale. Sipas Zehr-it “Kjo vjen pjesërisht

nga përkufizimi ligjor i shkeljes penale, i cili nuk i përfshin viktimat” (Howard, Z., 2002, fq.14).

Në sistemin e drejtësisë penale krimet konsiderohen si një veprim kundër shtetit, kështu që është shteti ai që merr rolin e viktimës” (Howard, Z., 2002, fq.14).

- *Viktimat kanë nevojë për informacion;* ata duan të pyesin autorin e veprës penale pse ndodhi kjo gjë, cilat janë arsyt, shkaqet që e shtynë të përfshihej në krim “Ata kanë nevojë për informacion të vërtetë, jo për spekulime apo për informacionin e kufizuar që mund të marrin nga një proces gjyqësor apo nga argumentet e një kërkesë për shfajësim” (Howard, Z., 2002, fq.14). Për të marrë një informacion të tillë, viktimat duhet të kenë aksesin e nevojshëm të shkelësi, i cili e ka këtë informacion.
- *Viktimat duhet të dinë të vërtetën.* Rrëfimi i mënyrës si ndodhi krimi është një tjetër nevojë e rëndësishme për viktimat e një shkeljeje. Sipas studiuesve, për viktimat ka shumë rëndësi jo vetëm rrëfimi i sinqertë i asaj çfarë ka ndodhur por edhe ritregimi. Të kuptojnë çfarë ndodhi dhe të dëgjojnë versionin e shkelësit ndikon në rregullimin e dëmit të shkaktuar ndaj viktimës, në një shkallë të konsiderueshme.
- *Viktimat gjithashtu duan të kenë kontrollin e asaj çfarë* ndodhi si dhe të konfliktit ku janë përfshirë. Në drejtësinë penale, kontrolli i veprës penale apo thjesht mbi konfliktin penal i takon aktorëve të tjerë, si: gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, punonjësve socialë, etj. Rikthimi i këtij zotërimi, ose i thënë ndryshe “Përfshirja në vetë rastin e tyre ndërsa kalojnë nëpërmjet procesit gjyqësor, mund të jetë një mënyrë e rëndësishme për t’i rikthyer ndjenjën e zotërimit” (Howard, Z., 2002, fq.15). Procesi i drejtësisë restauruese i aplikuar në rastet e çështjeve penale, merret pikërisht me këto nevoja të viktimave dhe i përmbush ato deri në një farë mase.

Zbatimi i drejtësisë restauruese u jep viktimave akses në:

- të drejtën për t’i bërë pyetje shkelësit dhe për të marrë përgjigje;
- të drejtën për t’i shprehur shkelësit mendimet e tyre rreth dëmit të shkaktuar dhe të diskutojnë me të për dëmshpërblimin;
- të drejtën për të shprehur si u ndjenë kur ndodhi vepra penale, si ka ndikuar sjellja e shkelësit në jetën e tyre, pasojat e veprës penale dhe ndjenjat e lindura kundër autorit.

Roli dhe nevojat e autorit të veprës penale

Sistemi i drejtësisë restauruese lindi si një kërkesë ndaj vendit që autori zë në një proces penal, nga përgjegjshmëria e tij/saj për veprimet kundër viktimës.

Sipas sistemit të drejtësisë penale, kur trajtohet një krim, çështja kryesore është që autori të marrë dënimin e merituar, duke marrë njëkohësisht edhe përgjegjësinë për krimin e kryer. Në këtë sistem, autorët nuk inkurajohen që të kuptojnë pasojat e veprimeve të tyre te viktimat. Ata nuk inkurajohen që të pranojnë përgjegjësinë e tyre dhe kanë pak mundësi për të reaguar në këtë drejtim. Përkundrazi, kjo drejtësi kërkon që autorët të kujdesen për veten” (Howard, Z., 2002, fq.16). Sistemi i drejtësisë penale është më tepër i interesuar në ndëshkimin ligjor të autorit të veprës penale dhe ta izolojë atë nga shoqëria duke e dënuar me burgim.

Sistemi i drejtësisë restauruese, sipas Zehr-it “ka rritur ndërgjegjësimin në lidhje me ndikimet negative të ndëshkimit. Përveç kësaj, mendohet se dënimi nuk është përgjegjshmëri e vërtetë. Përgjegjshmëria e vërtetë përfshin përballjen me ndikimin që veprimet e tyre kanë pasur te viktimat. Kjo nënkupton që autorët e veprave penale ndërgjegjësohen për sa i përket ndikimit të sjelljes së tyre dhe dëmeve të shkaktuara duke i nxitur të marrin hapa konkrete për të korrigjuar dëmet e shkaktuara sa më tepër që të jetë e mundur” (Howard, Z., 2002, fq.16). Kur autori tregohet përgjegjës, kjo ka ndikim pozitiv si për të edhe për viktimat dhe komunitetin. Këto ndikime kanë lidhje me të kuptuarit e sjelljes së autorit dhe me të ndryshuarit e veprimeve të tyre me qëllim që të integrohen në ambientin social ku jetojnë.

Sistemi i drejtësisë restauruese ndihmon në përmbushjen e disa nevojave kryesore të autorëve të veprave penale, si p.sh.:

- të kuptojnë dhe marrin përgjegjësinë për dëmin e kryer;
- të përmirësojnë situatën e tyre duke shmangur sjelljet kriminale;
- transformim personal të ndjenjave, veçanërisht në lidhje me turpin që mund të ndiejnë për veprimin dhe dëmin e shkaktuar;
- t’i inkurajojnë dhe integrojnë në jetën në komunitet.

Nëpërmjet drejtësisë restauruese:

- autorët të cilët ndihen fajtor për veprimet e tyre kanë mundësinë t’u kërkojnë falje viktimave;
- autorët kanë mundësinë “... t’u shpjegojnë viktimave si dhe pse u sollën në atë mënyrë” (Howard, Z., 2002, fq.17).
- autorët e veprave penale janë përgjegjës dhe marrin përgjegjësinë e veprimeve të kryera ndaj viktimave;
- autorët e veprave penale mund të dëmshpërblejnë viktimat për dëmin e shkaktuar.

Roli dhe nevojat e komunitetit

Kur kryhet një krim ndaj një anëtarit të një komuniteti të caktuar, ky i fundit ndikohet nga krimi, dhe shumë socio-kriminologë e konsiderojnë komunitetin si viktimën e dytë të krimit.

Anëtarët e komunitetit duhet të kenë akses në trajtimin e këtij rasti dhe njëkohësisht të kryejnë funksionet dhe rolin e tyre. Procesi i drejtësisë restauruese bën të mundur që disa nga këto funksione dhe role të komunitetit në lidhje me viktimat, të përmbushen. Përgjegjësia e komunitetit ndaj viktimave dhe autorit në një çështje penale shprehet me anë të përfshirjes së tyre në zgjidhjen e çështjes nëpërmjet konsultimeve në komunitet, forumeve si dhe rretheve paqevënëse.

Nëpërmjet drejtësisë restauruese:

- rritet ndjenja e përgjegjësisë së komunitetit për të ndikuar pozitivisht në jetën e viktimave dhe autorëve të veprës penale.
- Komuniteti mund të luajë një rol të rëndësishëm duke ndërmarrë detyrime ndaj anëtarëve të vet dhe duke u treguar aktiv, si dhe duke ndikuar në zgjidhjen e konflikteve.

Një histori e shkurtër rreth origjinës së drejtësisë restauruese

Praktikat restauruese janë shumë më të hershme sesa teoria dhe perceptimet moderne për drejtësinë restauruese. Format restauruese gjenden në shoqëritë tradicionale të tilla si fiset Maori në Zelandën e Re, apo modeli Hooponopono që përdoret në Havai. Praktikat restauruese gjenden edhe në shoqërinë e vendasve (indigjenëve) në Amerikën e Veriut dhe veçanërisht në Kanada. Studiuesit e shumtë vetëm sa kanë rizbuluar praktikat e drejtësisë restauruese të zbatuara në komunitetet e ndryshme, duke i riformuluar dhe pasuruar ato. Disa prej tyre kanë kritikuar praktikat e drejtësisë penale; të tjerë kanë ofruar perspektiva dhe programe të reja të cilat kanë çuar drejt një kuptimi më të drejtë të praktikave të drejtësisë restauruese.

Praktikat restauruese dhe tradita shqiptare

Praktikat restauruese gjenden edhe në traditën e lashtë dhe atë moderne shqiptare. Në të drejtën zakonore shqiptare, instituti i pajtimit dhe ndërmjetësimit zë një rol të rëndësishëm (nenet 667-682 të Kanunit të Lekë Dukagjinit). Këto nene parashikojnë parimet kryesore të ndërmjetësimit dhe pajtimit për të siguruar paqe dhe mirëkuptim ndërmjet palëve, për të shmangur diskutimet dhe konfliktet.

Sipas të drejtës zakonore, pajtimi ishte një proces vullnetar dhe elementi kryesor i tij ishte një marrëveshje e arritur midis palëve me vullnetin e tyre të lirë. Një element i

rëndësishëm i procesit të restaurimit ishte ceremonia e pajtimit ku palët e përfshira në konflikt, ndërmjetësi dhe të ftuar të tjerë mbledheshin dhe uleshin sipas moshës dhe rolit të caktuar. Ashtu siç ka shkruar Prof. Ismet Elezi, profesor i kriminologjisë “Karakteristika më e zakonshme e të drejtës zakonore shqiptare nga veriu në jug është përdorimi i institutit të faljes dhe pajtimit për të kufizuar gjakmarrjen, dhe si një mjet i fuqishëm kundër tyre, i pandashëm nga instituti i vendosjes së armëpushimit” (Elezi, I., 2004, fq.21).

Ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale/Drejtësia Restauruese në Shqipëri

Programi i ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale, drejtësia restauruese i zbatuar nga Fondacioni Shqiptar për “Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve” (AFRC), një organizatë jo-qeveritare, u themelua në vitin 2000. Modeli norvegjez i drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale, një nga më të përparuarit në Evropë, i dha shtysën krijimit të një programi të tillë edhe në Shqipëri. Modeli norvegjez bazohet në bashkëpunimin institucional midis Shërbimit Kombëtar të Ndërmjetësimit (Konfliktrodet) dhe policisë, prokurorisë dhe komunitetit. Shërbimi i ndërmjetësimit në Norvegji është i institucionalizuar dhe financohet nga shteti. Prezantimi i modelit norvegjez dhe shkëmbimi i eksperiencës midis AFRC-së dhe Shërbimit norvegjez të Ndërmjetësimit (NMS) u shoqërua me një program trajnimi për rrjetin e ndërmjetësuesve, i kryer nga trajnues dhe ekspertë norvegjezë. Në sajë të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistratëve, Këshillin e Evropës dhe NMS-në, ky bashkëpunim u zgjerua në sistemin e drejtësisë duke përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët në një program trajnimi në fushën e drejtësisë restauruese, ndërmjetësimit viktimë-autor, eksperiencave evropiane në këtë drejtim dhe rekomandimin e Këshillit të Evropës në lidhje me përdorimin e ndërmjetësimit në çështjet penale. Në këtë program trajnimi u prezantua modeli norvegjez, u shpjegua sesi u themelua ky model dhe si funksionon ai. Gjithashtu, u diskutua për hapësirën ligjore për zbatimin e drejtësisë restauruese në Shqipëri dhe për domosdoshmërinë e përmirësimit të procedurave në lidhje me përdorimin e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese në sistemin e drejtësisë.

Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale shihen nga ndërmjetësuesit e AFRC-së si një alternativë ndaj zgjidhjes së konfliktëve nëpërmjet një pale të tretë dhe si një alternativë jashtë gjykatës, qëllimi i së cilës është arritja e një marrëveshje midis palëve të përfshira në konflikt.

Aktiviteti i AFRC-së për të zbatuar drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin mbështetet në Ligjin shqiptar të Ndërmjetësimit (2003)”, dhe është i fokusuar në zgjidhjen e rasteve që lidhen me pronësinë dhe çështjet tregtare, në lidhje me dëmin

e shkaktuar, çështjet penale, si dhe ato familjare dhe civile.

Disa nga objektivat kryesore të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale në Shqipëri janë:

Programi i ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale dhe drejtësia restauruese u iniciuan si një projekt-pilot në vitet 2000-2001 dhe u zgjerua me kalimin e viteve. Në vitin e tij të parë, ky projekt u zbatua në Tiranë dhe disa rrethe të tjera, dhe nga viti 2002 programi i drejtësisë restauruese u shtri edhe në 8 rrethe të tjera ku u themeluan dhe funksionojnë disa qendra ndërmjetësimi, si dhe në 10 rrethe të tjera ku tashmë operon një rrjet ndërmjetësuesish.

Objektivat e programit:

- Përdorimi i metodave restauruese dhe ndërmjetësimit si një alternativë ndaj zgjidhjes së çështjeve penale.
- Prezantimi i instrumenteve përkatëse ndërkombëtare, respektivisht e Rekomandimit të Këshillit të Evropës, Nr. 19 (99) mbi Ndërmjetësimin në Çështjet Penale, si dhe prezantimi i eksperiencave më të avancuara evropiane në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale.
- Identifikimi i hapësirave ligjore për të zbatuar ndërmjetësimin viktimë-autor dhe drejtësinë restauruese nëpërmjet mbrojtjes ligjore dhe lobimit për të përmirësuar legjislacionin penal.
- Rritja e rasteve ku drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale përdoren si metoda për zgjidhjen e konflikteve duke shmangur procedimin penal.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me avantazhet e drejtësisë restauruese në zgjidhjen e konflikteve penale dhe për të krijuar mundësi që komuniteti të zgjidhë konfliktet nëpërmjet ndërmjetësimit, duke synuar ripërtëritjen e viktimës, rehabilitimin e autorit të veprës penale dhe vendosjen e marrëdhënieve të mira midis palëve të përfshira në këto konflikte pas mbylljes së këtij procesi.

Kuadri ligjor i ndërmjetësimit në rastet penale dhe llojet e rasteve ku përdoret ndërmjetësimi

Metoda alternative e zgjidhjes së konflikteve rregullohet nga legjislacioni procedural penal shqiptar.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e ndërmjetësimit në konfliktet penale. Legjislacioni parashikon të drejtat dhe detyrimet e gjykatës për të ndërmarrë hapa për zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet ndërmjetësimit dhe pajtimit për ato raste të përcaktuara me ligj. Gjykata mund të veprojë kështu për ato çështje

penale, për të cilat nuk mund të fillohet procedimi nëse nuk bëhet akuzë kundër autorit të veprës penale.

Kjo ndodh në dy raste kryesore:

- Në zbatim të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale për një kategori rastesh penale të tilla si, dëmtime të tjera me dashje (rrahja), plagosje e rëndë nga pakujdesia, plagosje e lehtë, dhunimi i banesës, shpifje, etj., viktimat ka të drejtën t'i bëjë kërkesë gjykatës për fillimin e procedimit gjyqësor, dhe të marrë pjesë në proces si palë për të dëshmuar për akuzën dhe për të kërkuar dëmshpërblim.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, në rastet e sipërpërmendura gjykata fton si viktimën edhe autorin dhe u propozon të zgjidhin këtë konflikt nëpërmjet ndërmjetësimit. Nëse viktimat pranon të tërheqë padinë dhe i akuzuari gjithashtu pranon tërheqjen e padisë, gjykata mbyll çështjen dhe rasti zgjidhet me ndërmjetësim.

- Neni 284 i Kodit të Procedurës Penale përcakton edhe rastet e çështjeve penale për të cilat fillohet procedimi penal nga prokuroria ose policia gjyqësore mbi bazën e padisë së viktimës kundër autorit të veprës penale, dhe viktimat mund të tërheqë padinë në çdo fazë të procedimit penal. Raste të tilla janë: plagosje të lehta nga pakujdesia, vrasje nga pakujdesia, shpifjet dhe fyerjet për shkak të detyrës, etj.

Metodat alternative në Shqipëri

Ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale, Drejtësia Restauruese për të miturit

Në vitin 2005 u ndërmor një projekt-pilot një vjeçar për “Ndërmjetësimin Viktimë-Autor i veprës penale, Drejtësia Restauruese për të Miturit” me mbështetjen e Shërbimit të norvegjez të Ndërmjetësimit, i cili u vazhdua në kuadrin e Reformës së Drejtësisë për të Mitur në Shqipëri (2006-2008) nga UNICEF-i dhe Ministria e Drejtësisë, mbështetur nga Komisioni Evropian dhe SIDA.

Qëllimi kryesor i projektit ishte zbatimi i metodave alternative të ndërmjetësimit në çështjet penale me të mitur, qoftë në rolin e viktimës apo të autorit të veprës penale, si e vetmja metodë alternative e zbatuar në Shqipëri.

Objektivi kryesor i këtij projekti ishte sigurimi i ndërmjetësimit për të miturit duke shmangur procedimin penal dhe duke zgjidhur rastin sipas rregullave të ndërmjetësimit me mirëkuptim nga palët e përfshira.

Për zbatimin e ndërmjetësimit në rastet penale u bazuam në filozofinë në vijim:

Nuk ka kosto më efektive të një projekti sesa të investosh në kapitalin social dhe ekzistencën paqësore të një komuniteti. Çdo fond i dedikuar të miturve ia vlen sepse i kursen komunitetit probleme të mëtejshme potenciale dhe kriminalitetin, dhe i rikthen shëndetin dhe produktivitetin individëve me probleme. Duke zgjidhur rastet e të miturve nëpërmjet ndërmjetësimit viktimë-autor, shmanget zgjidhja nëpërmjet procedimit gjyqësor dhe të miturit nuk kalojnë nëpër organet e drejtësisë dhe si rrjedhojë, nuk regjistrohet asnjë e dhënë/dosje penale për ta. Duke ia kaluar këto raste shërbimit të ndërmjetësimit, puna e policisë, gjykatës dhe prokurorisë lehtësohet (për ato raste kur ankesa i adresohet këtyre organeve të drejtësisë nga pala e dëmtuar). Kur zbatohet ndërmjetësimi viktimë-autor, ka shumë më pak gjasa që autorët e veprave penale të përsërisin veprimet e tyre dhe viktimat ndihen të lehtësuara. Ky fakt është evidentuar nga procesi i vlerësimit të kryer në fund të çdo faze një-vjeçare.

Elementët kryesorë të projektit ishin:

- Ndërgjegjësimi i forcave të policisë, ndërmjetësuesve dhe komunitetit për vlerat pozitive të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale për të miturit.
- Zgjidhja e çështjeve penale ku janë përfshirë të rinjtë e moshës 14-21 vjeç, qoftë në rolin e viktimës apo të autorit.

Zona e synuar: Fillimisht ky projekt u zbatua vetëm në Tiranë dhe në vitin e tretë të tij, u zgjerua në tre rrethe të tjera, përkatësisht në Elbasan, Shkodër dhe Durrës. Rezultati (zgjidhja e rasteve penale nëpërmjet drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit duke shmangur procedimin penal për të miturit) i projektit të zbatuar në këto katër rrethe të Shqipërisë është një thirrje për zgjerimin e këtij shërbimi ndërmjetësimi në nivel kombëtar, jo vetëm në disa rrethe dhe jo vetëm për të miturit, por në shkallë kombëtare dhe për të rriturit gjithashtu.

Një mënyrë si mund të arrihet ky qëllim është përfshirja e shërbimit të ndërmjetësimit në kontekstin e shërbimit të provës i cili po krijohet në Shqipëri, duke e orientuar kështu shërbimin e provës jo vetëm ndaj autorit të veprës penale por edhe ndaj viktimës. Nevojitet një përmirësim i legjislacionit mbi skemat alternative, në mënyrë që të prezantohet drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në zgjidhjen e konflikteve (jo vetëm në varësi të përfshirjes së viktimës).

Rastet

Zbatimi i këtij projekti u ndërmor duke marrë parasysh numrin në rritje të të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri, mbipopullimin e burgjeve, ndikimin negativ të burgimit, mungesën e zbatimit të alternativave të dënimit me burgim, shkallën e

recidivizmit midis të miturve dhe përparësitë e drejtësisë restauruese kundrejt drejtësisë ndëshkuese, veçanërisht të të miturit.

Për më tepër, eksperiencia e AFCR-së e përfutur gjatë fazës pilot një-vjeçare të ndërmjetësimit viktimë-autor i veprës penale dhe DR-së, mbështetur nga Shërbimi norvegjez i Ndërmjetësimit në vitin 2005 (155 raste penale me të miturit: viktima ose autorë, u zgjidhën në fazën eksperimentale) ishte një nxitje tjetër për të ndjekur këtë praktikë në kuadrin e Reformës së Drejtësisë për të Miturit.

Strategjia

Bashkëpunimi ndërsektoral ishte pika kryesore e strategjisë për zbatimin e këtij projekti për arsye se rezultati i synuar nuk do ishte arritur pa bashkëpunimin e frytshëm midis OJF-së sonë dhe organeve përkatëse për rastet e ndërmjetësimit, si Ministria e Brendshme, Policia dhe OJF të tjera që punonin në këtë fushë. AFCR dhe Drejtoritë e Policisë të synuara nga projekti, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me miratimin paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për zbatimin e projektit për Ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale dhe DR për grupmoshën 14-21 vjeç. Policia bashkëpunoi ngushtë me ndërmjetësuesit e AFCR-së në lidhje me rastet e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes. Kjo evidentohet nga numri i rasteve penale që i janë kaluar shërbimit të ndërmjetësimit nga të cilat 80% janë referuar nga policia.

Mobilizimi social është një metodë e rëndësishme, sepse komuniteti është më afër viktimave apo autorëve të veprave penale, palëve të përfshira në çështjet penale, dhe mbështetja e tyre është thelbësore në zbatimin e modeleve të DR-së (si p.sh., rasti i konsultimit në familje apo komunitet). Përfshirja e tyre në zbatimin e këtyre metodave të zgjidhjes së konflikteve ka rëndësi edhe për riintegrimin e autorëve të veprave penale.

Krijimi i kapaciteteve ka qenë një shqetësim tjetër për sa i përket zbatimit të suksesshëm të ndërmjetësimit dhe DR-së sepse punonjësit e policisë duhet të jenë në dijeni të avantazheve që sjell kjo metodë dhe të marrin trajnim në këtë fushë. Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin të tyre është thelbësore për shërbimin e ndërmjetësimit, sepse ata janë të parët që marrin kontakt me të miturit në konflikt me ligjin. Si rrjedhojë, punonjësit e policisë dhe ndërmjetësuesit janë trajnuar në fushën e drejtësisë restauruese, ndërmjetësimit dhe drejtësisë për të miturit në katër rrethet e synuara. Janë organizuar edhe vizita studimore të punonjësve të policisë në Norvegji, për shkak të eksperiencës shumë të mirë që ka Norvegjia në bashkëpunimin midis policisë dhe shërbimit të ndërmjetësimit, veçanërisht në çështjet e të miturve.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit:

Një element i rëndësishëm i këtij projekti ishte: së pari, monitorimi i aktiviteteve të tij, si: trajnimet, tryezat e rrumbullakëta si dhe monitorimi i procesit të bashkëpunimit midis punonjësve të policisë e qendrave të ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesve për të zgjidhur rastet penale me të mitur dhe së dyti, monitorimi i produktit final të projektit, respektivisht i monitorimit të rasteve të trajtuara dhe të zgjidhura nëpërmjet ndërmjetësimit dhe praktikës restauruese.

Medias iu dha gjithashtu rëndësi për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për DR-në dhe avantazhet e ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve, veçanërisht të rasteve penale. Në televizionet kombëtare u transmetuan kronika mbi ngjarjet kryesore në fushën e promovimit të DR-së, të tilla si: konferenca dhe forume, dhe në një nga televizionet private u transmetua një debat televiziv mbi drejtësinë restauruese kundrejt drejtësisë penale. Po në këtë kanal televiziv u transmetua një cikël bisedash në studio mbi Ndërmjetësimin viktimë-autor, DR-në dhe ndërmjetësimin brenda grupit.

Progresi dhe rezultatet

Rezultatet e projektit pilot një-vjeçar (2005-2006), të mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (nëpërmjet Shërbimit norvegjez të Ndërmjetësimit), dhe rekomandimet e nxjerra nga faza e monitorimit dhe vlerësimit të projektit pilot, tregojnë domosdoshmërinë e vazhdimet të këtij projekti. Metoda alternative e ndërmjetësimit u mor në konsideratë në Reformën tre vjeçare të Drejtësisë për të Mitur në Shqipëri (2006-2008). Si rrjedhojë, projekti i ndërmjetësimit viktimë-autor për të miturit u zbatua edhe për dy vite të tjera duke arritur rezultate premtuese.

Nga intervistat e kryera me punonjësit e policisë, të miturit (viktimat dhe autorët), ndërmjetësuesit, prokurorët dhe juristët, doli se situata në lidhje me kriminalitetin e të miturve, është problematike. Të intervistuarit raportuan se ka një rritje të përfshirjes së të miturve në kryerjen e veprave penale.

Anketim studimor: Në kontekstin e projektit tre vjeçar “Ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale dhe drejtësia restauruese për të miturit e moshës 14-21” u zhvillua një anketim studimor në vitin 2007 mbi “Drejtësinë restauruese dhe të miturit në konflikt me ligjin.”

Shumica e rasteve iu kaluan shërbimit të ndërmjetësimit nga Komisariatet e Policisë në ato qytete të synuara nga projekti dhe në disa raste nga prokuroria, dhe rrallë nga gjykata. Situata ekonomike, arsimore dhe familjare e këtyre të miturve si dhe trajtimi i rastit penal nga institucionet përgjegjëse shtetërore si policia, prokuroria dhe gjykata u theksuan si aktorët kryesorë që ndikojnë sjelljen e të miturve. Një nga konkluzionet

e anketimit ishte se 95% e të intervistuarve e vlerësojnë drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin si praktika të rëndësishme në përmirësimin e situatës.

Meqë ngritja e kapaciteteve ishte një nga strategjitë kryesore në implementimin e këtij projekti:

- 210 punonjës të policisë gjyqësore dhe të policisë kriminale morën pjesë në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere të organizuara në bashkëpunim me komisaritetet përkatëse të policisë.

- 60 punonjës policie u trajnuan në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, si në nivel fillestar edhe në nivel të avancuar, së bashku me 40 ndërmjetësues dhe juristë, psikologë, punonjës social, etj.

- Punonjës të nivelit të lartë të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve morën pjesë në vizita studimore në Norvegji dhe Itali të mbështetur nga partnerët norvegjezë (Shërbimi i Ndërmjetësimit Norvegjez) dhe UNICEF-i, për të ndërgjegjësuar këto institucione mbi drejtësinë restauruese.

Ndërmjetësimi i rasteve

Brenda periudhës janar 2005 – tetor 2008, *609 vepra penale* me rrezikshmëri të ulët për komunitetin në të cilat ishin të përfshirë të mitur, u zgjidhën nga shërbimi i ndërmjetësimit në kuadrin e projektit. Metoda e drejtësisë restauruese i ndihmoi palët të arrinin në një zgjidhje të pranueshme nga të dyja anët; parandaloi përballjen e të miturve me autoritetet gjyqësore, të cilës i frikësoheshin autorët e veprave penale në shumicën e tyre; siguroi riparimin e dëmit të shkaktuar; dhe parandaloi përkeqësimin e mundshëm të këtyre konflikteve.


Rastet më tipike që u zgjidhën ishin veprat penale të rrahjes , plagosjes së lehtë dhe fyerjes. Marrëveshjet e pajtimit për secilin rast dokumentohen nga qendrat përkatëse të ndërmjetësimit.

Rastet	Dëmtime të tjera me dashje Neni 90 i KP	Plagosje e lehtë me dashje Neni 89 i KP	Fyerje Neni 119 KP	Totali
Janar '05-mars '06	89	49	17	155
Nëntor '06-tetor '07	88	3	19	110
Nëntor '07-tetor '08	210	75	59	344
Totali	386	126	93	609

Tabela e rasteve të trajtuara nëpërmjet ndërmjetësimit

Nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit rezultoi se në të gjitha rastet e monitoruara për qëndrueshmërinë e zgjidhjes së tyre, të miturit e intervistuar dhe palët e përfshira në konflikt raportuan se nuk i ishin rikthyer konfliktit me palën tjetër dhe se kishin respektuar marrëveshjen e pajtimit. Pyetjes se nëse do ua rekomandonin këtë alternativë miqve apo të afërmeve të tyre nëse do ndodheshin në të njëjtën situatë, të gjithë iu përgjigjën pozitivisht.

Trajtimi dhe zgjidhja e rasteve



Rast studimor

Iliri, një i ri 21-vjeçar u kthye nga Greqia ku kishte qenë emigrant dhe bleu një makinë të re. Si i ri që ishte, i pëlqente të mburrej me makinën e re duke i dhënë me shpejtësi nëpër rrugët e qytetit. Fatkeqësisht ndërsa po kalonte një kryqëzim humbi kontrollin e drejtimit dhe u përplas me një makinë tjetër, shoferi i së cilës ishte po një i ri i quajtur Agron (emrat e përdorur këtu nuk janë emrat e personazheve të vërtetë).

Në atë çast, Iliri doli nga makina i nxehur dhe pa prituri për shpjegime filloi të godiste personin tjetër. Agroni, për t'u mbrojtur kapi një shufër hekuri dhe e goditi Ilirin në krah duke e plagosur.

Pas kësaj ngjarjeje disa kalimtarë e çuan Ilirin në spital. Doktorin e dha ndihmën e shpejtë dhe i rekomandoi të qëndronte në spital për t'u qetësuar dhe marrë mjekim të mëtejshëm. Iliri nuk e dëgjoji doktorin dhe u kthye në vendin e aksidentit për të vazhduar grindjen, por Agroni nuk ishte aty. Ai ishte larguar pasi i kishte sqaruar ngjarjen punonjësve të policisë, të cilët më pas e kishin lënë të lirë.

Kjo gjë e acaroi edhe më tepër Ilirin i cili nuk priti më gjatë por filloi të kërkonte Agronin. Kur u takuan përsëri situata u acarua edhe më shumë. Ata filluan të grindeshin dhe u desh ndërhyrja e policisë që i shoqëroi në komisariat. Iu shpjegua shkelja ligjore që kishin kryer dhe meqë kishin shkelur ligjin, policia duhej të fillonte procedimin penal kundër tyre. Në të njëjtën kohë, punonjësi i policisë i këshilloi dy të rinjtë të mendoreshin dhe të binin dakord për ndonjë zgjidhje alternative nëpërmjet ndërmjetësimit dhe parimeve restauruese. Meqë situata ishte e tensionuar dhe të dyja palët ishin në ankth, ata nuk e pranuan sugjerimin.

Iliri tha se do merrte një avokat për të hedhur në gjyq Agronin me akuzën e plagosjes, ndërsa Agroni e kërcënoi se do ta padiste për dëmtim të makinës. Pas disa orësh, punonjësit e policisë i kërkuan përsëri të rinjve të rikonsideronin mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje paqësore dhe nëse do binin dakord policia do t'i ndihmonte ta kalonin rastin te shërbimi i ndërmjetësimit. Të dyja palët tashmë ishin pak më të qetë dhe pasi hezituan pak në fillim, pranuan të kontaktonin qendrën e ndërmjetësimit. Pasi pranuan këtë zgjidhje alternative, u lanë të lirë.

(Në këtë rast policia njoftoi qendrën e ndërmjetësimit dhe dërgoi një raport teknik të përgatitur nga polici i trafikut në lidhje me aksidentin, si dhe një raport mjekësor për Ilirin ku shkruhej diagnoza dhe shkalla e dëmtimit sipas së cilit rasti u klasifikua si dëmtim jo i rëndë- plagosje e lehtë).

Takimet para ndërmjetësimit

Pasi palët u kthyen në shtëpi dhe u qetësuan, filluan të reflektonin mbi ngjarjen. Ishin shumë të stresuar dhe pasi u lanë të lirë nga policia kishin nevojë të flisnin me dikë për të gjetur zgjidhje. Më vonë u shprehën se edhe familjet u kishin kërkuar të gjenin një zgjidhje të përbashkët dhe të mos i përkeqësonin gjërat apo të ngrinin padi. Meqë në polici kishin premtuar se do drejtoheshin te qendra e ndërmjetësimit, te ndërmjetësuesi i rekomanduar nga policia, ishte gjëja e parë që duhej të bënin pasi u liruan. Në komisariat, ata kishin deklaruar se kishin dëgjuar për këtë lloj shërbimi por nuk e dinin se ekzistonte edhe në Shqipëri. Iliri mori i pari iniciativën për të folur me ndërmjetësuesin e këshilluar nga policia. Pas telefonatës ata lanë një takim për ditën tjetër. Agroni nuk e mori mundimin të bënte të njëjtën gjë. Ai preferoi të qetësohej dhe pastaj të mendonte se çfarë mund të bënte. Takimi i parë i Ilirin me qendrën e ndërmjetësimit do të bëhej në ambientet e qendrës. Pasi shpjegoi se çfarë ndodhi, Iliri bëri disa pyetje mbi procesin e ndërmjetësimit dhe detyrimet që kishte. Ndërmjetësuesi iu përgjigj pyetjeve të tij dhe i shpjegoi që ky shërbim ofrohej falas. Nga ana tjetër, ndërmjetësuesi bëri disa pyetje mbi konfliktin dhe e informoi Ilirin për avantazhet e zgjidhjes së konfliktit nëpërmjet ndërmjetësimit si dhe për bazat ligjore të ndërmjetësimit dhe për fuqinë ligjore të marrëveshjes nëse do të nënshkruhej edhe nga pala tjetër. Megjithatë, ai nuk pranoi se ishte fajtor, madje ishte ndierë i fyer dhe i goditur nga Agroni dhe, sipas diagnozës mjekësore, Iliri ishte dëmtuar jo rëndë, në krah për shkak të goditjes me shufër hekuri gjatë grindjes. Ndërmjetësuesi e dëgjoi me kujdes dhe i shpjegoi se procesi i ndërmjetësimit nuk kishte për qëllim të gjente fajtorin; askush nuk do gjykohej gjatë procesit të ndërmjetësimit dhe nuk do të jepej asnjë dënim. Qëllimi i këtij procesi – shpjegoi ndërmjetësuesi - ishte që të dyja palët të komunikonin me njëra-tjetrën në përpjekje për të zgjidhur problemin, të shlyenin dëmin e shkaktuar nga aksidenti dhe të mos përkeqësonin konfliktin, të shmangnin stresin, inatin dhe zemërimin. Ndërmjetësuesi i tha Ilirit se do takohej edhe me Agronin dhe se do organizonin një takim të përbashkët te qendra e ndërmjetësimit. Iliri ra dakord (takimi zgjati një orë e njëzet minuta).

Ndërmjetësuesi ishte informuar për këtë rast nga policia, të cilët i kishin dhënë dhe numrin e Agronit. Ndërmjetësuesi telefonoi Agronin dhe i kërkoi të takoheshin. Në fillim Agroni hezitoi dhe tha se do mendohej. Ndërmjetësuesi i la numrin e vet të telefonit nëse Agroni do dëshironte të flisnin për këtë rast. Pasi u konsultua me prindërit e vet, Agroni vendosi të takonte ndërmjetësuesin. Versioni i tij i ngjarjes ndryshonte nga ai i Ilirit. Agroni ishte më i stresuar dhe dyshues ndaj premtimeve të Ilirit për të zgjidhur rastin nëpërmjet ndërmjetësimit. Nga mënyra si po tregonte historinë, ndërmjetësuesi kuptoi se Agroni ishte i frikësuar nga mundësia e hakmarrjes nga Iliri. Agroni i tha ndërmjetësuesit se ndoshta ishte gabuar që kishte pranuar këtë lloj zgjidhjeje paqësore dhe do të kishte qenë më mirë të kishte ngritur padi duke akuzuar Ilirin për dëmtim dhe kanosje.

Ndërmjetësuesi pasi dëgjoi versionin e Agronit dhe për dhunën e ushtruar nga të dyja palët, i mendoj hezitimet dhe dyshimet e Agronit dhe vendimin e tij për të shkuar në gjykatë. Megjithatë, i kërkoi Agronit ta mendonte edhe një herë këtë vendim duke i thënë se edhe Iliri e kishte mirëpritur këtë zgjedhje. “Pata përshtypjen –tha ai- se Iliri ishte i gatshëm të flisnim të gjithë së bashku për të gjetur një zgjidhje të pranueshme nga të dy”. Ndërmjetësuesi tha se Iliri nuk kishte treguar shenja agresiviteti apo hakmarrjeje kështu që e siguroi Agronin të mos shqetësohej. Në fund të takimit, ai i kërkoi Agronit të mendonte mundësinë e një takimi me të tre personat (Iliri, Agroni dhe ndërmjetësuesi) që të diskutonin për një zgjidhje të mundshme. Agroni tha se do mendohej dhe do kthente një përgjigje shumë shpejt (takimi zgjati një orë e dhjetë minuta).

Meqë të dyja palët ishin të rinj, ndërmjetësuesi ftoi edhe prindërit e tyre të merrnin pjesë në takim. Prindërit ranë dakord me dëshirën që konflikti midis fëmijëve të tyre të zgjidhej paqësisht dhe sa më shpejt.

Sesioni i ndërmjetësimit të përbashkët

Ndërmjetësuesi i mirëpriti palët dhe prindërit e tyre dhe i falënderoi që e pranuan si ndërmjetësues të rastit të tyre. I kërkoi të uleshin dhe u shpjegoi që duhej t'i bindeshin disa rregullave të përbashkëta për të pasur një takim të suksesshëm, të tilla si:

- të respektonin njëri-tjetrin gjatë këtij sesi ndërmjetësimi,*
- të mos fyenin njëri-tjetrin dhe të mos përdornin fjalë me kuptim negativ,*
- të mos ndërprisnin njëri-tjetrin gjatë bisedës si dhe disa rregulla të tjera që duhet të respektoheshin gjatë procesit të ndërmjetësimit.*

Ai u kërkoi palëve leje të mbante disa shënime gjatë sesionit dhe u shpjegoi se sipas legjislacionit shqiptar për ndërmjetësimin, e gjithë përmbajtja e takimit do ishte konfidenciale. Ai u kërkoi palëve që nëse do të arrihej një marrëveshje, duhej të ishte në formë të shkruar dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

Pasi palët ranë dakord për rregullat, ai i ftoi të shprehnin mendimin e tyre në prani të prindërve. Agroni dha i pari versionin e tij të ngjarjes dhe pastaj Iliri. U bënë pyetje dhe u dha përgjigje nga të dyja palët. Palët ishin pozitive por me raste situata acarohesh sepse palët përpiqeshin t'ia hidhnin "fajin" njëri-tjetrit. (Mendimi i prindërve në fund të takimit ishte domethënës për rezultatit dhe ndihmoi në arritjen e një marrëveshjeje). Së fundi, palët arritën një marrëveshje, e zgjidhën rastin duke u pajtuar dhe duke i kërkuar falje njëri-tjetrit. Në marrëveshje deklarohesh shumë e dëmshtëpërblimit reciprok që Iliri do paguante për dëmtimin e makinës dhe Agroni për mjekimin e krahut të dëmtuar të Ilirit. (I gjithë takimi i ndërmjetësimit, duke përfshirë edhe marrëveshjen e nënshkruar, zgjati një orë e njëzet minuta).

Pas këtij sesioni dhe arritjes së një marrëveshjeje, ndërmjetësuesi njoftoi komisaratin e policisë që kishte referuar këtë çështje mbi rezultatit e ndërmjetësimit.

Pas ndërmjetësimit

Disa javë pas sesionit të ndërmjetësimit, palët që kishin nënshkruar marrëveshjen u kontaktuan nga ndërmjetësuesi i cili mësoi se dy të rinjtë ishin bërë miq dhe ndonjëherë dilnin bashkë për të pirë diçka. Në një intervistë të kryer nga eksperti që monitoronte rastin, (një nga djemtë) Agroni tha se tani, pas gjithë asaj që kishte ndodhur, ndihej i lehtësuar dhe kishte një shok të ri. Më pëlqen që këto alternativa për zgjidhjen e konflikteve po zbatohen edhe në Shqipëri. U kam treguar shumë miqve për këtë rast dhe disa prej tyre kishin interes të dëgjonin më tepër për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin.

Pyetje për diskutim:

1. Cila është esenca e procesit restaurues në trajtimin e çështjeve penale?
2. Cila është lidhja midis drejtësisë restauruese dhe kontrollit social?
3. Çfarë është ndërmjetësimi viktimë-autor brenda procedimit penal?
4. Cilët janë disa nga dimensionet njerëzore/demokratike të drejtësisë restauruese?
5. Çfarë çështjesh janë të përshtatshme për ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale, për drejtësinë restauruese?
6. Çfarë ndodh në një proces ndërmjetësimi mes viktimë-autorit të veprës penale?
7. Cilat janë hapat kryesorë që duhen ndjekur në një proces të drejtësisë restauruese?
8. Çfarë përfitimi ka autori i veprës penale nga ndërmjetësimi viktimë-autor?
9. Çfarë përfitimi ka viktimi nga ndërmjetësimi viktimë-autor?
10. Çfarë përfitimi ka komuniteti nga ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale?

Konteksti ndërkombëtar i shërbimit të provës

3

Migena Leskoviku

Çështja e ndëshkimit për tejkalimin e kufijve ligjorë është temë që ngjall interes të vazhdueshëm. Edhe pse jo më i përdorshmi, dënimi me burgim mbetet një ndëshkim i zakonshëm për veprat penale, i cili autorizohet nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, me kusht që të jepet pas një gjykimi që respekton parimin e një procesi të rregullt ligjor, dhe që nuk i tejkalon kufijtë e trajtimit të ndaluar nga standardet e të drejtave të njeriut, si sjellje e tepruar në krahasim me veprën penale të kryer.

Edhe pse dënimi me burgim është i nevojshëm në shumë raste ku përfshihen autorë të dhunshëm, ky dënim nuk është zgjidhja e duhur për çdo rast, as për parandalimin e krimit dhe as për riintegrimin social të të dënuarve. Për më tepër, në shumë shtete sistemi i burgjeve po kalon sfida të shumta për shkak të mbipopullimit apo infrastrukturës së vjetruar dhe si rrjedhojë, të dënuarit me burgim jetojnë në kushte të mjera të cilat mund të kenë një ndikim negativ për gjendjen e tyre fizike dhe atë mendore, dhe pengojnë përgatitjen e tyre arsimore dhe profesionale, duke ndikuar kështu në mundësitë e tyre për një jetë normale në komunitet në të ardhmen. Një dënim i gjatë me burgim ka ndikim edhe në jetën familjare dhe punën e një personi. Sanksionet penale më të përdorshme janë **të një natyre jo me burgim** (të ndryshme nga burgimi), dhe ky kapitull trajton pikërisht këto lloj sanksionesh. Duke marrë parasysh shtimin e skepticizmit në lidhje me efektivitetin e dënimit me burgim, ekspertët janë përpjekur të gjejnë masa të tjera të dobishme për të ndihmuar të dënuarit duke i mbajtur në komunitet.

Ka një numër instrumentesh ndërkombëtare të cilat vendosin detyrime, rregulla minimale standarde dhe udhëzime për shtetet/palët anëtare të traktateve dhe konventave për administrimin e drejtësisë dhe alternativave ndaj dënimit me burgim. Dokumentet e përshkruara në këtë kapitull të cilat janë përdorur për krijimin e këtij manuali – janë Rregullat e Pekinit dhe Rregullat Minimale Standarde për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (“Rregullat e Tokios”) dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe disa rekomandime të Këshillit të Evropës.

Edhe pse qëllimi i këtij kapitulli është të eksplorojë dhe të fokusohet në dokumentet bazë të Shërbimit të Provës në kontekstin evropian, si fillim po ndalem në dy dokumente të rëndësishme ndërkombëtare: Rregullat Standarde Minimale për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (“Rregullat e Tokios”) dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (“Rregullat e Pekinit”).

A. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios)

Të adoptuara nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/110 në 14 dhjetor 1990

Siç u përmend më sipër, *qëllimi i masave alternative të dënimit me burgim në përgjithësi dhe Rregullave të Tokios në veçanti, është gjetja e alternativave efektive ndaj dënimit me burgim për të dënuarit dhe të mundësojë autoritetet t’i përshtatin sanksionet penale me nevojat individuale të të dënuarit dhe në proporcionalitetin e duhur me veprën penale të kryer. Avantazhet e individualizimit të dënimit në këtë mënyrë, janë të dukshme sepse e lejojnë të dënuarin të mbetet i lirë dhe, duke i mundësuar të vazhdojë punën, studimet dhe jetën në familje.*

Megjithatë, këto masa alternative mund të jenë subjekt i kushteve dhe kufizimeve, shkelja e të cilave mund të çojë, në raste serioze, edhe në dënim me burgim. Për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor duhen vendosur disa standarde mbi detyrimin dhe zbatimin e këtyre kufizimeve, dhe një nga qëllimet kryesore të Rregullave të Tokios është pikërisht përkufizimi i këtyre standardeve të cilat duhet të konsiderohen si ***standardet minimale***, që synojnë të nxisin “përpjekjet për të kapërcyer vështirësitë praktike gjatë aplikimit të këtyre masave”. Si rrjedhojë, Rregullat nuk duhen lexuar si një model i detajuar i një sistemi masash alternative të dënimit me burgim, por si “*parime të mira dhe një praktikë e mirë*” në këtë fushë.

Rregullat e Tokios nxisin përdorimin e masave alternative të dënimit me burgim si dhe mbrojtjen minimale për personat e dënuar me këto masa alternative. Këto rregulla synojnë të inkurajojnë një përfshirje më të gjerë të komunitetit në trajtimin

e të dënuarve (duke përfshirë edhe dyshimet) dhe të nxisin një ndjenjë përgjegjësie sociale te të dënuarit. Duhet theksuar se Rregullat e Tokios aplikohen për ata persona ndaj të cilëve janë dhënë masa alternative të dënimit me burgim (siç janë sanksionet komunitare).

Fleksibiliteti në përdorimin e masave alternative

Edhe pse theksojnë rëndësinë e “dënimit të vazhdueshëm”, këto Rregulla nxisin fleksibilitet të konsiderueshëm në zhvillimin dhe përdorimin e masave alternative duke u bazuar në katër kritere:

- “natyra dhe rrezikshmëria e veprave penale”;
- “personaliteti dhe formimi i autorit të veprës penale”;
- “mbrojtja e shoqërisë”; dhe
- shmangia e “përdorimit të panevojshëm të dënimit me burgim”.

Kështu p.sh., masat alternative mund të jenë më të përshtatshme se paraburgimi. Megjithatë, vazhdimësia e tyre është në interes të drejtësisë dhe udhëzimet që përdoren për gjetjen e ekuivalencave midis llojeve të shumta të masave alternative të dënimit me burgim, do të ndihmonin në zbatimin e detyrueshëm të këtyre masave.

Rregullat Standarde Minimale aktuale përcaktojnë parimet bazë për promovimin e masave alternative të dënimit me burgim, si dhe për mbrojtjen minimale për të dënuarit ndaj të cilëve janë dhënë këto masa. Këto rregulla kanë për qëllim të inkurajojnë një përfshirje më të gjerë të komunitetit në administrimin e drejtësisë penale, veçanërisht në trajtimin e të dënuarve, si dhe nxisin një ndjenjë përgjegjësie sociale te të dënuarit. Rregullat do të zbatohen duke marrë parasysh kushtet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të secilit shtet si dhe synimet dhe objektivat e sistemit përkatës të drejtësisë penale. Gjatë implementimit të Rregullave, Shtetet Anëtare duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar një balancë të duhur midis të drejtave të të dënuarve, të drejtave të viktimave dhe shqetësimit të komunitetit në lidhje me sigurinë publike dhe parandalimin e krimit. Shtetet Anëtare duhet të krijojnë masa alternative të dënimit me burgim brenda sistemeve të tyre ligjore, në mënyrë që të sigurojnë opsione alternative duke reduktuar si rrjedhojë numrin e dënimeve me burgim dhe për të racionalizuar politikën e drejtësisë penale duke marrë parasysh vëzhgimin e të drejtave njerëzore, kërkesat e drejtësisë sociale dhe nevojat rehabilituese të të dënuarve.

Dispozitat përkatëse të Rregullave aktuale do të përdoren për të gjithë personat gjatë

fazës së procedimit penal, gjykimit apo gjatë ekzekutimit të vendimit penal, në të gjitha fazat e administrimit të drejtësisë penale. Për qëllimet e Rregullave, këtyre personave do t'i referohemi si “të dënuarit”, pavarësisht nëse janë të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar. Rregullat do të zbatohen pa asnjë lloj diskriminimi racor, ngjyre, seksi, moshe, gjuhe, besimi fetar, opinionin politik apo ndonjë opinion tjetër, origjinë kombëtare apo sociale, prone, prejardhje apo ndonjë status tjetër. Për t'u treguar sa më fleksibël, në përputhje me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale, personalitetin dhe formimin e autorit të veprës penale dhe për mbrojtjen e komunitetit, si dhe për të shmangur përdorimin e panevojshëm të dënimit me burgim, sistemi i drejtësisë penale duhet të krijojë një sërë masash alternative, që nga paraburgimi deri në dispozitat për kohën pas-dënimit. Numri dhe lloji i masave alternative të dënimit me burgim duhet të zhvillohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë vazhdimësinë e dhënies së këtyre alternativave.

Masat alternative janë mjete fleksibël të cilat mund të përdoren në fazën e paraburgimit, procesit gjyqësor dhe dënimit ose në fazën pas-dënimit. Këto masa duhen zbatuar gjithmonë nën dritën e parimit të ndërhyrjes minimale.

Në fazën para procesit gjyqësor, interesi i të dënuarit për të shmangur procedimin ligjor duhet të vlerësohet kundrejt:

- mbrojtjes së shoqërisë;
- parandalimit të krimit/nxitjes së respektimit të ligjit; dhe
- të drejtave të viktimave.

Mbyllja e procedimit është një masë alternative e zakonshme në këtë fazë.

Në fazat e gjykimit penal dhe dënimit, për adresimin e masave alternative duhet të merren parasysh:

- nevojat rehabilituese të të dënuarit;
- mbrojtja e shoqërisë; dhe
- interesat e viktimave.

Viktimat duhen konsultuar sa here që të jetë e përshtatshme. Në fazën pas-dënimit, autoritetet duhet të kenë tashmë një sërë masash alternative për të siguruar mundësinë e lirimit të të dënuarit sa më shpejt dhe për ta ndihmuar të ri-integrohet në shoqëri.

Zhvillimi i masave të reja alternative të dënimit me burgim duhet të nxitet dhe të monitorohet nga afër, si dhe duhet vlerësuar vazhdimisht përdorimi i tyre. I duhet dhënë rëndësi trajtimit të të dënuarve në komunitet duke mënjанuar sa më shumë

mundësinë e procedimit penal apo procesit gjyqësor në gjykatë, në përputhje me mbrojtjen ligjore dhe shtetin e së drejtës.

Masat alternative të dënimit me burgim duhen përdorur në përputhje me parimin e ndërhyrjes minimale. Përdorimi i këtyre masave duhet të jetë pjesë e lëvizjes drejt depenalizimit dhe dekriminalizimit, dhe jo të ndërhyjë apo të pengojë përpjekjet në këtë drejtim.

B. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (“Rregullat e Pekinit”)

Të adoptuara nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 në 29 nëntor 1985

Rregullat e Pekinit kanë për qëllim të sigurojnë minimizimin e efekteve të dëmshme në trajtimin e të miturve nga sistemi i drejtësisë, duke parandaluar shtimin e kriminalitetit dhe duke e përfshirë sistemin e drejtësisë për të miturit në një proces zhvillimi sa më të gjerë në nivel kombëtar. Rregullat e Pekinit përdoren për të gjithë të miturit brenda sistemit të drejtësisë, ku mund të përfshihen këtu edhe masat komunitare. Edhe pse një dispozitë në Rregullat e Pekinit, e cila nuk ekziston në Rregullat e Tokios, siguron më shumë mbrojtje për të miturit sesa për të rriturit, kjo nuk përjashton mundësinë që një mbrojtje e tillë të aplikohet edhe për të rriturit.

Këto Rregulla Standarde Minimale për të dënuarit e mitur, aplikohen në mënyrë objektive, pa asnjë dallim, si p.sh., për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik apo ndonjë opinioni tjetër, origjine kombëtare apo sociale, prone, prejardhjeje apo ndonjë statusi tjetër. Një i mitur është një fëmijë ose i ri i cili, nën sistemin përkatës ligjor, trajtohet ndryshe për kryerjen e një veprë penale nga një i rritur i cili supozohet të ketë kryer ose është gjetur fajtor për kryerjen e një veprë penale.

Duhen bërë përpjekje për të vendosur në çdo juridiksion kombëtar, një sërë ligjesh, rregullash dhe dispozitash për të dënuarit e mitur, si dhe për të krijuar institucione dhe organizma për administrimin e drejtësisë për të miturit. Këto rregulla duhen zbatuar plotësisht dhe me drejtësi. Këto perspektiva thelbësore të gjera i referohen politikave sociale në tërësi dhe synojnë të nxisin mirëqenien e të miturve që, si rrjedhojë, do të minimizojë nevojën për ndërhyrjen e sistemit të drejtësisë për të mitur dhe do të zvogëlojë dëmin që mund të shkaktojë kjo ndërhyrje. Këto masa kujdesi për të miturit, të zbatuara para sesa të shfaqen shenjat e para të delinkuencës, janë kërkesat e politikave bazë për të shmangur nevojën për përdorimin e Rregullave.

Mosha minimale për përgjegjësi penale ndryshon nga një vend në tjetrin, në bazë

të historisë dhe kulturës përkatëse. Metoda moderne do të merrte në konsideratë faktin nëse një fëmijë mund të jetojë sipas komponentëve moralë dhe psikologjikë të përgjegjësisë penale; d.m.th nëse një fëmijë, në bazë të dallimit dhe kuptimit të vet individual, mund të ketë përgjegjësi për një sjellje antisociale esenciale. Kështu që, duhen bërë përpjekje për të caktuar një moshë minimale të arsyeshme e cila të ketë zbatim ndërkombëtar.

Duke marrë parasysh nevojat e veçanta të të miturve si dhe shumëllojshmërinë e masave të disponueshme, nevojitet një shkallë e duhur maturie në të gjitha fazat e procedimit penal dhe në nivelet e ndryshme të administrimit të drejtësisë për të mitur, duke përfshirë hetimin, procedimin penal, gjykimin dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Megjithatë, duhen bërë përpjekje për të siguruar përgjegjshmërinë e duhur në të gjitha hapat e ushtrimit të këtij diskrecioni. Ata që ushtrojnë maturi duhet të kenë kualifikimin e duhur ose të jenë trajnuar për të vepruar me maturi dhe në përputhje me funksionet dhe postet e tyre. Këto Rregulla kombinojnë një sërë tiparësh të rëndësishme të një administrimi efektiv, të drejtë dhe humane të drejtësisë për të miturit: nevoja për të lejuar ushtrimin e autoritetit diskret në të gjitha nivelet e rëndësishme të procedimit, me qëllim që ata të cilët marrin vendime të mund të ndërmarrin veprimet e duhura në lidhje me çdo rast individual; dhe nevoja për të garantuar kontrolle dhe balanca, për të parandaluar çdo abuzim me pushtetin diskrecional dhe për të mbrojtur të drejtat e të dënuarve në moshë të re. Përgjegjshmëria dhe profesionalizmi janë instrumentet më të përshtatshëm për të frenuar përdorimin e gjerë të diskrecionit. Për këtë arsye, kualifikimi dhe trajnimi profesional theksohen si mjete të rëndësishme për të siguruar një ushtrim të duhur të diskrecionit në çështjet që lidhen me të dënuarët e mitur. (Shih gjithashtu nenet 1.6 dhe 2.2.) Në këtë kontekst, theksohet formulimi i udhëzimeve specifike për ushtrimin e diskrecionit dhe sigurimin e sistemeve të rishikimit, apelimit, etj, për të lejuar shqyrtimin e vendimeve dhe përgjegjshmërisë. Këto mekanizma nuk specifikohen në këtë kapitull, për shkak se nuk mund të përfshihen lehtësisht në rregullat minimale standarde të pranura në nivel ndërkombëtar, pasi këto të fundit nuk mund të mbulojnë të gjitha ndryshimet në sistemet e drejtësisë.

Mbrojtjet bazë procedurale si p.sh., prezumimi i pafajësisë, e drejta për t'u informuar mbi akuzat, e drejta për të heshtur, e drejta për këshillim, e drejta për praninë e një prindi ose kujdestari, e drejta për t'u ballafaquar dhe bërë pyetje dëshmitarëve, dhe e drejta për të apeluar te një autoritet më i lartë, duhet të garantohen në të gjitha fazat e procedimit penal. E drejta e të miturve për privatësi duhet respektuar në çdo rast, në mënyrë që të shmanget dëmi që mund t'i shkaktohet atij/asaj nga një publicitet jo i duhur apo nga etiketimi i mundshëm. Studimet kriminologjike në fushën e etiketimit kanë treguar për efektet e dëmshme (të llojeve të ndryshme) të shkaktuara nga identifikimi i përhershëm i të rinjve si “kriminelë” apo “delinkuent”.

Policia, prokuroria apo organe të tjera që trajtojnë rastet e të miturve, duhet të kenë autoritetin të disponojnë për raste të tilla, brenda diskrecionit të tyre, pa iu referuar seancave dëgjimore, në bazë të kriterëve të vendosura për këtë qëllim në sistemin përkatës ligjor, dhe në përputhje me parimet që përmbajnë këto Rregulla. Çdo lloj alternative, duke përfshirë edhe referimin ndaj masave të përshtatshme komunitare apo shërbimeve të tjera, kërkon miratimin e të miturit, të prindërve apo kujdestarit të tij/saj, me kusht që një vendim i tillë për një rast të referuar, të shqyrtohet nga një autoritet kompetent, për zbatim. Për të lehtësuar zgjidhjet diskrete të rasteve të të miturve, duhet të bëhen përpjekje për të krijuar programe komunitare, të tilla si: mbikëqyrje ose udhëzim i përkohshëm, zhdëmtim dhe kompensim i viktimave.

Përdorimi i një mase alternative duke zëvendësuar procedimin penal dhe, shpesh herë, ri-drejtimi të shërbimet e ndihmës komunitare, praktikohet në mënyrë formale dhe joformale në shumë sisteme ligjore. Kjo praktikë shërben për të penguar ndikimet negative të procedimeve ligjore të vazhdueshme në administrimin e drejtësisë për të mitur (për shembull, stigma e vendimit dhe dënimit). Në shumë raste, mos-ndërhyrja do të ishte përgjigja më e mirë. Si rrjedhojë, përdorimi i masave alternative që në fillim, pa iu referuar shërbimeve (sociale) alternative mund të jetë përgjigja më e mirë. Kjo ndodh zakonisht kur vepra penale nuk ka rrezikshmëri të lartë dhe kur familja, shkolla apo institucione të tjera sociale të kontrollit informal, kanë reaguar tashmë apo do të reagojnë në mënyrën e duhur dhe konstruktive.

Sipas nenit 11.2, masat alternative mund të përdoren në çdo fazë të vendimmarrjes nga policia, prokuroria apo institucione të tjera si: gjykatat, bordet apo këshillat. Mund të ushtrohet nga një, disa apo të gjitha autoritetet sipas rregullave dhe politikave të sistemeve përkatëse, dhe në përputhje me këto Rregullat. Këto masa alternative, jo domosdoshmërisht, duhet të kufizohen vetëm për vepra penale me rrezikshmëri të ulët, duke i kthyer ato në këtë mënyrë në një instrument të rëndësishëm.

Këto rregulla rekomandojnë gjetjen e masave alternative ndaj drejtësisë për të mitur në formën e masave me bazë punën në komunitet. Programet që përfshijnë zgjidhje të tilla si zhdëmtimi i viktimës dhe ato që përpiqen të shmangin konfliktet me ligjin në të ardhmen nëpërmjet mbikëqyrjes dhe udhëzimit, këshillohen në mënyrë të veçantë. Meritat e rasteve individuale do ta bënin përdorimin e masave alternative të përshtatshëm edhe për veprat penale me rrezikshmëri më të lartë (për shembull, kur një vepër penale kryhet për herë të parë dhe nën presionin e bashkëmoshatarëve, etj.).

Rregullat theksojnë nevojën për trajnim të specializuar për të gjithë punonjësit e ligjit të përfshirë në administrimin e drejtësisë për të miturit. Meqë policia është kontakti i parë me sistemin e drejtësisë për të mitur, është me rëndësi që punonjësit e policisë të veprojnë në mënyrë profesionale.

Kongresi i Gjashtë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin

e të Dënuarve, në rezolutën nr. 4 mbi standardet e drejtësisë për të mitur, specifikon se Rregullat, *inter alias*, duhet të reflektojnë parimin bazë që paraburgimi të përdoret vetëm si mundësia e fundit, në mënyrë që asnjë i mitur të mos mbahet në një ndërtesë ku është i ekspozuar ndaj ndikimeve negative të të rriturve, dhe të merren parasysh nevojat e tyre të veçanta gjatë kësaj faze zhvillimi.

C. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)

Qëllimi i Këshillit të Evropës është që të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore, që përbëjnë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë, ruajtja e të cilave mbështetet kryesisht mbi një regjim politik demokratik nga njëra anë, dhe nga ana tjetër mbi një kuptim dhe respektim të përbashkët të të drejtave të njeriut.

Të gjitha palët kontraktuese kanë detyrimin për të respektuar të drejtat e njeriut që parashikohen në këtë konventë. Disa nga këto të drejta dhe liri themelore marrin rëndësi të veçantë në kuadër të penologjisë.

Për efekt të tematikës së këtij Manuali, do të doja të ndalesha në disa prej të drejtave dhe lirive që parashikon KEDNJ, si garanci të rëndësishme në procesin penal dhe që afektojnë sistemin e drejtësisë penale në tërësi.

Një nga të drejtat që parashikon kjo konventë është padyshim “E drejta për jetën” – neni 2 i KEDNJ. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykatë pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

Po ashtu, një nen i rëndësishëm i Konventës lidhet me ndalimin e përdorimit të torturës (neni 3 i KEDNJ). Kjo konventë parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese”. Një sërë rastesh janë paraqitur në Gjykatën e Strasburgut në lidhje me shkelje të këtij neni, ku kjo gjykata ka bërë edhe vlerësimin në çdo rast nëse kemi të bëjmë me trajtim degradues/çnjerëzor, duke pasur parasysh interpretimin që i ka bërë kjo gjykatë termit torturë, trajtim johuman apo degradues.

Për të garantuar një trajtim sa më human të personit, në rastet kur ai arrestohet apo burgoset për një vepër penale, me rëndësi është padyshim neni 5 i KEDNJ, në lidhje me të drejtën e personit për liri dhe siguri, si dhe garancitë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me

procedurën dhe rastet e parashikuara me ligj

Neni 6 i KEDNJ parashikon *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Edhe në lidhje me këtë, rastet e shqyrtuara nga Gjykata e Strasburgut kanë qenë të shumta, duke krijuar kështu edhe një jurisprudencë të pasur. (shih nenet 5 dhe 6 të KEDNJ).

Për një proces penal, me rëndësi janë edhe disa garanci të tjera që parashikon kjo Konventë, si: “Mosdënimimi pa ligj”- neni 7 i KEDNJ, apo “Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar”- neni 4 i KEDNJ, që parashikon se askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar, duke përfshirë këtu çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë lirimit të tij me kusht.

D. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimi Nr. R 87 (3) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës

Këto Rregulla si dhe ato të Kombeve të Bashkuara nuk janë të detyrueshme në kuadrin ligjor të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, ato përfaqësojnë një Kod standardesh dhe praktikash të bazuara në konsensusin e përgjithshëm të gjithë shteteve që tashmë i kanë adoptuar si në aspektin politik ashtu edhe në atë ligjor.

Formulimi i këtyre rregullave në formën e rekomandimeve, zgjeron mundësinë që ato të pranohen nga një sërë shtetesh, kushtet ekonomike dhe sociale të të cilëve, mund të ndryshonin dukshëm. Gjithashtu, fleksibiliteti i Rregullave zgjeron mundësinë për të përmirësuar zbatimin e tyre praktik brenda sistemit të burgjeve. Në kontekstin evropian, këto Rregulla janë transformuar në një simbol dhe stimul me qëllim përmirësimin e standardeve të përgjithshme, si dhe nxitjen e politikave penale dhe të regjimit modern dhe humanitar të trajtimit të të dënuarve.

Edhe pse Rregullat nuk janë ligjërish të detyrueshme, përveç juridiksionit të detyrueshëm të brendshëm, statusi i tyre moral dhe ndikimi që kanë si një kod praktik merr një rëndësi të madhe, gjithnjë në rritje.

Vëmendje e veçantë i kushtohet përgatitjes para-lirimit. Për të gjithë të burgosurit duhet të merren masat e duhura që t'i ndihmojnë të rikthehen në jetën e tyre familjare, në shoqëri dhe në punë pas lirimit. Për këtë arsye duhen krijuar procedura dhe kurse të veçanta. Në rastin e personave të dënuar me burgim për një kohë të gjatë, duhen marrë masa për të siguruar një rikthim gradual në jetën në komunitet. Ky qëllim mund të arrihet, kryesisht, duke përdorur një regjim para-lirimit të organizuar në të

njëjtin institucion ose në një institucion tjetër të përshtatshëm, ose duke i liruar me kusht nën një mbikëqyrje të veçantë të kombinuar me mbështetjen e duhur sociale.

Administrata e burgjeve duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me shërbimet sociale dhe agjencitë që ndihmojnë të burgosurit e liruar të rikthehen në komunitet, veçanërisht në jetën familjare dhe në punë. Duhet marrë masa për të siguruar që të burgosurit e liruar të pajisen me dokumentet e duhura dhe dokumente identifikimi, si dhe t'u jepet ndihmë për të gjetur një shtëpi dhe punë të përshtatshme. Atyre iu duhet siguruar menjëherë mjetet e nevojshme të jetesës, veshjet e duhura në përshtatje me klimën dhe stinën, si dhe çfarë u nevojitet për të arritur në destinacionin e tyre.

E. Rekomandime të tjera të Këshillit të Evropës

Këto rekomandime janë bazuar në parimet e Rregullave Evropiane të Burgjeve me qëllim që t'u shërbejnë qeverive të shteteve anëtare në praktikën dhe legjislacionin e tyre të brendshëm, që t'i zbatojnë në mënyrë progresive dhe me bazë sa më të gjerë. Disa nga Rekomandimet kryesore të Këshillit të Evropës, në këtë drejtim, janë:

❖ *Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare*

Termi “sanksione dhe masa komunitare” i referohet atyre masave dhe sanksioneve që mbajnë të dënuarin në komunitet, por me disa kufizime të lirisë së tij nëpërmjet vendosjes së kushteve dhe/ose detyrimeve, dhe të cilat zbatohen nga organet e përcaktuara me ligj për këtë qëllim. Termi përfshin çdo sanksion të vënë nga një gjykatë apo gjyqtar, dhe çdo masë të marrë para apo në vend të një vendimi mbi një sanksion, si dhe mënyrat për të zbatuar një dënim me burgim jashtë ambienteve të burgut. Edhe pse ky përkufizim nuk përfshin sanksionet monetare, çdo aktivitet mbikëqyrës apo kontrollues i ndërmarrë për të siguruar zbatimin e tyre, përfshihet në qëllimin e rregullave.

Ai rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare të udhëhiqen në legjislacionin e tyre të brendshëm dhe në praktikë, nga parimet e përcaktuara në përmbajtjen e Rregullave evropiane mbi sanksionet dhe masat komunitare, bashkëngjitur Rekomandimit aktual, me qëllim që të zbatohen në mënyrë progresive dhe të përdoren sa më gjerësisht. Në shtetet anëtare, është zhvilluar dukshëm përdorimi i sanksioneve dhe masave të zbatuara në komunitet, gjë që tregon se më shumë vëmendje po u kushtohet masave alternative sesa dënimit me burgim.

Ky rekomandim konsideron rëndësinë e vendosjes së parimeve të përbashkëta në lidhje me politikën penale në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, me qëllim që të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë; kjo duke marrë parasysh që këto sanksione dhe masa konsiderohen mënyra të rëndësishme të luftimit të krimit, dhe që shmangin efektet negative të dënimit me burgim; si dhe rëndësinë e zhvillimit të normave ndërkombëtare për krijimin, detyrimin dhe zbatimin e këtyre sanksioneve dhe masave.

Megjithatë, masat që kanë lidhje specifike me të miturit, nuk përfshihen në këto Rregulla. Rregullat aktuale, të konceptuara si paralele me Rregullat Evropiane të Burgjeve, nuk duhen konsideruar si një sistem model. Ato formojnë një korpus kërkesash që mund të pranohen gjerësisht dhe të zbatohen. Nëse nuk respektohen këto kërkesa, nuk mund të ketë zbatim të kënaqshëm të masave dhe sanksioneve komunitare.

Dispozitat e Rregullave aktuale trajtojnë të gjitha sanksionet dhe masat komunitare që zbatohen në komunitet, duke përfshirë këtu edhe mënyrat për ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim jashtë burgut.

Ky rekomandim përbëhet nga sa vijon:

Pjesa I, përcakton parimet e përgjithshme duke përfshirë edhe kuadrin ligjor, garancitë gjyqësore dhe procedurat për apelim; respektin për të drejtat themelore, bashkëpunimin dhe miratimin e të dënuarit.

Pjesa II, përcakton burimet njerëzore dhe financiare, duke përfshirë stafin e kualifikuar, burimet njerëzore, pjesëmarrjen e komunitetit;

Pjesa III, mbulon aspektin e menaxhimit të sanksioneve dhe masave, duke përfshirë kushtet e zbatimit të tyre dhe metodat e punës.

Ky rekomandim është një instrument që nxit shumë përdorimin e dënimeve/masave komunitare sa herë që këto masa promovojnë riintegrimin social të një të dënuari, duke mbajtur parasysh interesat e komunitetit, si p.sh., parandalimin e krimit, respektimin e ligjit dhe interesat e viktimave. Masat dhe sanksionet komunitare janë një fushë ligjore që nuk është eksploruar ende plotësisht, por që ka një potencial të rëndësishëm, nga i cili mund të përfitojë si komuniteti ashtu edhe të dënuarit.

Mbikëqyrja e sanksioneve dhe masave komunitare ka për qëllim reduktimin e përsëritjes së veprave penale dhe të ndihmojë të dënuarin të ri-integrohet në komunitet. Nevoja për mbikëqyrje varet nga natyra e masës komunitare përkatëse.

Mbikëqyrja duhet të kryhet nga një autoritet kompetent në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj. Mbikëqyrja duhet të përshtatet me nevojat e të dënuarit dhe suksesi i saj varet nga miratimi, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i të dënuarit. Gjithashtu, ajo duhet rishikuar periodikisht.

Kohëzgjatja e sanksioneve dhe masave komunitare duhet të përcaktohet nga një autoritet përkatës në përputhje me ligjin; një masë mund të përfundojë para kohe dhe gjithashtu mund të zgjatet, nëse është e nevojshme dhe në interes të të dënuarit. Kushtet e caktuara për sanksionet dhe masat komunitare duhet të marrin parasysh nevojat e komunitetit, si dhe nevojat dhe të drejtat e të dënuarit dhe viktimës.

Kushtet duhet të jenë realiste dhe të përcaktuara drejtë, dhe i duhen shpjeguar të dënuarit si me gojë dhe me shkrim. Mund të nevojitet krijimi i skemave të veçanta trajtimi, për t'u marrë me nevojat dhe problemet e një kategorie veçanërisht të vështirë të dënuarish. Në rast se këto kushte shkelen, sanksionet/masat mund të modifikohen ose revokohen. Megjithatë, një shkellje e tillë, nuk mund të çojë automatikisht në heqjen e lirisë.

Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët luajnë një rol të rëndësishëm kur vendoset nëse i dënuari do t'i nënshtrohet masave komunitare dhe jo dënimit me burgim. Pushteti që u jepet këtyre profesioneve ligjore nga legjislacioni i brendshëm në lidhje me këtë çështje varion, por duke marrë parasysh efektin negativ që burgimi ka shpesh veçanërisht te të dënuarit e mitur, si dhe kostot sociale të rënda të burgimit, si dhe duhet eksploruar çdo mundësi për t'u siguruar të dënuarve një mundësi rehabilitimi duke përdorur sanksione më pak drastike, por mundësisht më efektive sesa dënimi me burgim.

Megjithatë, përdorimi i gjerë i sanksioneve dhe masave komunitare kërkon zhvillimin e një rrjeti njerëzish të aftë, të kualifikuar dhe trajnuar, jo vetëm në organet gjyqësore dhe të procedimit, por edhe në stafin e autoriteteve sociale dhe administrative. Pra, kërkohen përpjekje të bashkërenduara nga autoritetet e të gjitha niveleve, për të krijuar një sërë dënimesh komunitare të cilat mund të zbatohen me fleksibilitet dhe në përshtatje me nevojat specifike të të dënuarve.

Gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe punonjësit e shërbimit të provës me eksperiencën dhe lidhjet e tyre tepër të ngushta me të dyshuarit dhe akuzuarit për vepra penale, luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e problemeve dhe zgjidhjeve përkatëse,

dhe në nxitjen e një debati të hapur në shoqëri në lidhje me veprat penale dhe mënyrat e ndëshkimit të të dënuarve.

Sanksionet për kryerjen e një vepre penale janë subjekt i një debati dhe shqyrtimi të vazhdueshëm, veçanërisht, por nuk kufizohen vetëm nga kjo, për të dënuarit e mitur. Ndërsa shoqëritë tona ndryshojnë dhe evoluojnë, deri diku edhe veprat penale të kryera ndryshojnë dhe, si rrjedhojë, çështja e sanksioneve *largo sensu* do të vazhdojë në këtë mënyrë, të jetë një shqetësim por dhe një subjekt me interes për komunitetin.

❖ ***Rekomandimi Nr. R (99) 22, i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje (dhe Shtojca e këtij rekomandimi)***

(Adoptuar nga Komiteti i Ministrave në 30 shtator 1999 në mbledhjen e 681 të Zëvendës Ministrave)

Rekomandon qeveritë e shteteve anëtare, të marrin masat e duhura kur rishikojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre në lidhje me mbipopullimin dhe rritjen e popullsisë në burgje, me qëllim që të inkurajojnë shpërndarjen më të gjerë të mundshme të Rekomandimit dhe raportit mbi mbipopullimin dhe rritjen e popullsisë në burgje të hartuar nga Komiteti Europian për Problemet e Kriminalitetit.

Sipas këtij rekomandimi, mbipopullimi dhe rritja e popullsisë në burgje përbëjnë një sfidë madhore për administratën e burgjeve dhe sistemin e drejtësisë penale në tërësi, si në lidhje me të drejtat e njeriut, ashtu dhe me menaxhimin efikas të institucioneve penale. Gjithashtu, ai merr në konsideratë faktin që menaxhimi efikas i popullatës së burgjeve përcaktohet nga çështje të tilla si: situata e përgjithshme e kriminalitetit, prioriteti në kontrollin e krimit, gama e dënimeve të përcaktuara, ashpërsia e dënimeve të dhëna, shpeshtësia e përdorimit të sanksioneve dhe masave komunitare, përdorimi i paraburgimit, efektiviteti dhe efikasiteti i organeve të drejtësisë penale dhe qëndrimi i publikut ndaj krimit dhe ndëshkimit.

Ky rekomandim afirmon që masat e marra për të luftuar mbipopullimin e burgjeve dhe për të reduktuar popullsinë e burgjeve, duhet të bëhen pjesë e një politike penale koherente dhe racionale për parandalimin e krimit dhe sjelljes kriminale, zbatimin efektiv të ligjit, sigurinë dhe mbrojtjen e publikut, individualizimin e sanksioneve dhe masave si dhe për riintegrimin social të të dënuarve.

Këto masa duhet të jenë konform parimeve bazë të shteteve demokratike të udhëhequra nga ligji dhe që u nënshtrohen qëllimit madhor të garantimit të të drejtave të njeriut, në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me rastet e praktikës gjyqësore të organeve përkatëse të ngarkuara me zbatimin e tij.

Ky dokument ndahet në disa pjesë: Pjesa e parë përshkruan parimet bazë; pjesa e dytë trajton menaxhimin e situatës për reduktimin e popullsisë së burgjeve; pjesa e tretë përcakton masat që merren në lidhje me fazën para-gjykimin me qëllim shmangien e procedimit penal – Reduktimi i paraburgimit; pjesa e katërt përcakton masat në lidhje me fazën e gjykimin, sistemin e sanksioneve/masave – kohëzgjatja e dënimit, dhe pjesa e fundit trajton masat në lidhje me fazën pas-gjykimin, zbatimin e sanksioneve dhe masave komunitare – ekzekutimi i dënimeve me burgim.

❖ ***Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Rregullat Evropiane për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave***

(Adoptuar nga Komiteti i Ministrave në 5 nëntor 2008 në mbledhjen e 1040 të Zëvendës Ministrave)

Ky rekomandim ka për qëllim të rrisë unitetin midis shteteve anëtarëve të tij, veçanërisht duke harmonizuar ligjet mbi çështjet me interes të përbashkët, duke konsideruar faktin që nevojitet një bashkëveprim në nivel evropian për të mbrojtur më mirë të drejtat dhe mirëqenien e të miturve që hyjnë në konflikt me ligjin, si dhe për të zhvilluar një sistem drejtësie në interes të të miturve në shtetet anëtare.

Gjithashtu, ai merr në konsideratë faktin e rëndësishëm që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës vazhdojnë të përmirësojnë, përditësojnë dhe vëzhgojnë parimet e përbashkëta në lidhje me politikat dhe praktikat kombëtare të drejtësisë për të mitur, dhe të zhvillojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë.

Është e rëndësishme që ky rekomandim dhe komentaret që e shoqërojnë atë të përkthehen dhe shpërndahen gjerësisht dhe sidomos te autoritetet gjyqësore dhe në polici; institucionet që ekzekutojnë sanksionet dhe masat në lidhje me të dënuarit e mitur; institucionet penitenciare, të mirëqënies dhe shëndetit mendor ku qëndrojnë të dënuarit e mitur dhe personeli i tyre, si dhe media dhe publiku i gjerë.

Të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve apo masave, duhen trajtuar duke respektuar të drejtat e tyre. Sanksionet ose masat që mund të jepen për të miturit si dhe mënyra e zbatimit të tyre, duhet të përcaktohen me ligj dhe të bazohen në parimet e integritetit social dhe edukimit dhe të parandalimit të recidivizmit. Sanksionet dhe masat duhen vendosur nga gjykata, duhet të jenë të përcaktuara mirë dhe të zbatohen vetëm për periudhën më minimale të nevojshme dhe vetëm për një qëllim të ligjshëm. Imponimi dhe zbatimi i sanksioneve ose masave duhet të kryhet në interesin më të lartë të të dënuarve të mitur, të kushtëzuar nga rrezikshmëria e veprës penale të kryer (parimi i proporcionalitetit) dhe të marrë parasysh moshën e tyre,

shëndetin fizik dhe mendor, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale (parimi i individualizimit), të përcaktuara, kur është e nevojshme, nga raportet psikologjike, psikiatrike apo raportet e vlerësimit social. Sanksionet apo masat duhen zbatuar pa vonesë dhe vetëm për periudhën e nevojshme (parimi i ndërhyrjes minimale).

Privimi i lirisë së një të mituri duhet të jetë masa e fundit që mund të merret dhe të zbatohet për periudhën më të shkurtër të mundshme. Duhet bërë përpjekje të veçanta për të shmangur paraburgimin. Sanksionet ose masat duhet të jepen dhe zbatohen pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të racës, seksit, ngjyrës, gjuhës, fesë, orientimit seksual, opinionit politik apo ndonjë opinionit tjetër, origjinën kombëtare apo sociale, përkatësisë në një minoritet kombëtar, pronës, prejardhjes apo ndonjë statusi tjetër (parimi i mos-diskriminimit). Ndërmjetësimi ose masat e tjera restauruese duhet të inkurajohen në çdo fazë të trajtimit të një mituri.

Çdo sistem drejtësie për të mitur duhet të sigurojë pjesëmarrjen e tyre efektive në procedimet ligjore në lidhje me dhënien dhe zbatimin e sanksioneve apo masave. Të miturit nuk duhet të kenë më pak të drejta apo mbrojtje ligjore sesa ato që u ofrohen të rriturve nga rregullat e përgjithshme të procedurës penale. Çdo sistem drejtësie për të mitur duhet të marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve dhe kujdestarëve ligjorë, si dhe duhet t'i përfshijë ata sa më shumë gjatë procedimit penal dhe në ekzekutimin e sanksioneve ose masave, përveç se kur kjo gjë nuk është në interesin më të lartë të të miturve.

Çdo sistem drejtësie për të mitur duhet të ndjekë një metodë multi-disiplinare dhe multi-institucionale, si dhe të integrohet në shumë iniciativa të gjera sociale për të miturit, në mënyrë që të sigurojë një përqasje *holistike* dhe vazhdimësi të kujdesit për këta të mitur (parimet e përfshirjes së komunitetit dhe kujdesit të vazhdueshëm).

Personeli që punon me të miturit kryen një shërbim publik të rëndësishëm. Rekrutimi i tyre, trajnimi i veçantë dhe kushtet e punës duhet të sigurojnë që ata janë në gjendje të sigurojnë standardin e duhur të kujdesit, për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturve dhe të shërbejnë si shembull pozitiv për ta. Ekzekutimi i çdo sanksioni apo mase duhet t'i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga qeveria dhe monitorimit të pavarur.

Në të gjitha fazat e procesit duhet të zbatohen një sërë sanksionesh dhe masash komunitare, të përshtatura me fazat e ndryshme të zhvillimit të të miturve. Duhet t'u jepet prioritet sanksioneve dhe masave që mund të kenë ndikim edukues, si dhe atyre që formojnë një "përgjigje restauruese" ndaj veprave penale të kryera nga të miturit.

Legjislacioni kombëtar duhet të specifikojë karakteristikat e mëposhtme të sanksioneve dhe masave të ndryshme komunitare:

- a. përkufizimi dhe mënyra e zbatimit të të gjitha sanksioneve dhe masave që mund të zbatohen ndaj të miturve;
- b. çdo kusht apo detyrim që lind si rrjedhojë e dhënies së këtyre sanksioneve ose masave;
- c. rastet kur kërkohet miratimi i të miturit para se të zbatohet një sanksion ose masë;
- d. cilët autoritete janë përgjegjës për dhënien, ndryshimin dhe zbatimin e një sanksioni ose mase si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse;
- e. bazat dhe procedurat e aplikueshme për ndryshimin e një sanksioni ose mase të dhënë; dhe
- f. procedurat për shqyrtimin e rregullt dhe të jashtëm të punës së autoriteteve zbatuese.

Për të plotësuar nevojat e të miturve, legjislacioni kombëtar duhet të përcaktojë:

- a. detyrimin e çdo autoriteti kompetent për t'u shpjeguar të dënuarve të mitur, përmbajtjen dhe qëllimet e dispozitave ligjore që rregullojnë sanksionet ose masat komunitare dhe, nëse është e nevojshme, edhe prindërve apo kujdestarëve të tyre ligjorë;
- b. detyrimin e çdo autoriteti kompetent për të synuar bashkëpunimin më të mirë të mundshëm me të dënuarit e mitur dhe me prindërit apo kujdestarët e tyre ligjorë; dhe
- c. të drejtat e prindërve dhe kujdestarëve ligjorë të të dënuarve të mitur ndaj të cilëve po zbatohen sanksione ose masa komunitare, kufizimet e mundshme të të drejtave dhe përgjegjësi të tyre në lidhje me dhënien dhe zbatimin e këtyre sanksioneve dhe masave.

Vendimi për të dhënë apo anuluar një sanksion apo masë komunitare duhet të merret nga një autoritet gjyqësor ose, nëse merret nga një autoritet administrativ i autorizuar nga ligji, duhet të shqyrtohet nga një autoritet gjyqësor. Në varësi të progresit të të miturit, autoritetet kompetente, kur përcaktohet nga legjislacioni kombëtar, kanë të drejtën të reduktojnë kohëzgjatjen e sanksionit ose masës, të lehtësojnë kushtet apo detyrimet e përcaktuara nga këto sanksione ose masa, ose t'i japin fund asaj.

Mosrespektimi nga i mituri i kushteve dhe detyrimeve të sanksioneve apo masave komunitare të vendosura ndaj tyre, nuk çon automatikisht në heqjen e lirisë. Kur është e mundur, sanksione apo masa komunitare të ndryshuara ose të reja, mund të zëvendësojnë ato të mëparshme. Mosrespektimi i tyre nuk përbën automatikisht vepër penale.

Sipas *Shtojcës së Rekomandimit CM/Rec(2008)11 - Rregullat Evropiane për të dënuarit e mitur ndaj të cilëve janë vendosur sanksione apo masa:*

Qëllimi i rregullave aktuale është të mbështesë të drejtat dhe sigurinë e të dënuarve të mitur ndaj të cilëve janë vendosur sanksione ose masa dhe të promovojnë shëndetin e tyre fizik, mendor dhe mirëqenien sociale, kur ata i nënshtrohen këtyre sanksioneve ose masave komunitare, apo çdo lloj forme të heqjes së lirisë. Asgjë në këto rregulla nuk duhet interpretuar si pengesë ndaj zbatimit të instrumenteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe standardeve që sigurojnë më mirë të drejtat, kujdesin dhe mbrojtjen e të miturve. Për më tepër, dispozitat e Rekomandimit Rec(2006)2 mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe të Rekomandimit Nr. R (92) 16 mbi Rregullat Evropiane për sanksionet dhe masat komunitare, duhen zbatuar në interes të dënuarve të mitur për sa kohë që nuk janë në konflikt me këto Rregulla.

Rast studimi

Në maj të vitit 2001, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) vizitoi Irlandën për herë të tretë. Përveç komisariateve të policisë dhe burgjeve, KPT vizitoi edhe ndërtesat ku mbaheshin të dënuarit e mitur, spitalet për personat me probleme mendore dhe, për herë të parë, qendrat rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara mendore. KPT ia komunikoi rezultatet fillestare të vizitës së tyre qeverisë irlandeze në dhjetor, dhe qeveria kishte gjashtë muaj kohë për t'u përgjigjur. OJF-të që u takuan me KPT-në theksuan problemet kryesore në lidhje me burgimin e të miturve në Irlandë, që vazhdonte të shkelte rëndë standardet ndërkombëtare. Ndërkohë që po bëheshin pak investime në shërbimet e parandalimit, ndërhyrjes në kohë dhe masave alternative për të miturit në Irlandë, pati një rritje të kapaciteteve të vendeve në burgje, numrit të institucioneve të burgimit duke e vënë kështu theksin më tepër te burgimi sesa te rehabilitimi.

Në maj të vitit 2002 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dha vendimin kundër qeverisë në çështjen D.G. kundër Irlandës, duke pretenduar se burgimi i kërkuar, i cili ishte i mitur në Institucionin e Shën Patrikut përbënte shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së. Në vendimin e saj, gjykata iu referua specifikisht dështimit të Irlandës për të siguruar qendra të specializuara për të miturit. Shën Patriku është një burg për persona të moshës 16-21 vjeç, i ngjashëm me Mountjoy-in, burgun më të madh për të rritur në vend. Organizatat e të drejtave të njeriut që përfaqësojnë të drejtat e fëmijëve dhe të burgosurve, kishin kohë që kërkonin mbylljen e Shën Patrikut; edhe një raport i Komitetit të Hetimeve në Sistemin Penal (korrik 1985), i njohur si Raporti Whitaker, bënte thirrje për mbylljen e Institucionit të Shën Patrikut për shkak të kushteve fizike jo të përshtatshme të ndërtesës dhe një regjim burgimi të papërshtatshëm.

Megjithatë, kapaciteti në Shën Patrik është rritur me 47% gjatë pesë viteve të fundit, nga 163 deri në 239. Në prill të vitit 2002, Ministri i Drejtësisë deklaroi se po planifikohet hapja e një seksioni “të përkohshëm” për fëmijët e moshës 14 dhe 15 vjeç në Institucionin e Shën Patrikut. Ristrukturimi i propozuar i Shën Patrikut mundësohet vetëm nga legjislacioni i vitit 1908. Kjo nuk do të ishte e mundur nëse do të zbatohet Ligji për Fëmijët, i vitit 2001, sepse nuk ka asnjë klauzolë në këtë ligj për mbajtjen e fëmijëve nën 16 vjeç në një qendër burgimi [seksioni 150]. Megjithatë, shumë prej klauzolave të këtij ligji nuk kishin hyrë ende në fuqi. (në kohën kur trajtohej ky rast nga Gjykata e Strasburgut).

Në vitin 2002, të miturit e moshës 14 dhe 15 vjeç mbaheshin në shkolla riedukimi për fëmijë. Këto qendra drejtoheshin nga Departamenti i Arsimit dhe kishin një fokus të veçantë terapeutik dhe arsimor. Nga ana tjetër, Institucioni i Shën Patrikut drejtohet nga Shërbimi irlandez i Burgjeve dhe ka një regjim jo shumë ndryshe nga ai i një burgu për të rritur.

Pyetje dhe çështje për diskutim:

Pasi të njiheni me standardet ndërkombëtare ekzistuese që nxisin përdorimin e masave alternative të dënimit me burgim, ju lutem shpjegoni shkurtimisht:

- Qëllimin e masave alternative dhe përdorimin e tyre në fazat e ndryshme të administrimit të drejtësisë;
- Çfarë lloj masash alternative mund të jenë të dobishme brenda kontekstit të përgjegjësive tuaja profesionale;
- Njohja e pjesëmarrësve me mbrojtjen ligjore në lidhje me masat alternative;
- Pasojat e mospërputhjes me dispozitat e masave alternative.

1. Cilat alternativa të dënimit me burgim ekzistojnë në vendin tuaj (Shqipëri) dhe në lidhje me cilat vepra penale? A përputhen ato me kontekstin ndërkombëtar?
2. Si punonjës i shërbimit të provës, do ju duhet të këshilloni apo rekomandoni përdorimin e masave alternative. Në cilat situata mendoni se do ishte veçanërisht e dobishme rekomandimi i tyre?
3. A ka grupe të veçanta njerëzish që mund të përfitojnë më shumë se të tjerët nga zbatimi i masave alternative? Nëse po, identifikoni këto grupe dhe shpjegoni pse mund të përfitojnë më shumë nga masat alternative të dënimit me burgim, nga këndvështrimi i standardeve ndërkombëtare.
4. Çfarë mbrojtjesh ligjore ekzistojnë në vend në lidhje me përdorimin e masave alternative? Cilat janë sanksionet për shkeljen e kushteve që u bashkëngjiten masave alternative në vend? A përputhen me rregullat dhe standardet ndërkombëtare?

4. LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI SHËRBIMIN E PROVËS

Legjislacioni bazë mbi shërbimin e provës

4.1

Migena Leskoviku

Në teorinë dhe praktikën moderne penale dënimi penal ka disa karakteristika të tij në funksion të qëllimeve që synon të përmbushë. Së pari, çdo person që kryen një veprë penale do të ndëshkohet për kryerjen e saj, me një dënim që i korrespondon shkeljes së ligjit që ai ka bërë. Për disa prej tyre, burgimi është i pashmangshëm, për të garantuar kështu edhe mbrojtjen e shoqërisë dhe sigurinë publike. Dënimi penal synon të arrijë rehabilitimin e personit, autor i veprës penale si dhe ta parandalojë atë nga kryerja e veprave të mëtejshme kriminale, si edhe për personat e tjerë të lëkundshëm në shoqëri. Synimi i dënimit është parandalimi i veprimtarisë së rrezikshme të autorit, përmirësimi dhe edukimi i tij dhe, ndikimi pozitiv edukues tek personat e tjerë që mund të jenë kontigjentë për kryerjen e veprave penale në të ardhmen. Dëmi që i ka shkaktuar autori viktimës mund të “riparohet” dhe kështu krimi mund të reduktohet duke e kthyer sërish personin në komunitet por në këtë rast të rehabilituar.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ekziston një kapitull i veçantë me alternativa të cilat jepen ndaj personit autor të veprës penale, si pjesë e karakterit human të dënimit. Zakonisht këto alternativa të dënimit me burgim jepen kur nga gjykata vlerësohet se rrezikshmëria shoqërore e autorit dhe e veprës penale është e vogël, si edhe kur kjo gjykatë mendon se me zbatimin e masave të tilla i arrihet më së miri qëllimeve të dënimit. Alternativat e dënimit nuk janë lloje të veçanta dënimesh por janë një mënyrë e ekzekutimit të tyre. Në këtë rast gjykata e cakton më parë masën e dënimit ndaj autorit të veprës penale dhe në qoftë se shikon se plotësohen kushtet përkatëse, ajo vendos për zbatimin e një prej alternativave të dënimit.

Gjithashtu, për herë të parë u përcaktua me ligj krijimi i një institucioni të ri shtetëror të quajtur **shërbimi i provës**. Në nenin 31/7 të ligjit nr.10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’” përcaktohet edhe funksioni i shërbimit të provës si një organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë i cili i paraqet gjykatës dhe prokurorit informacione dhe raporte, ndihmon në ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim si dhe ndihmon të dënuarin të kapërcejë vështirësitë e ndryshme për riintegrimin social të tij. (më gjerësisht do të trajtohet më poshtë).

Që prej vitit 1995 kur hyri në fuqi, Kodi Penal ka ndryshuar vazhdimisht, por në ndryshimet e fundit të bëra me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, krahas dispozitave të tjera ndryshuan dhe u përmirësuan dispozitat që lidhen me Kreun VII të këtij kodi me titull “Alternativat e dënimit me burgim” si dhe në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Ndryshimet e reja ligjore japin më shumë hapësirë për zbatimin në praktikë të alternativave të dënimit me burgim. Duhet theksuar se këto alternativa të dënimit aplikohen ndaj personit vetëm në rast se gjykata e ka dhënë më parë dënimin për të, i cili duhet patjetër të jetë me burgim deri në një masë të caktuar.

1. Në ndryshimet e fundit që iu bënë Kodit Penal u fut një alternativë e re e quajtur “**Gjysmëliria**” (neni 58) e cila zëvendësoi alternativën e mëparshme “*Copëzimi i dënimit me burgim*”. Kjo alternativë e dënimit aplikohet ndaj personit vetëm në rast se gjykata jep dënimin deri në një vit. Që të japë këtë alternativë, duhet që gjykata të konstatojë se i dënuari ka rrethana të rënda familjare, mjekësore, arsimore, profesionale apo shoqërore.

Rrethanat e rënda familjare mund të ekzistojnë kur personi p.sh., ka pasur një fatkeqësi familjare dhe kur ai nuk ka asnjë lloj ndihme tjetër në familje përveç vetes së tij. Ai mund të ketë rrethana të rënda shëndetësore kur me raport mjekësor vërtetohet se vuan nga një sëmundje e rëndë. Në qoftë se me vuajtjen e dënimit në burg personi do të humbiste edhe aftësitë profesionale atëherë gjykata mund të aplikojë ndaj tij gjysmëlirinë. Kur vuajtja e dënimit shkakton reagime nga shoqëria ose personi mund të humbasë reputacionin që ka, atëherë këto rrethana mund t’i konsiderojmë si shoqërore.

Në çdo rast gjykata mund të aplikojë këtë alternativë kur ekzistojnë kushtet e sipërpërmendura, si edhe kur ajo është e bindur se qëllimi i dënimit mund të arrihet nëpërmjet aplikimit të kësaj alternative. Personi i dënuar që vuan dënimin në gjysmëliri është i detyruar të kthehet në burg pasi ka kryer detyrimet jashtë burgut brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata. Ajo që nuk përcakton kjo dispozitë e re është afati maksimal brenda të cilit duhet të ekzekutohet alternativa.

Ndryshe nga neni i mëparshëm i cili parashikonte shprehimisht që ekzekutimi i copëzimit të dënimit nuk duhet të kalonte tre vjet, pavarësisht se personi vuan dy ose tre ditë në javë burgim.

Kodi Penal parashikon edhe mundësinë e revokimit të alternativës në rastin kur personi që ka përfituar nga gjysmëliria nuk zbaton detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës. Në një rast të tillë personi do ta vuajë pjesën e mbetur të dënimit në burg.

Në bazë të ndryshimeve të bëra, neni 29 i ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” parashikon se pas marrjes së vendimit, gjykata ia dërgon atë prokurorit për ekzekutim. Mbi bazën e urdhërimeve të gjykatë, administrata e burgjeve dhe shërbimi i provës në bashkëpunim duhet të përcaktojë institucionin konkret të vuajtjes së dënimit për të dënuarin, në bazë të vendit ku ai duhet të përmbushë detyrimet e tij. Shërbimi i provës është i detyruar të përcaktojë një program ditor që duhet të realizohet nga personi i dënuar gjatë kohës që ai do të jetë jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit.

2. Një alternativë tjetër e re është ajo me titull “Qëndrimi në shtëpi”, parashikuar nga neni 63/a i Kodit Penal. Në këtë rast, kjo alternativë favorizon kategori të caktuara personash si: gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë nën moshën 10 vjeç që jetojnë me të, persona në kushte të rënda shëndetësore që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor jashtë burgut; personat mbi 60 vjeç që janë të paaftë nga ana shëndetësore; të rinj nën moshën 21 vjeç me nevoja të dokumentuara shëndetësore studimore, të punës apo përgjegjësive familjare. Edhe në këtë rast, kjo alternativë mund të jepet nëse gjykata vendos që personi të dënohet me burgim deri në dy vjet. Në rastin e qëndrimit në shtëpi, personi i dënuar duhet të mos largohet prej saj, me përjashtim të rasteve kur gjykata e autorizon të largohet për aq kohë sa i duhet për të plotësuar nevojat e tyre themelore të jetesës apo për t’u angazhuar në aktivitete pune. Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të kryejë shërbimi i provës.

Kur nuk ekzistojnë më kushtet për të cilat është dhënë kjo alternativë ose nëse personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendi i banimit apo shkel detyrimet e caktuara në vendim, atëherë gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe personi duhet të vuajë pjesën tjetër të dënimit në burg.

Në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi ashtu si edhe në rastin e gjysëm lirisë, vendimi i gjykatës i kalon prokurorit të ngarkuar me mbikqyrje në ekzekutim dhe nëse i dënuari ndodhet në burg, atëherë ai ia dërgon vendimin drejtorisë së burgut. Mbikqyrja e të dënuarit gjatë kohës së qëndrimit në shtëpi, bëhet nga shërbimi i provës në bashkëpunim me policinë e rendit të vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar, autoritetet vendore, shërbimet sociale. Për përmbushjen sa më të mirë të nevojave ditore të të dënuarit, shërbimi i provës siguron informacionin dhe ndihmën e nevojshme për të dënuarin nga institucionet mjekësore, të asistencës sociale dhe OJF-të.

Shërbimi i provës duhet të luajë një rol aktiv për zbatimin e kësaj alternative, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ndryshimin e kushteve në të cilat ndodhet personi apo kur ai nuk mund t'i plotësojë më detyrimet e vendosura. Në këtë rast, shërbimi i provës duhet të njoftojë menjëherë prokurorin për këto ndryshime. Pas verifikimit të fakteve dhe rrethanave/kushteve, shërbimi i provës informon prokurorin dhe kur e gjen me vend, i propozon atij ndryshimet e kushteve të vendosura për të dënuarin.

3. Përveç sa më sipër, gjykata mund të vendosë të pezullojë ekzekutimin e dënimit të dhënë për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi deri në dy vjet burgim, dhe ta vërë të dënuarin në provë. Në këtë rast të parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal kemi të bëjmë me *“Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë”* për një kohë të caktuar nga gjykata në vendimin e saj me kushtin që personi të mos kryejë një vepër tjetër penale gjatë afatit të pezullimit të tij. Edhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit nuk është një lloj i veçantë dënimi por është një alternativë e dënimit me burgim. Vuajtja efektive e dënimit nuk është në çdo rast e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të tij, dhe pikërisht mbi këtë parim mbështetet edhe kjo alternativë dënimi. Deri më sot kjo ka qenë alternativa më e përhapur dhe e zbatuar nga gjykatat shqiptare në praktikë.

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit jepet nga gjykata kur ajo e çmon se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të autorit është e tillë sa ndaj tij nuk është e nevojshme aplikimi i dënimit me burgim. Pra, për aplikimin e pezullimit të dënimit duhet parë në rradhë të parë rrezikshmëria shoqërore e autorit të veprës si dhe e veprës konkrete që ai kryen. Sa më pak të paraqesin rrezikshmëri shoqërore vepra dhe autori, aq më e prirur do të jetë gjykata në aplikimin e kësaj alternative. Në qoftë se vepra nuk do të jetë me rrezikshmëri shoqërore dhe autori të ketë mbajtur një qëndrim korrekt dhe pendues si para edhe pas kryerjes së veprës, si dhe gjykata të ketë arritur në përfundimin se me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit do t'i arrihet më së miri qëllimit të dënimit, atëherë mund të aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit ka të bëjë me një dënim në vetvete dhe duhet të synojë të arrijë ato qëllime që ka dënimi.

Kushtet që merr parasysh gjykata për këtë alternativë janë: rrezikshmëria e pakët e personit, mosha, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat e tij veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale. Në aplikimin e pezullimit të dënimit duhet të merren parasysh rrethanat lehtësuese të kryerjes së veprës penale, p.sh., rrethanat e kryerjes së krimit, qëndrimin e të dënuarit pas kryerjes së veprës, pendimin që tregon personi, vetitë e tij personale, tronditja psikike, etj.

Në çdo rast për t'u vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duhet që personi të jetë dënuar deri në 2 vjet burgim. I dënuari i vënë në provë duhet që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Afati gjatë të cilit gjykata

mund ta vërë në provë personin varion nga tetëmbëdhjetë muaj deri në pesë vjet. Me ndryshimet e bëra u parashikua si kusht që i dënuari të mos kryejë veprë tjetër penale. Më parë dispozita parashikonte që gjatë afatit të provës personi nuk duhet të kryente një veprë tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë.

Rast studimor

E.S., është mashkull i moshës 29 vjeç. Ai akuzohet për veprën penale të ‘Vjedhjes’, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Pas një aksidenti me motor, ai porositi në një dyqan pjesët e reja. Në momentin që njoftohet për ardhjen e këtyre pjesëve, ai hyn në dyqan dhe duke përfutur nga momenti ka marrë me shpejtësi pjesët dhe është larguar me vrap pa iu përgjigjur thirrjeve të shitësit për të ndaluar. Pasi është arrestuar nga policia, këta të fundit kanë sekuestruar pjesët e vjedhura prej tij dhe i pandehuri më vonë ka paguar detyrimin prej 400 eurosh për këto pjesë motori. I pandehuri e pranoi plotësisht akuzën dhe fajësinë, si dhe tregoi pendim të thellë për veprën e kryer prej tij. Në llojin dhe masën e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë e vogël shoqërore të E.S.-së, shkallën e fajit, pranimin e akuzës dhe të fajësisë nga i pandehuri, kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, si dhe rrethanat lehtësuese të parashikuara nga neni 48/ç dhe d i Kodit Penal.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e pakët të të pandehurit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, gjykata çmon se kërkesa për të aplikuar nenin 59 të Kodit Penal në dënimin e të pandehurit E.S. është e drejtë dhe e bazuar në ligj, pasi plotësohen kriteret e këtij neni. Kështu, gjykata deklaron fajtor të pandehurin për kryerjen e veprës penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe e dënon atë në bazë të këtij neni me 4 (katër) muaj burgim.

Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi për një kohë prove prej 18 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe E.S. të mos kryejë veprë tjetër penale kaq të rëndë apo më të rëndë.

Prokurori ka të drejtë të kërkojë revokimin e vendimit të pezullimit kur konstaton veprime që vijnë në kundërshtim me vendimin, ose i dënuari nuk përmbush kërkesat e vëna në vendim (neni 30 i ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”).

Çfarë detyrimesh duhet të përmbushë i dënuari gjatë kohës së provës?

Neni 60 i Kodit Penal, i ndryshuar:

“Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë”.

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

- 1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional;*
- 2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.*
- 3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar;*
- 4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara;*
- 5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari;*
- 6. Të mos frekuentojë vende të caktuara;*
- 7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike;*
- 8. Të qëndrojnë në banesën e tij në orare të caktuara;*
- 9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale;*
- 10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë;*
- 11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.*
- 12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.*

Gjykata ka të drejtë që gjatë kohës së provës të vendosë detyrime ndaj të dënuarit të vënë në provë. Kur përcakton këto detyrime, gjykata duhet të mbajë parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen e tij mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato familjare, të arsimimit apo punës, motivet që e kanë shtyrë personin për të kryer veprën penale, qëndrimin e tij pas kryerjes së saj, si dhe rrethanat të tjera të cilat mund të influencojnë vendosjen e detyrimeve dhe mbikqyrjen e tyre.

Nga vetë karakteri i detyrimeve që gjykata mund të marrë ndaj personit gjatë kohës së provës si, *ushtrimi i një veprimtarie profesionale ose arsimmii, të paguajë detyrimet që ka ndaj familjes si dhe ndaj personave që i ka shkaktuar dëm, ndalimi i vajtjes në vende të caktuara apo i shoqërimit me persona të caktuar, ndalimi për të drejtuar automjete apo për të mbajtur armë, mos shoqërimi me persona të caktuar, etj.*, tregojnë se me aplikimin e këtyre masave personit i jepet mundësia e riintegritit dhe e riaftësimit si dhe mundësia për t’u përfshirë edhe njëherë në shoqëri dhe për të ndikuar pozitivisht në mbarëvajtjen e saj.

Kur gjykata vendos ta verë të dënuarin në provë, ajo ia dërgon vendimin prokurorit dhe institucionit të vuajtjes së dënimit. I dënuari i vënë në provë duhet të raportojë periodikisht tek shërbimi i provës, dhe ky i fundit duhet të informojë në mënyrë periodike autoritetet lokale të policisë së shtetit.

Ndërsa e drejta e gjykatës për të vendosur detyrime ndaj personit të vënë në provë që parashikohet nga neni 61 i Kodit Penal si: *mbajtja e kontakteve me shërbimin e provës, të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendit të punës dhe banimit apo për udhëtime të vazhdueshme brenda vendit, si dhe të informojë vazhdimisht shërbimin e provës për punësimin e tij*, bëhet që i dënuari të jetë gjithnjë nën mbikqyrje, duke siguruar që vendimi i gjykatës të mund të ekzekutohet.

Në marrjen e masave ndaj të dënuarit të vënë në provë, neni 60 nuk vë ndonjë kufizim, pra gjykata mund të marrë një ose disa të tilla, në varësi të personalitetit të të dënuarit, moshës së tij, profesionit, gjendjes familjare, ekonomike të tij, veprës që ai ka kryer etj., të cilat personi i vënë në provë është i detyruar që t'i zbatojë. Këto detyrime që vendos gjykata kanë karakter edukues dhe parandalues, psh., në qoftë se personi ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, atëherë gjykata e ndalon të drejtojë automjete. Kur ai në kryerjen e veprës është shoqëruar me persona të caktuar atëherë gjykata e ndalon që të shoqërohet me ta, etj. Kur personi nuk u është përgjigjur detyrimeve familjare atëherë gjykata e detyron që të paguajë detyrimin për ushqim, etj.

Në cilat raste gjykata mund të vendosë revokimin e alternativës?

Në rast se personi ndaj të cilit janë aplikuar kushtet/detyrimet dhe, pa shkaqe të arsyeshme nuk i plotëson ato, atëhere shërbimi i provës informon menjëherë prokurorin. Në këtë rast, gjykata mund të vendosë të ndryshojë detyrimet e vendosura, të shtojë detyrime të tjera apo t'i zëvendësojë ato me një sanksion tjetër, ose të revokojë vendimin e pezullimit me vënie në provë dhe ta kthejë të dënuarin në burg për të vuajtur pjesën tjetër të dënimit, siç parashikohet shprehimisht në nenin 62 të Kodit Penal. Në qoftë se në moszbatimin e kushteve/detyrimeve nga personi kanë ndikuar shkaqe të arsyeshme, si: sëmundje, fatkeqësi familjare etj., atëherë gjykata do t'i marrë parasysh dhe në këtë rast nuk do të vendosë revokimin e vendimit të pezullimit.

Nëse i dënuari gjatë kohës së provës kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet e vendosura, mund të zëvendësojë dënimin e dhënë me një tjetër, apo mund të revokojë tërësisht ose pjesërisht vendimin e pezullimit.

Gjithashtu, për shkelje të vogla dhe kur kushtet/detyrimet janë shkelur për herë të parë, prokurori ka të drejtë të japë një paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen e të dënuarit.

Pra, siç shihet, mosplotësimi i kushteve apo detyrimeve të vendosura nga gjykata nuk çon *a priori* në revokimin e vendimit të alternativës së dhënë, duke i dhënë kështu mundësi gjykatës të vlerësojë situatën në të cilën është ndodhur i dënuari, rrethanat që e kanë shtyrë të mos i përmbushë detyrimet/kushtet e vëna si dhe shkallën e shkeljes së bërë. Kjo vlerësohet nga gjykata mbi bazën e informacionit që harton shërbimi i provës për këtë qëllim.

4. Një nga alternativat që ka pasur ndryshime të rëndësishme është ajo e parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal. Gjykata gjithashtu mund të vendosë edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim, kur ka caktuar një dënim deri në një vit burgim por në një rast të tillë ajo mund të vendosë zëvendësimin e këtij dënimi me një *punë në interes publik*. Puna në interes publik kryhet me pëlqimin e të dënuarit, i cili kryen një numër të caktuar orësh punë të papaguar në interes të komunitetit. Puna në interes publik është ajo që për nga karakteri dhe përmbajtja është në interes publik, si p.sh., në mirëmbajtje, gjelbërim, shërbim komunal, në ndërtim etj. Puna në interes publik nuk jepet në qoftë se personi nuk do që ta kryejë atë. Pra, gjykata nuk mund të vendosë asnjëherë kundër dëshirës së personit të dënuar. Kjo punë në interes publik jepet kur rrezikshmëria e personit dhe e veprës është e pakët, dhe kur nga rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale, gjykata çmon se ajo do t'ia arrijë qëllimit të dënimit. Kjo punë në interes publik jepet për një kohë nga 40 deri në 240 orë dhe duhet të kryhet brenda një afati prej 6 muajsh.

Është gjykata që vendos në vendimin e saj numrin e orëve të punës dhe detyrimin e të dënuarit për të mbajtur kontaktet me shërbimin e provës. Ndërsa shërbimi i provës përcakton llojin e punës që do të kryhet, vendin ku do të kryhet kjo punë, si dhe ditët kur do të kryhet puna në interes publik, duke marrë në konsideratë punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Nuk mund t'i nënshtrohen punës në interes publik ata persona që sipas Kodit të Punës nuk lejohet që të punojnë, pra, meshkujve që kanë mbushur moshën 65 vjeç, grave 60 vjeç dhe të miturve nën 16 vjeç. Gjithashtu nuk mund të zbatohet ndaj invalidëve të grupit të parë dhe të dytë.

Kur gjykata vendos të japë këtë alternativë, ia dërgon menjëherë vendimin përkatës shërbimit të provës për ekzekutimin e tij. Shërbimi i provës duke mbajtur parasysh aftësitë dhe formimin profesional të personit të dënuar harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës në interes publik.

Para fillimit të kryerjes së punës në interes publik, shërbimi i provës, në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit do të kryhet puna, u bëjnë të ditur personit të dënuar rregullat e sigurimit teknik në punë. Shërbimi i provës përcakton listën e institucioneve/shoqërive publike apo private në të cilat mund të kryhet puna në interes publik.

I dënuari është i detyruar që të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Kur personi i dënuar nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimin e vendosur, shërbimi i provës informon menjëherë gjykatën

Kur i dënuari nuk kryen punën në mënyrë të rregullt, subjekti pranë të cilit kryhet puna në interes publik njofton menjëherë shërbimin e provës. Moskryerja e punës në mënyrë të rregullt është p.sh., paraqitja me vonesë në punë, mungesa pa arsye në punë apo mosrespektimi i rregullave për kryerjen dhe rendimentin në punë.

Për arsye shëndetësore, familjare apo rrethana të tjera të jashtëzakonshme, personi i dënuar paraqet te shërbimi i provës kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në interes publik. Shërbimi i provës verifikon ndryshimin e situatës dhe e raporton atë në gjykatë. Gjykata brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës jep vendimin për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë në interes publik dhe ia dërgon menjëherë atë shërbimit të provës. Deri sa gjykata të japë vendimin mbi kërkesën, detyrimi për të kryer punë në interes publik pezullohet. Gjykata në vendimin e saj përcakton periudhën kohore të pezullimit.

Pezullimi i vendimit për punë në interes publik

Ekzekutimi i vendimit me punë në interes publik mund të pezullohet për shkak të:

- a) sëmundjes së papritur të personit të dënuar, që kërkon trajtim mjekësor dhe e pengon atë të kryejë aktivitetin e punës;*
- b) vdekjes së një anëtarit të familjes, e cila kërkon që personi i dënuar të veprojë si kujdestar për anëtarët e tjerë të familjes dhe e pengon atë për kryerjen e punës;*
- c) Rrethanave të tjera të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë prezencën e vazhdueshme të të dënuarit dhe e pengojnë atë të kryejë punën.*

5. Neni 64 i Kodit Penal parashikon se personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë lirimin me kusht, nëse plotëson disa kriterë. Lirimi me kusht do të bëhet vetëm për arsye të veçanta nëse i dënuari me sjelljen dhe punën e tij tregon se është arritur qëllimi i dënimit. Dhënia e lirimit me kusht varet nga fakti nëse vepra e kryer është krim apo kundërvajtje penale si dhe nga masa e dënimit të dhënë nga gjykata. Për kundravajtjet penale i dënuari duhet të ketë vuajtur të paktën gjysmën e dënimit, për krimet që dënohen deri në 5 vjet burgim. Për krimet që dënohen nga 5 deri në 25 vjet burgim i dënuari duhet të ketë vuajtur jo më pak se $\frac{3}{4}$ e dënimit. Dy të tretat e dënimit duhet të jetë vuajtur për krime deri në 5 vjet burgim. Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarit përsëritës në krime të kryera me dashje. Pra, për personat që janë përsëritës mund të lejohet lirimi para kohe me kusht në qoftë se krimi është kryer nga pakujdesia. Në qoftë se personi gjatë kohës së kushtit kryen një veper tjetër me dashje, vetëm në këtë rast mund t'i revokohet lirimi para kohe me kusht.

Të dhënat mbi sjelljen dhe punën e të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit, duhet të merren nga administrata e burgut ku personi ka vuajtur dënimin, si dhe

gjykata duhet të bindet plotësisht për vërtetësinë e këtyre vlerësimeve. Për të dënuarit përsëritës nuk lejohet zbatimi i neni për lirimin para kohe me kusht, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore që ata paraqesin.

Në qoftë se personi gjatë vuajtjes së dënimit të tij ka përfituar nga amnistia apo falja atëherë kjo kohë nuk do të llogaritet në gjysmën e dënimit të vuajtur. Kjo bëhet për të eliminuar mundësinë që personi të vuajë fare pak nga koha e tij e dënimit dhe të ketë të drejtë të përfitojë nga lirimi para kohe me kusht. Vuajtja e dënimit me burgim pra, duhet të jetë një kohë faktike që llogaritet nga dita e marrjes së vendimit. Në qoftë se personi gjatë kohës së kushtit kryen një vepër penale tjetër atëherë gjykata e revokon vendimin për librim para kohe me kusht dhe zbaton dispozitat për bashkimin e dënimeve. Pra, pjesa e mbetur pa u vuajtur nga vepra e parë do t'i bashkohet dënimit që do të jepet për veprën e dytë duke u aplikuar sistemi i dënimit më të rëndë të shtuar apo sistemi i përthithjes.

Kërkesa për librim para kohe me kusht mund të paraqitet nga personi i dënuar, por gjithmonë gjykata do të vendosë duke vlerësuar rrezikshmërinë e veprës dhe të personit, personalitetin e tij, shkallën e pendesës, sjelljen e tij gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, qëndrimin që ka mbajtur, etj. Nga kjo nuk përjashtohen edhe të dënuarit me burgim të përjetshëm, ndonëse për këtë kategori librimi me kusht është përjashtimor dhe aplikohet në raste të veçanta. Por ndaj tyre mund të aplikohet librimi para kohe me kusht vetëm në qoftë se kanë vuajtur të paktën 25 vjet burgim dhe gjatë kohës së vuajtjes kanë mbajtur një qëndrim shembullor dhe gjykata çmon se i është arritur qëllimit të dënimit për riedukimin e këtij personi. Pra, ai tashmë është gati për t'u rikthyer në shoqëri dhe për të bërë pjesë në të si njeri normal.(neni 65 i Kodit Penal).

I dënuari me burgim, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për librim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim. Me paraqitjen e kërkesës për librimin me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për personin e dënuar. Raporti përmban natyrën e veprës penale të kryer nga personi i dënuar, qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër të mëparshme penale të kryer prej tij, gjendjen fizike dhe psikologjike të personit të dënuar si dhe dinamikën e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Rast studimor

D.G. 50 vjeç, e dënuar për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 të Kodit Penal, me 2 (dy) vjet burgim në vitin 2005 i është drejtuar gjykatës me kërkesën për lirimin para kohe me kusht për pjesën tjetër të mbetur të pa vuajtur nga dënimi i mësipërm. Ajo vuan dënimin në I.E.D.P. “Ali Demi”, Tiranë dhe deri ditën e shqyrtimit të kërkesës së saj rezulton se ka vuajtur 1 vit, 7 muaj e 23 ditë burgim duke i mbetur ende për të vuajtur edhe 4 muaj e 7 ditë burgim. Pra, e dënuara ka vuajtur mbi $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë nga gjykata, duke përmbushur kështu një nga kërkesat e parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Gjithashtu, sipas vlerësimit të sjelljes e qëndrimit të të dënuarës në burg, të paraqitur nga përfaqësuesi i këtij institucioni, por dhe nga shpjegimet e tij të fundit në seancë gjyqësore, rezultoi se kërkuesja ka demonstruar një sjellje shumë të mirë dhe zbaton me përpikëri rregulloren, duke mos marrë asnjë masë disiplinore, dhe ndonëse nuk është e punësuar, merret me punime artizanale, për të reduktuar stresin e akumuluar nga qëndrimi në burg. Po ashtu sipas vlerësimit të mësipërm të përfaqësuesit të I.E.D.P. “A.Demi”, Tiranë, në seancë gjyqësore rezultoi se vuajtja e deritanishme e dënimit ia ka arritur qëllimit për integrimin dhe risocializimin e saj në shoqëri, duke plotësuar kërkesën e dytë të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal.

Nga dëshmia e gjendjes gjyqësore, e dënuara rezulton të mos ketë qenë më parë e dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Po ashtu, e dënuara D.G., për të përfutur nga neni 64 i KP ka dhe disa arsye të veçanta familjare, pasi rezulton se bashkëshorti i saj vuan nga hipertensioni dhe nuk ka njeri tjetër që mund të kujdeset për të; po ashtu dhe e dënuara vetë ka probleme shëndetësore me veshkat.

Përfundimisht, përsa më sipër Gjykata e gjen të bazuar në ligj e prova kërkesën e të dënuarës, e si të tillë e pranon duke e liruar atë. Përsa i përket periudhës së kushtit gjykata çmon se ajo duhet të jetë 3 (tre) vjet dhe detyrohet të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale po aq të rende apo më të rëndë.

Gjykata mund të kërkojë edhe raport nga shërbimi i provës për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të dënuarit, si dhe metodat e mbikëqyrjes së sjelljes së tij pas lirimit. Kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit të dënuar, vendimin ia dërgon institucionit të ekzekutimit të vendimit penal dhe shërbimit të provës ku do të jetojë i dënuari pas lirimit. Personi i liruar me kusht duhet të raportojë rregullisht te shërbimi i provës gjatë kohës së kushtit dhe shërbimi i provës duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit.

Kur personi i liruar me kusht ndryshon vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht në mënyrë të motivuar shërbimin e provës dhe organet vendore të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i provës në bashkëpunim me organet vendore të Policisë së Shtetit ndjek ekzekutimin e lirimit me kusht. Kur shqyrtohet revokimi i lirimit me kusht, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi i provës një raport për të gjithë periudhën kohore të sjelljes së personit të dënuar gjatë periudhës së kushtit.

Shërbimi i provës

Në ndryshimet në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, siç e përmendëm, krijohet për herë të parë shërbimi i provës (Kreu II/1 i ligjit), i cili do të merret me ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim të parashikuara nga Kodi Penal.

Shërbimi i provës është organi shtetëror që paraqet informacion para autoriteteve gjyqësore, mbikëqyr ekzekutimin e dënimit alternativ dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Shërbimi i provës është strukturë e Ministrisë së Drejtësisë dhe drejtohet nga Drejtori i shërbimit të provës. Shërbimi i provës organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e shërbimit të provës në Ministrinë e Drejtësisë përbën nivelin qendror ndërsa zyrat vendore të shërbimit të provës veprojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i Drejtorit të Shërbimit të Provës dhe drejtuesve të zyrave vendore bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Struktura dhe organika e shërbimit të provës përcaktohen me urdhër të Kryeministrit me propozim të Ministrit të Drejtësisë.

Rregullat e hollësishme të organizimit, të drejtave, detyrimeve, rekrutimit dhe masave disiplinore, trajnimeve, vlerësimit të punës, dhe kodit etik në shërbimin e provës, përcaktohen në rregulloren e brendshme që do të miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

Është e rëndësishme që me daljen e ligjit të hartohen aktet nënligjore më emergjente për funksionimin praktik të këtij shërbimi në shkallë vendi. Gjithashtu, këto ndryshime duhet të pasohen edhe nga ndryshime në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë - *ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë.”*

Shërbimi i provës i paraqet raport prokurorit (me kërkesë të tij) gjatë fazës së hetimeve paraprake apo gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, para dhënies së vendimit apo para se të vendosë për dhënien, ndryshimin apo mbarimin e tij. Në çdo rast ky raport kërkohet për vlerësimin e rrethanave shoqërore.

Raporti duhet të përmbajë informacion dhe të dhëna lidhur me personalitetin e shkelësit të ligjit, sjelljen dhe nivelin arsimor dhe faktorët që influencojnë apo mund të influencojnë në sjelljen e tij, me qëllim që të ndihmojë në vlerësimin e duhur të rrezikshmërisë shoqërore dhe mundësisë së kryerjes së një veprë tjetër penale. Raporti paraqitet me shkrim dhe mbështet në fakte, duhet të jetë i panashëm dhe objektiv, si dhe dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata. Raporti duhet të identifikojë dënimin e duhur alternativ si sugjerim/rekomandim për gjykatën, me qëllim riintegrimin në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë vendimin shërbimit përgjegjës të provës për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata dërgon një kopje të vendimit në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve penale ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij.

Revokimi i dënimit alternativ

Kur gjykata shqyrton raportin nga shërbimi i provës për shkeljen e kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimit të dhënë, mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e pjesshëm apo të plotë të dënimit alternativ. Gjatë periudhës që shqyrton masën e revokimit të dënimit alternativ, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e tij dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Kur gjykata vendos ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, dënimi me burgim jepet në mungesë të dënimeve të tjera alternative të përshtatshme. Në çdo rast gjykata merr në konsideratë mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari. Gjkata pasi dëgjon kërkuesin, mbrojtësin, prokurorin dhe provat e kërkua prej tyre, merr vendim brenda 7 ditëve nga marrja e raportit të shërbimit të provës. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit të provës dhe prokurorit. Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Përfundimi i periudhës së provës

Kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, shërbimi i provës paraqet përpara gjykatës raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Gjkata shpall me vendim kryerjen e dënimit alternativ. Gjkata mund të vendosë përfundimin e shpejtë të kryerjes së dënimit alternativ, me propozimin e shërbimit të provës, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe

vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Raporti i shërbimit të provës për përfundimin e shpejtë përmban të dhëna për precedentët penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit dhe progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës. Raporti për përfundimin e shpejtë të kryerjes së dënimit alternativ paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta.

Kodi i Procedurës Penale parashikon një kre të veçantë mbi vënien në ekzekutim të vendimeve penale, duke përcaktuar se mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë. Konkretisht, ekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë bëhet duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

Me **ekzekutim të vendimit penal** kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që, sipas Kodit të Procedurës Penale, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cënuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre.

Kjo vlen edhe kur gjykata jep një alternativë të dënimit me burgim sipas përcaktimeve që bën Kodi Penal. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve paraprake që kryen, prokurori nxjerr **urdhrin e ekzekutimit**. Urdhri i ekzekutimit është akti procedural mbi bazën e të cilit prokurori nis procedurën e ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë.

Urdhri i ekzekutimit përmban:

- ◆ Vendimin penal që vihet në ekzekutim,
- ◆ Identitetin e të dënuarit,
- ◆ Vendndodhjen e tij,
- ◆ Llojin dhe masën e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht,
- ◆ Dënimin plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij,
- ◆ Detyrimin civil në procesin penal,
- ◆ Organet që do të ekzekutojnë ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit.

Në çdo rast, vendimet e prokurorit i njoftohen brenda 30 ditëve, mbrojtësit të personit. Për të dënuarit e mitur organet e ekzekutimit njoftojnë paraprakisht edhe prindin ose kujdestarin. Ndërsa për të dënuarit me fëmijë të mitur, bashkëshortin dhe, kur nuk ka ose nuk dihet ku ndodhet, këshillin e kujdestarisë së vendbanimit të të dënuarit.

Veprimet paraprake dhe lëshimi i urdhërit të ekzekutimit duhet të bëhen brenda këtyre afateve:

1. Menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga ardhja e vendimit penal, për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, kur personi është i paraburgosur;
2. Për dënimet me burgim për të gjykuarit në gjendje të lirë, jo më vonë se 72 orë nga ardhja e vendimit;

Urdhri i ekzekutimit për vendimin penal me burgim për personat e paraburgosur ekzekutohet brenda 48 oreve nga marrja e tij. Për urdhrat e ekzekutimit me dënime ose urdhërime të tjera ekzekutimi duhet të fillojë menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij. Kur pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit gjykata vendos pezullimin ose shtyrjen e ekzekutimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data e anulimit të pezullimit, plotësimit të periudhës së shtyrjes ose ndërprerjes së tyre me vendim të gjykatës.

Me fillimin e ekzekutimit të vendimit, prokurori duhet të njoftojë me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin. Po ashtu edhe kur përfundon ekzekutimi. Urdhëri i ekzekutimit i dërgohet organeve përkatëse që do të merren me ekzekutimin e tij në praktikë. Prokurori ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit të vendimit.

Pyetje dhe çështje për diskutim

1. Në bazë të rasteve të mësipërme studimore, a mendoni se ka qënë i drejtë vendimi i gjykatës për aplikimin e alternativave që përmban Kodi Penal? Diskutoni.
2. Sa mendoni se ndryshimet e fundit në legjislacionin penal do të ndihmojnë në një zbatim më të gjerë të alternativave, për të synuar shmangien e efekteve të panevojshme të burgimit dhe rehabilitimin e personave të dënuar?
3. Si e shihni krijimin e shërbimit të provës dhe sa efektiv mendoni se do të jetë roli i rij në zbatimin praktik të alternativave të dënimit me burgim?
4. Ç'mendoni për shërbimin komunitar (kryerja e një pune në interes publik) dhe si do ta vlerësonit punën e shërbimit të provës në këtë drejtim?
5. A mendoni se mund të jepen edhe masa apo sanksione të tjera komunitare përveç sa më sipër? A duhen konceptuar ato thjesht si alternativa të dënimit me burgim? Diskutoni.

4. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR SHËRBIMIN E PROVËS

Aktet nënligjore për shërbimin e provës në Shqipëri

4.2

Ioana van Nieuwkerk

Me VKM nr. 302, datë 25 mars 2009, për të mundësuar zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me ekzekutimin e dënimeve alternative dhe me shërbimin e provës, Këshilli i Ministrave aprovoi Rregulloren “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës” dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” (referuar ne vazhdim si “Rregullorja”).

Rregullorja përmban 61 nene që ndahen në tre tituj/pjesë si dhe 13 krerë. Titulli i parë përcakton Dispozitat e Përgjithshme si dhe rolin e Shërbimit të Provës, titulli i dytë lidhet me organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës si dhe me statusin e punonjësve të shërbimit të provës, dhe titulli i fundit u kushtohet standarteve të mbikqyrjes së të dënuarve në komunitet.

Teksti i plotë i Rregullores, gjendet në Shtojcën 1 të këtij manuali. Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të përmbajtjes së Rregullores, e fokusuar në shpjegimet e krerëve më të rëndësishëm për qëllimet e këtij manuali.

TITULLI I

1. Kreu I - Dispozitat e Përgjithshme, në mënyrë të përmblodhur prezantojnë përmbajtjen e kësaj Rregulloreje, si dhe shpjegohen disa terma të përdorur në tekstin e kësaj rregulloreje. Rregullorja na njeh me rolin e shërbimit të provës në të gjitha fazat e procedimit penal, me organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimit; statusin e punonjësve të shërbimit të provës, standardet e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve.

Parimet që udhëheqin aktivitetin e shërbimit të provës dhe qëllimet e tij jepen edhe në Dispozitat e Përgjithshme të Rregullores:

1. Parimi i ligjshmërisë
2. Parimi i objektivitetit
3. Parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore
4. Parimi i mosdiskriminimit
5. Qëllimi i zhvillimit të ndjenjës së përgjegjshmërisë së personit të dënuar ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe për të mbështetur dhe inkurajuar riintegrimin social të të dënuarit.

Kreu i Dispozitave të Përgjithshme mbyllet me një nen që u njeh të dënuarit të drejtën e ankimit administrativ kundër veprimeve të punonjësit të shërbimit të provës të caktuar me mbikëqyrjen e tij, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e masave dhe sanksioneve komunitare

2. Kreu II – Roli i shërbimit të provës, i referohet administrimit të shërbimit të provës dhe vendit të tij në sistemin e drejtësisë, përcakton kompetencën territoriale të zyrave lokale të shërbimit të provës, si dhe jep misionin e shërbimit të provës në mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative.

2.1. Kompetenca territoriale (*rationae loci*)

Me kompetencë territoriale të shërbimit të provës kuptojmë zonën (territori i posaçëm gjeografik) në të cilin ky shërbim ka pushtetin për të ushtruar juridiksionin e tij apo aktivitetet e tij. Ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale” parashikon në nenin 31/12 se zyrat lokale të shërbimit të provës funksionojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. (21 gjykata të tilla funksionojnë aktualisht). Formulimi aktual në ligj mund të sugjerojë se kompetenca territoriale e shërbimit të provës përcaktohet në të, dhe për pasojë është identike me atë të gjykatës pranë të cilit është vendosur ky shërbim. Në realitet, kompetenca e tyre ndryshon për arsye që shpjegohen më poshtë.

Kompetenca territoriale e gjykatave penale përcaktohet nga neni 76 i Kodit të Procedurës Penale. Si rregull i përgjithshëm, në Shqipëri dhe në vende të tjera, **vendi**

ku është kryer vepra penale (apo ku është tentuar të kryhet ose vendi ku kanë ardhur pasojat e saj), përcakton juridiksionin territorial të gjykatave penale. Si përjashtim, vetëm në rast se vendi(et) i/e përmendur(a) më sipër nuk dihen, vendi i rezidencës së të dënuarit përcakton juridiksionin territorial. Në përcaktimin e “vendit ku është kryer krimi”, si rregull i përgjithshëm për juridiksionin e gjykatave penale, qëllimi i legjislatorit është të mundësojë procedimin dhe hetimin e një krimi në mënyrë të shpejtë dhe të duhur. Dhe kjo mund të arrihet më së miri në vendin ku është kryer krimi.

Kompetenca territoriale e shërbimit të provës përcaktohet nga Rregullorja me qëllim që të përcaktojë se cili shërbim prove ka juridiksion mbi një rast të caktuar. Detyrat kryesore të shërbimit të provës janë: të përgatisë raporte për gjyqtarët dhe prokurorët dhe të mbikqyrë të dënuarit në komunitet. Aktiviteti i tij fokusohet te të dënuarit dhe jo aq shumë mbi krimin(et) e kryera. Për pasojë, kompetenca territoriale nuk mund të identifikohet me atë të gjykatës pranë së cilës janë vendosur këto zyra të shërbimit të provës. Në nenin 5, Rregullorja parashikon kriteret që merren parasysh se cili shërbim prove ka juridiksion mbi një rast të caktuar. Si rregull i përgjithshëm, kur i dënuari nuk burgoset, **vendi i rezidencës/banimit të të dënuarit** (të vendosur nën mbikqyrje apo që është subjekt i një raporti vlerësimi) përcakton kompetencën territoriale të shërbimit të provës. Për të dënuarit që janë duke zbatuar një vendim gjykate dhe që janë subjekt i programeve rehabilituese, shërbimi i provës më i afërt me burgun, është ai që ka kompetencën në këtë rast.

Rast studimor

A.K. është 42 vjeç dhe jeton në Elbasan. Në datë 5 janar 2009 ai ka shkuar në Shkodër për të vizituar shokun e tij J.H. i cili jeton në këtë qytet. Në të njëjtën datë, vonë në mbrëmje, A.K. bashkë me shokun e tij J.H. kanë vjedhur një makinë të parkuar përballë Hotel Europës, që ndodhet në qendër të Shkodrës. Të dy autorët e kësaj vepre u arrestuan menjëherë nga policia lokale e Shkodrës, me akuzën e vjedhjes. Gjykata vendosi t'i mbajë ata në paraburgim gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit. Shërbimit të provës iu kërkua të hartonte raportet e vlerësimit (para dhënies së vendimit) për të dy personat, me qëllim që të asistonte gjykatën për të marrë vendimin më të përshtatshëm për secilin rast.

Pyetje:

- 1) Cila gjykatë ka juridiksionin për këtë çështje? Përse?
- 2) A është e njëjta gjykatë kompetente për të shqyrtuar këtë çështje për të dy autorët e vjedhjes? A mund të ndahet kjo çështje mbi bazë të asaj se dy të pandehurit kanë vendbanim të ndryshëm?
- 3) Cili shërbim prove është kompetent për të përgatitur raportet për gjykatën para dhënies së vendimit për të dy të pandehurit? Përse?

- 4) *A mundet i njëjti shërbim prove të jetë kompetent për të përgatitur raportet para dhënies së vendimit në rast se të dy të pandehurve do t'u privohet liria gjatë fazës së hetimit dhe gjykimin? Përse?*
- 5) *Çfarë ndodh nëse gjykata i bën kërkesë zyrës së shërbimit të provës që nuk është i autorizuar nga ligji për të përgatitur një raport para dhënies së vendimit për një apo të dy të pandehurit? Çfarë procedure duhet të ndiqet?*
- 6) *Në rast se gjykata vendos t'i dënojë të dy të pandehurit me një alternativë të dënimit me burgim, cili shërbim prove do të jetë kompetent për të mbikqyrur ekzekutimin e saj? Përse?*

2.2. Misioni i shërbimit të provës

Misioni i shërbimit të provës në Shqipëri përcaktohet në këtë Rregullore. Parandalimi i krimit, mbrojtja e publikut në tërësi dhe rehabilitimi i të dënuarve, janë qëllimet kryesore të shërbimit të provës në zbatimin e dënimeve alternative. Misioni dhe roli i shërbimit të provës jepet në nenin 6 të Rregullores.

TITULLI II- ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

3. Kreu i tretë – Organizimi i shërbimit të provës, parashikon strukturën qendrore dhe vendore të shërbimit, rolin e Drejtorisë së Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe strukturën dhe burimet financiare të shërbimit.

4. Kreu IV – Statusi i punonjësit të shërbimit të provës, përcakton detyrat kryesore të personelit të shërbimit të provës, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e këtij stafi, mospërputhjet kur ai bëhet pjesë e këtij shërbimi, situatat e konfliktit të interesave në punën e shërbimit të provës, kërkesat për trajnimin e personelit, si dhe rastet e largimit nga puna.

5. Kreu V – Masat disiplinore, përcakton rastet e përgjegjësisë disiplinore, klasifikon shkeljet disiplinore, përcakton 4 llojet e masave disiplinore që mund të vendosen ndaj personelit të shërbimit të provës në rast shkelje, si dhe specifikon procedurën për dhënien e masave disiplinore.

TITULLI III – MBIKËQYRJA E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

Titulli i fundit i Rregullores i referohet aktivitetit kryesor të punonjësve të shërbimit të provës, që është mbikqyrja e të dënuarve në komunitet në zbatim të vendimeve të gjyaktës për alternativat e dënimit me burgim. Në të njëjtën kohë, ky titull rregullon

edhe një funksionin tjetër kryesor të shërbimit të provës, që është ai për të hartuar dhe për t'u paraqitur gjyqtarëve dhe prokurorëve, raporte vlerësimi mbi të dënuarit në faza të ndryshme të procesit të drejtësisë penale.

6. Kreu VI – Standardet dhe procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative, përcakton standardet dhe procedurat e përgjithshme për mbikëqyrjen e dënimeve alternative. Ato aplikohen për çdo lloj alternative të dënimit me burgim që mund të vendoset nga gjykata. Krerët në vijim (VII, VIII, IX dhe X) u referohen sërish këtyre standardeve, por këtë herë atyre që aplikohen në rastin e një dënimi alternativ specifik. (Gjysmëliria; Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e të dënuarit në provë; Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik; apo lirimi me kusht).

Standardet e përgjithshme që përmenden në Kreun e gjashtë u referohen sa më poshtë:

6.1. Kontaktet mes punonjësit të shërbimit të provës dhe të dënuarit, veçanërisht në lidhje me procedurat që do të ndiqen gjatë takimit të parë të tyre.

6.2. Dosja personale e të dënuarit, lloji i regjistrave të mbajtur nga çdo shërbim prove dhe konfidencialiteti i të dhënave mbi të dënuarit;

6.3. Vlerësimi i personalitetit të të dënuarit, plani individual i mbikëqyrjes i hartuar për këtë qëllim, si dhe asistenca e konsultimi i programeve që zhvillohen për të dënuarit;

6.4. Procedura e ndjekur në rast se i dënuari nuk përmbush detyrimet dhe kushtet e vendosura nga gjykata.

6.5. Raportet e vlerësimit të përgatitura nga shërbimi i provës për gjykatat dhe prokurorët.

6.1. Kontakti i parë me shërbimin e provës

Një nga detyrimet kryesore që parashikon ligji për çdo person të dënuar me alternativë të dënimit me burgim, është të mbajë kontakte me autoritetin mbikëqyrës, respektivisht me shërbimin e provës. Kontaktet e vazhdueshme midis të dënuarit dhe shërbimit të provës për këtë arsye, ndodhin gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar me vendim gjykate. Në këtë mënyrë, shërbimi mund të planifikojë dhe të kryejë më mirë mbikëqyrjen e të dënuarit, mund të vlerësojë nevojat, rrezikun e përsëritjes së veprës penale si dhe rrezikun e dëmtimit për çdo të dënuar, mund të hartojë raporte të azhurnuara dhe informuese gjatë dhe në përfundim të periudhës së

mbikqyrjes, mund të zhvillojë dhe të japë asistencë individuale si dhe programme këshillimi të bazuar në vlerësimin e kryer.

Kontakti i parë me shërbimin e provës gjatë ekzekutimit të një alternative të dënimit me burgim shënon fillimin e një **marrëdhënieje** mes të dënuarit dhe mbikqyrësit të tij/saj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur nuk është zhvilluar asnjë takim i mëparshëm para sesa të jepet vendimi (nuk është kërkuar asnjë raport nga prokurori apo gjykata gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit). Kjo “*punë kokë-më-kokë*” apo “*marrëdhënie mbikqyrjeje*” siç quhet në vende që kanë një eksperiencë të gjatë në punën e shërbimit të provës, konsiderohet si rruga kryesore për ndërhyrjen nga ana e shërbimit të provës dhe një kusht bazë për ndryshimin e sjelljes dhe kushteve sociale që lidhen me recidivizmin. Për pasojë, punonjësi i shërbimit të provës i ngarkuar me çështjen, duhet t’i kushtojë rëndësi takimit të parë me të dënuarin, pasi ai vendos bazat dhe mund të influencojë cilësinë e marrëdhënies më të dënuarin.

Marrëdhënia është komplekse për shkak të rolit dualist që duhet të luajë punonjësi i shërbimit të provës. Nga njëra anë, punonjësi i shërbimit të provës duhet të shihet dhe të njihet si mbikqyrës, autoritet kontrolli për zbatimin e vendimeve dhe detyrimeve të gjykatës. Nga ana tjetër, punonjësi i shërbimit të provës duhet të shihet në të njëjtën kohë, si këshillues, terapist, ai i cili ndihmon të dënuarin të kapërcejë vështirësitë drejt riintegritetit të tij/saj social. Mënyra sesi punonjësi i shërbimit të provës luan rolin e tij të dyfishtë, është kryesore për të ndërtuar një marrëdhënie me të dënuarin, gjë që është themelore për një menaxhim të suksesshëm të të dënuarit. Puna e punonjësit të shërbimit të provës nuk duhet të ketë në plan të parë takimet e synuara, afatet, vënien në zbatim të dënimeve alternative, vlerësimin e rrezikut, paralajmërime për mospërmbushje të detyrimeve, e kështu me radhë. Të gjitha këto janë pjesë e punës, por në zemër të ekzekutimit duhet të qëndrojë ndërtimi i një marrëdhënieje të fortë, ose në të kundërt marrëdhënia do të ketë gjasa që të dështojë.

Ndonëse kontakti i parë me të dënuarin në mbikqyrje ka më tepër një rol informues dhe organizimi, stili i punonjësit të shërbimit të provës dhe mënyra sesi ai/ajo lidhet që nga fillimi me të dënuarin, mund të ketë një ndikim të fuqishëm në cilësinë e marrëdhënies së krijuar. Motivimi i të dënuarit është tepër i rëndësishëm. Nëse, në takimin e parë me të dënuarin, punonjësi i shërbimit të provës do të dijë si të vendosë kufijtë e marrëdhënies dhe të tregojë një qëndrim që shpreh dëshirën për ta kuptuar dhe asistuar të dënuarin, atëherë mund të arrihet një shkallë besimi tashmë e vendosur që nga kontakti i parë. Në të kundërt, nëse një qëndrim i ashpër dhe ndëshkues i punonjësit të shërbimit të provës do të zhvillohet që në takimin e parë, atëherë ka gjasa që të ndodhë një rezistencë e të dënuarit kundrejt ndryshimit dhe për pasojë, motivimi i tij/saj do të jetë minimal.

Një procedurë e detajuar për organizimin dhe kryerjen e takimit/kontaktit të parë me

të dënuarin jepet në nenin 24 të Rregullores.

6.2. Dosja personale e një të dënuari dhe regjistrat e veçantë të Shërbimit të Provës.

Mbajtja e të dhënave është një nga detyrat e rëndësishme të çdo punonjësi të shërbimit të provës. Menaxhimi i çdo rasti që mbikqyret dhe që i caktohet një punonjësi të shërbimit të provës, kërkon hapjen dhe përditësimin e dosjes personale për të dënuarit, mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave që përmban dosja, hapjen e saktë/korrekte dhe transmetimin e të dhënave që përmban dosja, respektimin e të drejtës së çdo të dënuari për të pasur akses dhe për të kundërshtuar dosjen e tij/saj personale.

Është e rëndësishme për shërbimin e provës që të përdorë një sistem numrash për dosjet e çdo rasti të uniformizuar, me qëllim që të identifikojë me lehtësi emrin e shërbimit, klientin (i rritur apo i mitur), vitin, muajin, dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm për çështjen që përmban dosja në mënyrë të menjëhershme. Një numër individual mund të lehtësojë kontrollin kronologjik dhe tërheqjen e lehtë të tij. Një shembull i një numri dosjeje për një rast, tregohet më poshtë:

SHK – 09 – J0001

SHK – Shërbimi i provës, Shkodër

09 – viti 2009

M – i mitur(në të kundërt, “R” mund të përdoret për të dënuarit madhorë)

0001 – Numri individual sipas rendit kronologjik.

Duhet përmendur se praktika e vendeve të tjera tregon se çdo shërbim prove cakton një anëtar të personelit, përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave statistikore mbi të dënuarit dhe aktivitetet specifike që zhvillohen në lidhje me ta. Punonjësi përgjegjës i shërbimit të provës, i quajtur “menaxheri i informacionit” është i ngarkuar me menaxhimin e të gjitha të dhënave të regjistruara nga shërbimi i provës, në lidhje me të dënuarit. Në të njëjtën kohë, në nivel qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, cakton një anëtar të stafit si “menaxher informacioni” për t’u marrë më të dhënat për të gjithë klientët e të gjithë shërbimit të provës në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara, mund të shërbejnë për qëllime kërkimi, studimi të dinamikës së kriminalitetit dhe mund të informojnë për vendimet e marra nga menaxherët e shërbimit të provës në nivel qendror dhe vendor. Shpresohet që Shqipëria do të fillojë të zhvillojë një sistem informacioni për shërbimin e provës që mund të lidhet, në një fazë të mëvonshme me sistemin e adoptuar nga secili prej institucioneve të sistemit të drejtësisë penale.

Përveç dosjes personale të përpiluar për çdo të dënuar, neni 26 i Rregullores

parashikon edhe regjistrat që duhen krijuar dhe plotësuar për nivelin e çdo shërbimi prove. Duhet të hapet një regjistër i vetëm hyrjeje për të gjithë të dënuarit e vendosur nën mbikqyrjen e shërbimit të provës. Gjithashtu, duhet të krijohen regjistrat për evidentimin e kërkesave dhe ankesave, për masat disiplinore, dhe për çdo ngjarje tjetër të rëndësishme. Një regjistër i veçantë duhet të hapet për të regjistruar të gjitha OJF-të dhe institucionet që asistojnë/këshillojnë të dënuarit, si edhe vendet e punës për kryerjen e punës në interes publik. Përmbajtja e çdo regjistri do të përcaktohet me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës duhet gjithashtu të krijojë regjistrin elektronik kombëtar dhe t'a përditësojë çdo javë atë.

Nenet 25, 26 dhe 27 të Rregullores përmbajnë dispozita që lidhen me hapjen dhe menaxhimin e dosjeve individuale, konfidencialitetin e të dhënave, aksesin në dosje, si dhe me transmetimin e të dhënave.

6.3. Vlerësimi i personalitetit të të dënuarit dhe plani individual i mbikqyrjes

Vlerësimi i personalitetit të të dënuarit është me shumë rëndësi për një planifikim dhe zbatim të mbikqyrjes gjatë ekzekutimit të dënimit. Bazuar në vlerësimin e bërë nga punonjësi i shërbimit të provës, mund të zhvillohet një program individual (apo “një plan mbikqyrjeje”, siç quhet në vende të tjera). Për një kuptim sa më të mirë të punës së vlerësimit, të natyrës dhe elementëve të saj, mund të thuhet se vlerësimi është një proces dhe konsiston në mbledhjen, analizën dhe sintezën e informacionit që lidhet me sa vijon:

- Natyrën e problemit (problemeve) të personit të dënuar
- Kapacitetin e të dënuarit për të përballuar problemet e identifikuara
- Sistemet përkatëse, të para përmes syve të personit të dënuar, si dhe natyrës së shkëmbimeve reciproke mes të dënuarit dhe këtyre sistemeve
- Burimet ekzistuese apo ato që nevojiten për të përmirësuar ose eliminuar problemet për të dënuarin
- Motivimin e të dënuarit për t'u marrë me problemet dhe për zgjidhjen e tyre.

Vlerësimi është një proces, pasi ai fillon që me takimin e parë ndërmjet punonjësit të shërbimit të provës dhe të dënuarit; vazhdon gjatë gjithë periudhës së mbikqyrjes dhe përfundon me ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Vlerësimi shihet gjithashtu përmes rezultateve të procesit, të çdo formulimi të një problemi/nevoje apo të një faktori të lidhur me të, çdo analize dhe sinteze të informacionit që në këtë mënyrë, konsiderohet si vlerësimi. Vlerësimi shfaqet duke filluar nga **nevojat** e të dënuarit dhe synon në fund t'i adresojë siç duhet këto nevoja të identifikuara.

Në lidhje me nevojat, duhen dalluar nevojat e personit të vlerësuar (siç shihen nga këndvështrimi i punës sociale) nga ato të ashtuquajtura “*nevoja kriminogjene*” të

cilat janë faktorë që, në mënyrë direkte apo indirekte, lidhen me sjelljen kriminale.

Nevojat e të dënuarit mund të përmbliken, si:

- Nevoja për t'u trajtuar si individ, i dalluar nga individët e tjerë
- Nevoja për t'u dëgjuar
- Nevoja për konfidencialitet, jetë private dhe besim
- Nevoja për t'u pranuar pa kusht apo diskriminim të çdo lloji
- Nevoja për t'u kuptuar dhe ndihmuar/asistuar.

Respektimi i të gjitha këtyre nevojave për forcimin e marrëdhënies mes punonjësit të shërbimit të provës dhe të dënuarit, dhe për pasojë, për të pasur një zbatim më të suksesshëm të urdhërimeve të gjykatës. Më shumë rreth nevojave të personit të vlerësuar, mund të gjeni në Kreun 6.1 – *Vlerat, parimet dhe aftësitë profesionale në shërbimin e provës*.

Nevojat kriminogjene janë krime që prodhojnë faktorë që mund të adresohen dhe që janë shumë në korelacion me rrezikun. Duhet përmendur se jo të gjithë faktorët e lidhur me sjelljen kriminale janë nevoja kriminogjene. Kërkimet³ tregojnë se 6 faktorë kryesorë mund të lidhen drejtpërdrejtë apo tërthorazi me krimin: faktorët e temperamentit apo personalitetit; qëndrimet antishoqërore, vlerat dhe besimet; bashkimet pro-kriminale; faktorët që lidhen me krimin; dhe një nivel i ulët arsimimi, arritjet financiare apo të kualifikimit profesional. Disa nga këta faktorë nuk mund të adresohen, nuk mund të ndryshohen, të konsiderohen “të pandryshueshëm” (p.sh., kriminaliteti familjar apo precedentët penalë të mëparshëm). Ata faktorë që mund dhe duhet të adresohen për ndryshim janë faktorë “dinamikë” që quhen nevoja kriminogjene. Ata janë të lidhur me rrezikun e recidivizmit dhe mund të konsistojnë në faktorë si: vlerat dhe qëndrimet e të dënuarit, përdorimi i substancave (kryesisht alkoolit dhe drogës), statusit të tyre të punës, mungesës së aftësive për zgjidhjen e problemeve, statusin e tyre të strehimit etj.

Nevojat kriminogjene duhet të identifikohen dhe adresohen nga punonjësi i shërbimit të provës, duke filluar nga kontakti i parë me të dënuarin, dhe duke vazhduar këtë proces gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes. Ndërhyrja efektive korrektuese mund të bëhet vetëm kur punonjësi i shërbimit të provës mund të zgjedhë tamam se “çfarë” duhet të targetojë për të ndryshuar tek një i dënuar i vënë në provë.

Trajtimi efektiv korrektues duhet t'i adresojë nevojat kriminogjene në zhvillimin e një plani bashkëkohor sipas rastit apo “programi individual” siç referohet në Rregulloren shqiptare. Prandaj, programet duhet të vlerësojnë dhe adresojnë probleme/nevoja, të tilla si: qëndrimet antisociale, lidhjet anti-shoqërore brenda grupit, abuzimi

3 Për shembull, Andrews, D.A. (1995). Psikologjia e sjelljes kriminale dhe trajtimet efektiv. Në McGuire, J. (Ed). Çfarë funksionon: Reduktimi i përsëritjes së veprave penale. Chichester: John Wiley and Sons.

me substancat, mungesa e optimizmit, aftësitë e vetëkontrollit. Duhet vërejtur se, adresimi i vetëm një problemi kur shumë të tjerë janë identifikuar, ka shumë të ngjarë që të mos prodhojë efektin e dëshiruar. Një plan/program individual i suksesshëm, duhet të adresojë llojin e nevojave kriminogjene që funksionojnë së bashku.

Për më tepër, çdo trajtim që nuk fokusohet tek nevojat kriminogjene, mund të jetë kundër-produktive për të pasur efikasitet dhe efikasitet. Studimet⁴ tregojnë se programet që përqëndrohen më tepër tek faktorët jo-kriminogjenë (si: vetëvlerësimi, aftësia krijuese, kushtet fizike) kanë efekte të pakta, ndonjëherë edhe negative.

Rregullorja i kushton dy nene (nenet 28 dhe 29) vlerësimit të personalitetit të të dënuarit, planit të mbikqyrjes/programit individual, si dhe asistencës së dhënë të dënuarit gjatë periudhës së mbikqyrjes. Referenca për nevojat kriminogjene dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale gjendet në tekst. Ka gjithashtu, edhe disa dispozita që lidhen me përmbajtjen e programit individual dhe me qëllimet e asistencës dhe këshillimit të një të dënuari.

6.4. Procedura në rast mospërmbushje së detyrimeve dhe kushteve të vendosura nga gjykata për të dënuarin

Pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve të vendosura nga gjykata ndaj të dënuarit dhe procedura që do ndiqet për të, jepen në nenin 62 të Kodit Penal si dhe në nenin 31/10 të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Rregullorja, në nenin 13 (të mëposhtëm) jep më shumë detaje mbi rolin e shërbimit të provës në rast se ndodh një shkelje e tillë e kushteve apo detyrimeve të vendosura.

Këtu është vendi për të përmendur një zhvillim pozitiv të legjislacionit shqiptar. Para miratimit të ndryshimeve të 27 nëntorit 2008, Kodi Penal parashikonte një revokim automatik të dënimit alternativ në rast se ndodhte një shkelje e detyrimeve (dënimi alternativ do të zëvendësohej automatikisht me dënim me burgim). Kjo procedurë në rast shkeljeje, ishte në kundërshtim me standardet ndërkombëtare që parashikojnë një qasje graduale në situata të tilla, në varësi të shkallës së shkeljes dhe të individualitetit të çdo rasti. Mund të thuhet se tashmë, legjislacioni penal shqiptar është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parashikon një ndryshim të plotë apo të pjesshëm të dënimit përpara sesa të merret në konsideratë revokimi. Për më tepër, kur revokohet dënimi alternativ, gjykata është e detyruar që së pari, të marrë në konsideratë nëse ka vend për të dhënë një alternativë tjetër më të përshtatshme dhe vetëm në rast se një alternativë e tillë e duhur nuk gjendet, atëherë ndaj të dënuarit mund të jepet dënim me burgim.

Një aspekt tjetër pozitiv që lidhet me shkeljen e detyrimeve është ai që prokurori, pas ndryshimeve të fundit të ligjit, ka të drejtë të bëjë një paralajmërim në rast se shkelja

4. Latessa, E.J & Lowenkamp, L. (2006), Riedukimi në komunitet: Kërkime dhe praktikat më të mira.

nuk është e rëndësishme dhe nëse është për herë të parë. Gjykata njoftohet vetëm kur shkelja është serioze apo kur ajo përsëritet. Për pasojë, ndërhyrja e prokurorit është një gjë e re, ndërkohë që më parë, vetëm gjykata mund të vendoste në rast të kryerjes së një shkeljeje (e rëndë ose jo) të detyrimeve të vendosura prej saj. Sërish, duhet theksuar përqasja graduale për të vendosur mbi masën që do merret ndaj të dënuarit që shkel detyrimet e vendosura.

Neni 30 i Rregullores u referohet procedurave që ndiqen në rast dështimi të kushteve dhe detyrimeve që duhet të plotësohen, të cilat rrjedhin nga një vendim që përmban dënim alternativ.

6.5. Raportet e vlerësimit të përgatitur nga shërbimi i provës për gjykatat dhe prokurorët. Rregullorja parashikon në nenet 31, 32, 33 dhe 34 dhe 15, detyrimin e shërbimit të provës për t'i paraqitur gjykatës apo prokurorit një raport vlerësimi, në shkallë të ndryshme të procesit penal. Informacion bazë mbi raportet, qëllimet e tyre, përmbajtjen, dhe procedurën, mund të gjenden në Kreun 7.1 të këtij Manuali.

Më poshtë, jepet një model raporti i hartuar nga shërbimi i provës në Rumani, për të ndihmuar gjykatën në marrjen e vendimit. Ky model mund të japë një kuptim më të mirë të përmbajtjes dhe terminologjisë së përdorur në një raport të tillë, të sasisë së informacionit të paraqitur, madhësisë së çdo seksioni të raportit, mënyrës së kryerjes së analizës së informacionit, formulimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Shembull raporti – Shërbimi i provës në Rumani

**Ministria e Drejtësisë
Rumani**

Tepër konfidencial pasi të plotësohet

Shërbimi i provës, Bukuresht Raport vlerësimi

I. HYRJE

Emri dhe mbiemri i të pandehurit: M.R.

Data dhe vendi i lindjes: XX/12/1983.

Adresa: Bukuresht.....

Krimi(et) për të cilën ai është dërguar para gjykatës: vjedhje me dhunë, bashkëpunim në mashtrim, fallsifikim i identitetit, parashikuar nga neni i Kodit Penal

Gjykata që ka kërkuar raportin e vlerësimit: Gjykata e Rrethit Gjyqësor,

Bukuresht

Numri i dosjes penale: XXXX/2001

Data e shqyrtimit gjyqësor: X/07/2001

Numri dhe data e kërkesës së gjykatës për raportin: XX/07/2001

Emri dhe mbiemri i punonjësit të shërbimit të provës, si autor i raportit: I.M.

II. BURIMET E INFORMACIONIT

- Intervistë me M.I, nëna e të pandehurit, në vendbanimin e saj
- Intervistë me M.R., i pandehur, në ambientin e paraburgimit të rajonit të policisë lokale
- Intervistë me M.G., punonjës social i punësuar nga OJF-ja “Terre des Hommes” Bukuresht, në zyrën e shërbimit të provës
- Akt-akuza e prokurorit që është në dosjen penale me nr. XXXX/2001

Do të doja të përmendja se jam përpjekur të konsultoj përmbajtjen e dosjes penale me nr. XXXX/2001, në arkivën e gjykatës, por pa sukses.

III. TË DHËNA MBI TË PANDEHURIN

M.R. vjen nga një familje e madhe në numër dhe ka 5 vëllezër. Prindërit e M.R.-së u divorcuan menjëherë pas lindjes së saj dhe ajo jetoi me babanë dhe një vëlla deri sa mbushi 5 vjeç, kohë në të cilën i ati u nda nga jeta. M.R. u dha për birësim në moshën 5-vjeçare, pasi e ëma nuk mund ta përballonte përgjegjësinë për rritjen e 6 fëmijëve.

Familja M. e birësoi M.R.-në si fëmija i vetëm i tyre dhe arriti t’i ofronte asaj kushte optimale jetese, duke pasur një zhvillim normal dhe arsimimin e duhur. Modeli familjar ishte pozitiv, duke u dominuar nga një atmosferë e mirë familjare në shtëpi dhe nga një marrëdhënie e konsoliduar dhe natyrore prindër-fëmijë.

Ati birësues i M.R.-së ishte një shofer profesionist, duke qenë kështu larg shtëpisë për kohë të gjatë, për shkak të punës. Të ardhurat e tij ishin të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për familjen dhe t’i ofronte asaj një mënyrë jetese dinjitoze. Në qershor të këtij viti, ai u nda nga jeta si pasojë e një ataku në zemër. Nëna birësuese e M.R.-së ka punuar gjithmonë si shitëse, është aktualisht në pension dhe merr një pension mujor prej 300 eurosh.

Në lidhje me marrëdhënien mes M.R.-së dhe prindërve të saj, asnjëherë nuk kishte pasur probleme serioze apo debate dhe tensione në familje. M.R. ishte integruar mjaft mirë në familjen e saj të re dhe kishte krijuar marrëdhënie të forta dhe të konsoliduara me gjyshërit e saj, me të cilët ajo kishte kaluar shumë kohë gjatë

pushimeve të shkollës.

M.R. kishte marrë një edukim të mirë nga prindërit dhe gjithmonë ishte inkurajuar që të ndiqte rregullisht shkollën dhe të studionte. Deri në maj të vitit 2001, M.R. ndoqi shkollën e mesme nr. XX112, të Bukureshtit.

M.R. kishte dy shoqe që ajo i njihte që nga shkolla fillore, të quajtura Ana dhe Maria. Të dy shoqet jetonin në të njëjtën lagje me M.R., duke e vizituar njëra-tjetër rregullisht. Prindërit e M.R.-së gjithnjë kishin qenë kundër një raporti të ngushtë mes vajzës së tyre dhe Anës, duke konsideruar faktin që ndikimi i Anës mund të ishte negativ. Sa herë që M.R. shkonte në festa, ajo kërkonte fillimisht miratimin e prindërve për të shkuar, dhe kurrë nuk ishte kthyer vonë në shtëpi. Të gjitha këto rregulla, M.R. i kishte perceptuar si të natyrshme, dhe ajo kurrë nuk ishte ndjerë e detyruar kur i ishte kërkuar t'u bindej rregullave të familjes.

Familja e M.R.-së jeton në një apartament me dy dhoma, i cili ofron kushte të përshtatshme jetese dhe ku M.R. ka dhomën e saj. Karakteristikat e personalitetit të M.R.-së tregojnë se ajo mund të ndikohej lehtësisht dhe kishte një shkallë të lartë ndjeshmërie. Situata shëndetësore ishte e mirë, por ajo kishte rënë në peshë, në mënyrë të konsiderueshme, gjatë muajve të fundit që kishte kaluar në paraburgim.

Kur M.R. ishte intervistuar për të hartuar raportin e vlerësimit për gjykatën, ajo kishte përmendur se në maj të vitit 2000, një person i panjohur i kishte telefonuar asaj duke e pyetur nëse ishte e interesuar për të takuar nënën e saj të vërtetë. Në atë kohë, M.R. nuk e dinte se ishte fëmijë i birësuar, pasi dhe kujtimet e saj nga fëmijëria e hershme ishin tepër të vagullta. Kur ajo zbuloi se ishte birësuar dhe anjëherë nuk i ishte thënë kjo gjë, M.R. u largua nga familja, nga shtëpia e saj, tepër e inatosur dhe shkoi në shtëpinë e Anës. Ana e ndihmoi të gjentë një apartament ku ajo mund të qëndronte për një periudhë kohe të pacaktuar. Këtë apartament, ajo e ndante me dy vajza të tjera. Shumë meshkuj vinin në apartament për të vizituar vajzat, dhe M.R. e pranonte faktin se ajo vetë pranoi të prostituonte.

Prindërit e M.R.-së nuk e njoftuan policinë, pasi u vinte turp të pranonin realitetin. Por ata i kërkuar një miku, i cili ishte officer policie, t'i ndihmonte të dinin se se ishte vajza e tyre. Kohë pas kohe, ata merrnin ndonjë njoftim apo telefonatë që i njoftonte: “Mos u shqetësoni, M.R. është mirë.”

Në lidhje me akuzën e bërë për fallsifikim identiteti, M.R. pranoi se kishte gënjyer për emrin e saj të vërtetë, pasi kishte frikë dhe turp për situatën ku ndodhej, veçanërisht para prindërve.

Në lidhje me akuzën për vjedhje të kartave të kreditit një shtetasi turk, M.R. deklaroi

se ajo nuk kishte marrë pjesë në këtë vjedhje dhe nuk kishte dijeni se si kishte ndodhur krimi. Ajo u akuzua se e kishte kryer krimin vetëm nisur nga fakti se ajo jetonte në apartamentin ku ishin vjedhur kartat e kreditit. Ajo e pranonte se dilte me shtetasin turk dhe e sillte atë herë pas here në apartament, pasi kjo gjë i ishte kërkuar asaj nga disa persona që e mbikqyrnin atë dhe i gjenin “klientë”. Por M.R. ishte shprehur se ajo nuk e dinte që ky shtetas turk kishte karta krediti në portofolin e tij dhe deklaroi se ndoshta dikush tjetër i kishte vjedhur kartat e tij të kreditit, ndërsa ata flinin, pasi rrobat e tij ishin vënë në një dhomë tjetër nga ajo ku ata flinin.

IV. FAKTORËT QË NDIKOJNË OSE QË MUND TË NDIKOJNË SJELLJEN E PËRGJITHSHME TË TË PANDEHURIT

M.R. është ende adoleshente, një periudhë me specifika në ndryshimet e personalitetit dhe që karakterizohet nga vulnerabiliteti i lartë kundrejt ndikimeve të jashtme. Adoleshenca është një fazë në zhvillimin psiko-social, ku adoleshenti tenton të asimilojë sjellje dhe modele që janë më të pranishme në jetën e tij/saj. Kjo është arsyeja se përse mund të thuhet që koha e gjatë e qëndrimit të M.R.-së në paraburgim, mund të ketë një ndikim negativ në sjelljen e saj në të ardhmen, në mënyrën e të menduarit dhe në marrëdhënie me individë të tjerë.

M.R. nuk ka kryer më parë ndonjë vepër tjetër penale. Krimi për të cilin ajo akuzohet se e ka kryer, mund të argumentohet me faktin se ajo ka qenë nën ndikimin negativ të ambientit dhe shoqërisë së saj të re. M.R. ishte e mitur (nën 18 vjeç) kur u krye vepra penale. Ne konsiderojmë se rikthimi pranë familjes së saj mund të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin, qëndrimin dhe përgjegjësitë e saj.

Pas intervistimit të M.R.-së, kuptuam se ajo ishte penduar që në muajt e fundit kishte zgjedhur të jetonte në atë mënyrë. Ajo dëshiron shumë që të vazhdojë studimet e saj në shkollën e mesme (shkollën e natës), në të njëjtën kohë të gjejë një punë dhe të jetë e pavarur financiarisht.

Në këtë moment, M.R. është ndikuar shumë nga vdekja e të atit, me të cilin gjithnjë ka qenë tepër e lidhur, e dashur dhe e afeksionuar. Gjithashtu, tani ajo zbulon se e ëma ka nevojë për shumë mbështetje në këto momente të vështira dhe ajo është gati t’ia ofrojë këtë mbështetje dhe ta bëjë nënën e saj të ndihet sërish krenare për të.

PERSPEKTIVAT E RIINTEGRIMIT SOCIAL

Në rast se gjykata do të vendosë të zbatojë një alternativë të dënimit me burgim, perspektiva e riintegrit social për M.R.-në është e lartë, për arsyet e mëposhtme:

- Mosha e saj lejon asimilimin e duhur dhe një zhvillim të ardhshëm të roleve sociale pozitive
- M.R. është i ndërgjegjshëm për sjelljen e saj të papërshtatshme, e zhvilluar së fundmi, e cila është larg nga arsimimi që ajo ka marrë si fëmijë e prindërve të saj
- M.R. përfiton nga mbështetja e nënës, si nga pikëpamja afektive ashtu dhe nga ajo financiare
- M.R. manifeston një lidhje të ngushtë me familjen e saj
- M.R. ka dëshirë të vazhdojë studimet dhe të gjejë punë
- M.R. ka treguar shumë interes për të bashkëpunuar me shërbimin e provës, për të përballuar vështirësitë e saj për riintegrim social
- M.R. është regjistruar në Fondacionin “Terre des Hommes” duke qenë pjesë e projektit të tyre mbi “Të miturit në konflikt me ligjin”. Fondacioni dëshiron të mbështesë M.R.-në in planet e saj për shkollim dhe integrim social, dhe madje mund edhe t’i japë asaj një mbështetje financiare nëse është e nevojshme.

Datë.....

Punonjësi i shërbimit të provës
(firma)

Drejtori i shërbimit të provës
Shërbimi i provës, Bukuresht
(firma)

7. Krerët VII, VIII, IX, X dhe XI – përcaktojnë standardet dhe procedurat specifike për mbikqyrjen e të dënuarve, për të cilët gjykata ka dhënë një alternativë të dënimit me burgim:

- të dënuarit me “gjysmëliri”
- të dënuarit, për të cilët gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë.
- të dënuarit, për të cilët gjykata ka vendosur “qëndrim në shtëpi”.
- të dënuarit, për të cilët gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin për të kryer një punë në interes publik
- të dënuarit e liruar me kusht.

Për këtë arsye, përveç standardeve të përgjithshme të mbikqyrjes të dhëna në kreun VI të Rregullores, punonjësi i shërbimit të provës duhet të njohë dhe të zbatojë standardet specifike të parashikuara në nenet 35-59 të Rregullores.

12. Kreu XII – Zbatimi i akteve ndërkombëtare nga shërbimi i provës, i referohet bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, në zbatimin e akteve ndërkombëtare mbi masat dhe sanksionet komunitare.

13. Kreu XIII – Dispozita të fundit, përcakton masat kalimtare, që duhet të ndërmerren për të vendosur dhe zhvilluar një shërbim kombëtar të provës në Shqipëri. Ky kre parashikon se Ministri i Drejtësisë duhet të nxjerrë aktet nënligjore, për të përcaktuar procedurat e rekrutimit për punonjësit e parë të rekrutuar të Shërbimit të Provës, si dhe për zhvillimin gradual të tij. Sipas dispozitave ligjore, numri i punonjësve të shërbimit të provës në nivel lokal, pranë çdo gjykate të rrethit gjyqësor do të jetë 21. Dispozitat tranzitore parashikojnë se, në fazën e parë, do të krijohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, vetëm disa zyra të shërbimit të provës. Në një fazë të mëvonshme, do të hapen zyra të tjera në nivel lokal, për të përfunduar të gjithë procesin në shkallë vendi.

5. NJOHURI KRIMINOLOGJIKE PËR PUNONJËSIN E SHËRBIMIT TË PROVËS

Teoritë sociologjike dhe teoritë psikologjike

5.1

Migena Leskoviku dhe Marinela Sota

Teoritë mbi krimin janë të shumta dhe kanë evoluar në kohë dhe në mendim. Për arsye të kuptimit sa më të mirë në funksion të këtij manuali, është bërë një ndarje dhe kategorizim i teorive si më poshtë:

- Teoritë psikologjike
- Teoritë sociologjike

a) Teoritë psikologjike

Linja psikologjike fokusohet në të gjitha aspektet mendore të çdo personi që kryen krim dhe lidh inteligjencën, personalitetin, të mësuarit me sjelljen kriminale. Teoritë më të njohura janë teoria psikodinamike, teoria e sjelljes dhe teoria njohëse. Brenda teorive psikologjike ka dy nën-linja që janë nën-linja e personalitetit dhe nën-linja e inteligjencës. Në teoritë psikologjike personaliteti luan një rol të madh nëse individ kryen krim ose jo. Individët që kanë personalitet i cili përfshin elementë të tillë si: impulsivitet, narcizëm, dyshim, sadizëm, mungesë shqetësimi për të tjerët, vetëvlerësim të ulët, shprehi të varfra personale, paqëndrueshmëri mendore, armiqësi, konsiderohen si individë që mund të përfshihen më shumë në sjellje kriminale se të tjerët.

Teoria psikodinamike - Kjo teori u zhvillua nga Sigmund Frojd (Sigmund Freud). Sipas saj, mendja njerëzore kryen tre funksione kryesore. Ato janë: e ndërgjegjshme, e parandërgjegjshme, dhe e pandërgjegjshme. E ndërgjegjshme kontrollon gjithë mendimet tona të përditshme. Parandërgjegjja kontrollon elementët e përvojave që janë jashtë ndërgjegjes por mund të kthehen në çdo kohë, siç janë kujtimet. E pandërgjegjshme kontrollon dëshirat biologjike të trupit, që nuk mund të shprehen lehtë siç mund të shprehen mendimet e përditshme të ndërgjegjshme. Shumë njerëz i shtypin ndjenjat e forta seksuale ose armiqësore duke bërë kështu që këto ndjenja të veprojnë mbi ta në një kohë të mëvonshme. Idi është pjesa biologjike e mendjes njerëzore që shfaqet që në lindje. Ego është pjesa e mendjes njerëzore që zhvillohet në fëmijërinë e hershme dhe kontrollon instinktët bazë që nuk mund të kënaqen menjëherë. Superegoja është aspekti i mendjes që zhvillohet si rezultat i inkorporimit të standardeve morale, vlerave të familjes, komunitetit, etj.

Struktura e personalitetit sipas Frojdit përcakton sjelljen e individit dhe përbëhet nga 4 pjesë:

1. ID (pjesa kryesore e personalitetit, energji fizike, parimi i kënaqësisë, i pandërgjegjshëm, jo-racional).
2. EGO (zhvillohet jashtë ID-it, i ndërgjegjshëm dhe i pandërgjegjshëm, parimi i realitetit, përmbushja e dëshirave, mekanizma mbrojtës, racional).
3. SUPEREGO (zhvillohet jashtë EGO-s, kryesisht i pandërgjegjshëm, i ndërgjegjshëm, jo-racional).
4. Mjedisi i jashtëm (situatë imediate e veprimit)

Frojdi (1938) nënvizoi se ka një ndryshim midis neurotikëve, ata që konfliktet e pandërgjegjshme iu rezultojnë në ankth, depresion dhe sjellje të tjera vetëdëmtuese dhe, kriminelëve, simptomat e të cilëve dëmtojnë të tjerët. Ai gjithashtu besonte se kriminelët udhëhiqen nga dëshira e pandërgjegjshme për të dëmtuar shoqërinë për sjelljet që çuan në krimet e tyre, kështu që fajë nuk vjen si rezultat i sjelljes kriminale, por është shkaku i pandërgjegjshëm i saj.

Kriminelët e natyrës psikoanalitike kanë karakteristika të:

- Superegos së dobët
- Egos së dobët
- Shkelësit normal antisocial
- Shkelësit neurotik
- Psikotik-ut
- Zhvillimit të vonuar

Superegoja e dobët shprehet me: mosvlerësim i vazhdueshëm për rregullat konvencionale të shoqërisë, qëndrime antisociale, ambicie e dobët konvencionale, shkakton probleme, krijon konflikte me figurat autoritare, ndahet nga të tjerët.

Egoja e dobët shprehet me: papjekuri, shprehi sociale të pazhvilluara, lidhje jo të mira me realitetin, varësi nga të tjerët, ndjekje e liderit dhe angazhim në aktivitete kriminale.

Psikopatia sipas listës së Cleckley-t (1982) përfshin: Sharm sipërfaqësor, inteligjencë e mirë, mungesë e zhgënjimeve, mungesë e nervozizmit, mungesë e turpit dhe dështim për të mësuar nga eksperiencat e jetës.

Teorinë psikodinamike e zhvilluan të tjerë studiues si Abrahamsen (1944, 1960), Aichorn (1935), F. Alexander (1935), Glueck&Glueck (1950, 1968).

Analiza e tyre filloi nga premise që një kriminel ka Ego të dobët, një Superego të dobët ose që i mungon dhe Id të fuqishëm. August Aichorn (1935) besonte se kriminelët përsëritës kanë një predispozitë për sjellje kriminale për shkak të paafëtisë së tyre për të kontrolluar kërkesat e Idit për përmbushje të menjëhershme dhe dështimit të Superegos për të zhvilluar fuqinë e duhur për të gjeneruar respekt për të tjerët dhe kuptimin e “së mirës” dhe “së keqes”. Studiuesit e teorisë psikodinamike besonin se të rinjtë kryejnë vepra penale si shkak i shprehjes së konflikteve të pandërgjegjshme të pazgjidhura. Krimet e tyre janë të udhëhequra nga Id i pakontrolluar sepse ata nuk e shtynë në kohë ose shmangin përmbushjen e kënaqësisë. Dështimi për të zhvilluar Ego dhe Superego të shëndetshme shkaktohet nga dështimi i identifikimit me figurat prindërore ose nga mungesa e modeleve të bindjes ndaj ligjit dhe/ose të dashura ndaj tyre. Brendësimi i normave, vlerave, moralit dhe mungesa e identifikimit bën që Superego të mos zhvillohet si duhet.

Abrahamsen (1960) i ka përshkruar kriminelët si individë të dominuar nga impulset e Id-it dhe që nuk janë në gjendje të kontrollojnë tendencat për impulsivitet dhe agresivitet. Moszhvillimi i duhur i Superego-s bën që kriminelët të kenë mungesë të ndërgjegjës dhe mungesë të empatisë për të tjerët. Gjithashtu, duke pasur Ego të dobët, ata mund të influencohen lehtë nga presioni i bashkëmoshatarëve dhe i forcave të tjera sociale.

Abrahamsen i klasifikon vrasësit si: vrasës simptomatikë dhe vrasës manifestues. Vrasësit simptomatikë vrasin sepse kanë një konflikt të pazgjidhur me nënat ose me figura të tjera në fëmijëri ndërsa vrasësit manifestues vrasin për përfitim të pastër ose për arsye të tjera.

Studiuesit e Teorisë psikodinamike sugjerojnë se sjellja kriminale vjen si rezultat i mbipërdorimit të mekanizmave mbrojtës. P.sh., shumë njerëz përdorin sublimimin për të kanalizuar impulset seksuale ose agresive në sjellje të pranueshme sociale, ndërsa kriminelët mbështeten vetëm në përdorimin e shtypjes dhe mohimit si

mekanizma mbrojtës duke i mbajtur impulset gati për të shpërthyer në situata të caktuara. Studiuesit e kësaj teorie përdorin konceptin e zhvendosjes për të shpjeguar abuzimin ndaj fëmijëve ose bashkëshortëve. Abuzuesit frikësohen të adresojnë zemërimin te një figurë autoritare dhe e drejtojnë drejt personave të pambrojtur. Kriminelët përdorin racionalizimin duke thënë se të vjedhësh nga punëdhënësi është e pranueshme sepse “nuk paguhem mirë dhe kompania e përballon humbjen”.

Teoria e njohjes sociale

Kjo teori fokusohet në shpjegimin e procesit të perceptimit të botës rreth tyre nga njerëzit dhe prezantimit mendor të këtij procesi.

Sipas Lawrence Kohlberg, individit kalon në gjashtë faza të zhvillimit mendor:

1. Gjëja e “duhur” për t’u bërë është bindja ndaj pushtetit dhe shmangia e dënimit.
2. Gjëja e “duhur” është marrja e përgjegjësisë për veten, përmbushja e nevojave të veta dhe lënia e të tjerëve të marrin përgjegjësitë për veten e tyre.
3. Gjëja e “duhur” është të jesh i mirë, në kuptimin që të kesh motive të mira, të shqetësohesh për të tjerët dhe “ta vësh veten në këpucët e tjetrit”
4. Gjëja e “duhur” është mbajtja e rregullave të shoqërisë dhe t’i shërbesh mirëqenies së grupit apo shoqërisë.
5. Gjëja e “duhur” është njohja e të drejtave të individit në shoqëri, bazuar në rregulla të pranuar.
6. Gjëja e “duhur” është detyrimi i pranuar nga të gjithë për të respektuar dhe zbatuar për të gjitha qeniet njerëzore parimet e drejtësisë, barazisë dhe respektit për jetën njerëzore.

Kohlberg zbuloi se individët që kryenin vepra kriminale kishin më pak qëndrime morale se ata që nuk ishin përfshirë në krim. Megjithatë ai theksoi se njerëzit që i binden ligjit me qëllim shmangien e dënimit ose për t’i shërbyer vetes, kanë probabilitet më të lartë për t’u përfshirë në krim se të tjerët.

Për Teorinë e njohjes sociale janë të rëndësishme njohjet, pra, njerëzit perceptojnë, mendojnë, presin, vlerësojnë dhe interpretojnë. Kështu elementët njohës bëhen qendrore si në shpjegimin e krimit ashtu edhe në zhvillimin e programeve për të ndryshuar sjelljen e individëve të përfshirë në krim.

Rotter (1954) dhe Bandura (1973) zhvilluan konceptet e të mësuarit vëzhgues/modelimin dhe vetë-efikasitetit, që janë koncepte që përdoren në hartimin e programeve të trajtimit të sjelljes kriminale.

b) Teoritë sociologjike

Këto teori kërkojnë të gjejnë shpjegime sesi njerëzit mendojnë, ndihen dhe sillen në situata të ndryshme sociale. Studiuesit e shkencave sociologjike zhvillojnë pyetje të tilla si: Si i formojmë përshtypjet për të tjerët? Cilat janë motivet që njerëzit i ndryshojnë qëndrimet e tyre? Cilat janë shkaqet që njerëzit konformohen me rregullat e grupit? Në cilat rrethana njerëzit iu binden urdhrave apo në të kundërt iu rezistojnë atyre? Këto teori i bazojnë paradigmat e tyre në ndikimin që situatat sociale kanë në përfshirjen ose jo të individit në krim.

Ndër teoritë më të njohura sociologjike përmendim:

- Teoria e asociimit të diferencuar
- Teoria e të mësuarit social
- Teoria e kontrollit social
- Teoria e frustracionit
- Teoria e përgjithshme e krimit

Teoria e asociimit të diferencuar – Është një teori e zhvilluar nga Edwin Sutherland dhe paradigma kryesore e saj është se individët mësojnë vlera, qëndrime, teknika dhe motive për sjellje kriminale nëpërmjet ndërveprimit me të tjerët. Sipas kësaj teorie krimi mësohet nëpërmjet asociimit të individit me qëndrime të të tjerëve që, ose e pranojnë sjelljen kriminale ose e justifikojnë atë në rrethana të caktuara. Ndërveprimi me bashkëmoshatarë të përfshirë në kriminalitet shihet si një rrethanë që nxit krimin. Sipas teorisë së asociimit të diferencuar, sjellja kriminale mund të përsëritet dhe të bëhet e vazhdueshme nëse ajo përforcohet gjatë viteve. Kur ekziston subkultura e krimit në një komunitet të caktuar atëherë shumë individë mësojnë të kryejnë krime dhe gjithashtu kjo shoqërohet me nivele të lartë kriminaliteti por edhe dhunë në komunitet.

Sutherland zhvilloi konceptin e “vetes” si një konstrukt social, që do të thotë se imazhi i individit për veten ndërtohet dhe rindërtohet në mënyrë të vazhdueshme nga ndërveprimet me të tjerët. Individët sipas kësaj teorie e përkufizojnë jetën e tyre sipas referencës që iu bëjnë eksperiencave të tyre dhe më pas duke përgjithësuar përkufizimet, ato bëhen shpesh përcaktuese për veprimet në të ardhmen. Një individ e sheh jetën ndryshe nëse është i punësuar ose i refuzuar për të punuar, nëse vjen nga një familje mbështetëse, ose nëse është rritur nga prindër abuzues. Megjithatë individët mund të reagojnë ndryshe në të njëjtën situatë në varësi sesi eksperiencat e tyre jetësore i ndikojnë ata për të kuptuar situatën ku ndodhen.

Teoria e asociimit të diferencuar parashikon që individi zgjedh rrugën e krimit kur barazpesha e përkufizimeve të tij për jetën është në favor të thyerjes së ligjit dhe jo në

favor të bindjes ndaj ligjit. Kjo tendencë do të përforcohet nga ndërveprimet sociale që individi do të ketë gjatë jetës.

Teoria e të mësuarit social- është teoria që bazohet në paradigmen se individët mësojnë sjellje të reja nëpërmjet rificimit të tyre ose nëpërmjet dënimit, ose nëpërmjet të mësuarit vëzhgues. Individët mësojnë duke vëzhguar sjelljen e të tjerëve. Nëse ata vëzhgojnë sjellje pozitive atëherë ata mund të modelojnë, imitojnë dhe zhvillojnë sjellje të tilla. Kjo teori sugjeron që mjedisi luan rol të rëndësishëm në mënyrën sesi individët sillen.

Teoria e të mësuarit social rrjedh nga puna e Gabriel Tarde-s (1843-1904), cili propozoi se të mësuarit social ndodh gjatë katër fazave të imitimit:

- Kontakti i ngushtë
- Imitimi i njerëzve me status më të lartë
- Kuptimi i koncepteve
- Modelimi i sjelljes sipas roleve të mësuara

Në kriminologji, Ronald Akers dhe Robert Burgess (1966) zhvilluan teorinë e të mësuarit social për të shpjeguar devijancën duke kombinuar variabla ose faktorë që nxisin kriminalitetin (si p.sh., presioni social nga bashkëmoshatarët të cilët kanë kryer vepra penale) me variabla që frenojnë kriminalitetin (si p.sh., reagimi i prindërve pas përfshirjes së parë të fëmijëve në kriminalitet).

Akers dhe Burgess u mbështetën në teorinë e asocimit të diferencuar, por ata përfshinë idenë e rificimit të sjelljes dhe që bazohet në parimin që sjellja është funksion i pasojave të veta (Pfohl, 1994).

Burgess dhe Akers (1966:128-147) përshtatën parimet e teorisë së asociimit të diferencuar për të shpjeguar sjelljet kriminale duke sjelle parime të tjera plotësuese si:

1. Sjellja ndikohet nga faktorët e mjedisit.
2. Sjellja mund të përforcohet jo vetëm nga ndërveprimet, por edhe nga rrethanat të tjera si p.sh., një hajdut që vjedh për t'u ushqyer, kjo sjellje nuk përforcohet nga një ndërveprim social por ajo përforcohet sepse uria largohet duke vjedhur.
3. Sjellja kriminale mësohet në grupe të vogla ku kryhet dhe funksioni i përficimit sipas teorisë së asociimit të diferencuar dhe familja është grupi kryesor që merret si shembull në këtë rast, por Burgess dhe Akers mendojnë se çdo grup mund të ofrojë mundësinë e përficimit të sjelljes pozitive, jo

vetëm familja.

4. Burgess dhe Akers, në procesin e të mësuarit të teknikave, u japin rëndësi qëndrimeve dhe sjelljeve kriminale, motivimit sesi ai ndikon në përforcimin e sjelljeve kriminale për ta përdorur motivimin në përforcimin e sjelljeve pozitive.
5. Burgess dhe Akers zgjeruan idenë se nga mund të vijë përforcimi i sjelljes. Modele përforcimi pozitiv duhen analizuar për të kuptuar zhvillimin e sjelljen e individit nën këto modele.
6. Ndërsa sipas teorisë së asociimit të diferencuar “sjellja kriminale është funksion i rregullave që diskriminojnë sjelljen kriminale, procesi i të mësuarit ndodh kur sjellje të tilla përforcohen më shumë se sjellja jo-kriminale” - Burgess dhe Akers theksojnë se ka një proces në të cilin diskriminohen rregullat në favor të kriminalitetit dhe pas kësaj sjellja përforcohet.
7. Fuqia e sjelljes kriminale është një funksion i drejtpërdrejtë i masës, shpeshtësisë dhe probabilitetit të përforcimit sipas Sutherland-it (1947:5-7), por Burgess dhe Akers shprehen idenë se kur ka një rritje të masës së përforcimit atëherë kemi edhe rritje të shkallës së reagimit.

Teoritë e kontrollit social të krimit dhe njohja me to

Teoritë e kontrollit social fokusohen në strategjitë dhe teknikat që ndihmojnë në rregullimin e sjelljes njerëzore dhe për pasojë, çojnë në konformitetin dhe përputhjen me rregullat e shoqërisë, duke përfshirë influencën e familjes, shkollës, moralit, vlerave, besimit, etj.

Problemi që shtrohet është: A garanton ekzistencë paqësore të grupit ekzistenca e rregullave? Cili është ai që garanton/siguron përputhjen me këto rregulla? Autorët e kontrollit social janë të interesuar të mësojnë se përse njerëzit u përshtaten normave, ata pyesin se përse njerëzit përshtaten para kaq shumë tundimeve, presionit të grupit, dhe shtytjeve apo nxitjeve të ndryshme. Të rinjtë dhe adoleshentët përshtaten me ligjin në përgjigje të forcave të caktuara të kontrollit të cilat janë të pranishme në jetën e tyre. Për pasojë, ata pothuajse bëhen kriminelë kur forcat e kontrollit në jetën e tyre prishen apo mungojnë.

Teoricienët e kontrollit social argumentojnë se sa më i përfshirë dhe i angazhuar të jetë një person në aktivitetet konvencionale, aq më e madhe është lidhja me të tjerët (si: familja dhe shoqëria), dhe aq më pak do mundet një person të thyejë rregullat e shoqërisë.

Kontrolli social shpesh shihet si *gjithë-përfshirës*, praktikisht duke përfaqësuar çdo fenomen që çon në konformitet, i cili çon në norma. Të tjerë e shohin kontrollin social

si një përfaqësim të gjerë të mekanizmave rregullatorë të vendosura mbi anëtarët e shoqërisë. Me fjalë të tjera, kontrolli social lidhet me atë se çfarë do konsiderohet devijante, shkeljet e ligjit, të drejta apo të gabuara. Mekanizmat e kontrollit social që mund të adoptohen, janë të tilla si: ligje, norma, doke, etikë dhe zakone, të cilat që të gjitha kontrollojnë dhe si pasojë, të përkufizojnë sjelljen.

Teoria e kontrollit social shihet në dy drejtime. Drejtimi makrosocial, i cili eksploron sistemet e kontrollit formal për kontrollin e grupeve, duke përfshirë sistemin ligjor, ligjet, zbatimin e ligjit, grupet e fuqishme në shoqëri (të cilat mund të ndihmojnë në influencën e ligjeve dhe normave) dhe strategjitë sociale dhe ekonomike të qeverisë apo të organizatave private. Kontrolle të tilla mund të shërbejnë për të qenë si pozitive, ashtu dhe negative.

Nga ana tjetër, drejtimi mikrosocial fokusohet mbi sistemet e kontrollit informal, të cilat ndihmojnë në shpjegimin e asaj se pse individët konformohen. Ai konsideron gjithashtu se burimet e kontrollit duhet të jenë të jashtme, domethënë jashtë personit.

Teoritë e kontrollit të krimit ndryshojnë nga teoritë e tjera kriminologjike. Në vend që të shtrohet pyetja se *çfarë i shtyn njerëzit të kryejnë krime*, ato pyesin se *pse shumica e njerëzve nuk kryejnë krime*. Autorët që mbështesin këto teori në përgjithësi argumentojnë se nuk ka asnjë problem për të shpjeguar se pse njerëzit kryejnë krime përderisa të gjithë qeniet njerëzore vuajnë nga dobësi humane të lindura, të cilat i bëjnë ata të pazotë për t'i rezistuar ngasjeve të ndryshme. Ata fokusohen mbi faktorët e shtrengimit apo “kontrollit” të cilët janë prishur apo mungojnë brenda personaliteteve të delinkuentëve.

Në ndryshim nga teoritë më tradicionale të strukturave sociale, kjo teori thekson se jo të gjithë njerëzit që u nënshtrohen disa kufizimeve strukturore sociale, do të bëhen kriminelë. Prandaj, pyetja kryesore që shtrohet është: çfarë parandalon kriminalitetin?

a) Teoritë më të hershme të kontrollit social argumentonin se delinkuenca ishte rezultat i dështimeve të kontrolleve sociale dhe personale. Problemet me kontrollet personale vinin nga paaftësia apo pazotësia e të rinjve për t'u frenuar nga nevojat e tyre. Një teori tjetër e vinte theksin te fakti se disa të rinj rrezikonin më tepër sesa të tjerët pasi nuk shqetësoheshin se vinin në rrezik të ardhmen e tyre. Autorë të ndryshëm e vunë theksin në atë se sa humbte një person nëse shkelte ligjin. Studimet e ndërmarra u përqendruan në ndryshimet mes zonave urbane dhe periferike në lidhje me delinkuencën e të rinjve.

Në vitin 1958, F. Nye publikoi një studim duke konsideruar **familjen** si burimi i vetëm më kryesor i kontrollit social. Ai theksonte se delinkuentët vinin nga familje ku kishte liri të plotë apo ku nuk kishte fare liri. Lidhja me familjen morri rëndësi në historinë e kontrollit social, sepse ajo konsiderohej e përshtatshme, si një mjet për të shpjeguar si format e kontrollit personal, ashtu dhe ato të kontrollit social.

Gjithashtu, Nye ishte i pari që përdori metodën e vetëraportimit, duke përdorur pyetësorët e ndryshëm për të pyetur delinkuentët se në çfarë lloj veprimtarish ishin përfshirë.

David Matza argumentonte se delinkuentët nuk janë të ndryshëm nga të tjerët. Pjesën më të madhe të kohës ata janë mjaft konvencionalë në besim dhe sjellje, dhe është e vështirë të parashikosh se cili do të konformohet dhe cili jo. Por ka raste kur humb mbajtja e kontrollit, adoleshentët në mënyrë fataliste hyjnë në eksperiencë negative dhe veprojnë sikur ata të mos ishin më moralisht përgjegjës për veprimet e tyre, dhe atëherë ata e gjejnë vetën të liruar nga hyrja dhe dalja nga rruga e delinkuencës.

Matza e shpjegonte sjelljen kriminale si rezultat i përdorimit nga adoleshentët i “technikave të neutralizimit”, gjë e cila nënkuptonte faktin se të rinjtë përdorin metoda për të justifikuar apo shfajësuar veprimet delinkuente. Sipas teorisë së tij, adoleshentët fitojnë liri nga moraliteti konvencional duke përdorur teknikat e neutralizimit. Kjo u jep mundësi të rinjve të hyjnë dhe të dalin nga sjellja delinkuente.

Nëse morali konvencional kontrollon devijancën, atëherë neutralizimi i këtyre besimeve përmes racionalizimit, dobëson kontrollin social. Kjo teori ka pak përkrahje empirike dhe, edhe ai që ekziston, nuk demonstroi shkakësi.

b) Teoritë moderne të kontrollit social

Një nga autorët më të njohur të kësaj shkolle është Travis Hirschi, i cili njihet si një nga përfaqësuesit kryesorë të teorisë të kontrollit social si dhe një nga pionierët e metodës së vetëraportimit.

1) Travis Hirschi, në librin e tij “Shkaqet e delinkuencës”, propozoi një teori kontrolli të pranuar gjerësisht në vitet ’70, të cilën ai e quajti *Teoria e lidhjeve sociale*. Ndryshe nga teoritë e tjera të mëparshme, teoria e Hirschi-t mund të aplikohet për të gjitha format e kriminalitetit. Kjo teori bazohet në supozimin e përgjithshëm se veprimet devijante ndodhin kur lidhjet e një individi me shoqërinë janë të dobëta apo kur ato prishen. Sipas tij, katër janë faktorët që formojnë këtë lidhje me shoqërinë: *lidhja, angazhimi, përfshirja dhe besimi*, formojnë një matricë shumë të gërshetuar ku çdo faktor varet nga tjetri; dobësimi i njërit prej tyre çon në dobësimin e të tjerëve.

Lidhja – kjo u referohet afeksionit, interesit dhe ndjeshmërisë ndaj të tjerëve, se sa të lidhur jemi me njerëzit e tjerë në shoqëri. Kjo kërkon ndjeshmëri ndaj nevojave të personave të tjerë dhe interesim për mirëqenien e tyre. Tre janë komponentët kryesorë në lidhje me këtë faktor, dhe konkretisht: prindërit, shkolla dhe grupi të cilit i përket personi.

Angazhimi i referohet shtrirjes në të cilën një person është angazhuar ndaj formave konvencionale të veprimit. Angazhimi kërkon kohë, energji dhe përpjekje.

Sa më tepër që ne e zhvillojmë këtë angazhim, aq më tepër ne humbasim nëse kryejmë veprime devijante.

Përfshirja i referohet shkallës në të cilën aktivitetet konvencionale zënë kohën tonë, kryesisht koha që zë familja, shkolla dhe zbavitjet. Nëse ne jemi tepër të zënë me aktivitete të tjera, ne jemi të kufizuar ndaj akteve devijante.

Besimet i referohen shkallës me të cilën ne i nënshtrohemi normave dhe vlerave konvencionale, veçanërisht besimi në shtetin e së drejtës (rule of law). Kjo, jo në mënyrë të domosdoshme i referohet një ligji specifik, por një nocioni të përgjithshëm mbi përshtatjen/përputhjen me rregullat e përshkruara të sjelljes. Raporti me sjelljen është i dukshëm.

Sa më pak që të besojmë se duhet të ndjekim rregullat, aq më probabilitet ka që ne t'i thyejmë/shkelim ato.

Këto janë mekanizma të kontrollit social, dhe kur ato dobësohen, atëherë shfaqet sjellja kriminale. Hirschi argumenton se nëse një person është i lidhur me shoqërinë, nuk ka gjasa që ai të shkelë ligjin. Ai person ka shumë për të humbur (për shkak të angazhimit në punë, në familje etj.), ka pak kohë për të shkelur ligjin (për shkak të përfshirjeve në aktivitete legjitime), është i ndjeshëm ndaj ndjenjave të tjerëve për t'i viktimizuar ata (lidhja me shoqërinë), dhe së fundi, ai beson dhe e respekton ligjin, dhe kjo e parandalon që ai të shkelë ligjin.

Elementët e teorisë së lidhjeve sociale të Hirschi-t janë bërë objekt i një vëmendjeje të madhe nga ana e kriminologëve në mbarë botën. Lidhja, p.sh., është marrë parasysh në kërkimet e ndryshme mbi faktorët familjarë; angazhimi në lidhje me komunikimin dhe marrëdhëniet e krijuara brenda grupit social të cilit i përket personi; përfshirja në lidhje me faktorët shkollorë, mënyrat/zakonet e të studiuarit, punën, takimet intime, si dhe me kohën e harxhuar duke parë televizor.

Teoria e vetëkontrollit të ulët (Gottfredson dhe Hirschi)

Më pas Hirschi e la disi këtë teori të lidhjeve dhe së bashku me një autor tjetër Gottfredson, zhvilluan në vitin 1990 një teori të quajtur *Teoria e vetëkontrollit*. Kjo teori pranon se personat me një shkallë të lartë vetëkontrolli do të kenë më pak gjasa të kryejnë veprime kriminale sesa ata që kanë një shkallë të ulët vetëkontrolli, pavarësisht nga rrethanat. Por lidhja midis vetëkontrollit të ulët dhe kriminalitetit nuk është perfekte.

Gottfredson dhe Hirschi (1990) besojnë se teoritë klasike janë teori kontrolli dhe gjithashtu janë teori të përgjithshme. Teoritë e përgjithshme tentojnë të shpjegojnë

llojet e krimeve (të rrugës, të kryera nga femrat, nga të rinjtë) dhe teorikisht ngjarjet ekuivalente me to (zjarret, aksidentet, problemet me trafikun, etj.) Shumica e testeve të teorisë së vetëkontrollit të ulët (VKU) janë testet bazë të teorisë së kontrollit social të Hirschi-t.

Është e rëndësishme të vërehet se teoria VKU bën argumentime individualiste shkakësore, që do të thotë se çdo veprim i sjelljes kriminale është rezultat i faktorëve unikë individualë, të tillë si: **tiparet**, të cilat janë karakteristika të personalitetit të qëndrueshëm gjysmë-të përhershme.

Individët nxjerrin në pah tre grupe tiparesh: (1) tipare që prodhojnë vetëkontroll të ulët, (2) tipare që paracaktojnë përfshirje në krim; (3) tipare të tjera që janë rezultat i shoqërizimit. Tiparet e VKU shfaqen në gjashtë apo tetë vitet e para të jetës dhe përfshijnë vetëm “faktorë që ndikojnë në llogaritjen e pasojave të veprimeve të një individi”. Grupi i dytë i tipareve përfshin inteligjencën e ulët, nivel të lartë aktiviteti, fuqi/forcë fizike dhe aventurizmin. Grupi i tretë i tipareve përfshin impulsivitetin, intensitetin, dhe paaftësinë për të vonuar/shtyrë kënaqësinë.

Faktorët e teorisë së VKU-s, mund të jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelë si më poshtë:

Tiparet e VKU-s:	Jolargpamës, paaftësi për të përfituar, gjykim i dobët, llogaritje e gabuar e dhimbjes
Tiparet parashikuese:	Aventurizmi, inteligjenca e ulët, nivel i lartë aktiviteti, forcë fizike
Tipare të shoqërizimit:	Impulsiviteti, pandjeshmëria, kënaqësi e menjëhershme
Tipare të tjera:	Sharmi, zemërgjerësia, disiplina

Pjesa më e kritikueshme dhe më e dobët e teorisë VKU është *modeli i oportunitetit*. Oportunitetet janë marrë si të dhëna dhe të trajtuara si shkaqe të largëta. Nuk bëhet asnjë llogaritje e oportuniteteve. Oportunitetet shihen si të ndërveprueshme dhe të shumta. Mundësia për të shmangur zgjedhjen e krimit është një çështje psikologjike, e ndryshueshme, ndërsa kënaqësitë vazhdimisht rrethojnë individin. Ky trajtim i vendimmarrjes individuale në mënyrë të suksesshme transformon motivet kriminale në strategji që reduktojnë dhimbjen për individin.

Hirsch-i nuk ofron asnjë shpjegim se pse kjo teori e vë theksin te një kontroll i brendshëm dhe nuk nënvizon kontrollin e jashtëm. Kërkuesit që tentojnë të vlerësojnë

teoritë e ndryshme të kontrollit, kanë hasur në mënyrë të dukshme probleme të pazgjidhshme tautologjike (përsëritjeje). Vlefshmëria empirike e këtyre teorive ka mbetur relativisht e patestuar.

Teoria e zgjedhjes racionale

Në një shtrirje të gjerë, studimet sociologjike të kontrollit social kanë ndodhur në nivelin makrosociologjik - influenca e qeverisë, sistemet ekonomike dhe grupet e fuqishme, në krijimin dhe mbajtjen e sistemeve të kontrollit formal. Megjithatë, vetë teoria e kontrollit më tepër ka qenë e lidhur me ekzaminimin e konsideratave mikrosociologjike të sistemeve të kontrollit informal. Këto kontrolle sociale informale janë interesante pasi ato shihen si të afta për të parandaluar që njerëzit të kryejnë krime pavarësisht nga fakti se ata e kanë të mundur ta bëjnë një gjë të tillë.

Teoria e zgjedhjes racionale. Pranohet se njerëzit motivohen nga paratë dhe mundësia e nxjerrjes së përfitimeve, dhe kjo ka lejuar ndërtimin e modeleve formale e shpesh parashikuese të sjelljes njerëzore. Përfaqësuesit e rrymave sociale janë përpjekur të ndërtojnë teori rreth idesë se të gjitha veprimet janë thellësisht “racionale” në karakter dhe se njerëzit llogarisin kostot dhe përfitimet e çdo veprimi para sesa të vendosin se çfarë do të bëjnë. Kjo njihet si *teoria e zgjedhjes racionale*, dhe aplikimi i saj në ndërveprimin social merr formën e *teorisë së shkëmbimit*.

Argumentohet se të gjitha veprimet sociale, mund të shihen si të motivuara racionalisht, si veprime instrumentale, ndonëse shpesh mund të duket se është joracionale.

Teoria e zgjedhjes racionale ndonëse është një teori që lidhet dukshëm me atë se si sjellja e individëve kanalizohet në drejtime specifike, tenton të shpjegojë krimin si një produkt të një konsiderate racionale individuale të pasojave fizike të veprimeve të tyre. Ndoshta, një konsideratë e dobishme këtu do të ishte dallimi që bën Maks Ueber (Max Weber) midis veprimit racional në ndjekje të një besimi dhe veprimit racional në ndjekje të një qëllimi. Kështu, veprimi konsiderohet i ndikuar nga kontrollet sociale informale, kryesisht lidhjet tona me të tjerët dhe besimet tona rreth sjelljes së moralshme.

Teoria e zgjedhjes racionale është më tepër e lidhur me veprimin që ndikohet nga qëllimet dhe ku moraliteti i jep rrugë praktikitetit. Teoria e zgjedhjes racionale adopton një pozicion individualist metodologjik dhe synon të shpjegojë të gjitha fenomenet sociale në kushtet e llogaritjeve racionale të bëra nga vetë individët e interesuar. Kjo teori e sheh ndërveprimin social si një shkëmbim social të modeluar mbi veprimin ekonomik. Njerëzit janë të motivuar nga çmimet dhe kostot e veprimeve dhe nga përfitimet që ata mund të kenë.

Disa autorë e kanë parë racionalitetin si një pasojë të kushteve psikologjike. Të tjerë kanë adoptuar pozicionin që kjo është thjesht e nevojshme për të pranuar se individët veprojnë sikur ata të ishin tërësisht racionalë.

Problemi i veprimit kolektiv nxjerr vështirësi të mëdha për teorinë e zgjedhjeve racionale, e cila nuk mund të shpjegojë përse individët bashkohen në mjaft lloje grupesh dhe shoqatash. Problemi i normave sociale, po kështu evidenton vështirësi. Autorët e kësaj teorie nuk mund të shpjegojnë origjinat e normave sociale, veçanërisht ato të altruizmit, reciprocitetit dhe besimit.

Problemi i strukturave sociale është një tipar i individualizmit metodologjik, më tepër sesa vetë teoria e zgjedhjes racionale, por ajo krijon vështirësi për teoritë që e marrin në konsideratë. Zgjidhjet për këtë problem janë parë në termat e pasojave të paqëllimshme të veprimit individual.

Vlerësimi dhe rëndësia e teorisë së kontrollit social

Teoritë e kontrollit kanë marrë një rëndësi praktike gjithnjë në rritje në lidhje me trajtimin dhe shpjegimin që i bëjnë sjelljes kriminale dhe mjeteve që e parandalojnë atë. Nga kërkimet e ndryshme të deritanishme në lidhje me aplikimin e teorisë së kontrollit social, nxirren këto përfundime:

- Angazhimet dhe lidhjet janë elementët më me influencë të teorisë së lidhjeve sociale,
- Njerëzit me pak ose aspak angazhime, apo lidhje mund të injorojnë “kostot” potenciale të veprimeve devijante,
- Devijanca mund të kuptohet më së miri në kushtet dhe termat e një procesi zhvillimi të lidhjeve për t’u konformuar me personat dhe stilet e jetesës së tyre,
- Edhe midis lidhjeve më të forta, teknikat e neutralizimit përdoren për të justifikuar veprimet devijante.

Nisur nga përhapja dhe rëndësia praktike e tyre, mbi bazën e arritjeve dhe përfundimeve të këtyre teorisë, mjaft vende kanë hartuar politika publike të cilat në vija të përgjithshme konsistojnë në:

- Programe për të asistuar prindërit në socializimin e duhur të fëmijëve të tyre,
- Programe për të asistuar familjet për të zhvilluar lidhje më të forta midis prindërve dhe fëmijëve,
- Programe për të asistuar të rinjtë në zhvillimin e angazhimeve më të forta

me linjat konvencionale të sjelljes,

- Programe për të asistuar të rinjtë në vlerësimin e kostove dhe përfitimeve në lidhje me veprimet devijante që ata kryejnë.

Pyetje për diskutim

1. Çfarë vlere mendoni se kanë teoritë psikologjike për punonjësit e shërbimit të provës nga pikëpamja praktike? Po ato sociologjike?
2. Cilat janë avantazhet e teorive të kontrollit social në shpjegimin e kriminalitetit dhe shkaqeve të tij në shoqëri?
3. Si do ta vlerësonit ju zbatimin praktik të teorive të kontrollit social në aspektin e politikave për parandalimin e kriminalitetit dhe të politikave publike?
4. Sa nga këto përjasje mendoni se kanë gjetur/gjejnë zbatim në praktikën tonë? Cila prej tyre mendoni se mund të konsiderohet në kushtet tona?

5. NJOHURI KRIMINOLOGJIKE PËR PUNONJËSIN E SHËRBIMIT TË PROVËS

Studimi i karrierës kriminale

5.2

Migena Leskoviku

Mësimi i aftësive të nevojshme për të kryer një vepër penale është një faktor që duhet marrë në konsideratë. Këto aftësi mund të mësohen nga kultura e përgjithshme, nga media, nga autorë të tjerë veprash penale ose nga jo-autorë të cilët shfaqin vlera që mund të çojnë në kryerjen e një veprë penale. Disa autorë përdorin aftësitë e specializuara që mund të kenë mësuar për të kryer një vepër penale. Skema konceptuale që ndërtojmë mund të na ndihmojë për të kuptuar arsyet përse njerëzit kryejnë vepra penale. Kur me kalimin e kohës akumulohen disa vepra penale individuale njëra pas tjetrës kemi të bëjmë me një **karrierë kriminale** – një sekuencë veprash penale që mund ta shtyjnë autorin e tyre të ndryshojë konceptin që ka për veten, qëndrimin dhe përkushtimin ndaj një jete kriminale. Për të kuptuar një qëndrim kriminal duhet të kemi njohuri të faktorëve që shkaktojnë apo nxisin kryerjen e veprave penale, si dhe informacion të detajuar mbi mënyrën sesi këto vepra shtohen dhe çojnë në një karrierë kriminale.

Duhet gjithashtu të kemi parasysh konceptin e *karrierës kriminale* dhe paradigmen studimore “*krimineli i karrierës*”, si dhe teoritë që përpiqen të shpjegojnë kriminalitetin gjatë gjithë jetës. Modeli i karrierës kriminale studion problemin e të kuptuarit të natyrës së krimit, duke u fokusuar në aktivitetet e individëve që kryejnë vepra penale më tepër sesa të përqendrohemi në shembuj të sjelljes kriminale. Ky model nuk trajton raste të izoluar apo një individ, por përpiqet të kuptojë llojet e sjelljes anti-shoqërore, delinkuencës, devijancës, dhe kriminalitetit që ndryshojnë gjatë gjithë jetës. Studimi i kryer në këtë fushë fokusohet në çështje që lidhen me dimensionet specifike të ndryshimit, si p.sh., procesi i marrjes së iniciativës, vazhdimet dhe largimit nga krimi.

Ne mund ta studiojmë karrierën kriminale nëpërmjet studimit të jetës dhe aktivitetit të autorit të veprës penale. Kjo gjë do të na mundësojë të njohim më shumë rreth anës subjektive dhe eksperiencave të individëve të caktuar, pavarësisht se këto raste nuk mund të përgjithësohen dhe nuk përfaqësojnë të gjithë llojet e kriminelëve. Prandaj, sot ndërmjet kriminologëve, diskutohet rreth rëndësisë së kërkimeve dhe studimeve mbi karrierën kriminale. Ata që e mbështesin kryerjen e këtyre studimeve mbështeten në idenë faktorë të ndryshëm mund të shpjegojnë sjelljen kriminale, vazhdimësinë e saj në kohë, si dhe shmangien nga kjo sjellje. Për shembull, mungesa e punës, mund ta shtyjë një person në krim, por nëse ky person më vonë mund të gjejë punë gjatë karrierës së tij kriminale, nuk do të thotë se ky person ka hequr dorë nga rruga e krimit.

Ata studiues që mbajnë një qëndrim të kundërt, argumentojnë se studimit të karrierës kriminale nuk duhet t'i kushtohet shumë vëmendje, pasi tendenca për t'u përfshirë në krim ndryshon gjatë ciklit të jetës, dhe për pasojë, sjellja kriminale në një kohë të caktuar, është e lidhur ngushtë me sjelljen kriminale në një periudhë tjetër kohore. Mbështetësit e këtij qëndrimi theksojnë se autorët e veprave penale as nuk specializohen dhe as nuk kryejnë më shumë vepra penale me kalimin e kohës. Si kundërpërgjigje, kriminologët që mbështesin studimet mbi karrierën kriminale, argumentojnë se disa individë kanë një karrierë të gjatë në kryerjen e veprave penale, dhe se ata ndryshojnë mes tyre dhe me kalimin e kohës, edhe në shpeshhtësinë me të cilën ata përfshihen në krim.

Vrasësit serialë janë bërë objekt studimi në SH.B.A. por dhe në vende të tjera të botës. Nga studimet ka rezultuar se ata kanë krijuar një karrierë kriminale, ku ata vrasin në periudha kohore të ndryshme.

Një prej tyre, A.C. kishte vrarë 52 persona në 12 vjet, ndër të cilët 21 djem, 14 vajza dhe 17 gra të reja. Ai kishte punuar si mësues dhe ishte i martuar dhe kishte dy fëmijë. Për 12 vjet kishte kryer vepra të ndryshme penale, si: vrasje, përdhunime, kishte keqtrajtuar dhe kanibalizuar viktimat e tij. Ai ishte pushuar nga puna, pasi kishte ngacmuar seksualisht disa fëmijë. Me kalimin e kohës, krimet e tij u bënë më sadiste. Viktimat e tij ishin kryesisht persona vulnerabël dhe krimet i kryente në zona të izoluar. Edhe kur u arrestua dhe dënua, ai nuk tregoi pendesë.

Analiza e karrierës kriminale kërkon vëmendje ndaj kushteve sociale që influencojnë zhvillimin e aktivitetit kriminal. Etiketimi nga ana e sistemit të drejtësisë penale, mund të ndikojë shanset e jetës së individit, dhe për rrjedhojë të ndikojë edhe në sjelljen e tij kriminale. Karriera kriminale varet nga faktorët që përcaktojnë mobilitetin nga një sjellje kriminale në tjetrën, apo nga një krim në tjetrin. P.sh., në krimin profesional dhe të organizuar kryesisht përfshihen meshkujt, ndërsa femrat janë më pak të përfshira në grupet kriminale, dhe në mundësinë e tyre për të mësuar shprehi apo aftësi kriminale. Sipas disa autorëve, roli i femrës në shoqëri

dhe mbikëqyrja prindërore ndaj femrës dhe mashkullit, janë elementë që kufizojnë përfshirjen e femrës në karrierën kriminale. Sipas disa studimeve të kryera, rezulton se individët që kanë një lidhje afektive, bashkëjetojnë apo janë të martuar, si dhe ata që kanë një punë të qëndrueshme dhe lidhje të forta sociale, kanë më pak gjasa që të hyjnë në rrugën e krimit dhe të bëhen recidivistë.

Njohja e karrierës kriminale ka edhe vlera praktike. Nëse ne kuptojmë se pse disa individë përfshihen në një jetë kriminale, atëherë ne mund të jemi në gjendje të hartojmë dhe zbatojmë politika që na ndihmojnë të parandalojmë zhvillimin e karrierës kriminale. Nga ana tjetër, nëse ne arrijmë të kuptojmë se përse disa kriminelë të karrierës “tërhiqen” nga rruga e krimit, atëherë mund të jemi në gjendje të hartojmë programe që mundësojnë daljen e tyre nga rruga e krimit. Gjithashtu, ndëshkimi dhe trajtimi i kriminelëve të karrierës, mund të ketë ndikim në përqindjen dhe shkallën e kriminalitetit në vend. Për këto arsye, në mjaft vende janë hartuar programe të karrierës kriminale, për të përqendruar burimet e sistemit të drejtësisë penale mbi të dënuarit që kryejnë vepra penale në mënyrë të përsëritur (recidivistët).

Eksperienca që mund të kenë individët me sistemin e tyre të drejtësisë penale, mund të kontribuojë në karrierën kriminale duke shkaktuar mungesë optimizmi apo duke mbyllur mundësi punësimi për ta. Por megjithatë, recidivistët mund të kryejnë më shumë vepra penale nëse nuk arrestohen dhe dënohen, pasi ideja se janë të suksesshëm në krim, mund të përforcojë tek ata sjelljen kriminale, duke nxjerrë përfitime prej saj.

Tipologjia e karrierës kriminale dhe ndëshkimi

Një mënyrë për të analizuar karrierën kriminale është të ndërtohet një *tipologji* që do të thotë një tërësi kategorish autorësh dhe modelet e tyre të aktivitetit kriminal. Një tipologji e “karrierës kriminale” ka ardhur nga informacioni që rrjedh nga vepra penale, fakti nëse individ i ka vepruar i vetëm apo në bashkëpunim, konceptet dhe qëndrimi i autorit të veprës penale, dhe modeli i krimit në jetën e tij. Gjithashtu, këtu mbahet parasysh edhe shtresa sociale në të cilën bën pjesë individ, familja, shoqërimi me shokët apo kolegët, si dhe kontaktet e tij me institucionet e zbatimit të ligjit.

Tipologjia e karrierës kriminale përfshin kategori të tilla si: “vjedhësit profesionistë”, “falsifikuesit”, “autorët e krimeve seksuale”, “grabitësit”, “autorët e veprave penale në fushën e pasurisë dhe pronës”, “trafikanët e drogës”, etj.

Një mënyrë tjetër kategorizimi, lidhet me kombinimet specifike të veprave penale që ata kryejnë, p.sh., një person vrasës mund të jetë edhe përdhunues, ose grabitës dhe trafikant droge.

Sistemi ndëshkimor synon të hartojë programe që të mundësojnë rehabilitimin e këtyre të dënuarve. E thënë ndryshe, burgjet shihen si vende ku të dënuarit mund të mësojnë të “sillen mirë” në shoqëri. Por parashikimi është larg asaj që arrihet. Në burgje, të dënuarit mësojnë një mënyrë jetese të kundërt nga ajo që u nevojitet për t’u shkëputur nga karriera kriminale. Kështu, në burg të dënuarit varen nga personeli i burgut për plotësimin e nevojave të tyre materiale, ndërkohë që pas lirimit ata duhet të mbështeten tek vetvetja për plotësimin e këtyre nevojave. Në burg koha e tyre është e strukturuar sipas një programi të caktuar, ndërsa pas lirimit ata duhet të mësojnë se si ta strukturjnë kohën e tyre për të mos u rikthyer në rrugën e krimit. Në burg jeta është më e thjeshtë, pasi të dënuarit nuk mendojnë shumë për të ardhmen e tyre, por jashtë burgut ata duhet të kenë dhe të krijojnë qëllime për veten dhe të ardhmen e tyre.

Sipas disa studiuesve, burgu gjithsesi ofron disa rezultate pozitive. Kur ndodhet jashtë burgut, personi i liruar mund të tërhiqet nga mënyra e jetesës që e përfshin atë në krim, por nga ana tjetër qëndrojnë rreziqet fizike dhe ideja se mund të kthehet sërish në burg. Ajo që sipas disa studiuesve ka rëndësi dhe është kritike, janë javët e para pas lirimit nga burgu. Gjatë kësaj kohe, personi ndihet si i huaj, dhe mund të ekzistojë rreziku që personi t’i rikthehet jetës kriminale.

Ajo që theksohet për karrierën kriminale, lidhet me faktin se sa më e gjatë të ketë qenë periudha e përfshirjes së personit në të shkuarën në krim dhe sa më e gjatë të ketë qenë karriera kriminale e tij, aq më e vështirë do të jetë dhe aq më pak shanse ka që personi të largohet nga rruga e krimit.

Shpesh këta persona krijojnë këtë karrierë kriminale, për shkak të subkulturës dhe grupit ku bëjnë pjesë, apo për shkak të punës që kryejnë.

Me kalimin e kohës, këta persona përjetojnë si ndryshime ndërpersonale ashtu edhe ndryshime në orientimin e tyre në jetë. Këto ndryshime në orientimin e individit përfshijnë katër elementë:

1. *Një perspektivë e re për veten.* Individët bëhen më kritikë ndaj sjelljes së tyre në të kaluarën dhe vlerësimit që i bëjnë sjelljes së tyre kur ishin më të rinj në moshë.
2. *Rritja e ndërgjegjësimit me kalimin e kohës.* Autorët e veprave penale fillojnë të mendojnë e planifikojnë se çfarë do të bëjnë pjesën tjetër të jetës dhe ndonjëherë kjo lidhet me frikën se mund të qëndrojnë shumë kohë në burg, apo mund të vdesin aty.
3. *Ndryshimi i aspiratave dhe qëllimeve.* Këta persona bëhen më të prirur ndaj krijimit të marrëdhënieve të mira me të tjerët, i kushtojnë rëndësi gjetjes së një pune të ligjshme dhe krijimit të një jete paqësore.
4. *Lodhja.* Disa nga këta kriminelë mund të kenë frikë nga të dënuarit e tjerë, apo mund të ndodhë që të kuptojnë se nuk shpëtojnë dot nga drejtësia penale.

Sipas këtij modeli, është i rëndësishëm edhe ndryshimi në marrëdhëniet ndërpersonale, ku ky ndryshim përfshin dy elementë:

1. *Lidhja me një person tjetër.* Disa nga këta kriminelë, fillojnë të shfaqin interes për të patur një marrëdhënie të mirë intime, apo me anëtarët e familjes.
2. *Lidhja me një aktivitet të caktuar.* Kjo nënkupton gjetjen e një pune të kënaqshme, që sjell të mira materiale dhe që gjithashtu përforcon identitetin e tyre jokriminal, pasi puna zë një pjesë të mirë të kohës së tyre.

Koncepti i karrierës kriminale merr rëndësi të veçantë kur flasim për të miturit. Disa studime kanë treguar se të miturit dhe të rinjtë që kanë pasur kontakte me drejtësinë penale, sidomos me policinë, kanë më tepër probabilitet të krijojnë një karrierë kriminale kur rriten me kalimin e kohës, sesa personat që në fëmijërinë dhe rininë e tyre nuk kanë pasur probleme me drejtësinë penale. Gjithsesi, studimet janë nga më të ndryshmet dhe po ashtu edhe përfundimet e arritura. Ajo që theksohet është fakti se studiuesit nuk kanë arritur përfundime bindëse nëse raporti mes karrierës kriminale të të rriturve dhe të të miturve është rezultat i etiketimit, i vazhdimësisë në kohë të sjelljes kriminale, apo një kombinim i të dyjave.

Tipologjitë ndihmojnë dhe mund të jenë të dobishme për zhvillimin e teorive që shpjegojnë modelet e ndryshme të sjelljes kriminale, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e metodave të trajtimit efektiv ndaj tyre. Kjo është arsyeja që në kriminologji ato zënë vend të veçantë dhe janë objekt studimesh dhe debatesh të ndryshme. Njohja e këtyre tipologjive dhe e karakteristikave të karrierës kriminale, do të jetë me interes edhe për punën e punonjësit të shërbimit të provës, në komunikimin, njohjen, analizën e faktorëve kriminogjenë si dhe në hartimin e raporteve për ta.

Pyetje dhe çështje për diskutim

1. Çfarë kuptoni me karrierë kriminale dhe çfarë ndikimi mund të ketë ajo për individin?
2. Cilët janë disa nga faktorët që mendoni se ndikojnë në krijimin dhe zhvillimin e karrierës kriminale? Si mund të parandalohen ata?
3. Çfarë kuptoni me tipologji të karrierës kriminale? Cila është shkalla e recidivizmit në Shqipëri? Diskutoni për të.
4. Cili është roli i sistemit ndëshkues në karrierën kriminale? Cila është gjendja në Shqipëri dhe si mendoni se ka ndikuar sistemi shqiptar i ndëshkimit në këtë drejtim?

6. METODAT E PUNËS ME TË DËNUARIT

Vlerat, parimet dhe aftësitë profesionale në shërbimin e provës

6.1

Sorina Poledna

Shpjegim konceptual

Kur flasim për drejtësinë mendojnë drejtpërdrejtë për vlerat. Fjala “drejtësi” i referohet aksiologjisë për sa kohë që kur themi “drejtësi” kemi në mendje të vërtetën, barazinë, etj. Për më tepër, drejtësia përfshin një horizont të tërë vlerash: drejtohet nga disa vlera dhe kërkon zbatimin e tyre dhe së fundi, por jo më e parëndësishmja, ka lidhje me disa konotacione vlerash: drejtësi për të gjithë, siguri e qytetarëve dhe komunitetit, humanizmi.

Sipas A. Pincus-it dhe A. Minahan-it (1973) “vlera” do të thotë besime, preferenca ose supozime mbi atë çfarë është e dëshirueshme ose e mirë për njerëzit. Një shembull është besimi se shoqëria duhet të ndihmojë çdo individ për të përmbushur plotësisht potencialin e tij/saj. Këto nuk janë pohime që tregojnë si është bota apo të njohurisë që ne kemi për botën, por sesi duhet të jetë ajo. Kështu që, konceptet që kanë përmbajtje vlerash nuk mund të jenë temë e një analize shkencore. Mund të themi që një vlerë është e mirë ose e keqe kur lidhet me një sistem të caktuar besimesh ose me një kod etik që përdoret si standard (Zastrow, Ch., 1993, fq. 60). Një kod etike i një profesioni të caktuar, si p.sh., ai i shërbimit të provës, bazohet në vlerat e atij profesioni, dhe aspektet etike e të vlerave kushtëzohen bashkërisht pa u ngatërruar: vlerat janë besime që drejtojnë sjelljen tonë, dhe dimensionin etik përfshin zbatimin e vlerave me qëllim për të parashtruar fakte në lidhje me atë

çfarë në sistemin profesional konsiderohet i dëshirueshëm. Etika është një çështje që fokusohet në kategoritë e sistemit të vlerave, normave dhe moralit, ku e drejta dhe e gabuara janë kategoritë bazë. Nga ana tjetër, etika ndryshon nga morali që është një tërësi formulimesh normative. Etika profesionale ka lidhje me detyrimet e ekspertëve të këtij profesioni kundrejt ekspertëve të profesioneve të tjera, klientëve dhe publikut, dhe formohet nga një tërësi detyrimesh që këta ekspertë pranojnë si pjesë të statusit të tyre profesional dhe nga pozicioni që marrin.

Kodi deontologjik i stafit të shërbimit të provës përfshin një sërë rregullash në lidhje me përgjegjësitë etike të punonjësit të shërbimit të provës ndaj kolegëve të tij/saj, të dënuarve të mbikëqyrur, profesionistëve të tjerë, institucioneve dhe organizatave të tjera, dhe ndaj vetë profesionit. Me fjalë të tjera, kodi është një udhëzues për sjelljen profesionale të punonjësve të shërbimit të provës i cili tregon standardet e sjelljes dhe qëndrimin profesional.

Parimi është dimension/aspekti normativ i vlerës. Pra, mund të flasim për një parim etik në fushën e shërbimit të provës që rregullon, nga një pikëpamje etike, sjelljet dhe ndërveprimet e pjesëmarrësve.

Për shembull, në Rumani Kodi Deontologjik rregullon standardet e sjelljes profesionale të personelit të shërbimit të provës për të siguruar që të jetë në përputhje me nderin dhe dinjitetin e profesionit (sipas nenit 2 të Kodit Deontologjik për Stafin e Shërbimit të Provës në Rumani).

Njëkohshmëria e detyrimeve etike mund të përcaktojë, të paktën teorikisht, shfaqjen e konflikteve ndërmjet këtyre detyrimeve dhe mund të shkaktojë dilema etike. Ka situata kur punonjësi i shërbimit të provës nuk mund të përmbushë në mënyrë të njëkohshme detyrimet e veta etike ndaj dy palëve/sistemeve të ndryshme me të cilat bashkëvepron, pa shkelur parimet etike ndaj njëres nga këto palë.

Si rezultat, vlera ka kuptimin e diçkaje të brendshme, të çmuar dhe të dëshirueshme. Vlerat përfshihen brenda një kornize më të gjerë kulturore dhe me anë të raportit të ndryshëm vlerë-premisa tashmë ekzistojnë edhe në shoqëri, jo vetëm në shërbimin e provës. Shërbimi i provës, puna sociale, psikologjia si dhe profesione të tjera zgjedhin nga kjo shumëllojshmëri vlerash-premisash ato që u përshtaten qëllimit të tyre. Kështu që, tema e vlerave në fushën e shërbimit të provës është e rëndësishme por edhe delikate. Vlerat duhen përfshirë në analizën e problemeve, njësoj si lidhja midis autoritetit dhe pushtetit, ose në analizën e diskriminimit. Kjo është një temë e rëndësishme sepse trajton problemet bazë për të cilat kuptimi i shërbimit të provës është: lidhja midis ndëshkimit/mbikëqyrjes, - asistencës/rehabilitimit – kompetencave profesionale dhe dilemave etike që mund të lindin kur vlerat zbatohen në aktivitetet specifike të shërbimit të provës.

Megjithatë, shpesh herë edhe përkufizimi i vetë shërbimit të provës si pjesë e sistemit të drejtësisë penale është bërë duke u bazuar në perspektivën e vlerave që orientojnë aktivitetin e shërbimit të provës: respekti për njerëzit, vlerat njerëzore, integriteti dhe jeta private, barazia, mendjegjerësia dhe përgjegjshmëria, parimi i ndërhyrjes minimale, parimi i normalizimit, parimi i ndërhyrjes së duhur, parimi i një ndërhyrjeje të vazhdueshme, përpjekjet për bashkëpunim me organizata të tjera (Haines, K., Durnescu, I., Edit. 2000, fq. 60). Ndërgjegjësimi dhe rëndësia e analizës së modaliteteve të zbatimit të vlerave në aktivitetet e shërbimit të provës duken se janë një kusht i domosdoshëm për të kuptuar qëllimin e funksionit të punonjësit të shërbimit të provës. Marrim përsëri një shembull nga Rumania: në këtë vend qëllimi i shërbimit të provës vendoset nga legjislacioni si: “(...) rritja e nivelit të sigurisë publike duke informuar dhe këshilluar viktimat e krimit, duke nxitur përdorimin e masave alternative ndaj dënimit me burgim, duke parandaluar krimin, duke zvogëluar mundësinë për recidivizëm dhe nëpërmjet riintegritit social të atyre personave që kanë kryer një vepër penale” (neni 6 i ligjit për shërbimit të provës në Rumani).

Zbatimi i vlerave

I. Respekti për veçantinë, individualitetin dhe dinjitetin e individit

Çdo praktikë profesionale që është aktive në një mikro-nivel social përcaktohet nga disa koncepte bazë, siç është respekti për çdo person. Ky koncept e tejkalon rolin, statusin, madje dhe sjelljen e një individi. Për profesionistët, duke përfshirë edhe ata që punojnë në shërbimin e provës do të thotë që e njëjta konsideratë dhe qëndrim profesional do të zbatohet ndaj çdo individi. Është një praktikë jo-diskriminuese që shpjegon vendin që zë vlera e respektit për veçantinë, individualitetin dhe dinjitetin e një personi brenda gamës së vlerave që drejtojnë shërbimin e provës. Njëkohësisht, tregon edhe faktin që individualizimi dhe vetëvendosmëria mund të konsiderohen si thjesht një ndryshim theksi brenda të njëjtit koncept vlerash.

Por si aplikohet në realitet premisa që çdo individ është unik dhe ka të drejtën të trajtohet me respekt dhe dinjitet? Përgjigja e kësaj pyetjeje përfshin mundësinë për zbatimin në praktikë të premisave të vlerave, bazuar mbi: 1) vëmendjen ndaj dhe vlerësimin e çdo aspekti që mund të shprehë veçantinë dhe vlerën e brendshme të çdo individi, gjithçka që përkufizon dhe përcakton kufijtë e specifikimit të tij, 2) përcaktimin e shkallës deri ku procedurat e klasifikimit, të pranishme në praktikën e shërbimit të provës, kufizojnë mundësinë e individualizimit.

Specialistë nga fusha e psikologjisë sociale deklarojnë që vetë-imazhi i njerëzve formohet kryesisht si rezultat i komunikimit me njerëz të tjerë. Njerëzit krijojnë dhe personalizojnë imazhin për veten e tyre nëpërmjet mesazheve që marrin nga njerëzit e tjerë në lidhje me ta. Si rezultat, njerëzit kanë besim tek vetja, mendojnë se janë

individë të vlerësuar, njohin kapacitetin dhe pushtetin e tyre, kanë tendencën për të qenë më të lumtur dhe janë në gjendje të përballen me ambientin e tyre në një mënyrë të përshtatshme dhe konstruktive. Duke u mbështetur në këto fakte, punonjësit social dhe ata të shërbimit të provës mësohen që të tregohen të ndjeshëm/kujdesshëm ndaj mesazheve që u përcjellin të tjerëve në lidhje me vlerat e tyre. Kjo mund të arrihet duke dëgjuar me kujdes personin e mbikëqyrur, duke kuptuar këndvështrimin e tij/saj pa e paragjykuar, duke e vlerësuar saktë nëpërmjet identifikimit individual të nevojave kriminogjene dhe njëkohësisht të burimeve. Në këtë mënyrë, punonjësi i shërbimit të provës mund të transmetojë qartë mesazhin se tregon respekt për këtë individ dhe se e trajton atë me dinjitet pavarësisht se nuk është dakord me sjelljen e tij/saj kriminale.

Ka edhe një problem tjetër që lidhet me zbatimin e vlerave të veçantisë, individualitetit dhe dinjitetit të një personi. Nga njëra anë, punonjësi i shërbimit të provës duhet të ruajë balancën, të klasifikojë dhe nxjerrë konkluzione nga vlerësimi dhe, nga ana tjetër, duhet t'i përgjigjet këtij personi në mënyrë individuale. Në këtë rast, klasifikimi ka lidhje me nevojën për të përgjithësuar informacionin, për ta organizuar sipas karakteristikave të përbashkëta dhe për ta përfshirë në kategori, të paktën për të dhënë një imazh të përgjithshëm për një sasi të caktuar informacioni. Kjo ka rëndësi në formulimin e raportit për gjykatën. Në këtë situatë diskutohet aftësia e punonjësit të shërbimit të provës për të gjetur formulimin e duhur të informacionit, për të përshtatur nevojën për nxjerrjen e konkluzioneve nëpërmjet një diagnoze sociale dhe për të bërë vlerësim individual.

Të mos harrojmë që të gjithë subjektet e aktivitetit të shërbimit të provës klasifikohen që nga fillimi. Ato përfshihen në një kategori specifike, një kategori personash ndaj të cilëve është krijuar një reagim zyrtar social si rrjedhojë e një vepre penale të kryer prej tyre, që ndryshe mund të quhet një etiketim.

Siç tregohet në literaturën që trajton temën e etiketimit, në shumicën e rasteve një person i etiketuar si kriminel e mbart këtë vulë dhe madje komuniteti rreth tij shpesh e sheh sipas këtij etiketimi dhe jo sipas karakteristikave të tij personale. Ky fakt i krijon personit të etiketuar kushtet për të vepruar si një i tillë dhe ndikon drejtpërdrejtë në mundësinë për t'u larguar nga krimi dhe për t'u ri-integruar në shoqëri, kryesisht në rastet e burgimit por edhe në ato raste që janë nën kujdesin e shërbimit të provës.

Ky vështrim i përgjithshëm i këtyre aspekteve na mundëson përsëri të shohim rëndësinë e zbatimit të vlerave të veçantisë, individualitetit dhe dinjitetit personal që konsiderohen si një mënyrë për të reduktuar efektet negative të dënimeve (etiketimi dhe stigmatizimi).

Punonjësi i shërbimit të provës e trajton personin e mbikëqyrur duke zbatuar këtë vlerë sipas tre orientimeve kryesore:

- 1) Personi i mbikëqyrur është një individ i veçantë sepse:
 - ☐ Është fizikisht unik: konstrukti trupor, aftësitë fizike, kapaciteti intelektual, metabolizmi, etj.
 - ☐ Është emocionalisht unik;
 - ☐ Ka një pozicion të caktuar në një rrjet unik rolesh sociale dhe lidhesh me familjen, fqinjët, shkollën, punën, aktivitetet e kohës së lirë;
 - ☐ Është unik në lidhje me traumat – askush tjetër nuk ka kaluar të njëjtën eksperiencë me të njëjtin kombinim ngjarjesh (sëmundje, aksidente, vdekje të një familjari apo miku, etj.);
 - ☐ Është unik për shkak të problemeve me të cilat është përballur – përjetimi i tyre është i veçantë – dhe ky mund të jetë problem edhe për njerëz të tjerë;
 - ☐ Ka një ekzistencë unike.
- 2) Individualizimi i përqasjes është një detyrë profesionale e punonjësit të shërbimit të provës.
- 3) Pranimi i veçantisë së një individi është kusht i individualizimit dhe argument për të respektuar dinjitetin dhe vlerën personale të çdo qenieje njerëzore.

Një marrëdhënie e individualizuar me çdo person nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës është thelbësore për:

- ☐ Të përmbushur qëllimin e raportit të vlerësimit, që është individualizimi i dënimit;
- ☐ Marrëdhënien profesionale ndërmjet personit të mbikëqyrur dhe punonjësit të shërbimit të provës;
- ☐ Vlerësimin e nevojave kriminogjene, të faktorëve të rrezikut dhe atyre mbrojtës për të vlerësuar rrezikun e recidivizmit, të rrezikut të komunitetit dhe vetëndëshkimit, vlerësimit dhe përcaktimit të rreziqeve shumë të rëndësishëm në formulimin e planit të mbikëqyrjes si dhe në rastin e asistencës psiko-sociale;
- ☐ Krijimin e metodave më të përshtatshme, të shpejta dhe efikase të mbikëqyrjes, ekzekutimit të masave dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
- ☐ Diagnozën sociale: nëse nuk individualizojmë, atëherë në mënyrë të palejuar, përgjithësojmë. Në rrethana të tilla, mund të jetë e vështirë të formulohet një diagnozë sepse mund të reflektojë përgjithësimet ose “akuzimet” e stereotipeve tona kulturore dhe të vlerave. Në të dyja situatat diagnoza mund të jetë e gabuar ose e thjeshtë, dhe si rrjedhojë zgjidhjet, ndërhyrja dhe strategjia e përqasjes së rastit në mbikëqyrje

ose/dhe asistencë mund të dëmtohet;

- Ndërhyrja psiko-sociale: perceptimi dhe përqasja e personit të mbikëqyrur si një individualitet ka shumë rëndësi për vetë-imazhin dhe vetëvlerësimin e këtij personi; për rritjen e vetëbesimit në aftësinë e tij/saj për të respektuar masat dhe detyrimet e vëna nga gjykata; për ndërtimin dhe zhvillimin e një motivimi në transformimin e sjelljes në një mënyrë të dëshiruar sociale.

Edhe emri i kësaj vlere tregon një nga dimensionet e saj kryesore, atë të respektit. Kjo mund të shihet si një vlerë për veten, por edhe e konkretizuar në lidhje me veçantinë, individualitetin dhe dinjitetin e qenies njerëzore. Ka shumë autorë që e konsiderojnë respektin si nevojën më të thellë njerëzore. Fjala “respekt” vjen nga latinishtja dhe do të thotë: “të shohësh”, “të vështrosh”. Si rezultat, respekti është një mënyrë e caktuar e të parit të vetes dhe të tjerëve. Të respektosh do të thotë t’i nderosh njerëzit thjesht për faktin që janë qenie njerëzore. (Egan, 1990, fq. 65).

Pra, respekti është më shumë se thjesht një qëndrim, më shumë sesa thjesht qëllime të mira; ka kuptimin e interesit për vetënjohje (kur flasim për vetëvlerësim), për njohje të dyanshme në marrëdhënien dhe komunikimin me të tjerët. Respekti do të thotë një përpjekje për të kuptuar tjetrin pa krijuar paragjykime dhe stereotipe. Këto kuptime të asaj çfarë ne quajmë *respekt* zbatohen në qëndrimin dhe gjestet që përbëjnë sjelljen profesionale të punonjësit të shërbimit të provës. Individualizimi i përpjekjeve të mbikëqyrjes dhe/ose asistencës (vlerësimi, planifikimi dhe ndërhyrja) në lidhje me nevojat, burimet personale, dhe karakteristikat kulturore të një personi është zbatimi i këtij dimensionit vlerash në praktikën e shërbimit të provës. Qëndrimi, qëndrueshmëria dhe harmonia e qëndrimeve dhe sjelljes së punonjësit të shërbimit të provës i transmetojnë personit të mbikëqyrur mesazhin që ai/ajo nuk po gjykohej, nuk po akuzohet apo neglizhohet, por po respektohet për atë që është dhe që bën në një mënyrë të pëlqyeshme sociale. Gjithashtu, respekti për personin e mbikëqyrur mund të shprehet në qëndrimin e punonjësit të shërbimit të provës i cili i transmeton atij/asaj faktin që ai/ajo i ka burimet dhe fuqinë për të menaxhuar më mirë jetën e tij/saj. Puna e punonjësit të shërbimit të provës gjatë mbikëqyrjes dhe asistencës psiko-sociale është të ndihmojë klientin të dallojë dhe kuptojë në një mënyrë më realiste që të çlirojë dhe kultivojë këto burime. Shumë herë nevojitet teknika e konfrontimit të personit nën mbikëqyrje me strategjitë e veta që përdor për t’u përballur me situatën, me rutinën e vet të mënyrës si i zgjidh problemet, me frikën dhe vlerat e tij/saj.

Të gjitha këto raste dhe modalitete në përdorimin e respektit nënkuptojnë një marrëdhënie të qëndrueshme profesionale e cila nëpërmjet modelit të një spiraleje lejon zhvillimin dhe shprehjen e respektit, i cili është i dëshirueshëm nga të dyja palët, midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit nën mbikëqyrje. Kjo lloj

marrëdhënieje mund të përbëjë një shembull, një model të marrëdhënies njerëzore ku mund të japim dhe marrim respekt, duke provuar që ndërveprimi me të tjerët mund të ndodhë edhe kështu, jo vetëm në një mënyrë të zhveshur nga dinjiteti, nëpërmjet krimit.

II. Vetëvendosmëria

Ky parim aksiologjik vjen nga besimi në dinjitetin e qenies njerëzore. Kjo ndiqet nga fakti që çdo person duhet të jetë i lirë të bëjë atë çfarë do, të vendosë vetë si të jetojë jetën. Lind pyetja: a funksionon kjo edhe në rastin e personave që kanë shkelur ligjin dhe janë nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës ose në burg? A duhet t'u jepet atyre liri dhe mundësi për të vendosur vetë, pavarësisht se me anë të sjelljes së tyre antisociale ata kanë treguar se mund t'i përdorin këto mundësi kundër vetes dhe të tjerëve?

Sipas mendimit tonë, përgjigja është po, por me disa kufizime që kanë lidhje me statusin e veçantë të marrë nga sanksionimi penal. Ndëshkimi do të përmbushë qëllimin e vet përfundimtar: të dënuarit mund të ndryshojnë si rrjedhojë e përvojës së dënimit dhe mund të jenë në gjendje të ri-përcaktojnë nevojat e tyre, forcën personale dhe të mësojnë si të jetojnë jetën e tyre bashkë me të tjerët dhe jo kundër tyre. E gjithë kjo do të thotë: vetëvendosmëri dhe e drejtë për të vepruar.

Në të njëjtën kohë, zbatimi i kësaj vlere në të gjitha llojet e ndërveprimit – mbikëqyrje ose asistencë – gjatë ekzekutimit të dënimit, i rrit mundësitë që personi i dënuar të bëhet i përgjegjshëm dhe të zbatojë ligjin. Në këtë mënyrë, lehtësohet rritja e mundësive për të arritur qëllimin e sanksionimit në komunitet (ulja e rrezikut të recidivizmit).

Disa punonjës të shërbimit të provës besojnë se përdorimi i kësaj vlere në aktivitetet e shërbimit të provës (vlera kryesore në punën sociale)⁵ zbatohet sipas dy kushteve: a) personi është nën mbikëqyrje si rezultat i një vendimi gjykate që e detyron personin të respektojë disa masa dhe detyrime; b) respektimi i këtyre masave dhe detyrimeve çon në pakësimin e kapacitetit të vetëvendosmërisë në kufijtë e përcaktuar nga kufizimi – deri në një nivel të caktuar – i disa të drejtave (qarkullimit të lirë, ndërveprimit të lirë social, etj.).

Megjithatë, mund të argumentohet se pavarësisht këtyre kufizimeve objektive dhe të nevojshme, vetëvendosmëria mund të jetë funksionale dhe të përdoret për ta bërë personin nën mbikëqyrje të përgjegjshëm.

5. Për arsye të këtij kreu, kam kërkuar përgjigje për një listë pyetjesh nga disa punonjës/këshilltarë të shërbimit të provës në Rumania (Cluj, Olt, Alba dhe Bistrița) të cilët i falenderoj për informacionin interesant që ndanë me mua.

Zgjedhja dhe më pas vendimi për të respektuar ose jo masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata, pasi të kuptohet domethënia e vendimit të gjykatës, është një shprehje e vetëvendosmërisë në nivelin e personit nën mbikëqyrje. Edhe vendimi për të pranuar (ose jo) asistencën dhe këshillimin përbën një provë vetëvendosmërie; kjo ndodh kur personi i mbikëqyrtur merr informacion të mjaftueshëm mbi llojin e asistencës që do marrë dhe mbi efektet e mundshme. Pjesëmarrja e personit nën mbikëqyrje, brenda kufijve të procedurave ligjore, në marrjen e vendimeve në lidhje me të, mund të kthehet në një mundësi të vërtetë për të treguar vetëvendosmëri.

Gjithashtu, këto zgjedhje dhe vendime të marra nga personi nën mbikëqyrje ose/ dhe që mëson t'i marrë gjatë mbikëqyrjes dhe/ose asistencës janë një lloj ushtrimi përgjegjshmërie. Besimi se kushdo ka të drejtën të vendosë vetë, edhe pse me disa kufizime në disa raste, nënkupton faktin se i duhen dhënë disa mundësi për të marrë vendime për veten. Vetëm në këtë mënyrë ai/ajo mund të dijë çfarë është përgjegjshmëria në lidhje me marrjen e vendimeve dhe zgjedhjeve personale, si dhe ndikimin që mund të kenë.

Periudha e provës dhe ndërveprimi profesional me punonjësën e shërbimit të provës përbëjnë një “periudhë të dobishme” reflektimi mbi sjelljen e vet dhe mbi vlerat, zgjedhjet dhe vendimet që ndikojnë personin e mbikëqyrtur.

Për këtë arsye gjatë mbikëqyrjes dhe asistencës besohet që nga detyrat kryesore dhe më të rëndësishme të punonjësit të shërbimit të provës është të punojë me personin e mbikëqyrtur për të ruajtur balancën e dëshiruar midis vetëvendosmërisë dhe përgjegjshmërisë. Të paktën nga perspektiva e asistencës dhe këshillimit, për sa kohë që nuk ka rrezik social, çdo kontakt profesional midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit të mbikëqyrtur duhet të çojë në vlerësimin dhe maksimizimin e mundësive për vetëvendosmëri. Këto mundësi mund t'u referohen, për shembull: marrëveshjes së përbashkët për caktimin e datës për takimin e ardhshëm ose vendimit të përbashkët mbi temën e këshillimit, ose të lejojë personin e mbikëqyrtur të marrë vetë vendimin për të përdorur burimet e krijuara gjatë procesit të këshillimit për të zgjidhur çështjet në një mënyrë pro-sociale.

Vlera e vetëvendosmërisë lidhet me idenë e alternativave/zgjedhjeve. Vetëvendosmëria nënkupton, siç përshkruhet më sipër, vendimmarrjen, zgjedhjen e një mënyre veprimi duke bërë krahasimin me të tjerat, dhe të një zgjidhjeje në krahasim me një tjetër. Kur nuk bëhet asnjë zgjedhje midis alternativave, edhe pse tashmë është dhënë informacion në lidhje me to, do të thotë që nuk ka një mundësi të vërtetë për vetëvendosmëri.

Kur shërbimi i provës është vetë një alternativë dënimi penal, atëherë koha e kaluar nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës duhet të jetë organizuar realisht dhe jo në

mënyrë të qëllimshme si një kohë mundësish për vetëvendosmëri. Duke u bazuar në marrëdhënien profesionale me punonjësën e shërbimit të provës, personi i mbikëqyrur duhet të ndihmohet, inkurajohet dhe pse jo, të drejtohet të dalë nga ai lloj arsyetimi dhe veprimesh që e shtynë të kryente një vepër penale. Personi nën mbikëqyrje mund të aftësohet të mendojë në mënyrë alternative, duke menduar pasojat, dhe të veprojë me përgjegjshmëri, çfarë do të thotë të marrë vetë vendimet në lidhje me rrjedhën e jetës së tij/saj.

Personi nën mbikëqyrje mund të inkurajohet të reflektojë mbi përmbajtjen dhe pasojat e alternativave, duke filluar me ato që kanë lidhje me shkallën e përmbushjes së masave dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata. Gjatë takimit të parë me personin e mbikëqyrur, punonjësi i shërbimit të provës i shpjegon qëllimin e kësaj ndihme dhe kështu limitit dhe i tregon alternativat/zgjedhjet e asistencës për të siguruar kështu mundësitë për vetëvendosmëri.

Mbikëqyrja dhe asistenca duhet të fokusohen në heqjen e kufizimeve të individit (informacion i kufizuar, edukim jo i duhur, përgatitje profesionale jo e mjaftueshme, nën-vlerësim i vetes, frika e stigmatizimit, etj.). Në të njëjtën kohë, duhet të jetë e fokusuar në heqjen e pengesave që kufizojnë mundësitë e të dënuarit për të përdorur burimet, dhe si rrjedhojë zgjedhjet alternative (stigmatizimi dhe marginalizimi i personave që kanë kryer vepra penale dhe janë dënuar nga ligji penal, shërbime të pamjaftueshme për asistencë pas dënimit, etj.).

Marrëdhënia profesionale në fushën e shërbimit të provës është një marrëdhënie e dyfishtë kontrolli dhe ndihme. Ndryshe nga rasti i llojeve të tjera të marrëdhënieve, punonjësi i shërbimit të provës duhet t'i ofrojë personit nën mbikëqyrje informacionin dhe mundësitë për të marrë vendime pa i imponuar perspektivën apo opinionin e vet. Kjo gjë duhet bërë pavarësisht faktit se është një marrëdhënie ku punonjësi i shërbimit të provës shpreh autoritet, si në një nivel simbolik edhe në atë të rolit profesional.

Nga ana tjetër, siç është shprehur Compton dhe Galaway (1989) përdorimi i autoritetit për të rehabilituar një person i cili ka shkelur ligjin, krijon një dilemë serioze etike në fushën profesionale. Kjo mund të zgjidhet në dy mënyra. Një mënyrë është përpjekja për të integruar autoritetin dhe rolet e shërbimeve dhe, brenda kufizimeve të vëna, përpjekja për të zgjeruar mundësitë për vetëvendosmëri (fq. 193). Alternativa e dytë është kalimi i theksit nga përpjekjet detyruese në atë rehabilituese.

Si rezultat i përdorimit të vlerave të vetëvendosmërisë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit të provës mund të testohen nëpërmjet kapacitetit të personit nën mbikëqyrje për të zgjedhur me përgjegjësi alternativat e një jete pro-sociale, gjatë ose në fund të periudhës së mbikëqyrjes.

III. Konfidencialiteti

Kur flasim për përdorimin e kësaj vlere në fushën e shërbimit të provës, gjërat janë të dukshme; legjislacioni⁶ përcakton kufijtë e konfidencialitetit në lidhje me mundësinë e marrjes së informacionit të shkruar dhe të dokumentuar (raportet e vlerësimit, dosjet personale, programet individuale, etj.).

Konfidencialiteti përcakton përmbajtjen dhe kufijtë në fushën e shërbimit të provës, i cili është një vend takimi, nga njëra anë për kushtëzimin e çdo aktiviteti që mbështet drejtësinë, dhe nga ana tjetër për kushtëzimet specifike për këtë aktivitet.

Për shkak të këtij aspekti të fundit, përdorimi i konfidencialitetit në punën e shërbimit të provës mund të shpjegohet nga fakti që një person i mbikëqyrur ka një status të veçantë, të përcaktuar nga kufizimi i disa të drejtave, dhe që i nënshtrohet disa kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga gjykata, të cilat duhen ekzekutuar jashtë burgut, në komunitet. Si rrjedhojë, siguria e komunitetit dhe nevoja për të respektuar masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata shpjegojnë kufizimin e konfidencialitetit për të cilin personi i mbikëqyrur duhet informuar që në fillim të këtij procesi.

Kufizimi i konfidencialitetit ka lidhje dhe me faktin që puna e shërbimit të provës nënkupton edhe bashkëpunimin e disa sistemeve, organizmave, agjencive dhe institucioneve të cilat komunikojnë me njëri-tjetrit. Ato ndajnë informacion dhe bashkëveprojnë për të përmbushur objektivin përfundimtar të punës së shërbimit të provës. Gjithashtu, “*shërbim i provës*” do të thotë: përdorimi i metodave të tilla si trajtimi i rastit, natyra dhe funksioni i të cilit janë koordinimi dhe vlerësimi plotësues, si dhe informimi dhe ndërhyrja e disa profesionistëve. Në të njëjtën kohë, periudha e provës përfshin mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen, si dhe situata objektive kur punonjësit e shërbimit të provës duhet t’ia transferojnë rastet njëri-tjetrit. Këto janë vetëm disa nga rrethanat dhe faktet që shpjegojnë përse kufijtë e konfidencialitetit në fushën e shërbimit të provës janë pak të ngushtë, por kjo nuk nënkupton një rënie të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së marrëdhënies profesionale në këtë fushë.

Në bazë të këtyre arsyeve, mund të themi se rishikimi i bërë nga Compton dhe Galaway (1989) mund të transferohet lehtë nga hapësira e punës sociale në atë të shërbimit të provës. Pozicionimi i tyre në fushën e literaturës së punës sociale është jo-tradicionall kur shprehet nevoja për të rishikuar rëndësinë, ose më saktë, pozicionin

6. Në Rumani, në përmbushjen e detyrave dhe në shoqëri, punonjësit dhe inspektorët e shërbimit të provës duhet të ruajnë konfidencialitetin e dokumenteve të përdorura për qëllime profesionale. Vënia e këtyre dokumenteve dhe ndonjë informacioni tjetër, në dispozicion të sistemit gjyqësor në përputhje me ligjin nuk konsiderohet shkelje e konfidencialitetit. Shërbimi i provës është i detyruar të bashkëpunojë me gjykatat dhe prokurorinë sipas kërkesës së tyre me shkrim për të treguar informacionin. Informacioni mbi rastet e regjistruara nga shërbimi i provës, si dhe çdo lloj informacioni tjetër mbi organizimin dhe funksionin e shërbimit mund t’i jepet, kur është e nevojshme, medias nga personeli i shërbimit të provës i caktuar nga drejtori i këtij shërbimi/departamenti për përmbushjen e kësaj detyre dhe vetëm duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale të të dënuarit (neni 7, shkronja „d” e Kodit Deontologjik rumun).

e konfidencialitetit në fushën e punës sociale.

Konfidencialiteti është i rëndësishëm në psikoterapi (një pjesë e vogël e fushës së punës sociale), ku lidhja terapeutike me klientin risjell më tepër ndjenjat nga e kaluara sesa nga ngjarjet aktuale. Në rast se një klient gjatë terapisë tregon plane që rrezikojnë të tjerët, terapeuti është i detyruar t'ia tregojë këtë fakt atyre që merren me parandalimin e këtij rreziku. Megjithatë, konfidencialiteti nuk është aq i rëndësishëm apo i dobishëm në disa fusha të tjera të praktikës ku operojnë vlera specifike të punës sociale.

Autorët e lartpërmendur flasin për dy aspekte problematike të lindura nga zbatimi në praktikë i konfidencialitetit:

“Si fillim, ky koncept mund t'i privojë aplikuesit dhe klientët nga mundësia dhe detyrimi për të qenë përgjegjës për deklaratat e tyre verbale. (...) çfarë bëni kur një klient ju thotë: ‘Dua t’ju them diçka, por dua që ta mbani sekret?’ Mendimi ynë është që nuk duhet t'i premtoni që në fillim, por t'i thoni se mund të vendosni për këtë gjë vetëm pasi të dëgjoni informacionin dhe aplikuesi [për një shërbim të punës sociale] duhet të jetë në dijeni të këtij fakti kur merret vendimi për të për të ndarë këtë informacion; për këtë arsye duhet të flisni me atë person se kur dhe si do të përdoret informacioni i dhënë” (Compton dhe Galaway, 1989, fq. 199).

Problemi i dytë i lidhur me konfidencialitetin del nga absolutizimi i tij, që sipas Compton dhe Galaway, i redukton në mënyrë drastike disa prej opsioneve në dispozicion të profesionistit dhe klientit.

“ (...) një zbatim jo shumë zyrtar i konfidencialitetit mund të jetë paqëndrueshmëria në lidhje me një përjasje të rëndësishme, atë të bashkëpunimit me rrjetet sociale dhe me sisteme mbështetëse më gjithëpërfshirëse. Konfidencialiteti i kufizon profesionistin dhe klientin, në kuptimin që në shumë prej ndërhyrjeve tona, referimi i bëhet sistemeve mbështetëse që janë të jashtme për klientin ” (fq.199).

I zhveshur nga mistifikimi, konfidencialiteti përdoret në një mënyrë më pak ndikuese në realitetin kompleks të fushës së shërbimit të provës.

Një argument i fundit në këtë aspekt ndërtohet nga njohja e faktit që konkretizimi i konfidencialitetit është një burim i rëndësishëm besimi; Në të njëjtën kohë, ndërveprimi midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit nën mbikëqyrje presupozon funksionimin e një marrëdhënie profesionale të bazuar jo vetëm në autoritet, duke marrë parasysh kontekstin institucional të marrëdhënies, por edhe mbi besimin. Pra, konfidencialiteti është një burim besimi, veçanërisht në atë lloj marrëdhënieje ku njëra nga palët merr pjesë vullnetarisht në ndërveprim dhe i është nënshtruar një lloj mbikëqyrjeje, kontrolli.

Për këtë arsye, qartësimi me transparencë i kufijve të konfidencialitetit dhe vëzhgimit të tij në çdo rast/sesion ose fazë të komunikimit midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit nën mbikëqyrje është një kusht i domosdoshëm për të vendosur, mbajtur dhe zhvilluar besimin. Kjo zbatohet edhe më tepër gjatë asistencës sociale, ku marrëdhënia profesionale nga fusha e shërbimit të provës (gjithashtu) shndërrohet në një marrëdhënie përkrahjeje; kjo nënkupton edhe më shumë besim nga klienti ndaj vetë-ndihmës dhe ndaj punonjësit të shërbimit të provës; nënkupton edhe më shumë nevojë për besim në vëzhgimin e konfidencialitetit të informacionit dhe ndjenjave që tregohen gjatë asistencës dhe këshillimit.

Konfidencialiteti pra, është një burim për të cilin punonjësi i shërbimit të provës duhet të sigurojë se po përdoret në mënyrën e duhur. Nuk duhet përdorur për të justifikuar dështimin e disa veprimeve ose si justifikim për mungesën e përfshirjes në dhënien e udhëzimeve për klientët, ose si justifikim për dështimin në dhënien e ndihmës ndaj klientit për të ndërtuar një sistem mbështetës.

Në të njëjtën kohë, duhen identifikuar edhe ato kufizime të konfidencialitetit që kanë lidhje me të ashtuquajturat *shkaqe faktike*. Për shembull: hapësira e pamjaftueshme e përdorur nga shërbimi i provës, për shkak të së cilës dy ose më shumë intervista me persona të mbikëqyrur ndodhin në të njëjtën sallë.

Nga kjo perspektivë më komplekse, konfidencialiteti mund të kuptohet në kontekstin e shërbimit të provës si një nga kushtet e negociuara për të dhënë këtë lloj shërbimi dhe jo si një vlerë në kuptimin klasik, siç sugjerohet nga Compton dhe Galaway (1989).

Zgjidhja e ambiguitetit dhe dilemave në lidhje me konfidencialitetin, që shpeshherë janë të pandashme dhe që shfaqen në praktikë, varet mbi të gjitha nga kufijtë e ligjshmërisë dhe pastaj nga përcaktimi konstruktiv i rolit dhe rëndësisë së konfidencialitetit në konfigurimin e horizontit aksiologjik të aktiviteteve të shërbimit të provës.

IV. Pragmatizmi

Sipas Egan-it (1990), pragmatizmi është pjesë e vlerave profesionale nëpërmjet të cilave u jepet ndihmë individëve, grupeve dhe komuniteteve të cenueshëm nga ana sociale. Ndoshta është një vlerë e përmendur më pak, por sipas mendimit tim meriton një zbatim më të gjerë në praktikë. Kjo për shkak se nga njëra anë kërkon fokusim në gjërat prioritare për klientin, dhe nga ana tjetër kur zbatohet në realitet, pragmatizmi i vendos një sërë standardesh efikasitetit dhe efektivitetit të cilat fitojnë një domethënie më të madhe në fushën e shërbimit të provës.

I parë nga kjo perspektivë, pragmatizmi siguron një “fokus real” në praktikë. Për shembull, në vlerësimin e bërë për planifikimin e mbikëqyrjes së një të dënuari, përfshihen të gjithë aspektet përkatëse të jetës së tij aktuale dhe në fokus janë vlerësimi dhe ndërhyrjet për të adresuar nevojat kriminogjene. Një fokusim i tillë në jetën reale lejon matjen e efikasitetit të punës së shërbimit të provës.

Nga përmbajtja e kësaj vlere rivendoset parimi i fleksibilitetit dhe formulon detyrimet e mëposhtme për profesionistët: “bëni çdo gjë që është etike dhe që funksionon; zhvilloni mundësi për klientët që ta çojnë të marrë vendime të cilat rrisin pjesëmarrjen e tyre në asistencën e ofruar; bëni (vetëm) atë që është e nevojshme për të dhënë ndihmë” (Egan, 1990, fq. 61).

Nga këto rishikime në lidhje me përmbajtjen dhe zbatimet praktike të pragmatizmit mund të kuptojmë se është një vlerë që përdoret në përputhje të plotë me kërkesat e arsytimit, efektivitetin dhe efikasitetin e menaxhimit të burimeve, të cilat janë specifike edhe për aktivitetet e shërbimit të provës.

Nuk duhet të harrojmë që në shumë vende, asistenca psiko-sociale në fushën e shërbimit të provës ofrohet me kërkesë të personit të mbikëqyrrur, por gjithsesi mbetet një pjesëmarrje jo-vullnetare për shkak se personi detyrohet nga gjykata të respektojë disa detyrime, për të ekzekutuar një dënim. Si rrjedhojë, përdorimi i kësaj vlere duhet të jetë i sigurt (pjesëmarrja e klientit është burimi bazë). Fleksibiliteti, që shpeshherë përfshin krijimtarinë, efikasitetin dhe efektivitetin (ndihma gjithmonë nënkupton një kosto – financiare, psikologjike, të përkohshme, etj. – edhe kur ofrohet falas), dhe ndërgjegjësimi në lidhje me kufizimet profesionale të punonjësit të shërbimit të provës, janë pikat e forta që mund të krijohen nga një përdorim i duhur i kësaj vlere.

Së fundi, pragmatizmi në aktivitetin e një punonjësi të shërbimit të provës nuk do të thotë të bësh vetëm atë që është e nevojshme në lidhje me prioritetet, duke treguar kështu një menaxhim të mirë të kohës dhe burimeve, por edhe të shmangësh lindjen e kundërshtimeve. Kjo ndodh kryesisht për shkak se motivimi i pamjaftueshëm për ndryshim, pasiviteti dhe madje kundërshtimi shpeshherë përfaqësojnë një fakt të kryer për shumë të dënuar që janë nën mbikëqyrje. Kur personi nën mbikëqyrje nuk tregohet i gatshëm për aktivitetet e provës, gjëja e parë që duhet të bëjë punonjësi është të analizojë kryerjen e detyrës së tij profesionale. Punonjësi i shërbimit të provës duhet më pas të identifikojë se çfarë ka thënë dhe/ose bërë që mund të konsiderohet nga personi nën mbikëqyrje si detyruese dhe kushtëzuese. Profesionistët në fushën e punës sociale duhet të bëjnë të pamundurën për t’i dhënë fund, shmangur ose edhe për ta përdorur kundërshtimin në këtë kuptim, në vend që ta luftojë dhe ta transformojë në një mënyrë jo të duhur në provokim personal.

Si rezultat, një ndërveprim midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit nën mbikëqyrje i cili orientohet nga pragmatizmi, do të shndërrohet në komunikim verbal dhe në veprime ku merret në konsideratë fakti që klientët tregohen jo entuziastë kur ndihen të detyruar. Por detyrimi objektiv tashmë ekziston që nga momenti që gjykata ka formuluar dhe vendosur masat dhe detyrimet mbi personin e mbikëqyrur. Prandaj besohet se një nga detyrat kryesore të punonjësit të shërbimit të provës është të zgjidhë këtë situatë e cila mund të shkaktojë probleme nëpërmjet një marrëdhënieje profesionale të përqendruar në komunikim, bashkëpunim, mbështetje dhe ri-drejtimit, duke shmangur zhvillimin e arsyeve të tjera për të qenë ngurrues.

Përveç cilësisë dhe natyrës së marrëdhënies së sipërpërmendur, një rol të rëndësishëm në uljen e ngurrimit dhe rritjen e motivimit dhe përfshirjes në provë të personave nën mbikëqyrje mund të luajë vlerësimi i duhur i nevojave kriminogjene dhe të burimeve të personit të mbikëqyrur, si dhe nga një vlerësim më i saktë i rreziqeve (të dëmtimit dhe recidivizmit).

Marrëdhënia profesionale, si hapësira e veprimit të vlerave në shërbimin e provës

Themelimi dhe zhvillimi i një marrëdhënieje profesionale midis punonjësit të shërbimit të provës dhe personit të mbikëqyrur është e ndikuar nga një dualizëm i qëllimshëm. Kjo do të thotë: qëllimi i kontrollit i lidhur me qëllimin e mbështetjes/ndihmës për rehabilitim; ky qëllim i dyfishtë i jep marrëdhënies profesionale në fushën e shërbimit të provës një specifikim të dallueshëm. Kjo shprehet nëpërmjet faktit që marrëdhënia ndërmjet punonjësit të shërbimit të provës dhe personit nën mbikëqyrje, siç përcaktohet nga kushtet paraprake dhe procedurat ligjore, *është dhe nuk është një marrëdhënie ndihme (asistence)* ose e thënë më mirë, nuk është vetëm një marrëdhënie ndihme dhe as një marrëdhënie asistence që ka në fokus mirëqenien e të ndihmuarit (siç ndodh në rastin e punës sociale).

Në punën e shërbimit të provës, ruajtja dhe rritja e sigurisë së komunitetit janë objektivat kryesore, të matura nga reduktimi i rrezikut social dhe ai i recidivizmit. Zgjidhja e nevojave me potencial kriminogjen që janë specifike për çdo person dhe vlerësimi për këtë qëllim i burimeve personale dhe të komunitetit nëpërmjet asistencës psiko-sociale, janë në varësi të këtyre objektivave.

Për të kuptuar natyrën e marrëdhënies profesionale në fushën e shërbimit të provës, le të shohim protagonistët kryesorë të saj, pozitën dhe rolet e tyre në këtë marrëdhënie. Gjithashtu, duhet bërë edhe një dallim i sugjeruar nga Pincus dhe Minahan (1973). Në përcaktimin e sistemeve të shumta me të cilat bashkëveprojnë punonjësit socialë, dy autorët identifikuan katër sisteme: *sistemi i klientit, sistemi i objektivit, sistemi agjentët e ndryshimit dhe sistemi i veprimit*.

Sipas autorëve të mirënjohur të cilëve u atribuohet përshtatja dhe zhvillimi i teorisë së sistemeve në fushën e punës sociale, *sistemi i klientit* përfaqësohet nga “personi i përfshirë në një situatë të tillë ku kërkon shërbim nga punonjësi social dhe *sistemi i objektivit* është personi ose situata mbi të cilin punonjësi social përqendron përpjekjet e veta” (Davies, 150). Këto dy sisteme mund të përputhen por edhe mund të ndryshojnë.

Në shërbimin e provës ky dallim është më i rëndësishmi sepse shteti, nëpërmjet organeve të drejtësisë, vepron si një sistem klienti, dhe personi i dënuar me mbikëqyrje është sistemi i objektivit. Ky person nuk e ka zgjedhur vullnetarisht ndërhyrjen e shërbimit të provës dhe as nuk mund të kërkojë ta ndërpresë; kjo për shkak të sjelljes së tij, të kaluarës ose kushteve aktuale (statusi – roli). Ai/ajo është detyruar nga gjykata për të kaluar këtë periudhë prove dhe për të marrë pjesë në një marrëdhënie profesionale të detyruar. Kjo e bën komplekse dhe të vështirë këtë marrëdhënie profesionale, është kompleksiteti i kushtëzimit specifik dhe sfidave.

Pozicioni profesional dhe roli i punonjësit të shërbimit të provës mund të konsiderohet si sfidë. Ky punonjës është ose duhet të jetë në mes të distancës midis të dënuarit dhe shtetit. Atij i është dhënë një pozicion profesional që mbështetet në *autoritetin* e dhënë nga ligji, me një rol kontrollues dhe ndihmues.

Në këtë mënyrë, autoriteti i punonjësit të shërbimit të provës qëndron si në nivel simbolik edhe në nivel real, tërheq vëmendjen tek nevoja për një përdorim konstruktiv të autoritetit, për një përjasje konstruktive që lidh autoritetin me përgjegjësinë në nivelin e qëndrimit të mbajtur, vendimeve dhe veprimeve të punonjësit. Tema e përgjegjësisë është edhe me delikatja, aktuale dhe më e rëndësishmja në debatin që përfshin fushën e shërbimit të provës dhe meriton të trajtohet në një kre më vete. Këtu sugjerohen vetëm disa udhëzime dhe diskutime mbi këtë temë dhe lidhjes midis *autoritetit dhe përgjegjësisë*.

Përgjegjësia është një koncept që duhet trajtuar në një kontekst, d.m.th., një analizë e përdorimit të saj në drejtimet në vazhdim:

Përgjegjësia e punonjësit të shërbimit të provës në aktivitetin e vet profesional nga njëra anë shprehet në lidhje me rezultatet dhe, nga ana tjetër, në lidhje me atë që ne quajmë deontologji profesionale.

Një drejtim tjetër i detyruar i analizës është ai i propozuar nga May dhe Vass (1996) nëpërmjet pyetjes: “Për kë dhe për çfarë është përgjegjës punonjësi i shërbimit të provës?” (fq. 93). Në përpjekje për të shpjeguar pyetjen më tepër sesa për të dhënë një përgjigje mund të thuhet se përgjegjësia matet si vertikalisht, në marrëdhënien institucionale – hierarkike, dhe horizontalisht, në marrëdhëniet e punonjësit të shërbimit me kolegët e tjerë, me profesionistë të tjerë me të cilët bashkëpunon, dhe

me personin nën mbikëqyrje. Kështu mund të shohim si dhe pse në secilin plan përgjegjësia shndërrohet në vlera të tjera si sinqeriteti, konfidencialiteti, respekti, individualizimi, ose në cilësi profesionale si: korrektësia, të qenit mendjegjerë, harmonia, vetënjohja, guximi, ndjeshmëria, shqetësimi për të tjerët, dhe autenticiteti.

Autoriteti dhe pushteti: Siç tregohet më sipër, autoriteti mund të përkufizohet si një pushtet i dhënë punonjësit të shërbimit nga shteti dhe departamenti ku punon. Punonjësi i shërbimit të provës shihet si dikush që ka njëkohësisht pushtetin/autoritetin ligjor dhe profesional për të përmbushur rolin e ndërlikuar që ka në sistemin juridik. Roli, i përcaktuar nga detyra konkrete profesionale, tregon dimensionet bazë që i japin formë autoritetit:

- a) *Dimensioni institucional* lidhet me pozicionin dhe funksionin e punonjësit të shërbimit në sistemin e drejtësisë penale në përgjithësi, dhe në shërbimin e provës në veçanti;
- b) *Dimensioni psikologjik* jepet nga fakti që shpeshherë, si rezultat i evolucionit të duhur të marrëdhënies profesionale, personi nën mbikëqyrje e pranon punonjësin e shërbimit si një person-burimi. Në këtë mënyrë, personi i mbikëqyrtur pranon autoritetin dhe pushtetin e punonjësit të shërbimit për ta ndihmuar/këshilluar personin nën mbikëqyrje në bazë të kompetencave të veta profesionale.
- c) *Dimensioni etik* vjen nga dy dimensionet e para dhe është ai që lidhet me idenë e përgjegjësisë. Tre dimensionet kryesore të *autoritetit – përgjegjësisë – etikës profesionale* do të tregojnë thelbin e të kuptuarit dhe funksionit të punës së shërbimit të provës si dhe gamën e vlerave specifike të këtij institucioni.

Autoriteti profesional vjen nga tre burime kryesore: 1) nga kompetencat profesionale (njohuria, aftësitë dhe vlerat); 2) nga pozicioni profesional (punonjësit e shërbimit i përkasin një profesioni që ka ose duhet të ketë një sistem etik që u jep atyre një pozitë profesionale); 3) nga cilësia e marrëdhënies profesionale.

Kompetencat profesionale në shërbimin e provës

Në bashkërrjedhjen e funksioneve të kontrollit social, kujdesit social dhe ndryshimit social të cilat duhet t'i përmbushë shërbimi i provës, mund të shohim konkluzionin, funksionin e pajtimit që i jep shtetit dhe qytetarëve mundësinë për të jetuar së bashku në harmoni (Davies, 155). Nga perspektiva e punës brenda shërbimit të provës, kjo do të thotë që punonjësi i shërbimit/profesional është një punonjës i shtetit. Ai/ajo nuk është thjesht një përfaqësues kontrolli social, por edhe një përfaqësues ndryshimi sepse punonjësi i shërbimit ka autoritetin dhe mandatin ligjor si dhe kompetencat

profesionale që e bëjnë të mundur përmbushjen e misionit të shërbimit të provës.

Misioni i shërbimit të provës në Evropë përcaktohet si “kontribut për sigurinë e komunitetit” (Malta) ose “reduktim i kriminalitetit dhe mbrojtja e qytetarëve nga krimi” (Suedi), ose si “vendosje e drejtësisë nëpërmjet hetimeve, akuzave, procedimit dhe dhënies së sanksioneve në mënyrë efikase dhe të shpejtë” (Angli) ose formulohet si një objektivi: “të stimulosh sigurinë e komunitetit dhe të nxitësh mirëqenien e publikut duke mbështetur, pranuar dhe përdorur sanksione dhe masa në komunitet, duke reduktuar kështu nivelin e recidivizmit” (Irlandë) (Kalmthout, A., M., Derks, J., T., M., 2000). Deklarimi i misionit të shumë prej shërbimeve të provës në Evropë thekson kryesisht mbrojtjen e qytetarëve, të komuniteteve, vlerësimin e rreziqeve dhe ekzekutimin efikas të sanksioneve të vendosura nga gjykatat për ato persona që kanë kryer vepra penale.

Sipas legjislacionit rumun, misioni i shërbimit të provës është të kontribuojë në sigurinë e komunitetit dhe të qytetarëve duke mbikëqyrur të dënuarit me qëllim për të parandaluar krimin dhe për të reduktuar rrezikun e recidivizmit. Kuadri legjislativ aktual përcakton përgjegjësitë e shërbimit të provës: mbikëqyrja e respektimit të masave dhe detyrimeve të vendosura nga gjykata; paraqitja, me kërkesë të gjykatës ose prokurorisë, e raporteve vlerësuese; ofrimi i ndihmës dhe këshillimit personit të dënuar sipas kërkesës së tij; bashkëpunimi me institucionet publike për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punës pa pagesë në interes të publikut; zbatimin e disa masave për mbrojtjen e viktimave të krimit, vlerësim dhe asistencë për ata persona të liruar parakohe me kusht nga burgu.

Misioni dhe objektivat e shërbimit të provës në Rumani përcaktohen në legjislacion. Fatkeqësisht, ligji rumun nuk i përcakton qartë rolet e *punonjësve të shërbimit të provës*. Megjithatë, disa role mund të identifikohen në varësi të detyrave profesionale të lidhura me përgjegjësitë e caktuara.

Në këtë aspekt, vlen të përmendet *roli i vlerësuesit* për secilin punonjës të shërbimit (vlerëson nevojat me potencial kriminogjen, situatën sociale dhe familjare të personave, rrezikun për të kryer përsëri shkelje ligjore, rrezikun e dëmtimit; vlerëson nevojat për asistencë dhe këshillim; vlerëson progresin e lidhur me planin e mbikëqyrjes dhe/ose asistencës).

Për të përmbushur detyrat e asistencës dhe këshillimit, mund të identifikojmë pesë *role ndërhyrjeje*: 1) komisioner social, 2) këshilltar, 3) edukator, 4) ndërmjetësues, 5) avokat.

Po marrim në konsideratë historinë e zhvillimit të shërbimit të provës në Rumani, masat legjislative, strategjinë edukuese dhe trajnimin në fushën e shërbimit të provës

dhe përkufizimin e *kompetencës profesionale* si “*demonstrimi i njohurisë, aftësive dhe vlerave në vendin e punës, në lidhje me standardet e pranuar*” (Këshilli Kombëtar rumun për Kualifikimet Profesionale, 1988). Duke parë përvojën rumune, mund të themi se për të përmbushur përgjegjësitë dhe atributet e caktuara me ligj, punonjësi i shërbimit të provës duhet të provojë që ka dhe mund të zbatojë në praktikë *njohurinë teorike, aftësitë praktike dhe vlerat*, sipas misionit dhe objektivave të shërbimit të provës dhe në varësi të rolit profesional që ka në një moment të caktuar gjatë kryerjes së aktivitetit profesional.

Nga përkufizimi i kompetencës profesionale shohim se “vlera” është një nga shtyllat kryesore mbi të cilën është ndërtuar. Nga njëra anë mund të theksojmë një dimension në lidhje me vendin e punës/fushën profesionale dhe nga ana tjetër një dimension që mund ta konsiderojmë si të përqendruar te personi, kompetenca personale.

Në vijim jepet një përshkrim i shkurtër i roleve profesionale të sipërpërmendura dhe elementet e kompetencave specifike për secilin rol:

- a) *Nëpërmjet rolit të komisionerit social*, punonjësi i shërbimit të provës përcakton lidhjet e nevojshme midis personit të mbikëqyrur dhe komunitetit, në bazë të objektivave të përcaktuara në planin e mbikëqyrjes. Kryerja e këtij roli kërkon kompetenca specifike profesionale: *njohuri* rreth burimeve të komunitetit si dhe njohuri të procedurave të organizatave/institucioneve për një lidhje efikase; *aftësi praktike* komunikimi dhe negocimi; dhe së fundi zbatimin e *vlerave etike dhe parimeve* (barazia, respekti për dinjitetin, mos-diskriminimi), që e lejojnë personin e dënuar të qëndrojë në komunitet, pavarësisht sanksioneve, dhe që të mund të përdorë burimet e komunitetit sipas kushteve të caktuara nga gjykata.
- b) *Roli i këshilltarit/ndihmuesit* vjen nga folja “ndihmoj”. Profesionisti luan këtë rol kur aktivitetet e ndërhyrjes psiko-sociale kanë për qëllim t’u ofrojnë këtyre personave asistencë për të gjetur forcën dhe burimet për të bërë ndryshimet e caktuara në planin e asistencës; ndryshimi ndodh kryesisht për shkak të përpjekjeve të personit të ndihmuar. Përgjegjësia e punonjësit të shërbimit të provës është të ndihmojë (ose aftësojë) klientin për të arritur objektivat e propozuara. Shembuj të përmbushjes së këtij roli përfshijnë: të inkurajojë komunikimin, të sigurojë shfaqjen e ndjenjave, të kontrollojë modelin e vendosjes së marrëdhënieve të përdorur nga personi i mbikëqyrur, të ofrojë inkurajim, të përfshijë personin e mbikëqyrur në diskutime logjike dhe në vendimmarrje racionale, etj. Kuptimi i gjithë këtyre është, *njohuri teorike* rreth ndryshimit të sjelljes, *aftësi praktike* për të ndihmuar ndryshimin dhe zbatimin e *vlerave* që orientojnë aktivitetin e shërbimit të provës në kryerjen e këtij roli: kryesisht respektin për veçantinë, individualitetin dhe dinjitetin e personit, mos-diskriminimin, vetëvendosmërinë, konfidencialitetin.

- c) Punonjësi i shërbimit të provës luan *rolin e edukatorit*, duke i dhënë personit të mbikëqyrur informacion, njohuri teorike dhe praktike të nevojshme për të qenë në gjendje të përballojë situatat problematike; punonjësi ndihmon personin nën mbikëqyrje të praktikojë/ushtrojë aftësitë e reja ose sjelljen, ose e mëson nëpërmjet shembujve të një sjelljeje alternative. Edhe në këtë rast ka *kompetenca profesionale* që duhen praktikuar. Kjo bëhet nëpërmjet *njohurisë teorike* mbi sociologjinë, kriminologjinë, psikologjinë e përgjithshme, psikologjinë e moshave ose atë të sjelljes njohëse. Në praktikë këto konkretizohen si *vlera* që shprehin qëndrimin e punonjësit të provës në kryerjen e këtij roli: respekt për veçantinë e personit, respekt për dinjitetin njerëzor, mos-diskriminim, pragmatizëm.
- d) *Roli i ndërmjetësuesit*: ndërmjetësimi përfshin përpjekje për të zgjidhur grindjen që mund të ekzistojë midis sistemit të klientit (personi i mbikëqyrur) dhe personave ose organizatave të tjera me të cilët ai/ajo ndërvepron gjatë periudhës së provës. Të ndërmjetësosh do të thotë të ndihmosh dy palët në konflikt të përcaktojnë dhe përdorin një bazë të përbashkët ku të bazohet zgjidhja e konfliktit. Përdoren teknika të ndryshme si p.sh.: të ndihmosh konvergjencën e vlerave të dy palëve në konflikt, të ndihmosh njërën palë të pranojë legjitimitetin e interesave të palës tjetër, të ndihmosh palët të identifikojnë interesat e përbashkëta, të ndajnë konfliktin në nën-probleme, të ndash temat, të ndihmosh komunikimin midis palëve, të inkurajosh palët të gjejnë një zgjidhje të përbashkët në një mënyrë pro-sociale.
- e) *Avokatia*: Ky është një rol i huazuar, kuptimi i të cilit është që punonjësi i shërbimit të provës bëhet përfaqësuesi i të drejtave të personave nën mbikëqyrje. Kjo bëhet sipas vlerave të etikës dhe parimeve që orientojnë gjithë aktivitetin e shërbimit të provës si dhe rolet profesionale që përmbush punonjësi i shërbimit në këtë aspekt. Ky rol luhet nga punonjësi i shërbimit kur, për shembull, personi i mbikëqyrur përballet me diskriminim nga disa anëtarë të komunitetit, përfaqësues të disa organizatave/institucioneve, punonjësve, etj.

Në shembujt e mësipërm mund të shohim që kryerja e roleve profesionale të punonjësve të shërbimit të provës mundësohet nën ekzistencën dhe shprehjen e *kompetencave profesionale* të nevojshme dhe specifike për fushën e shërbimit të provës. Një vërejtje tjetër që mund të bëjmë është: ndryshe nga fusha e punës sociale apo psikologjisë, nga të cilat shërbimi i provës ka huazuar disa njohuri teorike dhe praktike dhe disa aftësi (si komunikimi, marrëdhënia, vlerësimi, analizimi, planifikimi, ndërhyrja psiko-sociale), rolet profesionale dhe kompetencat e punonjësve të shërbimit të provës duhet të kenë qëllim dhe të përcaktohen *kryesisht nga vlera specifike*: siguria e komunitetit dhe reduktimi i rrezikut të recidivizmit.

Pyetje për diskutim:

1. Si mund të përcaktohen vlerat në punën e shërbimit të provës?
2. Cili është kuptimi i vlerës së respektit për veçantinë dhe dinjitetin e çdo individi në kontekstin e shërbimit të provës?
3. Cilët janë motivet e kufizimit të konfidencialitetit në aktivitetin e shërbimit të provës?
4. Pse është vetëvendosmëria e veçantë për fushën e shërbimit të provës?
5. Çfarë supozon lidhja midis autoritetit dhe pushtetit në fushën e shërbimit të provës?

6. METODAT E PUNËS ME TË DËNUARIT

Çfarë funksionon: teoria e sjelljes njohëse dhe modeli i ndërprerjes

6.2

John Deering

Historiku dhe një përmbledhje e metodës “Çfarë funksionon”

Baza e metodës “Çfarë funksionon” është meta-analiza e programeve të zhvilluara për t’u përdorur me të dënuarit, ku studimet mbi ri-dënimin kanë qenë pjesë e vlerësimit. McGuire vlerëson se po të merren së bashku, këto analiza tregojnë një ulje të recidivizmit prej 10%, ndërsa disa studime tregojnë deri në 20-30%. Kjo ka ndodhur vetëm kur programet janë krijuar për të përmbushur kriteret e suksesit që McGuire mendon se janë identifikuar që në fillim të viteve 1980 (McGuire 2000).

Vitet 1950 dhe 1960 ishin një periudhë optimizmi pozitiv në lidhje me aftësitë e shoqërisë për të analizuar shkaqet e krimit dhe për ta “kuruar” atë nëpërmjet ndërhyrjeve të bazuara kryesisht në psikologji dhe psiko-dinamikë. Megjithatë, filluan të lindin dyshime rreth efikasitetit të saj dhe studimet në Britani dhe SH.B.A. në vitet 1970 tregonin se asgjë nuk dukej se funksiononte për të reduktuar recidivizmin. Pohimi “asgjë nuk funksionon” i Martinson-it dhe Studimi i NDIKIMIT pati një ndikim të madh në mendimin zyrtar rreth mundësive për rehabilitim. Megjithatë, ato u vunë në dyshim në atë kohë dhe McGuire jep një sërë studimesh në lidhje me rezultatet që tregojnë se disa lloj ndërhyrjesh *mund* të reduktojnë recidivizmin, madje dhe vetë Martinson-i u tërhoq në vitin 1979 (Brody 1976, Martinson 1974).

Vitet e fundit, zhvillimi i meta-analizës e cila “përfshin agregimin dhe analizën e një sërë studimesh eksperimentale.... ndikimi i tyre kontrollohet në lidhje me madhësinë e ndikimit...” ka pasur ndikim në studimet e efektivitetit. (McGuire 2000, fq. 97). Në 15 studime të kryera gjatë viteve 1980 dhe 1990, kryesisht në Evropë dhe

SHBA, kanë dalë disa tema të përbashkëta sipas së cilave programet e suksesshme për të dënuarit duhet:

- 1) Të kenë një kuadër të qartë teorik që mbështetet në mënyrë empirike
- 2) Të përfshijnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të recidivizmit dhe shpërndarjen përkatëse në nivelet e shërbimit
- 3) Të synojnë faktorët dinamik të rrezikut (nevojat kriminogjene)
- 4) Të konsiderojnë reagimin dhe të zbatojnë një ndërhyrje të strukturuar duke përdorur një metodë më të drejtpërdrejtë në përputhje me mënyrën e të mësuarit të individëve të përfshirë në program.
- 5) Të jenë multi-modele, të orientuar drejt aftësive dhe të bazuara në një sjellje njohëse
- 6) Të jenë me bazë në komunitet
- 7) Të kenë integritet të lartë në mënyrën e trajtimit.

Chapman dhe Hough (1998) deklarojnë se ndërhyrja nuk duhet të ketë vetëm një formë, por në varësi të nevojës, pra të multi-modeleve. Ata e shohin punën në grup të përshtatshme për:

- Marrjen e roleve dhe sjelljeve
- Mësimin nga kolegët
- Sfidën dhe mbështetjen nga kolegët
- Trajnimin për aftësitë njohëse dhe sociale
- Reflektimin mbi çështjet dhe vështirësitë e përbashkëta

Mbikëqyrja individuale duhet të prekë:

- Nevojën për nivele të larta mbikëqyrjeje dhe kontrolli
- Reflektimin mbi zbulimin personal
- Vetëmonitorimin dhe instruktimin
- Zbatimin e çështjeve të lindura gjatë diskutimit në grup në rrethanat personale
- Menaxhimin e pengesave personale ndaj pjesëmarrjes në grup.

Edhe teknika të tjera mund të përdoren, me kusht që të adresojnë nevojën kriminogjene: puna në familje, terapi drame/arti, aktivitetet jashtë shtëpisë, etj.

Chapman dhe Hough zhvillojnë listën e kritereve që lindin nga meta-analiza dhe mendojnë se çdo lloj forme ndërhyrjeje duhet të përfshijë sa vijon:

- I. Zhvillimi i aftësive, p.sh., njohëse, ndërpersonale, të shkrimit dhe leximit, të numërimit, profesionale, krijuese
- II. Përqasjet e sjelljes njohëse të cilat adresojnë treshen: mendime/ndjenja/sjellje dhe kanë për qëllim të rregullojnë “mangësitë” në aftësitë njohëse, sjellëse dhe emocionale

- III. Të kenë bazë komunitetin
- IV. Modelimin pro-social, që thuhet se përmirëson respektimin e ligjit dhe redukton recidivizmin
- V. Nivelin e duhur të “dozës” që bën lidhjen me parimin e rrezikut
- VI. Gatishmëri për të zgjeruar njohuritë
- VII. Zbatimin e integritetit të programit.

Kushtet paraprake të metodës “Çfarë funksionon”

Mund të argumentohet se çelësi i metodës “çfarë funksionon” është vendosja e një pikësnyimi. Kjo do të thotë të vendosësh personin e duhur në programin e duhur në kohën e duhur. Këtu përfshihet parimi i reagimit, parimi i nevojës dhe parimi i rrezikut.

Parimi i reagimit i referohet kryesisht stilit të ndërhyrjes. Metodatat më “tradicionale” të shërbimit të provës dhe ndërhyrja e të rinjve janë këshillimi individual dhe puna psiko-dinamike në grup. Megjithatë, ka prova (Andrews dhe Bonta 2003) se individët me një nivel mesatar rreziku për recidivizëm reagojnë më mirë dhe mësojnë më shumë kur metodatat janë aktive dhe përfshirëse dhe jo të pastrukturuara apo tepër didaktike. Pjesë e caktimit të një synimi është vlerësimi nëse një individ i përshtatet llojit të ndërhyrjes që është siguruar. Reagimi përfshin edhe motivimin dhe bashkëpunimin e individit dhe mund të kuptohet se një individ është i përshtatshëm për një program tjetër që nuk është referuar.

Parimi i nevojës ka lidhje me nevojën kriminogjene, d.m.th., ato aspekte të situatës personale dhe mjedisore të individit që kanë lidhje me kryerjen e veprës penale. Disa shembuj janë: aftësi jo të mira njohëse, abuzim me drogën/alkoolin, kushte jo të mira familjare, aftësi të pazhvilluara ndërpersonale, edukim dhe aftësi jo të mira profesionale, etj. Niveli i nevojës në këto fusha duhet të drejtojë zgjedhjen ose mos-zgjedhjen e tyre të një lloji të caktuar ndërhyrjeje.

Parimi i rrezikut kërkon një vlerësim të rrezikut që përbën një person në lidhje me recidivizmin. Sa më i lartë ky rrezik aq më intensive duhet të jetë ndërhyrja dhe anasjelltas. Ka prova se “ndërhyrja e tepërt” tek individët që përbëjnë rrezik më të ulët mund ta rrisë këtë rrezik (shihni Chapman dhe Hough 1998, fq.14).

“Praktikat thelbësore korrigjuese” të identifikuara nga Downden dhe Andrews (2004) shihen edhe si kushtet paraprake të asaj “çfarë funksionon”. Këto kushte janë: përdorimi i duhur i autoritetit efektiv, modelimi i duhur, zgjidhja e problemeve dhe një marrëdhënie e hapur. Modelimi i duhur duhet të përfshijë parimet dhe praktikat e një modelimi pro-social, siç identifikohet nga Trotter (1999). Përfshin parimet dhe praktikat në vijim:

- Identifikimin e komenteve pozitive ose pro-sociale ose të sjelljes siç ndodhin në marrëdhënien tuaj me individët;
- Shpërblimin e këtyre komenteve dhe sjelljeve sa herë që është e mundur, më shpesh në formën e lavdërimit;
- Paraqitja e vetes si një model pro-social;
- Sfida ndaj komenteve ose sjelljeve pro-kriminale ose anti-sociale.

Diskutime dhe raste studimore:

Në bazë të diskutimit mbi parimet “çfarë funksionon”, si do e vlerësonit individin në vijim?

Femër, 26 vjeçe, prind i vetëm me një vajzë 8-vjeçare. Ajo është e ndarë nga i ati i fëmijës (kanë pasur një marrëdhënie për 10 vjet dhe ishin të martuar 5 vitet e fundit), për shkak se ai u bë një “i droguar i pashpresë”. Ajo nuk do të ishte ndarë për ndonjë arsye tjetër.

Ajo vinte nga një “familje e mirë” por kaloi nën kujdesin e shtetit në moshën 13-vjeçare pasi njerku i saj kishte abuzuar seksualisht me të. Megjithatë, e ëma nuk e kishte besuar dhe pas vitit të parë nuk mbajti më kontakt me vajzën. Vajza u çua në një shtëpi fëmijësh dhe ishte e lumtur dhe në gjendje të qëndrueshme. Por, kur kjo qendër u mbyll për arsye financiare, ajo u transferua në një shtëpi më të madhe ku kishte edhe fëmijë të cilët kishin kryer vepra penale. Ajo filloi të drogohej dhe të kryente vepra penale si një “ndjekëse” e djemve. U largua nga qendra e kujdesit në moshën 16-vjeçare dhe jetonte në një apartament me qira por me pak mbështetje. Brenda dy viteve u bë mashtruese çeqesh dhe përdoruese e heroinës. U dënua me burgim për një kohë të shkurtër gjatë së cilës vajza e saj u mor në kujdestari nga punonjësit socialë. Pas vuajtjes së dënimit, për 5 vjet ajo jetoi bashkë me partnerin dhe vajzën e vet pa kryer asnjë vepër penale, por vazhdoi të drogohej. Iu caktua një doktor i cili i dha metadon. Partneri i saj vazhdonte të drogohej kështu që u ndanë. Shumë shpejt ajo filloi përsëri të falsifikonte çeqe dhe të drogohej, pavarësisht se merrte metadon. Tani ka kaluar në kujdesin e shërbimit të provës.

Vajza e saj e vogël shkon në shkollë dhe nuk është në dijeni që e ëma ka kryer një vepër penale dhe drogohet. Ajo ndihet fajtores për këtë gjë dhe për shkak se kohët e fundit është arrestuar por nuk është akuzuar. Ajo ka frikë se do të përfundojë në burg dhe vajza e saj do mësojë të vërtetën.

Ajo i “racionalizon” veprat penale të kryera si “të nevojshme” për të ushqyer dhe veshur vajzën e saj, por mendon se mund të hiqte dorë nga kjo lloj jete nëse do të bënte pak përpjekje.

Një nga parimet e sjelljes njohëse e sheh aktivitetin njerëzor si produkt të ndërveprimit midis faktorëve personal/të brendshëm dhe të situatave/të jashtëm. Përpiqet të shpjegojë veprimet në nivel të përgjithshëm dhe ka të bëjë po aq shumë me sjelljen “normale” sa edhe me sjelljen “devijuese”, duke mos bërë asnjë dallim formal midis të dyjave.

Një parim i dytë tregon se aktiviteti i një organizmi ka tre modalitete, të cilat janë të ndërlidhura dhe të pandashme kur shpjegohet aktiviteti njerëzor. Këto modalitete janë:

Sjellja – sistemi motor, fjalimi

Ndjenjat – të quajtura ndryshe “ndikim” dhe “emocion”

Njohja – ose proceset e mendimit

Kjo njihet si treshja “Mendimet, ndjenjat, sjellja”

Vetërregullimi dhe gjuha

Qendra e mendimit/ndjenjës/sjelljes është truri dhe sjellja njohëse tërheq vëmendjen tek ndryshimet midis procedimit automatik dhe atij të kontrolluar. Procedimi automatik është baza e shumë aktiviteteve: të veshurit, përdorimi i automjetit, etj., ndërsa procedimi i kontrolluar kërkon që aktivitetet të kryhen në seri, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me përpjekje. Kjo ndodh në situata të reja, kur duhen marrë vendime dhe duhen zgjidhur probleme. Procedimi i kontrolluar shërben edhe si një funksion vetërregullator, kryesisht nëpërmjet gjuhës dhe konceptit të “të folurit me veten”.

Kapaciteti ynë për të krijuar programe automatike është i madh, por i kufizuar kur bëhet fjalë për programet e kontrolluara, kështu që sjellja njohëse sheh shumë funksione që shndërrohen nga të kontrolluara në automatike me kalimin e kohës, p.sh., kur mësohet një aftësi e re dhe kalojmë nga “paaftësia e ndërgjegjshme” në “aftësi të pandërgjegjshme”. Sjellja njohëse e sheh këtë proces si një funksion të njohjes, kështu që ka një lidhje të ngushtë midis njohjes dhe sjelljes.

Një vlerësim i sjelljes njohëse të një personi synon të vlerësojë njohjen në lidhje me shqetësimin ose sjelljen shqetësuese. Kur ndodh kjo gjë, sjellja njohëse u referohet “besimeve irracionale”, “gabimeve njohëse” ose “mangësive njohëse”.

Sjellja njohëse i sheh sa më sipër në gjendje për të shpjeguar vetëm veprimet njerëzore kur merret në konsideratë ndërveprimi i organizmit me mjedisin. Sjellja shihet si një ndërveprim kompleks ndërmjet faktorëve personalë dhe të situatave, ndërsa sjellja njohëse nuk i sheh në këtë mënyrë, dhe si rrjedhojë ia atribuon idetë tradicionale të

llojit të personalitetit individit dhe i përdor për të shpjeguar sjelljen. Sjellja mund të shpjegohet nga ndërveprimi i mendimeve/ndjenjave/sjelljes dhe kundërveprimi me mjedisin.

Pra, si faktorët personalë dhe ata të situatave përfshihen për të shpjeguar sjelljen dhe ndërveprimi i tyre jep një shpjegim më të mirë sesa secili më vete.

Sjellja njohëse dhe shpjegime të përgjithshme të krimit

Kriminologjia është përpjekur të shpjegojë krimin në disa mënyra të cilat zbatohen në pesë nivele:

- i. Shpjegimet makro e shohin krimin si produkt të shoqërisë dhe të lidhjes midis strukturës dhe pushtetit të saj.
- ii. Shpjegimet mikro ose lokale shpjegojnë ndryshimet gjeografike të krimit dhe studimet e mëparshme u përpoqën të gjenin një lidhje midis varfërisë dhe krimit.
- iii. Stili i jetesës, zgjedhja racionale dhe shpjegimet e aktivitetit rutinë e shohin krimin si funksion i një stili të caktuar jetese, shpesh i bazuar në zgjedhjen racionale dhe sjelljen e zakonshme.
- iv. Shpjegimet e shoqërizimit dhe ndikimit të grupit përpiqen të shpjegojnë përse disa individë nga e njëjta zonë dhe me prejardhje të ngjashme kryejnë krime. Pra, e sheh krimin si sjellje e mësuar dhe që ka lidhje me sjelljen njohëse.
- v. Shpjegimet e vetëpërkufizimit, faktorëve personalë dhe njohës lindën nga paaftësia për të shpjeguar ndryshimet midis individëve.

Dy nivelet e fundit kanë lidhje me sjelljen njohëse për shkak se mendojnë që proceset e mendimit dhe besimet ndikojnë sjelljen. Për shembull, individët që kryejnë vazhdimisht vepra penale mund të shihen si të ashpër në mënyrën e të menduarit, me aftësi jo të mira për të zgjidhur problemet, impulsiv dhe egocentrik. Këto funksione nuk lidhen me inteligjencën apo personalitetin por me përdorimin jo-profesional të mendimeve/ndjenjave/sjelljes. McGuire (2000) e sheh sjelljen njohëse në lidhje me nivelin e katërt dhe të pestë, por edhe me nivelet më të ulta, sepse kërkon të njohë rëndësinë kryesore të mjedisit dhe faktorëve strukturor në kryerjen e veprave penale. Në këtë mënyrë, ai kërkon të fshijë nocionin që sjellja njohëse bazohet në një model mjekësor ose patologjik që e sheh krimin si të bazuar plotësisht në personalitet.

Diskutim:

Si do i vlerësonit individët që kanë mungesë aftësish për të menduar, perspektivë jo të mirë dhe vetëkontroll jo të mjaftueshëm?

Si do i ndihmonit të përftonin këto aftësi?

Paradigma e ndërprerjes

Kjo paradigmë është shfaqur nga fundi i viteve 1990 dhe ndryshon në metodë sepse kërkon të zbulojë çfarë i mundëson individët të mos kryejnë më vepra penale dhe nuk përqendrohet tek lloji i ndërhyrjeve të dënuarit. “Paradigma e ndërprerjes” e konsideron ndërhyrjen si mbështetje të procesit të ndërprerjes dhe jo si trajtim korrigjues. Maruna mendon se ekzistojnë tri perspektiva teorike që përbëjnë ndërprerjen (Maruna 2001):

- Reforma e pjekurisë
- Teoria e lidhjeve sociale
- Teoria narrative.

Këto teori së bashku mund të çojnë në ndërprerje të aktivitetit kriminal sepse individ i përfiton gjëra me vlerë në jetën e vet që e bëjnë të rivlerësojë jetën. Pra, jo vetëm që ndodhin disa ndryshime, por edhe janë domethënëse për individin. Në mënyrë primare dhe sekondare ndërprerja e aktivitetit kriminal përcaktohet si:

- Parësore – arritja e një periudhe gjatë së cilës nuk kryhen vepra penale
- Dytësore – individ i fiton një identitet të ri si një ish i dënuar

Maruna ka theksuar rëndësinë e identitetit të vetes dhe imazhit. Ai dalloi dy “lloje dokumentesh” në një studim mbi të dënuarit recidivistë, disa prej të cilëve hoqën dorë dhe disa të tjerë vazhduan. “Të përhershmit” e përshkruanin jetën e tyre sipas asaj që Maruna e quan “lloji i dënimit”, sepse vazhdonin ta shihnin veten si kriminelë në një jetë të kontrolluar në shumë mënyra nga forca të jashtme (fq. 75), ndërsa “ndërprerësit” shkruan “llojin e shpengimit” që i identifikonin forcat e jashtme si ndikuese, por edhe e shihnin veten në gjendje për të hequr dorë me ndihmë nga jashtë, për të pasur atë stil jetese që e kanë dëshiruar gjithmonë (fq. 87). Kështu që “ndërprerësit” shihen si individë në gjendje për t’i rezistuar dhe kapërcyer presionet në jetën e tyre.

Nga pikëpamja e teorisë së ndërprerjes ajo “çfarë funksionon”, duke theksuar programet e akredituara dhe integritetin që u jepet grupeve, ka nënvlerësuar marrëdhënien midis të dënuarit dhe mbikëqyrësit e cila është thelbësore për ndërprerjen e aktivitetit kriminal. Megjithatë, studime të mëvonshme kanë njohur rëndësinë e tyre për procesin e ndërprerjes (Raynor 2004, fq. 201). Kjo pikëpamje mbështetet nga studimet e bëra në psikoterapi sipas së cilave edhe pse disa ndërhyrje mund jenë më efektive se të tjerat, janë elementet e përbashkëta të suksesit ato që dalin në pah:

- Ndjeshmëria, respekti dhe ngrohtësia në një marrëdhënie
- Krijimi i një “aleance pune” ose “marrëdhënie terapeutike”
- Një përjasje bashkëpunuese dhe e fokusuar te individ.

Por, edhe pse këto kanë ndikim në sukses, më të rëndësishëm janë faktorët e jashtëm të tillë si: karakteristikat individuale, mundësitë, etj. Disa studime kanë vlerësuar se përmbajtja specifike e një ndërhyrjeje vlen vetëm për 15% të ndonjë ndryshimi të suksesshëm.

Për sa u përket ndërhyrjeve të drejtësisë penale, Rex thekson rëndësinë e një marrëdhënie aktive dhe përfshirëse midis të dënuarit dhe punonjësit, e cila ndihmon në përkushtimin e këtij të fundi ndaj marrëdhënies dhe objektivave të saj - heqja dorë nga krimi (Rex 1999).

Kjo vjen nga përkushtimi i punonjësit që ka krijuar një ndjesi besnikërie personale dhe përgjegjshmërie ndaj mbikëqyrësit nga ana e të dënuarit. Në një studim mbi 199 të dënuar, Farral zbuloi se në shumicën e rasteve sukse si u atribuohet vetëm ndërhyrjeve specifike të shërbimit të provës. Aftësia për të hequr dorë u atribuohet motivimit individual për të ndryshuar dhe rrethanave familjare, sociale dhe ekonomike të individit (Farrall 2002), kështu që ndërhyrja duhet të mbështesë këto procese në vend që të shohë “të metat” individuale. Edhe pse një proces i përmirësuar i përfutimit të njohurisë mund të përmirësojë atë që njihet si “kapitali njerëzor”, kjo nuk mjafton për të pasur ndryshim pa ndërtuar “kapitalin social”, d.m.th., nuk mjafton për të ndërtuar kapacitetin e nevojshëm për të ndryshuar pa krijuar edhe mundësitë për këtë gjë. Si rrjedhojë, duhen theksuar dhe faktorët që lidhen me heqjen dorë nga krimi dhe jo faktorët e lidhur me krimin. Farral i konsideron këto të fundit si retrospektivë dhe negative, që fajësojnë individin, ndërsa të parat si largpamëse dhe frymëzuese.

McNeill (2006) argumenton që këto koncepte dhe ide mund të shpjegojnë suksesin e kufizuar të ndërhyrjeve të sjelljes njohëse. Ai e quan ndërhyrjen e bazuar në heqjen dorë nga aktiviteti kriminal si një proces që:

- Fokusohet në procesin e ndryshimit dhe riparimit
- Mbështet individin në përpjekjet për të “bërë mirë”
- I jep sa më shumë zgjedhje të dënuarit brenda sistemit të drejtësisë penale
- Përdor masat alternative që çojnë në heqjen dorë dhe ndryshim pozitiv
- Përfshin bashkëpunimin në marrëdhënien me mbikëqyrësin.

Diskutim dhe rast studimor:

Si do vendosnit nëse një individ është më i përshtatshëm për një ndërhyrje të bazuar në metodën “çfarë funksionon” apo për ndërprerje të aktivitetit kriminal? Cilat karakteristika personale do i shihnit si të përshtatshme për secilin nga këto opsione? Po rrethanat personale apo qëndrimi i tyre?

Duke u bazuar në sa më sipër si do punonit me individin e përshkruar në vijim?

Femër, 33 vjeçe. Nuk ishte dënuar më parë, por kohët e fundit u deklarua fajtores në gjykatë për vjedhje nga punëdhënësi dhe iu kalua shërbimit të provës. Vjedhja konsistonte në marrjen e shumave të ndryshme parash me një vlerë deri në 350 sterlina. Ajo ishte përgjegjëse për të arkëtuar paratë në bankë, një punë që e kishte bërë për 10 vjet. Ishte një firmë e vogël familjare dhe ajo ishte një person i besuar.

Ajo ndihej shumë fajtores. Kishte respekt për punëdhënësin dhe vinte nga një “familje e respektuar”. Asnjë nga anëtarët e familjes së saj nuk kishte pasur probleme me ligjin.

Është martuar që prej 10 vjetësh dhe ka dy vajza. Bashkëshorti i saj punon në një fabrikë dhe jetojnë në shtëpinë e tyre, madje kanë edhe dy makina. Megjithatë, për shkak të shpenzimeve të pamenduara dhe faktit që të ardhurat e bashkëshortit të saj ranë menjëherë në dimër si pasojë e ndërprerjes së punës nga moti i keq, ata kishin një borxh prej 15,000 sterlinash ndaj bankave dhe me kartat e kreditit. Vjedhjen e parë e kreu në mënyrë të pakontrolluar kur do të merrte vajzën pas pune dhe duke e ditur që nuk kishte para për të paguar kujdestaren e fëmijës. Pas kësaj here, “nuk ndalonte dot” derisa e zbuluan.

Ajo nuk fliste asnjëherë për paratë me të shoqin sepse kjo ishte “puna e saj”. Kjo gjë vazhdoi të përsëritej edhe pse të dy e dinin që po u dilte situata jashtë kontrollit. Asaj i vinte keq, edhe pse pranonte “ndarjen e punëve” të shtëpisë. Si rezultat, komunikimi midis tyre po bëhej i vakët dhe po jetonin jetë emocionale të ndara. Për shkak të ndjenjave të fajit dhe turpit, ajo ka shumë mundësi të mos e kryejë më këtë vepër penale. Megjithatë, ndihet “plotësisht e padobishme” si person, nënë, partnere, etj., dhe mendon se gjërat nuk mund të përmirësohen.

Çështje për diskutim dhe pyetje:

1. “Çfarë funksionon” dhe heqja dorë janë metoda shumë të ndryshme për të ndryshuar sjelljen e një të dënuari. Si do vendosnit se kë metoda të zgjidhni për ta përdorur me një individ?
2. Sipas teorisë “çfarë funksionon”, ata autorë që kryejnë vazhdimisht vepra penale nuk kanë aftësi të mira për të menduar, nuk janë në gjendje t’i shohin gjërat nga një këndvështrim tjetër dhe kanë vetëkontroll të dobët. Si i vlerësoni këto të ashtuquajtura “mangësi të aftësisë për të mësuar”?
3. Si do i “mësonit” dikujt disa aftësi duke përdorur metodën “çfarë funksionon”?
4. Çfarë do të përfshinte një ndërhyrje e bazuar në teorinë e ndërprerjes? Çfarë do të bënit me një individ nëse do përdornit këtë metodë si punonjës i shërbimit të provës?

6. METODAT E PUNËS ME TË DËNUARIT

Puna në nivel individual. Këshillimi dhe intervistimi

6.3

Sorina Poledna dhe Eliona Kulluri

1. Intervistimi cilësor

Intervista cilësore, kuptimi i së cilës është një intervistë e përqendruar tek problemi, gjysmë e strukturuar, narrative ose biografike, përfaqëson sipas mendimit tonë përdorimin sa më të mirë të të dhënave të nevojshme për një kryerje sa më të mirë të aktiviteteve të shërbimit të provës.

Gjatë përshkrimit të secilës intervistë do të zbulohen disa argumente, por më kryesori është që intervistimi cilësor promovon një perspektivë të caktuar mbi mirëkuptimin social. Elementët e kësaj perspektivë janë:

- a) Mirëkuptimi mund të arrihet duke inkurajuar të intervistuarit që të përshkruajnë botën e tyre me fjalët e tyre;
- b) Intervistimi përfshin një marrëdhënie specifike midis intervistuesit dhe të intervistuarit sipas së cilës të dyja palët e përfshira në komunikim kanë nga një rol;
- c) Elementi i tretë merr në konsideratë faktin që ky lloj intervistimi përfshin një aspekt etik nga pikëpamja e studimit që bëhet në bazë të intervistës.

Si rezultat, intervistat cilësore na fusin në universin faktik, njohës dhe emocional të individit nëpërmjet rrëfimit të tij/saj. Mund të ketë rrëfime, “histori nga jeta”, biografi

ose informacion mbi një problem të caktuar që ka lidhje me punën në shërbimin e provës. Në çdo rast, njohuria që vjen si rezultat i intervistimit tregon perspektivën e të intervistuarit. Kjo çon në një njohje më të mirë të personit të intervistuar dhe të nevojave kriminogjene, të burimeve, vlerave dhe të sjelljes së tij/saj kriminale.

Çfarë është intervistimi cilësor? Çfarë roli ka ai?

Intervistimi cilësor thekson idenë që po përdorim një metodë dhe në të njëjtën kohë një instrument të përdorur për të studiuar një fragment të realitetit social. Intervistimi cilësor përkufizohet edhe në mënyrën në vazhdim: dëgjon njerëzit kur përshkruajnë botën e tyre, universin ku punojnë dhe jetojnë ata.

Intervistimi cilësor eksploron tema specifike, situata jetësore, ngjarje ose “ndodhi”. Kjo do të thotë që po flasim për diçka që ka ndodhur, një ngjarje që përmban një intrigë, një konflikt, për protagonistë që ndërveprojnë, ndoshta që diskutojnë diçka në përgjithësi. Shpesh këto fakte dhe ngjarje ndodhin sipas një rrjedhjeje kohore. Por ka edhe raste kur intervistimi cilësor i eksploron ndryshimet më thellë sesa në nivel individual për t’i përdorur si studimet për programe të tilla si p.sh., të reformës sociale.

Karakteristikat e përbashkëta të intervistave cilësore janë:

- 1) vazhdim i bisedës së ndodhur gjatë ditës por me disa nota të ndryshme;
- 2) intervistuesi është i interesuar të kuptojë dhe njohë aspektet specifike të të intervistuarit pa treguar interes për etiketimin dhe/ose eksperiencat e tij/saj;
- 3) përmbajtja e intervistave është elastike, d.m.th që intervistuesi drejton intervistën. Në këtë mënyrë mund të zhvillohet një komunikim miqësor, pa lodhje apo kohë shtesë.

Këto tri karakteristika janë thelbësore sepse janë ato që e dallojnë intervistimin cilësor nga metodat e tjera të mbledhjes së informacionit.

2. Intervista e fokusuar tek problemi

Intervista e fokusuar tek problemi është gjysmë e strukturuar, por është më e strukturuar sesa intervista narrative apo biografike.

Kjo lloj interviste i fokuson përpjekjet investiguese në problematikën që ka lidhje të drejtpërdrejtë me sjelljen kriminale të personit të mbikëqyrur dhe në situatën e tij/saj psiko-sociale. Kjo lloj interviste është e hapur, d.m.th., që e lejon intervistuesin të kuptojë më mirë personin nën mbikëqyrje. Nga ana tjetër, i intervistuari mund të komunikojë hapur, të shprehë mendimet e veta dhe të zgjedhë vetë çfarë lloj informacioni të japë dhe mënyrën si të prezantojë këtë informacion.

Intervista e fokusuar tek problemi është efikase. Efikasiteti mund të shpjegohet nga fakti që shmanget përdorimi i pyetjeve tepër hetuese. Kështu kursehet më shumë kohë dhe burime sepse hetohet një aspekt i caktuar që është i domosdoshëm për të trajtuar problemin dhe i intervistuari është gati të diskutojë temën e propozuar.

Duhet përmendur që para se të fillohet kjo lloj interviste duhet të kuptohet mirë drejtimi i saj dhe përpjekjet për vlerësim, si dhe drejtimi dhe objektivi i monitoruar nëpërmjet informacionit të mbledhur nga kjo intervistë. Ndryshe, fokusi nuk do të jetë i saktë dhe mund të humbasë informacioni i rëndësishëm dhe përkatës.

Sipas teorisë mbi intervistën e fokusuar në problem, zbatohen parimet e mëposhtme:

- 1) *fokusimi te problemi* – intervista duhet të fillojë me problematikën sociale;
- 2) *orientimi i bazuar në objektin e studiuar*: sipas këtij parimi forma konkrete e intervistës të fokusuar te problemi duhet t'i referohet objekteve të studiara dhe jo të përdorë disa instrumente të gatshme;
- 3) *parimi i përpunimit* – përfaqëson një analizë elastike të fushës problematike, mbledhjen dhe kontrollin hap pas hapi të informacionit. Në këtë mënyrë krijohet lidhja dhe konfigurimi i elementëve të njohurive dhe evidentohen nëpërmjet një qëndrimi reflektues ndaj metodës së aplikuar.

Intervista e përqendruar te problemi përfshin:

1) *Formulimin dhe analizën e problemit të analizuar nëpërmjet intervistës* i cili kryhet gjithmonë para pranimit të intervistës. Intervistuesi (punonjësi i shërbimit të provës) analizon nevojën për informacion sipas kushteve specifike të aktivitetit të shërbimit të provës, formulon problemin që duhet sqaruar nëpërmjet intervistës dhe krijon një formim të duhur teorik;

2) *Përpilon intervistën në bazë të ndarjes së temave/problemit që është edhe subjekti i intervistës* – në këtë fazë i intervistuari përqendrohet në një temë të caktuar të ndarë në nën-tema në formën e pyetjeve të drejtuara të intervistuarit; *struktura e intervistës* shpreh në një rend logjik drejtimin e saj nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve në mënyrë që të përmbushet qëllimi i intervistimit;

3) *Faza pilote* – është faza e verifikimit dhe testimit të intervistës për të parë nëse duhet ndryshuar një pjesë ose e gjithë struktura e intervistës. Ky testim bëhet kryesisht në kontekstin e studimeve sociologjike dhe më pak në bazë të aktivitetit të vërtetë të shërbimit të provës;

4) *Faza e intervistës së vërtetë* – ka për qëllim të marrë informacion nëpërmjet tri

kategorive kryesore të intervistës: kategoria e pyetjeve thumbuese, drejtuese, ose pozitive dhe pyetjet specifike. Zakonisht nëse i intervistuari bie dakord, intervista regjistrohet. Në rast se i intervistuari refuzon gjatë diskutimit apo menjëherë pas intervistës mbahet një protokoll.

Kjo intervistë zgjat mesatarisht 90-120 minuta.

3. Aspektet teknike të intervistës

“Intervista është një sistem social specifik që shërben për të arritur një qëllim të caktuar”. (Kadushin, 1990, fq. 206)⁷¹

Për shërbimin e provës, intervista është instrumenti kryesor që punonjësi i shërbimit të provës përdor gjatë aktivitetit të tij/saj profesional për të ushtruar rolin dhe kompetencat si mbikëqyrës dhe në ofrimin e ndihmës psiko-sociale ndaj personave autorë të veprave penale. Aspektet bazë teknike të intervistës paraqiten në faqet në vazhdim duke treguar mënyrën sesi kjo metodologji e llojit të punës sociale mund dhe duhet të transferohet në punën e shërbimit të provës sipas specifikave dhe qëllimit të tij. Për këtë arsye, analiza e intervistës , e procesit të intervistimit, bëhet drejtpërdrejt nga perspektiva e përdorimit të këtij instrumenti në fushën e punës sociale. Intervista në fushën e punës sociale është një *ndërveprim* komunikimi me një *qëllim* të caktuar dhe që pranohet nga të dyja palët pjesëmarrëse në komunikim – intervistuesi (punonjësi social) dhe i intervistuari (klienti dhe/ose objektivi dhe/ose sistemet përkatëse).

Aspektet teknike të intervistës:

- Përdoret përmbajtja e llojit “punë-sociale” e intervistës për të lehtësuar përmbushjen e qëllimit specifik të punës sociale;
- Gjatë intervistës, intervistuesi dhe i intervistuari marrin role dhe detyra të ndryshme, ndërveprimi midis tyre është plotësues dhe jo reciprok për sa i përket formës së intervistës;
- Intervistuesi duhet të zgjedhë dhe planifikojë intervistën qëllimisht për të mbështetur qëllimin e saj; intervista është komunikim me një përshtjellim të planifikuar;
- Zakonisht intervista ka një kohë, vend dhe orar të caktuar zyrtarisht;
- Intervistuesi është i detyruar të pranojë kërkesën e një klienti për intervistë në frymën e vlerave dhe deontologjisë së punës sociale.

Intervistat nga puna sociale përfshijnë njerëz me probleme ose në situata problematike ku:

- Përmbajtja e diskutimit është konfidenciale (shikoni kufijtë e konfidencialitetit);

71. Prezantimi i intervistës dhe i aftësive e teknikave të nevojshme për të kryer intervistën ka ndjekur strukturën e propozuar nga A. Kadushin në “Intervista e punës sociale”, botimi III, Columbia University Press N.Y., 1990

- Fokusi është te klienti/intervista;
- Kërkohej maksimizimi i pjesëmarrjes së të intervistuarit, duke minimizuar standardizimin dhe si rrjedhojë, duke rritur individualizimin e intervistës;
- Funkcioni dhe natyra e profesionit zakonisht përcakton përmbajtjen e intervistës në punën sociale.

Intervista mund të ketë tre lloj qëllimesh:

- 1) Informuese ose anketim social;
- 2) Diagnostike ose vlerësuese;
- 3) Qëllim terapeutik ose për të kryer një ndryshim.

“Procesi i intervistimit është një lëvizje dinamike e kryer në mënyrë të ndërgjegjshme në disa faza të njëpasnjëshme, për të përmbushur qëllimin e intervistës.” (Kadushin, 1990)

4. Fazat e intervistës

Dallohen tri faza të ndryshme gjatë një interviste:

- A. Faza hyrëse
- B. Faza e mesme ose zhvillimi i intervistës
- C. Faza përfundimtare e intervistës.

Secila fazë shpjgohet më hollësisht në vijim.

A. Faza hyrëse e intervistës

Në literaturë thuhet se *intervistimi fillon para se të fillosh intervistën* ... Ideja e këtij pohimi është që intervista, të gjitha aspektet e saj, ndikohet nga ajo çfarë ka ndodhur ose jo para se ajo të fillojë.

Mënyra sesi një intervistë fillohet dhe vazhdon lidhet me:

- Faktin që intervista po zhvillohet me një *klient vullnetar ose jo-vullnetar*.
- *Motivimin fillestar* ose mungesën e tij për të kryer intervistën. Punonjësi social është *përgjegjës* për të ruajtur motivimin fillestar ose për të krijuar motivim te klienti.
- *Vendndodhjen* ku do të kryhet intervista. Për shembull, intervista mund të zhvillohet në zyrën e shërbimit të provës ose në një zyrë të institucionit të punës sociale ose në banesën e të intervistuarit, ose në një institucion (azil për të moshuarit, spital, burg).

U duhet kushtuar vëmendje e veçantë këtyre aspekteve:

- Mjedisi nuk duhet të prishë komunikimin
- Nuk duhet tërhequr vëmendja
- Në intervistë duhet të merret parasysh “vendndodhja”
- *Njohuritë profesionale dhe personale të intervistuesit kanë këtë kuptim:*
 - Punonjësi i shërbimit të provës rishikon informacionin nga intervistat e kaluara apo të përfutur në ndonjë mënyrë tjetër;
 - Rikujton njohurinë teorikë mbi përmbajtjen e intervistës së ardhshme;
 - Përcakton se çfarë do të arrijë nëpërmjet intervistës;
 - Strukturën e intervistës për të përfshirë konkretizimin e qëllimit të intervistës.
 - Përcakton kufijtë e kohës të intervistës, përcakton se çfarë mund të quhet informacion konfidencial, përgatit pyetjet, etj.

Fillimi i intervistës përbën momentin kur vëmendja u kushtohet:

- Përcaktimi i formulës së metodës që intervistuesi përdor me klientin;
- Formulave të mirësjelljes:
 - Të flasim shkurt
 - Të bëjmë kalimin në një marrëdhënie më profesionale (specifike për shërbimin e provës)
 - Të përqendrohemi te klienti.
- Përcaktimi i *qëllimit* të intervistës – detyra kryesore e fazës fillestare të intervistimit;
- Formulimi i pyetjes për të hapur intervistën:
 - Të jetë e lehtë për t’u përgjigjur;
 - T’i shërbejë ndërveprimit të dyanshëm;
 - Të orientojë diskutimin në intervistë, si për shembull: Pse jeni këtu?
 - Çfarë prisni nga ne? Çfarë mendon se mund të bëjmë për ju?

Kujdes!!

- ◆ Qëllimi duhet formuluar saktë dhe i duhet shpjeguar qartë të intervistuarit;
- ◆ Qëllimi duhet të jetë realist;
- ◆ Qëllimi duhet të jetë objektiv;
- ◆ Qëllimi duhet të jetë i matshëm;
- ◆ Qëllimi nuk duhet të jetë i përgjithshëm;
- ◆ Qëllimi duhet formuluar në mënyrë konkrete si nga i intervistuari edhe nga intervistuesi.

P.sh. Vlerësimi i burimeve të klientit me qëllim që të sigurojë një punë.

Në fushën e punës sociale, objektivat e fazës së parë janë:

- Një identifikim i qartë dhe i saktë i problemit të klientit;
- Ndërtimi i një marrëdhënie me punonjësin social dhe nëpërmjet tij/saj me institucionin/organizatën që ofron asistencë sociale;
- Motivimi i klientit që të japë intervistën;
- Sigurimi i informacionit mbi shërbimet, programet e institucionit/organizatës dhe burimet ekzistuese për problemin e klientit;
- Të përcaktohet se çfarë është i gatshëm të bëjë klienti për problemin e vet;
- Të përcaktohet dimensionet, kohëzgjatja dhe intensiteti i problemit të klientit.

Në punën e shërbimit të provës, disa nga komponentët janë specifike për misionin dhe objektivat e shërbimit të provës. Si rrjedhojë, gjatë takimit të parë me personin e mbikëqyrur, punonjësi i shërbimit të provës shpjegon kuptimin e shërbimit të provës i cili përfshin informacion në lidhje me sanksionet e vendosura për të dënuarin, përgjegjësitë dhe të drejtat e tij, etj.

E rëndësishme!

Objekti i fillimit të intervistës ose intervistës fillestare është të *ndihmojë të intervistuarin të bëhet klient.*

Intervista fillestare (fillimi) ose faza fillestare e intervistimit zbulon situatën e klientit. Komunikimi i brendshëm ka të bëjë më shumë me socializimin e klientit me rolin e tij në intervistë. Ka lidhje me përdorimin e teknikave që maksimizojnë zhvillimin e marrëdhënies midis të intervistuarit (klientit) dhe intervistuesit (punonjësit social). Mund të thuhet se punonjësi social drejton dhe është më aktiv (se në fazat e tjera).

Aftësitë dhe kompetencat e nevojshme në fazën hyrëse të intervistës:

- Njohuri sesi të sillesh për të ndihmuar klientin të flasë më hapur dhe lirshëm dhe që intervistuesi të flasë më pak;
- Aftësi komunikuese që tregojnë se po interesoheni për atë çfarë po thuhet;
- Ndërgjegjësimi i mënyrës së qëndrimit të klientit;
- Njohuri sesi të modifikoni qëndrimin tuaj për të krijuar një marrëdhënie me secilin individ. Njerëz të ndryshëm dhe grupe të ndryshme kulturore zakonisht mbajnë qëndrime të ndryshme;
- Të keni disa burime për ato raste kur ndiheni konfuz gjatë intervistës. Edhe më profesionisti nuk e di gjithmonë se si do shkojnë punët. “Kur nuk dini çfarë të bëni, merrni pjesë” (Ivey, 1994, fq. 21).

Një nga aftësitë më të rëndësishme u referohet *formulimit dhe bërjes së pyetjeve*, si edhe *dëgjimit aktiv*.

Pyetjet përfshihen shumë shpesh në kryerjen e çfarëdo interviste. Pyetjet ndihmojnë të fillojë intervista. Me klientin që flasim, pyetjet e hapura lehtësojnë diskutimin e lirë dhe japin hapësirë të bollshme për të biseduar. Ja disa shembuj:

“Për çfarë do t’iu pëlqente të flasim sot?”

“Mund të më tregoni për çfarë keni ardhur të më takoni?”

“Si kanë shkuar punët që herën e fundit që jemi takuar?”

“Herën e fundit që u takuam ne folëm për tensionin që ndjen kur shikon ndeshje futbolli. Po kësaj jave si shkoi?”

Tri pyetjet e para të hapura sigurojnë hapësirë të konsiderueshme, në të cilin klienti mund të flasë për çdo gjë. Pyetja e fundit është e hapur por siguron një farë fokusimi për tensionin, e ndërtuar në materialin e marrë gjatë javës së shkuar.

Punonjësi social (intervistuesi) bën pyetje që kanë qëllime të ndryshme, si p.sh.:

- Të zgjerojë territorin e të intervistuarit;
- Të thellohen më shumë;
- Të ndihmojë në zgjidhjen e problemit;
- Të eksplorojë problemin dhe situatën e klientit;
- Të aktivizojë të intervistuarin që të ndajë informacion faktiv dhe ndikues;
- Të inkurajojë të intervistuarin të flasë dhe të tregojë historinë e vet;
- Të ndihmojë të intervistuarin që të organizojë dhe sistemojë prezantimin e vet, duke siguruar që të përfshijë gjithë informacionin e duhur;
- Të inkurajojë të intervistuarin që të konsiderojë alternativat;
- Të socializojë klientin në rolin e të intervistuarit;
- Të tërheqë vëmendjen e të intervistuarit që të eksplorojë, të kuptojë dhe të jetë aktiv;
- Ta bëjë të intervistuarin të ndihet i respektuar dhe i lirshëm gjatë intervistës.

Shembull.

“A mund të më tregoni pak më shumë për këtë gjë?” - Kjo është një lloj pyetjeje që tregon qëllimin për të eksploruar më tej të intervistuarin.

“Si e interpretoni reagimin tuaj?” – Kjo lloj pyetje tregon qëllimin e të kuptuarit të informacionit të përfutur.

“Sipas mendimit tuaj, çfarë mund të bëhet në këtë rast?” – Kjo pyetje tregon qëllimin e të qenit aktiv.

Zakonisht, pyetjet e hapura ose pyetjet e mbyllura që mund të marrin përgjigje të ndryshme përdoren më shumë në intervistë (sesa pyetjet e mbyllura me përgjigje po

ose jo. Në këtë mënyrë i intervistuari ka më shumë mundësi për:

- Të zgjedhur përgjigjen nga një numër më i madh mundësish;
- Të përgjithësojë fushën personale të referencave;
- Të zgjedhë ato elementë nga situata e vet që duken më problematike dhe shqetësues;
- Të ndihet përgjegjës dhe i lirë për të marrë pjesë në intervistë dhe në përcaktimin e përmbajtjes dhe drejtimit të intervistës;
- Të ketë motivim të përshtatshëm për të krijuar një marrëdhënie pozitive komunikimi.

Pyetjet e hapura:

- Mund të jenë të dykuptimshme;
- Mund të frikësojnë, stresojnë një klient që është më pak kompetent dhe/ose ka më pak eksperiencë në rolin e të intervistuarit;
- Janë më pak efektive në rastin e një klienti që i pëlqen të flasë, është armiqësor ose nervoz.

Pyetjet e mbyllura përdoren:

Pasi është përfutur një sasi informacioni, por kanë mbetur ende disa detaje të padiskutuara;

Kur i intervistuari nuk është i sigurt se çfarë duhet të bëjë;

Kur situata duket e ngatërruar;

Kur intervistuesi ka nevojë për informacion të saktë;

Kur nevojitet më shumë qartësi dhe përqendrim nga ana e të intervistuarit;

Kur intervistuesi dëshiron të ketë më shumë kontroll mbi informacionin;

Kur nevojitet që të kufizohen disa tema që janë jashtë qëllimit të intervistës dhe nuk kanë lidhje me të;

Kur intervistuesi e ndihmon të intervistuarin e heshtur të nisë të flasë (të tregojë);

Kur duhet të pakësohet ndërveprimi dhe shkalla e emocionalitetit;

Ndonjëherë, kur prezantohet një temë e re dhe i intervistuari nuk ndihet mirë me një pyetje të hapur; një pyetje e hapur bëhet vetëm pasi tema është prezantuar dhe i intervistuari ka nevojë për inkurajim që të diskutojë këtë temë;

Kur koha për zhvillimin e intervistës është e shkurtër.

Pyetje me një fokus të ndryshëm:

Mund të fokusohen në periudha të ndryshme kohore, si p.sh.: “*çfarë ka ndodhur në marrëdhënien me familjen tuaj javët e fundit përpara se të kryenit veprën*

penale?” ose “Si ndiheni fizikisht në këto momente?”

ose

Mund të fokusohet te mendimet, ndjenjat ose sjellja, si p.sh.: *“çfarë po mendonit kur vendosët të braktisnit shkollën?”*

Pyetje konkrete qartësuese:

Bëhen kur:

- Përmbajtja nuk është e qartë;
- Duhet qartësuar një informacion i dykuptimtë;
- Nevojiten më shumë detaje;
- Nevojiten më shumë informacione specifike.

Pra, këto lloj pyetjesh përdoren kur përgjigja e mëparshme e të intervistuarit ka qenë e pamjaftueshme, pa lidhje, e paqartë ose e paqëndrueshme.

Formulimi i pyetjeve

Gabimet më të shpeshta në formulimin e pyetjeve janë:

- Ato sugjerojnë përgjigjen;
- E dyfishojnë pyetjen;
- Përdoret shpesh pyetja “pse”;
- Pyetje jo të plota.

a) Pyetjet që sugjerojnë përgjigjen bazohen në paragjykimin e intervistuesit në lidhje me përgjigjen që do të japë i intervistuari. I intervistuari nuk do ndihet i lirë në formulimin e përgjigjes por do të ndjekë sugjerimin që vjen nga pyetja (për shembull, “Ju me siguri që i doni dhe i respektoni prindërit tuaj, apo jo?”) ose përgjigja mund të sugjerohet nëpërmjet një faze mohuese (për shembull, “Ma merr mendja që nuk po mendonit të iknit nga shtëpia pa gjetur më parë një punë?”)

b) Pyetjet e dyfishta – zakonisht janë një gabim që intervistuesit e rinj bëjnë sepse pyesin dy pyetje në një. Si rezultat i intervistuari hutohet dhe nuk di kujt pyetjeje t’i përgjigjet. Zakonisht preferon t’i përgjigjet pyetjes më të thjeshtë që shumë herë është më pak produktivja në lidhje me qëllimin e intervistës. Intervistuesi mund të harrojë që nuk i është dhënë përgjigje pyetjes së parë kur bën pyetje të tilla si: “Që kur keni pasur konflikt me vëllezërit tuaj? Çfarë ndodh në këto situata konflikti?”

c) Pyetja “Pse” – është një nga ato pyetje që përdoren më shpesh nga ç’duhet. Është një pyetje e vështirë për të intervistuarin sepse:

- Kërkon një rrëfim racional rreth sjelljes së tij/saj; kjo gjë zakonisht është e pamundur për të intervistuarin – prandaj edhe të kuptuarit e situatës/ shpjegimit është shpesh qëllimi i kontaktit terapeutik;
- Kur bëhet fjalë për një sjellje vetëshkatërruese, shumë njerëz e kanë të vështirë të shpjegojnë përse janë sjellë ashtu – kjo shton stresin e tyre, pamjaftueshmërinë dhe qëndrimin mbrojtës;
- Në disa raste inkurajon tendencën për t'u sjellë në mënyrë racionale duke fshehur realitetin.

d) Pyetjet e paplota – dalin më shpesh kur intervistuesi nuk di çfarë të pyesë sepse ai/ajo nuk ka përgatitur një strukturë të intervistës. Në këto raste, mesazhi i përcjellë nga intervistuesi nuk është i plotë.

Kujdes!!

Pyetjet duhet të jenë:

- Të kuptueshme;
- Jo të dykuptimta;
- Të shkurtra (një pyetje më e gjatë se dy fjali konsiderohet shumë e gjatë).

Shembuj pyetjesh të dobishme për t'u përdorur në intervistë:

Cilat janë shqetësimet tuaja (të gruas/të dashurës suaj, etj.)?

Si ju ka shkaktuar telashe fakti që . . . ? Çfarë gjërash të mira ka . . . ? Çfarë janë disa nga gjërat jo të mira të.....?

Si do të përmirësoheshin gjërat nëse do kishit bërë këtë ndryshim?

Çfarë keni menduar rreth këtij ndryshimi?

Çfarë mendoni se do ndodhë nëse ju nuk . . . ?

Çfarë do donit të kishte ndryshuar në jetën tuaj pas një viti?

Ku dëshironi që të jeni?

Në çfarë rrethanash është më e vështirë për ju të qëndroni pa pirë?

Ka disa gjëra që mund t'ju ndihmojnë (jepni një listë të shkurtër). Cilat nga këto sugjerime do dëshironit të provonit?

Për këto gjëra duhet të flasim (jepni një listë të shkurtër). Për cilat nga këto tema do donit të flisnit si fillim?

Nga 1 në 10, sa e rëndësishme është për ju të ndryshoni . . . ?

Nëse do donit të ndryshonit, si do vepronit?

Kush do ju ndihmonte (ndihmojë) të . . . ?

Çfarë ka funksionuar për ju në të kaluarën?

Me cilën nga këto gjëra do donit të fillonit të punonit?

Cila do të ishte një kohë e mirë për të filluar?

Si do mund ta bënit (si do ia bëni?)?

Si mund ta realizoni këtë gjë?

Çfarë mund të bëj që t'ju ndihmoj të keni sukses në . . . ? Çfarë tjetër?

B. Faza e mesme ose zhvillimi i intervistës

Kjo fazë përfaqëson atë pjesë të procesit të intervistës kur arrihet qëllimi për të cilin intervistuesi dhe i intervistuari kanë rënë dakord në fazën hyrëse.

Në këtë fazë, intervistuesi u kushton vëmendje:

- Vazhdimet të ndërveprimit emocional me të intervistuarin në një nivel të pranueshëm;
- Ruajtjes së një marrëdhënieje pozitive;
- Të ndihmojë të intervistuarin të shprehë shqetësimet e veta që kanë lidhje me qëllimin e intervistës;
- Ta kalojë intervistën nga njëra nën-temë tek tjetra drejt qëllimit të caktuar;
- Të ndihmojë të intervistuarin të diskutojë disa nga këto nën-tema më me ndjenjë emocionale;
- Të ndihmojë të intervistuarin të identifikojë detyrat instrumentale për zgjidhjen e problemeve të veta.

Kujdes!!

Në këtë fazë të intervistës, punonjësi social duhet të planifikojë strategjinë e procesit të intervistimit me qëllim për të balancuar:

- *Kohëzgjatjen e intervistës* (variacioni dhe sasia e të dhënave që kanë lidhje me qëllimin e intervistës) dhe
- *Intensitetin e intervistës*.

Këto dy aspekte janë në antitezë, d.m.th., nëse intervista bëhet e përgjithshme atëherë nuk mund t'i trajtojë të gjitha këto çështje në imtësi.

Aftësitë për të intervistuar gjatë fazës së mesme të intervistës

1. Aftësi në lidhje me shtrirjen dhe intensitetin e intervistimit

1.1. Aftësitë për eksplorim dhe ndjekje të intervistës – përdoren kryesisht në pjesën e parë të intervistës kur punonjësi social përpiqet të identifikojë dhe shpjegojë sa më qartë të jetë e mundur natyrën e problemit dhe kontekstin ku shfaqet problemi i të intervistuarit.

Aftësitë eksploruese dhe ndjekëse përfaqësojnë ato veprime të vëzhgueshme të punonjësit social që tregojnë se është i interesuar dhe i kushton vëmendje të intervistuarit. Këtu mund të identifikohen dy komponentë:

a) Aftësitë jo-verbale (kontakti vizual dhe qëndrimi trupor):

Kontakti vizual duhet të jetë:

- I qetë – jo zhbirues dhe mos të tregojë neveri
- Në përputhje me një reagim që tregon rrjedhshmërinë e komunikimit me të intervistuarin.

Qëndrimi trupor duhet të tregojë:

- Intensitetin e pranisë së intervistuesit
- Çfarë nënkupton
- Shqetësimin për të përmbushur qëllimin e intervistës
- Dëgjimin aktiv të asaj çfarë po thotë i intervistuari
- Singleritet
- Pranim.

b) Aftësitë verbale si, inkurajimi, perifrazimi/përmbledhja/kalimi nga një temë te tjetra.

Ky komponent shpreh faktin që përgjigja e të intervistuarit nga njëra anë dhe pyetja/komenti i punonjësit social nga ana tjetër kanë të njëjtën:

- Rrjedhshmëri komunikimi;
- Qëndrimi emocional ndaj afirmimeve të intervistuarit reflekton intensitetin emocional nga pohimi i mëparshëm i intervistuesit.

Sa më sipër shprehen dhe konkretizohen nëpërmjet:

Inkurajimeve:

- Ndërhyrjet e intervistuesit janë pa ndonjë mesazh/përmbajtje personale,
- Motivon të intervistuarin për të vazhduar bisedën;
- Përfshin *elementë verbalë*, të tillë si: “Pra...”, “E kuptoj...”, “Dhe pastaj...”,

“Ëhë, e kuptoj...”, “Hmm...”, “Të lutem, vazhdo...”; dhe elementë jo verbal: shprehja e fytyrës, kontakti vizual, përkulja e trupit në mënyrë pohuese. Këto elementë mund t’i tregojnë të intervistuarit që punonjësi social është i interesuar në atë çfarë ai/ajo po thotë;

- Përdoren kur: a) i intervistuari fillon të flasë, të përgjigjet; b) i intervistuari është tashmë aktiv, i përfshirë në komunikim.

Kujdes!!

Inkurajimet e tilla si *“hmmm...”, “ëhë...”* nuk duhen bërë automatikisht sepse mund t’u humbasë efektiviteti.

Perifrazimi:

- Është një ri-afirmim selektiv i idesë kryesore nëpërmjet frazave të ngjashme, pa përsëritur po ato që ka përdorur i intervistuari; nëpërmjet perifrazimit intervistuesi riafirmon ato çfarë ka thënë i intervistuari, por duke përdorur fjalët e një punonjësi social;
- Duhet të jetë i saktë dhe t’i përmbahet idesë së klientit;
- Ka mënyra të ndryshme formulimi për mos ta bërë perifrazimin mekanik: *“Nëse e kam kuptuar mirë ...”, “Me fjalë të tjera ...”, “Dëgjova se thatë që ...”*

Kujdes!!

- Perifrazimi bëhet në formë afirmimi jo pyetjesh.
- Afirmimet janë reflektive.
- Afirmimet janë emocionalisht neutrale.
- Afirmimet nuk duhet të shprehin as miratim dhe as mosmiratim.
- Afirmimet nuk duhet të përfundojnë atë çfarë i intervistuari dëshironte të shprehte.
- Perifrazimi e ndihmon intervistuesin të kontrollojë ato çfarë ka kuptuar nga fjalët e të intervistuarit.
- Perifrazimi e ndihmon intervistuesin të dëgjojë më mirë atë çfarë ka thënë vetë.

Përmbledhja:

- Rishikon shkurtimisht diskutimin dhe në këtë mënyrë drejton intervistën,
- Përmbledh çfarë është përmendur dhe çfarë ka mbetur pa u diskutuar, pra tregon se cilave tema/aspekte u duhet treguar kujdes,
- Shpeshherë tregon faktin që i intervistuari ka për qëllim ta kalojë rrjedhën e intervistës në një temë tjetër,

- Ndonjëherë, kur përmbledhja është më e gjerë, mund të zëvendësojë mbylljen e intervistës duke ofruar edhe një imazh të asaj çfarë është arritur gjatë intervistës,
- I vë në dukje aspektet e rëndësishme të përmendura gjatë intervistës,
- Është përzgjedhëse.

Kujdes!!

1. Kur intervistuesi përmbledh dhe bën një përzgjedhje ndryshe nga pritjet e të intervistuarit, atëherë nevojitet mendimi i të intervistuarit. Për shembull, pas përmbledhjes intervistuesi mund të pyesë: “Si mendoni ju?”, “Çfarë mendoni për këto që sapo thashë?”
2. Pjesëmarrja e përbashkët e të intervistuarit dhe intervistuesit në përmbledhje është e domosdoshme.

Fjalë çelës

Në qoftë se do të dëgjoni me kujdes klientët, do të gjeni që disa fjalë shfaqen përsëri në përshkrimin e situatës. Duke dalluar fjalët e tyre çelës dhe duke ndihmuar ata të eksplorojnë faktet, ndjenjat dhe kuptimet, si dhe nënvizimi i atyre fjalëve mund të jetë i dobishëm. Fjalët përshkruese çelës janë shpesh struktura nga e cila një klient organizon botën; Këto fjalë mund të sjellin kuptime nënvizuese. *Nënvizimi verbal* nëpërmjet theksimeve vokale është një tjetër gjurmë ndihmuese në përcaktimin se çfarë është më e rëndësishme për një klient. Nëpërmjet intonacionit të zërit dhe volumit, klienti tenton të theksojë fjalë apo fraza të veçanta që janë më të rëndësishme për ta.

Ju do të gjeni që duke iu bashkuar klientit në përdorimin e fjalëve çelës lehtësohet kuptueshmëria juaj dhe komunikimi me ta. Nëse fjalët e tyre janë negative dhe vetëposhtëruese, reflektoni ato perceptime herët në intervistë, por më vonë ndihmohuni ato të përdorin më tepër përshkrime pozitive për të njëjtat situata ose ngjarje. Shpesh ju do të synoni të ndihmoni klientin të ndryshojë nga “Unë nuk mundem” në “Unë mundem”.

Mbivendosja (Lankton, 1980) është një term që thekson dobinë e sistemeve perceptuese të shumëfishta në ndihmën që i japim klientit të përshkruajë një ngjarje. Mund të takoni një klient që flet për një problem me bashkëshortin/bashkëshorten, p.sh., me terma abstrakte. Pyetni klientin për një shembull konkret të problemit; më pas vazhdoni me pyetje se si bashkëshorti dhe situata përshkruhen nga ana vizuale, çfarë tingujsh ka dëgjuar dhe më në fund çfarë ndjenjash janë gjeneruar tek klienti. Në qoftë se ju jeni empatik dhe përdorni konceptin e mbivendosjes në mënyrë të ndjeshme, ju mund të siguronit një kuptim shumë më të thellë të asaj çfarë po thotë klienti. Do të shihni se keni rikrijuar shumë nga problemi, dhe keni nxitur reflektimin

e klientit për problemin, nëpërmjet asaj që në intervistim dhe këshillim quhet ndryshe “tani dhe këtu”.

Kështu, nëpërmjet vëzhgimit efektiv dhe shprehive të dëgjimit, ju mund të ndihmoni klientin të rikrijojë probleme apo situata që ata kanë provuar. Disa, ndoshta shumica, e klientëve do të flasin më tepër rreth problemeve të tyre sesa të ribëjnë eksperiencat e drejtpërdrejta. Përdorimi i këtyre teknikave mund të ndihmojë klientë të tillë që të sjellin problemin sa më real. Së pari, iu kërkohet atyre të qetësohen, ndoshta duke mbyllur sytë. Më pas iu kërkohet të shohin problemin, ta përfytyrojnë me mendje. Pas kësaj iu kërkohet të dëgjojnë personin duke iu folur atyre dhe të kujtojnë çfarë ju kanë thënë. Vëzhgimi juaj ju tregon se kur klienti është “brenda” në eksperiencë. Më në fund, pyetini çfarë ndjejnë ata. Nëpërmjet këtij përdorimi të mbivendosjes, ju do t’i rikrijoni pamjet, tingujt dhe ndjenjat e situatave të kaluara. Kjo mund të përdoret për një kuptueshmëri më të thellë nga ana juaj dhe nga ana klientit po ashtu.

Thënie të dobishme gjatë intervistës

Faleminderit që erdhët në kohë!

Mund t’ju duket se njerëzit po e zmadhojnë këtë situatë.

Nuk mendoni se unë e kuptoj situatën tuaj?

Në këtë pikë, nuk ju duket dhe aq me rëndësi.

Pija ka disa aspekte pozitive për ju.

Është stresuese (Është stresuese të jesh këtu).

Është e vështirë (E di që kjo mund të jetë e vështirë për ju).

Është e zorshme (Mund të mos jetë e lehtë për ju).

E kuptoj pse mendoni kështu.

Pra, juve ju shqetëson më shumë....

Dëshironi të bëni gjënë e duhur.

Është ide e mirë.

Mendoj se mund t’ia dilni mbani nëse dëshironi vërtet.

Mendoj se do funksionojë.

Faleminderit që folët me mua.

E vlerësoj sinqeritetin tuaj.

1.2 Aftësitë instrumentale për të ndikuar dhe ndryshuar situatën – përdoren në fazat më të avancuara të intervistës, kur të dyja palët përpiqen të zgjidhin problemin.

Intensiteti ose thellësia e intervistimit

Pasi preken të gjitha fushat që kanë lidhje me qëllimin e intervistës, punonjësi social (intervistuesi) dhe i intervistuari identifikojnë ato tema që duhen trajtuar në një nivel më emocional.

Kjo ka lidhje me intensitetin e ndjenjave dhe tregon sesa personale janë. Ka lidhje me ndjenjat e të intervistuarit për atë çfarë ka ndodhur dhe atë që ai/ajo ka treguar. Aftësitë dhe teknikat që intensifikojnë intervistën janë:

- Teknikat identifikuese

Kanë lidhje me pyetjet e përdorura për të zbuluar ndjenjat dhe për të inkurajuar diskutimin, si p.sh.: *“si ndiheni në lidhje me ...?”*

- Vëmendja që u kushtohet ndjenjave të personit të intervistuar

Ka lidhje me pyetjet, komentet ku u kushtohet vëmendje ndjenjave të personit të intervistuar, si p.sh.: *“Thatë se ndiheni i mashtruar; mund të më thoni çfarë ndjenjash të tjera keni pasur pas kësaj ngjarjeje?”*

- Aftësi reflektuese

Dëgjuesi, intervistuesi, jo vetëm që duhet të reflektojë ndjenjat e të intervistuarit, por duhet të reflektojë edhe kuptimin e fjalëve. Shembuj pohimesh në lidhje me aftësitë reflektuese janë: *“Ndiheni fajtor ndaj familjes suaj sepse humbët punën”* ose *“Ndiheni i sigurt sepse familja ju kupton.”*

2. Teknikat dhe aftësitë e përdorura në fazën e mesme të intervistës

Teknikat dhe aftësitë e përdorura më shpesh janë:

- Qartësimi
- Interpretimi
- Konfrontimi
- Dhënia e informacionit
- Këshillimi
- Mbështetja.

Përdorimi i tyre mund të kontribuojë në arritjen e objektivave të intervistës.

a) Qartësimi dhe interpretimi

Qartësimi reflekton atë çfarë i intervistuari ka thënë, por në një gjuhë më familjare dhe më pak subjektive. Ndikimi i qartësimit është:

- Të ndihmojë klientin të ristrukturojë perceptimin
- Të theksojë alternativat dhe pasojat e disa zgjedhjeve – thekson të kuptuarit
- Të theksojë informacionin e veçantë
- Të ndihmojë për të kuptuar më mirë historinë e të intervistuarit.

Shembuj

I intervistuari: “Mendoj që mamaja ime nuk më do më”. Intervistuesi: “Çfarë ka bërë ose thënë mamaja juaj që mendoni se nuk ju do më?”

Intervistuesi: “Nuk jam i sigurt nëse e kuptova mirë këtë që përmendët tani në fund.” ose “Nuk e kuptova mirë nëse ...”

Kujdes!!

Nëse përdoret shpesh formulimi: “Nuk e kuptova mirë ...” mund të sugjerojë që intervistuesi nuk po i kushton vëmendje të intervistuarit.

Interpretimi:

- Është një hap më para perifrazimit, reflektimit apo qartësimit,
- E veçantë për interpretimin është fakti që përdor një metodë tjetër referimi (në rastin e tri teknikave të tjera përdoret e njëjta metodë referimi e të intervistuarit),
- Një interpretim përcjell mesazhin e të intervistuarit dhe përfshin konkluzionin e nxjerrë nga ajo. Ne nxjerrim konkluzione në bazë të vëzhgimeve ose konkluzioneve të nxjerra nga vëzhgimet e mëparshme. Konkluzioni është interpretimi i fakteve. (Një fakt është një vëzhgim që mund të verifikohet nga përdorimi i arsyes). Një konkluzion shkon përtej vëzhgimit dhe ka lidhje me të kaluarën, të tashmen ose me të ardhmen,
- I ofron të intervistuarit një lloj lidhjeje të fakteve për të cilën nuk ishte në dijeni,
- Bën një ri-konceptualizim,
- Ndhmon të intervistuarin të kuptojë më mirë problemet dhe burimet e veta,
- Ndhmon të intervistuarin të zgjidhë problemet.

Kujdes!!

Qëllimi i interpretimit është të ndihmojë të intervistuarin të kuptojë drejt situatën e krijuar nga intervistuesi.

Formulohet si hipotezë, për shembull: *“A mund të konsideroni mundësinë për të...”* ose *“Po pyesja veten nëse ...”*

b) *Konfrontimi* është një hap para interpretimit dhe ka lidhje me mospërputhjet:

- Ndërmjet deklaratave të të intervistuarit në një moment të caktuar dhe pohimeve të mëvonshme;
- Midis deklaratave të të intervistuarit dhe mënyrës si janë thënë;
- Midis asaj çfarë i intervistuari ka thënë rreth dëshirave të veta dhe sjelljes që tregon diçka tjetër.

Konfrontimi është i dobishëm sepse:

- Detyron ri-konsiderimin;
- Mund të theksohen elementet kontradiktore në pohimet e të intervistuarit;
- Qartëson mesazhet e komunikuar.

Kujdes!!

Vetë konfrontimi nuk ndryshon sjelljen e të intervistuarit, por mund të bëjë ta ri-konsiderojë atë dhe mund të sugjerojë nevojën për ndryshim.

Mospërputhjet

Llojshmëria e mospërputhjeve bën që klienti mund të manifestojë mund të ilustrohet më mirë në pohimet e mëposhtme:

“Djali im është perfekt, por vetëm se nuk më respekton”.

“Unë vërtet e dua vëllain tim (thënë me një ton të qetë duke shmangur vështirimin)

“Unë e meritoja të kaloja klasën” (një student i cili nuk kish bërë detyrën e kursit dhe mbeti në provimin përfundimtar)

“Ajo pyetje nuk më shqetëson.” (e thënë me fytyrë të skuqur dhe grushte të mbledhura).

Në momentin që klienti fillon të ndihet relativisht rehat dhe janë bërë disa hapa fillestare drejt raportimit dhe kuptimit të drejtë, detyra kryesore e këshillimit është të identifikojë mospërputhjet bazë, mesazhet e ndryshme, konfliktet ose papajtueshmëritë në sjelljen dhe jetën e klientit.

Mospërputhjet mund të jenë të llojeve të ndryshme:

Mospërputhjet midis sjelljeve joverbale. Një klient mund të flasë shtruar, qetësisht për një çështje, por vëzhgimet e kujdesshme mund të nxjerrin që buzëqeshja e tij/saj shoqërohet me grushte të mbledhura fort. Kur pjesë të trupit nuk janë të koordinuara shpesh nënkuptohen mesazhe mikserë ndryshme.

Mospërputhje midis dy pohimeve. Në një fjali të vetme një klient mund të shprehë ide plotësisht kontradiktore (“Djali im është perfekt vetëm se ai nuk më respekton”) ose “Kjo është një zyrë mjaft e lezetshme; por shumë keq që ndodhet në një zonë kaq të keqe”). Shumë prej nesh kanë ndjenja të ndryshme kundrejt njerëzve tanë të afërt, punës sonë, problemeve dhe situatave tona. Të ndihmosh të tjerët të kuptojnë dyshimet dhe dilemat e tyre është mjaft e dobishme.

Mospërputhjet midis atyre çka thuhet dhe atyre çka bëhen. Një prind mund të flasë për dashuri për fëmijën e tij, por të jetë fajtor njëkohësisht për abuzim ndaj fëmijës. Një student mund të pretendojë një notë më të lartë, pavarësisht se koha që ai ka shpenzuar për të studiuar ka qenë e pakët.

Mospërputhjet midis pohimeve dhe sjelljes joverbale. “Ajo pyetje nuk më shqetëson” (thënë me fytyrë të skuqur).

Mospërputhjet midis njerëzve. Konflikti mund të përshkruhet si mospërputhje midis njerëzve. Dallimi i konfliktit ndërpersonal është një nga detyrat kryesore të këshilluesit.

Mospërputhjet midis klientit dhe një situate. “Unë dua të pranohem në fakultetin e mjekësisë, por nuk ia dola”. Në situata të tilla bota ideale e klientit shpesh nuk përputhet me atë që është realisht. Detyra e këshilluesit është të punojë midis këtyre çështjeve në termat e sjelljeve ose qëndrimeve.

Shumica e klientëve janë të ndërgjegjshëm, në njëfarë mase, lidhur me konfliktet dhe mospërputhjet në jetën e tyre; megjithatë ata nuk janë plotësisht të pajtuar në të gjithë dimensionet e këtyre mospërputhjeve. Kur vëzhgojmë konfliktet e sapo cituara, është e rëndësishme të dallojmë ndjenjat dhe emocionet e ndryshme dhe ambivalente. Një këshillues i sprovuar nuk sulmon domosdoshmërisht dhe menjëherë mospërputhjet emocionale ose konjitive të klientit, por mund ta shtyjë për më vonë dhe vëzhgon me kujdes sjelljen verbale dhe joverbale, në mënyrë që të mund të dallojë mospërputhje të tjera akoma më të rëndësishme.

Megjithatë, në disa intervistime me kohë të kufizuar dhe në disa teori këshillimi (siç është Gestalt), konfrontimi i menjëhershëm, i drejtpërdrejtë i mospërputhjeve të tilla mund të jetë i rëndësishëm.

c) *Shkëmbimi i informacionit* – fluksi i informacionit nuk rrjedh vetëm në një drejtim: i intervistuari – intervistuesi, por edhe anasjelltas.

- Intervistuesi siguron informacionin e duhur në përputhje me nevojat e të intervistuarit (disa intervista quhen edhe “intervista për informacion”);
- Shkëmbimi i informacionit do të thotë të ofrosh informacion dhe të krijosh disa burime që ndihmojnë të intervistuarin të marrë vendime;
- Shkëmbimi i informacionit përfaqëson një ndërhyrje që kontribuon në zgjidhjen e problemit.

d) *Këshillimi*:

- Është një ndërhyrje që kontribuon në afirmimin e përgjegjësive të intervistuesit (5-8% e ndërhyrjes së punonjësit social gjatë intervistës është në formë këshillash);
- “Këshilla” mund të jetë një drejtim i qartë për “ÇFARË” duhet ose s’duhet të bëjë i intervistuari; mund të jetë edhe një sugjerim për alternativat që duhen konsideruar nga i intervistuari;
- Disa nga këshillat mund të jenë më delikate se të tjerat; ndonjëherë teknika e modelimit mund të jetë më e nënkuptuar, një formë joverbale që i sugjeron të intervistuarit të ketë një sjellje të caktuar;
- Për disa grupe të intervistuarish, dhënia e këshillave është e justifikueshme (për shembull, për ata individë në situata kritike, për individët me probleme mendore, për të turpshmit);
- Këshillimi e përfshin të intervistuarin në zgjidhjen e problemit. Studimet empirike kanë treguar se personi i ndihmuar e konsideron këshillën si një procedurë të dobishme për zgjidhjen e problemit.

Kujdes!!

Mos e teproni në dhënien e këshillave, por as mos refuzoni të jepni këshilla, sidomos pa i shpjeguar të intervistuarit arsyet pse s’mund të jepni këshilla.

Intervistuesi duhet të ofrojë këshilla sepse ai/ajo:

- Ka ekspertizën e duhur në lidhje me problemet sociale dhe alternativat e mundshme për të përmirësuar situatën;
- Ka eksperiencë në lidhje me pasojat e mundshme të zgjidhjeve të ndryshme.

Këshilla jepet vetëm nëse i intervistuari e kërkon një gjë të tillë.

Këshilla duhet të bazohet në njohurinë profesionale si dhe në përvojën e intervistuesit.

Në këtë mënyrë, ajo çfarë sugjerohet mund të japë efektin e dëshiruar. Natyra e këtij efekti diskutohet me të intervistuarin.

Kur ofrohet një këshillë duhet mbajtur parasysh konteksti në të cilin do të aplikohet kjo këshillë.

Në shumicën e rasteve këshilla jepet në baza hipotetike, duke i dhënë të intervistuarit mundësinë për të refuzuar në mënyrë që të mos ndihet i detyruar ta pranojë këtë këshillë.

Këshilla jepet bashkë me teknikat/procedurat e ndërhyrjes gjatë intervistës, si p.sh., kur ofrohet mbështetje.

Këshilla jepet vetëm pasi të intervistuarit i është dhënë ndihma e duhur për të eksploruar sugjerimet e veta.

Këshilla nuk jepet në fillim të intervistës apo të një serie intervistash.

e) Mbështetja dhe qetësimi

Mbështetja jepet duke shprehur me sinjeritet – në mënyrë verbale ose joverbale – mirëkuptim, qetësim, shqetësim dhe inkurajim.

Mbështetja përfshin vlerësimin që intervistuesi i bën të intervistuarit në lidhje me aftësitë, cilësitë dhe përpjekjet e tij/saj për të bashkëpunuar.

Kujdes!!

Cilësia e marrëdhënies profesionale midis të intervistuarit dhe intervistuesit mund të jetë mbështetëse.

C. Faza përfundimtare e intervistës

Karakteristikat e fazës përfundimtare të intervistës janë:

- Është faza që tregon mbylljen e intervistës.
- Përgatitja për mbylljen e intervistës fillon që në fillim të intervistës:
 - ✓ kur i intervistuari njoftohet mbi kohëzgjatjen e intervistës;
 - ✓ kur të dyja palët bien dakord për të përfunduar intervistën
- Mbyllja ka lidhje njëkohësisht me përmbytjen dhe me ndjenjat.
- Mbyllja duhet të bëhet para se i intervistuari dhe/ose intervistuesi të lodhen (lodhje fizike ose mendore).

Kujdes!!

Këshillohet që intervistuesi dhe i intervistuari të pranojnë vendimin për të përfunduar intervistën.

- Përdorimi i shprehjeve të tilla si: “*Duket se mbaruam*” ose “*Tani që jemi në fund të intervistës ...*” shënon dhe përfundimin e intervistës ose të serisë së intervistave. Gjithashtu, mund të përdoren gjeste joverbale.
- Përfundimi i intervistës bëhet në një mënyrë miqësore dhe me mirësjellje.

Përmbledhje

Inkurajimi, perifraximi dhe përmbledhja, të gjitha, komunikojnë tek klienti faktin që ata vërtetë janë dëgjuar. Në këto shprehje dëgjimit të kujdesshëm ju nuk duhet të ngatërroni idetë tuaja me çfarë klienti ju ka thënë. Ju mund të bëni një përmbledhje me fjalët tuaja për idetë e klientit, të cilët përmbledhin ndoshta shkurtimisht dhe sqarojnë çfarë klienti ka thënë. Megjithatë, është e përshtatshme të përdoren në këto raste fjalë çelës të klientit dhe ide për çështje veçanërisht delikate.

Inkurajuesit janë disa mjete verbale dhe joverbale që këshilluesi ose intervistuesi mund t’i përdorë për të nxitur klientët të vazhdojnë të flasin. Ata përfshijnë lëvizjet e kokës, gjestet me duar të hapura, fraza si “Uh-huh,” dhe thjesht përsëritje të fjalëve çelës të klienti ka përdorur.

Perifraximet i jepen në përgjigje klientit lidhur me esencën e gjërave që ata sapo kanë thënë duke shkurtuar dhe qartësuar komentet e klientit. Perifraximi nuk është përsëritja fjalë për fjalë si papagall; është përdorimi i disa fjalëve tuaja plus fjalët më të rëndësishme të klientit.

Përmbledhjet janë të ngjashme me perifraximet por mbulojnë një kohë më të gjatë dhe më tepër informacion. Përmbledhjet mund të përdoren për të filluar ose mbaruar një intervistë, apo për të qartësuar çështjet e gjata dhe komplekse të klientit. Më e rëndësishmja, përmbledhja ndihmon klientët të organizojnë të menduarit e tyre. Perifraximi dhe përmbledhja komunikojnë tek klientët se ata janë dëgjuar. Inkurajimi ndihmon klientët të eksplorojnë ndjenjat dhe mendimet e tyre në mënyrë më të plotë.

Përmbledhja është pjesë e fazës përfundimtare. Një përmbledhje e shkurtër:

- E asaj çfarë është përmendur gjatë intervistës;
- E vendimeve të marra;
- Të pyetjeve që janë bërë.

Njësoj si fillimi i intervistës bëhet në formën e një bisede, edhe përfundimi i saj duhet të ketë të njëjtin format. Këtu bëhet kalimi nga një komunikim i lokalizuar brenda temës së intervistës në një bisedë mbi një temë të zakonshme të përditshme.

Mbajtja e shënimeve

Pasi përfundon intervista, intervistuesi duhet të mbajë shënim informacionin në një dosje ose në kompjuter, etj.

Duhet mbajtur shënime si gjatë intervistës ashtu edhe pas përfundimit të saj.

Zakonisht, kur mbahet shënim i kushtohet më shumë vëmendje asaj që është thënë dhe jo asaj që po thuhet.

Kujdes!!

- Kur intervistuesi mban shënime, ai/ajo humbet kontaktin vizual me të intervistuarin dhe mund të humbasë informacionin joverbal.
- Mbajtja e shënimeve mund ta bëjë të intervistuarin të jetë i kujdesshëm dhe selektiv në gjërat që thotë.
- Kur intervistuesi nuk shpjegon se do të mbajë shënime dhe nuk jep arsye, i intervistuari mund të ndihet konfuz. Për këtë arsye intervistuesi duhet të shpjegojë qartë procesin e intervistës.
- Ndikimi i mbajtjes së shënimeve gjatë intervistës duhet rishikuar herë pas here, dhe nëse ka probleme ose vështirësi, atëherë duhet diskutuar hapur me të intervistuarin.
- Mbajtja e shënimeve nënkupton: saktësi, seleksionim, fleksibilitet, sinqeritet.
- Nëse mbahen shënime pas përfundimit të intervistës, është mirë të bëhet menjëherë pas intervistës në mënyrë që informacioni dhe përshtypjet të jenë sa më të sakta.

Ushtrim: Të dënuarit që shfaqin rezistencë

Të supozojmë se ju jeni një punonjës i shërbimit të provës (P.SH.P.) dhe duhet të përgatisni një plan mbikëqyrjeje/program individual për Gencin, i cili është dënuar nga gjykata dhe është vënë nën përgjegjësinë e shërbimit të provës. Ju duhet të intervistoni Gencin. Në vijim janë disa nga pohimet e mundshme të Gencit gjatë intervistës,

Mendoni dy përgjigje që mund t'i jepni Gencit nëse doni të qetësoni rezistencën e tij:

Genci: Nuk jam unë ai që ka probleme. Unë pi sepse gruaja ime më ngre nervat.

P.SH.P.: _____

Genci: Edhe ju do pinit po të kishit një familje si e imja.

P.SH.P.: _____

Genci: E di që po mendoni se unë jam i alkoolizuar, por nuk është ashtu. Thjesht më pëlqen të pi ndonjëherë.

Genci: Gruaja ime e tepron gjithmonë! Kurrë s'kam lënduar njeri kur pi!

P.SH.P.: _____

Genci: Nuk është puna problemi im. Unë dua të flas për djalin tim – ai ka probleme!

P.SH.P.: _____

Mund të përpiqeni të bëni sa vijon:

Të reflektoni (riformuloni bisedën në fjalë të përafërta).

Të perifrazoni (riformuloni bisedën me fjalë të tjera ose të nxirrni kuptimin e saj).

Reflektim emotiv (të tregoni emocion).

Reflektim i dyanshëm (duke theksuar ndjenjat e ndryshme).

Bëni një pyetje hipotetike (*Nëse do donit, si do të...?*).

Pyetje për diskutim

1. Cilat argumente mund të përmendni pro përdorimit të intervistës cilësore në shërbimin e provës?
2. Pse mund të transferohet intervista e punës sociale në fushën e shërbimit të provës?
3. Pse duhet që çdo intervistë të ketë një qëllim?
4. Cili është roli i kushtimit të vëmendjes gjatë procesit të intervistimit?
5. Cilat janë objektivat e çdo faze të intervistës?

6. METODAT E PUNËS ME TË DËNUARIT

Puna në grup

6.4

John Deering

Hyrje, vlerësim dhe caktim objektivash

Chapman & Hough (1998) sugjerojnë që puna në grup është e përshtatshme në rastin e punës me të dënuarit për të trajtuar çështjet dhe llojet e sjelljeve në vijim:

- Ndarja në role dhe provat për sjelljen e duhur
- Edukimi brenda grupit
- Sfida dhe mbështetja nga kolegët
- Trajnim mbi aftësitë njohëse dhe ndërpersonale
- Reflektim mbi vështirësitë e zakonshme

Pasi është vendosur se cilat lloje sjelljeje janë të përshtatshme për punën në grup, duhet të merret në konsideratë lloji i grupit që duhet formuar dhe cili duhet përfshirë në grup. Lloji i grupit duhet të reflektojë qëllimet dhe objektivat e grupit dhe pjesëmarrësit duhen zgjedhur pasi të merret në konsideratë nëse ky është grupi i përshtatshëm për ta, dhe nëse është koha e duhur “personi i duhur, në programin e duhur, në kohën e duhur”.

Anëtarësimi në grup duhet përzgjedhur mbi parimet “çfarë funksionon”, “rreziku”, “reagimi” dhe “nevojat” – shihni seksionin më sipër (McGuire 2000). Kriteria të tjera të rëndësishme janë: aftësia për të punuar në grup; sjellja e mirë në grup; aftësia për të mësuar; shëndeti mendor; abuzimi me substancat narkotike; aftësitë

komunikuese; kapaciteti intelektual; motivimi për të ndryshuar sjelljen dhe për të ndjekur programin.

Shumë prej kriterëve më sipër duhen vlerësuar para dënimit dhe t'i prezantohen gjykatës në raport. Megjithatë, ato duhen vlerësuar dhe ri-vlerësuar pas dhënies së dënimit, për të siguruar që ato ende qëndrojnë si kriterë dhe që individi është ende i përshtatshëm për grupin. Gjithashtu, duhet të sigurohemi që individi është i përshtatshëm për përmbajtjen dhe qëllimin e grupit. Për shembull, një person i cili do t'i nënshtrohet një programi mbi sjelljen njohëse, a ka probleme dhe vështirësi me stilin e vet të të menduarit në lidhje me: aftësinë për të dalluar problemet; aftësitë për të zgjidhur problemet; ndërgjegjësimin e tij në lidhje me pasojat; arritjen e synimeve; aftësinë për të pasur pikëpamje të ndryshme; impulsivitetin; mendimin konkret/abstrakt?

Pasi është vendosur se individi është i përshtatshëm për grupin, duhet marrë në konsideratë motivimi. Dihet mirë që individët do duan të ndjekin programin dhe të mësojnë e përfitojnë prej tij vetëm nëse janë të motivuar dhe gati për të ndërmarrë hapat e nevojshme. Një metodë për të konceptualizuar dhe për të vlerësuar motivimin është “Cikli i Ndryshimit” i krijuar nga Prochaska dhe DiClemente (1983). Ky quhet modeli “trans-teorik” sepse përfshin dhe kombinon një sërë modelesh të ndryshme mbi ndryshimin e sjelljes.

Cikli i Ndryshimit

Ideja kryesore e këtij modeli është që ndryshimi ndodh me kalimin e kohës. Para krijimit të këtij modeli, shumë teori alternative e shihnin ndryshimin në një këndvështrim tjetër – shpesh të konceptuar atë si një ngjarje si p.sh., lënia e duhanit, pijes apo heqja dorë nga veprimtaria kriminale. Cikli i Ndryshimit e shpjegon ndryshimin si një proces që përfshin progres, duke kaluar nëpër pesë faza:

Para-reflektimi është faza kur individët nuk duan të bëjnë ndonjë ndryshim në një të ardhme të parashikueshme, zakonisht këtu merren gjashtë muajt e ardhshëm. Ata mund të ndodhen në këtë fazë sepse nuk janë të informuar apo të mirëinformuar mbi pasojat e sjelljes së tyre për veten dhe të tjerët. Atyre mund të mos u duket sjellja e vet si problematike, ose mund të jenë përpjekur disa herë për ta ndryshuar këtë sjellje, por kanë dështuar dhe janë dekurajuar në lidhje me aftësitë e tyre për të ndryshuar. Individët në këtë fazë tentojnë të shmangin leximin, bisedat dhe nuk mendojnë sa e rrezikshme është sjellja e tyre. Shpesh, teori të tjera ndryshimi i kategorizojnë këta individë si rezistentë dhe të pamotivuar.

Reflektimi është faza kur individët mendojnë të ndryshojnë në gjashtë muajt e ardhshëm. Janë më të ndërgjegjshëm për të mirat e ndryshimit, por janë gjithashtu edhe për aspektet negative dhe vështirësitë. Balanca midis kostos dhe përfitimit nga

ndryshimi mund të shkaktojë një sistem dy-vlerësh, dhe mund t'i mbajë njerëzit të ngecur në këtë fazë për një kohë të gjatë. Ky fenomen njihet shpesh si “reflektim kronik” ose “sjellje e zvarritur”. Individët nuk janë ende gati për ndërhyrje që kërkojnë veprim.

Përgatitja është faza kur individët kanë për qëllim të bëjnë ndryshime në të ardhmen e afërt, që zakonisht është muaji në vazhdim. Si rregull, ata kanë marrë disa hapa të rëndësishëm një vit më parë. Këta individë kanë një plan veprimi, si p.sh., të ndryshojnë zakonet e tyre ose të punojnë në grup, dhe kështu mund të ndryshojë qëndrimi i tyre ndaj veprimtarisë kriminale. Këta individë janë tashmë gati për ndërhyrjet në grup.

Veprimi është faza kur individët kanë bërë ndryshime specifike në sjelljen e tyre gjatë gjashtë muajve të kaluar. Meqë veprimi është i dukshëm, ndryshimi i sjelljes shpesh herë është barazuar me veprimin nëpërmjet teorive të tjera. Megjithatë, në Ciklin e Ndryshimit, Veprimi është vetëm njëra nga pesë fazat. Veprimi është gjithashtu faza kur vigjilenca ndaj rikthimit në rrugën e krimit është kritike.

Kujdesi është faza kur njerëzit përpiqen të shmangin recidivizmin, por nuk i aplikojnë proceset e ndryshimit aq shpesh sa njerëzit në fazën e Veprimit. Janë më pak të tunduar për t'u rifutur në rrugën e krimit dhe gradualisht rritet besimi që ata kanë se mund të vazhdojnë të ndryshojnë.

Nuk duhet të harrojmë që Cikli i Ndryshimit e pranon mundësinë e recidivizmit dhe e trajton atë si normale dhe të mundshme. Është e rëndësishme të theksojmë se rikthimi në kriminalitet nuk duhet parë si dështim, dhe individët mund të ndihmohen të rifillojnë udhëtimin e tyre në Ciklin e Ndryshimit.

Në lidhje me punën në grup, individët në fazën e reflektimit mund të përfitojnë nga grupi në të ardhmen e afërt, dhe ata në fazën e veprimit duhet të jenë në grup ose shumë afër mundësisë për të qenë pjesë e një grupi.

Një çështje e rëndësishme për motivimin dhe Ciklin e Ndryshimit është roli i shërbimit të provës në rritjen e motivimit ose në ndihmën që i jep individëve të lëvizin nëpër Cikël. Kjo mund të bëhet në shumë mënyra. Motivimi është një çështje komplekse dhe praktika e punës motivuese mund të ndahet në tri kategori: a) bërja e planeve për individët që të kenë progres në shumë fusha dhe inkurajimi dhe ofrimi i kurajos e lavdërimi për përfundimin e fazave të tjera; b) puna motivuese para fillimit të një programi grupi. Në këto rrethana motivimi mund të bëhet duke i përfshirë individët në ushtrime mbi “pro-të” dhe “kundërshtimet” e pjesëmarrjes në programe dhe përfitimet e mundshme nga aftësitë e mësuara; c) metoda “ideale” nëpërmjet Intervistimit Motivues (Miller & Rollnick 2002) ku individëve mund t'iu duhen muaj ose vite të tëra për të lëvizur nëpër Cikël.

Diskutim dhe rast studimor:

Si do ta vlerësonit se në cilën fazë të Ciklit të Ndryshimit është një individ? Si do ia bënit për t'i ndihmuar individët të lëvizin nëpër Cikël?

R.D. është 19 vjeç. Së fundmi, ai u dënua për herë të parë. E pranoi se kishte marrë dhe përdorur 3 makina brenda një nate. Gjykata urdhëroi vendosjen e tij në provë. Kur vjen të takojë punonjësën e shërbimit të provës ai është shumë i qetë, pothuajse i tërhequr dhe nuk flet shumë. Megjithatë, gjatë disa takimeve në vazhdim, doli se ai ka 3 vjet që vjedh makina, por s'është kapur asnjëherë. Ndonjëherë, ai ka marrë 5 apo 6 makina brenda një nate, duke i dhënë secilës për disa kilometra, para se të braktiste njërin dhe të vidhte një tjetër. Ai duket se është krenar për “aftësinë” e tij për të vjedhur makina dhe thotë se është “më i miri” në zonën ku jeton. Gjithashtu, ai thotë se asnjëherë nuk i dëmton makinat që merr, përveç dëmit që mund t'u shkaktohet kur përpiqet që t'i hapë dhe të hyjë në to. Po kështu, ai shpjegon që të gjithë pronarët e makinave që merr, i kanë makinat e siguruara dhe kështu që nuk pësojnë asnjë dëm nga sjellja e tij. Ai jeton me të ëmën dhe vëllanë e vogël dhe është shumë mbrojtës ndaj tyre. Ndihet i turpëruar që mamaja e tij u mërzit kur e pa atë të dilte në gjyq dhe të dënohej. Vëllai i tij nuk di asgjë për veprat penale që ai ka kryer.

Formimi i grupit

Në çdo grup, anëtarët do të ndjekin punën në grup, vetëm nëse përmbushen nevojat e tyre bazë. Individët mund të mos shkojnë më në takimet në grup, edhe pse kjo mund të jetë e detyrueshme sipas kushteve të vendosura për vënien e tyre në provë, dhe grupi mund të dështojë për shkak të kësaj ndërprerjeje, një proces ky i njohur si “Fërkim” (Raynor 2006). Edhe nëse individët nuk largohen nga grupi, përsëri grupi nuk do të funksiononte po aq mirë.

Një nga mënyrat që na lejon ta marrim në konsideratë dhe ta shpjegojmë këtë sjellje, është “Hierarkia e Nevojave” e Maslow-t (cituar në Benson 2001, fq. 66). Sipas Maslow-t nevojat e papërmbushura motivojnë sjelljen dhe nevojat aktuale më dominuese bëhen motivuesit kryesorë. Ka mundësi që, një individ të braktisë nevojat e një niveli më të lartë nëse nuk i përmbushen më parë nevojat bazë. Në lidhje me pjesëmarrjen në grupe personash të vënë në provë, nëse individët kanë probleme madhore me nevojat e tyre bazë si p.sh., me strehimin, shëndetin, të ardhurat e mjaftueshme për t'u ushqyer, etj, ka më pak mundësi që “nevoja” e tyre për të marrë pjesë në grup të përmbushet, ose mund të mos jenë plotësisht të përqendruar kur marrin pjesë në grup, dhe këtu gjejmë paralelizma të qartë me Ciklin e Ndryshimit. Brenda një grupi, ka disa nevoja individuale dhe të grupit në tërësi dhe, nëse ato nuk shprehen apo nuk plotësohen, mund të çojnë në qëllime të pashprehura ose “programe të fshehta” si në nivel grupi ashtu dhe atë individual.

Pasi individët janë të gatshëm të marrin pjesë në një grup, përkushtimi i tyre ndaj qëllimeve të punës në grup, mund të ndikohet nga fakti nëse i shohin apo jo qëllimin dhe objektivat e grupit si:

- Tërheqëse
- Interesante
- Realiste për ta
- Sfiduese
- Stimuluese
- Të kënaqshme

Një çështje tjetër që duhet konsideruar është se sa mund të ndikojë në sjelljen, qëndrimin dhe ndjenjat e tyre, një eksperiencë e mëparshme pune në grup.

Diskutim:

Si do vendosnit nëse një individ mund të marrë pjesë në një grup, duke u bazuar në Ciklin e Ndryshimit dhe në “hierarkinë e nevojave”? Çfarë do bënit me ata që nuk janë ende gati?

Procesi dhe sjellja në grup

Të gjithë grupet kalojnë nëpër disa faza, ku disa anëtarë marrin role të caktuara dhe i gjithë grupi duket se fiton një sjellje të caktuar: është njësoj sikur grupi të ketë krijuar një jetë të veten. Procesi në vazhdim është sugjeruar nga Tuckman (1965, cituar në Benson 2001) dhe ka ndikuar teorinë e punës në grup për mbi 40 vjet.

Përbërja është faza fillestare, menjëherë pas formimit të grupit. Individët brenda grupit mund të testojnë dhe kontrollojnë cili është qëllimi i grupit, në lidhje me qëllimet dhe objektivat që ka, rregullat dhe rregulloret, p.sh., cilat mund të jenë kërkesat ligjore për të qenë pjesë e një grupi individësh të vënë në provë. Anëtarët e grupit mund të testojnë edhe kufijtë, dhe të shohin sa larg mund të shkojnë gjërat nga ana e grupit apo udhëheqësve të tyre.

Stuhia përshkruhet si një periudhë konflikti brenda grupit, ku individët janë në konkurrencë për rolet dhe për të dominuar grupin. Në këtë periudhë, mund të krijohet një hierarki midis individëve, dhe ku individët mund të marrin role të ndryshme, p.sh., drejtuesi, testuesi i kufijve, shakaxhiu, “dashi i kurbanit”.

Norma thuhet se fillon pasi dy fazat e para janë qetësuar bashkë me konfliktet dhe

tensionet e ndryshme. Që nga kjo pikë, grupi fillon të fokusohet në qëllimet dhe detyrat e grupit, bëhen më të hapur për të komunikuar, për të ndarë idetë dhe për të punuar së bashku.

Performanca është periudha kur grupi është aktiv në kryerjen e aktiviteteve të caktuara për të cilat ky grup u krijua.

Përfundimi është faza kur punës në grup i afrohet fundi dhe anëtarët mund të ndjejnë se po humbasin diçka, edhe pse disa të tjerë mund të jenë të kënaqur që kjo eksperiencë mbaroi.

Megjithëse modeli i Tuckman-it ka rezultuar i dobishëm dhe ka pasur ndikim, të tjerë mendojnë se një metodë kaq lineare dhe akademike ndaj proceseve të grupit, nuk pasqyron kaosin dhe rrjedhshmërinë e grupeve reale (p.sh., Benson 2001, fq.79). Për më tepër, disa individë mund t'i kalojnë këto faza në një mënyrë jo në sinkroni me procesin e grupit në tërësi.

Rolet në grup. Siç u përmend, disa individë mund të marrin role të caktuara brenda grupit të cilat mund të ndikojnë mënyrën e sjelljes së tyre. Kjo mund të mos jetë sjellja e tyre e zakonshme dhe drejtuesit e grupeve duhet të jenë në dijeni të këtij fakti dhe të sigurohen që çdo anëtar i grupit të mund të përfitojë nga puna në grup, dhe të mos dështojnë për shkak të roleve që marrin gjatë kësaj kohe.

Rolet në grup mund të jenë:

- | | | |
|--------------|-----------------------------|-------------------------------|
| • Drejtues | Agresiv | Jo pjesëmarrës |
| • Ndihmues | Person që kërkon mirënjohje | Shakaxhi |
| • Rrëfyes | Vëzhgues | Ndërmjetësues/Avokat mbrojtës |
| • Reflektues | Bllokues | Person që të bën qejfin |

Benson (2001, fq. 83-84) prezanton mënyra për të menaxhuar punën me këto role dhe tensione të ndryshme duke këshilluar që edhe pse grupet mund të jenë të karaktereve të ndryshme, do të ketë tipare kryesore sipas kulturës dhe strukturës. Ai paraqet këto konstatime:

- Sjellja nuk është e rastësishme
- Sjellja është e kuptueshme
- Sjellja mund të parashikohet
- Sjellja në grup kuptohet më mirë gjatë punës në grup sesa vetëm në bazë të personalitetit individual
- Individë brenda grupit mund të duan të përfshihen me grupin dhe gjithashtu të largohen prej tij – që ai i quan forca centrifugale dhe qendërsynuese
- Puna e grupit shpaloset me kalimin e kohës dhe është organike

Diskutim:

Po drejtoni një grup të ri. Të gjithë anëtarët janë dënuar për vepra penale të lidhura me humbjen e durimit. Janë javët e para dhe ju doni të diskutoni sesi mund të dalloni kur ata inatosen. Megjithatë, pjesëmarrësit në grup janë duke bërë një bisedë shpërqëndruese, duke qeshur dhe duke bërë shaka pa e marrë seriozisht procesin, me përjashtim të një ose dy personave më të qetë dhe të veçuar.

Si do e vlerësonit këtë grup?

Çfarë do bënit me ta në këtë fazë?

Llojet e grupeve

Siç përmendet më sipër, mund të përdoren metoda të ndryshme për të punuar me një grup në varësi të sjelljes së tyre. Në të kaluarën, punonjësit e shërbimit të provës kanë përdorur një sërë metodash të ndryshme. Por që kur doli parimi “Çfarë Funksionon”, shumica e programeve të grupeve, tani bazohen në sjelljen njohëse. Kjo metodë bazohet në teorinë se shumë të dënuar recidivistë nuk i kanë disa aftësi dhe, se këto “mangësi” janë edhe arsyet e sjelljes së tyre kriminale. Kjo mungesë aftësish mendohet se ndikon në zgjidhjen jo të mirë të problemeve, në paaftësinë për t’i parë gjërat në këndvështrimin e të tjerëve (duke përfshirë edhe viktimat), në paaftësinë për të kontrolluar emocionet dhe për të vepruar në mënyrë impulsive, duke çuar kështu në një sjellje mjaft të kufizuar dhe në disa lloj reagimesh ndaj situatave të caktuara.

Zakonisht, grupet ndahen në këto lloje:

- Programe të përgjithshme për të dënuarit. Përdoren për ata individë që i përkasin një niveli të mesëm ose të lartë rreziku për recidivizëm. Nuk trajtojnë në mënyrë direkte lloje të caktuara veprash penale apo një grup të caktuar të dënuarish, por përdorin një metodë të bazuar gjerësisht në sjelljen njohëse dhe në aftësitë.
- Programe për disa vepra penale specifike. Pavarësisht se edhe këto programe bazohen në sjelljen njohëse dhe theksojnë rolin e të menduarit në sjellje, ato fokusohen kryesisht në disa lloje veprash penale. Si shembull mund të përmendim grupet për individët që ngasin makinën në gjendje të dehur, apo dhe për ata që kryejnë vepra penale për shkak të mungesës së kontrollit. Grupet për individët që ngasin makinën në gjendje të dehur përfshijnë programe edukuese kundër përdorimit të alkoolit, por trajtojnë edhe proceset e të menduarit që mund të fshihen pas racionalizmit individual të sjelljes së tyre kriminale. Grupet që kanë probleme me kontrollin bazohen kryesisht në teknikat e Menaxhimit të Zemërimit, që i mësojnë individët të kuptojnë më mirë motivimin dhe besimet e

tyre mbi zemërimin dhe dhunën, si dhe i ndërgjegjësojnë ata për fazat emocionale dhe psikologjike të shuarjes së zemërimit.

- Grupet që trajtojnë grupe të caktuara individësh, p.sh., grupe për të rinjtë ose për femrat. Njihet tashmë fakti se disa grupe janë më të qetë kur janë të kufizuar në anëtarësinë e tyre dhe kanë individë me të njëjtat nevoja karakteristike. Për shembull, grupet vetëm me gra kanë më shumë sukses sesa grupet e përziera gjinore, për sa u përket pjesëmarrjes dhe gjasave për të kontribuar dhe mësuar. Aty mund të trajtohen tema ose çështje që janë tipike për anëtarët e grupit.

Çështje dhe pyetje

1. Mendoni për një grup ku jeni anëtar dhe për një grup me të cilin keni punuar ose keni dëgjuar, a mund të dalloni ndonjë nga fazat e Tuckman-it dhe Benson-it?
2. Nëse do duhet të drejtoni një program, mendoni se me kë do bashkëpunoni. Është e rëndësishme që të njihni pikëpamjet e njëri-tjetrit për çështje të ndryshme të cilat mund të trajtohen me anëtarët e grupit.
3. Bëni një listë me çështjet e mundshme për të cilat duhet të jeni të qartë.
4. Mendoni sesi do të menaxhoni njëri-tjetrin dhe grupin.
5. Duhet të mendoni paraprakisht se me kë dhe si do të trajtoni tema të tilla si: agresiviteti dhe mospranimi për të marrë pjesë në grup.
6. Keni rënë dakord për ndarjen e detyrave, me çfarë do të merret secili?
7. Ashtu siç i përdorni bisedat informuese (debriefing) për të menaxhuar situatat e vështira, a do t'i përdorni edhe për të dëgjuar anëtarët e grupit?
8. Drejtimi i një programi përfshin planifikim dhe aftësi të mira ndërpersonale të punës në grup. Identifikoni se cilat janë pikat tuaja të forta dhe ato të dobëta dhe bëni një plan veprimi për zhvillim personal.
9. Diskutojini këto pika të dobëta dhe të forta me kolegët tuaj – ata kanë për t'i dalluar dhe mund të habiteni nga reagimi i tyre (feedback-u).
10. Cila është metoda juaj e të punuarit në grup?
11. Diskutoni rolin dhe metodën tuaj të preferuar dhe mendoni për ndikimin që mund të ketë te grupi nëse jeni drejtues ose bashkë-drejtes.
12. Në grupe (veçanërisht me përbërje mikserë përzierë) duhet të dini të dalloni “dashin e kurbanit” apo përdorimin e tyre si përfaqësues “tipik” të racës së tyre, gjinisë, seksit, prejardhjes etnike, etj.
13. Cilat janë supozimet tuaja në lidhje me kategoritë e mësipërme të anëtarësimit social apo klasifikimit?
14. Mendoni se do ju duhet të kaloni një orë ose më shumë në një grup. Çfarë ndryshimi do të përbënte informacioni në vijim dhe pse?
 - a. Ora
 - b. Vendi
 - c. Anëtarët e tjerë

- d. Çfarë të duhet të bësh më pas
- e. Një ngjarje aktuale apo e kohëve të fundit
- f. Eksperienca të mëparshme në grup
- g. Kur hëngrët për herë të fundit
- h. Koha (moti)
- i. Çfarë mendojnë anëtarët e tjerë për ju
- j. Sa interesant/i mërzitshëm është grupi
- k. Sa e këndshme është dhoma
- l. Një problem personal
- m. Historia e jetës suaj kohët e fundit

6. METODAT E PUNËS ME TË DËNUARIT

Zhvillimi i komunitetit. Roli i vullnetarëve. Protokollet e bashkëpunimit

6.5

Marinela Sota

Komuniteti është shumë i rëndësishëm për ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim ose masave komunitare, siç iu referohet Konventa Evropiane “Për mbikqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000.

Komuniteti mund të shihet si njësi gjeografike ose si grupe që ndajnë çështje të përbashkëta apo identitete të përbashkëta që quhen komunitete funksionale. Megjithëse një komunitet gjeografik mund të përfshijë nga një lagje deri në një qytet të madh së bashku me periferitë e tij, shumica e studimeve për komunitetin i referohet një lagjeje të caktuar ose një territori të caktuar.⁸

Përbërësit e komunitetit janë: individët, familjet, grupet e qytetarëve, strukturat përfaqësuese të zgjedhura, institucionet që japin shërbime për komunitetin, organizatat qytetare me karakter social, ekonomik, fetar, politik, etj.

Roli i komunitetit në ndihmë të drejtësisë penale dhe të shërbimit të provës rrjedh nga vetë funksionet e komunitetit⁹ në shoqëri:

- Prodhimi: Të prodhojë dhe të shpërndajë për konsumatorët artikuj dhe produkte që kërkohen në treg.

8 Netting et al., 2004, *Handbook of Community Practice*, fq. 10, Sage, Inc

9 Warren (1978), fq. 9

- Shoqërizimi: Të krijoje lidhjet me të tjerët dhe të njohë individin, grupin me rregullat konvencionale të pranuar në komunitet. Shoqërizimi ndodh në familje, shkollë dhe nga media.
- Kontrolli social: Të ushtrojë kontroll social ndaj individëve, grupeve që thyjnë rregullat e pranuar nga të gjithë, përfshirë gjykimin dhe dënimin e tyre.
- Pjesëmarrja sociale: Të ushtrojë pjesëmarrje në diskutimin e çështjeve që e shqetësojnë atë dhe në vendimmarrjen për to.
- Mbështetja e përbashkët: Të ofrojë mbështetje për individët, familjet, grupet që ndodhen në kushte të vështira ose përballen me ndryshime në jetën e tyre duke përdorur burimet e veta.

Shërbimi i provës mbështetet në funksionet natyrale dhe funksionale të komunitetit duke e parë komunitetin si bashkëpunëtor por edhe si përfitues të drejtësisë penale.

Në referimin që i bën Marie Weil,¹⁰ komunitetet janë konteksti i praktikës së punës sociale, dhe praktika në komunitet njihet si një nga mjetet më të rëndësishme për të çuar përpara përkushtimin e çdo profesionisti ndaj drejtësisë sociale.

Në shoqëri, drejtësia sociale duhet të garantojë të drejta të barabarta, drejtësi dhe mundësi për të gjithë anëtarët, grupet e komunitetit bazuar në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të komunitetit në vendimmarrje. Kjo është baza e zhvillimit të iniciativave dhe programeve komunitare për të dënuarit në komunitet. Midis disa qëllimeve të drejtësisë penale,¹¹ dy janë nga më të rëndësishmet që projektojnë role shumë të rëndësishme dhe esenciale për komunitetin:

1. **Sistemi i drejtësisë penale duhet të zhvillojë një sistem progresiv që gjen përgjigje efektive për të siguruar kontrollin e të dënuarve në komunitet, si dhe për të garantuar sigurinë e publikut dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të komunitetit.**

Për të garantuar sigurinë e publikut dhe kontrollin e të dënuarve në komunitet, drejtësia penale dhe komuniteti kanë rolet e mëposhtme:

Sistemi i drejtësisë penale: Të sigurojë që të dënuarit të mbikëqyren në mënyrë të kujdesshme nga personeli dhe një rrjet anëtarësh të komunitetit; të sigurojë që koha e të dënuarit është strukturuar në aktivitete produktive; të zhvillojë disa lloj opsionesh mbikëqyrjeje, alternativa përgjigjesh ndaj shkeljeve dhe alternativa nxitjeje dhe motivimi për të dënuarit.

Komuniteti: Të kontribuojë në drejtësinë penale lidhur me çështjet e sigurisë

10. Handbook of Community Practice, (2005) fq. 8, Sage, Inc

11. Alternatives to Incarceration, www.ca.lvw.org/jj/alternat

së publikut; të ndajë me drejtësinë penale përgjegjësinë për kontrollin e të dënuarve dhe ri-integrimin e tyre.

2. Të dënuarit të dalin nga sistemi i drejtësisë më të aftë për një pjesëmarrje produktive në shoqëri, seç ishin kur hynë në këtë sistem.

Për të arritur qëllimin e aftësimit të të dënuarve me shprehje që forcojnë mundësitë e tyre për të mos kryer në të ardhmen vepra penale, drejtësia penale dhe komuniteti kanë rolet e mëposhtme:

Sistemi i drejtësisë penale: Të vlerësojë pikat e forta dhe interesat e të dënuarve si dhe të identifikojë burimet e komunitetit që ndihmojnë dhe plotësojnë të dënuarit në rrugën e shmangies së krimit; të përfshijë të dënuarit në këto aktivitete dhe të sigurojë përfundimin me sukses të programeve; ndërtimi i kapaciteteve parandaluese nëpërmjet bashkëpunimit produktiv me punëdhënësit, mësuesit, dhe shërbimet e tjera në komunitet.

Komuniteti: Të bëhet partner me drejtësinë penale në zhvillimin e mundësive për të dënuarit që të ri-bëhen anëtarë të komunitetit duke mësuar qëndrime, shprehje dhe vlera të reja.

Pse komuniteti është i rëndësishëm për ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim?

Qëllimi i punës me të dënuarit është: të vlerësojë dhe menaxhojë rrezikshmërinë dhe dëmin, të zvogëlojë mundësinë e ripërfshirjes në krim dhe të mbrojë publikun.¹² Këto qëllime arrihen duke përfshirë komunitetin në të gjitha fazat e punës me të dënuarit.

Si përfshihet komuniteti në punën me të dënuarit?

Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikshmërisë dhe dëmit – Në arritjen e këtij qëllimi komuniteti përfshihet duke:

- dhënë informacion për të dënuarin;
- krijuar dhe zbatuar skema zhdëmtimi për viktimat.

Zvogëlimi i mundësisë së ri-përfshirjes në krim – Në arritjen e këtij qëllimi komuniteti përfshihet duke:

- ofruar programe terapeutike për të dënuarit në komunitet;
- mbështetur me shërbime si: akomodimi, ndihma ekonomike pas lirimit;

12. Kemshall, H dhe Pritchard, J (1996) Good practice in Risk Assessment and Risk Management 1, London, Jessica Kingsley Publishers

- marrë pjesë në programet e vizitave dhe monitorimit të burgjeve;
- ushtruar kontroll, udhëhequr, mbështetur të dënuarit nëpërmjet organizatave ose vullnetarëve.

Mbrojtja e publikut – Në arritjen e këtij qëllimi komuniteti përfshihet duke:

- bashkëpunuar me policinë, prokurorinë, gjykatën;
- ngritur programe parandaluese në komunitet;
- marrë pjesë në komunitet në diskutimin e çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë.

Modeli “Çfarë funksionon”, e cila u zhvillua në vitet 1980, përfshin elementin komunitar si parim të saj midis primeve të tjera që aplikohen për shërbimin e provës dhe që janë:

- **klasifikimi i rrezikshmërisë:** përshtatja e nivelit të ndërhyrjes me rrezikshmërinë e individit;
- **faktorët kriminogjenë:** përqendrimi në ata faktorë që vlerësohet se ndikojnë në ri-përfshirjen në krim;
- **përputhshmëria:** përputhja e stilit të punonjësit të shërbimit të provës me stilin e të mësuarit të të dënuarit;
- **baza komunitare:** ofrimi i programeve në komunitet dhe jo në institucione;
- **modaliteti i trajtimit:** kombinimi i metodave të orientuara nga shprehitë me metoda të orientuara nga njohja e sjelljes, etj.;
- **integriteti i programit:** sigurimi që metodologjia e programeve reflekton qëllimin e tyre dhe rezultatet vlerësohen në mënyrë të pavarur.

Parimi i bazës komunitare për programet që adresojnë nevojat e të dënuarve ka lidhje me qasjen që e shih të dënuarin pas përfshirjes në krim dhe dënimit të tij si një individ që mund të ndryshojë, që burgimi ose izolimi krijon pasoja negative në jetën e tij dhe që duhen shmangur kur është e mundur. Gjithashtu, një element tjetër i kësaj përjasjeje është se komuniteti ka më shumë burime dhe mundësi për ta mbështetur, orientuar dhe ndihmuar të dënuarin.

Roli i vullnetarëve

Pjesë e përfshirjes së komunitetit në shërbimin e provës është puna vullnetare e njerëzve që ofrojnë kohën, energjinë, përkushtimin, fleksibilitetin dhe aftësitë e tyre dhe që përbën një kontribut unik për këtë shërbim.

Vullnetarizmi për të punuar me të dënuar, të cilët janë në shumë mënyra vulnerabël, bën që të dënuarit të marrin mesazhe pozitive dhe mbështetëse, që theksojnë tek ata mendimin se ata janë të vlefshëm dhe kanë mundësi për të bërë zgjedhje të mira dhe të ndryshojnë jetën e tyre.

Vullnetarët kanë disa avantazhe në punën me të dënuarit:

- Vullnetarët kanë shumë njohuri për kushtet vendase të komunitetit, burimet që mund t'u vijnë në ndihmë të dënuarit si dhe çështjet që shqetësojnë vetë komunitetin dhe mund të përbëjnë pengesa për të dënuarit.
- Vullnetarët krijojnë ura ndërmjet komunitetit dhe strukturave të tilla si shërbimi i provës.
- Vullnetarët bëhen gjithashtu modele pozitive për anëtarët e tjerë të komunitetit.
- Vullnetarët zvogëlojnë “faktorin e frikës” dhe çmitizojnë qëndrime ose koncepte për të dënuarit dhe, luajnë rol pozitiv në reduktimin e krimit në komunitet.

Protokollet e bashkëpunimit

Shërbimi i provës përmbush detyrat e veta duke bashkëpunuar me organet shtetërore qendrore, organet e njëjësive të qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse dhe shërbime të tjera në komunitete të ndryshme. Në legjislacion parashikohen fushat dhe modalitetet e bashkëpunimit duke përcaktuar rolin, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritshme nga bashkëpunimi. Bashkëpunimi realizohet bazuar në rregulla që formalizohen në Protokolle bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit të Provës dhe institucioneve, organizatave jofitimprurëse, shërbimeve në komunitet, etj.

Për një model marrëveshjeje bashkëpunimi, shih Aneksin 2.

Përvoja shqiptare

Përfshirja e komunitetit në ekzekutimin e dënimeve alternative është një eksperiencë e re për Shqipërinë. Edhe pse Kodet penale të vitit 1928, 1952, 1977, parashikonin dënime alternative, këto ishin dënime që ekzekutoheshin jashtë burgut, por komuniteti nuk kishte asnjë rol.

Kodi Penal, që u miratua në vitin 1995, parashikonte dënime alternative për të dënuarit për vepra jo të rënda, por ligjet dhe aktet nënligjore që u miratuan më pas me qëllim bërjen të zbatueshëm të Kodit Penal nuk reflektuan konceptin e komunitetit si kontribues dhe përfitues i drejtësisë penale.

Megjithatë, organizata ndërkombëtare dhe vendase duke kuptuar rëndësinë e përfshirjes së komunitetit në ekzekutimin e vendimeve penale në komunitet, duke vlerësuar burimet që ishin krijuar tashmë dhe që komuniteti mund të ofronte për shkelësit e ligjit, hodhën hapat e para për të pasur një perspektivë komunitare në drejtësinë penale.

Nga një bashkëpunim i Ministrisë së Drejtësisë, Komisionit Evropian, Sida-s dhe UNICEF-it, në Shqipëri po aplikohet një program tre-vjeçar për të zhvilluar sistemin e drejtësisë për të mitur. Qëllimi i programit është të hedhë bazat për një sistem që mbron të drejtat e të rinjve dhe të fëmijëve në konflikt me ligjin, parashikuar kjo në standardet ndërkombëtare. Programi synon të zhvillojë komponentët e sistemit të drejtësisë për të mitur nëpërmjet pesë fushave të ndërhyrjes:

- Advokim për përmirësimin e legjislacionit dhe zhvillimin e politikave.
- Ngritje të kapaciteteve institucionale.
- Zhvillim të alternativave të dënimit me burgim.
- Mbrojtje dhe ri-integrim të fëmijëve të dënuar.
- Programe parandaluese, që përfshijnë komunitetin dhe shkollën.

Në kuadër të këtij programi, Klinika Ligjore për të Miturit dhe Qendra për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve zbatuan dy projekte të rëndësishme duke krijuar një eksperience shumë të mirë të bashkëpunimit të organeve të drejtësisë penale me komunitetin.

Projekti “Zbatimi i dënimeve në komunitet për të miturit” është duke u zbatuar nga Klinika Ligjore për të Miturit në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni i të miturve. Deri tani nga ky seksion janë dhënë 18 dënime në komunitet, prej të cilëve vetëm 1 është revokuar. Fëmijët janë referuar në shkollë, qendra komunitare, për të vazhduar arsimin ose marrë shkollim profesional, gjithashtu, janë punësuar për të kryer punë të papaguar në interes të komunitetit. Personeli i projektit ka zhvilluar protokolle të punës me të miturit në kuadër të mbikëqyrjes, kontrollit, mbështetjes dhe ndihmës për ta.

Qendra për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve zbatoi projektin **“Ndërmjetësimi viktime-shkelës dhe aplikimi i drejtësisë restauruese për moshën 14-21 vjeç”**. Projekti është në vazhdim me mbështetjen e UNICEF-it.

Në kornizën e këtij projekti u zgjidhen 155 konflikte penale midis të rinjve të moshës 14-21 vjeç nëpërmjet aplikimit të drejtësisë restauruese. Çdo rast u finalizua me një marrëveshje, ku palët pranorin zgjidhjen e vendosur midis tyre. Për të realizuar marrëveshje të tilla, ndërmjetësit kryejnë shumë biseda me palët me qëllim zgjidhjen e konfliktit dhe pajtimin e palëve.

Qëllimet dhe objektivat e projektit synonin të zgjidhnin konfliktet midis të rinjve duke aplikuar praktika të ndërmjetësimit dhe drejtësisë penale, të rrisnin numrin e rasteve të konfliktëve që zgjidhen me ndërmjetësim dhe pajtim të palëve, të shmangnin procedimin penal të të miturve për vepra me rrezikshmëri jo të lartë.

7. PUNA ME TË DËNUARIT

Puna në gjykatë

7.1

John Deering

Roli i shërbimit të provës para dhënies së dënimit

Punonjësi i shërbimit të provës pranë gjykatës është i pranishëm në gjykatë për të kryer të gjitha shërbimet e duhura në lidhje me gjykatën dhe mund të thirret në çdo kohë gjatë seancave gjyqësore, për të asistuar ose ofruar këshilla. Detyra fillon para procesit gjyqësor, me njohuri mbi “listën e gjykatës” për individët që do dalin në gjyq, duke mundësuar kështu kontrollin për të parë nëse del ndonjë nga rastet e ngarkuara atij. Punonjësi i gjykatës duhet të ketë marrë të gjithë raportet në kohë, atë ditë.

Në gjykatë, ky rol konsiston në paraqitjen e raporteve, në regjistrimin e dënimeve dhe kërkesave për raporte, si dhe me intervistimin e të gjithë individëve, çështjet e të cilëve janë shtyrë për paraqitje raportesh si dhe të individëve të dënuar nga gjykata, qoftë me dënim me burgim ose me punë në komunitet.

Gjykata mund të kërkojë informacion ose këshilla mbi një sërë temash. Pas gjykatës, i gjithë informacioni i evidentuar, i kalon administratës së shërbimit të provës.

Raportet e gjykatës mund të shihen si kontributi më domethënës në procesin e drejtësisë penale nga shërbimi i provës, para dhënies së dënimit. Raportet para dhënies së dënimit përdoren si dokument për gjykatën, të shkruara objektivisht dhe të pavarura

nga këndvështrimi i prokurorisë dhe palës mbrojtëse. Ato duhet të paraqesin një sintezë të të gjithë informacionit dhe fakteve të çështjes, të siguruara nga prokuroria dhe pala mbrojtëse, të paraqitura në formën e një analize të arsyeve përse ky individ kreu këtë veprë penale në këtë kohë. Duhet përfshirë edhe informacioni i marrë nga burime të tjera mbi çështje të tilla si shëndeti i individit, punësimi, strehimi, etj., në mënyrë që analiza të jetë sa më e plotë.

Diskutim:

Vlerësimi para dhënies së dënimit

- Për çfarë shërben?
- Çfarë duhet të arrijë?
- Si mund të arrihet?

Për çfarë shërben?

Qëllimi i një raporti para dhënies së dënimit është të ndihmojë gjykatën të marrë një vendim për dënimin, duke u bazuar në informacion më të detajuar sesa ai që mund të paraqitet në gjykatë. Raporti jo vetëm që jep informacion shtesë, por jep edhe informacion të vlerësuar objektivisht dhe të paraqitur në një mënyrë të drejtë dhe të balancuar nga autori i raportit. Për më tepër, raporti duhet të bazohet në analizën e situatës, rrethanave, shkaqeve dhe qëndrimeve të autorit të veprës penale. Si rezultat i këtij procesi, çdo vendim i marrë duhet të jetë “më i drejtë”, pasi bazohet në informacionin më të gjerë të mundshëm. Ky informacion është i nevojshëm, sepse në përgjithësi nuk mund të japësh një vendim bazuar vetëm në llojin dhe natyrën e veprës penale. Nëse raporti mund të tregojë qëndrimin e individit duke prezantuar problemet, situata të tjera të ndryshme dhe shkaqet e veprës penale, atëherë dënimi i dhënë ka më shumë mundësi që të synojë reformimin dhe rehabilitimin e personit, dhe jo thjesht ndëshkimin e tij.

Në terma të përgjithshëm, raporti duhet të përpiket të tregojë se “përse ky individ ka kryer këtë veprë penale në këtë kohë”, dhe të konsiderojë se çfarë lloj dënimi do të reduktonte mundësinë e recidivizmit nga ana e tij, ndonëse pa dyshim është gjykata organi i vetëm kompetent për të dhënë dënimin; pra, raporti i punonjësit të shërbimit të provës është thjesht këshillues.

Procesi:

Pasi merr informacion nga gjykata dhe nga prokuroria mbi faktet e rastit konkret, punonjësi i shërbimit të provës duhet të intervistojë autorin e veprës penale, duke synuar ta përfshijë atë në mënyrë bashkëpunuese, jo autoritare apo kërcënuese, për të mos e bërë individin jo-bashkëpunues, sepse në këtë mënyrë nuk do të përmbushej qëllimi i raportit.

Përmbajtja dhe struktura e raportit

Çdo raport është i përbërë nga disa pjesë, zakonisht sipas shembullit në vijim:

1. Përshkrimi dhe analizë e veprës penale. Kjo pjesë duhet t'i përgjigjet pyetjeve në vijim lidhur me veprën penale: "kush, çfarë, kur, ku, pse dhe si?" Konsideron sa fajtor mund të jetë individit dhe qëndrimin e tij/saj ndaj veprës penale, si dhe të dëmit që i ka shkaktuar viktimës.
2. Përshkrimi dhe analiza e individit. Kjo pjesë përfshin një analizë dhe komente të disa fushave të jetës së individit dhe historisë personale të tij/saj, për aq sa ato mund të kenë lidhje me arsyet e kryerjes së kësaj vepre penale. Kjo mund të përfshijë informacion mbi: situatën sociale të individit, historinë personale, historinë kriminale (nëse ka) dhe reagimin ndaj dënimeve të mëparshme, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin mendor dhe fizik, vështirësitë personale duke përfshirë financat, përdorimin e alkoolit dhe/ose drogës, qëndrimin e përgjithshëm social dhe qëndrimin ndaj krimit, si dhe çdo faktor tjetër që autori i raportit i konsideron të nevojshëm.
3. Analiza dhe vlerësimi i Rrezikut. Ky seksion bën një vlerësim të rrezikut potencial që mund të përbëjë individit, si për sa i takon recidivizmit, ashtu edhe për dëmin që ai mund të shkaktojë. Këtu duhet të përfshihen edhe mundësitë se si mund të reduktohen ose menaxhohen këto rreziqe.
4. Konkluzioni. Ky seksion bën përmbledhjen e raportit dhe merr në konsideratë sa vijon: a ishte kjo një vepër penale "e kryer vetëm një herë" apo ka probleme ose shkaqe që tregojnë se personi është në rrezik recidivizmi? Si rrjedhojë, a mundet dënimi të trajtojë vetëm veprën penale apo duhet të marrë parasysh edhe autorin e veprës penale? Cilat janë dënimet e mundshme? Së fundmi, në raport duhet të jepet një propozim për gjykatën në lidhje me dënimin. Ky duhet të jetë një opsion që, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, do të sigurojë "një dënim në proporcion me këtë rrezikshmëri dhe të përshtatshëm për veprën penale të kryer", mbrojtje për publikun, nëse është e nevojshme, si dhe rehabilitim ose masa të tjera për të reduktuar rrezikun e recidivizmit, kur shihet se kjo ekziston si mundësi. Për pasojë, autori duhet të kuptojë rrezikshmërinë e veprës penale, të rrethanave rënduese ose lehtësuese, si dhe opsionet e ndryshme të dënimeve që mund të japë gjykata.

Gjatë 10 viteve të fundit, shërbimi i provës në Evropë ka përdorur gjerësisht instrumentet statistikore parashikuese të mundësisë për ri-dënim dhe të rrezikut për dëmtim, me qëllim që të ndihmojë si autorin por edhe për të siguruar një bazë objektive për pikëpamjet e shprehura në raport. Këto instrumente përfaqësojnë të dy anët e vlerësimit të rrezikut, konkretisht të atij klinik dhe statistikor. Instrumentet klinike janë zhvilluar kryesisht në mënyrë lokale, ndërsa instrumentet statistikore janë zhvilluar në bazë të shembujve të shumtë të marrë nga të dënuarit.

Përgatitja e raporteve për gjykatën

Përgatitja e raporteve për gjykatën bazohet në llojin e vlerësimit të kryer. Ka disa të dhëna empirike që tregojnë se punonjësit e praktikës punojnë sipas supozimeve të tyre teorike rreth individëve (Milner & O'Byrne 2002), dhe mund të përfshihen në një nga tre modellet e vlerësimit, siç identifikohet nga Smale & Tuson (1992, cituar në Smale 2000), dhe konkretisht: modeli i pyetjeve, procedural dhe i shkëmbimit. Modeli i pyetjeve përfshin një proces rutinë të njëanshëm, ku punonjësi bën pyetje në bazë të teorive të veta rreth individit dhe shkaqeve se përse është në këtë pozitë. Për më tepër, këto të dhëna mbliidhen dhe analizohen për t'iu përshtatur këtyre teorive mbi botën. Modeli procedural përmbush nevojat e institucionit, sepse intervista ka për qëllim të zbulojë nëse individit përshtatet në një nga shërbimet ekzistuese dhe kriteret e pranimit të tij në një nga këto shërbime. Së fundi, modeli i shkëmbimit i konsideron individët si ekspertë të nevojave dhe problemeve të tyre dhe theksi vendoset tek shkëmbimi i informacionit të përdorur për të ndihmuar individët të “mobilizojnë burimet e tyre të brendshme dhe të jashtme” për të arritur ndryshimin.

Përgatitja për intervistimin

Metoda më e mirë e intervistimit për të përpiluar një raport për gjykatën është ajo e intervistës gjysmë të strukturuar. Kjo përfshin përgatitjen e disa pyetjeve të mbyllura dhe një numri më të madh pyetjesh të hapura, të formulara për të nxjerrë informacion në bazë të seksioneve të raportit të përmendura më sipër. Gjithashtu, mund të përdoret edhe një instrument vlerësimi, që mund të ndihmojë në strukturën e intervistës.

Një para-kusht thelbësor i intervistës gjysmë të strukturuar është përgatitja. Shërbimi i provës duhet të ketë informacion në dispozicion para se të kryhet intervista. Është e rëndësishme që ky informacion të përvetësohet, pasi kjo gjë do të siguronte si kontekstin ashtu edhe mjedisin e tij, por gjithashtu do të shërbejë për ta përdorur si bazë për pyetjet. Informacioni merret nga burime të ndryshme, por disa nga më të rëndësishmet janë: Deklaratat e dëshmitarëve, Përmbledhja e çështjes, Fletë-thirrjet dhe Dokumentet e rasteve të mëparshme, të gjitha të marra nga prokuroria. Këto burime janë të rëndësishme kur intervistohen individë që kanë qenë edhe më parë të vënë në provë ose në burg, por janë po aq të rëndësishme edhe burimet e tjera si: rastet e regjistruara nga shërbimi i provës, raportet e mëparshme, informacion nga burgjet, etj.

Hartimi i një skeme apo plani për intervistën

Asnjë nga informacionet e mësipërme nuk do të jetë i dobishëm, nëse nuk përdoret për të përgatitur një plan për intervistën. Një pjesë e informacionit mund të pranohet, një pjesë tjetër mund të ketë nevojë për verifikim dhe një pjesë tjetër mund të ketë nevojë të zgjerohet. Në secilën nga këto situata, duhet krijuar një listë me fushat të cilat duhen eksploruar. Si fillim, do të ishte e dobishme të bëhet një listë me titujt

kryesorë dhe ndoshta me disa pyetje specifike, por duhen shmangur listat me pyetje detyruese sepse intervista do të jetë e ftohtë dhe nuk do të zbulohen shumë gjëra që mund të kenë nevojë për hetim të mëtejshëm.

Nevojiten të bëhen edhe disa pyetje të mbyllura për të përftuar informacion faktik, por kryesisht shumica e pyetjeve do të jenë të hapura, sepse me anë të tyre nxirret më shumë informacion.

Priestley dhe McGuire (1983) e përshkruajnë intervistën gjysmë të strukturuar si një intervistë që përmban tre lloje informacionesh:

- Të dhëna “të rënda”, informacion faktik bazë, të tillë si: adresa, ditëlindja, etj.
- Të dhëna “më të buta”, si: eksperiencia, qëndrimet dhe sjellja të cilat nuk përftohen aq lehtë, të dhëna informuese mbi prejardhjen, etj.
- “zhurmë” të ndjenjave dhe përshtypjeve.

Përgatitja e pyetjeve specifike

Nëse informacioni i mbledhur nuk jep mundësi për shumë pyetje, provoni metodën e 5 W-H-ve:¹³

KUSH jeni ju? Kush tjetër është ndikuar? Kush tjetër është përfshirë?

ÇFARË ndodhi saktësisht? Çfarë mund të më thoni për këtë situatë? Çfarë ka ndodhur që prej asaj kohe?

KU ndodhi kjo gjë? Ku keni punuar në të kaluarën?

KUR ndodhi? Kur e kuptuat fillimisht që ishte problem?

PSE mendoni se ndodhi? Pse ata reagues shtunë atë mënyrë?

SI ndihet partner-i/ja juaj në lidhje me këtë situatë? Si e shihni të ardhmen?

Lista e pyetjeve të mundshme është pa mbarim, por do të kufizohet nga lloji dhe qëllimi i intervistës, nga koha në dispozicion dhe nga shkalla e intuitës, aftësisë dhe bashkëpunimit të individit që përgjigjet.

Si përmbledhje:

- Çfarë lloj interviste është ajo?
- A jam i/e qartë në lidhje me qëllimin e intervistës?
- A e kam lexuar të gjithë informacionin përkatës?
- A e kam përdorur këtë për të formuluar pyetjet?
- A duhet të prekë kjo intervistë disa tema të caktuara?
- A mund të përdor mjete orientuese (*aide-mémoires*)?
- Çfarë lloj informacioni “të rëndë”, “të butë” dhe “zhurmë” do duhet të mbledh?

¹³ [Shënim i redaktorit] Metoda e 5 W-H është një metodë e cila u referohet pesë pyetjeve që në gjuhën angleze fillojnë me shkronjat WH, të cilat janë: Who? What? Where? When? Why? (Kush? Çfarë? Ku? Kur? Përse?)

Verifikimi dhe analizimi i informacionit

Verifikimi i informacionit mund të jetë i vështirë sepse mund të jetë e vështirë ose e pamundur të marrësh konfirmim nga palët e treta. Informacioni i siguruar nga dëshmitarët mund të përdoret për këtë qëllim deri në një farë shkalle, por duhet mbajtur parasysh që edhe ky informacion mund të jetë i njëanshëm dhe i vështirë për t'u verifikuar. Në fund, vendimet duhen marrë vazhdimisht sipas rëndësisë së informacioneve të përfuara dhe nëse është e dëshirueshme dhe e mundur për t'i verifikuar ato. Asnjëherë nuk duhet paraqitur një informacion si fakt në një raport nëse nuk është i verifikuar.

Analizimi i informacionit mund të konsiderohet si thelbi i punës së shërbimit të provës, pasi e gjithë ndërhyrja bazohet në analizën e situatës së individit, nevojave të tij dhe rrezikut që mund të përbëjë. Është shumë e vështirë të përshkruash mënyrën e analizimit të informacionit të mbledhur. Në tërësi, qëllimi i mbledhjes së informacionit nga shërbimi i provës, është të zbulojë shkaqet dhe pasojat e sjelljes së individit, dhe për të vendosur se si mund të përdoren në mënyrë më të mirë të mundshme me qëllim që të reduktohet rreziku i përsëritjes dhe/ose për të mbrojtur komunitetin. Informacioni duhet grumbulluar për këto arsye si dhe duhet analizuar e gjykuar për atë që ndihmon të kuptojmë individin dhe situatën e tij/saj, besimet/vlerat, sjelljen, funksionin, etj. Për rrjedhojë, analizimi i informacionit është një proces dinamik dhe çdo informacion i ri duhet të gjykohej nëse është i vlefshëm dhe shton diçka në situatën e përgjithshme të rastit përkatës.

Diskutim dhe raste studimore:

Konsideroni rastet në vazhdim. Cilat janë çështjet kryesore të paraqitura?

Bëni një plan/skemë interviste për të tre rastet:

1) Femër, 19 vjeçe. Është dënuar disa herë më parë që në moshën 14 vjeçe. Ajo është gjendur fajtores për: Humbje vetëkontrolli x 3 (raste të ndryshme), abuzim me alkoolin dhe prishje të rendit publik, si dhe vepra të tjera penale që lidhen me rendin publik. Kur u arrestua, ajo ishte e dehur dhe e përfshirë në prishje të qetësisë publike në qendrën e qytetit, gjatë natës. Atë natë u arrestuan edhe disa të rinj të tjerë.

Ajo kaloi disa kohë në një qendër kujdesi dhe aktualisht jeton në apartamentin e saj, një apartament i mbrojtur në zotërimin e një qendre bamirësie për fëmijë. Vajza përdor anti-depresivë të dhënë me recetë nga mjeku dhe ka “probleme me pijen”; kohët e fundit i është dërguar përsëri shërbimit vendor psikiatrik. Me raste, ajo ka qenë në kontakt me shërbimin psikiatrik, por asnjëherë nuk ka pasur një diagnozë zyrtare. Është dënuar për rrahje ku edhe e pranoi fajësinë, por është dënuar gjithashtu për përdorim të një blloku çeqesh të vjedhura, për të cilin deklaroi se ishte e pafajshme.

2) Mashkull, 19 vjeç, ka rreth gjashtë muaj që qëndron në paraburgim që nga momenti kur është arrestuar me akuzën e kanosjes për vrasje x 2 herë (të ëmën dhe partnerin e saj), rrahje, dëmtim të qëllimshëm të pronës private dhe për mbajtje kanabis. Është dënuar edhe një herë më parë në moshën 16 vjeçare për kanosje për të cilën ka marrë një paralajmërim. Prindërit e tij u ndanë kur ai ishte 10 vjeç dhe partneri i ri i mamasë së tij ka jetuar me ta që kur personi në fjalë ishte 15 vjeç. Ai nuk ka pasur një sjellje të mirë në shkollë dhe i ka lënë studimet në mes. Nuk ka një marrëdhënie të mirë me partnerin e nënës së tij, por nuk ka pasur probleme të mëdha deri kohët e fundit.

Pasi la shkollën, ai ka punuar në disa punë që i linte brenda një kohe të shkurtër, dhe e kalonte kohën duke fjetur në shtëpi ose në shtëpinë e një shoku. Ka përdorur sasi të mëdha kanabisi dhe amfetamine, dhe një natë mamaja e tij e përzuri nga shtëpia pasi ai po pinte kanabis në shtëpi. Meqë nuk mund të qëndronte në shtëpinë e shokut të vet, një natë ai hyri në shtëpinë e tij, hyri me forcë në garazhin e shtëpisë dhe e zuri gjumi aty. Mamaja dhe partneri i saj u kthyen në mbrëmje vonë në shtëpi, e gjetën aty dhe filluan të grinden, si rrjedhojë ai “u tërbua fare” dhe filloi t’i kërcënonte dhe të dëmtonte makinat e tyre. Ai u arrestua dhe u dërgua në paraburgim si i pastrehë ku qëndroi për disa muaj për shkak se u ngritën akuza të ndryshme dhe ndërkohë prokuroria po vendoste për akuzat përfundimtare. Si rrjedhim, ai e pranoi akuzën për përdorim kanabisi dhe dëmtime të qëllimshëm të pronës private. Akuzat e tjera janë në dosje.

Para pak kohësh u intervistua nga një punonjës i shërbimit të provës, ku rezultoi jo bashkëpunues dhe aspak i ndërgjegjësuar për të dëmtuarit. Ka pasur vonesa të gjata në hartimin e raportit psikiatrik, dhe kështu që duhet ta intervistoni për një raport të ri. Kohët e fundit, ka dhënë disa shenja se është “qetësuar”. I ka shkruar një letër babait të tij biologjik, me të cilin ka mbajtur shumë pak kontakt për 9 vjet, dhe mendon se mund të jetojë me të pasi të lirohet.

3) Mashkull, 52 vjeç. Dënuar për përdorim të tepruar alkooli, për drejtim automjeti pa dëshmi dhe pa sigurim automjeti. Niveli i alkoolit ishte dy herë më i lartë se norma e lejuar. U arrestua pasi u përplas me makinë me murin ndarës të korsive të rrugës, ndërsa po fliste në telefonin e tij celular. Nuk pësoi asnjë dëmtim dhe nuk pati makina të tjera të përfshira në aksident.

Ka pasur dy dënime të mëparshme. Pesë vjet më parë është dënuar me gjobë për vjedhje. Para nëntë muajsh, mori një gjobë për përdorim të tepruar alkooli (nivel dy herë më i lartë se norma e lejuar) dhe iu hoq patenta për 18 muaj.

Përgatisni një raport të shkurtër për gjykatën, për të tre këto raste në bazë të informacionit të dhënë.

Çështje për diskutim dhe pyetje:

- Cilat janë çështjet kryesore për punën në gjykatë, nga këndvështrimi i trajnimit të punonjësve të shërbimit të provës?
- Çfarë aftësish u nevojiten?
- Si do i arrijnë këto aftësi?
- Si e vlerësoni ju se sa i rrezikshëm është një person?
- Si e vlerësoni rrezikun për recidivizëm?
- Si duhet të ndikojnë këto vlerësime në raportin që i paraqitet gjykatës?
- Çfarë lloj dënimi do sugjeronit për një individ të cilin e keni vlerësuar si pak të rrezikshëm ose me mundësi të vogël për recidivizëm?
- Çfarë lloj dënimi do sugjeronit për një individ të cilin e keni vlerësuar si pak të rrezikshëm por me mundësi të lartë recidivizmi?
- Çfarë lloj dënimi do sugjeronit për një individ të cilin e keni vlerësuar si shumë të rrezikshëm, por me mundësi të vogël recidivizmi?

7. PUNA ME TË DËNUARIT

Mbikëqyrja e të dënuarve në komunitet

7.2

(procedurat, formularët, partneriteti, shërbimi komunitar, etj.)

Migena Leskoviku

Kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen e të dënuarve në komunitet, së pari u referohemi dënimeve me shërbim në komunitet të cilat u japin të dënuarve një mundësi për të treguar se mund të shmangin recidivizmin dhe i bëjnë ata të përgjegjshëm nëpërmjet një procesi mbikëqyrjeje, ku kombinohet monitorimi me inkurajimin dhe asistencën – mbikëqyrje dhe ndihmë në të njëjtën kohë. Si rrjedhojë, dënimet në komunitet nuk janë plotësisht ndëshkuese, as nuk bazohen në heqjen e lirisë siç ndodh me dënimin me burgim. Ato mbështeten në bashkëpunimin e të dënuarve për të pranuar kërkesat e vendimit të gjykatës dhe në aftësinë e mbikëqyrësve për të negociuar, motivuar dhe për të bindur.

Qëllimi i këtyre programeve trajtimi është rehabilitimi i të dënuarve. Kriminologët që pranojnë rehabilitimin, argumentojnë se trajtimi mund të jetë efektiv nëse të dënuarit caktohen në programin e duhur. Ri-integrimi i të dënuarve në komunitet është një aspekt i rëndësishëm i politikave korrigjuese, por duhet vendosur me kujdes se në cilin komunitet po ri-integrohen të dënuarit.

Institucionet e programeve dhe shërbimeve komunitare ofrojnë mundësi programesh institucionale dhe komunitare për të dënuarit – asistencë nëpërmjet punës në komunitet, programe akademike dhe profesionale, programe rikrijuese, bibliotekë, shërbime trajtimi ndaj abuzimit me drogën/pijen dhe për heqjen dorë nga to. Shërbime të tjera të specializuara përfshijnë asistencë ndaj viktimës, shërbime fetare, menaxhim stresi për punonjësit dhe familjet e tyre, ndihmë nga pushteti vendor dhe siguri për një bashkëpunim cilësor me programin e mbikëqyrjes intensive. Gjithashtu, këtu mund

të përmendim edhe kontratat me subjekte private dhe organizatat jofitimprurëse nga i gjithë vendi, me qëllim për të siguruar programe trajtimi në komunitet nën mbikëqyrjen e komunitetit. Siguria publike rritet nëpërmjet zhvillimit, koordinimit dhe shpërndarjes së këtyre programeve dhe shërbimeve institucionale dhe komunitare.

Çfarë përfaqëson mbikëqyrja?

- Një përgjegjësi thelbësore të shërbimit të provës
- Një mënyrë për të monitoruar aktivitetet dhe sjelljen e njerëzve të liruar në komunitet ose të liruar me kusht nga gjykatat
- Një mundësi për të ndihmuar të dënuarit të ri-integrohen në komunitet pas një periudhe burgimi
- Në rastin e shërbimit të provës, një dënim më i lehtë se burgimi, por që gjithsesi i mban njerëzit përgjegjës për shkeljen e ligjit
- Një masë alternative ndaj burgimit që kushton më pak dhe u jep të dënuarve për krime mundësinë të jetojnë me familjet e tyre, të kenë një punë dhe të jenë anëtarë produktivë të shoqërisë.

Mbikëqyrja përmbush disa qëllime të ndryshme të drejtësisë penale. Nëpërmjet mbikëqyrjes, punonjësit e shërbimit të provës:

- *Zbatojnë vendimin e gjykatës.* Punonjësit sigurohen që njerëzit nën mbikëqyrje të respektojnë kushtet e caktuara nga gjykata për lirimin e tyre në komunitet.
- *Mbrojnë komunitetin.* Punonjësit reduktojnë rrezikun që njerëzit nën mbikëqyrje të kryejnë vepra penale. Gjithashtu, reduktojnë rrezikun që individët në pritje për procesin gjyqësor të mos arratisen por të paraqiten në gjykatë siç kërkohet.
- *Ofrojnë trajtim dhe asistencë.* Punonjësit i ndihmojnë njerëzit nën mbikëqyrje të zgjidhin problemet që mund të kenë në lidhje me sjelljen e tyre kriminale duke i drejtuar tek shërbimet ku mund të gjejnë ndihmë. Këto shërbime mund të përfshijnë trajtim për abuzimin me alkoolin/drogën ose trajtim psikologjik, kujdes mjekësor, trajnim ose asistencë për të gjetur një punë.

Mënyra e mbikëqyrjes

Gjatë punës me individët nën mbikëqyrje, punonjësit :

- I informojnë rreth pritshmërisë që gjykata ka prej tyre.

- Takohen me ta në vendin e punës dhe/ose në shtëpi.
- Monitorojnë nëse po i respektojnë kushtet e caktuara nga gjykata për lirin e tyre.
- Ndërhyjnë për të kontrolluar dhe korrigjuar në rast se shkelet ndonjë nga kushtet.

Disa nga kushtet që gjykata mund të caktojë janë: shërbimi në komunitet, monitorimi elektronik, punësimi, trajtimi psikologjik ose trajtim për abuzimin me alkoolin/drogën.

Shërbimi në komunitet

Një nga kushtet e lirit mund t'i kërkojë individëve nën mbikëqyrje të kryejnë punë vullnetare për një organizatë shoqërore ose jofitimprurëse, si p.sh., në një bibliotekë, mensë për të varfrit ose në një program mbrojtjeje.

Shërbimin në komunitet gjykata e përdor:

- Si ndëshkim, për të kufizuar lirinë personale të njerëzve nën mbikëqyrje dhe që u kërkon të braktisin kohën e lirë.
- Si rehabilitim, për të nxitur një etikë pune dhe për t'i ndihmuar individët nën mbikëqyrje të zhvillojnë interesa dhe aftësi.

Detyrat e punonjësit të shërbimit të provës

Punonjësi i shërbimit të provës kryen disa detyra të rëndësishme në lidhje me mbikëqyrjen e të dënuarve në provë. Ndër këto detyra, si më të rëndësishme përmendim:

- Përcakton institucionet/organizatat që pranojnë të punojnë me individët nën mbikëqyrje
- U cakton individëve nën mbikëqyrje detyra të përshtatshme në komunitet.
- Viziton institucionet/organizatat për të monitoruar si po shkon shërbimi në komunitet dhe për të zgjidhur problemet e mundshme.
- Ndërmerr hapa për të kontrolluar dhe korrigjuar situatën nëse individët nën mbikëqyrje:
 - nuk shkojnë të kryejnë shërbimin në komunitet.
 - nuk i kryejnë mirë detyrat e caktuara në komunitet .

- sillen në mënyrë të papranueshme kur janë duke kryer shërbimin në komunitet.
- nuk respektojnë kushtet e caktuara nga gjykata.

Jo të gjithë individët nën mbikëqyrje janë të përshtatshëm për shërbim komunitar, duke përfshirë ata që: kanë probleme me drogën/alkoolin; kanë pasur raste ushtrimi dhune ose ngacmimesh seksuale; kanë probleme serioze emocionale ose psikologjike. Në çdo rast, raporti i vlerësimit të Shërbimit të Provës përcakton gjendjen e të dënuarit dhe propozon masën konkrete që mund të japë gjykata.

Punësimi

Një kusht për lirimin e individit nën mbikëqyrje është që ai/ajo të ketë një punë të ligjshme, përveç rasteve kur duhet të ndjekë shkollën, të trajnohet apo për arsye të tjera të pranueshme.

Këtë gjë gjykata e përdor:

- Për të rritur mundësitë që njerëzit të kenë sukses nën mbikëqyrje sepse janë duke bërë një punë me fitim.
- Të reduktojë mundësinë e recidivizmit si një mënyrë për të siguruar jetesën.

Detyrat e punonjësit të shërbimit të provës

Në fazën e mbikëqyrjes, shërbimi i provës duhet të fokusohet në disa aspekte kryesore. Si më të rëndësishmet përmendim:

- Të krijojë marrëdhënie me institucionet/organizatat dhe individët në komunitet të cilët mund të ndihmojnë individët nën mbikëqyrje të gjejnë dhe të mbajnë një punë, të tilla si: shërbim punësimi vendor dhe shtetëror, të punojë në organizata jofitimprurëse, me dhomën e tregtisë apo me punëdhënës të tjerë.
- Drejton individët nën mbikëqyrje të burimet komunitare që i përgatisin për të gjetur punë nëpërmjet shërbimeve të tilla si: vlerësimi i aftësive, trajnime për punë, seminare për të përgatitur një *Curriculum Vitae (CV)* dhe për të kërkuar punë, etj.
- Verifikon përpjekjet e tyre për të gjetur punë.
- Verifikon që po punojnë, duke i vizituar ata në punë apo duke mbajtur kontakt me subjektin ku ata kryejnë punën.

- Merr hapa për të kontrolluar dhe korrigjuar situatën nëse njerëzit nën mbikëqyrje: - Nuk paraqiten në kohë në punë.
- Humbasin punën ose e ndryshojnë shpesh atë.
- Kanë një stil jetesë që i kalon të ardhurat e tyre.
- Nuk respektojnë kushtet e caktuara nga gjykata.

Individët nën mbikëqyrje hasin pengesa të shumta kur kërkojnë punë dhe punonjësit e shërbimit të provës mund t'i ndihmojnë që t'i kalojnë këto pengesa. Kështu për shembull, individët nën mbikëqyrje mund të kenë probleme të cilat duhet t'i zgjidhin para se të punojnë, si p.sh.: abuzimin me alkoolin/drogën, shëndetin jo të mirë, mungesën e nevojave bazë për jetën si strehim dhe ushqim.

Gjithashtu, ata mund të mos kenë arsimin e duhur dhe aftësitë për të gjetur një punë apo punëdhënësit mund të mos kenë dëshirë t'i marrin në punë për shkak të veprave penale të kryera më parë dhe për mungesë eksperience.

Cilat janë përfitimet?

- Siguron trajnim edukues ose profesional që i ndihmon individët nën mbikëqyrje të gjejnë punë me pagesë.
- I mundëson të sigurojnë jetën për veten dhe të mbështesin familjen.
- Redukton mundësitë që ata të kryejnë vepra penale në të ardhmen.

Trajtimi psikologjik

Trajtimi psikologjik është një kusht për lirim, sipas së cilit individët nën mbikëqyrje duhet të marrin një trajtim të tillë. Ky trajtim mund të përfshijë shërbime të tilla si: vlerësim psikologjik/psikiatrik, këshillim individual, në familje ose në grup, dhe mjekimin përkatës të dhënë nga specialisti.

Gjykata e përdor këtë:

- Për të mundësuar punonjësit e shërbimit të provës të monitorojnë individët nën mbikëqyrje të cilët vuajnë nga probleme mendore duke filluar nga ankthi dhe depresioni deri në çrregullime më kronike si: çrregullimi bipolar, skizofrenia ose pedofilia.
- Për t'u dhënë punonjësve të shërbimit të provës mundësinë dhe mjetet për të identifikuar, vlerësuar dhe siguruar kujdes për këta individë.

Në lidhje me këtë kategori, punonjësi i shërbimit të provës ka disa detyra kryesore. Si të tilla përmendim:

- Identifikon ata individë nën mbikëqyrje që kanë probleme mendore, duke rishikuar informacionin në dosjen e tyre, duke intervistuar individët dhe familjarët e tyre, apo duke u konsultuar me profesionistin psikolog.
- Sipas urdhrit/vendimit të gjykatës, i orientojnë këta individë te programet e trajtimit psikologjik, të cilat ofrojnë shërbimin e përshtatshëm.
- Shohin për ndonjë shenjë rreziku, si p.sh., kërcënime për vetëvrasje, shenja që tregojnë se nuk po marrin mjekimin e rekomanduar, shenja që tregojnë se po tërhiqen nga jeta e përditshme, etj.
- Ndërmerr hapa për të kontrolluar dhe korrigjuar situatat kur individët nën mbikëqyrje nuk marrin mjekimin e dhënë, përbëjnë rrezik të mundshëm ndaj publikut, si dhe kur nuk respektojnë kushtet e vendosjes së tyre nën mbikëqyrje.

Në lidhje me mbikëqyrjen e kësaj kategorie, punonjësit e shërbimit të provës përballen me disa sfida. Individët nën mbikëqyrje që mund të vuajnë nga çrregullimet mendore mund të kenë vështirësi për të reaguar ndaj kërkesave të mbikëqyrjes, për shembull për shkak të: problemeve njohëse, zhgënjimeve, efekteve anësore nga mjekimi, etj. Ata gjithashtu mund të jenë më të vështirë për t'u mbikëqyrur pasi shpesh duhet monitorim më intensiv, apo pasi kërkojnë trajtim më të specializuar.

Një sfidë tjetër lidhet me faktin se këta persona mund të jenë më të paparashikueshëm për t'u mbikëqyrur pasi mund të kenë pasur probleme me dhunën, mund të vuajnë nga çrregullime psikotike ose për shkak të abuzimit me drogën, apo nëse nuk marrin mjekimin e dhënë.

Cilat janë përfitimet?

Për individët që vuajnë nga çrregullimet mendore, mbikëqyrja mund të japë disa rezultate pozitive. Të tilla mund të jenë:

- T'i stabilizojë që të mos përbëjnë rrezik për veten apo të tjerët.
- T'i mundësojë të jetojnë më mirë në komunitet.

Trajtimi ndaj abuzimit me drogën/alkoolin

Ky trajtim është një kusht për lirimin e individit sipas së cilit individ nën mbikëqyrje duhet të marrë një trajtim për abuzimin me drogën/alkoolin. Ky trajtim përfshin testin e urinës dhe shërbime këshillimi ose detoksifikimi.

Si e përdor gjykata trajtimin ndaj abuzimit me drogën/alkoolin?

- Mundëson punonjësit të monitorojnë përdorimin e drogave ilegale të palejuara, drogave të lejuara me recetë ose të alkoolit.
- Mundëson punonjësit të trajtojnë siç duhet problemin e këtyre individëve me drogën/alkoolin dhe të kontrollojnë sjelljen e tyre.

Detyrat e punonjësit të shërbimit të provës në lidhje me këtë kategori:

- Identifikon individët nën mbikëqyrje që kanë probleme me alkoolin ose drogën duke rishikuar informacionin në dosjen e tyre, duke intervistuar individët dhe familjarët e tyre, duke vëzhguar sjelljen e tyre, apo dhe nëpërmjet testeve të drogës.
- Sipas urdhrit/vendimit të gjykatës, i adresojnë këta individë në programet përkatëse që u ofrojnë shërbimin e duhur.
- Mund të lënë takim të paplanifikuar për testimin e urinës.
- Shohin për shenja që tregojnë përdorim të alkoolit ose drogës.
- Ndërmarrin veprime për të kontrolluar dhe korrigjuar situatat kur individët nën mbikëqyrje dalin pozitivë në testin e urinës, nuk pranojnë të bëjnë testin, sjellin kampion urine të një personi tjetër, apo nuk respektojnë kushtet e lirimit të tyre.

Cilat janë përfitimet?

Për individët që kanë probleme me përdorimin e drogës/alkoolit, mbikëqyrja mund t'i:

- Motivojë të heqin dorë nga alkooli dhe droga.
- Mësojë të jetojnë pa ndihmën e këtyre substancave.
- Reduktojë rrezikun për kryerjen e veprave penale në të ardhmen, për shembull, që të kryejnë vjedhje për të blerë drogë.

Sfidat e punonjësit të shërbimit të provës

Individët me probleme me alkoolin/drogën mund të jenë më të vështirë për t'u mbikëqyrur, kjo për faktin se ndikimi i përdorimit të substancave mund të jetë shkatërrues. Varësia nga droga ose alkooli ndikon gjendjen fizike, mendore,

emocionale ose sociale të individit nën mbikëqyrje. Gjithashtu, vlen të përmendim faktin se ka një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet përdorimit të alkoolit/drogës dhe krimit. Në interes të sigurisë së komunitetit, është e rëndësishme që punonjësit e shërbimit të provës të dallojnë abuzimin me alkoolin/drogën dhe të ndërhyjnë në kohë.

Mbikëqyrja gjatë kohës së provës bëhet sipas një procedure dhe modaliteteve të caktuara. Më konkretisht, në pjesën e Shtojcave janë dhënë disa nga formularët me procedurat përkatëse që ndiqen gjatë mbikëqyrjes nga ana e punonjësit të shërbimit të provës.

Pyetje dhe çështje për diskutim

1. Cilat mendoni se janë problemet kryesore me të cilat mund të ndeshet shërbimi i provës gjatë mbikëqyrjes? Cilat janë disa nga problemet më kryesore që mund të dalin në praktikën shqiptare në këtë drejtim?
2. Çfarë mendoni për përfshirjen e komunitetit dhe rolit të tij në mbikëqyrje? Po për rolin që mund të luajnë OJF-të dhe subjektet e tjera që mund të përfshihen në këtë mbikëqyrje apo në ofrimin e mundësive për trajnim, punësim, etj.
3. Çfarë duhet mbajtur parasysh nga shërbimi i provës gjatë mbikëqyrjes për kategori të veçanta të dënuarish? Cilat mund të jenë disa nga problemet dhe sfidat kryesore të shërbimit të provës në Shqipëri?
4. Si dhe sa mendoni se ndikon mbikëqyrja, roli i shërbimit të provës gjatë mbikëqyrjes në ri-integrimin e të dënuarve në komunitet. Në këtë drejtim, si do ta vlerësonit përvojën e deritanishme në Shqipëri?

7. PUNA ME TË DËNUARIT

Puna në burgje

7.3

Marinela Sota

Sistemi i burgjeve ka si detyrë të kryejë ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. Puna në burgje përfshin garantimin e sigurisë për shoqërinë, për të dënuarit e tjerë, personelin dhe vetë të dënuarin; trajtimin e të dënuarit dhe përgatitjen e të dënuarve për lirim në përputhje me planin e vuajtjes së dënimit.

Planifikimi i dënimit është mekanizmi nëpërmjet të cilit sistemi i burgjeve jep shërbimin e tij ndaj të dënuarve me burgim duke pasur dy prioritete:

- Prioriteti 1 Të përgatisë të dënuarit për një lirim të sigurt
(mospërfshirje në krim)
- Prioriteti 2 Të sigurojë shfrytëzimin më të mirë të kohës nga të dënuarit.

Objektivat specifike të planifikimit të dënimit janë:

- Të identifikojë faktorë të rëndësishëm për: rehabilitimin e të dënuarve, mbrojtjen e shoqërisë nga dëmi që mund të kryejë i dënuari, parandalimi i përfshirjes në krim pas lirim, përfundimi me sukses i dënimit dhe gjetja e burimeve që ndihmojnë të dënuarin pas dënimit.
- Të përgatisë të dënuarin për lirim.
- Të zhvillojë, përmirësojë ose rrisë aftësitë e të dënuarit për punë.
- Të bëjë të dënuarin t'a shfrytëzojë kohën në burg në mënyrë të dobishme.

- Të ofrojë qëllime dhe objektiva për të gjithë punën dhe ndërhyrjet me të dënuarin.
- Të japë shërbejë si informacion për të gjitha vlerësimet dhe vendimet që do të merren për të dënuarin, siç mund të jenë uljet e dënimit ose lirimi para kohe me kusht
- Të sigurojë bazat për planin e mbikëqyrjes gjatë lirit me kusht.
- Të sigurojë informacion bazë për sigurinë që duhet përdorur, shërbimet që duhen ofruar dhe burimet që duhen përdorur për të dënuarin.

Planifikimi i dënimit është pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit të dënimit dhe si i tillë, ai zgjidh detyrat e mëposhtme:

- Siguron një mekanizëm që mbledh së bashku të gjithë ata që do të punojnë me të dënuarin ose marrin vendime për të dënuarin.
- Siguron një vlerësim që përfshin rrezikshmërinë e të dënuarit, nevojat dhe çështjet e rëndësishme që lidhen me lirin e të dënuarit dhe rikthimin e tij në shoqëri.
- Siguron një kornizë për planifikimin, vendosjen e objektivave, procesin e rishikimit të progresit të të dënuarit.
- Përcakton bazat për të gjitha vendimet në lidhje me atë që do të bëjë i dënuari gjatë dënimit si p.sh.: puna, edukimi, programet e nevojshme.
- Përbën bazën kryesore për vlerësimet në lidhje me uljet e dënimit, lirit me kusht, rikategorizimin (ndryshimin e sigurisë).

Fazat e planifikimit të dënimit dhe detyrat për secilën fazë janë:

Faza I Kategorizimi, klasifikimi dhe përcaktimi i institucionit ku do të vuajë dënimin i dënuari.

Kategorizimi i të dënuarit duhet të bëhet menjëherë pas marrjes së dënimit. Për të bërë kategorizimin e të dënuarit është i nevojshëm informacioni nga gjykata, veçanërisht dënimet e tij të mëparshme, si dhe kryerja e një interviste me të dënuarin për të marrë informacion të drejtpërdrejtë. Qëllimi është që i dënuari të vuajë në një regjim me siguri të përshtatshme për të dhe programe që plotësojnë nevojat e tij.

Faza II Zhvillimi i planit të vuajtjes së dënimit

Ky proces përfshin vlerësim për veprën e kryer nëse ka pasur elemente dhune ose nëse krimi ka qenë i natyrës seksuale sepse këta elemente e rrisin rrezikshmërinë e të dënuarit. Informacion duhet

marrë gjithashtu nga vendimi i gjykatës dhe dokumentacioni tjetër i administruar nga gjykata. Gjithashtu informacion duhet marrë nga raporti para dhënies së dënimit, raportet mjekësore/psikiatrike dhe intervista me të dënuarin. Gjatë kryerjes së intervistës me të dënuarin punonjësi intervistues duhet të lejojë të dënuarin të shprehë ndjenjat për dënimin e marrë. Qëndrimi i të dënuarit ndaj autoritetit mund të vlerësohet gjatë intervistës. Shih Shtojcën 3.

Faza II

Rishikimi i planit të vuajtjes së dënimit

Plani i vuajtjes së dënimit duhet rishikuar periodikisht duke vlerësuar progresin e bërë, arritjet ose dështimet si dhe duke bërë riplanifikime të nevojshme. Në këtë fazë duhet vlerësuar shumë informacioni që vjen nga punonjësit e burgut, nga raportet me shkrim në dosjen e të dënuarit si dhe nga intervista me të dënuarit. E rëndësishme është që të kuptohet që vlerësimi i rrezikshmërisë dhe i nevojave të të dënuarit nuk është i pandryshueshëm, por duhet riparë dhe ndryshuar në varësi të të dhënave të reja.

Faza III

Rishikimi i planit të vuajtjes së dënimit pas transferimit

Arsyeja përse bëhen rishikime të planit të vuajtjes së dënimit pas transferimit është që të ketë një verifikim nëse regjimi i ri është i përshtatshëm për të plotësuar nevojat e identifikuara të të dënuarit.

Faza IV

Rikategorizimi dhe riklasifikimi

Pas vuajtjes së një pjese të dënimit ose me kërkesën e tij, një i dënuar mund të rivlerësohet për sa i përket sigurisë, sepse me kalimin e kohës të dënuarit mund të bëhen më pak të rrezikshëm ose në të kundërt, mund të rritet rrezikshmëria e tyre. Rikategorizimi bazohet në ndryshime të qarta dhe evidente të faktorëve që përcaktojnë rrezikshmërinë e individit. Në këtë fazë vlerësohet rrezikshmëria e të dënuarit ndaj shoqërisë, rreziku i largimit nga vendi i vuajtjes së dënimit, qëndrimi i të dënuarit ndaj autoriteteve dhe bashkëvuajtësve, progresi i bërë në çështjet e përcaktuara si shtysa të kryerjes së veprës penale.

Faza V

Lirimi me kusht i të dënuarit ose ulja e dënimit

Në këtë fazë është e rëndësishme që të shihen dhe vlerësohen gjithë informacionet e administruara për të dënuarin në lidhje me

rrezikshmërinë e tij, progresin e bërë në objektivat e vendosura, qëndrimin dhe sjelljen e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit.

Faza VI Mbikëqyrja e të dënuarit gjatë lirimit me kusht

Periudha gjatë lirimit me kusht është një pjesë integrale e dënimit dhe për kryerjen e mbikëqyrjes punonjësit e shërbimit të provës duhet t'i referohen planit të vuajtjes së dënimit. Gjatë kësaj kohe, rëndësi ka që t'u adresohemi objektivate të përcaktuara për t'u arritur gjatë kësaj faze, balancimit midis mbikëqyrjes dhe ndihmës ndaj të dënuarit.

Kush kontribuon në planin e vuajtjes së dënimit?

Plani i vuajtjes së dënimit dhe rishikimet që duhen bërë në faza të ndryshme kanë nevojë për informacion të saktë dhe në kohë për të dënuarin në mënyrë që të bëhen vlerësime realiste për të. Është e nevojshme që për të pasur një njohje sa më të mirë të të dënuarit, të këtë informacion që ndihmon në përcaktimin e nevojave dhe rrezikshmërisë ose në identifikimin e çështjeve me rëndësi nga:

- Departamente të rëndësishme ose specialistë brenda institucionit;
- Agjenci ose shërbime në komunitet.

Mbledhja e informacionit është një detyrë e rëndësishme e strukturave drejtuese të burgjeve që mund të kryhet vetëm nëse është zhvilluar një sistem që siguron informacion në kohë dhe të saktë nga struktura brenda dhe jashtë burgut.

Kontributet nga brenda burgut zakonisht përfshijnë:

- Personelin e burgut - personeli i sigurisë ose personel tjetër – kërkohet informacion nëse ka pasur kontakte të veçanta me të dënuarin dhe cilat janë konkluzionet e këtyre kontakteve.
- Departamenti i Edukimit - kërkohet informacion për vlerësimin e arsimit, qëndrimeve, sjelljes, nevojave të veçanta, problemeve me gjuhën, etj.
- Psikologu – a ka pasur kontakte të rregullta dhe cilat janë problemet në përgjithësi?
- Punonjësi përgjegjës për punën/trajnimet profesionale – kërkohet informacion për punën ose trajnimet e kryera nga i dënuari, arritjet, qëndrimet dhe sjellja.
- Specialistët (e gjimnastikës, programeve kreative, etj.) – u kërkohet informacion për frekuentimin, qëndrimet dhe sjelljet.
- Punonjësi i grupit – i kërkohet informacion për frekuentimin e ndonjë terapie grupi ose programi tjetër në grup, qëndrimet, sjelljet.
- Punonjësit që përgjigjen për programet kundër drogës – iu kërkohet informacion për përfshirje të mundshme të të dënuarit në probleme të drogës.
- Punonjësit të programit të para-lirimit – u kërkohet informacion për nevojat

specifike që lidhen me riintegrimin në shoqëri pas dënimit.

- Shërbimit shëndetësor – i kërkohet informacion për nevoja ose probleme të veçanta shëndetësore, nëse janë ekzistuese ose të krijuara vonë, informacion për probleme të shëndetit mendor ose probleme të varësive ndaj drogës ose alkoolit. Në procesin e integritimit të të dhënave mjekësore në planin e vuajtjes së dënimit merret miratimi me shkrim nga i dënuari për të dhëna që kanë natyrë konfidenciale.

Kontributet nga jashtë burgut mund të vijnë nga struktura të tilla si: pushteti lokal, policia, shërbimi i provës, struktura që ofrojnë ose kanë ofruar shërbime për të dënuarin, etj. Në këtë rast, informacioni duhet marrë në formë të shkruar.

Në kontributet që kërkohen për të hartuar planin e vuajtjes së dënimit është e nevojshme që të përfshihen informacione për fusha të tilla si: aktivitetet, grupet e trajtimit të sjelljes, riintegrimi, shëndeti, puna, arsimi-trajnimi, nevoja të veçanta dhe familja. Vendorsja e objektivave bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe duhet të jenë të përcaktuar në mënyrë konkrete objektivat që do të vlerësohen brenda periudhës së rishikimit.

Shembull:

Riintegrimi/Familja/Komuniteti

- Të përpiket të pajtohet me familjen
- Të mbajë kontakte të rregullta me familjen
- Të mbajë dhe/ose të zhvillojë lidhje me komunitetin.

Arsimi

- Pjesëmarrje në klasa ose lëndë të veçanta
- Përmirësime të specifikuar në fusha që janë identifikuar në vlerësimin e nevojave si p.sh.: të shkruarit, të lexuarit, etj.

Trajnimi

- Pjesëmarrje në trajnime dhe përfundim i tyre me sukses si p.sh.: përfundimi i kurseve profesionale, etj.

Puna

- Përcaktimi i një vendi pune
- Prezenca në punë
- Qëndrimi ndaj punës
- Produktiviteti/rezultatet.

Koha e lirë

- Pjesëmarrja në aktivitete të veçanta
- Progresi në nivele të ndryshme të programit
- Pjesëmarrja në aktivitete me grupe me nevoja specifike që vijnë nga jashtë burgut ose në favor të tyre.
- Përfshirja në muzikë ose aktivitete krijuese.

E rëndësishme: Objektivat duhen vendosur në mënyrë të specifikuar dhe të planifikuara në kohë. Objektivat duhet të vendosen sipas sistemit SMART, që do të thotë të jenë:

- Specifike (Specific)
- Të matshme (Measurable)
- Të arritshme (Achievable)
- Realiste (Realistic)
- Të planifikuara në kohë (Timely planned)

Përmbajtja e planit të vuajtjes së dënimit

Plani i vuajtjes së dënimit përbëhet nga rubrika të veçanta që administrojnë informacion dhe vendosin objektiva për:

- Veprën e kryer (detaje të rrethanave dhe faktorë të rëndësishëm për rrezikshmërinë e të dënuarit);
- Qëndrime të të dënuarit (ndaj veprës, ndaj viktimës);
- Abuzimi me substancat (histori të mëparshme, trajtim që është duke vazhduar);
- Probleme shëndetësore (histori të mëparshme/probleme, trajtime/raporte);
- Tentativa për vetëvrasje ose lëndime të vetes (histori të mëparshme, probleme);
- Rrethanat familjare (mbështetja, kontaktet, qëndrimet në familje, çështje të rëndësishme, kujdesi për fëmijët dhe personat/institucionet përgjegjëse);
- Probleme të tjera me drejtësinë dhe reagimi (ndaj përmbarrimit, shërbimit të provës, qëndrimi gjatë lirimimit me kusht nëse ka pasur dënime të mëparshme, shkelje ose thyerje të kushteve);
- Nevoja speciale (cilat janë ato? Si mund të përmbushen?);
- Edukimi/trajnimi/punësimi (historia, nevojat, qëndrimet);
- Lirimi (çështje të riintegritetit si p.sh., strehimi);
- Informacione të tjera të rëndësishme për planin e vuajtjes së dënimit;
- Vlerësimi i rrezikshmërisë dhe dëmit (*Shih më poshtë*);

Vlerësimi i rrezikshmërisë

Studimet tregojnë se është shumë më efektive të identifikohen sjellje potenciale që sjellin rrezik ose dëm sesa të identifikohen të dënuar të rrezikshëm ose jo. Ky është edhe koncepti kryesor që përshkon vlerësimin e rrezikshmërisë. Vlerësimi i rrezikshmërisë është llogaritja nëse ka rrezik ose dëm nga një sjellje specifike e të dënuarit ose një grup rrethanash dhe qëllimi i tij është t'u përgjigjet pyetjeve si: sa i

rëndë, sa shpejt, sa shpesh, si mund të ndodhë, çfarë e favorizon.

Qëllimet e vlerësimit të rrezikshmërisë

Vlerësimi i rrezikshmërisë është një nga detyrat më të rëndësishme dhe sfiduese të punonjësve në sistemin e drejtësisë penale si në burgje dhe në komunitete. Qëllimet e tij janë:

- Të identifikojë faktorët që ndikojnë rrezikshmërinë që vjen nga një individ për shoqërinë;
- Të zvogëlojë rrezikshmërinë;
- Të parashikojë rrezikshmërinë në të ardhmen;
- Të sigurojë informacion dhe drejtojë menaxhimin e dënimit;
- Të sigurojë informacion gjatë marrjes së vendimeve për individin;
- Të vendosë prioritetet në përdorimin e burimeve.

Vlerësimi i rrezikshmërisë në vetvete nuk redukton rrezikshmërinë, por nëpërmjet identifikimit të probabilitetit të sjelljeve që sjellin rrezikshmëri ose dëm dhe identifikimit të atyre që mund të jenë viktima të kësaj rrezikshmërie, përpunohen strategji që adresojnë ato faktorë që çojnë në reduktimin e saj.

Kur kërkohet vlerësimi i rrezikshmërisë?

Fusha të veçanta të rrezikshmërisë të përmendura më sipër vlerësohen në faza të ndryshme të procedimit të një të dënuari brenda sistemit të drejtësisë penale që nga dalja e parë para gjykatës deri në momentin e lirimit me kusht: aplikimi për masa alternative sigurie, raporti para dhënies së dënimit, hyrja në burg, kategorizimi, shpërndarja, planifikimi i dënimit, lirimi me kusht, rikategorizimi i sigurisë, mbikëqyrja e të dënuarit me kusht.

Partneriteti në vlerësimin e rrezikshmërisë

Vlerësimi i rrezikshmërisë mban parasysh perspektivën që i dënuari hyn në burg me një histori penale dhe lirohet nga burgu me një të ardhme. Kjo do të thotë se planifikimi i dënimit, pjesë e rëndësishme e të cilit është vlerësimi i rrezikshmërisë, duhet të hartohet bazuar mbi njohuritë dhe vlerësimin e të dënuarit para dënimit. Ky planifikim duhet të shtrihet deri në momentin e përfundimit të dënimit, që do të thotë se sistemi i burgjeve dhe shërbimi i provës janë në një partneritet që duhet të marrë në konsideratë perspektivën e burgimit dhe atë të rikthimit në komunitet.

Metodologjia e vlerësimit të rrezikshmërisë

Metodat që përdoren duke plotësuar njëra-tjetrën janë:

- Statistikore/të bazuara në sisteme të zhvilluara mbi parimin e parashikimit të reagimit të individëve në rrethana të ngjashme;
- Cilësore/të bazuara në informacion, përvojën dhe gjykimin profesional të punonjësve.

Metoda statistikore bazohet në zhvillimin e një sistemi vlerësimi të rrezikshmërisë për individin duke u nisur nga parimi i parashikimit të sjelljeve të individit të rrethana të ngjashme. **Megjithatë kjo metodë nuk përdoret vetëm por së bashku me vëzhgimin e individit, vlerësimin e tij, mbledhjen e informacionit, përvojën e punonjësit dhe kualifikimin e tij.** Gjithsesi, metoda statistikore parashikon probabilitetin e ridënimit brenda dy vjetëve të të dënuarve me histori të përafërt.

Kjo metodë parashikon rrezikshmërinë e:

- Ri-burgimit;
- Kryerjes së krimeve të dhunshme;
- Kryerjes së krimeve seksuale;
- Kryerjes së krimeve të tjera.

Në metodën statistikore kërkohet informacion paraprak për: gjininë, moshën, masën e dënimit, moshën e të dënuarit kur është dënuar për herë të parë, moshën aktuale, numrin e dënimeve të mëparshme me burgim përpara moshës 21-vjeçare, numrin e dënimeve të mëparshme pas mbushjes së moshës 21-vjeçare, dënimet e mëparshme për krime të dhunshme ose seksuale, llojin e krimit aktual.

Formati i vlerësimit të rrezikshmërisë

Formati i vlerësimit të rrezikshmërisë, i përdorur në Britaninë e Madhe, përbëhet nga katër pjesë kryesore:

1.Vlerësimi paraprak i rrezikshmërisë

Ky lloj vlerësimi bëhet në bazë të informacionit për të dënuarin që gjendet në vendimin e dënimit dhe dëshminë e penalitetit. Ka katër nivele të rrezikshmërisë të cilat më pas vlerësohen duke u bazuar edhe në të dhëna të tjera që merren për të dënuarin ose nga i dënuari: rrezikshmëri e ulët, rrezikshmëri mesatare e ulët, rrezikshmëri mesatare e lartë, rrezikshmëri e lartë.

2.Rrethana dhe Çështje/Nevoja të rëndësishme

Pas përcaktimit të vlerësimit fillestar të rrezikshmërisë është e nevojshme të zhvillohet intervista me të dënuarin për të qartësuar elemente të sjelljes në të kaluarën që kanë

përfunduar me dënime penale dhe për të identifikuar rrethanat në të cilat janë shfaqur këto sjellje të rrezikshme. Gjatë intervistës duhet të identifikohen nevojat që më pas të planifikohet adresimi për to dhe si rezultat, vjen reduktimi i rrezikshmërisë.

Shembull:

Një i dënuar mund të ketë nevojë të ndryshojë qëndrime ose sjellje të caktuara, të mësojë shprehi të ndryshme ose të ndryshojë stilin e tij të jetesës për të reduktuar rrezikshmërinë. Të dhënat që merren për të vlerësuar rrethanat dhe nevojat e të dënuarit duhet të jenë në formë të shkruar në mënyrë që të analizohen më pas dhe t’iu vihen në dispozicion specialistëve të tjerë që do të bëjnë planifikimin e planit të vuajtjes së dënimit dhe zbatimin e tij.

3.Nevojat dhe objektivat

Pjesa që vjen pas identifikimit të nevojave është vendosja e objektivave që adresojnë disa nga nevojat. E rëndësishme është që të adresohen ato nevoja që duken se kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e kryerjes së veprave të tjera pas këtij dënimi dhe t’iu jepet atyre prioritet. Në këtë pjesë duhet pasur parasysh që të vendosen objektiva të arritshëm gjatë kohës së dënimit duke përfshirë pjesën e burgimit dhe pjesën e lirit me kusht. Objektivat duhet të jenë sipas sistemit **SMART**. Gjithsesi edhe nevoja të tjera duhet të identifikohen megjithëse nuk mund të adresohen gjatë dënimit sepse ato përbëjnë një paralajmërim për fusha të rrezikshmërisë që mbeten të paadresuara dhe për të cilat mund të zhvillohen programe të reja.

4.Rishikimi i vlerësimit të rrezikshmërisë

Niveli i rrezikshmërisë duhet të ulet nëse është bërë mirë identifikimi i nevojave dhe vendosja e objektivave. Suksesi nuk mund të përcaktohet vetëm nga ndjekja e rregullt e programit të planifikuar për të dënuarin. Për të vlerësuar nëse është ulur rrezikshmëria, duhet të shqyrtohen të gjitha raportet për të dënuarin ku mund të gjenden fakte të ndryshimit ose jo. Rishikimi i vlerësimit të rrezikshmërisë bazuar në sjelljet e të dënuarit në burg është përgjegjësi e administratës së burgjeve. Në asnjë rast nuk duhet nënvlerësuar as mbivlerësuar efekti mbi sjelljen e të dënuarit pas lirit që ka ardhur si pasojë e trajtimit në burg.

Shembull

Vlerësimi i rrezikshmërisë së riburgimit (për arsyen se gjithmonë riburgimi ndodh për shkak të kryerjes së veprave të caktuara, nevojat që identifikohen në këtë vlerësim janë ato që kanë lidhje me dhunën, sjelljen seksuale dhe sjellje të tjera të rrezikshme duke anashkaluar identifikimin e nevojave të tjera).

Vlerësimi paraprak i rrezikshmërisë

Ky vlerësim i kategorizon të dënuarit në katë kategori të cilave iu korrespondojnë probabilitete të ndryshme të riburgimit brenda dy viteve pas lirimit.

Kategorizimi i rrezikshmërisë

Probabiliteti i ridënimit për krime “të tjera”

I ulët	Të mos dënohet më për krime “të tjera”
Mesatar i ulët	Të dënohet përsëri ka probabilitet nga 2-10
Mesatar i lartë	Të dënohet përsëri ka probabilitet nga 5-10
I lartë	Të dënohet përsëri ka probabilitet nga 8-10

Rrethanat

Kur kategorizimi i rrezikshmërisë së të dënuarit është të paktën “Mesatar i ulët” i dënuari intervistohet për të identifikuar natyrën e “krimeve të tjera” që kanë ndodhur në të shkuarën. Në këtë fazë përcaktohet nëse ka ndonjë tregues ose tendencë të i dënuari për të përsëritur të njëjtën vepër (p.sh., vjedhje të makinave) ose nëse tendenca është për të kryer vepra që përfshihen në një grup më të gjerë. I dënuari pyetet për rrethanat në të cilat kanë ndodhur veprat e mëparshme. Për rrethanat p.sh., mund të shkruhet: “Vjedhja e shtëpisë ndodhi me një grup shokësh pasi kishin pirë në një bar. Vendimi për të kryer vjedhjen u morr nga grupi kur ishin në bar. Pas marrjes së vendimit, grupi do të shkonte të kërkonte për një shtëpi që ishte lehtë të vidhej. Gjithashtu grupi kishte bërë edhe më përpara vjedhje biçikletash kur ndjeheshin të mërzhitur dhe donin të argëtoheshin.”

Çështje të rëndësishme/ Nevojat

Shumë të dënuar nuk kanë shprehur të zgjidhjes së problemeve. Ata shpesh marrin vendime pa u menduar për pasojat, pa menduar për alternativa dhe zgjidhje të tjera

ose pa menduar për reagimin e të tjerëve. Ata gjithashtu mund të mos kenë shprehur ndërpersonale ose qëndrime të nevojshme për të përballuar kërkesat e jetës. Këto vështirësi rrisin ose ndikojnë në probleme të tjera praktike siç janë gjetja ose mbajtja e punës, menaxhimi i të hollave ose strehimi i qëndrueshëm. Kjo situatë mund të rëndohet nga varësia ndaj alkoolit ose drogës. Gjithashtu ka të dënuar që nuk kanë asnjë nga problemet e sipërpërmendura por mund të kenë nevoja të tjera që duhen identifikuar dhe adresuar.

Objektivat

Trajnimi profesional, ndihma praktike për të gjetur strehim, përfundimi i shkollës janë objektiva që mund të vendosen. Nëse i dënuari ka përsëritur një lloj të veçantë vepre penale p.sh., vjedhje mund të sugjerohet të ndjekë një program që rrit ndërgjegjësimin për viktimën dhe ndryshon qëndrimet ndaj veprimeve të kundërligjshme.

Nëse i dënuari ka histori të varësisë nga droga, sjellja e tij, si në burg si jashtë tij, do të orientohet drejt sjelljeve të paligjshme për të gjetur dhe blerë drogë. Në këtë rastë është evidente që nëse duam të kemi progres atëherë i dënuari duhet të ndjekë një program rehabilitimi nga droga. Njohja dhe pranimi i problemit si dhe motivacioni i të dënuarit për të ndryshuar janë elementë që duhen vlerësuar para se të vendosen objektivat në mënyrë që të kemi objektiva realiste dhe të arritshëm. Objektivat duhet të jenë sipas sistemit **SMART**.

Rishikimi i vlerësimit të rrezikshmërisë

Rishikimi duhet bërë në mënyrë periodike dhe vëmendje i duhet kushtuar vlerësimit të situatave të tilla që **rrisin** rrezikshmërinë e kryerjes së veprave të tjera si: raporte për shkelje të rënda disiplinore gjatë burgimit, ndërprerja e programeve, mundësi të pakta për punësim ose strehim. Gjithashtu në rishikim duhet të vlerësohen situata të tilla që **ulin** rrezikshmërinë e kryerjes së veprave të tjera si: përfundimi me sukses i programeve gjatë burgimit për aq kohë sa raportet në përfundim të tij tregojnë se rreziku në atë fushë është ulur.

Kategorizimi i të dënuarve me burgim

Procesi i kategorizimit të të dënuarve është procesi nëpërmjet të cilit përcaktohet kategoria e sigurisë ku duhet të vuajë dënimin i dënuari me burgim. Dy janë elementët që vlerësohen në këtë proces: rrezikshmëria e të dënuarit për t'u arratisur nga vendi i vuajtjes së dënit si dhe rrezikshmëria që i dënuari ka për shoqërinë nëse ai realizon arratisjen.

Faktorë të tillë si: sjellja e të dënuarit, nevojat edukative, trajnuese ose mjekësore, si

dhe kapacitetet që sistemi i burgjeve ka për sa i përket strehimit nuk merren parasysh në këtë fazë. Ato merren në konsideratë në fazën e përcaktimit të institucionit ku i dënuari do të vendoset që quhet procesi i shpërndarjes.

Megjithëse procesi i shpërndarjes vjen menjëherë pas procesit të kategorizimit. Këto dy procese duhen parë si të ndarë nga njëri-tjetri në procedura dhe kohë. Sistemi i burgjeve duhet të garantojë që të dënuarve t'u përcaktohet kategorizimi i sigurisë pavarësisht nga mundësitë konkrete për të akomoduar të dënuarin në atë lloj regjimi ose institucioni.

Çdo i dënuar duhet të vendoset në kategorinë më të ulët të sigurisë në përputhje me nevojat për siguri, kjo do të thotë që gjithmonë merret në konsideratë aplikimi i sigurisë më të ulët dhe pas përjashtimit të të dënuarit nga kategorizimi në këtë kategori sipas disa kriterëve, atëherë merret në vlerësim një siguri më e lartë.

Kriteret për kategorizimin

Vende të ndryshme aplikojnë kriterë të ndryshme për kategorizimin. Në Shqipëri dy janë kriteret që gjykata merr në konsideratë për të bërë kategorizimin: masa e dënimit dhe vepra e kryer. Kategorizimi i sigurisë sipas legjislacionit shqiptar është: i lartë, i zakonshëm dhe i ulët. Ky lloj kategorizimi aplikohet në mënyrë të njëjtë për gratë dhe burrat, përveç sigurisë së lartë që nuk mund të jepet për gratë. Për të miturit që dënohen me burg nuk bëhet kategorizim por përcaktohet në vendimin e gjykatës që i dënuari duhet ta vuajë dënimin në një institucion për të mitur.

Kriteret që pranohen se duhen aplikuar për të bërë kategorizim të saktë të sigurisë janë si më poshtë:

1. Të gjithë të dënuarit duhet të shihen si të mundshëm për t'u kategorizuar në sigurinë më të ulët përveç nëse:
 - a) janë të dënuar më shumë se 2 vjet për një vepër të dhunshme;
 - b) janë dënuar për një krim seksual;
 - c) kanë pasur një dënim të mëparshëm me mbi 2 vjet burgim dhe kur kanë vuajtur në siguri të ulët kanë pasur shkelje të rënda disiplinore;
 - d) janë dënuar ose kanë pasur dënime të mëparshme për drogë që ka përfshirë importimin ose shpërndarjen;
 - e) kanë pasur një histori të mëparshme largimi nga vendi i vuajtjes së dënimit ose tentativë.
2. Kur aplikohen kriteret e mësipërme, të gjithë të dënuarit për të cilët nuk mund të aplikohet kategorizimi në sigurinë më të ulët, atëherë ata shihen si të mundshëm për t'u kategorizuar në sigurinë e zakonshme (sipas kategorizimit shqiptar) përveç nëse:

- a) janë dënuar më shumë se 7 vjet burgim për vepër të dhunshme ose krim seksual;
 - b) kanë pasur dënim të mëparshëm me burg mbi 7 vjet dhe kur kanë vuajtur në siguri të ulët kanë pasur shkelje të rënda disiplinore;
 - c) dënimi që kanë është më shumë se 10 vjet burgim;
 - d) kanë një histori arratisjeje nga siguria e lartë ose kanë burime të jashtme të mjaftueshme për një tentativë arratisjeje.
3. Duke ndjekur këto kritere për një të dënuar me burgim për një krim të dhunshëm, krim seksual ose vepër të lidhur me drogën, do të aplikohet kategorizimi i sigurisë së lartë. Të dënuarit me burgim me dënime afatshkurtra ose afatmesme nuk do të kategorizoheshin më lart se siguria e zakonshme. Të dënuarit për kundërvajtje kategorizohen në sigurinë e ulët. Parimisht, një i dënuar që ka vuajtur një dënim të mëparshëm me burg në mënyrë të suksesshme (pa incidente, shkelje disiplinore, tentativë arratisjeje ose arratisje) nuk mund të kategorizohet në siguri më të lartë se ajo e mëparshme.
4. Kriteret e përmendura më lart nuk janë të pandryshueshme dhe as detyrimisht përcaktuese në kategorizimin e sigurisë. Gjithmonë ka dhe do të ketë raste kur një kategorizim më i lartë ose më i ulët sigurie është më i përshtatshëm për një të dënuar të veçantë.

Përgjegjësia për kategorizimin

Procesi i kategorizimit të sigurisë për të dënuarit në vende të ndryshme bëhet nga trupa ose struktura të ndryshme. Në Shqipëri kategorizimin e sigurisë e bën gjykata, në shumë vende të tjera e bën vetë sistemi i burgjeve me struktura profesionale dhe instrumente të veçantë që përdoren gjatë vëzhgimit të të dënuarit.

Procesi i kategorizimit

Kategorizimi kryhet në dy faza:

- Vlerësim paraprak për sigurinë e nevojshme bazuar në kriteret e përmendura në seksionin e mësipërm që pikëzohen duke nxjerrë një total pikësh që përdoret si referim kryesor në procesin e kategorizimit. Instrumente që përdoren për kategorizimin ndryshojnë nga një vend në tjetrin, por në përgjithësi ato përbëhen nga dy pjesë: Pjesa e ponderimit dhe pjesa e veçantë. Në pjesën e ponderimit, për të dhëna të tilla si vepra aktuale për të cilën është dënuar i dënuari, masa e dënimit, dënimet e mëparshme, arratisjet e mëparshme ose tentativa për arratisje vendosen një sasi pikësh dhe totali i korrespondon një niveli sigurie paraprake. Në pjesën e veçantë punonjësi përgjegjës mund të argumentojë ndryshime

të kategorizimit të sigurisë paraprake nxjerrë në pjesën e ponderimit bazuar në të dhëna të tjera që nuk mbulohen në pjesën e ponderuar, siç mund të jenë: tendenca të të dënuarit për agresivitet ndaj të dënuarve të tjerë në pozita më të ulta, përfitime dhe privilegje të merituar gjatë vuajtjes së dënimit të mëparshëm, etj.

- Intervista me të dënuarin bëhet kur i dënuari është dënuar më shumë se 6 muaj burgim. Kjo procedurë aplikohet për të gjithë të dënuarit pavarësisht nga gjinia, mosha, etj.

Shpërndarja e të dënuarve brenda sistemit të burgjeve

Parimet e shpërndarjes së të dënuarve brenda sistemit të burgjeve

1. Shpërndarja e të dënuarve nëpër burgje megjithëse vjen pas kategorizimit të sigurisë shihet si një proces i ndarë por që në shumë vende kryhet nga e njëjta strukturë e specializuar.
2. Në rastet e të dënuarve deri në 1 vit burgim dhe më shumë, kur nevoja për të bërë një planifikim të dënimit është e shpejtë shpërndarja e të dënuarve duhet bërë sa më parë që të jetë e mundur.

Kriteret dhe prioritetet e shpërndarjes së të dënuarve

1. Procesi i shpërndarjes bazohet në katër prioritete, të cilat jo gjithmonë shkojnë bashkë me njëra tjetrën, por gjithmonë mbahen në konsideratë pasojat e përbashkëta të tyre:
 - a) nevoja për siguri
 - b) nevoja për kontroll
 - c) nevoja për përdorim maksimal të kapaciteteve të burgjeve
 - d) nevojat individuale të të dënuarit.
2. Megjithëse faktori kryesor që përcakton vendosjen e të dënuarve në një burg të caktuar është kategorizimi i sigurisë për të, duhen mbajtur parasysh edhe faktorë të tjerë si:
 - a) sjellja e tij e mundshme, p.sh., a do të paraqesë ai ndonjë problem të paparanueshëm kontrolli në atë burg?
 - b) Përshtatshmëria e tij për lloje të veçanta akomodimi p.sh., mosha, ngjarje të mëparshme të tij si viktimë e një abuzimi, etj.
 - c) Nevojat e tij mjekësore dhe/ose psikiatrike që mund të kërkojnë një nivel të caktuar përkujdesje
 - d) Nevoja për të marrë pjesë në programe të veçanta që

- adresojnë faktorët që përcaktojnë rrezikshmërinë tij
 - e) Vendbanimi i familjes së tij ose i vizitorëve të tjerë të mundshëm
 - f) Nevojat e tij për arsim ose trajnim si dhe potenciali që ai ka në këtë drejtim për t'u zhvilluar
 - g) Kufizime në kriteret për vendosjen e të dënuarve të përcaktuara në marrëveshje me burgje të veçanta
3. Çdo vendosje e të dënuarve në regjime që kanë siguri më të lartë se ajo e përcaktuar në kategorizimin e sigurisë, i duhet raportuar menjëherë eprorëve dhe të pritët miratim me shkrim nga ata.

Programet në burgje

Njerëzit me mangësi të mëdha në shprehinë bazë të të shkruarit dhe të lexuarit, me vetëvlerësim të ulët, mund të përjashtohen nga zgjidhje të thjeshta dhe të ligjshme për problemet e tyre, dhe të kërkojnë zgjidhje të paligjshme përfshirë edhe krimin. Mungesa e vetëvlerësimit shpesh bëhet një nxitës për zemërim dhe mungesë respekti për të tjerët.

Arsimimi dhe pjesëmarrja në programe të ndryshme i ndihmon njerëzit të bëjnë zgjedhje. Shumë njerëz habiten kur lexojnë letërsi ose literaturë sociale dhe mësojnë se shumë njerëz kanë provuar të njëjtën përvojë me ta, ose sesi të tjerë kanë bërë ose nuk kanë bërë të njëjtin gabim kur kanë qenë në situata të ngjashme. **Vënia në dijeni për mundësi të tjera është një lloj lirie shumë e rëndësishme për të dënuarit.**

Shembull:

Diskutimi për prindërimin dhe përgjegjësitë e tij ofron mundësi për të dënuarit për të parë fëmijërinë e tyre dhe më pas qëniet për të cilat duhet të ishte i përgjegjshëm. Gjatë këtij programi të dënuarit prezantohen me detyrimet prindërore dhe gjatë programit duhet të përmbushin disa nga këto detyrime në kushtet e burgimit.

Është e rëndësishme që të dënuarit t'i krijohet mundësia të bëjë zgjedhje në burg, dhe t'i jepet mundësia të njohë dhe të vlerësojë avantazhet dhe disavantazhet që ka çdo zgjedhje. Kjo bën pjesë në disa programe që aplikohen në institucione të veçanta ku i dënuari përfiton privilegje, të ardhura, librim të parakohshëm. Programe që tashmë gjykohen si të dobishme dhe zhvillimore janë ato që përfshijnë qëllime specifike, matje të kujdesshme të rezultateve të tyre dhe dhënie çmimesh me përmbajtje. Burgu i hapur ku mund të aplikojë një i dënuar për të shkuar është një shembull i shkëlqyer i kësaj skeme. Pjesë të kësaj skeme janë gjithashtu: mundësia për të bërë pazar, pagesa, disiplinë pune si në botën e lirë, trajnime dhe mundësi për të punuar jashtë

burgut, çdo gjë shumë afër botës reale të punës.

Edhe kjo skemë ka kufijtë e vet, por programet nxitëse janë një mjet shumë i rëndësishëm dhe efektiv i përgatitjes së të dënuarit për jetën e lirë në kushtet e burgimit.

Programet e edukimit, rehabilitimit, trajtimit, fokusohen më shumë në shprehi të përgjithshme që kanë të bëjnë me ndjenjat, qëndrimet dhe sjelljet sesa thjesht në shprehi intelektuale. Programet e arsimimit gjatë burgimit brenda dhe jashtë institucionit janë të rëndësishme dhe iu japin të dënuarve mundësi dhe perspektiva të reja pas lirimit. Këto programe mund të përmbyllen gjatë kohës së burgimit por edhe mund të vazhdojnë në komunitet.

Shembull: Disa nga këto shprehi mund të jenë:

Ndërtimi i besimit	Shprehi komunikuese	Përgjegjësi personale
Zhvillimi i marrëdhënieve familjare dhe ndërpersonale	Të punuarit në grup, skuadra, dinamika grupi	Shprehi jetësore të vendimmarrjes, zgjidhjes së problemeve
Shprehi teknologjike	Shprehi pune	Shprehi të menaxhimit financiar
Mundësi për vetëzhvillim	Menaxhim i stresit, zemërimit, agresivitetit.	Shprehi të gjetjes dhe mbajtjes së strehimit

7. PUNA ME TË DËNUARIT

Risistemimi i të dënuarve

7.4

John Deering

Shërbimi i provës në Angli dhe Uells ka punuar për shumë vjet me ish të burgosur, si fillim vullnetarisht duke ofruar mbështetje dhe asistencë, por më vonë dhe kohët e fundit në baza ligjore. Të gjithë të burgosurit e dënuar për më shumë se 12 muaj me burgim lirohen me kusht (me vendim gjykate) dhe e vuajnë pjesën e mbetur të dënimit në komunitet. Shumë të dënuar hyjnë në burg me shumë probleme kronike sociale dhe personale (shpesh të lidhura me arsyet e kryerjes së veprave penale) të cilat shumë rrallë mund të zgjidhen gjatë kohës që kalojnë në burg. Si rezultat i periudhës së kaluar në burg ata mund të humbasin punën ose shtëpinë, marrëdhëniet e tyre mund të prishen dhe mund të ndikohen nga sjellja negative e të burgosurve të tjerë. Janë bërë shumë studime mbi nevojat sociale të të burgosurve dhe një shembull është (Maguire 2007, fq. 401):

- Dy e treta ishin të papunë para se të hynin në burg
- Një e treta nuk kanë një vend ku të kthehen pasi të lirohen
- Më shumë se gjysma nuk ishin të arsimuar
- Më shumë se gjysma abuzonin me alkoolin/drogën.

Këto probleme janë të përbashkëta si për të dënuarit për një kohë të shkurtër edhe për të dënuarit për një kohë të gjatë, por vetëm të dënuarve për 12 muaj ose më gjatë u ofrohet shërbimi i risistemimit; të dënuarit për një periudhë më të shkurtër lirohen pa qenë nevoja për të raportuar te shërbimi i provës. Në këtë mënyrë ata nuk marrin ndihmë apo mbështetje, ndaj nuk është për t'u habitur që rastet e ridënimit të ish të burgosurve janë shumë të larta, ndonjëherë rreth 70% (Maguire 2007, fq. 402). Në Angli dhe Uells një raport nga Njësia e përjashtimit social (*Reduktimi i*

recidivizmit nga ish të burgosurit, 2002) një organ i krijuar nga qeveria, nxori si konkluzion se e vetmja mënyrë për të reduktuar numrin e lartë të krimeve të kryera nga ish të burgosurit është nëpërmjet ndërhyrjeve dhe shërbimeve të cilat duhet të jenë të bazuara në një “mendim të përbashkët” dhe planifikim nga disa departamente qeveritare për të siguruar një metodë të koordinuar.

Modele të risistemimit

Risistemimi është quajtur “kujdesi gjatë dënimit” dhe “kujdesi pas dënimit” në të kaluarën, por detyrat, praktikat dhe qëllimet e tij kanë ndryshuar. Qëllimi është të sigurojë shërbime për të ndihmuar të burgosurit të rivendosen në shoqëri, por edhe që të kalojnë këtë periudhë prove në një mënyrë të ligjshme dhe t’i raportojnë shërbimit të provës si dhe kur kërkohet një gjë e tillë. Edhe pse këto qëllime mund të duken të qarta dhe të drejtpërdrejta, ka shumë probleme dhe vështirësi. Gama e problemeve personale dhe sociale të sipërpërmendura ka shumë mundësi të mos zgjidhen gjatë kohës në burg; madje ka më shumë mundësi të përkeqësohen. Mund të kthehen në një ambient që është armiqësor ndaj tyre ose të zotëruar nga të dënuar të tjerë të cilët do të kishin ndikim negativ. Të tjerë mund të mos kenë interes ose dëshirë për të jetuar një jetë “të drejtë” dhe duke mos shkelur ligjin. Nga këto çështje lindin disa pyetje: çfarë duhet bërë, nga kush dhe për çfarë arsyes? Këto pyetje lidhen me këto lloje shërbimesh dhe ndërhyrjesh (Maguire 2007, fq. 405):

- Ofrimi i shërbimeve sociale ose në lidhje me parandalimin e recidivizmit
- Ofrimi i një asistence praktike ose zhvillimi i aftësive të tyre për t’i zgjidhur vetë problemet
- Përfshijnë detyrimin nëpërmjet kushteve të shërbimit të provës ose pjesëmarrjes vullnetare
- Fokusohen në zgjidhjen e problemeve për një kohë të shkurtër ose mbi baza të qëndrueshme
- Ndodhin në burg, gjatë lirimit ose vazhdimisht.

Këto metoda mund të ndërthuren, por duket se formojnë një numër modelesh të ndryshme risistemimi. Thelbi i këtyre modeleve është ndarja e metodave:

- A parandalon risistemimi recidivizmin apo ka më tepër për qëllim të ndihmojë njerëzit e cenueshëm, duke reduktuar përjashtimin social ose dëmin e shkaktuar nga burgimi?
- A shkaktohet krimi kryesisht nga elementë strukturorë, përcaktues apo është zgjedhje personale? Këto pikëpamje ndikojnë përjasjen e risistemimit (Maguire 2007, fq. 405-406).

Praktika e risistemimit

Praktika mund të ndikohet nga modelet e përmendura më sipër, por ndikohet edhe nga një përzierje shërbimesh ndihme, vëmendjeje ndaj mendimit individual, motivimet

dhe qëndrimi dhe nga kërkesat e ligjit. Regjimet e risistemimit kanë një element të zbatimit të ligjit që përfshin një periudhë prove (shpeshherë sa gjysma e kohëzgjatjes së dënimit). Gjatë kësaj kohe, ish i dënuari duhet t'i raportojë shërbimit të provës dhe t'i informojë për çdo ndryshim adrese apo rrethana të tjera, të shmangë çdo mundësi për kryerje të ndonjë veprë penale dhe të jetojë një jetë “të përshtatshme”. Nëse personi nuk i respekton këto kërkesa mund të ridërgohet në burg për ta përfunduar aty pjesën e mbetur të dënimit.

Risistemimi ndjek procesin në vazhdim:

Lirimi nga burgu:

- Kur lirohen të burgosurit?
- A mund të lirohen parakohe me kusht?

Nëse ka një kusht për lirimin e parakohshëm, p.sh., në gjysmë të periudhës së një dënimi, çfarë kushtesh do të vendosen për kohën e provës?

Rast studimor:

J.B. është 29 vjeç dhe do të lirohet pas 2 nga 4 vjet që është dënuar për plagosje. Ai goditi me thikë një person të cilin kishte vite që e njihte. Këta dy persona nuk e pëlqenin aspak njëri-tjetrin. J.B. ishte i pirë në kohën kur ndodhi plagosja me thikë dhe ka kohë që ka pasur probleme me alkoolin. Ai ishte i papunë kur hyri në burg dhe tani është edhe i pastrehë. Megjithatë, mamaja e tij, gjithashtu një e alkoolizuar, i ka ofruar një strehë kohët përkohshme. Ajo jeton në të njëjtën rrugë ku jeton edhe viktima i cili është shprehur se do të hakmerret ndaj J.B.-së.

Ju jeni caktuar si punonjësi i shërbimit të provës për J.B.-në. Cilat mendoni se janë problemet kryesore të tij?

Çfarë kushtesh për periudhën e provës mendoni se duhet të ketë?

Çfarë plani pune do përcaktonit për të?

Procesi i mbikëqyrjes

Periudha e lirit me kusht (me vendim gjykatë) përfshin një periudhë mbikëqyrjeje. Kohëzgjatja e kësaj periudhe ka lidhje me kohëzgjatjen e dënimit të parë. Përmbytja dhe “rregullat” e periudhës në mbikëqyrje janë të ngjashme me kushtet e mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës dhe kanë të njëjtën strukturë.

Modelet e ndërhyrjes

Modelet e ndërhyrjes diskutohen në një kre tjetër të këtij manuali. Megjithatë, ato trajtohen pak edhe këtu por jo në detaje. Metodatat më të përdorura janë ato të sipërpërmendura: metoda e përgjithshme “çfarë funksionon” që përfshin sjelljen njohëse; metoda e ndërprerjes; një metodë e bazuar në marrëdhënien profesionale,

modelin pro-social, motivimin dhe “praktikat korigjuese” të Downden dhe Andrews (2004). Do të trajtohet edhe një model tjetër i bazuar mbi menaxhimin dhe monitorimin:

Menaxhimi dhe monitorimi është një metodë sipas së cilës personi i liruar me kusht (me vendim gjykatë) duhet të raportojë për periudhën e lirit me kusht, por nuk bëhet asnjë ndërhyrje tjetër. Individit duhet të raportojë, të informojë zyrën e shërbimit të provës për çdo ndryshim adrese ose pune dhe “të sillet mirë”. Këto janë të vetmet kërkesa, dhe as nuk ofrohet ndonjë shërbim tjetër. Nëse individi nuk raporton sipas kërkesave, kryen përsëri një vepër penale apo lë shkak për shqetësim, mund të ridërgohet në burg për ta vuajtur aty pjesën e mbetur të dënimit.

Mendoni për “Metodën e menaxhimit dhe monitorimit për mbikëqyrjen pas dënimit”. Cilat janë aspektet pozitive dhe ato negative të saj?

Metoda “Çfarë funksionon” kërkon një vlerësim sistematik dhe identifikim të “mangësive” njohëse si dhe të nevojave kriminogjene. Kjo metodë duhet adresuar në bazë të parimit të rrezikut, nevojave dhe reagimit. Ish të burgosurit ndryshojnë në lidhje me këto tri fusha, për shembull, disa mund të jenë në rrezik të lartë recidivizmi, por të tjerë jo, ndoshta për shkak se vepra penale që kanë kryer ka qenë si rezultat i rrethanave specifike të cilat nuk ka shumë mundësi që të përsëriten. Kështu që është e rëndësishme të mos krijojmë supozime mbi rrezikun për recidivizëm. Por është edhe rreziku i dëmtimit dhe individët e konsideruar si të rrezikshëm në këtë aspekt mund t’i përkasin një niveli tjetër lirimi.

Pas rrezikut duhet bërë edhe një vlerësim i nevojave. Këtu përfshihet strehimi, edukimi dhe trajnimi, financat, etj., (shihni më poshtë). Së fundi, mënyra më e mirë për të trajtuar një individ duhet menduar për çdo rast specifik ndërhyrjeje, p.sh., përfshirja në një grup ose mbikëqyrjen individuale.

Metoda e ndërprerjes përfshin caktimin e qëllimeve bashkë me të dënuarin në lidhje me nevojat e tij/saj personale dhe sesi mund të kapërcehen me ndihmën e shërbimit të provës. Punonjësi i shërbimit të provës mbështet përpjekjet për të ndërtuar kapital human dhe social (vetëvlerësimi, besimi te vetja dhe krijimi i një imazhi si një ish i dënuar, gjetja e një strehimi të qëndrueshëm, ndihma për problemet me drogën, etj.).

Metoda e “Praktikave kryesore korigjuese” lidhet me të dyja metodat “çfarë funksionon” dhe “metodën e ndërprerjes” dhe përfshin: përdorimin e duhur të autoritetit efektiv, modelimin e përshtatshëm, zgjidhjen e problemeve dhe një marrëdhënie të hapur dhe miqësore. Modelimi i përshtatshëm përfshin parimet dhe praktikatat e modelit pro-social të identifikuar nga Trotter (1999). Ky model përfshin

parimet dhe praktikat në vijim:

- Identifikimin e komenteve ose sjelljeve pozitive apo pro-sociale gjatë ndërveprimit me individët.
- Shpërblimin e këtyre komenteve dhe sjelljeve sa herë që është e mundur, kryesisht nëpërmjet lavdërimeve.
- Paraqitja e vetes si një model pro-social
- Sfidat e komenteve ose sjelljes anti-sociale apo pro-kriminale.

Rast studimor:

T'i kthehem rastit të J.B.-së më hollësisht:

J.B. është 29 vjeç. Ai do të lirohet me kusht pasi është dënuar me 4 vjet burgim për plagosje me dashje: goditi me thikë një moshatarin e tij pas një grindjeje të parëndësishme për një femër. Ai ishte i dehur dhe kishte marrë amfetaminë në atë kohë.

Ai ishte vënë nën përgjegjësinë e kujdesit social që në moshën 12 vjeçare bashkë me vëllanë e tij 11-vjeçar pasi fqinjët raportuan se i kishin parë duke kontrolluar koshat e plehrave për ushqim sepse mamaja e tyre, një e alkoolizuar kronike, ishte zhdukur për dy javë.

Ai i kaloi gjashtë vitet e ardhshme duke shkuar shpesh, vullnetarisht, në një shtëpi fëmijësh ku kishte një numër të lartë të fëmijëve.

Ai filloi të kryente vepra penale në moshën 13-vjeçare, shpeshherë bashkë me vëllain dhe disa bashkëmoshatarë nga e njëjta zonë në të cilën gjatë asaj kohe, kishte një nivel të lartë krimesh dhe ky grup ishte përgjegjës për një numër të madh krimesh, kryesisht për krime “të zakonshme” të miturish, p.sh., vjedhje e përdorimi i makinave dhe dëmtimi i qëllimshëm i tyre.

Gjatë dy viteve në vazhdim, ai është vendosur shpesh nën mbikëqyrje dhe më vonë nën shërbimin e provës, por asnjë nga këto nuk dha rezultate për sa i përket reduktimit të recidivizmit.

Ai filloi të kryente vepra penale të dhunshme nga fundi i periudhës së adoleshencës, gjithmonë pasi kishte pirë. Zakonisht, menjëherë para kryerjes së këtyre veprave penale ishte e pakontrollueshme, madje psikotike, gjë që nuk ndodhte asnjëherë kur ishte esëll dhe nuk përdorte drogë. Kjo sjellje shqetësuese u bë më e zakonshme pasi vëllai i tij kreu vetëvrasje.

Midis periudhave, kur ka pasur shumë probleme dhe ka kryer vepra penale, ai ka pasur mundësi të punonte për periudha të gjata kohore dhe ishte punëtor dhe i afrueshëm me punëdhënësit dhe kolegët e vet. Gjatë kësaj kohe nuk përdorte drogë

dhe as nuk pinte. Megjithatë, këto periudha nuk zgjasnin shumë dhe ai i rikthehej pijes dhe kimit.

Si punonjësi i shërbimit të provës të cilit i është caktuar ky rast, i keni shkuar për vizitë në burg. Ai ka shmangur çdo problem që mund të ketë duke thënë se tani nuk pi dhe nuk drogohet dhe “gjithçka që i nevojitet” për të qëndruar larg telasheve është një punë. Nuk ka ku të jetojë pasi të lirohet, por mamaja e tij i ka ofruar strehë të përkohshme në shtëpinë e saj. Ajo pi dhe jeton në të njëjtën rrugë me viktimën i cili është shprehur se do të hakmerret ndaj J.B.

Si e vlerësoni J.B.-në?

Cilin nga modelet e mësipërme do të përdornit për të punuar me të?

Pse?

Fushat ku duhet punuar

Studimet e kryera në Angli dhe Uells identifikuan fushat e jetës së një individi të cilat mund të ndikojnë në mundësitë për një risistemim të suksesshëm pas një periudhe dënimi. Në një raport u identifikuan “shtigjet” e mëposhtme që duhen konsideruar në shumë raste (Ministria e Brendshme 2004):

- Strehimi
- Edukimi, trajnimi dhe punësimi
- Shëndeti (duke përfshirë edhe shëndetin mendor)
- Abuzimi me alkoolin/drogën
- Financat, fitimet dhe borxhet
- Fëmijët dhe familja
- Qëndrimi dhe sjellja.

Rast studimor:

Le t'i kthehemi përsëri rastit të J.B.-së. Përmbli dhni problemet e tij sipas “shtigjeve” të mësipërme. Si mund të adresohen ato? Çfarë lloj shërbimesh të këtij lloji ekzistojnë sot në Shqipëri? Cilin “shteg” mund të adresoni më mirë si punonjësi përkatës i shërbimit të provës për J.B.-në?

Rast studimor:

K.M. është 21 vjeç dhe është dënuar me 12 muaj burgim për kërcënim për vrasje x 2 (mamanë dhe partnerin e saj), rrahje dhe dëmtim i qëllimshëm të pronës private. Është dënuar edhe një herë më parë në moshën 16-vjeçare për agresion.

Prindërit e tij u ndanë kur ai ishte 10 vjeç dhe partneri i ri i mamasë së tij ka jetuar me ta që kur personi në fjalë ishte 15 vjeç. K.M nuk ka pasur një sjellje të mirë në

shkollë dhe i ka lënë studimet në mes. Nuk ka pasur një marrëdhënie të mirë me partnerin e nënës së tij, por nuk ka pasur as probleme madhore deri kohët e fundit.

Pasi la shkollën K.M ka punuar për pak kohë dhe e kalonte kohën duke fjetur ose në shtëpinë e një shoku.

Filloi të përdorte sasi të mëdha kanabisi dhe amfetamine dhe një natë, mamaja e tij e përzuri nga shtëpia sepse ishte duke pirë kanabis. Meqë nuk mund të flinte në shtëpinë e shokut të vet atë natë ai hyri me forcë në garazhin e shtëpisë dhe e zuri gjumi atje. Mamaja dhe partneri i saj u kthyen vonë në shtëpi, e gjetën aty dhe filluan të grinden, si rrjedhojë ai “u tërbua fare” dhe filloi t’i kërcënonte dhe të dëmtonte dy makinat e tyre.

Para pak kohësh ai u intervistua nga një punonjësi i shërbimit të provës ku rezultoi jo bashkëpunues dhe aspak i ndërgjegjësuar për viktimat. Së fundi i ka shkruar një letër babait të tij biologjik me të cilin ka mbajtur shumë pak kontakt 9 vitet e fundit dhe mendon se mund të jetojë me të pasi të lirohet.

Si do ta vlerësonit këtë individ?

Cilin nga modelet e sipërpërmendura do të përdornit për të punuar me të?

Pse?

Zbatimi

Çdo lirim me kusht ka rregulla dhe rregullore të cilat përcaktojnë sesa shpesh duhet të raportojë individi te punonjësi i shërbimit të provës, çfarë ndodh nëse nuk raporton si dhe kushte të tjera (shihni më sipër). Disa nga çështjet që lindin nga ky zbatim janë:

- Cilat janë kërkesat ligjore të shërbimit të provës?
- Si dëshironi t’i zbatoni?
- Sa takime, çfarë ndodh nëse ata nuk marrin pjesë?

Në Angli dhe Uells një individ i lejohen dy mungesa “të papranueshme” gjatë periudhës së provës brenda 12 muajve, përpara se t’u jepet një paralajmërim përfundimtar. Nëse bëjnë edhe një mungesë tjetër “të papranuar” mund të ridërgohen në burg sipas procedurave të “revokimit”. Revokimi zakonisht përfshin punonjësit më me eksperiencë të shërbimit të provës ose në nivel drejtuesish të cilët duhet të bien dakord për revokimin. Nëse ata janë dakord, departamenti i qeverisë që merret me burgjet dhe lirin me kusht, merr vendimin përfundimtar dhe siguron që personi të arrestohet dhe të ridërgohet në burg. Vini re që zakonisht nuk nevojitet paraqitja në gjyq. Personi mund të rikthehet në burg nëse kryen një vepër tjetër penale ose për “sjellje jo të mirë” që do të thotë një sjellje e cila mund të përbëjë shqetësim për komunitetin.

Pyetjet e rëndësishme në lidhje me zbatimin janë: çfarë është një mungesë e papranueshme; cili vendos nëse një mungesë është e pranueshme ose jo; a duhet

ridërguar gjithmonë në burg personi pasi ka bërë tri mungesa të papranueshme brenda 12 muajve?

Mendoni për sa më shumë arsye të mundshme përse një individ mund të mos vijë në takimin me punonjësin e shërbimit të provës. Pasi t'i keni menduar ato, vendosni nëse janë mungesa të “pranueshme” apo “të papranueshme”. Pse i keni vendosur ato në secilën kategori?

Cili duhet të vendosë nëse një mungesë është e pranueshme?

Pse?

Rast studimor:

A.B. ka rreth 12 muaj që ka dalë nga burgu. Ai kishte qëndruar në burg për 3 vjet i dënuar për vjedhje. Një natë kishte ndaluar me dhunë një grua të moshuar dhe i kishte marrë paratë dhe disa sende të tjera.

Që kur doli nga burgu, ai ka treguar shenja pendimi dhe është sjellë mirë gjatë periudhës së provës. Është kthyer të jetojë me mamanë e tij të cilën e ndihmon me punët e shtëpisë dhe ka gjetur edhe një punë.

Megjithatë, pasi kishte vetëm 3 javë që kishte dalë nga burgu kishte harruar të paraqitej në zyrën e shërbimit të provës. Kjo u quajt mungesë e papranueshme dhe i dhanë një paralajmërim. Për gjashtë muajt e ardhshëm ai u paraqit në çdo takim. Por një ditë nuk ishte zgjuar dot në kohë për shkak se kishte punuar deri vonë dhe kështu që u bë vonë për takimin. Kjo u konsiderua si mungesë e pranueshme për shkak të sjelljes së tij të mirë. Por, e njëjta gjë ndodhi edhe një javë më vonë. Kësaj radhe nuk u konsiderua mungesë e pranueshme dhe atij iu dha paralajmërimi i fundit.

Javën e kaluar ai u kujdes për mamanë e tij të sëmurë. Si rrjedhojë, kishte harruar të paraqitej në takim dhe nuk kontaktoi me punonjësin e shërbimit të provës. Ky incident i fundit ndodhi mbi 5 muaj pas mungesës së parë.

A është mungesa e tij e fundit e papranueshme apo jo? Pse? Kush duhet të vendosë?

A duhet të rikthehet në burg A.B-ja?

Rast studimor:

C.D. ka gjashtë muaj që ka dalë nga burgu. Ai vuajti një dënim prej 12 muajsh për agresion dhe abuzim me alkoolin. Që prej daljes nga burgu, ai ka qenë i rregullt në takime dhe nuk ka pasur më probleme me pijen. Nuk ka qenë në gjendje të gjejë punë dhe as nuk ka strehim të përhershëm. Ai duhet të qëndrojë te miqtë e tij për disa ditë ose disa javë.

Mbrëmë u deh dhe e sulmuan rrugës për në shtëpi. Ai kundërveproi dhe goditi sulmuesin. U arrestua por më vonë u lirua pa asnjë akuzë sepse policia mendoi se e kishin provokuar.

A duhet të rikthehet ai në burg? Pse?

Çështje për diskutim dhe pyetje

- Sa e gjatë duhet të jetë periudha e provës?
- Çfarë do të thotë të “testosh” një individ për të parë nëse është reformuar? Të kursejmë duke i liruar të dënuarit para kohe? Të ndihmojmë ish të dënuarit të risistemohen dhe të mos kryejnë më vepra penale?
- Cilat janë rregullat dhe procedurat e revokimit të lirimit me kusht dhe zbatimit të tij?
- Çfarë ndodh me risistemimin në Shqipëri?
- Cilat lloje mungesash duhet të jenë të pranueshme dhe cilat të papranueshme?
- A duhen trajtuar të gjithë njësoj për sa i përket pranimi ose jo mungesave?
- A duhet të ndikojë progresi dhe motivimi i tyre në pranimin ose jo të mungesës? A është kjo e drejtë apo e padrejtë?
- Si do t’i trajnonit punonjësit e shërbimit të provës në lidhje me njohuritë dhe aftësitë që ata duhet të kenë?

8. DISA GRUPE TË VEÇANTA

Të miturit

8.1

Migena Leskoviku

Marrëdhënia midis moshës dhe krimit ka qenë subjekt i shumë analizave dhe studimeve kriminologjike. Në përgjithësi, mosha kulminante për të kryer vepra penale është më e lartë për meshkujt sesa për femrat. Pas viteve '90, numri i veprave penale të kryera nga të miturit në Shqipëri është rritur. Kështu që, është e rëndësishme të njihen të gjitha shkaqet dhe nevojat për të ndërhyrë që në fazat e para për t'i parandaluar ata, si dhe për të shmangur recidivizmin. Tendenca e të miturve për t'u përfshirë në aktivitete kriminale, është një tregues i problemeve sociale. Kështu, varfëria, mungesa e mjeteve të jetesës në familje, braktisja e shkollës, problemet familjare, divorci, emigracioni, përdorimi i drogës, etj, janë disa nga problemet që kanë çuar në rritjen e shkallës së kriminalitetit të të miturve.

Sipas statistikave, veprat penale të kryera nga të miturit janë më të shpeshta në zonat e mëdha urbane dhe, shumë prej këtyre problemeve janë evidentuar në Tiranë. Në bazë të statistikave të policisë dhe gjykatave, një numër i madh të miturish që kanë kryer vepra penale vijnë nga familje me probleme sociale dhe disa prej tyre nuk kanë përfunduar as arsimin e detyruar (9- vjeçar).

Statistikat zyrtare tregojnë se veprat penale që lidhen me vjedhjet e ndryshme, janë ato që janë kryer më shpesh nga të miturit këto vitet e fundit, dhe duke marrë parasysh ndarjen e veprave penale në krime dhe kundërvajtje penale, rezulton se shumica e të miturve kanë kryer më shumë krime se kundërvajtje. Gjithashtu, të miturit kanë kryer edhe vepra penale të tilla si: vrasje, plagosje e rëndë, krime seksuale, shpërndarje droge, etj, gjë që tregon për rrezikshmërinë e veprave penale të kryera prej tyre, pavarësisht se ky numër është më i ulët se numri i veprave penale të kryera nga të rriturit.

Sipas statistikave zyrtare të gjykatave për vitin 2003-2007, shifrat për krimet e kryera nga të miturit janë si vijon:

Viti	Numri total i autorëve të veprave penale	Autorë të veprave penale të mitur	Në përqindje
2003	6628	308	4.6 %
2004	6379	320	5 %
2005	6317	289	4.5 %
2006	6613	268	4.1 %
2007	5678	211	3.8 %

Në lidhje me të miturit, për efekt të përgjegjësisë penale, Kodi Penal shqiptar, e përkufizon një të mitur si një individ të moshës 14-18 vjeç. Moshë minimale për përgjegjësi penale është 14 vjeç për krimet dhe 16 për kundërvajtjet penale. Në fakt, legjislacioni shqiptar nuk përcakton ndonjë masë për krime të kryera nga një fëmijë nën 14 vjeç, madje as për fëmijët e moshës 14 ose 15 vjeç që kryejnë kundërvajtje penale. Ligji, siç tregohet më sipër, parashikon vetëm “masa edukuese” të cilat zbatohen në institucione të posaçme për këtë qëllim, që dikur përcaktoheshin si shkolla apo institucione edukuese, dhe që tashmë nuk ekzistojnë më. Pamundësia e kërkesës për pjesëmarrje të këtyre fëmijëve në ndonjë program të caktuar për të parandaluar vazhdimin e aktivitetit kriminal, kontribuon në kryerjen e veprave penale dhe ndoshta në shfrytëzimin e të miturve nën moshën për përgjegjësi penale nga kriminelët e rritur.

Përfshirja e të miturve në disa aktivitete “jo-kriminale”, por që përsëri janë të papërshtatshme për ta, si: lypja, përdorimi i drogës, braktisja e shkollës, etj., mund të krijojë kushtet potenciale që i mituri të përfshihet në aktivitete kriminale ose të viktimizohet. Realiteti tregon se të miturit kanë qenë viktimë të disa veprave penale, të tilla si: keqtrajtimi ose abuzimi nga prindërit, duke përfshirë edhe abuzimin seksual, trafikimi për qëllime të ndryshme, gjakmarrja, etj. Ka një numër të madh veprash penale në lidhje me dhunën në familje, ku një pjesë e mirë e viktimave janë të mitur. Megjithatë, nuk ka statistika zyrtare për numrin e fëmijëve të viktimizuar në Shqipëri, edhe pse janë bërë disa studime/projekte mbi disa lloje krimesh, viktimat e të cilave janë kryesisht fëmijë.

Raste të ndryshme abuzimi me fëmijët janë paraqitur dhe shqyrtuar nga Avokati i

Popullit. Nevojitet një strukturë e fortë shtetërore e cila do të promovojë dhe mbrojë të drejtat e fëmijëve nga sjellja abuzive e autoriteteve shtetërore dhe individëve. Kjo kërkon përkushtim politik dhe financiar, si dhe reforma ligjore, por që nga ana tjetër, këto kërkojnë kohë për t'u realizuar. Avokati i Popullit ka propozuar një projektligj, në lidhje me Hetuesin privat dhe Avokatin e personit të dëmtuar (viktimës) që nga fillimi i hetimeve, duke iu referuar modeleve të aplikuara tashmë në shtete të tjera, për të garantuar një mbrojtje sa më të mirë të së drejtës së jetës, si dhe të lirive dhe të drejtave të njeriut. Këto dy funksione, që përmbajnë të drejta dhe detyrime procedurale, do të ndihmojnë në rritjen e zbulimit të krimit, do të shmangin vonesat e hetimit dhe gjykimin dhe, mbi të gjitha, do të shmangin shpërdorimin e detyrës apo korrupsionin në prokurori dhe gjykata.

Avokati i Popullit ka dhënë një kontribut të veçantë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke trajtuar ankesa individuale dhe duke hetuar me nismën e vet disa raste të bëra publike, si dhe duke dhënë rekomandime për ndryshime apo përmirësime të nevojshme në legjislacion.

Gjatë vitit 2007, janë trajtuar 136 ankesa me subjekt dhunimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithsej 657 fëmijë përfituan direkt nga ndihma e dhënë nga trajtimi i këtyre rasteve. Kjo ndodhi sepse disa nga ankesat, kërkesat apo rastet e ekzaminuara me iniciativë, ndikonin mbi të drejtat e një numri të madh fëmijësh.

Janë trajtuar 8 raste që kishin për qëllim përmirësimin e të drejtave për një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Këto raste kishin lidhje kryesisht me përmirësimin e kushteve të edukimit parashkollor; për fëmijët e izoluar për shkak të gjakmarrjes ose problemeve me kushtet shtëpiake, etj.

Përveç ligjit penal dhe sanksioneve ndëshkuese, masat parandaluese përfshijnë: masa sociale, ekonomike dhe kulturore, të cilat duhet të zbatohen veçanërisht për të miturit. Kështu, masat edukuese, të punësimit, masa për rritjen e mirëqënies dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, si dhe shërbimet e kujdesit social dhe mjekësor, janë mjete të rëndësishme dhe thelbësore për parandalimin e krimit. Këto masa parashikohen nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe, si rrjedhojë, duhen reflektuar në pjesën tjetër të legjislacionit tonë.

Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton:

Shteti, në bazë të pushtetit kushtetues dhe mjeteve në dispozicion, si dhe për të mbështetur nismën dhe përgjegjësinë private, synon:

- *Kushte të përshtatshme pune për individët në gjendje pune;*
- *Standardet më të larta të mundshme për shëndetin fizik dhe mendor;*

- *Edukimin dhe kualifikimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të punësuarve sipas aftësive të tyre përkatëse;*
- *Zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve argëtuese;*
- *Kujdes dhe ndihmë për të moshuarit, jetimët dhe personat me aftësi të kufizuara;*
- *Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin aktual dhe brezat e ardhshëm.*

Reforma të rëndësishme administrative kanë ndikuar pozitivisht në trajtimin e të miturve. Një reformë e rëndësishme ka qenë krijimi i seksioneve të veçanta për të miturit, në gjykata. Krijimi i këtyre seksioneve të veçanta, ishte një kërkesë e Kodit të Procedurës Penale. Me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vitin 2007 u autorizua krijimi i këtyre seksioneve në 6 gjykata të rretheve gjyqësore, në bazë të vendndodhjes aktuale të gjykatave të apelit. Emërimi i gjyqtarëve të specializuar për këto raste, ka përmirësuar cilësinë e drejtësisë deri tani. Dënimet e dhëna për të miturit - autorë të veprave penale, të cilët mbajnë përgjegjësi penale, nuk mund të tejkalojnë gjysmën e dënimit që do të jepej për një të rritur, të dënuar për të njëjtën veprë penale.

Disa ndryshime të bëra në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, synojnë të përmirësojnë procedurat për vëzhgimin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin. Së fundi, si rezultat i reformës brenda strukturës së policisë, në 12 drejtori policie është krijuar një njësi e specializuar policie për krimet që përfshijnë fëmijët dhe dhunën në familje. Ky është konsideruar si një zhvillim pozitiv në trajtimin e rasteve të të miturve.

Dispozita të ndryshme ligjore lejojnë reduktimin e dënimit. Kodi Penal parashikon që dënimi për të miturit është sa gjysma e dënimit të dhënë për të rriturit në ato raste kur vepra penale dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të ulët për shoqërinë, si dhe kur ka rrethana lehtësuese. Sipas Kodit Penal, çdo i mitur i dënuar për një veprë penale mund të vendoset në një institucion edukues dhe jo në burg, nëse gjykata e shikon si të përshtatshme në bazë të sjelljes së mëparshme të të miturit, të rrethanave sociale dhe rrezikshmërisë që paraqet vepra penale e kryer. Megjithatë, aktualisht nuk ekzistojnë institucione të tilla, ndaj dhe kjo dispozitë nuk është zbatuar.

Kodi Penal parashikon dhënien e masave mjekësore me mjekim të detyruar për ata individë të cilët nuk kanë përgjegjësi penale për veprën penale të kryer për shkak të problemeve mendore. Këto vendime nuk zbatohen në praktikë për të miturit, pasi institucionet për të sëmurët mendorë nuk kanë njësi të veçanta për trajtimin e përshtatshëm të të miturve.

Kodi i Procedurës Penale parashikon disa dispozita që lidhen kryesisht me të miturit. Kështu, Kodi i Procedurës Penale njeh të drejtën e të miturit të akuzuar për asistencë ligjore dhe psikologjike gjatë gjithë procesit penal. Ky Kod parashikon që edhe

mundësinë për t'u mbrojtur nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, mbi bazën e listave emërore që miratohen çdo vit nga dhomat e avokatisë, në rastet kur i pandehuri dëshiron të mbrohet, por nuk mund të paguajë një avokat mbrojtës. Në rastin e të miturve, çdo veprim i ndërmarrë në mungesë të avokatit mbrojtës quhet i pavlefshëm.

Por ka edhe disa probleme që lindin nga Kodi i Procedurës Penale lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit. Fakti është që, ky Kod nuk bën asnjë dallim midis të miturve dhe të rriturve në lidhje me afatet e paraburgimit, dhe masat e sigurisë dhe kohëzgjatja e tyre janë të njëjta për të dyja kategoritë. Ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve” parashikon që të miturit e vuajnë dënimin në institucione të veçanta ose në njësi të veçanta brenda institucioneve të vuajtjes së dënimit. Aktualisht nuk ekziston asnjë institucion i veçantë për të miturit e dënuar, por të miturit vuajnë dënimin në një seksion të veçantë brenda një burgu për të rritur. Një institucion i ri për të miturit do të hapet së shpejti, por ku mendohet se aty do të qëndrojnë vetëm të miturit e dënuar, por jo ata që janë të paraburgosur.

Kreu VII i Kodit Penal trajton alternativat e dënimit me burgim. Të gjitha dispozitat e këtij kreu aplikohen njësoj, si për të rriturit dhe të miturit e dënuar, të cilët mbajnë përgjegjësi penale për veprat e kryera. Paketa e re ligjore (miratuar në 27 nëntor 2008), ka rritur numrin e alternativave të dënimit me burgim dhe sanksionon krijimin e Shërbimit të Provës. Këto dispozita të reja i kushtojnë vëmendje të miturve, por përsëri nuk mund të themi se është e mjaftueshme. Për më tepër që ndryshime duhen bërë edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me këtë aspekt.

Rast studimor

E.K. është një 15 vjeçar i akuzuar për vjedhje (sipas nenit 134/1 të Kodit Penal). Ai hyri në zyrën e drejtorit të shkollës dhe vodhi kartën e tij të kreditit. Më pas, ai tërhoqi një shumë parash nga llogaria e tij. Kur u arrestua, E.K. ishte nxënës në vitin e parë të shkollës së mesme. Gjatë gjyqit, gjykata vuri re që prokurori nuk kërkoj asistencë sociale-psikologjike. Si rrjedhojë, gjykata urdhëroi që i mituri të vlerësohej nga një psikolog i specializuar, i cili përgatiti një raport vlerësues dhe i rekomandoi gjykatës një sanksion alternativ për të miturin në fjalë, gjë që do të ishte në favor të tij.

Pas gjykimit, E.K. u shpall fajtor dhe u dënua nga gjyqtarë të seksionit për të mitur, me 3 muaj burgim. Duke mbajtur parasysh që i mituri nuk paraqiste shkaillë të lartë rrezikshmërie, moshën e tij, pendimin për atë çfarë bëri si dhe rrethanat në të cilat kreu këtë veprë penale, gjykata vendosi të zbatonte alternativën e përcaktuar në nenin 59 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim dhe duke e vënë të miturin në provë, për një periudhë prej 18 muajsh, me kusht që gjatë kësaj

kohe i mituri të mos kryente asnjë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë edhe arsimimin e të miturit, gjykata vendosi që gjatë periudhës së provës, ai të kryente një aktivitet profesional ose të merrte trajnim profesional/arsimor, sipas nenit 60/1 të Kodit Penal. Gjykata vendosi që ky detyrim të zbatohet në qendrën arsimit/trajnimit profesional “Don Bosco” në Tiranë, ku ofrohet arsimim për të miturit e kësaj moshe, si dhe kurse profesionale.

Bazuar në rastin e mësipërm studimor, a mendoni se ky ishte vendimi i duhur që duhej dhënë nga gjykata?

- Si e vlerësoni këtë dënim në bazë të asaj çfarë ndodhi?

- A mendoni se ky dënim do ta ndihmojë të miturin “të ndëshkohet” për atë çfarë bëri dhe për rehabilitimin e tij?

Një projekt-pilot mbi shërbimin në komunitet filloi në vitin 2007 i financuar nga UNICEF. U krijuan 11 “qendra pritëse” me një kapacitet total për 40 të dënuar. Ky projekt u zbatua në bashkëpunim me Prokurorinë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. U hartuan protokolle në lidhje me referimet, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e këtyre personave. Gjatë vitit të parë (gusht 2007 – shtator 2008) 26 të mitur janë dënuar me shërbim në komunitet. Kjo përbën 44% të dënimeve të dhëna nga seksioni i të miturve në Tiranë. Vetëm një dënim i pezulluar u revokua për shkak të sjelljes jo të mirë të të miturit.

Skemat e ndryshme alternative nuk njihen aq sa duhet. Ndërmjetësimi është e vetmja formë alternative e përdorur dhe, si rrjedhojë, çështjet e ndryshme që paraqiten nuk mund të trajtohen duke iu referuar masave alternative, pa miratimin e viktimës. Masat alternative reduktojnë rrezikun e stigmatizimit të të dënuarit, që mund të kontribuojë në kryerjen e krimeve edhe më të rënda, parandalojnë rritjen e panevojshme të numrit të rasteve të trajtuara nga gjykatat dhe prokuroria, si dhe koston e administrimit të drejtësisë.

Një OJF, “Fondacioni shqiptar për ndërmjetësim dhe zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve” ofron shërbime për ndërmjetësimin midis viktimës dhe autorit të veprës penale, për të miturit e moshës 14-21 vjeç; shërbime ligjore për të miturit dhe fëmijët në konflikt me ligjin; restaurimi/ri-integrimin e viktimave; rehabilitimin për të dënuarit; këshillimin familjar për palët e përfshira në konflikt; ndërmjetësimin nga bashkëmoshatarët në shkolla.

Masat/programet e parandalimit social për të miturit, janë me bazë komunitare dhe

kanë lidhje me zhvillimin e programeve kulturore dhe argëtuese për të kaluar kohën e lirë, në mënyrë që të shmanget përdorimi i drogës apo të frenohet kriminaliteti.

Duhet zhvilluar shërbime dhe programe komunitare, të cilat u përgjigjen nevojave të veçanta, problemeve, interesave dhe shqetësimeve të të miturve, dhe që të ofrojnë këshillim dhe udhëzime për këta të mitur dhe familjet e tyre; apo të forcohen aty ku këto programe tashmë ekzistojnë.

Disa sugjerime për masat parandaluese fokusohen në:

- arsimimin tërheqës/monitorim të pjesëmarrjes në shkollë;
- integrimin ekonomik të të rinjve;
- skemën për mbështetje familjare;
- mbështetjen e pjesëmarrjes së fëmijës në jetën sociale;
- programet mbështetëse për fëmijët e rrugës;
- krijimin e mjediseve argëtuese për dhe me fëmijët;
- parandalimin e përdorimit/abuzimit me alkoolin/drogën;
- krijimin e ambienteve sportive si një mjet për integrimin social;
- krijimin e shërbimeve sociale duke përfshirë edhe mbështetjen familjare.

Krijimi i një politike të përgjithshme sociale për këdo, është mënyra më e mirë për të parandaluar probleme të tilla si: delinkuenca, neglizhimi ose abuzimi. Fëmijët dhe familjet duhet të kenë akses të pakushtëzuar ndaj shërbimeve bazë sociale. Këto shërbime duhen integruar sa më shumë në skemat “e jetës normale” dhe të bëhen pjesë e strukturave ekzistuese.

Për parandalimin e kriminalitetit të të miturve, është e rëndësishme të theksohet edhe nevoja për masa psiko-sociale, veçanërisht në fazat e para. Këtu mund të përfshijmë programe për trajnimin e prindërve mbi edukimin e fëmijëve të tyre, programe shkollore për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet fëmijëve, mësuesve, prindërve, policisë, punonjësve socialë apo psikologëve, si dhe programe të tjera ndërgjegjësuese apo në media. Këto masa synojnë të ngulitin te të miturit parimet dhe vlerat që kanë lidhje me respektimin e ligjit, të rregullave sociale dhe normave të sjelljes, bashkëpunimit komunitar, respektin për familjen, prindërit, vlerat sociale dhe morale, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi sjelljen ose fenomenet negative në shoqëri, si dhe për të minimizuar rrezikun e viktimizimit.

Në Shqipëri është bërë progres në lidhje me masat parandaluese. Kështu, p.sh., është miratuar ligji kundër dhunës në familje, po zbatohen strategji të ndryshme, të tilla si: strategjia për reduktimin e varfërisë, kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për barazinë gjinore, për zhvillimin e zonave rurale, etj. Përveç masave qeveritare, po

evidentohet edhe një pjesëmarrje gjithnjë e më e gjerë e shoqërisë civile, si dhe një rritje e bashkëpunimit midis organizatave ndërkombëtare dhe vendase me autoritetet shqiptare.

Programe/projekte të veçanta për grupet e cenueshme/të rrezikuara, të tilla si: fëmijët e trafikuar, gratë e dhunuara, fëmijët me vështirësi sociale, fushata ndërgjegjëse, etj, po zbatohen me rezultate pozitive. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksojmë edhe nevojën dhe domosdoshmërinë për zbatimin në kohë dhe me efektivitet të këtyre masave dhe programeve.

Pyetje për diskutim:

- 1. A mendoni se shkaqet e kryerjes së krimeve nga të miturit vlerësohen siç duhet nga autoritetet shtetërore kur krijohen programe/masa parandaluese?*
- 2. Çfarë mendoni për masat parandaluese për të miturit, të zbatuara deri tani në Shqipëri? Po për reagimin e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve në lidhje me masat/vendimet e përshtatshme për të miturit?*
- 3. Diskutoni masat alternative për të miturit, bazën ligjore dhe zbatimin e tyre.*
- 4. Çfarë programesh mendoni se do ishin efikase dhe duhen zbatuar për të miturit dhe fëmijët në konflikt me ligjin në Shqipëri?*
- 5. Bazuar në rastin e mësipërm studimor, çfarë mendoni për shërbimin e ri të provës që do të fillojë të zbatohet/funksionojë ? A jeni pro dënimeve alternative për të miturit? Çfarë mendoni se do të ndryshojë në rehabilitimin e të dënuarve të mitur dhe për të shmangur recidivizmin?*

8. DISA GRUPE TË VEÇANTA

Personat me sëmundje mendore, autorë të veprave penale

8.2

Ioana van Nieuwkerk

Raporti i veprimit të ligjit me personat me sëmundje mendore, autorë të veprave penale është një raport i ndërlikuar për vetë tiparet ndër-disiplinare të tij, prandaj dhe trajtimi i këtyre personave mbetet një çështje e vështirë edhe në Shqipëri. Kjo vjen nisur edhe nga këndvështrimet e ndryshme mbi natyrën e sjelljes kriminale. Sjellja kriminale në vende si ai i yni, është e lidhur si me karakteristikat e zonave të ndryshme gjeografike, stadin e zhvillimit social-ekonomik të zhvillimit të shoqërisë sonë, nivelin kulturor dhe atë arsimor. Autori i veprës penale konsiderohet “i keq” nga natyra ose e kundërta, herë të tjera autori i veprës penale konsiderohet “i sëmurë” dhe ka nevojë për trajtim.

Ka disa çështje të tjera që lidhen me këtë fushë të punës së shërbimit të provës, si për shembull, mënyra e trajtimit të krimit dhe sjelljes kriminale. Ne, ose mund ta konsiderojmë autorin e veprës penale si individualisht përgjegjës për “zgjedhjen” e tij/saj në momentin e kryerjes së veprës penale, ose mund të përpiqemi të kuptojmë kriminalitetin duke marrë parasysh ndikimet e faktorëve socialë në fenomenin e krimit.

Në Shqipëri nuk ka shumë informacion dhe publiku nuk është i ndërgjegjësuar për situatën e shëndetit mendor. Për më tepër, informacioni lidhur me personat me probleme mendore të cilët kryejnë vepra penale, pothuajse nuk ekziston. Ekziston informacion vetëm për autorët e identifikuar të veprave penale të cilët janë evidentuar se kanë çrregullime mendore, që janë proceduar penalisht dhe më pas janë dënuar me burgim, apo në rastet kur kanë qenë të papërgjegjshëm për t’iu nënshtruar një procedimi dhe ndaj tyre janë aplikuar masat mjekësore.

Kuadri ligjor

Sipas ligjit për shëndetin mendor¹⁴ “*Person me çrregullime mendore*” është personi që:

- a) paraqet probleme të funksionimit mendor, të cilat, në bazë të njohurive mjekësore, klasifikohen si çrregullime mendore dhe është nevoja për trajtim të specializuar shëndetësor;
- b) ka prapambetje mendore;
- c) paraqet çrregullime psikosociale, që kërkojnë trajtim të specializuar psikosocial.

Ky ligj përcakton edhe se cilat konsiderohen institucionet psikiatrike dhe rehabilituese¹⁵ për këtë kategori, duke përmendur si të tilla:

- a) spitali psikiatrik;
- b) reparti psikiatrik në një spital të përgjithshëm;
- c) shtëpitë e kurimit dhe/ose rehabilitimit;
- d) agjencitë e shërbimeve sociale.

Po kështu, mënyra e ekzaminimit, trajtimit, rehabilitimit, kujdesit dhe asistencës të të sëmurëve mendorë nga institucionet psikiatrike dhe rehabilituese, sipas këtij ligji, rregullohet sipas parimeve të përgjithshme të politikës shëndetësore dhe sociale.¹⁶ Ndërsa gjykata hyn në veprim për rastet kur kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore ose me prapambetje mendore.¹⁷ Për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepra penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në institucione psikiatrike, ky ligj¹⁸ u njeh të drejtën e përfitimit të kujdesit mjekësor të nevojshëm. Po në këtë rast institucionet psikiatrike iu nënshtrohen rregulloreve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Të sëmurët mendorë sikurse edhe të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë gëzojnë mbrojtje juridiko-kushtetuese.¹⁹ Shteti ka për detyrë t’u garantojë shtetasve të tij standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm.²⁰

Legjislacioni penal i R.Sh.-së bazohet tek nocioni i përgjegjshmërisë në rastin e kryerjes së një vepre penale duke iu përmbajtur me rigozitet parimit “*nullum crimen, sine culpa*”, kjo do të thotë që ligji penal vepron vetëm ndaj autorëve që janë të përgjegjshëm para ligjit, ndërsa të tjerët, pra të papërgjegjshmit, u nënshtrohen masave mjekësore.

14. Neni 4 i ligjit nr. 8092, datë 21.03.1996 “Për shëndetin mendor”.

15. Po aty, paragrafi 2

16. Po aty, neni 11.

17. Po aty, neni 15.

18. Po aty, neni 41.

19. Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

20. Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kuadri social

Cilët janë autorët e veprave penale me çrregullime mendore? Sigurisht ka shumë sëmundje mendore, por prezantimi i detajuar i të gjitha këtyre sëmundjeve nuk është qëllimi i këtij materiali. Është e mjaftueshme të përcaktojmë në vija të përgjithshme se termi “autorët e veprave penale me sëmundje mendore” u referohet atyre personave që kanë një problem mendor ose një sëmundje mendore dhe të cilët, përveç kësaj, kryejnë vepra penale. Këta persona mund të ndahen në katër kategori të ndryshme:

1. Persona të cilët kanë probleme mendore dhe kryejnë vepra penale, por që ende nuk janë identifikuar si të tillë, për shkak se as nuk janë trajtuar nga ana shëndetësore dhe as nga sistemi i drejtësisë penale.
2. Personat të cilët kanë hyrë tashmë në sistemin e drejtësisë penale dhe kanë probleme mendore. Është po kështu e vështirë për të përcaktuar përqindjen e autorëve të veprave penale nga kjo kategori. Disa studime në Mbretërinë e Bashkuar kanë arritur në konkluzione të ndryshme në këtë aspekt, megjithatë ato sugjerojnë se përqindja e autorëve të veprave penale me sëmundje mendore është nga 2% - 30%. Këto përqindje ndryshojnë nga një studim tek tjetri, pjesërisht për shkak se studimet kanë pasur si synim autorë të veprave penale në rrethana të ndryshme (persona të dënuar me dënime alternative dhe të dënuar me burgim) dhe, pjesërisht për shkak se janë përdorur përkufizime të ndryshme të konceptit “të sëmundjes mendore”.
3. Grupi i tretë përbëhet nga persona të cilët janë regjistruar në sektorin shëndetësor dhe kryejnë vepra penale, por nuk përcaktohen dhe nuk konsiderohen autorë të veprave penale për shkak se, ndoshta sjellja e tyre tolerohet dhe kuptohet si pasojë e sëmundjes së tyre mendore. Këta persona nuk hyjnë në sistemin e drejtësisë penale duke u konsideruar të papërgjegjshëm për sjelljen e tyre kriminale dhe marrin “trajtim”, gjë e cila nuk i etiketon ata si autorë të veprave penale. Përsëri është e pamundur për të përcaktuar numrin e personave të cilët mund të vendosen në këtë kategori.
4. Grupi i fundit përbëhet nga persona të cilët zyrtarisht janë identifikuar si autorë të veprave penale me probleme mendore dhe të cilët në të njëjtën kohë, u janë nënshtruar disa masave dhe sanksioneve të vendosura nga gjykata.

Grupi i fundit është ai i cili mund të njihet dhe përcaktohet si një grup që duhet vendosur në kontakt me shërbimin e provës dhe shërbimin për shëndetin mendor. Ekziston gjithashtu mundësia për autorin e veprës penale, i cili bëhet klient i shërbimit të provës, të ketë një sëmundje mendore, gjë e cila nuk është identifikuar asnjëherë në të kaluarën. Një mundësi e tillë duhet të merret në konsideratë kur punonjësit të shërbimit të provës i kërkojnë të vlerësojnë nevojat dhe rrezikshmërinë e paraqitur nga autori i veprës penale.

Mundësitë e reja që ofron Kodi Penal me ndryshimet e bëra, për sa u përket dënimeve alternative, mund ta angazhojë shërbimin e provës më tepër me këtë kategori personash. Këtu bëhet fjalë për atë kategori personash të cilët kanë kryer vepra penale jo shumë të rrezikshme në gjendje të turbullimeve psikike apo të uljes së ekuilibrit mendor, rrethana këto që e bëjnë atë të përgjegjshëm para ligjit, megjithëse i sëmurë dhe, që merren parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit. Ndaj këtyre personave mund të jepen dënime të tilla si ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, të ndryshuar, si:

1. detyrimi për të qëndruar larg një vendi të caktuar
2. mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor
3. Nënshtrimi të një trajtimi mjekësor apo rehabilitues.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 17 “Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore”, personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale, nuk ka përgjegjësi penale. Po kështu, personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet ose mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.²¹

Pra, Kodi Penal e ndan papërgjegjshmërinë në dy kategori: në rastin e parë, në kategorinë e personave të cilët janë të papërgjegjshëm para ligjit dhe nuk i nënshtrohen dënimit dhe në rastin e dytë, kur kanë ulje të ekuilibrit mendor, janë të përgjegjshëm para ligjit por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, gjykata mund të japë masë mjekësore si:

1. Mjekim i detyruar ambulator
2. Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor.²²

Mjekimi i detyruar ambulator nënkupton shtrimin e detyruar të personit në një institucion neuropsikiatrik për mjekim pa e veçuar atë. Mjekimi i detyruar në institucion mjekësor nënkupton shtrimin në një institucion mjekësor të posaçëm neuropsikiatrik.²³ Në Shqipëri ka dy spitale psikiatrike, një në Elbasan dhe një në Vlorë dhe dy pavione ose reparte psikiatrike në Tiranë dhe në Shkodër. Këto spitale dhe pavione psikiatrike kanë në total 730 shtretër. Në spitalin e burgut pranë Qendrës Spitalore Universitare ka një pavion të veçantë për të sëmurët psikikë që kanë kryer krime të rënda.

21. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 17/2.

22. Neni 46 i Kodit Penal.

23. Prof.Dr. I. Elezi, Prof.Dr. S. Kaçupi, Prof.as.Dr. M. Haxhia - Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, GEER, Tiranë 2006

Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat prej të cilit ai është dhënë. Por në çdo rast, gjykata është e detyruar që pas kalimit të një viti nga data e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj.²⁴

Veprimet shoqërisht të rrezikshme që kryejnë të sëmurët psikikë, nuk kanë karakter penal pasi ata nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e kryerjes së veprimeve, por fakti që ata deklarohen të papërgjegjshëm, nuk do të thotë që do të lihen të lirë dhe jashtë kontrollit të shoqërisë.²⁵

Mjekimi psikiatrik i detyruar kryhet në institucione të veçanta²⁶, ku janë të siguruara masat për mjekim të domosdoshëm e të kualifikuar, si dhe kushtet për të parandaluar dhe mënjeluar veprimet e rrezikshme të të sëmurit. Deri tani këto masa janë zbatuar pranë spitaleve psikiatrike ose spitalit të burgut.

Personat me çrregullime mendore të cilët nuk paraqesin rrezikshmëri, kanë mundësi të vazhdojnë të jetojnë në komunitet më mirë se sa ata të mbyllen/izolohen në institucionet e mbyllura të kujdesit shëndetësor. Duket të ketë një politikë drejt orientimit të shmangies së dënimeve me burgim apo masave mjekësore që synojnë mbylljen në spitale psikiatrike dhe referimin e këtyre rasteve të alternativat e dënimit me burgim apo masat mjekësore ambulatorë, duke synuar kështu rehabilitimin dhe integrimin e kësaj kategorie në shoqëri.

Lidhur me trajtimin komunitar të të sëmurëve mendorë, autorë të veprave penale, në vend të shtrimit të spital psikiatrik, ata mund të trajtohen gjatë ditës në qendrat ditore, duke bërë të mundur kështu si mjekimin ashtu edhe angazhimin e tyre në aktivitete të ndryshme, dhe më pas ata mund të kthehen në shtëpitë e tyre.

Është tepër e domosdoshme për punonjësit e shërbimit të provës që në rastet ku ata do t'i sugjeronin gjykatës, nëpërmjet raportit të tyre, të jenë në dijeni të qendrave komunitare të shëndetit mendor dhe shërbimet që ato ofrojnë, si ato shtetërore ashtu edhe OJF-të e ndryshme.

24. Neni 46 i Kodit Penal.

25. Psikiatria ligjore, Dr. Nazim Shtino.

26. Neni 45 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

Në vijim do të gjeni një përshkrim të shkurtër të shërbimeve komunitare që ekzistojnë në Shqipëri, në fushën e shëndetit mendor.²⁷

Tiranë

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (OKSHM), Rajoni Nr. 1- Tiranë

QKSHM ofron shërbime të shëndetit mendor për banorët e njësive bashkiake Nr. 5, 6 dhe 7, si dhe komunat; Baldushk, Bërzhitë, Bërxull, Dajt, Paskuqan, Petrelë, Farkë, Shëngjergj, Zallherr, Zallbistar, Krrabë. Shërbimi mundësohet nëpërmjet një ekipi multidisiplinar të përbërë nga profesionistë të shëndetit mendor për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur.

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Rajoni Nr. 2-Tiranë

QKSHM (Rajoni 2) është Qendra e parë komunitare e hapur në vitin 2000, e cila ka shërbyer si model edhe për ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të tjera të ngjashme, në Tiranë dhe në rrethe. Kjo qendër ofron shërbime për banorët e njësisë bashkiake Nr. 5, 6, dhe 7. Shërbimet e saj konsistojnë në diagnostikim dhe trajtim mjekësor, vizita shtëpie, mbështetje psikologjike dhe emocionale, dhe zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese, mbështetje për zhvillimin e aftësisë për punë, kurse të zhvillimit të aftësive profesionale si: pikturë, anglisht dhe kompjuter, njohje të mundësive ekzistuese për punë, psiko-edukim (informacion mbi sëmundjen dhe mënyrat e përballimit të saj), si dhe mbështetje të familjarëve të personave me probleme të shëndetit mendor.

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3-Tiranë

QKSHM (Rajoni 3) ofron shërbime për banorët e njësive bashkiake Nr. 8, 9, 10, 11, komunat - Kashar, Prezë, si dhe bashkitë; Vorë dhe Kamëz.

Qendrës i është atashuar dhe shërbimi i psiko-pediatrisë, i cili ofron shërbim për fëmijët dhe adoleshentët si dhe “Qendra e Zhvillimit të Fëmijës”. Shërbimet e ofruara pranë QKSHM-së janë në përputhje të plotë me standardet e përqasjes komunitare dhe mundësohen nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga dy mjekë psikiatër, një psiko-pediatër, katër specialistë në fushën e psikopediatrisë, dy punonjës socialë, dy psikologë, katër infermiere.

Linja për Informimin mbi Shëndetin Mendor, Tiranë - mundësuar nga Qendra Shqiptare e Zhvillimit të Shëndetit Mendor (QSHZSHM).

Linja për informimin mbi shëndetin mendor funksionon nga e hëna në të premte, ora 09:00 deri 14.00, me qëllimin për t’iu ardhur në ndihmë të gjithë atyre personave,

27. Në mbledhjen e informacionit lidhur me qendrat komunitare dhe OJF-të në fushën e shëndetit mendor, është bashkëpunuar me Qendrën Shqiptare të Zhvillimit të Shëndetit Mendor.

përdorues shërbimesh të shëndetit mendor apo familjarë, që duan të dinë më shumë mbi çështje të shëndetit mendor si dhe mbi shërbimet ekzistuese. Kjo asistencë ofrohet nëpërmjet linjës telefonike me një profesionalizëm të plotë nga një grup profesionistësh të përbërë nga psikologë, punonjës socialë dhe infermierë.

Qendra Alternativa

Qendra është pjesë e sektorit jo-qeveritar dhe si e tillë ushtron aktivitetin e saj në fushën e shëndetit mendor prej vitesh. Ajo funksionon si qendër ditore për anëtarët e saj, si dhe synon socializimin dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor nëpërmjet aktivizimit dhe përfshirjes e tyre në aktivitete prodhuese që gjenerojnë të ardhura.

Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve

Qendra përbëhet nga një ekip multidisiplinar profesionistësh dhe synon t'u vijë në ndihmë fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor. Në këtë qendër ofrojnë ekspertizën e tyre profesionale mjekë psiko-pediatër, punonjës socialë, psikologë dhe terapistë okupacionalë dhe të zhvillimit. Qendra gjithashtu ofron shërbime ditore si dhe strehim, me zonë mbulimi në të gjitha rrethet.

Apartamenti i Mbrojtur i Komunitetit Sant Egid – Tiranë

Apartamenti ofron mundësi strehimi për 10 pacientë kronikë meshkuj, të cilët riaftësohen për jetesën dhe integrimin e tyre në komunitet.

Vlorë

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor me vendndodhje pranë spitalit psikiatrik të Vlorës, është mbështetur financiarisht dhe teknikisht nga “Pakti i Stabilitetit” dhe përbëhet nga një ekip multidisiplinar i cili mbulon qytetin e Vlorës dhe disa komuna.

Elbasan

Në Elbasan është ngritur një **Apartament i Mbrojtur “Drita”**, i cili ofron strehim për 10 pacientë ish kronikë të spitalit psikiatrik në Elbasan. Po në Elbasan prej vitesh tashmë ushtron aktivitetin e saj një **Qendër Ditore**, e cila mundëson parapërgatitjen e pacientëve të spitalit të Elbasanit për të rifilluar në komunitet, si dhe një aktivitet që gjeneron të ardhura, në të cilin janë angazhuar pacientë të spitalit. Gjithashtu në spitalin psikiatrik të Elbasanit është krijuar **Pavijoni i urgjencës**, i cili mundëson asistencën mjekësore afatshkurtër të të sëmurëve mendorë, duke parandaluar shtrimet afatgjata.

Cërrik

Apartament i Mbrojtur “Jeta”, i cili ofron strehim për 10 pacientë ish kronikë burra dhe gra, të spitalit psikiatrik në Elbasan.

Shkodër

Në Shkodër ushtron aktivitetin e tij prej vitesh **Apartamenti i Mbrojtur, “Shtëpia Mimoza”**. “Shtëpia Mimoza” ofron mundësi strehimi për 10 gra me probleme të shëndetit mendor.

Berat

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, mbështetur nga GIP. (Global Initiative on Psychiatry). Ekipi përbëhet nga infermierë, mjekë psikiatër dhe një punonjëse sociale.

Korçë

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor – pranë Spitalit të Sëmundjeve të Mushkërive. Qendra është e pajisur me një ekip multidisiplinar dhe ofron shërbime bashkëkohore për shëndetin mendor.

Deri tani nuk ka ndonjë statistikë zyrtare lidhur me personat që kanë kryer vepra penale dhe janë njëkohësisht të sëmurë mendorë por nuk janë dënuar për shkak të papërgjegjshmërisë së tyre. Gjithashtu, edhe lidhur me personat e liruar nga burgu i veçantë në Krujë të cilët janë shtruar në spital psikiatrik, nuk ka ndonjë të dhënë zyrtare.

Rreziku që paraqet për sigurinë publike autori i veprës penale me sëmundje mendore

Të sëmurët mendorë, autorë të veprave penale, paraqesin potencialisht rrezikshmëri për sigurinë publike në çdo moment. Kjo vjen për shkak të situatës mendore të tyre, e cila mund të evoluojë në kohë. Pra, prania e një çrregullimi mendor përbën një faktor për t’u marrë në konsideratë në vlerësimin e rrezikut që paraqet autori i veprës penale. Punonjësi i shërbimit të provës duhet të jetë në gjendje të parashikojë rrezikshmërinë e autorit të veprës penale. Sigurisht që për këtë, ata duhet të mbajnë kontakte të afërta me ekspertët e shëndetit mendor dhe të bëjnë punë në partneritet me ta. Kjo kuptohet, pasi vetë punonjësi i shërbimit të provës nuk mendohet të jetë ekspert i shëndetit mendor.

Punonjësit e shërbimit të provës duhet të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të garantuar sigurinë e tyre personale, përfshirë këtu strategjitë e zakonshme dhe procedurat organizative që lidhen me shëndetin dhe sigurinë e personelit. Për shembull, duhet të shmangen vizitat vetëm të një punonjësi të shërbimit të provës kur ka arsye për të besuar se siguria e tij/saj është në rrezik. Gjithashtu, lidhur me takimet me autorin e veprës penale me sëmundje mendore, punonjësi i shërbimit të provës duhet gjithmonë t'i verë në dijeni kolegët e tij/saj për vendin e takimit.

Çfarë është e rëndësishme për punonjësin e shërbimit të provës?

Puna me autorë të veprave penale që vuajnë nga sëmundje mendore, kërkon zhvillimin e dijeve dhe aftësive:

1. Njohuritë: punonjësi i shërbimit të provës duhet të jetë i familjarizuar me legjislacionin përkatës, me procedurat e shërbimit dhe rolin e specialistëve të ndryshëm që mund të përfshihen. Për një punonjës të shërbimit të provës është e rëndësishme të vendosë kontakte dhe të bashkëpunojë ngushtë me specialistët dhe institucionet e shëndetit mendor.
2. Trajnimi profesional: është e domosdoshme për punonjësit e shërbimit të provës që të marrin pjesë në sesione trajnimi për trajtimin e kësaj kategorie të dënuarish.
3. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërdisiplinar: Puna me autorë të veprave penale me sëmundje mendore, kërkon gjithmonë një përjasje ndërinstitucionale. Duhet të kuptohen qartë rolet, përgjegjësitë, detyrat e çdo institucioni ose eksperti.
4. Siguria: Punonjësit e shërbimit të provës duhet të kenë njohuri të rregullave bazë lidhur me sigurinë personale dhe duhet të mbështeten në ndihmën e kolegëve të tjerë.
5. Trajtimi human: punonjësit e shërbimit të provës duhet t'i trajtojnë në mënyrë humane personat e sëmurë që kanë kryer vepra penale dhe duhet të jenë në gjendje të njohin ndikimin e diskriminimit në shëndetin mendor dhe karakteristikat e diskriminimit që mund t'u bëhet personave të cilët kanë ose supozohet se kanë probleme të shëndetit mendor.

Të burgosurit me sëmundje mendore

Përveç sa është përmendur më sipër për personat e sëmurë mendorë në burgje, është tepër e rëndësishme për punonjësit e shërbimit të provës të kenë njohuri lidhur me trajtimin dhe gjendjen e të dënuarve me sëmundje mendor në burgje.

Në vijim, jepet një raport i përgatitur në vitin 2007 nga Prezenca e OSBE-së së Shqipëri, për t'iu dhënë të kuptoni situatën e autorëve të veprave penale të cilët janë të sëmurë mendorë dhe që vuajnë dënimin me burgim në Shqipëri, dhe që njihen si të dënuar vulnerabël (ose të burgosur me nevoja të veçanta). Për më tepër, raporti përmban njëkohësisht disa informacione lidhur me situatën e shëndetit mendor në

Shqipëri dhe për disa kategori të tjera të burgosurish me nevoja të veçanta, të cilat mund të jenë po kështu të përshtatshme për këtë Manual.

RAPORT MBI VIZITËN NË BURGUN E KRUJËS

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri – Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut

Data e vizitës: 26 shtator 2007

Hyrje

Si pjesë e punës së Departamentit të Ligjit për të përmirësuar standardet e të drejtave të njeriut në vendet e vuajtjes së dënimit dhe paraburgimit dhe, për të përkrahur reformën në vazhdimësi të burgjeve, në fund të shtatorit 2007 u krye një vizitë në institucionin e veçantë në Krujë.

Burgu i Krujës është një institucion i veçantë i vuajtjes së dënimit ku vendosen të burgosurit me nevoja të veçanta, me qëllim për të mbrojtur këto kategori të cilët janë veçanërisht në një pozicion vulnerabël dhe që kërkojnë më tepër kujdes. Në burgun e Krujës ndodhen të burgosur me sëmundje mendore, me aftësi të kufizuara, të moshuar dhe të burgosur me probleme të ndryshme shëndetësore. Ka gjithashtu seksione të veçanta për të burgosurit të sigurisë së zakonshme (pa nevoja të veçanta) dhe të paraburgosurit.

Qëllimi i vizitës

Vizita u fokusua në trajtimin dhe kushtet e jetesës të të burgosurve me nevoja të veçanta në mënyrë për të pasur një panoramë më të mirë të nevojave kryesore dhe përgjigjeve të mundshme të cilat mund të përdoren nga autoritetet shqiptare dhe të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Informacion i përgjithshëm

Sistemi i burgjeve në Shqipëri përballet me një situatë mbipopullimi, kushte jetese jo sanitare dhe qeli me ajrosje jo të mirë në shumicën e institucioneve të burgimit dhe të paraburgimit. Mbiipopullimi është problemi kryesor, meqë kapaciteti i përgjithshëm i burgjeve është 3609 dhe numri i të burgosurve është më tepër se 4800.²⁸ Kohët e fundit ka pasur një fluks të paraburgosurish²⁹ meqë të paraburgosurit janë transferuar të gjithë nga komisaritet e policisë në institucionet e burgjeve bazuar në një vendim të qeverisë.³⁰ Në të njëjtën kohë, për shkak të pothuajse mungesës së alternativave të dënimit me burgim, pjesa më e madhe e autorëve të veprave penale dënohen me burgim dhe dënimet e tyre janë tepër të gjata. Burgjet arritën një mbiipopullim në

28. Sipas deklaratës së Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në një konferencë më datën 25 shtator 2007.

29. Më 1 maj 2007, numri i të burgosurve dhe i të paraburgosurve ka qenë 4269. Pothuajse 600 të burgosur të rinj kanë hyrë në sistem në pesë muajt e fundit (sipas statistikave mujore të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve).

30. Në bazë të Vendimit nr. 327 të Këshillit të Ministrave, datë 15.05.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, i cili është vënë në zbatim plotësisht vetëm kohët e fundit (mesi i vitit 2007).

shifrën 133%, gjë e cila është alarmante.

Shërbimi i burgjeve në Shqipëri menaxhohet dhe administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila është një drejtori brenda Ministrisë së Drejtësisë, në varësi të së cilës ndodhen institucione të ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit. Këto institucione klasifikohen si më poshtë:

- institucione paraburgimi
- burgje të sigurisë së lartë
- burgje të zakonshme ose të sigurisë së ulët
- institucion i veçantë (në Krujë)
- spitali i burgjeve (në Tiranë)

Ende nuk ka institucion të veçantë për të miturit, por ndërtimi i një burgu në Kavajë për të mitur, me ndihmën financiare të BE-së, pritet të fillojë funksionimin së shpejti.

Autoritetet shqiptare kanë vendosur të vendosin të burgosurit të identifikuar me nevoja të veçanta në institucione të veçanta. Institucionet e veçanta janë institucione të veçanta të trajtimit mjekësor, të cilat shërbejnë kryesisht për trajtimin mjekësor të të burgosurve, veçanërisht të dënuarve me sëmundje mendore. Burgu i veçantë i Krujës është një institucion i krijuar për ekzekutimin e dënimeve me burgim për të dënuarit me nevoja të veçanta. Gjithashtu, Spitali i Burgjeve në Tiranë ka një seksion të vogël për të burgosurit me sëmundje mendore. Ka plane për hapjen vitin tjetër të një qendre paraburgimi në Durrës, i cili është krijuar për të pasur gjithashtu edhe një seksion për të dënuarit me sëmundje mendore.

Sipas Qendrës së të Drejtave të Njeriut të Universitetit të Kalifornias,³¹ shërbimet për shëndetin mendor në Shqipëri janë elementare, jo mirë të organizuara dhe të fokusuara vetëm në shtrimin në spital dhe trajtimin mjekësor pa programe të rehabilitimit social apo të parandalimit dhe, komuniteti është pak ose aspak i përfshirë. Ka vetëm 3.2 psikiatër për 100.000 banorë, dhe pothuajse asnjë punonjës psikosocial që punon në spitalet mendore (Elbasan, Tirana, Vlora dhe Shkodra).³² Për në tepër, trajnimi profesional është tepër elementar, veçanërisht në parimet dhe praktikën e bioetikës klinike dhe zbatimit të parimeve të të drejtave të njeriut në kujdesin për pacientin. Përpara vitit 2000, nuk ka pasur trajnime për kategori të tjera të profesionistëve të shëndetit mendor (psikologëve, punonjësve socialë dhe terapistëve). Po kështu, nuk ka pasur asnjë trajnim për profesionistët përpara vitit 2004 për çështje të shëndetit mendor të fëmijëve/adoleshentëve.³³

31 Raport i një vizite konsultative mbi sistemin e shëndetit mendor në Shqipëri, qershor 2000.

32 Sistemi i Shëndetit Mendor në Shqipëri, një raport i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të vlerësuar sistemin e shëndetit mendor në Shqipëri, 2006.

33 Po aty, 5.

Një strategji kombëtare për shëndetin mendor është hartuar në vitin 2003 nga Ministria e Shëndetësisë (megjithëse nuk ka asnjë departament/njësi për shëndetin mendor në nivel qendror) dhe një plan për çështjet e shëndetit mendor është miratua vetëm në vitin 2005. Zhvillimi i shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet dhe përfshirja sociale e të sëmurëve mendorë, ishte fokusi kryesor i këtyre dokumenteve. Një qendër komunitare pilote u inaugurua në Vlorë, në prill 2005. Roli i spitaleve dhe numrit të shtretërve është ulur shumë vitet e fundit, por ende 97% e burimeve të qeverisë të shpenzuara për sistemin e shëndetit mendor, i është dhënë spitaleve psikiatrike.

Shërbimet për fëmijët/adoleshentët me sëmundje mendore pothuajse nuk ekzistojnë, në një vend si Shqipëria ku më tepër se çereku i popullsisë është nën 15 vjeç. Shërbimet për të moshuarit, gratë dhe abuzuesit me substancat janë tepër të rralla dhe elementare.³⁴ Zbatimi i ligjit për shëndetin mendor, miratuar në vitin 1996, është tepër i ulët, kryesisht për shkak të një infrastrukture të papërshtatshme.³⁵ Po kështu, nuk ka asnjë studim për sëmundjet mendore dhe pasojat e tyre.

Sipas Raportit të Organizatës Botërore të Shëndetit, për Sistemin e Shëndetit Mendor në Shqipëri,³⁶ përqindja e të burgosurve me sëmundje mendore u llogarit të jetë më pak se 2% për vonesën mendore dhe 2-5% për psikozat. Të drejtat e njeriut të pacientëve me sëmundje mendore nuk respektohen dhe vërehen shkelje të rënda në institucionet e vuajtjes së dënimit ku mbahen të burgosurit me sëmundje mendore.³⁷

Fatkeqësisht, mungon koordinimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të shëndetit mendor për të lehtësuar vazhdimësinë e trajtimit për të burgosurit e liruar. Nuk ka asnjë periudhë rehabilitimi pas lirimit nga burgu dhe gjithashtu komuniteti nuk është i gatshëm të ndjekë rastet në fjalë.

Kohët e fundit,³⁸ është hartuar një Strategji Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara nga një grup ndërministror në bashkëpunim me OJF kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia thekson rëndësinë e ndërhyrjes së hershme dhe shërbimeve të rehabilitimit, i jep mundësinë shtetit të bashkëpunojë me OJF-të dhe fokusohet gjithashtu në sjelljen e shërbimeve të kujdesit në shtëpitë e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe promovon qendrat komunitare të kujdesit ditor.

34 Po aty. 4

35 Ligji nr. 8092 “Për shëndetin mendor”, datë 21.03.1996.

36 2006.

37 Po aty. 4.

38 Shtator 2006, Tiranë.

Përmbledhje e gjetjeve

Burgu i Krujës ndodhet në një vend jo shumë të përshtatshëm. Rruga kur del nga qyteti i Krujës për të shkuar në burg nuk ka asfalt, është e ngushtë dhe është tepër vështirë për të drejtuar automjetin. Duhet më tepër se gjysmë ore për të shkuar atje me makinë nga qyteti i Krujës.

Në ditën e vizitës, kishte katër grupe të burgosurish me nevoja të veçanta që mbaheshin në Burgun e Krujës:

- të sëmurë mendorë
- me aftësi fizike të kufizuara
- të moshuar
- të burgosur me probleme shëndeti (kryesisht me sëmundje të zemrës dhe të qarkullimit të gjakut)

Janë krijuar seksione të veçanta për akomodimin e secilës kategori të burgosurish me nevoja të veçanta. Përveç kësaj, në Krujë ka një seksion të sigurisë së ulët për të dënuarit e zakonshëm dhe një seksion paraburgimi. Numri i përgjithshëm i të burgosurve në Krujë në ditën e vizitës ishte 210 dhe kapaciteti ligjor i burgut është 196.

Rreth 40 të burgosur me sëmundje mendore mbahen në një seksion të veçantë, shumica prej të cilëve vuan nga skizofrenia apo forma të psikozës paranojake. Sipas ligjit për shëndetin mendor, të vitit 1996, të sëmurët mendorë duhet të trajtohen për një vit dhe më pas të rivlerësohen. Të burgosurit janë vendosur në këtë institucion të veçantë ose drejtpërdrejtë me anë të një urdhri të gjykatës ose me kërkesën e institucionit të vuajtjes së dënimit ku gjatë vuajtjes së dënimit është shfaqur sëmundja mendore.

Përveç kësaj, kishte seksione të veçanta për personat me aftësi të kufizuara fizike (gjashtë persona – katër prej të cilëve totalisht paraplegjikë), seksion për të paraburgosurit (22), të moshuar (numri nuk dihej), të burgosur me probleme shëndetësore (rreth 20 të burgosur) dhe një seksion për të burgosurit pa nevoja të veçanta (numri nuk dihej).

Gjetjet kryesore të vizitës janë si vijojnë:

- Vendndodhja e burgut e bën të vështirë zgjidhjen e problemeve të urgjencave mjekësore të cilat ndodhin shumë herë. Në një situatë të tillë, burgu duhet të presë për disa orë që ambulanca të vijë nga qyteti i Krujës. Gjithashtu, vetë burgu nuk mund të adresojë të gjitha sfidat dhe situatat e përfshira në mbikëqyrjen dhe kujdesin e të gjithë kategorive të të burgosurve me nevoja të veçanta;
- Nuk ka asnjë protokoll, politikë apo strategji të hartuar nga burgu i Krujës në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet shëndetësore që janë të disponueshme në

atë zonë. Për më tepër, nuk ka një politikë të tillë apo protokoll as në nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) për të krijuar një rrjet me shërbimet e shëndetit publik dhe shërbimet e mirëqenies sociale. Politika/protokolle të tilla në nivel qendror dhe lokal do të ishin të nevojshme për të siguruar një trajtim të mjaftueshëm, për të adresuar sjelljen e tyre kriminale dhe nevojat e tyre gjatë dhe pas periudhës së burgimit;

- Trajtimi i të burgosurve me sëmundje mendore fokusohet vetëm në dhënien e medikamenteve; duke u përpjekur kështu për të menaxhuar simptomat e sëmundjes mendore. Nuk kryhet aspak kujdes intensiv i kombinuar me mbikëqyrjen, kryesisht për shkak të mungesës së personelit profesionist psiko-social në burg dhe mungesës së trajnimit dhe njohurive të personelit të burgut për rëndësinë e saj për një rehabilitim efektiv të këtyre të burgosurish.
- Të burgosurit me sëmundje mendore janë të vendosur në një seksion krejtësisht më vete në qeli me 4-6 vetë për qeli. Ka disa të burgosur agresivë të cilët janë vendosur në qeli më vete.
- Burimet njerëzore: në burgun e Krujës janë të punësuar 36 profesionistë mjekësorë (përsirë mjekë, infermierë, farmacistë, personel për të shoqëruar të burgosurit me aftësi të kufizuara dhe personel arsimor). Çdo ditë janë të pranishëm dy mjekë gjatë ditës dhe një mjek gjatë natës. Vetëm njëri prej tyre është psikiatër. Gjithashtu, ka tri infermierë çdo ditë 24 orë. Për gjashtë personat me aftësi të kufizuar, janë pak persona për t'i shoqëruar ata. Ka vetëm një psikolog që merret me rehabilitimin social të këtyre të burgosurve. Psikologu është pjesë e sektorit të edukimit, i cili ka gjithashtu dy edukatorë dhe një shef.
- Psikiatri i viziton të 40 të burgosurit dy herë në javë. Për çdo të burgosur me nevoja të veçanta, ka një kartelë dhe mjeku çdo ditë shënon në këtë kartelë medikamentin e dhënë për çdo pacient.
- Lirimi me kusht, megjithëse lejohet nga ligji, pothuajse asnjëherë nuk aplikohet në rastet e të burgosurve me sëmundje mendore. Vetëm dy të dënuar u liruan parakohe nga viti 1997 deri në vitin 2000.³⁹ Sipas Shefit të Sektorit të Shëndetësisë të Burgut të Krujës, vetëm një i burgosur me sëmundje mendore është liruar nga 2006-2007. Ka pak gjasa që një kërkesë për lirim parakohe të pranohet nga gjykata. Ndoshta gjyqtarët janë të ndërgjegjshëm për faktin se nuk ka asnjë përgatitje për lirim, vazhdimësi të kujdesit në komunitet, përkrahje të qeverisë jepen me lirimin e tyre. Për këtë arsye, nuk ekzistojnë mundësi për lirim parakohe me kusht dhe kjo ka një ndikim negativ në rehabilitimin e të burgosurve (si në atë mjekësor ashtu edhe në atë social).
- Të gjithë të burgosurit me nevoja të veçanta lejohen të dalin jashtë qelive për katër orë në ditë. Për ajrosjen janë në dispozicion dy oborre të mëdha. Pothuajse asnjë aktivitet profesional nuk është në dispozicion për rehabilitimin e të burgosurve (arsimor, trajnim profesional, seminare). Vetëm aktivitete sportive organizohen shpeshherë nga burgu (futboll, volejboll, shah). Një numër prej 30 të burgosurish

39 Sipas Raportit të vizitës Konsultative mbi Sistemin e Shëndetit Mendor në Shqipëri, qershor 2000, e Qendrës së të Drejtave të Njeriut të Universitetit të Kalifornisë.

- lejohen të punojnë, kryesisht në kuzhinë për gatim apo për qëllime pastrimi.
- Kushtet e jetesës: mbipopullimi është një shqetësim, por jo aq i madh sa në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit. Në kohën e vizitës sonë nuk pamë ndonjë problem lidhur me ventilimin.
- Nuk ka standarde të matshme të zhvilluara për të vlerësuar rezultatet e programeve të trajtimit. Brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka një drejtori të kujdesit shëndetësor për të vlerësuar dhe mbikëqyrur trajtimin, por për këto çështje nuk ka pasur raporte. Përveç kësaj, prokurori inspekton çdo muaj burgun e veçantë, si një nga detyrimet e tij sipas ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Të burgosurit njoftohen për trajtimin, rreziqet dhe mundësitë e rehabilitimit dhe shumica prej tyre i pranon medikamentet, përveç pesë rasteve të cilët vazhdojnë të refuzojnë marrjen e medikamenteve. Personeli i burgut ofron këshilla dhe ndihmë për hartimin e ankesave. Aktualisht ka pasur një rast ankimi të një të burgosuri kundër trajtimit të tij dhe punonjësi i akuzuar u shkarkua nga puna pas hetimit të çështjes.
- Burgu i Krujës bashkëpunon me OJF-të, kryesisht me Kryqin e Kuq, për të siguruar asistencë sociale për të burgosurit dhe për të mbajtur lidhjet familjare.
- Në burgun e Krujës nuk ka të mitur me çrregullime mendore apo me nevoja të tjera të veçanta.

Rast studimor

Çështja “Dybeku kundër Shqipërisë”, çështja nr. 41153/06, 18 dhjetor 2007, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)

Kërkuesi ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht vuan dënimin me burgim në Burgun e Sigurisë së Lartë në Peqin. Nga viti 1996 dhe në vazhdim, kërkuesi ka vuajtur nga skizofrenia kronike paranojake. Për shumë vjet ai ka qenë nën trajtim mjekësor në spitale të ndryshme psikiatrike në Shqipëri.

Më 23 gusht 2002, tre persona vdiqën, përfshirë dy fëmijë të moshës 10 dhe 13, dhe të tjerë u plagosën si rezultat i shpërthimit të eksplozivëve të vendosur në apartamentin e familjes së motrës së kërkuesit.

Më 24 gusht 2002 filloi procedimi penal kundër kërkuesit, i cili, në të njëjtën ditë u arrestua dhe u akuzua për vrasje, inter alia, të fëmijëve dhe për mbajtje pa leje të eksplozivëve. Kërkuesi u vendos në një qeli paraburgimi të Komisarariatit të Policisë së Durrësit ku ai ndante qelinë me një numër të papërcaktuar personash të tjerë.

Më 27 maj 2003, bazuar në një raport mjekësor, i cili arriti në përfundimin se në kohën

e kryerjes së veprës penale, kërkuesi ishte i përgjegjshëm, Gjykata e Rrethit Durrës vendosi që ai mund të merrej si i pandehur. Gjykata e deklaroi atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Kërkuesi e apeloj vendimin por pa sukses, dhe kërkesat e tij për ekzaminime të reja mjekësore nuk u pranuan nga gjykatat si të panevojshme.

Që prej vitit 2003, kërkuesi ka qenë në tre burgje të ndryshme: Burgu nr. 302 në Tiranë, Burgu i Tepelenës dhe në burgun e Peqinit, ku ai ka ndarë qelitë me të burgosur të cilët kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe është trajtuar si i burgosur i zakonshëm, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore. Sipas autoriteteve shqiptare, meqë ishte e pamundur për t'i siguruar kërkuesit trajtimin mjekësor që ai kishte nevojë, ai u trajtua me medikamente të ngjashme me ato që i kishte dhënë mjeku i tij. Ai u shtrua në Spitalin e Burgjeve në Tiranë vetëm kur shëndeti i tij u përkeqësua nga 26 maji 2004 deri më 2 qershor 2004 dhe nga 1 dhjetori 2004 deri më 26 janar 2005.

I ati i kërkuesit dhe avokati i tij kishin dërguar disa ankesa tek autoritetet kompetente kundër administratës së spitalit të burgjeve dhe seksionit mjekësor, duke pretenduar se ata ishin treguar neglizhentë lidhur me trajtimin mjekësor dhe se shëndeti i kërkuesit ishte përkeqësuar për shkak të mungesës së trajtimit mjekësor. Kërkesat e tyre u rrëzuan. Për shkak të gjendjes mendore të kërkuesit që sa vinte e përkeqësohej, më datë 7 janar 2005 avokati i tij kërkoi që ai të lirohej apo të transferohej në një qendër mjekësore me arsyetimin se kushtet e izolimit të tij ishin të papërshtatshme, duke marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore dhe jetën e kishte në rrezik. Avokati kërkoi gjithashtu kryerjen e ekzaminimeve psikiatrike por këto kërkesa nuk u pranuan.

Kërkuesi pretendonte se kushtet në të cilat ai mbahej dhe trajtimi mjekësor që ai merrte në burg nuk ishin të përshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore. Kërkuesi u ankua pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së “Ndalimi i torturës”⁴⁰ dhe për shkelje të nenit 6 të KEDNJ “E drejta për një proces të rregullt”.

Pyetje për diskutim:

1. A mendoni se GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së? Mbajtja e këtij të burgosuri me sëmundje mendore në ambientet e burgut, a përbën trajtim çnjerëzor apo degradues?
2. Në përgjithësi, a mendoni se të burgosurit me sëmundje mendore mund të dërgohen në një burg të zakonshëm së bashku me të dënuar të tjerë të cilët janë në gjendje të mirë shëndetësore? Në çfarë rastesh dhe përse mund të vendosen ose jo me të tjerët?
3. A mendoni se të sëmurët mendorë duhet të mbahen të izoluar nga të tjerët?

40. KEDNJ - Neni 3 – Ndalimi i torturës “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.”

Përse?

4. Tashmë që gjykata mund të marrë në konsideratë alternativat e dënimit me burgim edhe për të sëmurët mendorë, si punonjës i shërbimit të provës, çfarë informacioni mund t'i jepni gjykatës për t'i dhënë asaj një garanci që një dënim i tillë do të ekzekutohet në mënyrën e duhur?

Vlerësimi i aktivitetit të shërbimit të provës

9

Migena Leskoviku dhe Lukas Pieplow

Ky kre synon të ekzaminojë çështje dhe dilema për të vlerësuar efektivitetin e shërbimit të provës në juridiksione të ndryshme. Sipas qëllimeve të publikuara të shërbimeve të ndryshme të provës, sistemet e shërbimit të provës në vendet e BE-së, mund të ndahen në katër lloje kryesore: ato shërbime prove që bazohen mbi promovimin e masave dhe sanksioneve komunitare, shërbime prove që bazohen në modelin e ndihmës që i jepet gjyqësorit; shërbime prove të bazuara mbi modelin e rehabilitimit/mbrojtjen publike, si dhe shërbime prove që bazohen mbi modelin e ndëshkimit apo të shtrëngimit. Këto lloje të ndryshme kërkojnë kritere të ndryshme për të vlerësuar efektivitetin e shërbimit të provës, por çdo kriter mbart disa rreziqe të rëndësishme, të cilat kanë nevojë për vlerësim të kujdesshëm.

Hyrje

Gjithnjë e më shumë vende të demokracive të reja kanë filluar të zhvillojnë shërbimin e provës, dhe vendet e konsoliduara prej kohësh kanë filluar gjithashtu të ristrukturojnë shërbimin e provës për t'iu përshtatur programeve të reja politike. Disa shtete synojnë të përdorin shërbimin e provës kryesisht si një mënyrë për të reduktuar numrin e të burgosurve duke zhvilluar masa dhe sanksione komunitare (p.sh., Estonia, Turqia, etj.); shtete të tjera theksojnë rolin e shërbimit të provës për të ndihmuar gjykatat në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me dënimin (p.sh., Italia, Rumania, etj.); disa shtete të tjera kanë për qëllim primar të rehabilitojnë të

dënuarit dhe të mbrojnë publikun (p.sh., Franca, Irlanda, Austria, Çekia, Danimarka, Finlanda, Hungaria, Letonia, Irlanda e Veriut, Norvegjia, Gjermania, Bullgaria, etj.); ndërsa shtete të tjera i japin prioritet dënimit në komunitet dhe zbatimit të tij, ndonjëherë bashkë me rehabilitimin (p.sh., Anglia dhe Uells). Shërbimi i provës në disa vende kontrollohet rreptësisht (Mbretëria e Bashkuar, Italia, etj.) dhe në disa vende të tjera duhet të provojë që është efektiv dhe se i përdor mirë fondet e vëna në dispozicion. Pyetja që lind është, se si do arrihet kjo gjë?

Qëllimi i këtij kreu është të eksplorojë disa nga mundësitë e shumta potenciale të vlerësimit të shërbimit të provës, si dhe të marrë në shqyrtim disa nga vështirësitë që hasen në këtë drejtim. Ka mënyra të ndryshme për të vlerësuar shërbimin e provës si dhe mënyra të ndryshme për të përkufizuar efektivitetin. Efektiviteti përkufizohet si aftësia e një programi/organizate "për të arritur rezultatet e duhura" (Canton & Hancock, 2007, fq. 112). Por cilat janë këto rezultate? Ky përkufizim mund të duket i thjeshtë, por duhet të mbajmë parasysh se shërbimi i provës në mbarë Evropën ka më shumë se një qëllim. Diskutimi i shkurtër i katër llojeve të sistemeve të shërbimit të provës të përmendur më sipër, tregon sa të ndryshme mund të jenë prioritetet e shërbimit të provës në vende të ndryshme të Evropës. Të shohim si shembull objektivat e mëparshme të shërbimit të provës në Rumani, siç tregohet në qëllimin e tij:

Shërbimi i provës në Rumani i shërben gjykatave dhe publikut duke mbikëqyrur të dënuarit në komunitet, në mënyrë që të reduktojë krimin dhe koston e tij, si dhe pasojat e burgimit të panevojshëm.

Ose qëllimi i Sistemit të Shërbimeve Korrektuese në Maltë:

Të kontribuojmë për një komunitet më të sigurt duke: ushtruar kontroll të përshtatshëm, të sigurt dhe human mbi të dënuarit; duke i stimuluar për t'u bërë produktivë, qytetarë që respektojnë ligjin; duke ndihmuar viktimat e krimit për t'u shëruar; dhe duke ndihmuar komunitetin ndërsa përballen me kushtet që kontribuojnë në krim.

Shërbimi i provës u prezantua për herë të parë në Shqipëri, në ndryshimet e fundit në Kodin Penal dhe ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i miratuar së fundmi. Në këtë ligj, shërbimi i provës përkufizohet si:

"Shërbimi i provës është organi shtetëror i cili i paraqet prokurorisë ose gjykatës informacion dhe raporte sipas këtij ligji dhe ndihmon në zbatimin e dënimeve alternative dhe të dënuarin për të kapërcyer vështirësitë për ri-integrimin social të tij".

Misioni i tij:

- Shërbimi i provës bashkëpunon me organet lokale dhe OJF-të për të mbështetur programet rehabilituese për të dënuarit dhe ofron shërbim ndërmjetësimi.
- Shërbimi i provës i ndihmon të dënuarit të kapërcejnë vështirësitë për ri-integrimin social, duke vendosur kontakte me familjen dhe mjedisin social të të dënuarit, me OJF dhe individë.

Duke parë përkufizime të tilla të misionit, kaq komplekse dhe polimorfoze – të cilat lidhen me tre llojet e para të shërbimit të provës – e vetmja mënyrë për të vlerësuar efektivitetin e shërbimit të provës është një model pluralist, i bazuar në një metodologji të sofistikuar dhe të ndjeshme (McNeill, 2000; Tournier, 2004). Edhe pse format e ndryshme të vlerësimit, të paraqitura më poshtë disi të veçuara nga njëra-tjetra, ato duhen trajtuar si të ndërthurura dhe të integruara kur zbatohen në jetën reale.

1. Shërbimi i provës, qëllimi i të cilit është të promovojë masat dhe sanksionet komunitare

Aty ku qëllimi i shërbimit të provës është të nxisë përdorimin e masave dhe sanksioneve komunitare, vlerësimi ka të bëjë me çështjen nëse shërbimi i provës, si një masë ose sanksion, përdoret shpesh apo jo. Supozimi në këtë rast është që, efektiviteti ka lidhje me ndarjen e tregut; në shumicën e rasteve rritja e zbatimit të sanksioneve komunitare pritet që të reduktojë dënimin me burgim.

Brenda kuadrit të Këshillit të Evropës (Statistikat vjetore penale), ka dy tregues për matjen e peshës që zë një masë apo sanksion i caktuar (Tournier, 2004): një *tregues i frekuencës globale* që mat raportin e sanksioneve komunitare kundrejt dënimeve me burgim; dhe një *frekuencë specifike* që mat raportin e sanksioneve komunitare kundrejt dënimeve me burgim, veçanërisht të atyre që janë më pak se një vit burgim (ku përfshihen dënimet me burgim që janë më të mundshme për t'u zëvendësuar me një masë apo sanksion komunitar). Duke përdorur këto dy tregues, raporti i dënimeve me burgim/vendimeve për vënien në provë, ilustron efektivitetin e sistemit të shërbimit të provës; një raport më i ulët ose në rënie përfaqëson një shërbim efektiv ose në përmirësim.

Megjithatë, një nga vështirësitë e hasura në këtë rast, është i ashtuquajtimi “efekti gjerues” (Mair, 1991). Le të marrim p.sh., rastin e një të mituri që është dënuar për herë të parë për një vepër penale, i cili është vënë në provë pasi është dënuar nga gjykata për vjedhjen e një biçiklete. Në shumicën e rasteve, në pjesën më të madhe të shteteve, për këtë çështje gjykata do të jepte si dënim një gjobë ose qortim/

paralajmërim. Megjithatë, kur mundësohet vënia në provë gjyqtari mund të japë një vendim të tillë për arsye të ndryshme. Në këto rrethana, në vend që të përbënte një alternativë ndaj dënimit me burgim, vënia në provë mund të ishte një alternativë kundrejt masave të tjera alternative. Për më tepër, krijohet edhe rreziku i burgimit në rast se nuk respektohen këto masa nga i dënuari. Pra, nuk mjafton vëzhgimi i numrit të masave apo sanksioneve alternative, por duhet parë edhe struktura sociale/demografike/gjyqësore e të dënuarve që janë vënë në provë. Gjithashtu, do të ishte e dobishme të shihnim të dhënat në lidhje me dënimin me burgim, për të parë nëse numri i dënimeve me burgim (dhe zbatimi i tij) ka ndryshuar pas krijimit të shërbimit të provës.

Nga kjo perspektivë, në teori shërbimi i provës mund të shihet si jo efektiv, nëse numri i të dënuarve me burgim për herë të parë, për vepra penale që lidhen me pronën/pasurinë, rritet dukshëm. Edhe pse në disa shtete shërbimi i provës është një opsion për të dënuarit me rrezikshmëri të lartë dhe, si rrjedhojë, ka më shumë mundësi të përdoret efektivisht si një masë alternative ndaj burgimit, vështirësitë metodologjike qëndrojnë.

Një kritikë tjetër ndaj kësaj përjasjeje është që, duke matur peshën që zë vendimi apo urdhri për vënien në provë të të dënuarit, ne jemi duke matur aktualisht ndryshimet në vendimmarrjen e gjykatës, për të përcaktuar sanksionin më tepër sesa efektivitetin e shërbimeve që pasojnë vendimin. Së fundi, gjykatat janë përgjegjëse për caktimin e dënimit, jo shërbimi i provës. Në këtë aspekt, Bondenson (1989) bën një dallim të dobishëm midis vlerësimit të një sanksioni dhe vlerësimit të një programi. I pari fokusohet mbi matjen e ndryshimeve midis sanksioneve të ndryshme, dhe i dyti mat efektet e një programi të caktuar.

2. Shërbimi i provës që ka për qëllim të ndihmojë sistemin gjyqësor për të marrë vendimin më të mirë

Në aspektin funksional, shumica e aktiviteteve të shërbimit të provës, fokusi i së cilave është të ndihmojnë vendimmarrjen gjyqësore, kanë për qëllim të sigurojnë informacion për prokurorët ose gjyqtarët; të përgatisin raporte për lirimin me kusht, raporte para ose pas dhënies së dënimit, etj. Në këtë lloj sistemi, kriteret kryesore në matjen e efektivitetit të shërbimit të provës janë ato të lidhura me dy agjencitë e drejtësisë penale: raporti “konvertim”, “marrëveshje” ose “konfirmim” (që do të thotë, pjesa e dënimeve të sugjeruara nga raportimi i shërbimit të provës), efektiviteti i prokurorëve/gjyqtarëve, cilësia e raporteve të paraqitura në gjykatë, shpejtësia e paraqitjes së raporteve, etj.

Në këtë rast, klientët e shërbimit të provës janë aktorët ligjorë të përfshirë dhe si

rrjedhojë, nëse prokurorët dhe gjyqtarët janë të kënaqur me shërbimin e provës, atëherë ky shërbim është efektiv. Megjithatë, kriteret vlerësuese të përmendura më sipër duhen parë të ndërlidhura mes tyre. Një kriter i vetëm mund të jetë çorientues. Për shembull, konsideroni normën e konfirmimit. Duke përdorur këtë matës, disa shërbime mund të ishin të kënaqur nëse konstatohet se norma e konfirmimit është rreth 90%. Por nga një vëzhgim më i hollësishëm, mund të vihet re që disa punonjës të shërbimit të provës i përgatisin konkluzionet e raporteve të tyre në bazë të atyre që ata parashikojnë në lidhje me qëndrimin e gjyqtarit të çështjes përkatëse. Ky fenomen quhet *efekti paraprak* (ose “*hamendësimi*”). Si rrjedhojë, ata e rekomandojnë vënien në provë në ato raste kur hamendësojnë se cili do të jetë rezultati i mundshëm; apo kur njohin qëndrimin e gjyqtarit në lidhje me këtë lloj rasti. Ndërsa hamendësimi i vendimit të gjyqtarit mund të sigurojë një normë të mirë konfirmimi, është për t’u diskutuar nëse kjo përbën një shërbim efektiv. A është ky aktivitet i dobishëm për gjykatën? A e ndihmon të dënuarin apo komunitetin?

3. Shërbimi i provës që ka në fokus rehabilitimin e të dënuarit/mbrojtjen e komunitetit

Shërbimet e fokusuara në rehabilitimin dhe/ose mbrojtjen e komunitetit janë ndoshta më të përhapurat në Evropë, por këto shërbime po kontrollohen rreptësisht dhe po kritikohen. Ashtu si aktiviteti i këtyre shërbimeve dikur vlerësohej nga ata që dolën në konkluzionin se “asgjë nuk funksionon”, dhe më pas nga ata që nxorën përfundimin se “diçka funksionon”, kohët e fundit ka lindur pyetja “çfarë funksionon?”.

Qëllimi i qartë i këtyre shërbimeve është të mbështesë të dënuarit të jetojnë një jetë larg krimit dhe, në këtë mënyrë, reduktohet recidivizmi dhe krijohet një komunitet më i sigurt. Për të përmbushur këtë qëllim këto shërbime kryejnë aktivitete rreth shkaqeve të krimit: probleme në marrëdhëniet mes individëve, mungesa e një pune apo strehimit, sjellje apo qëndrime kriminale, abuzimi me alkoolin/drogën, mangësi të aftësive personale, etj. Supozimi bazë i kësaj metode është se, vetëm pasi i trajtojmë këto nevoja kriminogjene, reduktojmë mundësinë e recidivizmit. Për këtë arsye, efektiviteti i shërbimit të provës vlerësohet në dy nivele: rezultatet e ndërmjetme dhe niveli i recidivizmit.

Treguesit e ndërmjetëm si fillim u njohën si tregues të efektivitetit kur, Sër Leon Radzinowicz (1958), përdori zbatimin me sukses të vendimit të gjykatës, si një tregues të tillë. Këta tregues të ndërmjetëm përfaqësojnë hapat e ndërmarra nga i dënuari në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të dëshirueshme, si p.sh.: testet paraprake dhe pasuese, që matin ndryshimet në qëndrim apo njohuri, ndryshimet në rrethanat sociale të klientit, stabilitet ose kënaqësi më të madhe në punë, etj. (Priestley et al., 1984).

Gjetja e shembujve, vlefshmëria dhe niveli i ndikimit e bëjnë këtë metodë vlerësimi shumë të vështirë për t'u zbatuar në praktikë nga jo-specialistët. Për më tepër, kjo metodë nuk duhet përdorur më vete, por si pjesë e një forme shumë-modelëshe vlerësimi, që përfshin edhe masat cilësore dhe sasiore (Merrington and Stanley, 2007).

Kur flasim për rezultatet e ndërmjetme, duhet të tregojmë kujdes në lidhje me llojin e masave të përfshira. Për shembull, shumica e shembujve të sipërpërmendur, janë marrë nga “ modeli i sjelljes njohëse të ndërhyrjes”. Një masë alternative ose një model plotësues për ndërhyrjen e shërbimit të provës, mund të jetë i ashtuquajtur “ modeli i shmangies”.

Pra, roli i shërbimit të provës duhet të jetë i lidhur si me rritjen e “ kapitalit social” dhe mundësitë e të ardhmes, ashtu dhe me zhvillimin e aftësive individuale ose “ kapitalin njerëzor” (McNeill, 2003, fq. 159).

Farrall dhe Maruna (McNeill, 2006) e përkufizojnë shmangien primare nga rruga e krimin, si një rënie apo boshllëk të aktivitetit kriminal, dhe shmangien dytësore, si një ndryshim në vetë-imazhin e një ish të dënuari i cili kthehet nga një kriminel, në një imazh të një qytetari që respekton ligjin. Roli i vetë-identitetit theksohet më tej nga Maruna (2001), i cili argumenton se për të mbështetur të dënuarin të vazhdojë këtë shmangie, punonjësi i shërbimit të provës duhet të mbështesë klientin të rikonstruktojë në mënyrë simbolike imazhin e tij si një person jo-kriminel. Siç mund të shohim, *modeli i shmangies* siguron më tepër rezultate të ndërmjetme, të reja dhe të mundshme për t'u arritur, si p.sh., kënaqësi në punë dhe në martesë, lidhje sociale, vetë-identitet, etj.

Një tjetër gjetje e rëndësishme në lidhje me efektivitetin e shërbimit të provës, vjen nga vëzhgimi – theksohet gjithashtu edhe në modelin e shmangies – se ajo që duket si më efektive, është ndihma praktike që marrin klientët për të zgjidhur problemet e tyre: punësim, strehim, etj. Punësimi dhe strehimi janë rezultate shumë të ndërmjetme të rëndësishme të punës që bën shërbimi i provës. Por punësimi dhe strehimi, rrallë janë burime që janë direkt të aksesueshme nga shërbimi i provës. Ato sigurohen ose nga tregu i lirë, ose nga autoritetet qendrore/vendore. Ajo që mund të bëjë shërbimi i provës është që të përgatisë klientët për të gjetur punë dhe strehim, dhe pastaj t'i lidhë ata me burimet ekzistuese. Në këtë rast, shërbimi i provës është përgjegjës për procesin e përgatitjes dhe lidhjes së klientëve me burimet, por jo për rezultatet. Përveç përgatitjes dhe informimit për të gjetur punë, ka edhe aspekte të tjera praktike që mund ta pengojnë klientin të gjejë punë: mungesa e një pune të përshtatshme, mungesa e një politike aktive në lidhje me punësimin e njerëzve të përjashtuar nga shoqëria, stigma sociale që u është ngjitur ish të dënuarve, etj. Meqë vetëm një pjesë

e vogël e procesit të punësimit lidhet me ndikimin e personelit të shërbimit të provës, atëherë si mund të vlerësohet efektiviteti i shërbimit të provës në këtë aspekt?

Një kontekst më i gjerë politik i këtyre pyetjeve, është veçanërisht i dukshëm në vendet në tranzicion (Rumania, Bullgaria, Shqipëria, etj.) ku grupet e tilla të cenueshme si p.sh., të dënuarit, kanë më shumë mundësi që të përjashtohen nga shoqëria. Për shembull, Rumania ka një popullsi prej 21.6 milion banorësh me 45.1% të popullsisë që jeton në zonat rurale (Vjetari statistikor në Rumani, 2006). Norma e papunësisë për vitin 2005 ishte 5.9% dhe Komisioni Kombëtar për Prognozën e vlerësoi pagën mesatare në vitin 2008 të barabartë me 470 Euro (<http://www.bloombiz.ro/business>). Edhe pse norma e papunësisë nuk është shumë e lartë, të ardhurat nga puna janë shumë të ulta. Në vitin 2005, numri i përgjithshëm i të dënuarve ishte 65,682. Numri më i madh i të dënuarve i përkiste kategorisë së veprave penale kundër pasurisë dhe pronës (44.2%) (Administrata Kombëtare e Burgjeve, e pabotuar).

Përveç rezultateve të ndërmjetme, norma e recidivizmit është masa më e përdorshme matëse e rezultateve, apo treguesi i performancës për pjesën më të madhe të shteteve. Megjithatë, shembulli klasik i keqpërdorimit të këtij treguesi është krahasimi midis normës së recidivizmit të dhënë nga burgjet dhe nga shërbimi i provës. Për shumë vite, shërbimi i provës është lavdëruar për nivelin e ulët të recidivizmit në krahasim me burgjet, pa marrë parasysh karakteristikat e popullsisë së synuar specifike për secilën nga këto dy masa.

A është e mundur të krahasohen normat e recidivizmit të gjeneruara nga këto dy masa në mungesë të një instrumenti të vlefshëm për vlerësimin e rrezikut? Është e dukshme në gjithë Evropën që, për të dënuarit në burgje, rreziku i recidivizmit është më i lartë. Gjithsesi, në sistemin e shërbimit të provës, rreziku i recidivizmit është më i ulët. Nga ky këndvështrim, kuptohet se përse norma e recidivizmit e sistemit të burgjeve është më e lartë se ajo e gjeneruar nga shërbimi i provës. Një mënyrë pothuajse efektive e përdorimit të këtij treguesi, do të ishte të krahasohej norma standarde e recidivizmit për secilin grup klientësh me normën aktuale të përfutur pas ndërhyrjes së agjencisë. Por kjo mënyrë mund të zbatohet vetëm në shumë pak shtete ku ekzistojnë instrumente të vlefshme vlerësuese të rrezikut (në Angli dhe Uells; në Bullgari, në Republikën Çeke, në Irlandë dhe Skoci, etj.). Në shumicën e vendeve evropiane këto instrumente ende nuk ekzistojnë.

Në mënyrë më të përgjithshme, shumë studiues e kanë kritikuar përdorimin e normave të ri-dënimit si tregues të rezultateve. Lloyd dhe të tjerë, përpiluan një listë problemesh të lidhura me përdorimin e normave të recidivizmit për të matur efektivitetin, duke sugjeruar që ato:

- Nuk llogarisin të gjithë qëllimet e dënimit,

- Shpesh nuk kanë një përkufizim të vetë e të qartë të recidivizmit (për sa kohë që ato masin më tepër ri-dënimin sesa recidivizmin), dhe
- Nuk i adresojnë çështjet për një periudhe të saktë pasuese.

Tournier (2004) i shton kësaj liste pyetjesh duke lënë mënjane recidivizmin, si një tregues të efektivitetit: “çfarë periudhe kohore merret parasysh për sa i përket ‘recidivizmit’ dhe për pasojë në lidhje me dështimin? Një dënim apo një shkallë e caktuar e rrezikshmërisë? Një lloj vepre penale e caktuar?” (fq. 24).

Një kritikë tjetër e rëndësishme është se kur shërbimi i provës vlerësohet sipas normës së recidivizmit, shpesh herë neglizhohet “cilësia” ose lloji i recidivizmit. Për shembull, një gjë është të kryesh përsëri një vepër penale brenda tre muajsh dhe tjetër gjë ta përsëritësh atë brenda tre vjetësh. Për më tepër, është ndryshe të ri-dënohesh për një krim të dhunshëm dhe ndryshe të ri-dënohesh për vepra penale që lidhen me pronën. Pra, edhe kur përdoret ky rezultat si matës i vlerësimit të efektivitetit, disa aspekte duhen parë më në detaje si p.sh., intervale më të gjata midis kryerjes së veprave të reja penale, vepra penale më pak të rrezikshme, llojit të krimit, etj. Për këto arsye, kur përdoret ky tregues si matës i efektivitetit të shërbimit të provës, do të ishte e këshillueshme që recidivizmi të shihej më gjerësisht dhe të kombinohej ky tregues me masat e rezultateve të ndërmjetme. Vlerësimi i efektivitetit të shërbimit të provës duhet të përfshijë një vlerësim objektiv të masës deri ku përdorimi i tyre:

- përpulhet me pritjet e ligjvënësve, autoriteteve gjyqësore, autoriteteve vendimmarrëse, autoriteteve zbatuese dhe komunitetit në lidhje me qëllimet e sanksioneve dhe masave komunitare;

- kontribuon në reduktimin e normës së dënimeve me burgim;
- mundëson përmbushjen e nevojave të të dënuarve;
- është efektiv në lidhje me koston;
- kontribuon në reduktimin e krimit në komunitet.

4. Shërbimi i provës i bazuar në zbatimin e modelit të ndëshkimit në komunitet

Zhvillimet pozitive në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në zbatimin e sanksioneve dhe masave komunitare, tregojnë se më shumë vëmendje u kushtohet masave alternative sesa vetë burgimit.

Sipas Ligjit për Drejtësinë Penale dhe Shërbimet e Gjykatës, i vitit 2000 (Ministria e Brendshme – Mbretëria e Bashkuar, 2000) një nga qëllimet e përmendura qartë për Shërbimin Kombëtar të Provës në Angli dhe Uells është “*ndëshkimi i përshatshëm*

i të dënuarve në komunitet”.

Ky është i vetmi shtet evropian me një mesazh kaq të qartë mbi dënimin. Por *“ndëshkimi i përshtatshëm i të dënuarve në komunitet”* nuk është synimi i vetëm i Shërbimit Kombëtar të Provës në Mbretërinë e Bashkuar. Objektiva të tjera janë: *“mbrojtja e publikut”, “reduktimi i recidivizmit”, “ndërgjegjësimi i të dënuarve mbi ndikimin e krimit te viktimat dhe publiku”* dhe *“rehabilitimi i të dënuarve”*. Disa nga këto objektiva duken sikur janë në konflikt me njëra-tjetrën. Një shembull i këtij konflikti ka lidhje të drejtpërdrejtë me matjen e efektivitetit – është për t’u debatuar nëse burgosja e të dënuarve ndihmon në rehabilitimin e tyre. Atëherë, cili është një shërbim efektiv, burgosja e të dënuarve që nuk respektojnë rregullat e caktuara për ta apo ai që merr kohë për të gjetur një mundësi sesi të respektohen këto rregulla?

Në sistemet e dënimit, matja e kënaqësisë së të dënuarve është një tregues më pak domethënës i efektivitetit. Çështja kryesore këtu është të sigurohemi që të dënuarit “të ndihen” të ndëshkuar. Për më tepër, jo vetëm i dënuari duhet të ndihet i ndëshkuar, por edhe shoqëria duhet të bindet për faktin që të dënuarit marrin atë që meritojnë. Si rrjedhojë, kënaqësia e të dënuarit si një masë e efektivitetit duhet zëvendësuar me kënaqësinë e shoqërisë.

Përveç objektivave në lidhje me të dënuarit, shërbimi i provës ka edhe synime në lidhje me viktimat (Turqi, Rumani). Shërbimi i provës në këto vende pritet jo vetëm të marrë parasysh pikëpamjen e viktimës apo ta ndihmojë atë në programet e ndërmjetësimit (si p.sh., në Republikën Çeke apo Sllovaki), por t’u ofrojë shërbime të drejtpërdrejta me qëllim që të lehtësojë pasojat e veprës penale (këshillim, mbështetje gjatë procesit gjyqësor, etj.). Në këto raste, vlerësimi i efektivitetit duhet të përfshijë edhe kriteret në lidhje me këtë grup të synuar. Këta tregues mund të jenë: numri i viktimave të ndihmuara, numri i shërbimeve të siguruar, kënaqësia e viktimave, etj.

Duhet theksuar që në shërbimin e provës është për t’u konsideruar edhe perspektiva e viktimës. Në Shqipëri, detyra e shërbimit të provës do të zgjerohet edhe me ndërmjetësimin viktimë-autor i veprës penale, meqë tashmë kemi një model pozitiv për të ndjekur. Ndërmjetësimi duhet përdorur në rastin e krimeve jo të rënda me qëllim për të kënaqur viktimën e një veprë penale nga njëra anë, dhe për të shmangur procedimin penal ose për të reduktuar sanksionet nga ana tjetër.

Shërbimi komunitar kryhet jashtë burgut, pavarësisht se konsiderohet ndëshkim. Por në të njëjtën kohë, mund të shihet si një lloj riparimi i dëmit të shkaktuar nga autori i veprës penale. Në përdorimin e shërbimit komunitar duhet mbajtur parasysh nevoja për ta kombinuar këtë shërbim me garanci kundër rrezikut të shkeljes së të drejtave themelore të të dënuarit i cili u nënshtrohet këtyre sanksioneve apo masave.

Edhe pse këto tregues janë të drejtpërdrejtë, mund të lindë pyetja sesi mund të sigurohemi që shërbimi i provës përfaqëson vërtet interesat e viktimës. Cila është një shifër e arsyeshme e numrit të viktimave të ndihmuara, meqë ky shërbim nuk mund të imponohet dhe njëkohësisht varet nga kërkesa e viktimës për ndihmë?

Është për t'u theksuar edhe mbledhja e të dhënave. Duhet supozuar se këto të dhëna, që lidhen gjithashtu me ndihmën që jep shërbimi i provës, shpesh kërkohen për raporte që paraqiten në parlament, për masat që japin organet administrative gjyqësore si dhe për interesin e publikut.

Të dhënat e mbledhura personalisht ose nga shkencëtarë ekspertë, përdorin burimet financiare dhe njerëzore, dhe shpesh nuk mund të mbledhen brenda një kohe të shkurtër.

Dy janë fushat ku të dhënat duhen mbledhur në mënyrë statistikore:

- a) Numri i punonjësve të shërbimit të provës (të caktuar, ndarja sipas njësive të rrethit, vendet vakante) dhe numri i klientëve të vënë në provë, për të cilët ata janë përgjegjës. Këto të dhëna janë të rëndësishme për kundërshtimet në lidhje me rishpërndarjen e tyre, nëse kërkohet kjo gjë, dhe për të justifikuar faturat buxhetore.
- b) Për secilin të dënuar të vënë në provë: të dhëna mbi veprën penale të kryer, dënime të mëparshme, moshën, gjininë, datën e caktimit nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës, datën dhe arsyen e ndërprerjes së mbikëqyrjes, d.m.th., suksesin (vënien në provë) ose dështimin (revokimin).

Këto të dhëna na japin një pikëpamje të qartë të efektivitetit të shërbimit të provës dhe të grupeve të dënuarve të vënë në provë, për të cilët duhen vendosur masa të veçanta ligjore apo sociale. Bashkëpunimi brenda shërbimit është i rëndësishëm për zhvillimin e një skeme grumbullimi të dhënash si dhe për një program zhvillimi.

Shpresojmë që ky trajtim, në lidhje me eksplorimin e çështjeve të trajtuara më sipër, të ketë hedhur dritë mbi kompleksitetin në zhvillim apo vlerësimin e shërbimit të provës në Evropë. Qëllimi i autorëve është të tregojnë që edhe pse shërbimi i provës ndryshon në vende të ndryshme në varësi të qëllimeve që ndjek dhe strukturës që adopton, ai përballlet me një sfidë të përbashkët në lidhje me gjetjen e një zgjidhjeje për kryerjen e vlerësimit; si dhe has rreziqe dhe dilema të ngjashme në këtë drejtim.

Pyetje për diskutim

1. Si mund ta vlerësoni efektivitetin e sistemit të shërbimit të provës në Shqipëri?
2. Cilët janë treguesit që shihni si instrumente të përshtatshëm për matjen e efektivitetit (veçanërisht në fazën e parë të zbatimit të shërbimit të provës)

në Shqipëri?

3. Cili mendoni se do të ishte ndikimi praktik i shërbimit të provës në Shqipëri ndaj përjasjes së rehabilitimit të të dënuarve? Po rritja e numrit të masave dhe sanksioneve komunitare?
4. Cili është implikimi i mbledhjes së të dhënave nga pikëpamja e efektivitetit të shërbimit të provës? Çfarë mund të bëhet në Shqipëri në këtë aspekt?
5. Si ka ndryshuar norma e recidivizmit midis të burgosurve të liruar dhe atyre nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës?

Referencat

Aertsen, Ivo., Mackey, Robert., Pelikan, Christa., Willemsens, Jolien., Wright, Martin., (2004) *Rebuilding Community Connections – Mediation and Restorative Justice in Europe*, Council of Europe Publishing

Basic Principles of United Nations on the Use of Restorative Justice. Programmes in Criminal Matters, 2002

Benson, J. (2001) *Working More Creatively with Groups*, 2nd ed. London: Routledge
Blumstein, A. “*Criminal Carriers and Career Criminals*”, Washington D.C: National Academy Press, 1986

Bondenson, U.V. (1989). *Prisoners in Prison Societies*. Transaction Publishers. New Brunswick and New Jersey

Canton, R. , Hancock, D. (2007) *Dictionary of Probation and Offender Management*, Cullompton: Willan

Cartledge (1995) in: Harris, R. et al *Probation Round the World*,
Coles, B. (1995) *Youth and Social Policy*, London: UCL Press

Chapman, T. & Hough, M. (1998) *Evidence Based Practice – a Guide for Practitioners*. London: Home Office

Christie, Nils. (1977), *Conflict as Property*, British Journal of Criminology, 17 (1)

Conklin, J. “*Criminology*”, Tufts University, USA, 1995

Elezi, Ismet. (2004), *Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale (Mediation in Penal Case Reconciliation)*

Haines, K. (2000), *Referral Orders and the New Youth Justice*, in: Goldson, B. (ed) *The New Youth Justice*, Lyme Regis: Russell House Publishing

Haines, K. Jones, R. & Isles, E. (1999) *Promoting Positive Behaviour in Schools*, Raport i paraqitur Zyrës për Kërkime dhe Zhvillim në Uells

Halili, R. “*Kriminologjia*”, Universiteti i Prishtinës, 2003

Hareide, Dag., (2006) *Conflict Mediation – A Nordic Perspective*

Home Office (1991) *Organising Supervision & Punishment in the Community*,

London: Home Office

Hope, M. & Chapman, T. (1998) *Evidence Based Practice: A Guide to Effective Practice*, London: Home Office

<http://www.bloombiz.ro/business>

Israel, M., Chui, W.H. (2006). *If "Something Works" is the Answer, What is the Question?* In "European Journal of Criminology", vol. 3 (2): 181-200. Sage Publications

Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut: www.echr.coe.int

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, shtator 2005

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, prill 2007

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Law on Mediation in Dispute Resolution, 26 June 2003

Lösel, F. (2008), *Doing evaluation research in criminology: balancing scientific and practical demands*, in Kig, R.D., Wincup, E. (eds) *Doing Research on Crime and Justice*. Oxford: Oxford University Press

Mair, G. (1991), *What works – nothing or everything ? Measuring the effectiveness of sentences*, Home Office Research Bulletin, 30, 3-8, London: HMSO

McGuire, J. (2000) *Cognitive Behavioural Approaches*. London: Home Office

McGuire, J. (2000) *Cognitive Behavioural Approaches: An Introduction to Theory and Research*, London: Home Office

McNeil, F. (2006). *A desistance paradigm for offender management*. In *Criminology & Criminal Justice*. Vol. 6(1): 39-62. Sage Publications

McNeill, F. (2000) "Defining Effective Probation: Frontline Perspectives" in *The Howard Journal*, Vol. 39, No. 4, pp 382-397

McNeill, F. (2003) "Desistance-focused probation practice" in Chui, W.H. and Nellis, M. (eds) *Moving Probation Forward*, Harlow: Pearson 's Longman

McWilliams, W. (1983) *The Mission to the English Police Courts 1876-1936*, *The Howard Journal*, Vol. 22

McWilliams, W. (1985) *The Mission Transformed*, *The Howard Journal*, Vol. 24

Mehlbye, J. & Walgrave, L. (1998) *Confronting Youth in Europe*, Copenhagen: AKF

Mehlbye, J. & Sommer, B. (1989) "Denmark", in : Mehlbye, J. & Walgrave, L. (1998) *Confronting Youth in Europe*, Copenhagen: AKF

Merrington, S., Stanley, S. (2007) "Effectiveness: who counts what?" in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) *Handbook of Probation*. Cullompton: Willan

Miller, W. & Rollnick, S. 2002, *Motivational Interviewing: Preparing People for Change*. 2nd edn. London: Guildford Press

Milner, J. & O'Byrne, P. (2002) *Assessment in Social Work*. 2nd edn. Basingstoke: Palgrave

Ministry of Justice of Romania (2008). *Statistical Bulletin (internal paper)*

Porporino, F (2007) "The Basics of Motivational Interviewing". Lecture to University of Wales, Newport, Gregynog, Powys. June 2007

Priestley, P & McGuire, J (1983) *Learning to Help*. London: Tavistock

Priestley, P., McGuire, J., Flegg, D., Hemsley, V., Welham, D., Barnitt, R. (1984). *Social Skills in Prison and the Community. Problem Solving for Offenders*. Rotledge and Kegan Paul. London and Boston

Prochaska, J. & Diclemente, C. (1983). "Stages dhe Processes of Self-Change of Smoking: Toward an Integrative Model of Change". *Journal of Consulting dhe Clinical Psychology*, 51, 390-395

Radzinowicz, L. (ed.) (1958) *The Results of Probation*, English Studies in Criminal Science. Macmillan. London

Raynor, P (2006) "The 'What Works' Experiment in England dhe Wales: Achievements dhe Lessons to be Learned". Lecture to University of Wales, Newport, Gregynog, Powys. June 2006

Recommendation No. R 99(19) of the Committee of Ministers of the Council of Europe to Member States concerning Mediation in Penal Matters, 15 November 1999

Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Rregullat Evropiane për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave

Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare

Rekomandimi Nr. R (99) 22, i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje (dhe Shtojca e këtij rekomandimi)

Rhys, M.T. (2001) *Reports of Serious Incidents 1995-2000*. London Probation Area. London Action Trust

Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimi Nr. R 87 (3) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur ("Rregullat e Pekinit")

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios)

Smale, G. (2000) *Social Work dhe Social Problems: Working Towards Social Inclusion and Social Change*. London: MacMillan

Thorpe, D. et al (1980) *Out of Care*, London: George Allen and Unwin

Tournier, P.V. (2004). *Aspects of good practice in the criminal justice system. In Crime Policy in Europe*. Council of Europe Publishing.

Tuckman, B. (1965) "Developmental Sequence in Small Groups". Psychological Bulletin, Vol. 63, No.6, pp. 384-399

UNICRI (1998) *Handbook on Probation Services*, Rome-London

Van Kalmthout, A. & Derks, J. (2000) *Probation and Probation Services: A European Perspective*, Utrecht: CEP

Vinding, S. (2000) 'Denmark', in: Van Kalmthout, A. & Derks, J. (2000) *Probation and Probation Services: A European Perspective*, Utrecht: CEP

Vjetari Statistikor, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë (për vitet 2003-2007)

Waggrave, Lode. RJ and beyond – an Agenda for Europe, Paper presentation at the Conference of the European Forum for RJ, Barcelona, Spain 15-17 June 2006

Wright, Martin. (1996), *Justice for victims and offenders: A Restorative Response to crime*, Winchester, Watergate Press, 2nd edition

Zehr, Howard. (2002) *The Little Book of Restorative Justice*

Shtojca 1

LIGJ
Nr.10 494, datë 22.12.2011

PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË CILËVE U KUFIZOHET LËVIZJA ME VENDIM GJYQËSOR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, në funksion të kontrollit të zbatimit të urdhërimeve që përmban një vendim gjyqësor, që cakton një nga alternativat e dënimit me burgim, dënim plotësues, një nga llojet e masave shtrënguese, apo një urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rritja e sigurisë publike dhe garantimi i ekzekutimit efektiv të vendimeve gjyqësore.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Mbikëqyrje elektronike ose ME” është mekanizmi që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

b) “Organi që realizon ME-në” është personi juridik, publik ose privat, që realizon ME-në, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

c) “Pajisje” është mjeti elektronik i vendosur në trupin e subjektit dhe që mundëson përcaktimin në kohë reale të vendndodhjes së tij.

ç) “Person i afërt” është personi që ka lidhje të afërta familjare deri në shkallë të

tretë me subjektin dhe/ose jeton në të njëjtën banesë me të.

d) “Sallë operative” është zyra e krijuar nga organi që realizon ME-në për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave që vijnë nga pajisja dhe që mundëson kontrollin e zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor nga subjekti.

dh) “Subjekt” është personi i vendosur nën ME, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

e) “Viktimë” është personi, ndaj të cilit është ushtruar dhunë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave, ndaj të cilëve, me vendim gjyqësor, është:

a) vendosur një nga masat shtrënguese, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c” dhe “d” të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale;

b) vendosur një nga alternativat e dënimit me burgim, të parashikuara nga nenet 58, 59, 59/a dhe 64 të Kodit Penal;

c) vendosur dënimi plotësues i përcaktuar në paragrafin e shtatë të nenit 30 të Kodit Penal;

ç) lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 5

Parimet e ME-së

Veprimtaria e organeve të ME-së bazohet në parimin e:

a) ligjshmërisë;

b) mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike;

c) garantimit të lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës;

ç) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, dinjitetit njerëzor dhe sigurisë personale të subjektit të ligjit;

d) mosdiskriminimit;

dh) proporcionalitetit të ME-së me rrethanat e rastit dhe personalitetin e subjektit;

e) objektivitetit dhe efektivitetit.

KREU II

PËRDORIMI I ME-SË

Neni 6

Nisma për përdorimin e ME-së

Gjykata vendos përdorimin e ME-së, kryesisht ose me kërkesën e prokurorit, subjektit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të të miturit.

Neni 7

Pëlqimi i subjektit

1. Gjykata, përpara caktimit të masave shtrënguese, shpalljes së vendimit përfundimtar të gjykatës, apo lëshimit të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, pyet subjektin nëse jep pëlqimin për përdorimin e ME-së dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj.

2. Përdorimi i ME-së vendoset vetëm me pëlqimin e subjektit dhe pasi gjykata sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i ME-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

3. Pëlqimi i subjektit për përdorimin e ME-së jepet me shkrim ose nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore. Në rastin e subjekteve të mitura, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.

4. Nëse subjekti nuk jep pëlqimin, sipas pikës 3 të këtij neni, gjykata nuk mund të urdhërojë përdorimin e ME-së, por ky fakt mbahet në konsideratë prej saj, së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, në përcaktimin e masës shtrënguese apo dënimit.

5. Përjashtimisht, gjykata mund të vendosë përdorimin e ME-së, edhe pa pëlqimin e subjektit, në rastin e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 4 të këtij ligji, nëse vlerëson se është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të të tretëve dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se subjekti paraqet rrezikshmëri për cenimin e këtyre të drejtave. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, vetëm nëpërmjet ankimit të vendimit gjyqësor që lëshon urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 8

Caktimi i personit të afërt

Kur është e mundur, subjekti përcakton edhe një person të tij të afërt, i cili ndihmon në zbatimin e vendimit për përdorimin e ME-së. Nëse jep pëlqimin të caktohet si i tillë, personi i afërt ka detyrimin të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon ME-në adresën e tij të saktë dhe numra telefoni kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë.

Neni 9

Vendimi për përdorimin e ME-së

1. Përdorimi i ME-së urdhërohet nga gjykata në vendimin gjyqësor të dhënë ndaj subjekteve, në rastet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Gjykata, gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit, në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 4 të këtij ligji, i kërkon Shërbimit të Provës një raport vlerësimi për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të ME-së.

3. Përdorimi i ME-së mund të jetë me ose pa afat. Nëse gjykata nuk ka përcaktuar afat, kohëzgjatja e përdorimit të ME-së është e barabartë me kohëzgjatjen e masës shtrënguese, alternativës së dënimit me burgim, urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

Neni 10

Përmbajtja e vendimit

Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e ME-së, përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, duhet të përmbajë, sipas rastit, edhe:

- a) dhënien e pëlqimit nga subjekti, kur këtë e kërkon ligji, dhe/ose prindërit apo kujdestari i të miturit, për përdorimin e ME-së;
- b) zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së subjektit;
- c) detyrimin e subjektit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zona të ndaluara;
- ç) kohën e përdorimit të ME-së, nëse gjykata urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.

KREU III

REALIZIMI I ME-SË

Neni 11

Organi që realizon ME-në

1. Organi që realizon ME-në është përgjegjës për vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes. Vendi, koha dhe rregullat për vendosjen dhe heqjen e pajisjes përcaktohen në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të nxjerrë nga prokurori ose gjykata, të cilët ia njoftojnë menjëherë subjektin dhe organin që realizon ME-në.

2. Organi që realizon ME-në, nëpërmjet sallës operative të ngritur prej tij, mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat që vijnë nga pajisja.

3. Kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon ME-në, rregullat për përzgjedhjen e tij, si dhe të drejtat e detyrimet e tij caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Shërbimi i Provës

1. Shërbimi i Provës është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të ME-së.

2. Shërbimi i Provës, në mënyrë periodike, informon Ministrinë e Drejtësisë për kontrollet e ushtruara për mënyrën e realizimit të ME-së.

3. Shërbimi i Provës vendos, çdo javë, në dispozicion të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit, të dhëna të përditësuara për numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim dhe mundësinë teknike të realizimit të ME-së.

4. Metodologjia dhe rregullat e ushtrimit të kontrolleve të Shërbimit të Provës për mënyrën e realizimit të ME-së, periodicitetit dhe përmbajtja e informacionit të përcjellë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rregullat për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë

gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 13

Pajisja për realizimin e ME-së

1. ME-ja realizohet nëpërmjet vendosjes së një pajisjeje të posaçme në trupin e subjektit, e cila duhet:

a) të ketë përmasa të vogla, në mënyrë që të mbulohet lehtësisht nga veshjet dhe të mos shikohet nga të tretët;

b) të mos lëshojë tinguj ose dritë;

c) të përbëhet nga materiale të parrezikshme për jetën dhe shëndetin e subjektit dhe të të tretëve;

ç) të vendoset në një pjesë të trupit që e bën të pamundur shikimin e saj nga të tretët;

d) të lejojë subjektin të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimtaritë e tij të zakonshme.

2. Pajisja duhet të plotësojë karakteristikat teknike të mëposhtme:

a) të jetë në gjendje të transmetojë sinjal nga çdo pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) të ketë rezistencë të lartë ndaj elementeve natyrore, e cila mundëson funksionimin normal edhe gjatë ekspozimit ndaj tyre;

c) të jetë e vështirë për t'u hequr;

ç) të transmetojë sinjal të posaçëm nëse dëmtohet ose hiqet.

Neni 14

Salla operative

1. Informacioni i siguruar nga pajisja i transmetohet drejtpërdrejt sallës operative, e cila funksionon pa ndërprerje.

2. Salla operative duhet të ketë aftësinë teknike të marrë në kohë reale informacionin për vendndodhjen e subjekteve që ndodhen brenda territorit ku ushtron kompetencën organi që realizon ME-në.

3. Organi që realizon ME-në siguron funksionimin pa ndërprerje të sallës operative dhe lidhjen e saj në kohë reale me pajisjen që përcakton vendndodhjen e subjektit.

Neni 15

Informacioni i transmetuar sallës operative

1. Informacioni i siguruar nga pajisja shfaqet në harta, të cilat mundësojnë perceptimin e vendndodhjes së subjektit në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me sistemin rrugor dhe administrativ të Republikës së Shqipërisë.

2. Shfaqja e informacionit në harta dhe perceptimi pamor i tij është i ndaluar nëse subjekti qëndron brenda zonës së lejuar ose jashtë zonës së ndaluar të lëvizjes.

3. Informacioni për vendndodhjen e subjektit shfaqet në hartë vetëm në rast se:

a) subjekti del nga zona e lejuar ose hyn në zonën e ndaluar të lëvizjes, sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor që urdhëron përdorimin e ME-së;

b) salla operative, nëpërmjet organit që realizon ME-në, merr një kërkesë nga

Shërbimi i Provës ose Policia e Shtetit, të cilët kërkojnë të përcaktojnë vendndodhjen e subjektit për shkak se:

- i) subjekti dyshohet se ka shkelur kushtet e vendosura në vendimin gjyqësor;
- ii) duhet të evitohet një rrezik i mundshëm që i kanoset subjektit ose të tretëve;
- iii) subjekti duhet të kontaktohet menjëherë për t'u pyetur apo për ndonjë qëllim tjetër të ligjshëm;

c) organi që realizon ME-në, nëpërmjet sallës operative, ka arsye të motivuar të besojë se:

- i) subjekti mund të ketë dëmtuar ose hequr pajisjen;
- ii) pajisja ka pësuar një dëmtim aksidental dhe nuk transmeton informacion si duhet.

4. Informacioni që shfaqet në hartë u vihet në dispozicion, në kohë reale, me terminal të dedikuar, Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.

Neni 16

Konfidencialiteti i informacionit

1. Organi që realizon ME-në, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, respekton rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Informacioni i siguruar për vendndodhjen e subjektit është i ndaluar t'u jepet personave të tretë apo agjencive ose organeve të paautorizuara nga ky ligj.

KREU IV

ZBATIMI I VENDIMIT PËR PËRDORIMIN E ME-SË

Neni 17

Detyrimet e subjektit

Subjekti detyrohet:

- a) të zbatojë kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor;
- b) të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon ME-në adresën e saktë të banimit dhe të punës, si dhe numra telefonikë kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë;
- c) të kthehet brenda zonës së lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e ndaluar, brenda 30 minutave nga çasti kur është kontaktuar nga salla operative;
- ç) të mos dëmtojë ose heqë në asnjë rast pajisjen;
- d) të njoftojë menjëherë organin që realizon ME-në për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose funksionimin në kushte jonormale të saj.

Neni 18

Veprime në rast të shkeljes së vendimit gjyqësor

1. Kur informacioni në hartë evidenton daljen nga zona e lejuar ose hyrjen në zonën e ndaluar të lëvizjes, si edhe dëmtimin ose heqjen e pajisjes, salla operative kontakton menjëherë subjektin. Nëse ky i fundit nuk mund të kontaktohet, atëherë salla operative

kontakton personin e afërt të përcaktuar në vendimin e gjykatës për përdorimin e ME-së.

2. Nëse subjekti kthehet në zonën e lejuar ose largohet nga zona e ndaluar brenda 30 minutave nga çasti që ai ose personi i afërt i tij kontaktohen nga salla operative, atëherë nuk ndërmerret asnjë veprim i mëtejshëm. Në këtë rast salla operative e evidenton këtë fakt në një regjistër të posaçëm.

3. Nëse subjekti dhe personi i afërt nuk mund të kontaktohen, salla operative njofton menjëherë Policinë e Shtetit, së cilës i përcjell informacionin për vendndodhjen e subjektit. Salla operative, brenda 24 orëve, njofton Shërbimin e Provës për shkeljen dhe veprimet e kryera prej saj në zbatim të këtij ligji.

4. Informacionet e marra në rastet e parashikuara nga ky nen ruhen për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga çasti i evidentimit të shkeljes. Prokurori ose gjykata mund të urdhërojë që informacionet të ruhen për një kohë më të gjatë se gjashtë muaj.

5. Nuk evidentohet si shkelje e kushteve të përdorimit të ME-së rasti kur Shërbimi i Provës i ka komunikuar me shkrim sallës operative autorizimin e lëshuar ndaj subjektit për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar. Autorizimi duhet të përmbajë përcaktimin e saktë të zonës ku lejohet të lëvizë subjekti dhe afatin e lejit të lëvizjes.

6. Rregulla të hollësishme për kriteret e dhënies së autorizimeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 19

Shkelja e kushteve të ME-së

1. Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Provës vënë në dijeni prokurorin menjëherë sapo marrin njoftimin për shkeljen e kushteve të ME-së.

2. Prokurori, kur vlerëson se janë shkelur qëllimisht, ose në mënyrë të përsëritur, kushtet për përdorimin e ME-së, harton një raport, të cilin ia paraqet gjykatës brenda 48 orëve nga marrja dijeni për shkeljen e kryer.

3. Raporti i hartuar në rastet e parashikuara nga pika 2 e këtij neni i paraqitet së njëjtës gjykatë që ka vendosur përdorimin e ME-së dhe përmban rekomandimin e Shërbimit të Provës për vazhdimin ose jo të ME-së ndaj subjektit që ka kryer shkeljen.

4. Gjykata dëgjon në seancë prokurorin, përfaqësuesin e Shërbimit të Provës e subjektin dhe, pasi vlerëson të gjitha rrethanat, vendos:

a) vazhdimin e ME-së me të njëjtat kushte;

b) sipas procedurës së parashikuar nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale ose nenit 31 pika 10 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar;

c) sipas procedurës së parashikuar nga neni 22 pika 2 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Fillimi i zbatimit të ligjit

1. Ligji, menjëherë pas hyrjes në fuqi, fillon të zbatohet ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i këtij ligji, gjykimi i të cilave është në kompetencë të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, të cilat urdhërojnë përdorimin e ME-së, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësinë teknike të realizimit të saj.

2. Zbatimi i ligjit ndaj personave të parashikuar nga neni 4 i këtij ligji, që nuk janë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, fillon sipas afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të fondeve financiare të vëna në dispozicion për realizimin e mbikëqyrjes elektronike.

Neni 21

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 11 pika 3 dhe të nenit 20 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 12 pika 4 dhe të nenit 18 pika 6 të këtij ligji.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1.4.2012.

**Shpallur me dekretin nr.7219, datë 10.1.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

SHTOJCA 2

VENDIM
Nr.302, datë 25.3.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN
E SHËRBIMIT TË PROVËS DHE PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE E
TË PROCEDURAVE, PËR MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE
ALTERNATIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31/12 të ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS DHE PËR
PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE E PROCEDURAVE PËR MBIKËQYRJEN E
EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

TITULLI I

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave lidhur me:

- a) rolin e Shërbimit të Provës në çdo fazë të procedimit penal;
- b) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
- c) statusin e punonjësve të Shërbimit të Provës;
- ç) standardet dhe procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative;
- d) mënyrën e realizimit të të drejtave të të dënuarve.

Neni 2 **Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “I dënuari” është personi, për të cilin gjykata ka vendosur dhënien e një dënimi alternativ sipas ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

b) “Dënim alternativ” është një prej alternativave të dënimit me burgim të parashikuara në kreun VII të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

c) “Shërbimi” është Shërbimi i Provës.

ç) “I dënuari në provë” nënkupton të dënuarin me masë alternative, për të cilin gjykata ka vendosur plotësimin e një ose disa detyrimeve gjatë një periudhe prove.

d) “Prokurori” është prokurori i çështjes penale, në të cilën kërkohet asistenca e Shërbimit të Provës ose prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit penal të masës alternative të dhënë ndaj një të dënuari.

e) Dispozitat, që zbatohen për të dënuarin, zbatohen për atë që janë të pajtueshme edhe për personin nën hetim dhe të pandehurin. Ndaj personit nën hetim dhe të pandehurit shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të dënuarin.

Neni 3 **Parimet e veprimtarisë**

1. Veprimtaria e Shërbimit të Provës bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, parimin e objektivitetit, si dhe mbi parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

2. Shërbimi i Provës siguron që në veprimtaritë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.

3. Shërbimi i Provës gjatë veprimtarisë së tij respekton dinjitetin e personit nën hetim, të pandehurit dhe të të dënuarit.

4. Në veprimtarinë e tij, Shërbimi i Provës përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.

Neni 4 **E drejta e ankimit**

1. I dënuari ka të drejtën e ankimit administrativ kundër veprimeve të punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar me mbikëqyrjen e tij. Për shqyrtimin e këtij ankimi zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Administrative.

2. I dënuari ka të drejtën e ankimit tek prokurori apo gjykata për aktet e nxjerra nga shërbimi i provës që kanë të bëjnë me çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal të dhënë ndaj tij. Për këto çështje zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

KREU II ROLI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 5

Administrimi dhe kompetenca tokësore e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës është organ shtetëror në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Shërbimi i Provës përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, si dhe zyrat vendore, të cilat janë të organizuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.

2. Në rastin e të pandehurve, për të cilët autoriteti procedues ka kërkuar një raport vlerësimi, kompetente është zyra vendore e shërbimit të provës pranë gjykatës ku zhvillohet procedimi.

3. Në rastin e të dënuarve me një masë alternative, kompetente është zyra vendore pranë gjykatës ku i dënuari ka banimin.

4. Në rastin e të dënuarve me burgim që u nënshtrohen programeve rehabilituese apo për të cilët kërkohet nga gjykata kryerja e raporteve përpara lirimit, kompetente është zyra vendore pranë gjykatës ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të dënimeve penale.

5. Çdo zyrë e Shërbimit të Provës vepron brenda kompetencës së vet tokësore. Në rast konflikti mbi kompetencën tokësore, çështja zgjidhet nga gjykata që ka dhënë vendimin me kërkesë të prokurorit ose të të dënuarit apo mbrojtësit të tij.

Neni 6

Roli dhe detyrat e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr dhe mbështet zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit alternativ në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.

2. Shërbimi i Provës bashkëpunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

3. Shërbimi i Provës përcakton metodat e zbatimit të dënimit alternativ në përputhje me parashikimet ligjore. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione shtetërore, qendrore apo lokale, me komunitetin lokal, si dhe me institucione të tjera dhe organizata jofitimprurëse për zbatimin e dënimeve alternative.

TITULLI II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

KREU III ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 7

Organizimi i përgjithshëm

1. Shërbimi i Provës është organi i centralizuar, i cili organizohet dhe funksionon në

nivel qendror dhe vendor. Ai përbëhet nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë, niveli qendror; dhe

b) zyrat vendore pranë gjykatave të shkallës së parë, niveli vendor.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës drejton, organizon dhe kontrollon ekzekutimin e dënimeve alternative, si dhe merr masat përkatëse për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

3. Zyrat vendore mbikëqyrin dhe mbështesin zbatimin e dënimeve alternative dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

Neni 8

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit të Provës.

2. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 9

Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

a) Drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Provës.

b) Merr masat që Shërbimi i Provës të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të detyrave ligjore.

c) Përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin e çështjeve në kompetencë të Shërbimit të Provës.

ç) I propozon Ministrisë të Drejtësisë emërimin, lirimin dhe shkarkimin e drejtorëve të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.

d) Urdhëron kryerjen e inspektimeve në Shërbimin e Provës

dh) Emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

e) Emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e zyrave vendore të Shërbimit të Provës me propozim të drejtorit përkatës të zyrës vendore.

ë) Organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e punonjësve të Shërbimit të Provës.

f) Ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë së Shërbimit të Provës.

g) Përfaqëson Shërbimin e Provës në marrëdhënie me të tretët.

gj) I raporton Ministrisë të Drejtësisë, të paktën një herë në muaj, për veprimtarinë e kryer nga Shërbimi i Provës, duke vënë në dukje mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse.

h) Ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara në akte ligjore.

Neni 10

Organika dhe struktura e Shërbimit të Provës

1. Struktura dhe organika e Shërbimit të Provës miratohet nga Kryeministri, me

propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

2. Organizimi i brendshëm i çdo zyre vendore miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, bazuar në parimin e specialitetit të natyrës së punës dhe të efektivitetit.

3. Zyrat vendore të Shërbimit të Provës përbëhen nga:

a) drejtori i zyrës;

b) punonjësit e Shërbimit të Provës

4. Drejtori i zyrës vendore emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

5. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

6. Punonjësit e zyrës vendore emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të drejtorit të zyrës vendore.

Neni 11

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi i Provës ka buxhetin e vet, si pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Shërbimi i Provës ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

KREU IV

STATUSI I PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 12

Punonjësi i shërbimit të provës

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës është personi i ngarkuar me mbikëqyrjen dhe asistimin e të dënuarit në zbatimin e dënimit alternativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, punonjësi i Shërbimit të Provës udhëhiqet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi.

Neni 13

Rregulla të përgjithshme për emërimin

1. Emërohet punonjës i Shërbimit të Provës shtetasi që plotëson këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;

ç) të ketë kryer arsimin e lartë në degët psikologji, punë sociale, sociologji ose juridik;

d) të gëzojë figurë të pastër morale.

dh) të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

e) të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizative.

2. Rekrutimi i punonjësve në Shërbimin e Provës i nënshtrohet parimit të konkurrit

të hapur bazuar në meritat. Konkursi organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Kandidati fitues emërohet përkohësisht punonjës i Shërbimit të Provës për një periudhë prove 3-mujore.

3. Emërohet drejtor i zyrës vendore i Shërbimit të Provës, personi që, përveç kriterëve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, plotëson edhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë pesë vjet përvojë profesionale në fushën përkatëse, nga të cilat të paktën një vit në pozicion drejtues;

b) të mos ketë marrë masa disiplinore gjatë përvojës së tij profesionale;

c) të ketë aftësi drejtuese dhe administruese, interpretuese të politikave qeverisëse dhe zbatuese të tyre, planifikuese dhe përballuese të krizave, si dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie pozitive me gjykatat, prokurorinë dhe bashkëpunëtorët e Shërbimit të Provës.

Neni 14

Periudha e provës

1. Gjatë periudhës së provës, punonjësi i Shërbimit të Provës është nën kujdesin e një punonjësi të vjetër në detyrë. Veprimtaritë e trajnimit janë të detyrueshme për punonjësin e Shërbimit të Provës në periudhën e provës. Gjatë periudhës së provës, punonjësi në provë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me punonjësit e tjerë të Shërbimit të Provës.

2. Në përfundim të periudhës së provës, punonjësi i vjetër në detyrë mbikëqyrës, së bashku me drejtorin e zyrës vendore përgatisin një raport vlerësimi të punës së kryer nga punonjësi në provë, të cilin ia paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm me propozimin konkret.

3. Në përfundim të periudhës së provës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës vendos:

a) emërimin përfundimtar si punonjësi i Shërbimit të Provës;

b) lirimimin nga Shërbimi i Provës.

Neni 15

Papajtueshmëritë

1. Punonjësi apo drejtuesi në Shërbimin e Provës nuk mund të kryejë funksione të tjera, publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat e tij funksionale ligjore.

2. Ai nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune ose të kryejë veprimtari të tjera, të cilat paraqesin konflikt interesash me detyrën që ka ose pengojnë përmbushjen e saj.

Neni 16

Përfundimi i punonjësit të Shërbimit të Provës në rastet e konfliktit të interesit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës deklaron të gjitha rastet e rënies së tij në konflikt interesi sipas parashikimeve të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, gjatë detyrave të tij për mbikëqyrjen dhe asistimin e të dënuarit.

2. Veçanërisht, ai është i detyruar të kërkojë heqjen dorë nga mbikëqyrja dhe asistimi i të dënuarit në rastet e konfliktit faktik dhe të vazhdueshëm të interesit me të dënuarin ose me institucionet e kryerjes së dënimit alternativ nga i dënuari.

3. Deklarimi i konfliktit të interesit dhe kërkesa për heqjen dorë i paraqitet për vendim drejtorit të zyrës përkatëse të Shërbimit të Provës. Në rastin e drejtorit të zyrës vendore,

aktet i paraqiten për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Përmbajtja e kërkesës dhe e vendimit, në çdo rast, i njoftohet palëve.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës

Punonjësit e Shërbimit të Provës gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit të njohura nga legjislacioni i punës për aq sa ato përputhen me detyrat e tyre funksionale ligjore.

Neni 18

Dokumenti i identifikimit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës ka dokument identifikues, të cilin e paraqet gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

2. Modeli i dokumentit identifikues miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 19

Trajnimi

1. Shërbimi i Provës organizon kurse trajnimi të detyrueshme për punonjësit, me qëllim aftësimin profesional dhe përsosjen e njohurive në drejtim të kryerjes së detyrave me efektivitet dhe profesionalizëm.

2. Shërbimi i Provës krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione lokale, publike, shtetërore, private, organizata jofitimprurëse, vendase apo të huaja, për realizimin e detyrimit për trajnim të punonjësve të Shërbimit të Provës.

Neni 20

Lirimi nga detyra e punonjësit të Shërbimit të Provës

Punonjësi i Shërbimit të Provës lirohet nga detyra kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) nuk kalon me sukses periudhën e provës në punë sipas nenit 14.

KREU V

MASAT DISIPLINORE

Neni 21

Përgjegjësia disiplinore

1. Shkelja e dispozitave të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” , të ndryshuar, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Punës, të Kodit të Etikës ose të kësaj rregulloreje, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.

2. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje të lehta, shkelje të rënda dhe shkelje shumë të rënda.

3. Shkelja e rregullave të etikës gjatë orarit zyrtar përbën shkelje të lehtë disiplinore.

4. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore.

5. Shkelja e dispozitave urdhëruese të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave urdhëruese ligjore që sjellin pasoja, si dhe e afateve të përcaktuara për kryerjen e veprimeve përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore.

6. Përsëritja e shkeljeve përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Neni 22

Llojet e masave disiplinore

1. Masat disiplinore që merren ndaj punonjësve janë si më poshtë:

a) vërejtje;

b) vërejtje me shkrim;

c) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra;

ç) shkarkim nga detyra.

2. Këto masa disiplinore jepen në mënyrë të përshkallëzuar dhe në raport me pasojën që shkelja disiplinore ka shkaktuar.

3. Për shkelje të lehta jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.

4. Për shkelje të rënda jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” dhe “c”.

5. Për shkelje shumë të rënda jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “c” dhe “ç”.

Neni 23

Procedura për dhënien e masave disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe jepen nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Masat disiplinore ndaj drejtorëve të zyrave vendore jepen nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Masat disiplinore ndaj punonjësve të zyrës vendore jepen nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të drejtorit të zyrës vendore.

4. Masat disiplinore jepen sipas një procedure që garanton të drejtën për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar.

TITULLI III

MBIKËQYRJA E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

KREU VI

STANDET DHE PROCEDURAT E MBIKËQYRJES SË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

Kontakti i parë i të dënuarit me Shërbimin e Provës

1. Zyra vendore kompetente vendos kontaktin e parë me të dënuarin brenda pesë ditëve nga dita që merr njoftim për urdhrin e ekzekutimit të prokurorit për vendimin penal gjyqësor që ka caktuar dënimin alternativ.

2. Pas njoftimit të urdhrin të ekzekutimit, drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës cakton një ose dy punonjës të Shërbimit të Provës për të vendosur kontaktin e parë me të dënuarin dhe për të mbikëqyrur zbatimin e dënimit alternativ.

3. Punonjësi i caktuar për mbikëqyrjen njofton të dënuarin për datën e kontaktit të parë. Në njoftim tregohet vendi, data dhe ora e kontaktit, si dhe numri i telefonit dhe adresa e Shërbimit të Provës. Ky njoftim kryhet me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, si: telefoni, telegrafi, telegrami, faksi apo posta elektronike. Ky njoftim ka vlerë kur i dënuari konfirmon marrjen e tij.

4. Kur i dënuari është i mitur, punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen njofton edhe mbrojtësin e të dënuarit, me qëllim dhënien e informacionit për vendndodhjen e zyrës vendore të Shërbimit të Provës, numrin e telefonit dhe emrin e punonjësit të Shërbimit të Provës të ngarkuar me çështjen.

5. Në rast të mungesës së konfirmimit të njoftimit nga i dënuari, punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen i drejtohet menjëherë prokurorit të ekzekutimit për të realizuar njoftimin nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore. Në këtë rast afati i kontaktit të parë është dy ditë nga data e njoftimit të të dënuarit.

6. Në kontaktin e parë me të dënuarin punonjësi i Shërbimit të Provës verifikon identitetin e tij dhe e informon atë mbi qëllimin dhe objektivat e mbikëqyrjes, arsyet e dhënies së dënimit alternativ nga gjykata dhe pasojat e përmbushjes ose jo të tij.

7. Shërbimi i Provës informon të dënuarin edhe për detyrimin e tij për të respektuar rregullat mirësjelljes, veçanërisht me ato që kanë të bëjnë me shmangien e sjelljeve të dhunshme apo agresive dhe shmangien e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme që dëmtojnë punonjësit e Shërbimit të Provës.

8. Punonjësi i Shërbimit të Provës informon të dënuarin mbi të drejtën e tij për t'u ankuar pranë drejtorit të zyrës vendore në rast se ai e konsideron të papërshtatshëm trajtimin e tij gjatë periudhës së mbikëqyrjes.

9. Punonjësi i Shërbimit të Provës i dokumenton këto veprime informuese në procesverbal, i cili nënshkruhet prej tij dhe të dënuarit. Kur i dënuari është i mitur, procesverbali nënshkruhet edhe nga mbrojtësi i tij.

10. Në kontaktin e parë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës kryen një vlerësim paraprak mbi situatën e të dënuarit, me qëllim hartimin e programit të mbikëqyrjes.

11. Punonjësi i Shërbimit të Provës kryen vlerësimin e personalitetit të të dënuarit në programin e mbikëqyrjes, me qëllim analizimin e:

a) veprimeve/mosveprimeve penale, rrezikshmërisë shoqërore dhe dëmit të shkaktuar;

b) situatës familjare, ekonomike dhe sociale dhe qëndrimit të të dënuarit ndaj saj;

c) të planeve afatshkurtra dhe afatgjata të të dënuarit dhe mënyrave për realizimin e tyre.

12. Nëse nga vlerësimi rezulton se i dënuari është përdorues i pijeve alkoolike apo i substancave narkotike apo psikotrope, punonjësi i Shërbimit të Provës vlerëson llojin e substancave të përdorura, sasinë, masën e përdorimit dhe mënyrat e sigurimit të substancës,

periudhën dhe historikun e konsumimit të substancës, si dhe nëse është rasti institucionin ku i dënuari është regjistruar për trajtim. Në përfundim të këtij vlerësimi, punonjësi i Shërbimit të Provës përgatit raportin e vlerësimit dhe njofton prokurorin në përputhje me ligjin.

13. Në përfundim të kontaktit të parë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës e njofton atë për datën dhe vendin e takimit të ardhshëm.

14. Punonjësi i Shërbimit të Provës, pas kontaktit të parë, regjistron të dënuarin në regjistrin e të dënuarve.

Neni 25

Dosja personale

1. Për çdo të dënuar hapet dosja personale, plotësimi i së cilës fillon që në momentin e vendosjes së kontaktit të parë me të dënuarin dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit.

2. Dosja personale përmban:

- a) vendimin penal gjyqësor që cakton dënimin alternativ;
- b) urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të lëshuar nga prokurori;
- c) raportin e vlerësimit të përgatitur gjatë fazës së hetimeve paraprake për caktimin e dënimit alternativ, nëse ka;
- ç) një fotokopje të dokumentit të identifikimit të të dënuarit;
- d) raportin mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore, kur është e nevojshme;
- dh) procesverbalin e kontakteve me të dënuarin;
- e) programin e mbikëqyrjes;
- ë) raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
- f) çdo paralajmërim të dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
- g) një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka;
- gj) raportin përfundimtar të hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes;
- h) të dhëna mbi përparimin e të dënuarit gjatë periudhës së mbikëqyrjes, duke përfshirë arsyet për përfundimin e parakohshëm të saj;
- i) kopje të ankesave të të dënuarit mbi Shërbimin e Provës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
- j) kopje të ankesës së të dënuarit mbi të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes personale;
- k) urdhrin e caktimit të institucionit të ekzekutimit të masës alternative;
- l) çdo dokument tjetër në lidhje me të dënuarin që është i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes.

3. Informacioni i përfshirë në dosjen personale duhet të jetë i besueshëm, objektiv dhe të ketë të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me masën apo llojin e dënimit dhe ekzekutimin e tij.

4. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar informon të dënuarin mbi të drejtën për t'u njohur me aktet në dosjen personale, si dhe i shpjegon atij përmbajtjen e dosjes.

5. Me përfundimin e kryerjes së dënimit alternativ ose në rast lirim, dosja arkivohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 26
Regjistrat e Shërbimit të Provës

1. Çdo zyrë vendore e Shërbimit të Provës hap dhe ruan regjistrat e mëposhtëm:
 - a) regjistri themeltar i personave të dënuar;
 - b) regjistri i kërkesëankesave;
 - c) regjistri i shkeljeve të planit individual të trajtimit;
 - ç) regjistri i ngjarjeve të rënda;
 - d) regjistri i OJF-ve dhe institucioneve të tjera që ofrojnë këshillim dhe asistencë ose vende pune për të dënuarit me dënim alternativ.
2. Përmbajtja e regjistrave të përmendur në paragrafin 1 përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës krijon regjistrin elektronik, në të cilin regjistron të dhënat e zyrave vendore. Të dhënat e këtij regjistri përditësohen çdo javë.

Neni 27
Shfrytëzimi i të dhënave

1. Të dhënat lidhur me të dënuarin mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9887 datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, karakterin konfidencial të tyre dhe mund të njihen nga Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës, i dënuari, nga çdo autoritet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e akteve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Dhënia e informacioneve të dosjes personale apo regjistrit lejohet vetëm në rast se këto informacione kanë lidhje me ushtrimin e detyrave të autoritetit që e kërkon atë.
3. Dhënia e informacioneve mbi të dënuarin, institucioneve apo organizatave që sigurojnë për të vende pune apo asistencë sociale, lejohet vetëm në përputhje me funksionet dhe rolin e tyre në zbatimin e dënimit alternativ. Ndalohet dhënia e informacioneve mbi veprën penale dhe personalitetin e të dënuarit pa një pranim të shprehur të tij, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve në jetën e tij private.
4. I dënuari ka të drejtë të kundërshtojë të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes së tij personale nëpërmjet një ankese me shkrim drejtuar Drejtorit të Shërbimit të Provës.

Neni 28
Trajtimi i të dënuarit

1. Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Shërbimi bazuar në këtë vlerësim, si dhe në të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit, ndërton programin individual të trajtimit të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Ky program duhet të miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore.
2. Në takimin e dytë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar i paraqet dhe shpjegon të dënuarit përmbajtjen e programit individual. Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet me të dënuarin. Ky program mund të ndryshohet në varësi

të ecuarisë së të dënuarit.

3. Programi individual nënshkruhet nga punonjësi i Shërbimit të Provës dhe i dënuari dhe, kur i dënuari është i mitur, edhe nga mbrojtësi i tij. Një kopje e programit individual i dorëzohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

4. Programi individual përmban elementet e mëposhtme:

a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, duke përmendur datat e fillimit dhe të mbarimit të saj, si dhe emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;

b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave.

c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre;

ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;

d) metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuar dhe për të reduktuar rrezikun;

dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata.

5. Kur gjykata vendos detyrimin e të dënuarit për të marrë pjesë në një program rehabilitimi, programi individual shkurtimisht përshkruan përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e kryerjes së tij.

6. Kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik, plani i mbikëqyrjes përmban përshkrimin e veprimtarive, vendin e punës dhe oraret e saj.

7. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes.

8. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet e identifikuar, plani i mbikëqyrjes mund të rishikohet, nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

9. Në rast rishikimi të planit të mbikëqyrjes, paragrafi 3 zbatohet kur është e përshtatshme.

Neni 29

Asistimi i të dënuarit

1. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të personalitetit dhe kontakteve të vazhdueshme me të dënuarin gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, Shërbimi i Provës e ndihmon atë në kapërcimin e vështirësive për riintegrim social. Shërbimi i Provës kontakton me familjen e të dënuarit, persona të tjerë të afërt me të, kryen vëzhgim të mjedisit social të të dënuarit, bashkëpunon me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit me qëllim reduktimin dhe eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit dhe rehabilitimin e tij.

2. Në kryerjen e kësaj veprimtarie, Shërbimi i Provës synon të:

a) reduktojë dhe eliminojë rrezikshmërinë shoqërore të të dënuarit, duke e ndërgjegjësuar atë mbi veprën penale të kryer dhe pasojat e saj;

b) ndërgjegjësojë të dënuarin për rrezikshmërinë dhe rëndësinë e veprës penale, si dhe vetëdisiplinën;

c) hartojë dhe të realizojë programe efektive asistence dhe këshillimi për të dënuarin bazuar në nevojat e identifikuara të tij;

ç) mbështesë të dënuarin me qëllim përmbushjen e nevojave sociale që lidhen me edukimin, trajnimin, punësimin, strehimin e nevoja të tjera të ngjashme;

d) respektojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të të dënuarve, dhe të garantojë respektimin e dinjitetit personal të tyre.

Neni 30

Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ

1. Në rast pamundësie të përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, pasi verifikon faktet dhe rrethanat që ndikojnë në pamundësinë e përmbushjes, dhe pas takimit me të dënuarin, Shërbimi i Provës i dërgon menjëherë një raport njoftimi prokurorisë mbi arsyet e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

2. Shërbimi i Provës i bashkëlidh raportit, sipas rastit, kur është e nevojshme, të dhëna në lidhje me mospërmbushjen nga ana e të dënuarit të detyrimeve të vendosura nga gjykata.

3. Raporti përmban edhe një propozim për prokurorin për veprimet që duhen ndërmarrë në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së shkeljes dhe vlerësimin që Shërbimi i Provës i ka bërë rastit.

4. Llojet e propozimit për prokurorin janë:

a) dhënia e një paralajmërimi në rastet e të miturve ose shkeljeve të kryera për herë të parë;

b) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të ndryshuar detyrimin, për të shtuar detyrime të tjera, për t'i zëvendësuar ato me dënime të tjera ose për të revokuar pezullimin e kryerjes së dënimit dhe periudhën e dënimit me burgim.

Neni 31

Detyrimi për të hartuar dhe paraqitur raportin

Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, paraqet një raport vlerësues për personin nën hetim, për të pandehurin ose për të dënuarin në këto raste:

a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;

b) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;

c) gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal:

i) në rastin e mbikëqyrjes së personit të dënuar;

ii) në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;

iii) në përfundimin para kohe të periudhës së vënies në provë;

iv) në përfundim të dënimit alternativ apo në përfundim të përmbushjes së detyrimeve të caktuara.

Neni 32

Raporti i shërbimit të provës

1. Shërbimi i Provës harton raportin vlerësues duke analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin apo të dënuarin. Ky raport paraqet një ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të shërbimit të provës.

2. Në rastin e fazës së hetimeve paraprake dhe të gjykimit, ky raport hartohet nga një punonjës i caktuar nga drejtori i zyrës vendore për këtë qëllim. Në rastet e fazës së ekzekutimit të dënimit penal, raporti hartohet nga punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen e të dënuarit.

3. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

4. Shërbimi i Provës paraqet në raport mendimin e tij për llojin apo masën dënimit të përshtatshme që duhet marrë në çdo rast individual. Ky mendim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit.

5. Raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur, duke shmangur termat e specializuar apo shprehjet që do ta vështirësonin kuptimin e tij.

6. Raporti duhet të përgatitet nga Shërbimi i Provës bazuar në dy a më shumë takime me personin, për të cilin gjykata ose prokurori ka kërkuar raport vlerësimi.

7. Në rast se nevojitet një analizë komplekse dhe tepër e specializuar psikologjike, sociologjike, pedagogjike, mjekësore apo analizë tjetër e ngjashme, zyra vendore i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme ekspertizën e duhur për të hartuar raportin e vlerësimit.

8. Punonjësi i Shërbimit të Provës kontakton anëtarë të familjes, persona nga shkolla apo vendi i punës dhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për hartimin e raportit të vlerësimit.

9. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit nuk bashkëpunon, punonjësi i Shërbimit të Provës e përmend refuzimin e bashkëpunimit në raport.

10. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti nuk gjendet, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën që ka kërkuar raportin, duke përgatitur një njoftim të posaçëm që tregon faktet e gjetura dhe pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit.

11. Të dhënat e parashikuara nga paragrafi 9 nënkuptojnë çdo lloj të dhëne, përfshirë edhe punën me Policinë e SHTETIT për të identifikuar personin.

Neni 33

Detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës në lidhje me hartimin e raportit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar për të hartuar raportin e vlerësimit:

a) cakton menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e kërkesës nga gjykata ose prokurori, vendin, datën dhe orën e kontaktit të parë me personin për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit. Kontakti i parë duhet të zhvillohet brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës nga gjykata apo prokurori. Në rastin e të miturve, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton vendin, datën dhe orën e takimit apo takimeve me fëmijën dhe prindërit dhe mbrojtësin ose, nëse është e nevojshme, me njerëz ose institucione, përfaqësuesve të të cilëve iu është besuar mbikëqyrja e fëmijës.

b) kontakton çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth personit në vlerësim, rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave të tij shoqërore dhe familjare;

c) regjistron, në çdo takim, të dhënat e nevojshme dhe të dobishme për hartimin e raportit të vlerësimit;

ç) i propozon drejtorit të zyrës vendore, kur çmohet e nevojshme, të marrë masat e parashikuara nga paragrafi 7, i nenit 32;

- d) harton raportin e vlerësimit bazuar në informacionin e marrë dhe ia paraqet për shqyrtim dhe nënshkrim drejtorit të zyrës vendore të Shërbimit të Provës;
- dh) ia dërgon raportin e vlerësimit organit procedues brenda afatit të kërkuar prej tij.

Neni 34

Përmbajtja e raportit të vlerësimit dhe e raportit përfundimtar

1. Raporti i vlerësimit përmban elementet e mëposhtme:

a) Përshkrimin dhe analizën e veprës penale në rastin e raporteve të përgatitura në çdo fazë të procedimit përpara dhënies së dënimit me qëllim vlerësimin e rrezikshmërisë dhe personalitetit.

b) Një përmbledhje të të gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize mbi shkakun e kryerjes së kësaj veprë penale të veçantë në këtë kohë.

c) Burimet e informacionit të përdorura opër të përgatitur raportin të paraqitura shprehimisht, duke përfshirë njerëzit e intervistuar dhe dokumentat e konsultuara.

ç) Numrin e takimeve të mbajtura me personat e intervistuar dhe refuzimin e bashkëpunimit apo çdo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, si dhe burimet e informacionit mbi të cilat aksesit ka qenë i pamundur.

c) date privind persoana pentru care a fost solicitat;

d) Përshkrimin dhe analizën e autorit të veprës penale, duke përfshirë informacion mbi sfondin e tij social, historinë personale, historinë kriminale dhe reagimet ndaj dënimeve të mëparshme dhe, kur është e nevojshme, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, duke përfshirë gjendjen financiare, përdorimin e drogës dhe të alkoolit, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e konsideron të rëndësishëm.

dh) Rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, si dhe faktorët që mund të ndikojnë ose prekin sjelljen e tij në përgjithësi. Kur është e përshtatshme, raporti përfshin mendime/konsiderata mbi mënyrat e reduktimit apo menaxhimit të rrezikut të përsëritjes apo dëmit.

e) Përfundimet dhe rekomandimet e Shërbimit të Provës për gjykatën ose prokurorinë.

2. Raporti për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes përmban:

i) gjeneralitetet e të dënuarit;

ii) të dhënat e vendimit gjyqësor penal që ka caktuar masën alternative;

iii) datën e fillimit dhe të përfundimit të masës alternative të dënimit;

iv) arsyen e përfundimit të masës alternative; dhe

v) një paraqitje të ecurisë së përbushjes së detyrimeve dhe masës alternative të dënimit.

3. Raportet përpilohen sipas modeleve të standardizuara të miratuara nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KREU VII

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE NË GJYSMËLIRI

Neni 35

Përcaktimi i institucionit

1. Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, me urdhër të përbashkët përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Në këtë përcaktim, mbahen parasysh shkaku për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlorisë dhe vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.

2. Modeli i urdhrit miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorëve të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës.

Neni 36 **Programi**

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program ditor individual për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Ky program përmban detyrimet e të dënuarit gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar:

- a) oraret e hyrjes dhe daljes në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;
- b) personat me të cilët i dënuari lejohet ose ndalohet të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;
- c) ambientet e lejuara dhe ato të ndaluara për frekuentim;
- d) kushte të tjera.

KREU VIII MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE VËNIEN NË PROVË

Neni 37 **Programi**

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pezullimin e dënimit me burgim dhe vënie në provë, ku përcakton të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 38 **Kontaktet me Shërbimin e Provës**

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr zbatimin e vendimit me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënie në provë dhe e informon të dënuarin mbi detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me Shërbimin gjatë zbatimit të dënimit.

2. Punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton në programin individual numrin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe vendin e takimeve me të dënuarin në provë, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

3. Kur për arsye objektive, i dënuari në provë nuk mund të jetë i pranishëm në njërin prej takimeve, ai njofton paraprakisht punonjësin e Shërbimit të Provës. Në rast se njoftimi

nuk është i mundur, ai paraqitet pranë Shërbimit të Provës brenda tre ditëve nga përfundimi i pengesës dhe justifikon me dokumente mungesën e tij.

4. I dënuari në provë paraqet të dhëna me shkrim mbi arsyet objektive të mungesës, të cilat përfshihen në dosjen e tij personale.

5. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar verifikon arsyet e parashtruara dhe kur çmon që arsyet nuk justifikojnë mungesën, i jep të dënuarit në provë një njoftim me shkrim ku i ribën të ditur pasojat e mospërbushjes së detyrimeve dhe përmend datën e takimit të ardhshëm.

6. Kur shihet që pas dy njoftimeve i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar njofton drejtorin e zyrës vendore të Shërbimit të Provës, i cili njofton brenda dy ditëve prokurorin.

Neni 39

Detyrimet e të dënuarit në rast ndryshimi të vendbanimit

1. I dënuari në provë njofton paraprakisht me shkrim punonjësin e caktuar me mbëqyrjen e tij për ndryshimin e vendbanimit apo vendqëndrimit me përjashtim të rasteve urgjente kur njoftimi bëhet fillimisht nëpërmjet telefonit dhe më pas me shkrim. Brenda 15 ditëve nga ndryshimi, i dënuari në provë i paraqet punonjësit të caktuar të dhënat e detajuara rreth situatës së re.

2. Në rastin e udhëtimeve që i tejkalojnë 8 ditë, i dënuari në provë informon Shërbimin e Provës për adresën e vendit ku do të qëndrojë, numrin e telefonit dhe ditën e kthimit nga udhëtimi.

3. Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të zyrës vendore të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me çështjen, kjo e fundit brenda 3 ditëve i dërgon zyrës vendore të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i të dënuarit, dosjen personale të të dënuarit në provë dhe njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë dënimin.

4. Në rastin e ndryshimit të vendit të punës, i dënuari në provë njofton me shkrim Shërbimin e Provës dhe e informon atë për arsyet e ndryshimit, vendin e ri të punës, natyrën dhe veprimtaritë e punës. Brenda 15 ditëve nga ndryshimi i punës, i dënuari në provë i dërgon Shërbimit të Provës dokumentet që vërtetojnë dhe justifikojnë ndryshimin.

Neni 40

Detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës në lidhje me mbështjen e të dënuarit

1. Kur gjykata në vendimin e saj ka caktuar një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, Shërbimi i Provës inkurajon dhe mbështet të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve dhe verifikon përmbushjen e tyre.

2. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës identifikon dhe lidh marrëveshje me institucionet lokale që mund të mbështesin përmbushjen e një apo më shumë detyrimeve të vendosura nga gjykata, siç janë Policia e Shtetit, qendrat e arsimit apo trajnimit, qendrat e punës, institucionet mjekësore apo OJF-të që ofrojnë programe rehabilitimi.

Neni 41

Mbikëqyrja e detyrimit për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të marrë një formim profesional

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 1 të Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin për të ushtruar një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim ose formim profesional, Shërbimi i Provës merr masat për vendosjen e të dënuarit në formën e përshtatshme të veprimtarisë profesionale apo arsimit/formimit profesional.

2. Për këtë qëllim, punonjësi i Shërbimit të Provës identifikon qendrat arsimore dhe institucionet e kualifikimit profesional në nivel lokal që organizojnë kurse të tilla.

3. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar, kontrollon periodikisht nëse i dënuari në provë i ndjek kurset e arsimit apo kualifikimit.

4. Nëse vendimi i gjykatës nuk specifikon llojin e veprimtarisë që do të ndiqet nga i dënuari në provë, Shërbimi i Provës përcakton llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij.

Neni 42

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve financiare

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 2 dhe 3 të Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin të paguajë pensionet familjare apo të riparojë dëmin civil të shkaktuar, Shërbimi i Provës, gjatë kontaktit të parë, kërkon informacion mbi vendbanimin, mbi situatën dhe detyrimet financiare, vendin e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës së punësimit dhe, kur është rasti, informacion mbi personat në ngarkim të të dënuarit.

2. Shërbimi i Provës i shpjegon të dënuarit që ai duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata dhe identifikon bashkë me të mënyrën dhe kohën e duhur të përmbushjes së detyrimeve financiare.

3. Shërbimi i Provës kontrollon rregullisht nëse i dënuari në provë i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata dhe i dokumenton rezultatet e kontrollit.

Neni 43

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve të tjera

1. Kur gjykata ka caktuar për të dënuarin detyrimet e parashikuara në nenin 60, pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 ose 12, të Kodit Penal, Shërbimi i Provës bashkëpunon ngushtësisht me institucionet lokale apo entet e tjera publike apo private që mund të asistojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të detyrimeve.

2. Brenda 3 ditëve nga kontakti i parë, Shërbimi i Provës i dërgon Policisë së Shtetit ose çdo organizatë tjetër apo institucion që mund të asistojë mbikëqyrjen, informacion mbi të dënuarin në provë, duke kërkuar që, në rast mospërmbushjeje të detyrimit, të njoftohet menjëherë.

3. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bën vizita pa lajmërim paraprak në banesë ose në vendin e qëndrimit të të dënuarit për të siguruar mbikëqyrjen efektive të detyrimeve nga i dënuari. Nëpërmjet këtyre vizitave, Shërbimi i Provës mbledh edhe faktet, si dhe bashkëpunon me familjen e të dënuarit me qëllim asistimin e personit në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.

4. Kur Shërbimi i Provës konstaton që i dënuari në provë ka shkelur një apo më shumë nga detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, bën një paralajmërim me shkrim dhe i shpjegon verbalisht të dënuarit në provë përmbajtjen e paralajmërimit.

5. Detyrimi konsiderohet i papërbushur kur, pas një paralajmërimi me shkrim, Shërbimi i Provës konstaton që i dënuari në provë rishkel detyrimet e caktuara.

Neni 44

Mbikëqyrja e përbushjes së detyrimit për mjekim apo rehabilitim

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 11 e Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin e mjekimit ose rehabilitimit në një institucion shëndetësor ose të nënshtimit në një program trajtimi, mjekësor ose rehabilitues, Shërbimi i Provës identifikon, fillimisht, në nivel lokal, brenda 10 ditëve nga kontakti i parë, qendrën e përshtatshme për përbushjen e këtij detyrimi. Kjo qendër mund të jetë shëndetësore, organizatë, institucion apo ekspert që realizojnë programe rehabilitimi për substancat narkotike, alkoolin apo lloje të tjera programesh rehabilitimi.

2. Punonjësi i Shërbimit të Provës, gjatë takimeve me të dënuarin në provë dhe në lidhje të vazhdueshme me personat e përfshirë në trajtim, kontrollon nëse i dënuari në provë ndjek programet e trajtimit.

3. Me qëllim lehtësimin e përbushjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me qendrat mjekësore, institucionet, organizatat dhe specialistët për rregullimin e procedurave konkrete të bashkëpunimit.

4. Detyrimi i parashikuar në nenin 60, paragrafi 1 pika 11, të Kodit Penal konsiderohet i papërbushur kur i dënuari në provë:

- a) në mënyrë të paarsyeshme, refuzon përfshirjen në një program trajtimi;
- b) në mënyrë të pajustificuar, ndërpret programin e trajtimit;
- c) refuzon t'u nënshtrohet testeve për konsumin e substancave.

KREU IX

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR QËNDRIMIN NË SHTËPI

Neni 45

Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për qëndrimin në shtëpi, ku përcakton kushtet dhe detyrimet e personit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 46

Mbikëqyrja dhe informimi për ekzekutimin e dënimit me qëndrim në shtëpi

1. Shërbimi i Provës kontakton institucionet lokale, shërbimin social, Policinë e Shtetit dhe çdo ent privat apo publik që mund të asistojë në ekzekutimin e dënimit me qëndrim në shtëpi. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje bashkëpunimi me ta me qëllim mbikëqyrjen e të dënuarit.

2. Mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimit me qëndrim në shtëpi përfshin vizitat rutinë

të lajmëruara dhe ato të palajmëruara në shtëpinë e të dënuarit në provë ose në qendrat e kujdesit ku i dënuari vuan dënimin, si dhe mbajtjen e kontakteve me të dënuarin dhe familjen e tij.

3. Kur gjykata, sipas nenit 59/a paragrafi 2 të Kodit Penal, lejon të dënuarin të largohet nga vendbanimi, Shërbimi i Provës harton programin e mbikëqyrjes në përputhje me masat e përcaktuara nga gjykata për kohën e kaluar jashtë shtëpisë. Shërbimi i Provës mbikëqyr mënyrën e respektimit nga i dënuari të plotësimit të nevojave të domosdoshme familjare të lejuara nga gjykata.

4. Kur Shërbimi i Provës konstaton se kushtet e parashikuara në nenin 59/a paragrafi 1 të Kodit Penal, për të cilat gjykata ka caktuar masën alternative qëndrim në shtëpi nuk ekzistojnë më, raporton menjëherë tek prokurori me qëllim që t'i kërkohej gjykatës revokimi e masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër. Raporti i Shërbimit të Provës përmban, në këtë rast, një propozim konkret për dënimin zëvendësues.

Neni 47

Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve

1. Në rastin kur i dënuari nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga dënimi me qëndrim në shtëpi, Shërbimi i Provës verifikon faktet dhe rrethanat që kanë sjellë mospërbushjen dhe i raporton prokurorit të çështjes me qëllim zbatimin e nenit 62 të Kodit Penal.

2. Kur Shërbimi i Provës çmon që i dënuari nuk ka përmbushur detyrimet si rezultat i pamundësisë objektive, ai i propozon prokurorit ndryshimin e detyrimeve në përputhje me mundësitë dhe nevojat e të dënuarit.

KREU X

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMIN PËR KRYERJEN E NJË PUNE ME INTERES PUBLIK

Neni 48

Përcaktimi i llojit dhe vendit të punës

1. Kur gjykata ka caktuar ndaj të dënuarit masën alternative të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal, në favor të interesit publik, Shërbimi i Provës vendos llojin e punës që do të kryhet, vendin ku do të kryhet dhe ditët e javës.

2. Kur gjykata ka caktuar në vendimin e saj kryerjen e një pune në favor të interesit të një shoqate, Shërbimi i Provës përcakton llojin e punës dhe ditët e javës.

3. Në marrjen e këtij vendimi, Shërbimi i Provës vlerëson llojin e veprës penale të kryer, treguesit personalë të të dënuarit, si arsimi, mosha, gjendja shëndetësore, aftësitë profesionale, përvojën e mëparshme të tij dhe kushte të tjera sociale apo familjare të të dënuarit.

4. Shërbimi i provës në caktimin e vendit ku do të kryhet puna me interes publik merr në konsideratë vendbanimin e të dënuarit. Kur brenda territorit të vendbanimit të të dënuarit nuk ka një institucion të përshtatshëm, Shërbimi i Provës cakton një institucion tjetër të së njëjtës natyre i cili ndodhet në rrethin më të afërt me vendbanimin e të dënuarit.

Neni 49

Programi

1. Pas përcaktimit të institucionit, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës me interes publik në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje, i cili përmban:

a) ditët e javës gjatë të cilave do të kryhet puna, oraret për fillimin dhe mbarimin e punës dhe veprimtaritë e përditshme;

b) mënyrën e takimeve me punonjësën e Shërbimit të Provës;

c) elemente të tjera të nevojshme.

2. Kur i dënuari është person i mitur, programi ditor duhet të hartohet duke marrë parasysh moshën, interesin më të lartë të fëmijës, nevojat psiko-sociale, duke u konsultuar me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri.

3. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet në të cilin do të kryhet puna me interes publik për përmbushjen e programit. Marrëveshja përcakton programin, punën që do të kryhet, personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rastet e mospërmbushjes nga i dënuari të detyrimeve.

4. Shërbimi i Provës shpjegon, tek personi përgjegjës i caktuar për mbikëqyrjen, që është e nevojshme të evidentohen orët e punës mbi baza ditore për të verifikuar nëse orari i punës ditore është respektuar apo jo, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit.

Neni 50

Informimi i personit të dënuar për ekzekutimin e dënimit

1. Para fillimit të punës, Shërbimi i Provës informon të dënuarin për detyrimin e tij për të përmbushur udhëzimet e dhëna nga ky Shërbim dhe ato që rrjedhin nga puna që ai kryen.

2. Shërbimi i Provës informon personin e dënuar për detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me të.

Neni 51

Të drejtat dhe detyrat e të dënuarit

Gjatë kryerjes së punës i dënuari gëzon të drejta të njëjta me punëmarrësit e tjerë lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenien sociale dhe kohëzgjatjen në punë, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga natyra e dënimit dhe përmbushja e detyrimeve të tij.

Neni 52

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr të dënuarin gjatë ekzekutimit të vendimit për

kryerjen e punës në favor të interesit publik a shoqatës.

2. Kur Shërbimi i Provës njoftohet nga subjekti pranë të cilit kryhet puna për mospërbushje të detyrimeve nga i dënuari, atëherë ai e verifikon objektivisht këtë informacion dhe rezultatet e verifikimit ia raporton menjëherë prokurorit.

Neni 53

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit për punë me interes publik

1. Në rastet kur i dënuari paraqet tek prokurori kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit për punë me interes publik, ia njofton këtë kërkesë edhe Shërbimit të Provës dhe ky i fundit informon personin përgjegjës të caktuar me mbikëqyrjen e punës.

2. Shërbimi i Provës verifikon shkakun e paraqitur nga i dënuari në kërkesën e tij për pezullim dhe rezultatet e verifikimit ia raporton prokurorit. Në raport, Shërbimi i Provës evidenton edhe nëse kushtet e të dënuarit kanë ndryshuar në atë masë që justifikojnë pezullimin.

Neni 54

Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve

Kur Shërbimi i Provës konstaton se i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte të rregullta me të apo shkel kushtet apo detyrimet e tjera të caktuara, i raporton prokurorit.

Neni 55

Përfundimi i punës me interes publik

Subjektet pranë të cilave është kryer puna me interes publik, në përfundim të punës, pajisin të dënuarin me një vërtetim mbi orët e punës dhe datat e kryerjes së saj.

KREU XI

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR LIRIMIN ME KUSHT

Neni 56

Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 57

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të lirimit me kusht

Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe me Policinë e Shtetit. Ai informon personin e dënuar për detyrimin e tij për të raportuar rregullisht pranë Shërbimit lidhur me kryerjen e dënimit.

Neni 58

Ndryshimi i vendbanimit

Në rast ndryshimi të vendbanimit, i liruari me kusht njofton paraprakisht Shërbimin e Provës dhe Policinë e Shtetit mbi adresën e re të banimit dhe mbi arsyet e ndryshimit. Në këtë rast, Shërbimi i Provës njofton menjëherë prokurorin dhe Shërbimin e Provës së vendit të banesës së re të të liruarit me kusht.

Neni 59

Ndryshimi i detyrimeve

Në rastin kur i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga lirimi me kusht, Shërbimi i Provës, pasi verifikon kushtet dhe rrethanat për mospërmbushjen e tyre, njofton prokurorin e çështjes dhe bën propozime në lidhje me ndryshimin e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe nevojat e përshtatshme.

KREU XII

ZBATIMI I AKTEVE NDËRKOMBËTARE NGA SHËRBIMI I PROVËS

Neni 60

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

1. Në rastet kur Shërbimi i Provës çmon se duhen zbatuar rregullat e Konventës Europiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruuar me kusht” apo sipas rregullave e ndonjë akti tjetër ndërkombëtar të ratifikuara, atëherë njofton dhe bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë.

2. Procedurat e bashkërendimit të punës me Ministrinë e Drejtësisë përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

KREU XIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 61

Dispozitë kalimtare

1. Ministri i Drejtësisë nxjerr aktet nënligjore në përputhje me parashikimet ligjore, si dhe të kësaj rregulloreje për vënien në efikasë të Shërbimit të Provës.

2. Deri në plotësimin e numrit të punonjësve të Shërbimit të Provës, Ministri i Drejtësisë ngre një komision të posaçëm prej 5 vetësh për realizimin e procedurave për emërimin e punonjësve të parë të Shërbimit të Provës. Për punonjësit e parë të rekrutuar zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, rregullat e neneve 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.

3. Deri në krijimin e të gjitha zyrave vendore të Shërbimit të Provës sipas nenit 5 pika 1 të kësaj rregulloreje, Ministri i Drejtësisë përcakton me akt nënligjor vendndodhjen e zyrave vendore të para.

Shtojca 3

VENDIM

Nr. 377, datë 6.6.2012

PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË ORGANI QË REALIZON MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE, RREGULLAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE TË DREJTAT E DETYRIMET E TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organi shtetëror që realizon mbikëqyrjen elektronike, në fazën e projektit pilot, është Shërbimi i Provës, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, si organ epror i Shërbimit të Provës, ka detyrimet e mëposhtme:

a) t’i sigurojë Shërbimit të Provës mjedise të mjaftueshme për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

b) të sigurojë personelin e nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

c) të marrë të gjitha masat për të siguruar trajnimin e personelit shtetëror të përfshirë në mbikëqyrjen elektronike;

ç) të sigurojë postet e punës për kompjuterët e përdoruesve fundorë (*client computers*) për sistemin e mbikëqyrjes elektronike;

d) të sigurojë shpejtësi të mjaftueshme të aksesit në internet të kompjuterëve fundorë për komunikimin nëpërmjet internetit (*via web*) me sallën operative.

3. Ministria e Drejtësisë, për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, kontraktin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nëpërmjet procedurës së hapur, tender ndërkombëtar, shërbimet e një subjekti që ka eksperiencën e nevojshme në fushën e mbikëqyrjes elektronike.

4. Subjekti i përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, duhet të sigurojë:

a) trajnimin e stafit të Ministrisë së Drejtësisë apo Shërbimit të Provës, të përfshirë në mbikëqyrjen elektronike;

b) ofrimin e pajisjeve të nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

c) mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

ç) asistencën teknike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike.

5. Kushtet që duhet të plotësojë subjekti i përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, janë:

a) të ketë një eksperiencë, të paktën, trevjeçare në fushën e mbikëqyrjes elektronike në shtete të tjera;

b) të ketë eksperiencë në sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi që siguron mbikëqyrjen elektronike;

c) të jetë i pajisur me certifikatën e sigurisë së informacionit;

ç) të mos ketë qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Kriteret teknike të pajisjeve elektronike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe detyrimet e subjektit, të parashikuara në pikën 3, përcaktohen nga aneksi që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Subjekti duhet të ofrojë pajisjet e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes elektronike, këto pajisje duhet të plotësojnë kriteret teknike të mëposhtme:

PAJISJA ELEKTRONIKE

1. Pajisja elektronike duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

2. Pajisja elektronike mund të përbëhet nga një pajisje e identifikimit personal (PIP) dhe një njësi mbikëqyrjeje fikse ose e lëvizshme e cila komunikon me sallën operative duke përdorur një linjë telefoni fikse ose një linjë telefonike celulare. Në këtë rast pajisja elektronike, përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike, duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë mundësinë të instalohet në kyçin e këmbës ose, në raste të jashtëzakonshme, në kyçin e dorës të subjektit që është në mbikëqyrje elektronike;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të punojë në temperatura nga minus 20 deri në 50 gradë celsius;

d) Duhet të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

dh) Duhet të ketë mundësinë që të komunikojë me njësinë fikse të mbikëqyrjes në një largësi prej 50 metrash;

e) Duhet të përdorë një frekuencë radio të miratuar;

ë) Jetëgjatësia e baterisë duhet të jetë të paktën 12 muaj me një shenjë paralajmëruese kur mbeten më pak se 48 orë nga shkarkimi i saj;

f) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi të pajisjeve elektro-shtepiake;

g) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

3. Njësia fikse e mbikëqyrjes vendoset brenda mjedisit në të cilin subjektit i lejohet të lëvizë. Ajo duhet të ketë mundësinë të komunikojë me pajisjen e identifikimit personal dhe sallën operative nëpërmjet linjës së telefonit fiks ose nëpërmjet linjës telefonike celulare.

4. Njësia fikse e mbikëqyrjes duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë një pamje të tillë që të mos bjerë lehtësisht në sy;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të ketë një përbërje të fortë që të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

d) Duhet të ketë mundësinë të punojë me bateri për të paktën 48 orë në rast ndërprerjeje të energjisë;

dh) Duhet të jetë në gjendje të instalohet në një shtëpi të zakonshme pa nevojitur ndonjë modifikim/ndryshim;

e) Duhet të ketë mundësi të detektojë pajisjen e identifikimit personal në një largësi prej 50 metrash;

ë) Çdo njësi fikse mbikëqyrjeje duhet të jetë në gjendje të mbikëqyrë në mënyrë të njëkohshme 10 pajisje të identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

f) Duhet të jetë në gjendje, me kërkesë të sallës operative ose automatikisht mbas ndonjë ngjarjeje, të dërgojë një raport që përfshin: ndryshimin e llojit të furnizimit me energji; dëmtime të njësisë fikse të mbikëqyrjes; mosfunksionimin e pajisjes personale të identifikimit në zonën e mbikëqyrur;

g) Duhet të ketë aftësinë dhe mundësinë për të kontrolluar çdo tentativë për të dëmtuar ose penguar funksionimin e njësisë fikse të mbikëqyrjes e cila përfshin: fikje, lëvizje të njësisë fikse të mbikëqyrjes, tentativë për të hapur njësinë fikse të mbikëqyrjes apo çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

gj) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi që prodhojnë pajisjet shtëpiake;

h) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

5. Njësia e lëvizshme e mbikëqyrjes është një pajisje e vogël e cila mundëson marrjen e sinjaleve nga pajisja e identifikimit personal. Ajo duhet të ketë mundësinë e komunikimit me sallën operative nëpërmjet rrjetit telefonik celular.

6. Njësia e lëvizshme e mbikëqyrjes duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë një pamje të tillë që të mos bjerë lehtësisht në sy dhe të jetë e lehtë për t'u transportuar/lëvizur;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të ketë një përbërje të fortë që të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

d) Duhet të jetë në gjendje të detektojë të gjitha pajisjet e identifikimit personal në një rreze prej 200 metrash;

dh) Duhet të jetë në gjendje të sigurojë diferencimin dhe dallimin e të gjitha pajisjeve të identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

e) Duhet të ketë mundësinë/aftësinë që të punojë me bateri për të paktën 18 orë.

ë) Duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji;

f) Duhet të jetë në gjendje, me kërkesë të sallës operative ose automatikisht mbas ndonjë ngjarjeje, të dërgojë një raport që përfshin: dëmtime të njësisë së lëvizshme të mbikëqyrjes; mosfunksionimin e pajisjes së identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

g) Duhet të ketë aftësinë dhe mundësinë për të kontrolluar çdo tentativë për të dëmtuar ose penguar funksionimin e njësisë së lëvizshme të mbikëqyrjes e cila përfshin: fikje, tentativë për të hapur njësinë e lëvizshme të mbikëqyrjes apo çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër.

7. Pajisja elektronike mund të jetë gjithashtu një njësi e mbikëqyrjes GPS, e cila duhet të jetë e pajisur me module komunikimi RF, GPS, GPRS. Në këtë rast pajisja elektronike, përveç kriteve të përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike, duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë mundësinë të instalohet në kyçin e këmbës ose, në raste të

- jashtëzakonshme, në kyçin e dorës të subjektit që është në mbikëqyrje elektronike;
- b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;
 - c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;
 - ç) Duhet të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;
 - d) Duhet të ketë mundësi të punojë me bateri për të paktën 24 orë;
 - dh) Duhet të ketë mundësinë të tregojë vendndodhjen e subjektit duke përdorur sinjal GPS;
 - e) Duhet të ketë mundësinë e komunikimit interaktiv me subjektin nëpërmjet dridhjeve dhe alarmeve;
 - ë) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi që prodhohet nga pajisjet shtëpiake;
 - f) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

SALLA OPERATIVE

1. Salla operative duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

2. Salla operative përbëhet prej pajisjeve fizike (hardware), programeve kompjuterike (software) dhe pajisjeve që janë receptorë dhe analizues të sinjaleve që dërgohen nga pajisjet e identifikimit personal dhe njësitë e mbikëqyrjes. Programi kompjuterik (software) menaxhon mbikëqyrjen e përgjithshme të subjekteve. Vendndodhja dhe çdo informacion tjetër, si mesazhet dhe alarmet në tërësinë e sistemit, përfshirë këtu edhe alarmet që shkaktohen kur personi i mbikëqyrtur nuk është brenda zonës së kontrollit në kohën e paracaktuar, ose po vepron në mënyrë të paautorizuar mbi pajisjet, pasqyrohen në programin kompjuterik (software) në mënyrë të vazhdueshme.

3. Salla operative, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën e parë të këtij neni, duhet të ketë këto karakteristika:

- a) Sistemi kryesor i kontrollit (serveri) duhet të jetë i pajisur me të gjitha pajisjet e komunikimit të nevojshme për marrjen (receptimin) dhe dërgimin e të dhënave;

- b) Një sistem rezervë identik duhet të jetë i instaluar, me qëllim që të marrë menjëherë kontrollin e të gjitha funksioneve të mbikëqyrjes në rast të defekteve apo rënies së sistemit kryesor;

- c) Sistemet duhet të furnizohen me energji të pandërprerë. Në rast ndërprerjeje, duhet të garantojë furnizim të pandërprerë me energji për një periudhë kohore prej të paktën 24 orësh;

- ç) Duhet të jetë e pajisur me një sistem alarmi i cili i informon personelit defektet ose rënien e serverit kryesor;

- d) Sistemi i monitorimit duhet të jetë unik për secilën nga pajisjet që do të përdoren;

- dh) Gjuha e përdorimit duhet të jetë gjuha shqipe;

- e) Sistemi duhet të sigurojë kriptimin e informacionit, në mënyrë që monitorimi të mund të bëhet edhe nga jashtë mjediseve të sallës operative;

- ë) Pasqyrimi dhe verifikimi i informacionit duhet të bazohet në rrjetin ndërkombëtar *world wide web* nëpërmjet një shfletuesi të zakonshëm (web browser);

- f) Duhet të ketë mundësinë për të kontrolluar njëkohësisht 300 persona;

- g) Duhet të ketë aftësinë për të iniciuar procedurat standarde të veprimit për çdo rast

që mund të paraqitet, duke përfshirë një rreze të gjerë alarmesh pamore dhe zanore në varësi të llojit të shkeljes dhe rrezikut që paraqet personi nën mbikëqyrje elektronike;

gj) Duhet të ketë të gjitha programet kompjuterike të nevojshme për një operim normal të sistemit, gjithashtu duhet të ketë aftësinë që të mbajë kopje rezervë të të gjithë sistemit;

h) Duhet të regjistrojë për një periudhë kohore të paktën 6-mujore të gjitha të dhënat e mbledhura, si dhe të gjitha alarmet dhe ngjarjet që kanë ndodhur në çdo pikë të sistemit;

i) Duhet të ketë aftësinë që të sinkronizojë një orë të vetme në të gjithë sistemin;

j) Duhet të ketë aftësinë të ruajë dhe të shfaqë informacionet personale për secilin nga personat nën mbikëqyrje;

k) Duhet të ketë mundësi të përcaktohet dhe programohet koha që nevojitet përpara se një alarm të ndizet në rast të humbjes së komunikimit ndërmjet sallës dhe pajisjeve.

DETYRIMET E SUBJEKTIT

1. Subjekti që ofron pajisjet elektronike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike duhet:

a) Të verë në dispozicion në sasi të mjaftueshme pajisjet për mbikëqyrjen elektronike të subjekteve, duke përfshirë dhe një sasi rezervë të tyre;

b) Të instalojë një sallë operative;

d) T'i raportojë në mënyrë të përmuajshme Ministrit të Drejtësisë në lidhje me performancën e sistemit;

e) Të bashkëpunojë plotësisht me Shërbimin e Provës;

ë) Të mos degradojë cilësinë e shërbimit, pavarësisht përdorimit të teknologjive të reja;

f) Të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes dhe të asistencës teknike 24 orë në ditë, 7 ditë në javë;

g) Të instalojë sistemin e mbikëqyrjes, i cili duhet të vendoset në territorin e Republikës së Shqipërisë;

gj) Të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë pajisjet që përdor Ministria e Drejtësisë apo organet e tjera shtetërore të përfshira në mbikëqyrjen elektronike;

h) Të garantojë sigurinë e komunikimit të të dhënave gjatë komunikimit të Sallës Operative me kompjuterët fundorë të përdoruesve (client computers), përfshirë këtu edhe programe kriptimi;

i) Të sigurojë të gjitha pajisjet e nevojshme të komunikimit për të lidhur pajisjet elektronike me sallën operative (karta SIM dhe pajisje të tjera);

k) Të trajnojë personat e caktuar nga Ministria e Drejtësisë për përdorimin e sistemit të mbikëqyrjes.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

URDHËR

Nr. 05, datë 10/01/2013

PËR

**PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË DHE RREGULLAVE TË USHTRIMIT
TË KONTROLLEVE PËR MËNYRËN E REALIZIMIT TË MBIKQYRJES
ELEKTRONIKE, PERIODICITETIT DHE PËRMBAJTJES SË INFORMACIONIT
TË PËRCJELLË MINISTRISË SË DREJTËSISË, SI DHE RREGULLAVE PËR
PARAQITJEN E TË DHËNAVE TË PËRDITËSUARA PRANË GJYKATAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2, të nenit 7 të ligjit nr. 8768, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, paragrafit 4, të nenit 12 të ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, si dhe vendimi nr. 377, datë 06.06.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe të drejtat dhe detyrimet e tij”

URDHËROJ:

I. Metodologjia dhe rregullat e ushtrimit të kontrolleve nga Shërbimi i Provës për mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes elektronike

1. Mbikëqyrja elektronike e personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor, realizohet nga struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, e cila ushtron të gjitha kompetencat e organit që realizon ME-në, sipas ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

Mos përmbushja e detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 10494/2011 dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, përbën shkelje disiplinore sipas Kreut V të vendimit nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, dhe shqyrtohet/vlerësohet sipas rregullave të përcaktuara në të.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose personat e autorizuar prej tij, ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse, sipas metodologjisë dhe rregullave të përcaktuara në këtë urdhër.

3. Kontrolle të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse, ushtrojnë edhe personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, mbi bazën e informacioneve të marra apo sipas një programi kontrolli të përcaktuar.

4. Kontrolli mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse fokusohet në mbrojtjen e interesit publik, si dhe të interesave të ligjshme të subjekteve, dhe arrihet nëpërmjet:

- a) vlerësimit për përmbushjen e rregullt të detyrave të ngarkuara;
- b) vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore;
- c) dokumentimit të praktikave më të mira në respektimin e kërkesave ligjore;
- ç) rekomandimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- d) korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre;
- dh) marrjes së masave për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të subjektit;
- e) bashkëpunimit të ndërsjellët institucional.

5. Kontrolli mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse realizohet në përputhje me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, legjisllacionin në fuqi, si edhe brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë autoriteteve kontrolluese dhe në harmoni me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Procesi i kontrollit udhëhiqet nga këto parime:

- a) parimi i ligjshmërisë;
- b) parimi i pavarësisë së kontrollit;
- c) parimi i proporcionalitetit në ushtrimin e kontrollit;
- ç) parimi i informimit të subjekteve të interesuara dhe mbrojtjes së konfidencialitetit;
- d) parimi i një procesi të drejtë dhe objektiv;
- dh) parimi i formalizmit të procedurave dhe tipizmit të shkeljes;
- e) parimi i barazisë para ligjit;
- ë) parimi i prezumimit të pafajësisë.

6. Kontrolli mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse realizohet sipas kësaj metodologjie:

- a) kontrolli brenda sallës operative. Ky kontroll mund të ketë:
 - i. karakter njohës, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse;
 - ii. karakter evidentues, me qëllim vlerësimin dhe dokumentimin e shkeljeve disiplinore të kryera.
- b) kryerja e telefonatave në sallën operative në orare të papërcaktuara, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse.
- c) kontrolli i raporteve me shkrim, regjistrave dokumenteve të tjera të administruara nga struktura përgjegjëse. Ky kontroll mund të ketë:
 - i. karakter njohës, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse;
 - ii. karakter evidentues, me qëllim vlerësimin dhe dokumentimin e shkeljeve disiplinore të kryera.

7. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose në raste të veçanta Ministri i Drejtësisë, urdhërojnë ushtrimin e kontrollit edhe kur nevojitet informacioni për një nga subjektet nën mbikqyrje, ose gjatë fazës së vendosjes, heqjes apo kontrollit të funksionimit të rregullt të pajisjes për realizimin e mbikëqyrjes elektronike.

8. Procedura e kontrollit mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse, ndjek këto faza:
 - a) Faza paraprake, në të cilën përcaktohen nevoja për ushtrimin e kontrollit, rregullat e përgjithshme për planifikimin dhe organizimin e ushtrimit të kontrollit, si dhe përzgjedhja e metodologjinë më të përshtatshme që do të zbatohet.
 - b) Faza e kontrollit mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse, sipas njëres nga 3 metodat e parashikuara në pikën 6, të Kreut i të këtij urdhri.
 - c) Faza e analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të mbledhura dhe hartimi i raportit që përmban rezultatet veprimtarive të kryera gjatë kontrollit, duke përcaktuar qartësisht përfundimet dhe rekomandimet e arsyetuara.
 - ç) Faza përfundimtare, në të cilën ndiqen rezultatet dhe rekomandimet e nxjerra nga procesi i kontrollit.
9. Në rastet kur kontrolli mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse realizohet nëpërmjet kontrollit brenda sallës operative, apo kontrollit të raporteve me shkrim, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të administruara nga struktura përgjegjëse, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose personat e autorizuar prej tij, apo personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, njoftojnë strukturën përgjegjëse që realizon ME-në për detajet e kontrollit. Në rastin e ushtrimit të kontrollit nga personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, njoftohet edhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.
10. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose personat e autorizuar prej tij, apo personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, i dokumentojnë veprimet që ushtrojnë gjatë kontrollit, në një procesverbal që nënshkruhet prej tyre dhe një përfaqësuesi të strukturës përgjegjëse që realizon ME-në, në rastet e kontrollit brenda sallës operative, apo kontrollit të raporteve me shkrim, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të administruara nga struktura përgjegjëse.

Nëse përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse që realizon ME-në nuk pranon të nënshkruajë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës ose personat e autorizuar prej tij, apo personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, e evidentojnë këtë fakt në përmbajtjen e procesverbalit, së bashku me arsyet e refuzimit të nënshkrimit.
11. Sipas rastit, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose personat e autorizuar prej tij, apo personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, përgatisin draft-raportin e nënshkruar nga të gjithë personat e përfshirë në procesin e ushtrimit të kontrollit, i cili përmban:
 - a) vlerësimet mbi kontrollin e ushtruar dhe problematikat e evidentuara;
 - b) rekomandimet mbi problematikat e evidentuara.
12. Draft-raporti i dërgohet për njohje dhe vlerësim paraprak strukturës përgjegjëse që realizon ME-në, të cilët shprehin mendimin e tyre për përmbajtjen e tij brenda 5 ditëve nga momenti i marrjes dijeni. Pas marrjes së mendimit të tyre, hartohet raporti përfundimtar, i cili i paraqitet për miratim, sipas rastit Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose Ministrit të Drejtësisë.
13. Raporti përfundimtar duhet të jetë i strukturuar në tre pjesë si më poshtë:
 - a) Pjesa I - Përmbledhje ekzekutive/hyrje, ku duhet të përshihet informacion mbi:
 - i. grupin e kontrollit;

- ii. bazën ligjore për ushtrimin e kontrollit;
 - iii. periudhën kohore të kryerjes së kontrollit;
 - iv. arsyet dhe objektin e kontrollit;
 - v. metodologjinë e përdorur për ushtrimin e kontrollit; si dhe
 - vi. një përmbledhje sintetike të konkluzioneve dhe rekomandimeve të raportit.
- b) Pjesa II – Përshkrimi i fakteve/gjetjeve dhe analiza e tyre, ku duhet të përshihet informacion mbi:
- i. faktet/gjetjet e evidentuara dhe të verifikuara gjatë kontrollit; si dhe
 - ii. një analizë e hollësishme ligjore e fakteve/gjetjeve të evidentuara dhe të verifikuara gjatë kontrollit.
- c) Pjesa III – Konkluzionet, Observacionet dhe Rekomandimet, ku duhet të përshihet informacion mbi:
- i. konkluzionet e plota, të qarta, objektive dhe të mbështetura në referenca ligjore dhe nëse veprimet apo mosveprimet kanë sjellë pasojë;
 - ii. mendimet/prendimet e sjella nga struktura përgjegjëse që realizon ME-në, vërejtjet e marra parasysh në këtë raport, si dhe shkaqet e mos marrjes në konsideratë të mendimit/prendimit të shfaqur nga struktura përgjegjëse që realizon ME-në;
 - iii. rekomandimet, të cilat mund të jenë të përgjithshme ose të posaçme, dhe që duhet të jenë të argumentuara, praktikisht të realizueshme, të detajuara, të adresuara saktë dhe me afate të mirëpërcaktuara.

14. Pas miratimit të Raportit Përfundimtar të kontrollit, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, merr të gjitha masat e nevojshme për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të shprehura në raport, nga ai vetë apo struktura përgjegjëse. Në cdo rast, Raporti Përfundimtar i kontrollit i dërgohet për njohje Ministrit të Drejtësisë.

15. Mos ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të shprehura në Raportin Përfundimtar nga struktura përgjegjëse që realizon mbikëqyrjen elektronike përbën shkelje shkelje disiplinore sipas Kreut V të vendimit nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, dhe shqyrtohet/vlerësohet sipas rregullave të përcaktuara në të.

II. Periodiciteti dhe përmbajtja e informacionit të përcjellë për Ministrinë e Drejtësisë nga Shërbimi i Provës.

1. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës përcjell, brenda datës 5 të çdo muaji, një informacion të hollësishëm mbi realizimin e mbikëqyrjes elektronike. Informacioni mund të përcillet edhe jashtë këtij afati, sa herë që kërkohet nga Ministria e Drejtësisë, brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
2. Informacioni që i përcillet Ministrisë së Drejtësisë, duhet të përmbajë këto çështje:
 - a) Vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së strukturës përgjegjëse që realizon ME-në.
 - b) Ecurinë e mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me

vendim gjyqësor, problematikat e evidentuara në veprimtarinë e përditshme, apo çështje të tjera që kanë ndikim në ecurinë e procesit të mbikëqyrjes elektronike.

c) Numrin e subjekteve ndaj të cilëve është urdhëruar nga gjykata përdorimi i ME-së, gjatë një muaji, të ndarë sipas kategorisë së subjekteve të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. nr. 10494/2011.

ç) Numrin në total të subjekteve ndaj të cilëve është urdhëruar nga gjykata përdorimi i ME-së dhe që janë nën mbikëqyrje deri në datën e dërgimit të informacionit, të ndarë sipas kategorisë së subjekteve të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. nr. 10494/2011.

d) Numrin e subjekteve që kanë shkelur përcaktimet e vendimit gjyqësor që ka urdhëruar përdorimin e ME-së, si dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse në rastet kur janë shkelur detyrimet dhe kushtet e ME-së.

dh) Të dhëna të përditësuara për numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim dhe mundësinë teknike të realizimit të ME-së.

e) Numrin e kontrolleve të ushtruara, konkluzionet e përmbledhura të tyre, si dhe masat e marra për adresimin e rekomandimeve të përcaktuara në Raportet Përfundimtare të këtyre kontrolleve.

ë) Numrin e kërkesave për dhënien e autorizimit për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar, që janë miratuar apo refuzuar.

f) Nivelin e bashkëpunimit ndërinstytucional, me autoritetet e përfshira në realizimin e procesit të mbikëqyrjes elektronike, duke evidentuar sipas rastit edhe problematikat e hasura.

g) Çdo informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga struktura përgjegjëse që realizon ME-në apo Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose që kërkohet nga Ministria e Drejtësisë.

3. Informacioni që i përcillet Ministrisë së Drejtësisë përgatitet nga përgjegjësi i strukturës përgjegjëse për realizimin e ME-së dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

4. Format i tip i dërgimit të informacionit, i cili detyrimisht duhet të përfshijë çështjet e përcaktuara në pikën 2, të Kreut II të këtij urdhri, miratohet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

III. Rregullat për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Gjykatave të Apelit

1. Përgjegjësi i strukturës përgjegjëse për realizimin e ME-së, në fund të çdo jave, përllogaritë numrin e pajisjeve që ka patur në dispozicion javën e kaluar, numrin e pajisjeve që janë përdorur gjatë javës, numrin e vendimeve gjyqësore që kanë urdhëruar përdorimin e ME-së dhe që do të ekzekutohen gjatë javës së ardhshme, me qëllim përcaktimin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata.

2. Pas kryerjes së përllogaritjeve dhe analizave të hollësishme, sipas pikës 1 të Kreut III të këtij urdhri, përgjegjësi i strukturës përgjegjëse për realizimin e ME-së, brenda ditës së dielë të çdo jave, paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, të dhënat e përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose një person i autorizuar prej tij,

pasi vihet në dijeni me raportin e përgjegjësit të strukturës përgjegjëse për realizimin e ME-së, të hënën e cdo jave, vë në dispozicion të Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatave të Apelit, të dhënat e përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së.

4. Të dhënat e përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, i dërgon në formë elektronike dhe shkresore, njëkohësisht Kancelarit dhe Kryetarit të Gjykatës, brenda orës 10:00, të ditës së hënë të çdo jave.

5. Kancelari informon çdo ditë gjyqtarin që pritet të marrë një vendim, sipas neni 14 të ligjit nr. 10494/2011, si dhe cdo gjyqtar që kërkon një informacion të tillë, për të dhënat e përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së.

6. Kancelari merr informacion çdo ditë mbi numrin e vendimeve gjyqësore që kanë urdhëruar përdorimin e ME-së dhe përditëson të dhënat e dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës mbi numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së. Këtë informacion Kancelari ia njofton në rrugë elektronike edhe strukturës përgjegjëse për realizimin e ME-së.

7. Sipas rastit, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, Kancelari apo Kryetari i Gjykatës, njoftojnë Ministrin e Drejtësisë për çdo problem që lidhet me procesin e mbikëqyrjes elektronike, si dhe mënyrën e bashkëpunimit midis tyre.

8. Format i tip për paraqitjen e të dhënave të përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së, miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

IV. Dispozita të fundit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, në fazën e projektit pilot, dërgon të dhënat e përditësuara lidhur me numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim nga gjykata dhe mundësitë teknike për realizimin e ME-së, vetëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, miraton formatin tip sipas pikës 4, të Kreut II dhe pikës 8 të Kreut III, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Cështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, i njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, të dhënat e kontaktit, të Kancelarit e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë.

4. Ky urdhër i njoftohet menjëherë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës dhe Kancelarit e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Kancelarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EDUARD HALIMI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

UDHËZIM

NR. 06, DATË 10/01/ 2013

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR KRITERET
E DHËNIES SË AUTORIZIMIT PËR SUBJEKTET E VENDOSURA NËN
MBIKQYRJE ELEKTRONIKE PËR TË DALË NGA ZONA E LEJUAR OSE PËR
TË HYRË NË ZONËN E NDALUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe paragrafit 6, të nenit 18 të ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”,

UDHËZOJ:

1. Subjekti ndaj të cilit është vendosur me vendim gjyqësor përdorimi i mbikëqyrjes elektronike është i detyruar të qëndrojë brenda zonës së lejuar ose larg zonës së ndaluar, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin gjyqësor, me përjashtim të rasteve kur ka marrë një autorizim për të dalë ose për të hyrë në zonën e ndaluar, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Autorizimi për të dalë nga zona e ndaluar ose për të hyrë në zonën e ndaluar për subjektet e vendosura nën mbikëqyrje elektronike, jepet:

- a) Në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes së subjektit nën mbikëqyrje elektronike, të vërtetuar me raport mjekësor;
- b) Në rast vdekjeje të një anëtari të familjes së subjektit nën mbikëqyrje elektronike;
- c) Në rast martese të tij apo të një anëtari të familjes së subjektit nën mbikëqyrje elektronike; ose
- ç) Në rast të lindjes së fëmijës, motrës apo vëllait të subjektit nën mbikëqyrje elektronike.

3. Në kuptim të pikës 2 të këtij udhëzimi me:

- a) anëtarë të familjes së subjektit nën mbikëqyrje elektronike, nënkuptohen nëna, babai, fëmijët, motra, vëllai, bashkëshorti/ja.
- b) “sëmundje të rënde” nënkuptohet çdo sëmundje që lidhet me çrregullime fizike që cenojnë ose vënë në rrezik në mënyrë të dukshme integritetin fizik ose jetën e anëtarit të familjes së subjektit, në atë masë që mund të sjellin si pasojë vdekjen e tij dhe për këtë shkak kërkon përkujdesje të veçantë mjekësore apo familjare.

4. Autorizimi mund të jepet deri në 7 ditë dhe, me kërkesë të subjektit nën mbikëqyrje elektronike, vetëm në rastet e sëmundjeve të rënda, mund të zgjatet për aq kohë sa e diktojnë

rrethanat. Në çdo rast, kohëzgjatja e autorizimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e autorizimeve për subjektin nën mbikëqyrje elektronike për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar.

6. Subjekti nën mbikëqyrje elektronike në rastet kur kërkon autorizimin për të dalë nga zona e lejuar apo të hyrë në zonën e ndaluar duhet të paraqesë kërkesë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Kjo kërkesë regjistrohet në një regjistër të posaçëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

7. Kërkesa e subjektit nën mbikëqyrje elektronike për marrjen e autorizimit për të dalë nga zona e lejuar apo për të hyrë në zonën e ndaluar duhet të përmbajë:

- a) Gjeneralitetet e subjektit që kërkon autorizim;
- b) Arsyen për të cilën kërkohet autorizimi;
- c) Afatin kohor për të cilin kërkohet autorizimi;
- d) Dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim sipas shkaktit për të cilën kërkohet autorizimi, si dhe çdo dokument tjetër që mund të mbështesë kërkesën për autorizim.

Për subjektin e mitur, krahas kërkesës së subjektit duhet të jepet pëlqimi me shkrim edhe nga prindi ose kujdestari i tij ligjor.

Formati tip i kërkesës miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës dhe publikohet në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit të Provës.

8. Kërkesa e subjektit duhet të jetë e argumentuar dhe e shoqëruar nga dokumentacioni përkatës. Në raste të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes kërkesa duhet të shoqërohet me raportin mjekësor të familjarit të sëmurë ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore e tij. Në rastet e ngjarjeve të rëndësishme familjare si vdekje, lindje apo martesë kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin zyrtar që provon vdekjen, lindjen apo martesën. Në çdo rast, aktet e gjendjes civile duhet të jenë lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për autorizim.

9. Për autorizimin e kërkuar për shkak të sëmundjes së rëndë që rrezikon jetën e anëtarit të familjes, subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) certifikatë të zyrës së gjendjes civile që provon lidhjen familjare të subjektit me të sëmurin.
- b) Epikrizën mjekësore që provon sëmundjen e rëndë, të lëshuar nga spitali publik apo privat ku është trajtuar ose trajtohet familjari i sëmurë. Epikrizja mjekësore duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të saj dhe duhet:
 - i. të përmbajë datën e lëshimit të saj, datën e shtrimit/trajtimit në spital, numrin e kartelës, pavijonin ku është shtruar/trajtuar.
 - ii. të përmbajë firmën e 3 mjekëve, vulat personale të tyre.
 - iii. të konfirmohet nëpërmjet nënshkrimit të Drejtorit të institucionit mjekësor, si dhe vulozet me vulën e institucionit.
 - iv. të shoqërohet ose të përmbajë të dhënat mbi institucionin mjekësor, duke përfshirë adresën dhe numrin e telefonit, si dhe numrin e telefonit të mjekëve dhe Drejtorit të institucionit mjekësor.
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit të subjektit

10. Për autorizimin që jepet në rastet e vdekjes së anëtarit të familjes, subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) certifikatë të zyrës së gjendjes civile që provon lidhjen e subjektit me anëtarin e familjes që ka vdekur.
- b) Certifikatën e vdekjes ose skedën e vdekjes të anëtarit të familjes të subjektit lëshuar nga autoriteti shtetëror apo vërtetim nga mjeku i zonës, qendra shëndetësore, spitali apo urgjenca përkatëse, ku ka ndodhur vdekja, në përputhje me ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit të subjektit

11. Për autorizimin që jepet në rastet e martesës së vetë ose të anëtarit të familjes, subjekti duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- a) Certifikatën e martesës së anëtarit të familjes së subjektit ose kërkesën për shpallje martese lëshuar nga komuna ose bashkia, ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin,
- b) Vërtetimet e njërive vendore që vërtetojnë datën e zhvillimit të ceremonisë së martesës nga të dy bashkëshortët,
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit të subjektit

12. Për autorizimin që jepet për shkak të lindjes së fëmijës, fëmijës, motrës apo vëllait, subjekti duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- a) Certifikatën e lindjes apo vërtetimin nga organi shëndetësor, shtetëror ose privat, që sipas ligjit nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, ka të drejtë të vërtetojë lindjen dhe njoftimin për lindjet e ndodhura.
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit të subjektit

13. Pas marrjes së kërkesës së argumentuar nga subjekti, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës urdhëron brenda ditës së marrjes së kërkesës, një ose dy punonjës të Shërbimit të Provës, për shqyrtimin e kërkesës dhe përgatitjen e dokumentacionit që do të shërbejë si bazë për miratimin apo refuzimin e dhënies së autorizimit.

14. Punonjësit e Shërbimit të Provës të ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës përgatisin brenda ditës nga dita e marrjes së urdhrin, një raport të hollësishëm, i cili shpjegon dhe dokumenton:

- a) lidhjen e ngushtë familjare të subjektit me personin e sëmurë rëndë, të vdekur, të lindur ose të martuar;
- b) arsyet për të cilin subjekti është vendosur nën mbikëqyrje elektronike;
- c) respektimin prej tij të kushteve të mbikëqyrjes elektronike
- ç) çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me subjektin e vendosur nën mbikëqyrje elektronike;
- d) propozimin e argumentuar të miratimit apo refuzimit të dhënies së autorizimit dhe të ditëve që subjekti duhet të marrë autorizimin.

15. Raporti, propozimi dhe dokumentacioni i paraqiten brenda 1 dite Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, i cili e shqyrton dhe jep miratimin apo refuzimin, në mënyrë të arsyetuar.

16. Vendimi për miratimin ose refuzimin e autorizimit për të dalë nga zona e lejuar

apo për të hyrë në zonën e ndaluar, i njoftohet brenda ditës kërkuesit, Sallës Operative dhe Komisariatit të Policisë. Autorizimet e dhëna regjistrohen në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim, i cili titullohet “Regjistri i Autorizimeve për personin e vdekur nën mbikëqyrje elektronike, për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar”. Autorizimi, raporti dhe propozimi i punonjësve të shërbimit të provës, si dhe kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues, ruhen në arkivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

17. Në rast të ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme, nga të cilat rrezikohet jeta dhe shëndeti i subjektit nën mbikëqyrje elektronike dhe për të cilën ai është i detyruar të dalë nga zona e lejuar ose të hyjë në zonën e ndaluar, subjekti ose personi i afërt i caktuar në vendimin gjyqësor, duhet të njoftojë menjëherë Sallën Operative për rrethanën. Me rrethana të jashtëzakonshme nënkuptohet rasti i forcave madhore, ku përfshihet, por pa u kufizuar, zjarri, përmbytja, tërmeti, sulmi i armatosur, ose sëmundja e rëndë e subjektit nën mbikëqyrje, që kërkon një trajtim të specializuar spitalor të tij.

18. Me marrjen e njoftimit sipas pikës 17 të këtij udhëzimi, Salla Operative njofton menjëherë Policinë e Shtetit për rrethanën dhe kërkon verifikimin e ekzistencës së saj, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit.

19. Në rast se Policia e Shtetit konfirmon ekzistencën e rrethanës së jashtëzakonshme që rrezikon jetën dhe shëndetin e subjektit nën mbikëqyrje elektronike, Salla Operative, nëpërmjet punonjësit që merr njoftimin, autorizon subjektin të dalë nga zona e lejuar ose të hyjë në zonën e ndaluar. Në këtë rast, autorizimi regjistrohet në regjistrin “Autorizimet për personin e vendosur nën mbikëqyrje elektronike, për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar në rrethana të jashtëzakonshme”.

20. Salla Operative, në rastin e rrethanave të jashtëzakonshme i kërkon Policisë së Shtetit të mbajë nën mbikëqyrje subjektin. Nëse rrethana e jashtëzakonshme mund të zgjasë më shumë se 12 orë, Salla Operative njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, i cili konfirmon autorizimin, si dhe përcakton kohëzgjatjen e tij. Konfirmimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës i njoftohet brenda ditës Sallës Operative, e cila merr masat për njoftimin e subjektit nën mbikëqyrje elektronike ose personin e afërt të caktuar në vendimin gjyqësor.

21. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, në informacionin e dërguar çdo muaj pranë Ministrisë së Drejtësisë, specifikon edhe numrin e autorizimeve të dhëna për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar. Raporti shoqërohet edhe me kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ose autorizimet e dhëna nga Salla Operative në rastin e ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme dhe ose konfirmimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

22. Shërbimi i Provës, në çdo rast të vendosjes së pajisjes që realizon mbikëqyrjen elektronike, siguron informacionin e nevojshëm për subjektin mbi përmbajtjen e këtij udhëzimi. Me kërkesë të subjektit, Shërbimi i Provës, i siguron atij një kopje të këtij udhëzimi.

23. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, miraton formatin tip sipas pikës 7 të

këtij udhëzimi, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

24. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, merr masat për nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, për zbatimin e detyrimeve të përbashkëta sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim dhe në ligjin nr. 10494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

25. Ky udhëzim i njoftohet menjëherë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

26. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EDUARD HALIMI

SHTOJCA 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
ZYRA VENDORE TIRANË

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda
Tel: + 355 042 232 852

Intervistë

[vendi] [Data e intervistës (dd:mm:vvvv)] [ora (oo:mm)]

	:	
--	---	--

Emri, Mbiemri			
Datëlindja		Gjinia:	☐ Mashkull ☐ Femër
Gjuha amtare	☐ shqipe ☐ tjetër _____ (në rastin kur është nevojitur përkthyes)		
Kryer në prani të	☐ Prindit ☐ Mbrojtësit ligjor ☐ Psikologut ☐ Tjetër _____ (specifiko)		

Formular i plotësuar në funksion të hartimit të :	☐ Programit Individual të Trajtimit ☐ Hartimit të raportit të vlerësimit për personin nën akuzë/ të pandehurin ☐ Hartimit të raportit të vlerësimit për të dënuarin (Lirim me kusht, Qëndrim në shtëpi, Gjysmëliri)
---	--

Numër personal kontakti	Adresa e vendbanimit

<i>Personi i kontaktit (emër, mbiemër) Prindi, mbrojtësi ligjor, i afërm, etj...</i>	<i>Nr. telefonik i personit të kontaktit</i>

❖ **Rrethanat familjare/anëtarët e familjes me të cilët jeton dhe ekonomia familjare:**

** Shënoni anëtarët në mënyrë zbritëse duke u nisur nga mosha*

Emri/ mbiemri	Mosha	Gjinia	Lidhja me personin	Arsimi	Statusi i punësimit	Probleme me ligjin	Të ardhura mesatare/ muaj

❖ **Kushtet e jetesës:**

Lloji i banesës	Nr. i personave të cilët jetojnë në këtë banesë	Nr. i dhomave të disponueshme në banesë	* Shumë në lekë e qirasë mujore
Apartament në pronësi			
Shtëpi private në pronësi			
* Banesë me qira			
Pa strehë			

Tjetër (specifikoni):			
-----------------------	--	--	--

Duke marrë parasysh dhe informacionin e dhënë me sipër, si do t'i përshkruanit kushtet e banimit të familjes tuaj?

*Shënoni një " x " në të djathtë të alternativës së përzgjedhur.

Shumë të këqija	Të këqija	Të mjaftueshme	Të mira	Shumë të mira
-----------------	-----------	----------------	---------	---------------

❖ HISTORIA E PUNËSIMIT

A keni qenë i punësuar apo i papunë në kohën rreth ngjarjes në fjalë?

* Shënoni kohëzgjatjen e papunësisë, shkaqet, nëse personi ka qenë duke kërkuar në mënyrë aktive për punësim, etj...

.....

.....

.....

Punësimi aktual/punësimi i fundit

*Shënoni detaje mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit, marrëdhëniet me punëdhënësin e kolegët, nëse personi është pushuar nga ky vend, etj...

.....

.....

Nëse i papunë, a keni një ofertë/kontratë punësimi të sigurt?

*Shënoni detaje që kanë të bëjnë me punësimin apo kontratën e punësimit

.....

.....

Kualifikime të cilat do ta ndihmojnë në fitimin dhe mbajtjen e një vendi pune

*Shënoni llojin/llojet e kualifikimit

.....

.....

❖ MARRËDHËNIET ME KOMUNITETIN

Prej sa kohësh jetoni në komunitetin ku jetoni aktualisht?

.....

.....

.....

A keni pasur konflikte apo probleme me anëtarë të komunitetit ku ju/familja juaj jetoni?

❖ ABUZIMI ME ALKOOLIN DHE DROGAT

Histori me konsum problematik të alkoolit?

Shpeshtësia :

Sasia :

Histori me konsum problematik të drogave?

Substanca(t) :

Shpeshtësia :

Sasia :

Probleme me alkoolin gjatë ose rreth periudhës së ngjarjes së ndodhur?

Probleme me drogën gjatë ose rreth periudhës së veprës penale?

.....Përdorimi i drogës ose alkoolit ka shkaktuar probleme në shtëpi/shkolle/punë në periudhën gjatë ose rreth ngjarjes së ndodhur?

.....

Jeni shoqëruar me miq apo persona të tjerë të cilët kanë probleme të përdorimit të alkoolit apo drogës?

❖ Marrëdhëniet me të tjerët

Marrëdhënie problematike me partnerin/partneren gjatë ose rreth periudhës së veprës penale në fjalë?

*Specifikoni natyrën e problemeve, zgjatjen kohore, etj...

.....

Marrëdhënie problematike me prindërit gjatë ose rreth periudhës së veprës penale në fjalë?

*Specifikoni natyrën e problemeve, zgjatjen kohore, etj...

.....

Shokë apo bashkëpunëtorë janë përfshirë në aktivitete kriminale gjatë ose rreth periudhës së veprës penale në fjalë?

.....

Shokë apo bashkëpunëtorë kanë pasur ndikim negativ gjatë ose rreth periudhës së veprës penale në fjalë?

.....

SHËNDETI FIZIK

*Shënoni probleme shëndetësore të personit apo të anëtarëve të familjes të cilët kanë nevojë për kujdes të veçantë apo përbëjnë pengesë për punësim apo aktivitete të tjera ditore

.....

HISTORIA E KALUAR PERSONALE

*Ngjarje apo episode tronditëse për personin gjatë periudhës së fëmijërisë dhe adoleshencës
Shënoni ndonjë ngjarje e cila mund të ketë lënë pasojë në mënyrën e sjelljes dhe të menduarit:
si p.sh. divorc i prindërve, mungesë e përkujdesjes nga prindi/prindërit, forma të dhunës fizike apo psikologjike, etj...

.....

KARAKTERISTIKA TË PERSONALITETIT

* Këtu shënoni karakteristika që kanë të bëjnë me mënyrën se si personi e sheh veten e tij në raport me të tjerët p.sh. nëse personi është i hapur apo i mbyllur në komunikim të tjerët, i shoqërueshëm apo i tërhequr, i qetë apo impulsiv, i shtyrë drejt normave të komunitetit apo shpërfilljes së tyre, etj ... kini kujdes që pyetjet të ndërtohen nga ju në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Gjithashtu këtu mund të shënoni vëzhgimet tuaja në lidhje me personin bazuar në ndërveprimin gjatë intervistës.

.....
.....
.....

MOTIVIMI

Faktorë motivues për personin/në lidhje me përmirësimin e gjendjes (nëse ka) si dhe faktorë të cilët shërbejnë si barriera për përsëritjen e veprës penale.

*Këtu shënoni faktorë të cilët ndikojnë në motivimin e personit për përmirësimin e gjendjes aktuale (faktorë ekonomikë, faktorë shëndetësorë, faktorë familjare, etj...)

.....
.....
.....

PLANET PËR RI-INTEGRIM

Cilat janë planet tuaja për të ardhmen e afërt dhe përmirësimin e gjendjes në të cilën ndodheni aktualisht?

*Shënoni plane që kanë të bëjnë me punësimin, shkollimin, trajnimin, zgjidhjen e konflikteve ekzistuese, zgjidhjen e problemeve të natyrave të ndryshme. Është mirë të adresohen të gjitha çështjet problematike që dalin gjatë kryerjes së intervistave.

.....
.....
.....

Përshkrimi i ngjarjes

* Shënoni në mënyrë të detajuar rrjedhën e ngjarjes, personat e përfshirë në ngjarje, rolin në ngjarje, etj...

.....
.....
.....

Ekzistonin ide, synime apo plane paraprake lidhur me ngjarjen?

.....
.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....Si u ndjetë pas ngjarjes?

.....

.....

.....

.....

.....

A skripten aktuellicht adoniä konfölt ma persong tö nöfshirü nö psicrie

337

Shënime (*këtu shënoni informacion i cili nuk ka qenë i mundur të merret me anë të pyetjeve të mësipërme):

.....

.....

.....

I intervistuari

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Specialisti i Shërbimit të Provës

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Shtojca 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
Zyra Vendore e Shërbimit të Provës _____

Tepër konfidencial
pasi të plotësohet

RAPORT I VLERËSIMIT
për personin nën hetim / të pandehurin

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i personit nën hetim / të pandehurit:

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e personit nën hetim / të pandehurit:

Adresa e personit nën hetim / të pandehurit:

Vepra/veprat penale për të cilën/cilat personi është nën hetim/akuzohet:

Gjykata/Prokuroria që ka kërkuar raportin e vlerësimit:

Numri i dosjes penale:

Data e seancës gjyqësore:

Data dhe numri i kërkesës së gjykatës/prokurorisë për raportin e vlerësimit:

Lloji dhe kohëzgjatja e masës/masave të sigurimit, nëse ka:

Emri dhe mbiemri i punonjësit të shërbimit të provës që ka përgatitur raportin: -----

II. Burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin

(personat e intervistuar, numri dhe datat e intervistave të bëra me çdo person, dokumentet e konsultuara, çdo refuzim për të bashkëpunuar apo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, çdo burim të informacionit mbi të cilat aksesi ka qenë i pamundur)

III. Përshkrimi dhe analiza e veprës/veprave penale për të cilën/cilat personi është nën hetim/akuzohet

(përfshirë shkakun/shkaqet për kryerjen e veprës penale, qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së kryer dhe dëmi i shkaktuar viktimës/viktimave, nëse ka)

IV. Përshkrimi dhe analiza e autorit të veprës penale

(përfshirë jetën dhe historinë personale të autorit të veprës penale që ka lidhje me kryerjen e veprës penale)

V. Analiza dhe vlerësimi i rrezikut

(rreziku i përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij, përfshirë mënyrën e reduktimit apo menaxhimit të rrezikut, nëse ka)

VI. Konkluzione dhe rekomandime

(përfshirë propozimin për marrjen në konsideratë nga gjykata/prokuroria për llojin dhe kohëzgjatjen e masës/dënimit që do jepet duke shpjeguar arsyet se përse një masë/dënim i tillë konsiderohet më i përshtatshmi në këtë rast)

Data e përgatitjes dhe e nënshkrimit të raportit të vlerësimit -----

Nënshkrimi i punonjësit të shërbimit të provës që përgatiti raportin

.....

Drejtori i zyrës vendore (emri dhe nënshkrimi)

.....

Vula e zyrës vendore të shërbimit të provës

Shtojca 8

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI PROVËS
ZYRA VENDORE TIRANË**

Tepër konfidencial pasi të plotësohet

**RAPORT I VLERËSIMIT
për të dënuarin**

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i të dënuarit:

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e të dënuarit:

Adresa e të dënuarit:

Vepra/veprat penale për të cilën/për të cilat është dënuar personi për të cilin hartohet ky raport:

Gjykata/Prokuroria¹ së cilës i dërgohet raporti i vlerësimit:

Data dhe numri i vendimit përfundimtar:

Lloji dhe kohëzgjatja e dënimit (përfshirë datën e fillimit dhe mbarimit) të dhënë nga gjykata:

Detyrimet e dhëna nga gjykata për të dënuarin (parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal), nëse ka:

¹ _____ Rrethoni të duhurën.

343

IV. Analizimi dhe vlerësimi i rrezikut

(përfshirë, sipas rastit, informacion mbi: çdo ndryshim të rrezikut të identifikuar në fillim të përsëritjes së veprave penale dhe/ose dëmit të të dënuarit; zgjidhjet praktike që janë përdorur për të menaxhuar dhe reduktuar rreziqet; gjendjen familjare, rrethanat sociale të të dënuarit dhe planet konkrete për riintegrimin e tij social pas lirimit me kusht)

V. Konkluzione dhe rekomandime

(përfshirë propozimin e shërbimit të provës, së bashku me arsyet përkatëse lidhur me veprimin që duhet të marrë prokurori/gjykata, sipas rastit:

- në rast se i dënuari ka bërë progres gjatë ekzekutimit të dënimit:
 - vazhdimi i ekzekutimit të dënimit me të njëjtat kushte, ose
 - përfundimi para kohe i dënimit alternativ.
 - në rastin e të miturit ose shkeljeve të para të kushteve apo detyrimeve, paralajmërimi i prokurorit:
ose
 - ndryshimin e kushteve dhe detyrimeve të dhëna nga gjykata, kur ka arsye për të besuar se ato nuk janë më të përshtatshme ose nuk mund të përmbushen nga i dënuari,
ose
 - në rastin e shkeljeve të rënda apo të përsëritura:
 - detyrime shtesë të vendosura nga gjykata, ose
 - zgjatje të periudhës së provës, ose,
 - zëvendësimin e dënimit alternativ me një tjetër dënim alternativ, ose
 - revokimin e plotës apo të pjesshëm të dënimit të pezulluar dhe ekzekutimi i dënimit me burgim).
-
-
-
-
-

Data e përgatitjes dhe e nënshkrimit të raportit të vlerësimit.....

Nënshkrimi i punonjësit të shërbimit të provës që përgatiti raportin

Drejtori i zyrës vendore (emri dhe nënshkrimi)

Vula e zyrës vendore të shërbimit të provës

SHTOJCA 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E DREJTËSISË SHËRBIMI I PROVËS ZYRA VENDORE TIRANË

PROGRAMI INDIVIDUAL I TRAJTIMIT

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i të dënuarit:

Datëlindja dhe vendlindja:

Adresa e të dënuarit:

Vepra/veprat penale e(të) kryer(a):

Numri i vendimit gjyqësor:

Dënimi alternativ i dhënë nga gjykata:

Periudha e provës:

Data e fillimit të mbikëqyrjes:

Data e mbarimit të mbikëqyrjes:

Emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës së caktuar:

II. Masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata dhe mënyrat e përdorura për të siguruar përmbushjen e tyre

III. Nevojat kriminogjene dhe sociale të të dënuarit dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre

IV. Rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit

V. Metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuara dhe për të reduktuar rrezikun

VI. Data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit gjatë periudhës së mbikëqyrjes

VII. Përmbajtja, kohëzgjatja dhe mënyra e kryerjes së detyrimit për të marrë pjesë në një program rehabilitimi (vetëm kur gjykata vendos një detyrim të tillë)

VIII. Përshkrimi i veprimtarive, vendi i përmbushjes dhe oraret e saj (vetëm kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik)

I dënuari është njohur me përmbajtjen e Programit Individual të Trajtimit dhe kupton bashkëpunimin në përmbushjen e detyrimeve të tij.

Një kopje e Programit Individual të Trajtimit, e plotësuar dhe e nënshkruar, i dorëzohet të dënuarit. Në rastet kur i dënuari është i mitur, gjithashtu një kopje e Programit Individual të Trajtimit, e plotësuar dhe e nënshkruar, i dorëzohet mbrojtësit të tij/saj.

Data dhe vendi i nënshkrimit të Programit Individual të Trajtimit

Punonjësi i Shërbimit të Provës, (emri, mbiemri dhe firma)

I dënuari (emri, mbiemri dhe firma)

Mbrojtësi (emri, mbiemri dhe firma)
(vetëm në rastin kur i dënuari është i mitur)

SHTOJCA 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E DREJTËSISË SHËRBIMI I PROVËS

RAPORT PËRFUNDIMTAR

I. Të dhëna të përgjithshme

Emri i personit të dënuar: _____

Mbiemri: _____

Atësia: _____

Amësia: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Vendbanimi: _____

Gjendja Civile: _____

II-Numri dhe data e vendimit gjyqësor:

Lloji i dënimit alternativ: _____

Periudha e mbikqyrjes: _____

III- Data e fillimit të dënimit alternativ _____

Data e përfundimit të dënimit alternativ _____

IV- Arsyeja e përfundimit të masës alternative _____

V- Ecuria e përmbushjes së detyrimeve dhe masës alternative të dënimit

VI- Specialisti përgjegjës i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

VII- Drejtori i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës_____

Vula e zyres vendore te sherbimit te provës

Shtojca 11

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nënshkruhet midis palëve:

Përfaqësuar nga:

Palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Konteksti i bashkëpunimit

Në kuadër të zbatimit të programit, objektivi kryesor i bashkëpunimit ësh të.....

Për zbatimin e programit palët bien dakord Zbatimi i programit do të jetë sipas neneve të mëposhtme.....

Neni 2

Kohëzgjatja e bashkëpunimit

Bashkëpunimi do të zgjasë sipas marrëveshjes.....

Neni 3

Aktivitetet

Palët bien dakord që të zbatojnë aktivitetet e mëposhtme.....

Neni 4

Njoftimi i autoritetit përgjegjës

Neni 5

Personeli

1. Shërbimi i provës.....
2. Organizata do të punësojë.....
3. Kontratat do të përcaktojnë.....

Neni 6
Shpenzimet

1. Palët bien dakord që të ndajnë shpenzimet sipas Buxhetit si Aneks i kësaj Marrëveshjeje

Neni 7
Monitorimi dhe vlerësimi

Neni 8
Kushtet e pagesës

Neni 9
Konfidencialiteti

Neni 10
Ligjshmëria e veprimeve

Neni 11
Përfundimi – Ndryshime të Marrëveshjes

Neni 12
Zgjidhje të mosmarrëveshjeve

Për

Shërbimin e provës

Për

Organizatën

Aneks:
Buxheti